

Botohet me rastin e vitit jubilar, 20-vjetorit të çlirimit të Kosovës

Kryeredaktor:

Prof. asoc. dr. Sabit Syla

Redaktor shkencor:

Prof. dr. Ibrahim Gashi

Sekretar i redaksisë:

Prof. asoc. dr. Gjon Berisha

Redaksia:

Akademik Marenglen Verli

Prof. dr. Frashër Demaj

Akademik Beqir Meta

Prof. dr. Skënder Asani

Redaktore gjuhësore:

Shqipe Doda

Realizimi kompjuterik:

Teuta Zeqiri -Aliu

© 2020 Instituti i Historisë “Ali Hadri”-Prishtinë

Ueb: www.ih-rks.org; e-mail: institutihis@hotmail.com

INSTITUTI I HISTORISË “ALI HADRI” - PRISHTINË

“Kosova - rruga drejt lirisë”

(Materiale nga Konferenca shkencore ndërkombëtare: “Kosova-rruga drejt lirisë”,
organizuar me rastin e vitit jubilar, 20-vjetorit të çlirimit të Kosovës, Prishtinë, më
11 qershor 2019)



Prishtinë, 2020

PËRMBAJTJA

Fjala e hapjes

Prof. asoc. dr. Sabit SYLA, drejtor i Institutit të Historisë – Prishtinë.....9

Marenglen VERLI

Çështja e Kosovës dhe stabiliteti i shtetit shqiptar, 1912-1999.....13

Jakup KRASNIQI

Lufta çlirimtare e Kosovës në fokus të autorëve të huaj.....29

Beqir META

Ndikimi i faktorëve ndërkombëtarë në rezultatet e rezistencës së shqiptarëve të Kosovës gjatë shek. XX39.....41

Qerim LITA

Problemi i Kosovës, 1981-1990.....57

Hamit KABA

Kosova në rrugën drejt pavarësisë dhe politika e SHBA-së.....91

Kalojan METODIEV& Anton PANÇEV

Qëndrimi i Bullgarisë ndaj Kosovës, fundi i shek. XX dhe fillim shekulli XXI.....103

Ksenofon KRISAFI

Diplomacia e Shqipërisë në mbrojtje të Kosovës.....115

Frashër DEMAJ

Sensibilizimi dhe ndërkombëtarizimi i çështjes së Kosovës, 1990-1996.....147

Ibrahim GASHI

Kontribut në periodizimin historik të lëvizjes për pavarësinë e Kosovës.....173

Zeqirja REXHEPI

Shqiptarët e Maqedonisë dhe roli i tyre gjatë kohës së çlirimit të Kosovës.....179

Afrim KRASNIQI

Kosova në aktet zyrtare të shtetit shqiptar, 1991-2008.....199

Haki KASUMI

Masakra në Burgun e Dubravës (Maj 1999).....231

Fati ISENI

Debat i për Kosovën në Parlamentin britanik gjatë krizës së viteve të '90 – ta.....253

Minir ADEMI &Avni AVDIU

Pjesëmarrja e shqiptarëve të Maqedonisë në luftën e UÇK-së përçlirimin e Kosovës.....287

Isamedin AZIZI

Zhvillimet politike në Maqedoni në kohëne luftës së Kosovës.....303

Yüksel HOŞ

Analizë politike dhe socio-kulturore e qasjes së medias turke ndaj luftës së Kosovës për pavarësi.....319

Armend MEHMETI

Qëndrimi i klasës politike të Kosovës ndaj ndryshimeve kushtetuese të vitit 1989.....339

Teuta SHALA-PELI

Krimet serbe në rajonin e Pejës, mars-qershor 1999.....361

Fitim RIFATI & Naim MUSLIU

Krimet serbe ndaj shqiptarëve në Anamoravë (1998-19.....375

Miftar KURTI

Ushtria Çlirimtare e Kosovës sipas Henry H. Perritt Jr. dhe James Pettifer.....405

Mrika LIMANI

Ndërhyrja e NATO-s në luftën e Kosovës.....421

Fjala e hapjes

Prof. asoc. dr. Sabit SYLA, drejtor i Institutit të Historisë - Prishtinë

Prishtinë, 11.06.2019

I nderuar Ministër i Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë, z. Shyqyri Bytyçi,

I nderuar ish-Kryetar i Kuvendit, z. Jakup Krasniqi,

I nderuar Akademik Marenglen Verli, Akademik Beqir Meta, Zotëri Skënder Asani,

Deputetë, përfaqësues të institucioneve, mediave, studentë, mysafirë,

Të respektuar referues, zonja dhe zotërinj!

Përpyjekjet e shqiptarëve për formimin e një shteti gjatë shekullit XIX dhe fillimit të shekullit XX, nuk gjetën përkrahjen e duhur tek faktori relevant ndërkombëtar. Shqiptarët shpallën Pavarësinë e Shqipërisë në Vlorë, por, si pasojë e vendimeve të Konferencës së Ambasadorëve në Londër, shteti i ri shqiptar u njoh në kufij etnikë të përgjysmuar dhe Kosova iu aneksua dhunshëm Mbretërisë së Serbisë. Përkundër padrejtësive historike, angazhimi i shqiptarëve të Kosovës për çlirim dhe bashkim nuk u ndal as pas luftërave ballkanike, Luftës së Parë Botërore, ndërmjet dy luftërave botërore, si dhe gjatë dhe pas Luftës së Dytë Botërore.

Në këtë proces të gjatë rrugëtimi, në fundshekullin XX, do të ndeshemi me dhembjen e vazhdueshme për bijtë e rënë në luftë, për

civilët e masakruar dhe për zhvendosjen “*biblike*” të mijëra shqiptarëve, si dhe për shkatërrimin e shtëpive, të pronave dhe të çdo gjëje shqiptare. Në Kosovë, pushteti serb bëri krime të përmasave të gjenocidit: aksione të ideuara dhe të planifikuara në detaje nga Serbia, përkatësisht nga qarqet e saj politike, shkencore, kulturore dhe ushtarake. Gjatë këtij procesi të shtetndërtimit, në vigjilje të shek. XXI, ndeshemi edhe me heroizmin e qytetarëve shqiptarë të Kosovës në rrugën e tyre pa kthim, drejt lirisë e pavarësisë. Në fund të viteve ‘90-të, të shek. XX, lufta çlirimtare, e cila pati si pikë reference çlirimin kombëtar, u bë gjenerues i problemeve që ndikuan thellësisht në diplomacinë preventive të SHBA-së e fuqive evropiane. Lufta për çlirim i dha fund *status quo*-së shumëvjeçare dhe nismë procesit të pandalshëm duke e shndërruar çështjen e Kosovës në një problem mbarëkombëtar dhe u vu, si asnjëherë tjetër në historinë kombëtare të shqiptarëve, në fokusin e vëmendjes botërore. Tashmë është e qartë se pa Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës dhe pa luftën e saj, nuk do të kishte ndërhyrje të NATO-s dhe as mbështetje të opinionit ndërkombëtar dhe organizmave tjerë evropianë e botërorë.

Kosova sot feston 20-vjetorin e çlirimit. Data 12 qershor është ditë historike për Kosovën, sepse shënon ditën kur përfundoi lufta e UÇK-së me forcat policore dhe ushtarake të pushtuesit serb, me ndihmën e NATO-s u realizua ëndrra shekullore e lirisë. Kosova sot është shtet i lirë e sovran, me të gjitha perspektivat, sfidat dhe shpresat për një të ardhme më premtuese e më të mirë për të gjithë qytetarët e vendit, pa dallim.

Andaj sot, më 11 qershor të vitit 2019, me rastin e 20-vjetorit të çlirimit të Kosovës dhe ndërhyrjes së forcave të NATO-s, Instituti i Historisë “*Ali Hadri*” - Prishtinë, në bashkëpunim me

Instituti i Historisë-Tiranë dhe Instituti për Trashëgimi Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve në Shkup, organizojnë Konferencën shkencore ndërkombëtare: *“Kosova - rruga drejt lirisë”*, rezultatet e së cilës do të botohen në vitin e ardhshëm. Në këtë eveniment shkencor do të paraqiten me kumtesa 31 studiues të historisë, ku rrugëtimi historik i lirisë së Kosovës do të pasqyrohet në dimensionet e saja politike, juridike, ekonomike, ushtarake, shoqërore, kulturo-arsimore dhe historiografike.

Konferenca që sot po i nis punimet, ka një rëndësi të veçantë në historinë më të re shqiptare, në të cilën do të trajtohen tema të ndryshme, duke ofruar, materiale të reja, mbështetur në të dhëna dhe fakte shkencore dhe në metodologji të trajtimit bashkëkohor. Duke besuar se kjo konferencë është në funksion të këtij kursi, presim rezultate të reja, të cilat padyshim, do t'i shpijnë përpara studimet në fushën e historiografisë shqiptare e më gjerë, me argumente e përmes fakteve dhe të dhënave jo të njohura deri më tani. Në mbyllje të fjalës sime, duke ju dëshiruar punë të mbarë e të frytshme dhe qëndrim të këndshëm, i shpall të hapura punimet e Konferencës shkencore ndërkombëtare: *“Kosova - rruga drejt lirisë”*.

Ju faleminderit!

Marenglen Verli

Çështja e Kosovës dhe stabiliteti i shtetit shqiptar, 1912-1999

Nuk ka dyshim se qysh kur lindi, çështja e Kosovës, ka qenë një çështje madhore për të ardhmen e kombit dhe të shtetit shqiptar. Pikërisht prandaj situata në Kosovë është reflektuar dukshëm në këtë shtet dhe anasjelltas, pikërisht prandaj nga zgjidhja e çështjes së Kosovës ka qenë kushtëzuar stabiliteti i shtetit shqiptar, por edhe marrëdhëniet e shqiptarëve të Kosovës e më gjerë me shtetin amë. Studiues dhe analistë të shumtë të historisë dhe politikës ballkanike dhe evropiane të viteve '20-të janë pajtuar me këtë pikëpamje, mandej nuk ka munguar edhe shfaqja e mendimit se “zgjidhja” e çështjes shqiptare më 1913, në mënyrën se si u bë, përveç synimit të përgjithshëm për ruajtjen e paqes midis Fuqive të Mëdha, ka pasur edhe synime të veçanta për të lënë mollën e sherrit në rajon, sepse kombi shqiptar kurrë nuk do të pajtohej me copëtimin që iu imponua, dhe në të dy anët e kufirit do të synonte e do të përpiqej për të realizuar bashkimin në një shtet të vetëm.

Le të shohim kronologjikisht si janë ndërthurur zhvillimet në Kosovë dhe në shtetin shqiptar që nga fillimi.

Më 17 dhjetor 1912, Konferenca e Londrës njohu autonominë e Shqipërisë, kurse aleatët ballkanas nxituan të zgjerimin territorit e pushtuara dhe ta bënë këtë autonomi të pavlefshme, duke ndërprerë lidhjet tokësore të Shqipërisë me Turqinë. Më 8 maj 1913, Austro-Hungaria dhe Italia, edhe pse kishin mbështetur vendimin për autonominë, diskutonin mundësinë për ta ndarë Shqipërinë midis tyre.

Sidoqoftë, Fuqitë e Mëdha arritën të gjenin një gjuhë të përbashkët dhe, më 29 korrik 1913, Konferenca e Londrës njohu pavarësinë e Shqipërisë nën kontrollin dhe garancinë e tyre. Disa ditë më pas, më 11 gusht, kishte përfunduar në vija të përgjithshme edhe caktimi i kufijve të shtetit shqiptar (22 mars kufiri i Veriut, 11 gusht kufiri i Jugut). Kufiri i caktuar që i favorshëm për Serbinë, megjithatë ajo shfrytëzoi, në mos provokoi, në shtator kryengritjen e shqiptarëve, të njohur si Kryengritja e Dibrës, duke synuar të krijonte pretekstin për të ndërmarrë spastrimin etnik në viset e aneksuara dhe për të shtrirë kufirin më në Perëndim. Terrori e spastrimi etnik kaluan pa bujë, sepse më 12 tetor, me krijimin në Durrës të Qeverisë separatiste të E. Toptanit, shteti i porsalindur shqiptar u fut në kaos dhe vëmendja e botës u spostua në situatën e brendshme të tij. Komisionit Ndërkombëtar të Kontrollit iu desh të ndërhynte menjëherë (tetor 1912) për të marrë në dorë situatën, duke larguar dy qeveritë shqiptare (janar 1914) dhe duke sjellë në krye të Shqipërisë, V. Vidin (7 mars). Por, ndërkohë synimi imediat i Serbisë, në një masë të konsiderueshme, ishte realizuar. Dhjetëra mijëra shqiptarë në Dibër e në Kosovë qenë vrarë, terrorizuar e dëbuar nga vatrat e tyre. Ndërkohë, shqiptarë të viseve të mbetura jashtë kufijve ende u dukej ëndërr ajo që kishte ndodhur. Ata kishin marrë pjesë në kryengritjen e vitit 1912, për të siguruar autonominë e katër “vilajeteve shqiptare”, kishin miratuar përmes delegatëve të tyre aktin e Shpalljes së Pavarësisë, më 28 Nëntor në Kuvendin e Vlorës, kishin krijuar korpusin më kompakt të forcave të armatosura në shërbim të Qeverisë së IsmailQemalit, qeveri ku kishin përfaqësues të tyre etj. Shqiptarët e viseve të mbetura jashtë Shqipërisë politike prisnin të merrte fund makthi, prisnin ribashkimin kombëtar, prisnin ndihmën e qeverisë së

tyre, prisnin reflektimin e faktorit ndërkombëtar dhe reagonin edhe me armë, madje me kryengritje masive si ajo e shtatorit të 1913.

Por, edhe pse Pavarësia e Shqipërisë ishte miratuar dhe garantuar me konsensusin e Fuqive të Mëdha, fqinjët ballkanas, duke shfrytëzuar kontradiktat midis Fuqive dhe duke siguruar përkrahës ndërmjet tyre, nuk u pajtuan, madje minuan stabilitetin dhe deri ekzistencën e shtetit shqiptar. Për të spastruar qetësisht Kosovën nga shqiptarët dhe për të sjellë shtetin e porsakrijuar shqiptar para një situatë të re ricopëtimi, nga shumë duar u nxit rebelimi islamik në Shqipërinë e Mesme (17 maj 1914) dhe nga Greqia rebelimi “vorio-epirot” në Shqipërinë e Jugut. Vidi, u sjellë të qeveriste Shqipërinë e njohur nga faktori vendimmarrës ndërkombëtar, nuk mund të bënte më tepër se të bashkëpunonte me kosovarët për të mbrojtur Durrësin dhe nëse punët do të shkonin sipas parashikimeve, të stabilizonte Shqipërinë e 28 mijë kilometrave katrorë. Ndërkohë edhe irredentistët më të flaktë nga “viset e robëruara” ishin ndërgjegjësuar se pa u stabilizuar Shqipëria politike, nuk kishte gjasa të ëndërrohej për Kosovën. Madje duhej një koniunkturë e favorshme ndërkombëtare që ëndrra të bëhej realitet.

Destabilizimi me rebelime i Shqipërisë më 1914, tregoi se asgjë nuk ishte e rastësishme. Praktika e stabilizimit të Greqisë, Bullgarisë dhe Rumanisë, me kontributin e monarkëve të importuar nga Evropa, nuk do të lejohej nga fqinjët dhe aleatët e tyre të ndodhte në Shqipëri, kështu që eksperimenti me V. Vidin ishte i destinuar të dështonte. Një marrëveshje serbo-greke për ndarjen e Shqipërisë në dy zona ndikimi u firmos pak ditë pasi kishte nisur krahura e dumbabistëve (1 qershor). Lufta e Parë Botërore, që shpërtheu një muaj më pas (4 gusht), e detyroi V. Vidin të largohej (3 shtator), duke

i hequr kështu Shqipërisë mbrojtjen ndërkombëtare dhe duke e kthyer territorin e saj në një territor të pushtuar. Serbia, ndërkohë, paralelisht, terrorizonte Kosovën dhe përgatiste në mënyrë sistematike, në disa variante, dominimin e pasluftës në Shqipëri, duke përdorur si instrument të parë pashain toptanas. Ai u nxit të krijonte sërish një qeveri të përkohshme në Durrës, që si kryetar shteti të firmoste me Serbinë dy marrëveshjet e njohura të tradhtisë kombëtare (1914, 1915), të cilat do të mund të shfrytëzoheshin më pas si argument juridik për pretendimet e Serbisë.

Në konflikt midis tyre, edhe Fuqitë e Mëdha e shfrytëzuan Shqipërinë si fushë lufte duke hyrë njëherësh në pazarllëqe për trevat shqiptare. Traktati i Fshehtë i Londrës (1915), që kishte për qëllim ta joshte Italinë t'i bashkohej Antantës, i shkatërronte, nëse do të zbatohej, arritjet e shqiptarëve të viteve 1912-1913.

Rrjedhat e luftës, ndonëse mjaft problematike për monarkinë ballkanike, nuk i bënë ato më të arsyeshme në qëndrimin ndaj shqiptarëve. Duke shfrytëzuar situatën e kaosit, ato nuk e ndërprejnë politikën e dhunës mbi shqiptarët dhe të spastrimit etnik të trevave shqiptare. Madje ato synuan komprometimin, ose likuidimin, e elitës së patriotëve dhe luftëtarëve shqiptarë, që mund të ishin problematikë në të ardhmen (u vranë Muço Qulli, Çerçiz Topulli, Dedë Gjo Luli, Mehmet Shpendi, Isa Boletini, Themistokli Gërmenji etj.). Situata ndryshoi pozitivisht vetëm në vitet 1916-1918, kur në shumicën e trevave shqiptare ushtritë ballkanase u detyruan t'u lëshojnë vendin ushtrive italiane, austro-hungareze dhe franceze. Por, ndërprerja e përkohshme e gjenocidit antishqiptar dhe ndonjë gjest diplomatik dashamirës nga evropianët nuk do të thoshte se rreziku ishte shmangur. Sidoqoftë, shqiptarët e Kosovës dhe viseve lindore e

shfrytëzuan momentin e favorshëm për të ngritur administratën e tyre, për të hapur shkolla shqipe, për të dëbuar kolonët agresivë të vendosur në viset e tyre në 1913-1915 dhe për të rikuperuar në gjithçka ku kishin humbur terren më 1912-1915.

Kur fundi i Luftës Botërore afroi, patriotë kosovarë, por edhe nga treva të tjera shqiptare, formuan komitetin “Mbrotjta Kombëtare e Kosovës” (1 maj 1918). Platforma e tij strategjike, mbrotjta e Shqipërisë së 1913 dhe çlirimi i Kosovës, si dhe taktika e përdorur, përkatësisht sigurim, konsolidim dhe demokratizim i shtetit ekzistues, si dhe luftë diplomatike dhe me armë për çlirimin e Kosovës, dëshmojnë jo vetëm pjekurinë e faktorit shqiptar për momentin, në të dyja anët e kufirit politik të caktuar në Londër, por, për këtë arsye, dhe rolin e tij të rëndësishëm në koniunktura e pasluftës, për të garantuar dhe çuar më tej arritjet e 1912-1913.

Veçanërisht në vitin 1920 çështja shqiptare hodhi hapa të rëndësishëm përpara. Pavarësisht nga ankthi që sollën kombinacionet brenda dhe jashtë portave të Konferencës së Paqes së Parisit në vitet 1919-1921 (Marrëveshja Titoni-Venizellos, më 29 korrik 1919; Memorandumi i Francës, Anglisë dhe SHBA-së, më 9 dhjetor 1919; Kompromisi i Fuqive të Mëdha i 13 janarit 1920 etj.), më në fund dëbimi i Italisë matanë Otrantos (pas Kongresit të Lushnjës dhe luftës së Vlorës, më 1920), e shpëtoi Shqipërinë nga rreziku i copëtimit dhe asgjësimit dhe, përgjithësisht, i ruajti edhe kufijtë e saj tokësorë të 1913. Luftimet në Koplik, Dibër, apo rebelimet në Mirditë e gjetiu (1920-1921), pas kësaj nuk mund të kishin më tepër se synime diversioniste e destabilizuese. E shumta, ato ishin edhe një leksion force mbi shqiptarët në të dy anët e kufirit dhe përpyetje për krijimin e kushteve, që do të ndikonin në forcimin e lobit proserb në Tiranë.

Natyrisht synohej edhe largimi i vëmendjes së botës nga Kosova, ku duhej mbytur në gjak një kryengritje, duhej thyer moralisht një popull dhe duhej zbatuar sa më lehtësisht e pa bujë një politikë shoviniste shkombëtarizimi. Ndërkohë, në të gjithë ngjarjet e sipërpërmendura elita politike e Kosovës, e vendosur në Shqipëri, por edhe ata mijëra refugjatë të ardhur e të sistemuar në kushte tmerrësisht të vështira, luajtën një rol konstruktiv, madje morën pjesë si reparte të armatosura të Qeverisë së dalë nga Kongresi i Lushnjës, për të vendosur rendin dhe për të konsoliduar pozitat e kësaj qeverie kombëtare. Kontributi i Hoxhë Kadrisë në Qeveri dhe i luftëtarëve kosovarë në luftimet në Peshkopi e Koplik, mandej në shtypjen e rebelimit të kapëdanit të Mirditës dhe shpërndarjen e bandave sadiste në vitet 1920-1921, janë të padiskutueshëm.

Gjithsesi, ndërsa italianët nuk patën sukses më 1920 në planet e tyre, qoftë për shkak të faktorit shqiptar, të faktorit të brendshëm italian dhe të atij ndërkombëtar (mbajtën vetëm Sazanin), serbët ia arritën të pengonin për disa vjet stabilizimin e shtetit shqiptar, të siguronin ratifikimin e kufirit në favor të tyre, të forconin lobin e tyre në Tiranë, të dobësuar pas eliminimit të EsatToptanit dhe goditjeve që morën pasuesit e tij të hapur, të shtypnin qëndresën e organizuar legale e ilegale, parlamentare ose me armë, në Kosovë (më 1924 qe shpartalluar Lëvizja Kaçake dhe më 1925 qe shpërndarë “Xhemijeti”) dhe të institucionalizonin e intensifikonin politikën shoviniste të shkombëtarizimit të Kosovës, përkatësisht praktikën e shpronësimit dhe dëbimit masiv të shqiptarëve në Turqi (ndoshta më shumë se gjysmëmilionin nga viti 1912 deri më 1941) si dhe të kolonizimit të trevave të tyre me elementë serbo-sllav (rreth 80 mijë vetë deri më 1941).

Sidoqoftë Serbisë, nën emrin shteti Serbo-Kroato-Slloven, ose tashmë Jugosllavi, do t'i duhej të ndeshej me konkurrencën italiane, në përpjekjet për të dominuar në Tiranë dhe, pas vitit 1922, jo më me Italinë në kaos social, por me Italinë agresive të Musolinit, që po forcohej me shpejtësi. Do t'i duhej të respektonte edhe politikën angleze me peshë, e cila në kuadër të gjeostrategjisë globale britanike, mbështeti pranimin e Shqipërisë në Lidhjen e Kombeve (17 shtator 1920) dhe miratimin e kufijve të Shqipërisë nga Konferenca e Ambasadorëve (9 nëntor 1921).

Potenciali italian dhe politika gjeostrategjike e Perëndimit nuk i lanë hapësirë serbëve në shtetin shqiptar ku, veçanërisht pas vitit 1925, ata humbën terren, por në Kosovë hipoteka e tyre nuk u ngacmua. Sidoqoftë, njëfarë stabiliteti politik në Shqipëri (fryt i koniunkturave ndërkombëtare të viteve 1925-1938, por edhe i përpjekjeve të diplomacisë shqiptare për të manovruar), i kombinuar me qëndresën stoike të shqiptarëve kosovarë, si dhe interesimi i mbuluar italian, këshillat diplomatike britanike dhe të fuqive të tjera për shmangien e ngjarjeve me bujë në Kosovë, që do të sillnin destabilizim për vetë Jugosllavinë, të gjitha këto, i penguan qarqet drejtuese të Beogradit të shmangeshin nga zbatimi gradual i synimeve të veta në favor të një veprimi të shpejtë të dëshiruar. (Qysh më 1912 N. Pashiq, kryeministri shumëvjeçar i Serbisë e Jugosllavisë, qe shprehur se në kushte qetësie Serbisë do t'i mjaftonin 25 vjet për të serbizuar Kosovën). Sidoqoftë, në Beograd i nuhasnin oshilacionet në stabilitetin e Tiranës dhe gjenin rast të shtonin dhunë në Kosovë, sikurse bënë pas vitit 1933 dhe planifikuan të bëjnë veçanërisht më 1938, pikërisht në momentin kur në Evropë çështja e pakicave u çua në pikën më të nxehtë nga politika e Rajhut gjerman, për qëllimet që

dihen dhe Serbisë i duhej të nxitonte. Por marrëveshja e 1938 me Turqinë për shpërnguljen atje të 40 mijë familjeve, brenda disa viteve, u arrit vonë. Lufta II Botërore e pengoi zbatimin e saj.

Qëndresa e shqiptarëve të Kosovës gjatë gjithë periudhës midis dy luftërave, u favorizua dukshëm nga arritjet pozitive në shtetin shqiptar. Territori i Shqipërisë politike ishte gjithnjë strehë për të dëbuarit nga Kosova dhe viset e tjera shqiptare në Jugosllavi. Legjislacioni i dalë në vitet '20-'30 "për vendosjen e emigrantëve", u krijonte të ardhurve kushte të përshtatshme instalimi dhe u siguronte një jetesë të garantuar. Nga radhët e rreth 15-20 mijë emigrantëve që u vendosën në shtetin shqiptar, në periudhën midis dy luftërave botërore, nuk ishin të pakët ata që u bënë pjesë e administratës qendrore e lokale dhe e forcave të armatosura, duke bërë edhe karrierë në radhët e tyre. Emrat e Sali Vuçiternit, Tafil Boletinit, Mehmet Delisë, Ali Rizait, Ali Shefqet Shkupit, Asim Vokshit etj., janë të njohur në vitet 1925-1939. Por, edhe personalitete si Hasan Prishtina, Bajram Curri, Hoxhë Kadriu, Bedri Pejani etj., ishin si në shtëpinë e tyre në Shqipërinë politike të viteve 1920-1924. Largimi i tyre nga radhët e elitës politike të vendit në periudhën e mëvonshme lidhet edhe me rreshtimin e tyre në krahun e forcave politike që dolën të humbura nga ballafaqimet e ashpra politike në vitet e pluralizmit të parë politik shqiptar.

Bashkëpunimin dhe mbështetjen e Tiranës e patën edhe figura të tilla si Ferhat Draga, që vepruan në Jugosllavi në mbrojtje të interesave sociale e kombëtare të popullsisë shqiptare atje.

Qëndresa e shqiptarëve të Kosovës, jo vetëm u favorizua nga arritjet e shtetit shqiptar. Ajo, sikurse u përmendën disa shembuj, nga ana tjetër, favorizoi në konsolidimin dhe demokratizimin e shtetit

shqiptar. Elita politike kosovare ishte prezente dhe përgjithësisht ndikoi pozitivisht në gjithë ngjarjet e rëndësishme të kohës (Kongresi i Lushnjës etj.). Nën drejtimin e saj, luftëtarët kosovarë morën pjesë në mbrojtjen e Shqipërisë politike. Madje, në prill të vitit 1939, kur Italia fashiste ndërmori agresionin për pushtimin e Shqipërisë, në viset shqiptare në Jugosllavi, u hodhën hapa për të dërguar luftëtarë për të prapsur pushtuesit, të cilat u penguan të finalizohen nga regjimi i Beogradit.

Vështrimi, sado i përciptë, për të evidentuar marrëdhëniet e shqiptarëve të Kosovës me shtetin amë në vitet 1912-1939, dëshmon qartë lidhjen organike, shumëdimensionale, tepër konkrete e konstruktive. Kombi i ndarë politikisht, nuk u nda kurrë shpirtërisht. Aspirata për realizimin e një shteti kombëtar të njësuar do të rezultonte thelbësore, në rrjedhën e një shekulli do të determinonte qëndrime masive e individuale në të dy anët e kufirit politik dhe do t'i jepte frytet në dekadën e fundit të shek. XX. Në koniunkturat e favorshme ndërkombëtare të kësaj kohe, vatra asnjëherë e shuar do të mbushej me flakën e madhe që çoi në çlirimin e Kosovës dhe arritjet e tjera të rëndësishme për statusin e shqiptarëve në Maqedoni e Malin e Zi.

Momentet e Luftës së Dytë Botërore, si dhe periudha e pasluftës, janë ende mjaft të diskutuara e natyrisht analizat bëhen mjaft të politizuara. Forca të ndryshme politike në të dy krahët e kufirit kanë shpesh optikën e tyre të veçantë për të parë ngjarjet dhe fenomenet. Sidoqoftë lufta dhe paslufta kanë për të gjithë specifikat e veta.

Gjatë Luftës së Dytë Botërore nuk mundi të ruhet shteti shqiptar i pavarur dhe bashkimi i pjesës më të madhe të trevave

shqiptare ndodhi në kuadrin e zgjerimit të pushtimeve të Italisë fashiste. Kështu, edhe pse për shqiptarët e Kosovës gjendja e krahasuar me vitet e sundimit serb u përmirësua, çështja e Kosovës nuk u zgjidh dhe nuk mund të zgjidhej, as si duhej e as përfundimisht. Mandej lindi dhe rreziku që copëtimi i viseve shqiptare të ish-Mbretërisë Jugosllave në tre zona pushtimi të shoqërohej me spastrimin etnik të rajonit të Mitrovicës dhe rajonit të Moravë-Vardarit, përkatësisht nën kontrollin serbo-gjerman dhe bullgar.

Së fundi, Italia dhe aleatët e saj të Boshtit BRT, kishin tërhequr mbi vete një koalicion shumë të fuqishëm dhe përgjithësisht urrejtjen dhe kundërshtimin e popujve të vënë nën zgjedhje, kështu që situata e re për shqiptarët nuk mund të ishte e qëndrueshme. Prandaj, çështja e Kosovës në këtë kohë mund të fokusohet vetëm në kuadrin e konfliktit botëror, që përfshiu edhe trevat shqiptare, dhe opsionet e paraqitura, ose hapat e ndërmarra nga forcat e ndryshme politike shqiptare mund të gjykohen nëse siguronin për shqiptarët perspektivën apo mbylljen e saj përfundimtare. Sot, ndër shqiptarët mbizotëron pikëpamja se rreshtimi masiv përkrah aleatëve antifashistë gjatë Luftës së Dytë Botërore, ka qenë një zgjedhje realiste, edhe pse llogorja e përbashkët me serbo-sllavët ka qenë sakrificë dhe paralajmëronte probleme për të ardhmen. Ndër këto probleme vlen të përmendet jo vetëm shtyrja në kohë e zgjidhjes së çështjes së Kosovës, por edhe rreziku i madh që do të kërcënonte pavarësinë e shtetit shqiptar, si rezultat i forcimit të lobit serbo-jugosllav në radhët e elitës politike shqiptare që drejtoi luftën antifashiste dhe mori pushtetin pas saj. Gati u vu në jetë ideja e lindur qysh në vitet '20, që, në pamundësi të bashkimit të Kosovës me

shtetin shqiptar, pranonte si alternativë të kundërtën, d.m.th. bashkimin e tyre në suazat e Jugosllavisë.

Ende pa mbaruar lufta, por veçanërisht pas saj, u vu re se PKJ dhe Federata Jugosllave, pavarësisht nga fasadat dhe demagogjitë, madje pavarësisht edhe nga ulja e peshës së Serbisë, do të ishte sërish një njerjë për shqiptarët brenda Jugosllavisë. Kosova do të mbetej peng i rivaliteteve klanore të sllavëve, çështja e saj nuk do të gjente asnjëherë zgjidhjen e duhur, kurse shqiptarët do të toleroheshin ose keqtrajtoheshin sipas koniunkturave të brendshme jugosllave ose ndërkombëtare.

Gjatë rreth 50 vjetëve të pasluftës ndërvlerësia e çështjes së Kosovës me stabilitetin e shtetit shqiptar u aktivizua sërish. Janë të njohura faktet e kësaj periudhe që dëshmojnë për këtë. Dihet p.sh. se pasi mbytën me gjak revoltën e kosovarëve në vitin 1945 dhe kryen farsën e Prizrenit (korrik 1945) për aneksimin e Kosovës në Serbi, si qark autonom, elita drejtuese e Beogradit e pakësoi për 2-3 vjet dhunën në Kosovë. Me sa duket ajo, pasi i dha përgjithësisht kombit shqiptar dhe elitës së tij politike një leksion të ri që të mos kishte iluzione për ndonjë zgjidhje të çështjes së Kosovës jashtë variantit që vendosej në Beograd, priti “me siguri” që lobi projugosllav në Tiranë të realizonte përfshirjen e Republikës së Shqipërisë në Federatën Jugosllave. Edhe pse niseshin nga qëllime jo identike, të dy klanet sunduese në RSFJ e dëshironin këtë përfshirje.

Por, porsa “muaji i mjaltit” i Tiranës me Beogradin mbaroi dhe në koniunkturat e reja ndërkombëtare, Rusia-BRSS më 1948 “mori nën sqetull” Republikën e Shqipërisë, mbi shqiptarët e Kosovës, tashmë jo duke i etiketuar “ballistë” si më 1945, por “informbyroistë”, filloi sërish dhuna e terrori. Sidoqoftë, ai edhe për

disa vjet do të prekte kryesisht shtresa të caktuara të popullsisë. Pozita e Tiranës në këtë kohë ishte forcuar, kurse Beogradi ende se kishte marrë veten nga divorci me Moskën. Kështu që për kosovarët nuk pati pogrome masive e spastrim etnik. Ato do të fillonin nga mesi i viteve '50-të, kur si rezultat i pajtimit të Hrushovit me Titon pas vdekjes së Stalinit, pozitat e Tiranës u dobësuan dhe në të kundërt Beogradi e ndjeu se mund të vepronte lirisht në Kosovë. Marrëveshja "xhentëlmene" jugosllave-turke (Tito - Qypri), aksioni i mbledhjes së armëve, shpërngulja masive e kosovarëve dhe sjellja e "kuadrove", në fakt kolonëve të shumtë në Kosovë, vazhduan pa ndërprerje. Edhe pse Hrushovit ia shtrëngoi dorën kroati Tito, pozitat përreth 10 vjet do t'i forconte posaçërisht serbi Ranković. Me sa duket liberalizmi i Hrushovit i zhvlerësoi disi aksionet e Titos në bursën politike të Perëndimit dhe kjo i dha dorë Rankovićit për revansh të përgjithshëm. Deri më 1966, klani serb e përdori si deshi Kosovën, shpërnguli mbi 400 mijë shqiptarë prej saj dhe nga viset shqiptare në Maqedoni dhe terrorizoi mbi 1 milion të tjerë, kurse Tirana nuk qe në gjendje të reagoje. Prishja me aleatin e "madh" rus të viteve '50-të dhe lidhja me "kolosin kinez" nuk i solli asaj ndonjë avantazh në politikë dhe impotencia për t'u angazhuar për çështjen e Kosovës vazhdoi.

Situata do të ndryshonte pozitivisht vetëm më 1968. Tanket ruse në Pragë e trembën Beogradin dhe gjesti i Tiranës për braktisjen e Traktatit të Varshavës, u mirëprit. Forcimi i kredos shqiptare në të dy krahët e kufirit, politika e kundërpeshës e klanit kroato-sllloven dhe sinjalet nga Perëndimi, sollën elementë pozitivë për çështjen e Kosovës. Ndonëse nuk morën zgjidhjen e kërkuar brenda kuadrit jugosllav, përkatësisht nuk siguruan republikën, shqiptarët e Kosovës

siguruan mjaft të drejta që nuk i kishin pasur, të cilat u sanksionuan veçanërisht me Kushtetutën e vitit 1974. Ata fituan të drejtat kombëtare të mohuara, nuk u shpërngulën më si dikur (emigracioni për punë në Evropë, përveç problemeve solli edhe përfitime), njohën një zhvillim të rëndësishëm në arsim e kulturë, madje pati edhe përmirësim strukturor në ekonomi dhe ngritje të standardit të jetesës.

Në vitet '80-të, koniunkturat ndryshuan sërish. Ndryshimet në politikat ndërkombëtare, me rastin e kapitullimit të Lindjes përpara Perëndimit dhe përfundimi i Luftës së Ftohtë të blloqeve, sollën zhvlerësimin e rolit të RSFJ-së në botë, si edhe thellimin e krizës ekonomike e politike dhe në marrëdhëniet midis kombeve e kombësive të Federatës.

Shpërbërja e Federatës në fillim të viteve '90-të erdhi si diçka e pashmangshme. Ndërkohë, Kosova e braktisur gradualisht për arsye pragmatiste nga republikat e tjera, iu dhurua Serbisë. Në fakt ngjan më tepër sikur iu hodh në prehër si një peshë balasti për ta fundosur, që të tjerët të kishin kohë të dilnin në breg pa probleme. Ndoshta ende në Beograd nuk e kanë kuptuar të gjithë se sa u ka kushtuar kjo "dhuratë" danajsh. Ajo që nisi në Kosovë më 1988-1989, me shumë sakrifica për shqiptarët, përfundoi pas 10 vjetësh, më 17 shkurt 2008 me Shpalljen e Republikës së Kosovës.

Shqipëria dhe Kosova që nga kjo kohë mbështesin sa mundën njëra-tjetrën në forumet ndërkombëtare dhe të dyja së bashku mbështesin edhe kauzën e shqiptarëve në Maqedoni, në Mal të Zi e në Serbi. Shteti shqiptar, i integruar në përpjekjet politike të SHBA-së e partnerëve evropianë dhe në fushatën e NATO-s, që mori përsipër 20 vjet më parë t'i jepte fund regjimit të fundit diktatorial në Evropë, u përpoq të bënte sa mundej. Por, edhe sot Shqipërisë i mbetet ende

shumë për të bërë, sikurse e njëjta gjë mund të thuhet edhe për Kosovën. Klasës politike shqiptare përgjithësisht, i duhet të mbajë përgjegjësinë që i takon, që faktori shqiptar të njësohet, për të mos mbetur një faktor pa peshë kur për çështjen shqiptare, jo vetëm në Kosovë, por edhe kudo tjetër ku gjenden shqiptarët, të merren vendimet përfundimtare. Çështjet e njohjes dhe përfshirjes së Kosovës në forumet ndërkombëtare, si edhe arritjes së të drejtave të shqiptarëve në shtetet e sipërpërmendur, janë çështje të gjithë kombit shqiptar.

Bibliografi:

- Arkivi i Institutit të Historisë-Tiranë*, Fondi: Arkivi i Vjenës (Haus, Hof und StaatsarchivWien, PolitischesArchiv, Albanien)
- Arkivi Qendror Shtetëror i Republikës së Shqipërisë*, Fondi KMKK, Fondi MPB
- Bajrami, Hakif, *Rrethanat politiko-shoqërore në Kosovë 1912-1941*, Prishtinë: 2017.
- Çami, Muin&Verli, Marenglen - *Shqipëria në Konferencën e Pages (1919-1920)*, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë: Kristalina-KH, 2015.
- Fjalori Enciklopedik Shqiptar*, vëll. II, III, botim i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, Tiranë: Kristalina-KH, 2003, 2008.
- Historia e Popullit Shqiptar*, vëll. III, Periudha e Pavarësisë (28 nëntor 1912-7 prill 1939), Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Historisë, Tiranë: Toena, 2007.
- Historia e shqiptarëve gjatë shekullit XX*, vëll. I, botim i Institutit të Historisë, Akademia e Studimeve Albanologjike, Tiranë: Kristalina-KH, 2017.
- Limon Rushiti, *Lëvizja kaçake në Kosovë 1918-1928*, Prishtinë: 2016.
- Milo, Paskal – *Politika e Jashtme e Shqipërisë*, Tiranë: Toena, 2013.
- Prifti, Kristaq – *Popullsia e Kosovës (1831-1912)*, botim i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, Tiranë: Toena, 2014.
- Verli, Marenglen - *101 Profile biografike*, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë: 2017.

-
- Verli, Marenglen - *Kosova - sfida shqiptare në historinë e një shekulli*, Tiranë: Botimpex, 2007.
- Verli, Marenglen - *Shqipëria dhe Kosova - historia e një aspirote*, vëll. I, Tiranë: Botimpex, 2008.
- Vllamasi, Sejfi - *Ballafaqime politike në Shqipëri 1897-1942* (Kujtime dhe vlerësime historike), Tiranë: 1995.

Jakup Krasniqi

Lufta çlirimtare e Kosovës në fokus të autorëve të huaj

Disa zhvillime, qëndrime e tendenca të shfaqura edhe në njëzetvjetorin e çlirimit, sikur na obligojë e akoma më shumë i obligojnë studiuesit e ardhshëm të shkencave shoqërore, e veçmas historianët, që të hulumtojnë, gjurmojnë e rishikojnë sesi autorë të huaj e burime të ndryshme të botës demokratike, i shohin dhe i vlerësojnë zhvillimet në Kosovë në dekadën e fundit të shekullit XX e më theks të veçantë, sesi ata e shohin rolin e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës në ato zhvillime. Edhe sot ia vlen që ta shohim se si e kanë parë e vlerësuar UÇK-në autorë të huaj të cilët disponojnë kredibilitet politik e shkencor. Konsiderojmë se autorët e huaj vlerësimet e tyre i kanë pa emocione dhe si të tilla, gjithsesi janë më realiste sesa mund t'i kemi ne, me animet politike të mishëruara në ne. Duke i parë trajtimet që i bëhen luftës nacionalçlirimtare shqiptare në 70-vjetorin e saj, se kush luftonte për lirinë e kush mrizonte nën hijen e pushtuesit të kohës, mbase nuk me habisin as mrizuesit e luftës së fundit çlirimtare në Kosovë. Në këtë 20-vjetor të çlirimit tonë, e them me bindje se kemi degradim në shkencën e historisë, por më e dhimbshme se kaq është degradimi i kulturës dhe i traditës sonë kombëtare dhe ky degradim është në zhvillim në segmentet më vitale të shoqërisë sonë. Ndalja e këtij degradimi është bërë domosdoshmëri!

Vetëm lufta çlirimtare e nxori në rend të ditës problemin e Kosovës dhe e shtroi atë për zgjidhje serioze politike. Sikur vendet e Bashkimit Evropian, të bënin një trusni më të fuqishme mbi politikën

e Beogradit, por kjo nuk u bë asnjëherë pas vitit 1989, prandaj lufta kishte mbetur si option i vetëm dhe kjo ishte e domosdoshme¹. Këtë, ndoshta edhe më mirë do ta thonë, Wolfgang Petriq dhe Robert Pihler, në librin: “...Kosova dhe bashkësia ndërkombëtare”, Prishtinë, 2002, ata shkruajnë: “*Çfarë nuk qe e mundur të arrihej për vite të tëra me protesta paqësore dhe mosbindje qytetare, u arrit brenda pak muajve me anë të dhunës: Kosova u bë qendra e vëmendjes së mediave, për këtë arsye kriza e saj politikisht nuk mund të lihej më pas dore. (...)*”. Më pas autorët vazhdojnë dhe konfirmojnë se: “... UÇK-ja arriti pikërisht atë qëllim, në të cilin Rugova kishte dështuar”. Sipas autorëve, ishte lufta çlirimtare ajo që e tërhoqi vëmendjen e tyre për të marrë masat e duhura. Autorët konfirmojnë se “*(...) Vetëm atëherë bashkësia ndërkombëtare u gjend e shtrënguar të merrte masa..*”². Kurse, K. Hill, ambasadori amerikan në Shkup, do të deklaron: “... askush nuk ishte i gatshëm t’i kushtonte vëmendje Kosovës, përderisa situata nuk eskaloj në dhunë”³.

Për luftën tonë çlirimtare kanë shkruar shumë autorë e politikanë të huaj. Njëri nga ata ishte edhe ministri i Jashtëm i Gjermanisë, Joshka Fischer, librin: “Vitet kuq-gjelbër - politika e jashtme gjermane nga Kosova deri më 11 shtator”. Me të drejtë ministri Fischer konstaton se pas Konferencës së Dejtonit, “*shqiptarët e Kosovës kuptuan se pa luftë nuk do të realizonin kurrë synimet e tyre kombëtare*”⁴. Madje askush më mirë se ky politikan nuk e tha qëllimin e vërtetë të politikës serbe të Millosheviqit. Ai

¹Joschka Fischer, *Vitet kuq-gjelbër*, Koha, Prishtinë, 2008, f. 99.

²Wolfgang Petriq dhe Robert Pihler, *Rruga e gjatë në luftë - Kosova dhe bashkësia ndërkombëtare*, Prishtinë, 2002, f. 254-255.

³Blerim Shala, *Lufta diplomatike për Kosovën, dialog me ambasadorin Christopher Hill*, botim i “Zërit”, Prishtinë 2000, f. 43.

⁴Joschka Fischer, *Vitet kuq-gjelbër - politika e jashtme gjermane nga Kosova deri më 11 shtator*, KOHA, Prishtinë 2008, f. 99- 100.

konstatoi se qëllimi i vërtetë i luftës së Millosheviqit ishte: “Jo lufta kundër UÇK-së, por para së gjithash terrorizmi dhe dëbimi i popullatës shqiptare ishte qëllimi i vërtetë i luftës”⁵. Nëse lufta që Serbia bënte në Kosovë ishte terroriste dhe kishte qëllim dëbimin e popullsisë shqiptare, kjo ishte krim i gjenocidit në luftë, i cili krim kishte qëllim zhdukje e tërësishme ose të një pjese dhe si e tillë kjo ishte krim i gjenocidit.

Për të njëjtën gjë, eksperti ndërkombëtar, Marc Viller, në librin e tij: “Shtetësia e kontestuar: administrimi ndërkombëtar i luftës së Kosovës për pavarësi”, shkruan: “Përmbyllja e Marrëveshjes së Daytonit pa u përmendur Kosova në të, në thelb e minoi besueshmërinë e qeverisë Rugova. Haptazi rezistenca pasive kishte dështuar. [...] Në këtë klimë dekurajuese, ata që kishin insistuar për zgjidhje ushtarake menjëherë u bënë me ndikim”.⁶ Këtë po e thotë një njohës i mirë i rrethanave ndërkombëtare të kohës. Ndërsa, britaniku, MishaGlenny, në librin e tij “Historia e Ballkanit (1804-1999)”, trajton edhe zhvillimet e viteve ‘90 në Kosovë dhe në mes të tjerave ai ka shkruar: “Politika e vetëpërmbytjes e ndjekur nga Rugova, bëri që Kosova të mbetej në paqe gjatë gjithë kohës së luftërave në Kroaci e Bosnjë. Mirëpo, kjo paqe u shoqërua nga një gjendje stanjacioni politik dhe nga vazhdimi i shtypjes sistematike mbi shqiptarët”.⁷ Më pas autori vazhdon: “Mësymbja serbe në Drenicë pati tri pasoja, që Millosheviqi thuajse me siguri i kishte parashikuar. Së pari, UÇK-ja erdhi duke u bërë dita-ditës më e fuqishme, sepse mijëra të rinj shqiptarë mbushën radhët e saj. Së dyti, Evropa Perëndimore dhe

⁵Po aty, f. 100.

⁶Marc Weller, *Shtetësia e kontestuar: administrimi ndërkombëtar i luftës së Kosovës për pavarësi*, Koha, Prishtinë 2009, f. 144.

⁷Misha Glenny, *Historia e Ballkanit 1804-1999 - nacionalizmi, lufta dhe Fuqitë e Mëdha*, Toena, Tiranë 2007, f. 653.

*Shtetet e Bashkuara u përfshinë më shumë në çështjet e këtij konflikti. Së treti, stabiliteti rajonal u turbullua nga polarizimi i shoqërisë malazeze dhe nga ngritja e tensionit në vendet fqinje, sidomos në Shqipëri e në Maqedoni”.*⁸ Këto konstatime të autorit, përveç që janë të sakta, janë edhe shumë mirë të argumentuara.

Ndërsa, një autor tjetër i huaj, Raymond Detrez, në librin e tij: “Kosova - lufta e shtyrë”, vije në përfundim se: “Ndoshta edhe UÇK-ja vetë nuk besonte të ishte në gjendje të “çlironte” Kosovën, përfshirë qytetet e mëdha dhe thjesht provonte atë taktikë që në Ballkan ishte provuar me dhjetëra herë - disa herë me sukses: organizimi i një kryengritjeje të armatosur, kur dihet se kundërshtari do të kundërveprojë me dhunë të jashtëzakonshme, duke synuar kështu ndërhyrje nga jashtë, që sjell zgjidhjen e pritur politike”.⁹ Në këtë konstatim, autori sigurisht që ka të drejtë, vetëm se kjo nuk mund të thuhet vetëm për Ballkanin. Në historinë politike të shumë luftërave edhe popujve më të mëdhenj se shqiptarët, ju është dashur ndihma ose ndërhyrja e më të fuqishmeve. Për luftën çlirimtare të popullit tonë e sidomos rolin e UÇK-së në çlirimin e Kosovës, vlerësim mjaft të saktë ka dhënë edhe autori, Serge Métais, në librin e tij: “Historia e shqiptarëve - nga ilirët deri te pavarësia e Kosovës”, ku autori ka nënvizuar se: “Sigurisht, opinioni publik perëndimor ishte i ndjeshëm ndaj padrejtësisë që po u bëhej shqiptarëve, mirëpo për te ky nuk ishte veçse një nga rastet e panumërta të padrejtësive në këtë botë. Dhe, për sa kohë që nuk kishte përleshje të përgjakshme, Kosova nuk kishte asesi që të zinte faqet e para të gazetave, asesi të mallëngjente me të vërtetë ndokënd. U deshtë të shpërthente një luftë e re në ish-Jugosllavi (dhe pamjet e saj të përhapura përmes televizionit), në mënyrë që udhëheqësit perëndimorë të bindeshin se

⁸Po aty, f. 655.

⁹Raymond Detrez, *Kosova - lufta e shtyrë*, Skenderbeg Books, Tiranë, 2004, f. 153.

kësaj radhe nevojitej të ndërhyhej ushtarakisht. Kjo luftë u nis nga UÇK-ja në pranverën e vitit 1998".¹⁰ Për këtë autor, ndërhyrja do të duhej të ndodhte para se të fillonte lufta e armatosur dhe të ndodhnin krimet e gjenocidi serb mbi shqiptarët në Kosovë.

Kurse, për disa autorë të huaj, përfshirë këtu edhe Noel Malcolm, "meritat" për formimin e UÇK-së ia përshkruajnë politikës serbe e sidomos politikës shtypëse të Slllobodan Millosheviqit. Noel Malcolm në parathënien e librit të tij: "*Kosova - një histori e shkurtër*" (botimi i dytë i KOHËS), shkruan: "*Politika serbe nxiti shtimin e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, ekzistimi i së cilës atëbotë, u mor si pretekst i fushatës serbe të shkatërrimit të fshatrave të Kosovës në verën e vitit 1998. Së këndejmi, përpjekjet e qeverive të Perëndimit për ta ndërmjetësuar një marrëveshje, bazë e së cilës ishte rikthimi i autonomisë së Kosovës, dolën të pasuksesshme*".¹¹ Nuk ka dyshim, politika serbe e udhëhequr nga Millosheviqi ishte një faktor përshpejtues, por populli shqiptar gjatë gjithë shekullit XX kishte bërë përpjekje të vazhdueshme për liri, për çlirim e bashkim kombëtar. Prandaj, populli ynë kurrë nuk e kishte ndërprerë luftën për realizimin e aspiratës së tij kombëtare. Në këndvështrimin e njëjtë me Malcolm është edhe John G. Stoessinnger, i cili në librin: "*Përse kombet shkojnë në luftë*", shkruan: "*Nuk është për t'u çuditur që pas çdo barbarie radhët e UÇK-së shtoheshin në numër dhe me vrull. Nga pikëpamja historike Millosheviqi mund të dukej fare mirë si shef rekrutimi pa dashje i UÇK-së*".¹² Ani pse krimineli i padënuar serb për krim e gjenocid në Tribunalin e Hagës kishte llogaritur se politika e tij

¹⁰Serge Métais, *Historia e shqiptarëve nga ilirët deri të lufta e Kosovës*, f. 394.

¹¹Noel Malcolm, *Kosova - një histori e shkurtër*, KOHA & Shtëpia e Librit, Prishtinë-Tiranë, 2001.

¹²John G. Stoessinnger, *Përse kombet shkojnë në luftë*, ISN, Tiranë 2007, f. 153.

kriminale do të shkaktonte frikë e ikje nga Kosova. Madje ai politikën e mosdëgjimit (pacifizmit) e shihte si një pus pa fund, ku shqiptarët i hidhnin pakënaqësitë e tyre¹³. Mbase këta autorë kishin ardhur në këtë konstatim duke e parë përmasën e angazhimit të faktorit politik në luftën e Kosovës.

Me shumë interes janë konstatimet e Mark Veller për luftimet e vitit 1998, e veçmas ato të ofensivës së verës së atij viti. Autori nënvizon: “... Duke e zhvendosur UÇK-në nga disa zona për të cilat thoshte se i kontrollonte. Thuhej se ky veprim nuk ishte kundërshtuar ndërkombëtarisht, sepse qëllimi ishte të evitohej që UÇK-ja të kishte një rol dominues në negociatat që po vinin”.¹⁴ Siç po shihet, qëllimi i asaj strategjie, ishte: “Që UÇK-ja të mos ishte në pozitë për ta penguar marrëveshjen të paraparë nga bashkësia ndërkombëtare”.¹⁵ Diçka ngjashëm me M. Veller, shkruan edhe James Pettifer, në librin e tij: “Ekspres Kosova”. “Në Përfundim komentator si Carl Bildt, gjithnjë kishin kërkuar një forcë kontrollimi të kufirit për ta vënë nën fre dhe për ta mbyllur hesapin me UÇK-në”.¹⁶ Besueshmërinë e këtyre që thonë autorët e përmendur padyshim që na shtojnë bindjen se rihapja e bisedimeve politike për statusin e Kosovës në vitin 2012 në bisedimet e Brukselit dhe i gjithë debati i zhvilluar për korrigjimin e kufijve në mes Kosovës e Serbisë që po zhvillohen që një vit, kanë për qëllim kënaqjen e Serbisë e jo të shqiptarëve.

Lufta që kishte filluar në fund të shkurtit e në fillim të marsit 1998, që në fillim të saj, pushteti serb kishte urdhëruar policinë e ushtrinë që në sulmet e tyre, objektiv kryesor të kishte sulmin mbi

¹³HUMAN RIGHTS WATCH: Nën pushtetin e urdhrave - Krime të luftës në Kosovë, Botime Korbi, Tiranë 2002, f. 32.

¹⁴Marc Weller: Shtetësia e kontestuar - administrimi ndërkombëtar i luftës së Kosovës për pavarësi, KOHA, Prishtinë 2009, f. 158.

¹⁵Po aty, f. 159.

¹⁶James Pettifer, *Expres Kosova*, Edicioni Liria, Prishtinë 2004, f. 263.

popullsinë civile. Kjo shihet si në luftimet në Likoshan e Qirez e më pas edhe në Prekaz, ku pjesa dërmuese e të vrarëve e të masakruarve ishin nga radhët e popullsisë civile. Kjo politikë krimi e gjenocidi vazhdoi edhe gjatë verës e vjeshtës së vitit 1998. Për komunitetin ndërkombëtar tanimë ishte e qartë kriza humanitare. Në një situatë të tillë, KS miratoi Rezolutën 1199 e një ditë më vonë, “*më 24 shtator 1998, Këshilli Veriatlantik miratoi ACTWARN-in - vendimin për një operacion ajror të kufizuar dhe një fushatë ajrore të përshkallëzuar në Kosovë, duke e sjellë NATO-n në një nivel më të lartë të gatishmërisë ushtarake*”.¹⁷ Për të gjithë në atë kohë ishte e qartë se Ushtria Çlirimtare e Kosovës vazhdonte të kishte gatishmëri për luftime të reja me ushtrinë okupuese serbe. Këtë e konfirmon edhe James Pettifer, i cili shkruan: “*Gatishmëria e ushtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe e njerëzve që punonin me ta për të dhënë jetën, kishte arritur brenda dy vjetësh më tepër sesa Lidhja Demokratike në dhjetë vjet*”.¹⁸ Edhe pse ishte kështu, në verën dhe vjeshtën e vitit 1998, kishte përpjekje ndërkombëtare për të penguar forcimin dhe ndikimin e UÇK-së me qëllim që popullit shqiptar i Kosovës ti ofroj një zgjidhje autonomiste, ndërsa pengesë kryesore për të arritur këtë ishte Ushtria Çlirimtare e Kosovës. Kjo më së miri konfirmohet edhe nga mbështetësja kryesore e shqiptarëve, nga ish-sekretarja e SHBA-së, zonja Albricht. Albricht në librin e saj “Zonja Sekretare”, thotë: “*Ne kërkonim të bindnim shqiptarët e moderuar, duke nxitur dialogun me Beogradin, që kishte për qëllim rivendosjen e Autonomisë së Kosovës, dhe nuk donim që UÇK-ja të gjente mbështetje në botë. Gjithashtu kërkonim rrugë të reja për të ndihmuar forcat që ishin për demokracinë në Jugosllavi sepse besonim se problemet e Kosovës dhe të rajonit nuk do të zgjidheshin*

¹⁷Po aty, f. 173.

¹⁸Po aty, f. 303.

përpara se Millosheviqi të largohej nga pushteti".¹⁹Kjo politikë e kohës konfirmohet edhe ngapresidenti, Bill Clinton, i cili në librin e tij "Jeta ime", shkruan: "*Ibrahim Rugova, kreu i qeverisë-hije, ishte një njeri fjalëbutë, që kishte zakonet të vinte një shall rreth qafës. Isha i bindur se mund të arrinim një marrëveshje paqeje me të, por nuk isha aq i sigurt për fraksionin tjetër kryesor kosovar, Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës*".²⁰Kushdo që i lexon këto deklarata të shkruara në libra, të njerëzve më të fuqishëm në politikën ndërkombëtare nuk ka si të mos e krijojë bindjen se Ushtria Çlirimtare e Kosovës ishte faktori kryesor që Kosovës dhe popullit të saj ua hapi perspektivën e lirisë e të pavarësisë. Edhe sot, 20 vjet pas asaj lufte, dikush mund të thotë se lufta nuk ishte zgjidhja më e mirë, por e vërteta është se lufta ishte zgjidhja e vetme. Sigurisht që këtë që u tha, akoma më mirë do ta verifikojnë zhvillimet luftarake në pjesën e parë të vitit 1999.

Edhe në tremujorin e parë të vitit 1999, përfshirë edhe Konferencën ndërkombëtare të Rambujesë për Kosovën, nuk kanë munguar përpjekjet për të bërë një zgjidhje autonome. Mbase edhe këtu, disa "merita", si në rastin e mobilizimit të UÇK-së, mund t'i përshkruhen kokëfortësisë së Millosheviqit, i cili që i padëgjueshëm ndaj politikave të vendeve euro-atlantike. Nuk ka asnjë dyshim, kjo ngurtësi politike, për të nënshkruar Dokumentin Përfundimtar të Rambujesë, solli bombardimet 78 ditësh të NATO-s mbi Serbinë. Pa bombardimet e NATO-s e me Dokumentin Politik të Rambujesë, rrjedha e vështirësi të tjera do të ndodhnin në rrugëtimin politik të shqiptarëve e të Kosovës.

Jo vetëm autorët e përmendur flasin se ishte dhuna e ushtruar nga regjimet serbe e sidomos ai i regjimit të Millosheviqit, ishte ajo që e kishte bërë të domosdoshme krijimin e UÇK-së dhe luftën e

¹⁹Madeleine Albright, *Zonja Sekretare*, Dudaj, Tiranë 2004, f. 443.

²⁰Bill Clinton, *Jeta ime*, Dudaj, Tiranë 2005, f. 713.

armatosur të popullit shqiptar në Kosovë. Nëse është kështu, atëherë cila është arsyeja e baraspeshimit të krimeve e të gjenocidit serb të qeveritarëve të Beogradit me atë të shqiptarëve të Kosovës të cilëve u qe imponuar lufta e armatosur?! Një zgjidhje paqësore e politike do të ishte më e dëshirueshme sesa lufta. Është e dhimbshme, por tendenca për të kriminalizuar luftën tonë çlirimtare, gjendet edhe brenda vendit tonë?! Se kështu ata më lehtë do të merrnin pushtetin?! Është më se e saktë se shumica e autorëve të huaj ia konfirmojnë meritat dhe sukseset Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe politikës klandestine që kishte zhvilluar për dekada politika të vendosura vetëfliji, liridashëse dhe largpamëse. Dëshmi për këtë janë 250 shekujt e burgut të mbajtura vetëm nga gjenerata e Pranverës shqiptare të '81 e mbi 600 shekujt e burgut pas LDB-së. Shkurt, Lëvizja Kombëtare klandestine për çlirim ishte ajo që e mbajti gjallë frymën e lirisë e të pavarësisë dhe vetëm në vitin e fundit të shekullit XX, duke pasur edhe ndihmën ndërkombëtare u realizua një pjesë e madhe e aspiratës kombëtare, çlirimi i Kosovës dhe krijimi i shtetit të pavarur sovran e demokratik. Si lufta çlirimtare ashtu dhe i gjithë procesi i pavarësisë së Kosovës, janë arritur në koordinim të plotë me faktorin ndërkombëtar. Mbyllja e këtij procesi në rrafshin kombëtar është bërë më 17 shkurt 2008, e në atë ndërkombëtar më 20 korrik 2010. Zhvillimet tjera e sidomos bisedimet politike të Brukselit që janë ende në zhvillim, ishin prapakthim që nuk i janë dashur askujt.

Jakup Krasniqi**SUMMARY**

The Kosovo Liberation War in the light of foreign authors On the twentieth anniversary of the liberation of Kosovo, it was reasonable to bring to the historical remembrance of our people some assessments and findings of foreign authors about the role of the Kosovo Liberation Army. The authors I have elaborated ranges in three lines: professional (historic); diplomatic; and the high EU and USA political class. For a long time period those authors had monitored the political developments concerning the disintegration of Yugoslavia, paying a particular attention to the political developments in Kosovo during the years '90. The findings are unique, although the authors came from different lines – the International Community would not pay any attention to resolve the issue of Kosovo, if the Kosovo Liberation Army was not on the scene. Certainly, many foreign authors elaborated the Albanian issue concerning the last decades of century twentieth, but I have selected the top of ones who studied the role and weight of the Kosovo Liberation Army and the intervention of NATO in the liberation of Kosovo. The authors, in their works, had not denied the role and importance of other forms of resistance, but they have clearly emphasized the lack of the political and military factor without the armed struggle of Kosovo Albanians. Many authors came to the conclusion: the World was not willing to deal seriously with the Kosovo, if the war didn't break up. The other finding stated that: the purpose of Serbian war in Kosovo was not the KLA, but in fact, it was the expulsion of Albanian civilian population from their lands.

This was a truthful statement about the aims of Serbian policy towards Albanians. On the grounds of this policy, Serbia organized and exercised a programme of genocide in Kosovo. And, at the end, it was the liberation war and the humanitarian crises that accelerated NATO intervention against the Serbian military and politic infrastructure. As argued above, the armed activities of the KLA paved the way for NATO military intervention, resulting with the liberation of Kosovo and establishment of International Administration in Kosovo. The new circumstances that arose beyond the June 1999 brought, inevitably, the Independence of Kosovo that was proclaimed on February, 17th 2008. The independence of Kosovo was a result of interactions between Kosovo and International Community.

Beqir Meta

Ndikimi i faktorëve ndërkombëtarë në rezultatet e rezistencës së shqiptarëve të Kosovës gjatë shek. XX

Teksa po punoja për një pjesë të projektit “Historia e shqiptarëve gjatë shek. XX” dhe konkretisht për raportet e KMKK me qeveritë shqiptare gjatë viteve 1920-1924, më lindi ideja e kryerjes së një analize historiografiko-politologjike krahasuese midis efektivitetit, forcës dhe rezultateve të kryengritjeve shqiptare gjatë shekullit të kaluar, me oportunitetin e rrethanave ndërkombëtare.

Në historiografinë tonë tashmë janë bërë studime serioze dhe të thelluara mbi rezistencën e popullit shqiptar kundër sundimit njëshekullor serb, duke filluar qysh me rezistencën shqiptare kundër pushtimit serb në vitin 1912, gjatë luftërave ballkanike, mbi kryengritjen e madhe antiserbe të Dibrës, shtator 1913, rezistencën kundër ripushtimit serb të Kosovës në fund të Luftës së Parë Botërore, kryengritjen e vitit 1919, Lëvizjen Kaçake 1918-1927, rezistencën e shqiptarëve kundër ripushtimit serb të Kosovës në vitet 1943-1945, dhe së fundi me luftën e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, 1998-1999.

Por deri më sot, me sa di unë, nuk ka një studim analitik krahasues midis këtyre ngjarjeve dhe kontekstit ndërkombëtar kur ato janë zhvilluar.

Në këtë kumtesë do të përpiqem të jap vetëm disa vëzhgime kryesore, me shpresën se kjo mund të bëhet nxitje për ndonjë studiues të ri që të marrë përsipër një studim të plotë e të thelluar, të cilin e konsideroj të dobishëm dhe të nevojshëm.

Nga një shqyrtim kritik i të gjitha lëvizjeve shqiptare në raport me situatën ndërkombëtare, mund të nxirren këto konkluzione:

1). Në përgjithësi gjatë gjithë shekullit të kaluar rrethanat ndërkombëtare kanë qenë të pafavorshme dhe trajektorja e këtij negativiteti ka lëvizur nga kundërshtia gati totale e faktorëve ndërkombëtarë kundër rezistencës së armatosur deri në dekurajimin verbal dhe indiferencën ndaj saj. Kështu, rezistenca shqiptare kundër pushtimit serb në vitin 1912-1913, ndeshi në një qëndrim frenues e kundërshtues të të gjitha Fuqive të Mëdha të kohës dhe të shteteve ballkanike. Rusia, Franca, Britania e Madhe, ishin inkurajuese të drejtpërdrejta ose të tërthorta të agresionit serb në tokat shqiptare, që zotëroheshin nga Perandoria Osmane dhe, kuptohet, ishin kundërshtarë të krijimit të një Shqipërie autonome dhe respektimit të territoreve të saj etnike e për pasojë, kundërshtarë të çdo rezistence shqiptare. Por, edhe dy fuqitë adriatike të interesuara për një Shqipëri autonome brenda Perandorisë Osmane, ishin po kaq kundërshtarë të krijimit të një force të armatosur shqiptare, të lëvizjes së armatosur shqiptare, të lëvizjeve të armatosura brenda Perandorisë.

Kështu, Lufta Ballkanike i gjeti Austro-Hungarinë dhe Italinë, pra këto fuqi aleate (nëse mund t'i quajmë kështu) dhe shqiptarët thuajse tërësisht të papërgatitur dhe përballë dilemave të shumta të cilat thuajse e paralizuan aktivitetin dhe forcën e tyre ushtarake.

Madje edhe Porta e Lartë që iu ekspozua agresionit nuk pranoi t'i armatoste paraprakisht shqiptarët, dhe nuk organizoi paraprakisht

kapacitetet e tyre luftarake. Ajo i trajtonte ata thjesht si shtetas ose rezervistë osmanë dhe jo si aleatë në një luftë finale për mbijetesën qoftë të Perandorisë Osmane, qoftë të trojeve shqiptare të lakmuara nga ballkanasit.

Këto rrethana ndikuan që rezistenca shqiptare të mos kishte një orientim të qartë politik se në cilën anë duhej të rreshtohet. Kështu, për shembull: një pjesë e nacionalistëve ose krerëve shqiptarë apelonin për t'u bashkuar me armatat osmane kundër agresionit ballkanik, e një pjesë tjetër apelonin për t'u bashkuar me serbët etj., kundër Perandorisë (Gazeta "Liri e Shqipërisë"), të tjerë ranë në apati, e kështu me radhë. Mungesa e çdo aleati të jashtëm e shtoi copëzimin dhe e mpaku më shumë kohezionin e brendshëm të shqiptarëve, mungesa e të cilit edhe më parë kishte qenë e meta thelbësore e qëndresës së tyre.

Në këtë mënyrë, potenciali shqiptar i rezistencës kundër agresionit u mpak në limite drastike.

2). Rezistenca shqiptare e viteve 1918-1927, shquhet për faktin se kishte përballë jo vetëm shtetin e fuqizuar serb përmes krijimit të Mbretërisë Serbo-Kroato-Slllovene, me një pozitë ndërkombëtare edhe më të fuqishme se ajo që kishte Serbia e Mali i Zi para Luftës I Botërore, por kishte kundër tashmë të gjitha Fuqitë e Mëdha Evropiane, fituese të luftës ose atë që është quajtur Sistemi i Versajës. Veçanërisht dy fuqitë kryesore, Britania e Madhe dhe Franca, të interesuara për të përjetësuar këtë sistem që plotësonte interesat e tyre evropiane e më gjerë, mbështesnin konsolidimin e shtetit SKS, i cili ishte krijesë e tyre, duke dekurajuar çdo lëvizje shpërbërëse kundër tij.

Për këtë arsye, rezistenca e armatosur e këtyre viteve e drejtuar nga Komiteti “Mbrojtja Kombëtare e Kosovës” mund të thuhet se ishte në kundërkohë me rrethanat ndërkombëtare, prandaj ajo, megjithëse ishte një lëvizje mjaft e fuqishme që u karakterizua edhe nga kryengritje masive dhe të përgjakshme kundër sundimit serbo-malazez dhe krijoi një organizëm të vetëm dhe autoritar drejtimi, ishte e destinuar të dështonte, të mbetej e izoluar, e fragmentarizuar në territore dhe forca të limituara, në raport me potencialin e popullit shqiptar.

Madje, ndonëse shërbeu për të mbajtur gjallë frymën e qëndresës kundër pushtimit serb, ajo pati edhe efekte të dëmshme: veçanërisht i dha organeve të pushtetit serb pretekstin për të intensifikuar dhunën mbi shqiptarët dhe presionin për spastrimin e tyre etnik.

Nga ana tjetër, duke u fokusuar tek qëndresa e armatosur, KMKK harxhoi shumë energji e mjete, të cilat mund të ishin investuar më me shumë efektivitet për mbrojtjen e të drejtave elementare të shqiptarëve, përmes rrugëve politike-diplomatike brenda Mbretërisë SKS dhe në arenën ndërkombëtare, duke u përqendruar në Lidhjen e Kombeve, dhe veçanërisht për denoncimin dhe frenimin e spastrimit etnik. Vlen të shënohet këtu se kur H. Prishtina, B. Pejani etj., paraqitën disa memorandume në Lidhjen e Kombeve për këtë qëllim, ato u devalvuan sepse Qeveria jugosllave dhe relatorët e LK i konsideronin anëtarët e tyre si revolucionarë. Pra, mund të thuhet shkurt se, faktorët ndërkombëtarë ndikonin që çdo rezistencë e armatosur të frenohej e të shuhej pa arritur sukses, dhe kishin lënë një hapësirë tepër të ngushtë për mbrojtjen diplomatike dhe juridike të popullsisë së robëruar shqiptare.

Një aspekt tjetër i kësaj rezistence të armatosur ishte fakti se ishte në kundërthënie me nevojat jetike të rikrijimit dhe stabilizimit të shtetit të ri shqiptar. Forca kryesore drejtuese e kësaj rezistence, pjesa më aktive e Komitetit “Mbrotjtja Kombëtare e Kosovës”, nuk e kuptoi këtë rrethanë dhe kushtëzim të rëndësishëm dhe u fut në konflikt me qeveritë shqiptare të kohës, duke krijuar një situatë të rrezikshme për stabilitetin e shtetit shqiptar, por edhe për sigurinë e popullsisë shqiptare në Kosovë. Rezistenca kundër sundimit serb në këtë kohë zhvillohej në një situatë kur shteti shqiptar i cunguar po luftonte për mbijetesën e tij. Në vitet 1919-1921, fati i kufijve dhe ekzistencës së tij ishte i rrezikuar seriozisht, por edhe pas kësaj kohe stabilizimi i brendshëm, si dhe pozita e tij në arenën ndërkombëtare ishte tepër e vështirë, sepse ishte në një pozitë shumë fluide, të brishtë dhe gjithnjë të rrezikuar. Në këtë mënyrë, ekzistenca e një Shqipërie të pavarur në atë kohë kërkonte medoemos paqen me fqinjët, për të frenuar sa të ishte e mundur faktorët shpërbërës. Në këto rrethana, të gjitha qeveritë shqiptare të asaj kohe nuk e mbështetën një luftë të armatosur në Kosovë, duke parë tek ajo rreziqe të mëdha për një intervencion jugosllav kundër shtetit shqiptar, por edhe për ashpërsimin e fushatës së spastrimit etnik në Kosovë dhe në viset e tjera shqiptare nën Mbretërinë SKS.

3). Rezistenca antiserbe e viteve 1941-1945, e cila u zhvillua në kuadrin e Luftës II Botërore, njohu një shkallë më të lartë organizimi dhe mund të thuhet se kishte aleatë të fuqishëm, italianët dhe gjermanët, të cilët kontrollonin dhe kishin pushtuar territorin shqiptar. Pra, mund të thuhet se kjo ishte hera e parë në histori kur rezistenca nacionaliste e shqiptarëve kishte një aleat të drejtpërdrejtë,

i cili sigurisht synonte të shfrytëzonte forcën e tyre të armatosur për interesat e veta politike e strategjike.

Ky ka qenë faktori kryesor që rezistenca nacionaliste shqiptare kundër serbëve arriti rezultate pozitive përgjatë viteve 1941-1944, të cilat ishin më të rëndësishmet në historinë e saj deri në këtë kohë. Por, këto rezultate ishin të përkohshme dhe vareshin nga koniunkturat e përgjithshme të zhvillimit të Luftës së Dytë Botërore, çka e minimizonte vlerën e tyre. Aleatët e shqiptarëve në atë kohë do të rezultonin humbës të historisë, për pasojë edhe sukseset e kësaj rezistence shqiptare do të treteshin në vorbullën e historisë, me ripushtimin jugosllav të territoreve shqiptare. Duhet shtuar këtu se, aleanca me gjermanët dhe italianët në atë kohë ishte e diktuar nga interesat strategjike të tyre që përkonin në një shkallë të konsiderueshme me objektivat themelore legjitime të kombit shqiptar.

Një aleancë me bllokun tjetër, anglo-amerikan, bazuar në këto objektiva, pavarësisht propagandës për vetëvendosjen pas luftës, rezultoi e pamundur, pasi Aleatët e Mëdhenj antifashistë synuan të shfrytëzonin potencialin luftarak të popullit shqiptar për interesat e tyre të luftës, pa i ofruar atij asgjë në këmbim. Ata ishin përcaktuar për mosndryshimin e kufijve dhe për ruajtjen e Jugosllavisë së Versajës. Ata jo vetëm nuk përcaktuan asnjë qëndrim për mbrojtjen e të drejtave elementare të popullsisë së Kosovës pas luftës, por Fuqia kryesore Aleate me ndikim në Ballkan, Britania e Madhe shkoi aq larg sa, duke përcaktuar si aleatë kryesorë nacionalizmin serb e grek, vuri sërish në diskutim kufijtë politikë të shtetit shqiptar, madje duke e deklaruar këtë edhe publikisht. (Deklarata e sekretarit të Jashtëm, Eden, më 17 dhjetor 1942, në Dhomën e Komuneve). Gjithashtu, edhe ato segmente të nacionalizmit shqiptar në Kosovë që vendosën

të luftonin dhe luftuan kundër gjermanëve si Lëvizja Kryeziu etj., pa kërkuar ndonjë angazhim politik të britanikëve për çështjen e Kosovës, u braktisën në çastet më kritike të luftës së tyre për shkak të kërkesave të shefit të partizanëve jugosllavë, Titos, të cilët konsideroheshin si forcë e rëndësishme për interesat britanike të luftës.

Kështu në mjedisin ndërkombëtar, pas kapitullimit të Gjermanisë, Serbia e inkuadruar në Jugosllavinë e Titos, gjeti aleatë të fuqishëm dhe oportunitet të favorshëm ndërkombëtar për të shtypur rezistencën shqiptare kundër ripushtimit jugosllav.

Edhe pse rezultatet themelore të kësaj rezistence u zhbënë, mbeti i gjallë kujtimi i tyre, përvoja e parë e bashkimit të pjesës më të madhe të trojeve shqiptare në një shtet kombëtar. Ky ishte një cak historik që shqiptarët nuk do të pushonin kurrë së lakmuari për ta riarritur sërish.

4). Lufta e UÇK-së në vitet 1998-1999, shënonte kulmin e rezistencës së armatosur shqiptare për nga masiviteti, qartësia politike, programi politik. Por, mbi gjithçka, ajo ndryshonte shumë nga valët e mëparshme të rezistencës shqiptare, për nga oportuniteti politik ndërkombëtar më i favorshëm se kurrë më parë. Prandaj, këtë oportunitet ndërkombëtar të kësaj lëvizjeje mund ta përkufizojmë në këtë mënyrë: ajo u zhvillua në kohën e duhur, në mënyrën e duhur dhe në kontestin ndërkombëtar më të favorshëm. Në gjykimin tim, ky faktor thelbësor e bën atë të ndryshme nga lëvizjet e mëparshme. Gjithashtu, ky ka qenë edhe faktori thelbësor që ajo arriti rezultatin më pozitiv të rezistencës rreth njëshekullore të shqiptarëve kundër pushtuesve serbë.

Kjo nuk do të thotë se ajo pati ndonjë përkrahje të drejtpërdrejtë ndërkombëtare. Të paktën nga dokumentet që disponojmë deri tani, nuk rezulton se UÇK-ja u përkrah politikisht apo ushtarakisht nga një fuqi e huaj, madje shumë vende perëndimore u përpoqën ta dekurajojnë atë me deklaratat e tyre publike, ndërsa Rusia bëri çmos të mbështeste Serbinë në shtypjen e saj me të gjitha mjetet. Por, fuqitë perëndimore, me në krye SHBA-në, deklaruan publikisht se mbështesnin një pjesë të objektivave të kësaj rezistence, kryesisht një autonomi të Kosovës brenda Serbisë, e cila duhej të realizohej në bazë të një marrëveshjeje paqësore. Nga ana e saj, Serbia po luftonte që të fitonte gjithçka në Kosovë dhe të kthente statusin e vjetër të Jugosllavisë së Karagjorgjeviqëve. Atëherë, Perëndimi e kufizoi deri diku atë, duke e parandaluar që të arrinte këtë objektiv dhe spastrimin e dhunshëm etnik të shqiptarëve përmes forcës. Këto dy shtylla të politikës euro-atlantike ishin mbështetja më e madhe për rezistencën shqiptare dhe dhanë mesazhin se tashmë në aspektin ndërkombëtar kishte ardhur ora e saj. Kjo që zgjuarsia dhe largpamësia e drejtuesve të saj që e shndërroi rezistencën, e cila për shumëkënd në fillim dukej anemike dhe e pashpresë, në një lëvizje fitimtare. Këtë herë, blloku i Fuqive të Mëdha që mbështetën dy objektivat e lartpërmendura, ishte blloku që dominonte politikën dhe vendimmarrjen botërore, pra ishin fituesit e Luftës së Ftohtë. Firma e hedhur në projekt-marrëveshjen e Rambujesë nga udhëheqësit e UÇK-së, së bashku me udhëheqësit e tjerë kosovarë dhe kundërshtimi i saj prej Serbisë, bëri që UÇK të përfitonte indirekt edhe mbështetjen ushtarake nga këto Fuqi të Mëdha dhe të bashkonte potencialet e saj me veprimet e fuqishme ushtarake, politike e diplomatike të Perëndimit, i cili në këtë rast po mbronte interesat e tij thelbësore në

Kosovë: parandalimin e një konflikti midis anëtarëve të NATO-s në krahun e saj juglindor dhe shpërbërjen e këtij krahu të Aleancës; parandalimin e rivendosjes së influencës ruse në Ballkan dhe Evropë; parandalimin e bllokimit të proceseve integruese në Evropë.

Duhet shtuar edhe diçka: këtë herë, ky faktor madhor favorizues ndërkombëtar u shfaq edhe si një faktor që ruajti në parametra minimalisht të nevojshme shkallën e kohezionit brenda faktorit shqiptar në Kosovë e në rajon, i cili kishte qenë problematik gjatë gjithë shek. XX, vijonte të ishte në dyshim dhe përballë dilemave të rrezikshme edhe në këtë kohë. Madje, mund të thuhet se politika dhe ndërhyrja perëndimore e shpëtoi këtë kohezion dhe shmangu me forcë një konflikt brenda shqiptar që nxitej nga armiq të tyre, qoftë ky politik, pa përjashtuar edhe një konflikt me armë.

Edhe në këtë rast, shteti shqiptar ishte i dobët dhe ndihmesa e tij për rezistencën e armatosur ishte minimale. Kjo së pari sepse Shqipëria ishte në anarki dhe ende po përpiqej të rimernte veten nga konflikti i thellë politik i viteve 1997-1998, ku kishte ende një polarizim të brendshëm politik të skajshëm etj. Së dyti, ndihma e shtetit shqiptar për rezistencën e armatosur kufizohej nga legjislacioni ndërkombëtar. Por, ekzistonte një rrethanë e re e rëndësishme ndërkombëtare që kishte përforcuar ndikimin pozitiv të shtetit shqiptar, e cila nuk kishte ekzistuar më parë: Shqipëria, pavarësisht krizës së rëndë që sapo kishte kaluar dhe vijonte ta përjetonte, ishte projektuar si pjesë integrale e strukturës politiko-ushtarake euro-atlantike, kështu që, pozita e saj ndërkombëtare ishte më e mira në historinë e saj dhe pikërisht për këtë arsye ajo shërbente si faktor ndihmës me rëndësi për rezistencën e shqiptarëve të Kosovës në koniunkturën ndërkombëtare të kohës.

Bibliografia

Archivio Storico Diplomatico, Ministero degli Affari Esteri (ASD MAE), Roma
Arkivi i Institutit të Historisë (AIH), Tiranë
Arkivi i Ministrisë së Punëve të Jashtme (AMPJ), Tiranë
Arkivi Qendror Shtetëror i Republikës së Shqipërisë (AQSh), Tiranë
The National Archives(TNA), London

II. Botime dokumentare

- Bisedimet e Këshillit Kombtar*, Tiranë: Mbrothësija, Kristo Luarasi, 1920, 1921, 1923, 1924.
- Bisedimet e Këshillit Kombtar*, Tiranë: Nikaj, 1922.
- Documenti (I) Diplomatici Italiani*, Settima Serie (1922-1935), vol. I (31 ottobre 1922 – 26 aprile 1923), Ministero degli Affari Esteri, Roma: 1953.
- Documentson British Foreign Policy, 1919-1939*, First Series, vol. IV, Edited by [Ernest Llewellyn Woodward](#) & [Rohan Butler](#), London: Her Majesty Stationary Office (HMSO), 1952.
- Documentson British Foreign Policy, 1919-1939*, First Series, vol. XXII, Edited By W. N. Medlicott, Douglas Dakinand Gillian Benett, London: HMSO, 1980.
- Documentson British Foreign Policy, 1919-1939*, First Series, vol. XXIV, Edited By W. N. Medlicott, Douglas Dakinand Gillian Benett, London: HMSO, 1983.
- Dokumente e materiale historike nga lufta e popullit shqiptar për liri e demokraci 1917-1941*, botim i Drejtorisë së Arkivave Shtetërore të RPSH, Tiranë: 1959.
- Hasan Prishtina: Përmbledhje dokumentesh(1908-1934)*, përgatitën për botim Kujtim Nuro, Nezir Bata, Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave, Tiranë: 1983.
- Lufta e popullit shqiptar për çlirimin kombëtar 1918-1920* (përmbledhje dokumentesh), përgatitur nga Muin Çami dhe Hidajete Luga (Bejtja) në bashkëpunim me Dhimitër Andonin, Mediha Shuteriqin dhe Zekeria Rexhën, vëll. I, II, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave, Tiranë: 1975.
- Shqipëria në dokumentet e arkivave ruse* (përmbledhje dokumentesh), përgatitur nga Islam Lauka, Eshref Ymeri, Tiranë: Toena, 2006.

III. Literaturë historiografike, ditare e kujtime

- AUSTIN, Robert C. - *Shtegu i pashkelur i Fan Nolit - Demokracia shqiptare në vitet 1920-1924*, Tiranë: Albin, 2000.
- AVRAMOVSKI, Živko - “Jugoslovensko-Albanski odnosi 1918-1939”, në *Ideje, casopis za teoriju savremenong drustva*, Broj. 5-6, Beograd: 1987.
- “Kontributi i studimit të historisë së Shqipërisë në periudhën midis dy Luftërave Botërore”, në *Gjurmime albanologjike*, nr. 2, Prishtinë: 1968.
- “Qëndrimi i Anglisë ndaj qeverisë së F. Nolit në Shqipëri në vitin 1924”, në *Gjurmime Albanologjike*, nr. 2, Prishtinë: 1972.
- Bytyçi, Enver - *Diplomacia imponuese e NATO-s në Kosovë*, Tiranë: Instituti i Studimeve të Evropës Juglindore, 2012.
- CICI, Arben - *Marrëdhëniet shqiptaro-italiane në vitet 1920-1934*, Tiranë: UET Press, 2013.
- Clark, Howard - *Civil Resistance in Kosovo*, London: Pluto Press, 2000.
- Clark, Wesley - *Të bësh luftë moderne*, Prishtinë: Zëri, 2003. Clewing, Konrad – Oliver Jens Schmitt, *Geschichte Südosteuropas_Von frühen Mittelalter bis zu Gegenwart*, Verlag, Friedrich Puster, Regensburg: 2011.
- CULAJ, Lush - *Komiteti Mbrojtja Kombëtare e Kosovës (1918-1924)*, Instituti Albanologjik i Prishtinës, Prishtinë: 1997.
- *Shqipëria dhe problemi kombëtar (1918-1928)*, Instituti Albanologjik i Prishtinës, Prishtinë: 2004.
- ÇAMI, Muin - “Mbi rolin e Bajram Currit në shtypjen e lëvizjes reaksionare esadiste më 1920”, në botimin *Bajram Curri (Trajtesa e dokumente)*, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë: 1982.
- “Mbi themelimin e Komitetit “MKK” dhe orientimin politik të tij”, në *Komiteti “Mbrojtja Kombëtare e Kosovës”*, botim i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, Tiranë: 2004.
- Danner, Mark - *Endgame in Kosovo*, New York: 1999.
- DERVISHI, Kastriot - *Historia e shtetit shqiptar (1912-2005)*, Tiranë: 55, 2006.
- Engelberg, Stephen - *Weighing Strikes in Bosnia, US Warns of Wider War*, The New York Times, 25 prill 1993.
- FISCHER, Bernd J. - *Mbreti Zog dhe përpjekja për stabilitet në Shqipëri*, Tiranë: Çabej, 1996.

- FRASHËRI, Mehdi - *Kujtime (Vitet 1913-1933)*, Tiranë: OMSCA-1, 2005.
 - *Nevruzi*, Tiranë: Mbrothësija, 1923.
- Garton Ash, Timothy - *Cry, the dismembered Country*, The New York Review of Books: 1999.
- Hajrullahu, Arben - *Paqja afatgjatë në Ballkanin Perëndimor përmes integritit në BE - Procesi i Integritit në BE si mundësi për tejkalimin e konfliktit serbo-kosovar*, Prishtinë: Fondacioni Konrad Adenauer, 2015.
- von Horn, Helga - "Auf dem Weg zu neuen Krieg? Der UN – Sicherheitstat und die Erosion des Voelkerrechts", in Ralf M. Leudicke/ Peter Strytynski (Hg), *Permanenter Krieg oder nachhaltiger Frieden?*, Verlag Wilfried Junior, Kassel: 2005, Seite, 151.
- Hesibourg, François - "The Future of the Atlantic Alliance: Whither NATO, Whether NATO"? Në botimin U.S. *Security in an Uncertain Era*, edited by Brad Roberts, MIT Press, Cambridge, Massachusetts, London, England, pp. 100.
- Historia e shqiptareve gjatë shekullit XX*, vëll. II, Periudha 1920 -1925, Akademia e Studimeve Albanologjike, Instituti i Historisë, Tiranë: 2019.
- Holbrooke, Richard - *To end a War*, New York: RandomHouse, 1998.
- Hoxhaj, Enver - *Ngritja e një shteti - Politika e Jashtme e Kosovës*, Tiranë: Botimet Dudaj, 2016.
- JACOMONI, Francesco - *La Politica dell'Italia in Albania: nelle testimonianze del Luogotenente del Re Francesco Jacomoni di San Savino*, Roccadi San Casciano, Cappelli ed., 1965.
- Judah, Tim - *Kosovo: War and revenge*, New Haven and London: Yale University Press, 2000.
- KADRIA, Sali - "Përplasja e 'Klikës' me Ahmet Zogun në vitin 1923. Thellimi i përçarjes së nacionalizmit shqiptar", kumtesë e mbajtur në konferencën shkencore "Rrugëtimi i shtetit të pavarur shqiptar nga krijimi drejt integritit europian", organizuar nga Instituti i Historisë i Akademisë së Studimeve Albanologjike, mbajtur në Tiranë, më 27 nëntor 2017.
 - *Nacionalizmi shqiptar në vitet 1912-1924*, dorëshkrim në Institutin e Historisë.
- KOLIQUI, Ernest - *Vepra V*, Prishtinë: Faik Konica, 2003.
- Kühmel, Bernhard - *Deutschland und Albanien, 1943-1944*. Auswirkungen der Besetzung auf die innenpolitische Entwicklung des Landes, Bochum 1981 (Inaugural dissertation zur Erlangung eines Doktors der Philosophie in der Abteilung für Geschichte swissenschaft der Ruhr–

- Universität *Integritet në BE si mundësi për tejkalimin e konfliktit serbo-kosovar*, Prishtinë: Fondacioni Konrad Adenauer, 2015.
- Malcolm, Noel - *Kosovo: A short History*, London: Macmillan, 1998.
- MILO, Paskal - *Shqipëria dhe Jugosllavia 1918-1927*, Tiranë: Shtëpia Botuese Enciklopedike, 1992.
- PASTORELLI, Pietro - *L'Albania nella politica estera italiana, 1914-1920*, Napoli: Jovene, 1970.
- PEARSON, Owen - *Albania and King Zog. Independence, Republic and Monarchy, 1908-1939*, The Centre for Albanian Studies, London: 2005.
- *Albania in the Twentieth Century a History*, vol. I – Albania and King Zog (1908-1939), Tauris: 2005.
- Petritsch, W., Kaser, K., Pichler, R. - *Kosovo, Kosova, Mythen, Daten, Fakten [Kosova, mite, data, fakte]*, Klagenfurt 1999.
- Prifti, Kristaq & Shtylla, Zamir - "Komiteti 'Mbrotja Kombëtare e Kosovës' dhe veprimtaria e tij për çlirimin dhe unitetin kombëtar", në *Studime historike*, nr. 4, Tiranë: 1988.
- Rachfelder, Erich - *Kosovo-Geschichte eines Konflikts*, Suhrkamp, Verlag, Berlin: 2010, f.228.
- Reuter, Jenz - *Die Kosovo-Politik der internationalen Gerneinschaft in den neunziger Jahren. In Der Kosovo-konflikt*, Ursachen, Verlauf, Perspektiven, Wieser Verlag, Klagenfurt, Celovec: 2000.
- REXHA, Zekeria - "Kontributi i Komitetit MKK për mbajtjen e Kongresit të Lushnjës dhe mbrojtjen e vendimeve të tij", në *Kongresi i Lushnjës dhe Lufta e Vlorës*, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë: 1974.
- Rubin, James - *Njëluftëshumë personale*, Klan: 2000.
- RUSHITI, Liman - *Lëvizja kaçake në Kosovë (1918-1928)*, Instituti I Historisë "AliHadri", Prishtinë: 1981.
- SKËNDI, Eqber - *Hoxhë Kadriu (Kadri Prishtina)*, Prishtinë: Rilindja, 1992.
- Stedma, Stephen J. - "Alchemy for a New World Order", in *Foreign Affairs*, 1995.
- SWIRE, Joseph - *Shqipëria - Ngritja e një mbretërie*, Tiranë: Dituria, 2005 (Swire, Joseph - *Albania. The Rise of a Kingdom*, London: Williams and Norgate, 1929).
- SHTYLLA, Zamir - "Rreth krijimit dhe veprimtarisë së Komitetit 'Mbrotja Kombëtare e Kosovës' në vitet 1918-1920", në *Studime historike*, nr. 3, Tiranë: 1986.
- TELI (DIBRA), Pranvera - *Shqipëria dhe diplomacia angleze (1919-1927), nën dritën e burimeve arkivore angleze*, Tiranë: Neraida, 2005.

VLLAMASI, Sejfi - *Ballafaqime politike në Shqipëri (1897-1942). Kujtime dhe vlerësime historike*, përgatiti për botim Marenglen Verli, Tiranë: Neraida, 2000.

Weller, Marc - *Shtetësia e kontestuar: Administrimi ndërkombëtar i luftës së Kosovës për pavarësi*, Prishtinë: Koha, 2009. *Zur Geschichte der UÇK: in Der Kosovo Konflikt*, Ursachen, Verlauf, Perspektiven, Seite 171.

Beqir Meta

SUMMARY

1. Throughout the last century, the international circumstances were mainly unfavourable to the armed resistance of Kosovo Albanians and other territories under the Serbian, Montenegrin or Yugoslavian rule, with regard to national liberation or against the national and social oppression.

2. This situation has generated serious difficulties within the Albanian resistance, particularly in its political positioning towards the international scene, encountering numerous dilemma about the course to be followed.

3. The lack of fair and determined allies in the international scene has sometimes incited a distrust and apathy within the internal power of Albanians, and this has obstructed the resistance movement in regards to the number of armed participants, although it was widely supported by people, as well as its military potential in front of the enemy.

4. The lack of an external ally was followed by the division and fragmentation of this movement, including the loss of its internal cohesion. In some cases, the invader used this movement as a pretext to increase the violence and repression on Albanians, as well as to intensify the ethnical cleansing. In some cases, the armed resistance took place in contradiction to the essential needs of renovation and stabilization of Albania state, which in general, did little or nothing to support this resistance. The Albanian resistance found strong allies only during the World War II, in two main Axis powers: Italy and Nazi Germany. This was the first time in history that it had direct allies; but the allies aimed to exploit it for their own political, military and strategic interests. The allies lost the war; consequently the

positive achievements that Albanian resistance gained by their support would be dissolved in vortex of history, through Yugoslavian re-conquest of Albanian territories. The Serbs and Montenegrins paid great efforts to force Albanians to pay politically and by their life this episode of the history. Only the war of the Kosovo Liberation Army in 1998- 1999 marked the peak of the Albanian armed resistance: in terms of massiveness, political clarity and political program. But, this time it differed greatly from previous waves of Albanian resistance in regards to international political opportunity, which was more favourable than ever. This essential factor makes it different from previous movements and provided the possibilities to achieve the best positive results of one century of resistance against the Serbian invaders.

QerimLita

Problemi i Kosovës, 1981-1990

Shqiptarët në Kosovë dhe në viset tjera nën Federatën komuniste Jugosllave, gjatë viteve shtatëdhjeta të shekullit të kaluar, krahasuar me vitet e mëparshme të pas Luftës së Dytë Botërore, patën një zhvillim të dukshëm në përgjithësi, e në sferën e arsimit e të kulturës në veçanti. Burimet arkivore vënë në dukje se deri në vitin 1981, numri i përgjithshëm i nxënësve e studentëve në Kosovë arrinte shifrën prej rreth 450 000, që nënkuptonte se çdo i treti banor i Kosovës ishte në shkollim. Në vitin akademik 1980/81 në Universitetin e Prishtinës studionin mbi 48 000 studentë. Edhe zhvillimi i veprimtarisë kulturore e shkencore ishte i shpejtë. Në atë periudhë kohore në Kosovë vepronin gjithsej 18 institucione kulturore-shkencore në të cilat punonin 1 160 studiues shkencorë¹.

Duhet vënë në dukje se ky zhvillim erdhi menjëherë pas demonstratave shqiptare të vitit 1968 në Kosovë dhe në Tetovë, të cilat e detyruan udhëheqjen jugosllave, të ndërmerr hapa më konkretë e më të përshpejtuar për avancimin e statusit të shqiptarëve². Ndërkohë, përderisa demonstratat e vitit 1968, ndikuan pozitivisht në ngritjen dhe zhvillimin e gjithanshëm të shqiptarëve nën Jugosllavi, demonstratat studentore të organizuara gjatë muajve mars-prill 1981, në Prishtinë dhe nëpër qytete tjera të Kosovës, do të jenë si pretekst për autoritetet komuniste jugosllave që të ndërmarrin masa të

¹Државенаркивна Република Македонија (më tej ДАРМ). 1.427.382.28/567-590.

² Shih më gjerësisht: “Problemi shqiptar në RP(S) të Maqedonisë 1944-1974”, përmbledhje dokumentesh, përzgjedhjen, redaktimin, përkthimin, parathënien dhe hyrjen QerimLita, Logos-A, Shkup 2018, Vëllimi 1- 6.

dhunshme, për siç thuhej “shuarjen e kundërrevolucionit në Kosovë”³. Rol të rëndësishëm për tërë këtë, gjithsesi se pati edhe udhëheqja e atëhershme e Kosovës, e cila siç dihet menjëherë pas demonstratave doli me dy qëndrime kundërthënëse njëra me tjetrën. Përderisa Mahmut Bakalli dhe përkrahësit e tij, mbronin idenë se “pakënaqësia sociale e studentëve” përbënte thelbin kryesor të demonstratave, e në anën tjetër Fadil Hoxha, Ali Shukriu, Xhavit Nimani, Azem Vllasi etj., dolën me qëndrim se ato janë vepër “e elementeve armiqësore” të cilat vijnë nga “pozita e nacionalizmit e irredentizmit shqiptar”⁴.

Ndërkohë, edhe Këshilli Federativ për mbrojtjen e rregullimit kushtetues të RSFJ-së, me të cilin udhëhiqte shovinisti i mirënjohur maqedonas, L Lazar Kolishevski, në mbledhjen e mbajtur në Zagreb, vlerësonte se “standarti studentor” nuk ishte shkaku kryesor i demonstratave, por se bëhet fjalë “për një aksion armiqësor”, i cili qëndrim u mbështet edhe nga Kryesia e RSFJ-së, dhe në marrëveshje me udhëheqjen e Kosovës, më 12 mars 1981 nëpërmjet “Tanjugut”, u shpall si “qëndrim zyrtar i udhëheqjes jugosllave”⁵. Kjo ia hapi rrugën policisë jugosllave për të ndërmarrë masa të rrepta kundër studentëve dhe inteligjencës shqiptare.

³ Arhiv Slovenije (më tej AS) 1589. The. eno. 1470-Kosovo 1981.

⁴ AS.1589 teh. eno. 1470-IV, Kosovo 1981, Savezni Savet za Zaštitu Ustavnog Poretka, br. 25, Državna Tajna, Beograd, 23 april 1981 god: “Ocene i Stavovi o Kontrarevolucionernim dogadjajima u Socijalističkoj Autonomnoj Pokrajini Kosovu”; Po aty, Strogo Poverljivo, Centralni Komitet SKJ - Predsedništvo, 05/2 Br. Str.Pov. 307/1, 15. VII. 1981 god., Beograd, Izveštaj Komisije Predsedništva CK SKS i PK Kosovo za utvrdjivanje partijske odgovornosti Mahmuta Bakalija.

⁵ Instituti i Trashëgimisë Kulturore e Shpirtërore të Shqiptarëve në Maqedoni (më tej: ITKSHM), Marrëdhëniet shqiptaro-jugosllave 1968-1981, përmbledhje dokumentesh, përzgjedhjen, parathënien dhe redaktimin: Qerim Lita, Shkup, 2012, dok. nr.38, f. 250-266.

Në fakt, shtettrrethimi policor i Kosovës, ndodhi më 2 prill 1981, kur në mbledhjen e përbashkët të Kryesisë së RSFJ-së dhe Kryesisë së LKJ-së, u soll vendimi për “shpalljen e gjendjes së jashtëzakonshme në territorin e komunës së Prishtinës”⁶. Mbështetur në këtë, brenda natës së 2-3 prillit, në Kosovë u stacionuan njësi të shumta policore-ushtarake. Qeveria jugosllave, përmes nënkryetarit, DragolubStavrev, më 3 prill i raportonte Kryesisë së RSFJ-së dhe Kryesisë së LKJ-së, se “në kuadër të masave të ndërmarra, me kërkesë të udhëheqjes krahinore, janë dërguar përf forcime të organeve të punëve të brendshme të KSA së Kosovës nga efektivit i Federatës dhe të gjitha republikat socialiste e të KSA të Vojvodinës”⁷. Në një dokument i cili konsiderohej si “sekret shtetëror”, thuhej se vetëm në Prishtinë ishin stacionuar mbi 3 500 forca policore dhe dy divizione të APJ-së. Më tej dokumenti vinte në pah se “gjatë aksionit të zhvilluar midis 1-3 prillit, forcat ushtarako-policore jugosllave vranë 8 (tetë) demonstrues, plagosën 75 të tjerë, arrestuan 807 vetë, ndaj 28 prej tyre u zhvillua procedurë e shpejtë hetimore, ndërsa ndaj 698 personave tjerë është ndërmarrë masa disiplinore”⁸.

Përderisa në Prishtinë e nëpër qendra tjera të Kosovës zbatohej një terror dhe krim i paparë ndaj shqiptarëve të pambrojtur, në anën tjetër udhëheqja politike kukull e Kosovës, vazhdonte ta

⁶ AS.1589,teh. eno, 1470-IV, Kosovo, Beleška sa sastanka članova predsedništva SFRJ i članova predsedništva CK SKJ, koji su se nalazili u Beogradu 1 i 2 aprilla 1981 g.; po aty, Odluku o proglašenju vandrednog stanja na teritoriji opshtine Prištine.

⁷ AS.1589. teh. eno. 1470-IV Kosovo marec-april 1981 g., Državna tajna, 05. Br. str. pov. 3/29, 6 aprill 1981 god., Beograd, Članovima Predsedništva CK SKJ, Izvršnim Sekretarima Predsedništva CKSKJ: Po nalogu predsednika Predsedništva CKSKJ, šaljeno Vam Informaciju SIV-a o političko-bezbednosnoj situaciji u Socijalističkoj Autonomnoj Pokrajini Kosovo, u vezi sa neprijateljskim akcijama u Prištini i nekim drugim opštinama i preduzetim merama....

⁸ AS.1589. teh. eno 1470-IV. Kosovo, Savezni Savetza zaštiti Ustavnog Poretka.

propagandoj politikën mashtruese të “vëllazërim-bashkimit”, që sipas tyre “armiqtë e jashtëm e të brendshëm dëshirojnë ta përmbysin atë”. Ndër ta duhet veçuar Fadil Hoxhën, i cili në fjalimin e mbajtur më 3 prill 1981, para aktivitet politik të LK të Prishtinës, veç tjerash përdori një fjalor tepër brutal e ofendues kundër demonstruesve dhe mbështetësve të tyre, duke i quajtur ata si “plehu i Kosovës”, “hajna të Kosovës”, “fëlliqësira të Kosovës”, “Bira e minit 300 grosh” etj. Fjalimi i tij u transmetua drejtpërsëdrejti nga të gjitha stacionet e RTV të Jugosllavisë, për çka pasuan reagime të shumta anë e mbanë hapësirës shqiptare⁹.

Masat e dhunshme që u vendosën në Kosovë menjëherë pas demonstratave studentore mars-prill 1981, si dhe proceset e shumta gjyqësore të zhvilluara kah mesi i atij viti kundër inteligjencës dhe rinisë shqiptare (shumica e tyre ishin studentë dhe mësimsdhënës)¹⁰, alarmoi opinionin e gjerë ndërkombëtar. Shumë medime perëndimore kritikonin regjimin komunist të Beogradit për shkeljen drastike të të drejtave njerëzore në Kosovë, ndërsa disa prej tyre Jugosllavinë e konsideronin si shtet totalitar, e cila në këtë pikëpamje fare nuk dallonte nga vendet tjera socialiste. Proceset gjyqësore të zhvilluara në Kosovë, i vlerësonin si procese të montuara nga ana e regjimit, e në të cilat siç bëhej me dije “ishin dhënë dënime drastike”. Madje disa medime, si në: Belgjikë, Gjermani, Zvicër e Turqi,

⁹ AS. 1589. teh. eno. Kosovomarec-april 1981 god., Letër anonime dërguar më 12 maj 1981, KK të LKK dhe KQ të LKJ nga një grup fshatarësh, punëtorësh dhe intelektualësh shqiptarë nga Kosova dhe nga viset tjera shqiptare nën Jugosllavi, me titull: “Ko je poseonacionalizam na Kosovu i kod Albanaca u Jugoslaviji”, 05. Br. Str. pov. 3/41, 15 maja 1981 god. Beograd.

¹⁰ ДАРМ.1. 427.484.26/936-1010, Stenogramske Beleške sa razgovora delegacije Centralnog komiteta Saveza komunista Makedonije i Pokrajinskog komiteta Saveza komunista Kosova, održanog 20 decembra 1982 godine u Centralnom komitetu SKM.

akuzonin udhëheqjen komuniste jugosllave, përkatësisht shërbimin e saj sekret UDB-në për “kryerje të terrorizmit shtetëror në vendet e huaja”¹¹.

Është e rëndësishme të thuhet se për një pozicionim të tillë nga ana e mediumeve demokratike perëndimore, krahas shumë faktorëve tjerë, meritë të madhe pati edhe aktiviteti i bujshëm i diasporës shqiptare në shtetet e Evropës Perëndimore, SHBA, Kanada, Australi etj. Burimet sekrete diplomatike e partiake jugosllave, ofrojnë të dhëna të shumta për aktivitetet e organizatave politike shqiptare në botën demokratike perëndimore, të cilat shtriheshin në disa fusha. Kështu, sipas një raporti i të besuarit të LKJ-së në botën e jashtme, kuptojmë se: “brenda periudhës prill 1981-shtator 1982”, nga ana e organizatave të ndryshme shqiptare që vepronin në shtetet e Evropës Perëndimore dhe SHBA-së, ishin organizuar 40 demonstrata, në të cilat kishin marrë pjesë mbi 50 000 demonstrues shqiptarë¹².

¹¹ “..disa mjete të informimit në Belgjikë, RF të Gjermanisë, Turqi në përmasa më të mëdha insistojnë për “shkeljen e të drejtave njerëzore” të kombësisë shqiptare. Publiciteti i kësaj teme mori përmasa më të zgjeruara në fund të vitit me publikimin e raportit të AmnestyInterneshenel, i cili pati jehonë të madhe në mediumet perëndimore. Aksenti kryesor është në përforcimin e “represionit” pas vdekjes së Titos (shkaqet “frika dhe nervozizmi”), ndërsa përmbajtja e teksteve shkon në konstatimin se Jugosllavia është “vend totalitar” e cila në këtë pikëpamje nuk dallohet nga vendet tjera socialiste.... Tendencia e politizimit sa më të madh të EA (emigracionit armiqësor-Q.L.) dhe prezantimin e saj si forcë demokratike, në muajt e fundit gjithnjë e më tepër është e pranishme e që është e lidhur me tezën e përsëritur për “veprimtarinë e palejueshme të UDB-së” dhe për “terrorizmin shtetëror jugosllav” në territoret e huaja...”, ДАРМ. Ф. Секретариат за Односисо Странство (më tej 1326).11/1-22 – Inostrana sredstva informisanja o Jugoslaviji (1.I.1981-31.III.1982 godine).

¹² “Sipas të dhënave të SHSSH (SFPB) EASH përfshinë rreth 20 000 pjesëtarë (gjysma janë me prejardhje nga RSFJ) të organizuar në 25 organizata. Në kuadër të EASH ekzistojnë dy rryma: 1) emigracioni i vjetër me orientim nationalist

Përveç kësaj, organizatat e atëhershme politike shqiptare të cilat vepronin në ilegalitet, si dhe një numër i konsiderueshëm i veprimtarëve dhe intelektualëve të shquar shqiptarë, revoltën e tyre kundër shtettrrethimit ushtarako-policor të Kosovës e shprehën edhe përmes letrave anonime drejtuar udhëheqjes së atëhershme komuniste kosovare e jugosllave, duke ua bërë me dije se pas kërkesave të studentëve qëndron i mbarë kombi shqiptar, pa marrë parasysh përkatësinë e tyre ideologjike dhe se nuk ka forcë e cila do t'i detyronte shqiptarët të tërhiqeshin nga aspiratat e tyre të kamotshme, “krijimin e Republikës së Kosovës në kuadër të Federatës Jugosllave”, në të cilën republikë do të përfshiheshin “të gjitha viset shqiptare nën Jugosllavi”. Ndër reagimet e para ishte letra e Organizatës Revolucionare të Kosovës, dërguar Kryesisë së Komitetit Krahinor të LK të Kosovës, më 14 prill 1981. Në fakt, ajo përbënte “Notën” e Komitetit Qendror të asaj organizate, me çka ajo e mori përsipër organizimin e demonstratave. Në të ndër të tjerave thuhej: “Kombet e mbarë botës luftojnë dhe angazhohen për liri, pavarësi, sovranitet, drejtësi të përgjithshme, kulturë dhe paqe. Përse kombi shqiptar nuk duhet të angazhohet për të gjitha këto, aq më

profashist të njohur si ballistë (“Lidhja e Prizrenit”, “Legaliteti”, “Balli Kombëtar”, “Lidhja Kosovare”, “Blloku Indipendent”, “Bashkimi Shqiptar”) etj.; 2) emigracioni i ri “grupet marksiste-leniniste”, gjoja me orientim të majtë, të cilat drejtpërsëdrejti i ka organizuar shërbimi sekret shqiptar (“Organizata Nacional Demokratike Shqiptare”, “Rezistenca Nacionale e Kosovës”, “Rinia Shqiptare në Botën e Lirë”, “Komiteti i Kosovës për Evropë” dhe gjithsesi më ekstremja “Fronti i Kuq Popullor” - FKP, e cila nga viti 1982 është transformuar në “Lëvizje për Republikën Socialiste Shqiptare në Jugosllavi” - LRSSHJ).”: ДАРМ.1.427.469.85/857-879, Strogo Poverljivo – Predsedništvo CKSKJ –opunomočstvo za delatnost SK u vezi sa privremenim radom nashih grahana u inostranstvo “Neka aktuelna pitanja političko-bezbednosnog stanja i društvenog samoorganizovanja među našim grahanima albanske narodnosti u inostranstvo”, Beograd, dhjetor 1985.

tepër kur ndaj tij armiqtë dhe tradhtarët me shekuj ia kanë nëpërkëmbur atë aspiratë të shenjtë...Kërkuam republikë në territorin e Federatës Jugosllave, atë kërkesë e lamë anash, ndërsa ju, përkundrazi, na e morët edhe autonominë. Merremi me çështjet sepse ju na thatë se “Kosova Republikë” është kërkesë armiqësore, ndërsa demonstratat “irredentiste, shoviniste, nacionaliste dhe së fundit na quajtët shqiptaromëdhenj”, ndërsa lirisht mund të na quani edhe pansllavist. Ju jeni munduar të na bindni se kërkesa Kosova republikë është armiqësore, ndërsa ne e dimë se nëse Kosova shpallet republikë në territorin e Federatës jugosllave, atëherë Jugosllavia do të ishte më e fortë... Na quajtët neve shqiptaromëdhenj. Jo, nuk jemi ne shqiptaromëdhenj dhe asnjëherë nuk kanë qenë të mëdhenj ata të cilët i kanë kërkuar të drejtat e tyre. Të mëdhenj janë ata të cilët i shtypin të tjerët, i robërojnë, i vrasin dhe së fundit e rrahin shokun dhe nuk e lënë të qajë. Ju shumë shqiptarë në Maqedoni i keni regjistruar si maqedonas dhe shumë në Kosovë i keni regjistruar si myslimanë. Ne lirisht ju themi se mund t’i regjistroni shqiptarët që jetojnë në Jugosllavi ashtu siç dëshironi ju, por ata vetveten e dinë shumë mirë se janë shqiptarë. Mund t’i ndryshoni emrat e qyteteve në Kosovë edhe atë jo vetëm me emrin e Titos dhe Rankoviqit apo të Pashiqit. Ato qytete i kanë emrat e tyre edhe atë: Prizreni - qytet i Mbretërisë shqiptare, Gjakova - e Bajram Currit, Peja - e Haxhi Zekës, Mitrovica - e Isa Boletinit, Vushtrria - e Shaban Polluzhës, Podujeva - e Sali Hoxhë-Përpelacit, Prishtina - e Hasan Prishtinës, Ferizaj- i Idriz Seferit, Gjilani - i Xheladin Beqirit, pra ju mund t’i quani ashtu siç dëshironi...”.

Nota e organizatës së sipërpërmendur përfundonte si vijon:

“Bëni çfarë të dëshironi, jo vetëm policinë, por ftoni edhe ushtrinë. Le t’ua ruajnë jo vetëm rrugët, por edhe arat, ashtu siç vepruan motrat dhe vëllezërit tanë më 26 mars dhe 1 e 2 prill. Nga mesi ynë i ndatë 1 200 vëllezër e motra tona, mirëpo ju falënderojmë që i keni ftuar edhe ata që na i dërguat. Kosova, sot ka dy festa të reja, 26 marsin dhe 2 prillin, të cilat historia kurrë nuk do t’i fshijë. Ato dy data të rëndësishme janë futur në kalendarin e përkujtimeve të dëshmorëve të Kosovës. Veproni si të doni, ndërsa ne ju betohemi qoftë në kishë qoftë në xhami, se nuk do të tërhiqemi edhe nëse lëshoni bombë atomike”¹³.

Më 12 maj 1981, në adresë të KQ të LKJ-së, arriti edhe një letër tjetër, pas së cilës qëndronin një grup intelektualësh shqiptarë të Kosovës dhe viseve tjera nën Jugosllavi. Letra mbante titullin: “Kush e mbolli nacionalizmin në Kosovë dhe te shqiptarët në Jugosllavi”. Në fakt, intelektualët shqiptarë, një letër me përmbajtje të njëjtë e adresojnë edhe deri te Kryesia e KK të LK të Kosovës. Duhet të vëmë në dijeni se përmbajtja e letrës ishte bukur e gjerë, me gjithsej 32 faqe, ku në mënyrë kronologjike përshkruhen ngjarjet dhe zhvillimet politike në Kosovë dhe në viset tjera shqiptare nën Jugosllavi, që nga rënia e Perandorisë Osmane e deri te Plenumi i Brioneve (1966):

“...Pas rënies së Turqisë filloi lufta për dominim dhe hegjemonizëm te fqinjët, filluan luftërat vëllavrasëse dhe shumë të ashpra midis tyre, ashtu siç i njohim nga historia. Luftërat të cilat u zhvilluan nuk u iniciuan nga shqiptarët - sepse ata mbroheshin nëpër shtëpitë e tyre, por nga serbët e malazezët në Kosovë, në Mal të Zi dhe në Maqedoni. Vetëm gjatë vitit 1913 u vranë 13 000 shqiptarë. Krijimi i shtetit të SKS-së, shqiptarëve, maqedonasve, myslimanëve

¹³ AS. 1589-the.eno.1470-Kosovo 1981, *Po aty*.

nuk ua solli lirinë, por dhunën dhe terrorin - kurse më së shumti shqiptarëve. Qëllimet nacionaliste e shoviniste ishin që shqiptarët të depërtohen me dhunë nga vatrata e tyre, të asimilohen, mirëpo kjo nuk u arrit... Në vitin 1951 u përdor dhuna që shqiptarët të regjistroheshin si turq, myslimanë apo si të papërcaktuar ose të pa fe. Filloi forma më e errët e deportimit të dhunshëm e të terrorit jashtë vatrave të tyre, madje në Turqi haptazi flitet për një Konventë të nënshkruar nga pala jugosllave për deportimin e shqiptarëve në atë shtet. Kështu nga evidencat shtetërore shpërngulja e dhunshme e shqiptarëve, shprehur në numër është si vijon: në vitin 1953 u shpërngulën 13 000 banorë; në vitin 1954 ky numër u rrit në 17 000; në vitin 1955 u shpërngulën 51 000; në vitin 1956 u arrit rekordi prej 57 000 të shpërngulur; në vitin 1957 u shpërngulën 41 000; në vitin 1958, 27 000; në vitin 1959, 23 000 banorë, që zgjati deri te Plenumi i Brioneve. Në të gjitha forumet partiake e shtetërore pas Plenumit të Brioneve zyrtarisht pranohet për shpërnguljen e më shumë se 300 mijë shqiptarë nga Kosova, 200 mijë shqiptarë nga Maqedonia dhe rreth 100 mijë të tjerë nga Mali i Zi. Në Maqedoni jo vetëm që janë shpërngulur, por ato vendbanime janë kolonizuar me popullsi maqedonase. Këtë me siguri e di mirë LllazarKolishevski, sepse në atë kohë ishte udhëheqësi kryesor në RS të Maqedonisë...”

Pasi i numërojnë të gjitha ngjarjet e zhvilluara në trevat shqiptare nën Jugosllavi, gjatë viteve 1948-1966, intelektualët shqiptarë ju drejtohen anëtarëve të Kryesisë së KQ të LKJ-së me fjalët: “...Si ndryshe ta formulojmë mënyrën që u përdor ndaj shqiptarëve të Jugosllavisë së pas luftës, përveç se si nacionalizëm shovinizëm i tepruar, pra kush e mbolli nacionalizmin e shovinizmin në Jugosllavi, shqiptarët - të terrorizuar dhe të depërtuar jashtë

kufijve të atdheut të tyre apo serbomëdhenjtë, maqedonomëdhenjtë dhe elementet tjera. Shqiptarët të cilët bashkërisht luftuan me kombet e kombësitë tjera në Jugosllavi, nuk janë fajtorë për këtë...”.

Duke u ndalur në fjalimet e funksionarëve të lartë kosovarë, pas demonstratave të marsit e të prillit, në letër shprehimisht thuhej: “Fjalimet e shokëve drejtues të Kosovës, nisur nga shoku Fadil Hoxha deri te Asllan Fazliu, përveç gjykimeve të arsyeshme, futën edhe shumë dyshime, sepse përdorën fjali fyese, kërcënuese, sharje, ndërsa fyerjet nuk duhet të dalin nga goja e një udhëheqësi siç është Fadil Hoxha”. Rreth fjalës “Bira e minit 300 grosh”, që e përdori Fadil Hoxha më 3 prill në Prishtinë, artikullshkruesit e letrës i falënderohen shumë atij, sepse siç vënë në pah: “nga shprehje të tilla kosovarët dhe shqiptarët në Jugosllavi janë mësuar të paguajnë edhe më shumë, madje nga 12 mijë grosh edhe atë nga viti 1913 e deri te Plenumi i Brionëve, ndërsa ne menduam se do të na thoni diçka të re”.

Intelektualët shqiptarë, në vazhdim të letrës, shprehin revoltën e tyre edhe kundër fjalimit të LllazarKolishevskit në mbledhjen e përbashkët të Kryesisë së RSFJ-së dhe Këshillit Federativ për mbrojtjen e rregullit kushtetues mbajtur më 29 prill 1981 në Beograd, i cili kishte apeluar “për përdorimin e mëtejshëm të dhunës mbi shqiptarët”, duke dhënë vlerësime të njëanshme për demonstratat:

“...Fjalimi i shokut Lllazar Kollishevski ishte i përqendruar për një dhunë më të madhe në Kosovë, për kufizimin e zhvillimit ekonomik, kulturor e politik, në vend se të apelojë për zhvillim të mëtejshëm, ai apeloj për kufizimin e numrit të studentëve dhe të inteligjencës...Me siguri edhe Kollishevskie di të vërtetën e asaj çka ndodhi në Kosovë, i di shumë mirë arsyet që ndikuan për këtë

gjendje. A thua është e mundur të mos i dijë arsyet e stagnimit në Kosovë. Prandaj, i drejtohem Kolishevskit se dhuna, nxitja e frikës, kontrollit, arrestimeve, stagnimit, nuk janë mjete për zgjedhjen e problemeve, përkundrazi ato edhe më shumë e zgjerojnë revoltën tek qytetarët dhe ju mundësojmë të tjerëve të përzihen në çështjet tona për të cilat vetë mund t'i zgjedhim. Këtë me siguri e dinë mirë Kolishevski. Ai e di se shqiptarëve në Maqedoni ju është nxjerrë me dhunë nga koka plisi i bardhë, e di se sa dasma shqiptare për shkak të flamurit kombëtar janë shndërruar në mort e zi për shkak se policia maqedonase nuk u ka lejuar të futen në territorin e Maqedonisë me flamur (simbol nacional) dhe kështu janë krijuar shumë probleme të këtij lloji. Atëherë si mund ta vlerësojmë këtë, kur dihet se kombësia shqiptare në Maqedoni për nga numri i banorëve është e dyta menjëherë pas maqedonasve, prandaj parashtrohet pyetja: Përse të mos lejohet përdorimi i simbolit të kombësisë në formë legale dhe si mund të arsyetohet kjo? Pastaj dygjuhësia në Maqedoni tërësisht është jashtë përdorimit. Sikur shqiptarët në ato vise fare nuk figurojnë, si në: Shkup, Tetovë, Gostivar, Kërçovë, Strugë, Manastir, Ohër etj. A thua këtë nuk e dinë dhe nuk e ka të njohur Kolishevski!?”.

Në fund të letrës, intelektualët shqiptarë, ndalen te përgjegjësia e autoriteteve më të larta partiake e shtetërore të Kosovës, veçmas për strukturën e vjetër, për të cilët në letër thuhet: “Ata përgjegjësinë e kanë dhënë para popullit të vet që në kohën e para Plenumit të Brioneve, në periudhën e errët 1956 e deri më 1966, kur ky popull përjetoi aq mizoria, shokët udhëheqës, filluar nga shoku Fadil (Hoxha - Q. L.), Xhavid (Nimani - Q. L.), Ali (Shukriu - Q. L.), Milija Kovaçević, Xhevdet (Hamza - Q.L.), Petar Brajeviq, Kol

(Shiroka - Q. L.), Veli (Deva - Q. L.) e deri te Asllan Fazlia, nuk kanë guxuar të ndërmarrin asgjë që ta pengojnë atë dhunë e egërsirë që e përjetoi populli shqiptarë në Kosovë e në Jugosllavi, përkundrazi nuk u dëgjua zëri i tyre... Xhavidi, Mahmuti, Dushku, Bahriu, Mustafa Sefedini etj., nuk ishin në gjendje që vetë ta zgjidhnin situatën, me çka nuk do të lejohej që policia speciale të ndërmeret gjithçka çka është më e errët për studentët e studentet dhe për qytetarët në përgjithësi...Një vlerësim i tillë nuk vjen nga pozita egoiste, por nga dëshmitë dhe faktet e gjalla, të cilat janë parë nga ana e qytetarëve. Si shembull po e marrim brutalitetin e skajshëm të policisë jugosllave gjatë legjitimitetit të qytetarëve, duke ju drejtuar atyre me fjalët: “T’i nuk mban armë, sepse t’i nuk e donë atdheun” apo “T’i posedon armë, sepse je armik” dhe shumë tortura tjera, apo siç thotë populli “zdryp se të vrava, hip se të vrava” etj...Për torturën që ju është dhënë studentëve nëpër konvikte, besoni se as ushtria gjermane nuk do të vepronte aq tmerrshëm. Pas gjuajtjes së lotsjellësit nëpër konvikte, policia ka hyrë brenda dhe kudo që iu është dhënë rasti dhe cilindo që e kanë kapur nuk e kanë lëshuar pa e rrahur dhe pa i dhënë lëndime të rënda me shkopinj gome. Gratë i kanë rrahur nga barku duke ju thënë, nuk do të lindni më fëmijë shqiptarë etj. Për këtë shkak, disa studentë kanë kërcyer nga kati i dytë e i tretë, vetëm se të mos bijën në duart e tyre, duke mos llogaritur se a do të vdesin apo do të ngelin gjallë...Kjo si mund të arsyetohet dhe a ka ndonjë logjikë ose element humanitarë? Ne që i kemi përjetuar këto situata të rënda dhe tejet dramatike, e dimë vetë, ndërsa ata që nuk i kanë përjetuar le të flasin si të duan dhe si u vijnë nëpër gojë! Në fund, ne mendojmë se kërkesa

që Kosova të bëhet republikë në kuadër të Federatës nuk e minon bashkësinë tonë socialiste të kombeve e kombësive”¹⁴.

Në luftë e ashpër gjatë asaj periudhe kohore u zhvillua edhe kundër mërgatës shqiptare në përgjithësi, e të organizatave të tyre politike në veçanti. Burimet diplomatike jugosllave, vinin në dukje për një ndryshim të kursit politik të mërgatës shqiptare. Përderisa më herët, veprimtaria e saj në botën perëndimore ishte “në grupe të vogla ilegale”, tashti ajo kishte kaluar në “organizata masive dhe publike”. Tërë kjo, sipas autoriteteve komuniste të Beogradit, Shkupit e Prishtinës, ishte si rrjedhojë e ndikimit të “disa shërbimeve dhe qarqeve” demokratike perëndimore, të cilat te emigracioni politik shqiptar shihnin “alternativën e ardhshme demokratike” në Kosovë, e cila me kalimin e kohës duhej të lidhej “me kundërshtarët e brendshëm të regjimit komunist”, të cilët “dëshirojnë të organizohen si alternativë e Lidhjes Komuniste.”¹⁵. Një konstatim i tillë i tyre vinte për faktin se, siç shpreheshin “në kuadër të fushatës për të drejtat e njeriut në Jugosllavi” në disa shtete perëndimore “janë themeluar komitete, këshilla dhe liga”, ndërsa “mbështetje ju japin edhe disa organizata ndërkombëtare”. Mundësimi i publicitetit “të pjesëtarëve të kësaj kategorie” për drejtuesit komunistë të Beogradit “ishin ndër format më kryesore të mbështetjes nga ana e faktorit ndërkombëtar”¹⁶.

Për ta penguar aktivitetin e mërgimtarëve shqiptarë, Qeveria jugosllave nga marsi i vitit 1982, krahas udhëzimeve të rregullta nga

¹⁴*Po aty.*

¹⁵ ДАРМ.1.1326.13/1-25, Извршен Совет на Собранието на СР Македонија, Строго доверливо: “Актуелната меѓународна ситуација и политичко безбедносната положба на СФРЈ со посебен Освт на одразот на состојбите во непосредно соседство на СР Македонија”, Shkup, janar 1985.

¹⁶*Po aty.*

përfaqësitë e veta diplomatike e konsullore, do të kërkojë që të “themelojnë grupe operative në kuadër të përfaqësive diplomatike në shtetet me numër më të madh të popullsisë shqiptare, me detyrë që të hartojnë analizë të gjendjes dhe ta vlerësojnë situatën në mesin e qytetarëve të kombësisë shqiptare dhe të ndërmarrin masa përkatëse”, siç thuhet, “për ta pamundësuar ndikimin e irredentizmit në mesin e qytetarëve shqiptarë në diasporë”. E gjithë kjo, sipas një dokumenti tepër të besueshëm, duhej zbatuar, për shkak se “nacionalistët dhe irredentistët shqiptarë” jashtë vendit, veç tjerash, “përpiqen ta pamundësojnë aktivitetin e klubeve jugosllave” si dhe “ta komprometojnë politikën jugosllave para opinionit botëror” nëpërmjet “zhvillimit të rrjetit të gjerë të aktiviteteve armiqësore (demonstrata, tubime, përvjetorë, mbledhje përkujtimore, shpërndarjes së materialit propagandues etj.), që deri tash nuk ishte prezent në veprimtarinë e tyre”¹⁷.

Grupe, përkatësisht komisione të ngjashme do të krijohen edhe në kuadër të kryesive të komiteteve qendrore dhe krahinore të Lidhjes Komuniste, që quheshin “Prokura e Lidhjes komuniste për veprimtari në botën e jashtme”. Me Prokurën e Komitetit Krahinor të LK të Kosovës, udhëhiqte Kaqushë Jashari, e cila gjatë viteve 1982-1983, në bashkëpunim të ngushtë me prokurat e KQ të LK të Serbisë, KQ të LK të Maqedonisë dhe KQ të LK të Malit të Zi, hartoi një sërë plane operative, analiza etj., në të cilat në mënyrë të detajuar përshkruhej veprimtaria e organizatave politike shqiptare në botën e jashtme, që me këtë rast do ta veçojmë analizën me titull “Ecuritë ideopolitike në mesin e punëtorëve tanë të punësuar përkohësisht në botën e jashtme”, hartuar në qershor të vitit 1983 nga “Prokura e KK

¹⁷ ДАРМ.1.427.469.42/499-503, Записник од (зедничка) седница на Комисијата на ЦК СКМ за ОНО и ОСЗ со Полномоштвото за дејноста на СК во врска со заминувањето на привремена работа на наши работници во странство.

të LK të Kosovës”. Po të lexohet me kujdes, do të vërejmë se terminologjia e përdorur në të aspak nuk dallon nga terminologjia e analizave të përpiluara në Beograd apo në Shkup. Kështu, ajo veprimtarinë atdhetare e patriotike të organizatave politike shqiptare e konsideronte si “veprimtari armiqësore”, “nacionaliste dhe irredentiste”, ndërsa drejtuesit e tyre si “armiq të përbetuar të vetëqeverisjes socialiste në Jugosllavi”, apo “kriminelë dhe tradhtarë” dhe shumë epitete tjera¹⁸.

¹⁸ “...Punëtorët tanë u janë rreshtuar vazhdimisht presioneve të emigracionit armiqësor, të cilët ndihmojnë anën e shërbimit informativ (mendohet për shërbimet informative të shteteve perëndimore - Q.L.), aktiviteti i të cilëve është shtuar sidomos pas ngjarjeve kundërrevolucionare në Kosovë, (ballistët, zogistët e tjerë), pastaj presionit dhe formave të tjera të ndryshme të propagandës nga ana e organizatës së “Frontit të Kuq”, e cila në çdo mënyrë tenton që t’i përfitojë punëtorët tanë për qëllimet e veta. Në kuadër të kësaj organizate kryesisht janë personat, pjesëtarë të grupeve ilegale në vend të ikur në botën e jashtme, në mesin e të cilave është një numër i konsideruar aventuristësh dhe i kriminelësh, të cilët atje paraqiten si “luftëtarë” për të drejtat e shqiptarëve në Jugosllavi... Si udhëheqës i kësaj organizate paraqitet studenti Ibrahim Kelmendi, i cili ka ikur nga vendi ynë për shkak të veprimtarisë armiqësore. Rreth vetes ka tubuar një grup bashkëmendimtarësh të vet të cilëve më vonë u është bashkuar Jusuf Gërvalla, gazetar i cili ka vepruar në mënyrë armiqësore edhe sa ka qenë në vend. Qëllimi kryesor ka qenë shkatërrimi i shoqërisë dhe i klubeve dhe ndarja e punëtorëve të kombësisë shqiptare nga klubet jugosllave. Në RF të Gjermanisë vepron organizata e njohur e nacionalistëve shqiptarë, në të cilën janë tubuar kryesisht kriminelët në krye me EminFazliun, të ashtuquajtur “EminKastrati”, i cili në mënyrë të haptë bashkëpunon me ustashtët. I ngjashëm me të është edhe Enver Hadri, emigrant në Bruksel, i cili rrjedh prej një familje bejlerësh. Ai është vënë në krye të grupit të ashtuquajtur “Rezistenca Nazionale e Kosovarëve”, i cili tenton që me një emër të këtillë të bujshëm të veprojë në mënyrë armiqësore ndaj Kosovës. Janë shumë aktivë edhe pjesëtarët e organizatës “Lëvizja për Republikën Socialiste Shqiptare në Jugosllavi”, veprimi i të cilës po zhvillohet në atë drejtim që të përvetësohen qytetarët tanë të angazhuar për veprimtarinë armiqësore duke zbatuar metodat e

Në Arkivin e Maqedonisë ekzistojnë një memorie raportesh, analiza, informata, elaborate, etj., të Sekretariatit Federativ për Punë të Jashtme të RSFJ-së, që me këtë rast po e shpalosim analizën, me titull: “Disa aspekte dhe vlerësime të veprimtarisë së emigracionit armiqësor ndaj RSFJ-së në kontekstin e marrëdhënieve bashkëkohore botërore”, hartuar më 24 shkurt të vitit 1984, nga Sekretariati Federativ për Punë të Jashtme të Jugosllavisë, në të cilin gjerësisht përshkruhen aktivitetet politike, organizative, diplomatike të emigracionit politik shqiptar përgjatë viteve 1982-1983. Analiza, fillimisht në pika të shkurta ndalet në historiatin e krijimit të organizatave politike shqiptare në botën e jashtme, sipas së cilës ajo ndahej në dy grupime. Në grupimin e parë përfshiheshin organizatat politike të krijuara menjëherë pas Luftës II Botërore, si: Balli Kombëtar, Lëvizja e Legalitetit, Lidhja Kosovare, Lidhja II e Prizrenit dhe disa organizata dhe grupe më të vogla. Aktiviteti i tyre, “në vijimësi është antikomunist dhe antijugosllav”, përkatësisht ata angazhohen për: “përmbysjen e regjimit komunist në Shqipëri dhe Jugosllavi si dhe krijimin e Shqipërisë me kufijtë e saj etnikë” dhe se ata që nga fillimi kanë hasur në “mbështetje të fuqishme nga disa qarqe perëndimore”, të cilat “në përputhje me interesat e tyre strategjike të blloqeve dhe interesave tjera të ngushta, qenë orientuar në shfrytëzimin e emigracionit armiqësor shqiptar”. “Në këtë proces - thuhet në vazhdim të elaboratit - me përkrahjen e shërbimit zbulues

bindjes, duke u dhënë ndihmë “Për punësim”, duke i udhëzuar për të drejtat që u takojnë në vendet ku punojnë, madje edhe duke zbatuar metodën e kushtëzimit.

Veprimtaria armiqësore e kësaj organizate (LRSSHJ) është zhvilluar dhe zhvillohet përmes formimit të klubeve të reja, në të cilat do të tuboheshin bashkëmendimtarët e tyre, si dhe përmes përpjekjeve që të depërtojnë në klubet e punëtorëve tanë....”, Agjencia Shtetërore e Arkivave të Kosovës (më tej: ASHAK), F. KK i LK të Kosovës, kut. 307, fl. 33.

amerikan, në vitin 1962, në Nju Jork, u ripërtëri “Lidhja e Prizrenit”, me qëllim që nëpërmjet saj të aktivizohet emigracioni shqiptar nga Kosova dhe se me aktivizimin e “Lidhjes së Prizrenit” dhe krijimin e “Lidhjes Kosovare” erdhi deri te grumbullimi më masiv i nacionalistëve dhe irredentistëve shqiptarë dhe aktiviteti i tyre antijugosllav filloi të realizohet thuajse gjithkund ku ekzistonte kombësia shqiptare me prejardhje nga Jugosllavia”¹⁹. Grupimin e dytë e përbënin organizatat politike të krijuara nga mërgimtarët e gjeneratës më të re, aktiviteti i së cilave kishte filluar viteve shtatëdhjeta të shekullit të kaluar, e sidomos pas shpërthimit të demonstratave të vitit 1981 në Kosovë. Si bartëse të të gjitha aktiviteteve të këtij grupimi, sipas elaboratit ishte “Lëvizja për krijimin e Republikës Socialiste Shqiptare në Jugosllavi” (më tej: LRSHJ), e cila siç thuhet, “vepron si pjesë përbërëse e aktiviteteve kundërrevolucionare të nacionalistëve dhe irredentistëve në vend (viset shqiptare nën Jugosllavi - Q.L.)”, krijimi i së cilës lidhej ngushtë me “zgjerimin e veprimtarisë ilegale të irredentistëve shqiptarë” në Jugosllavi gjatë periudhës 1978-1980 dhe “të ngjarjeve kundërrevolucionare në KSA të Kosovës në vitin 1981”. Nga kjo periudhë në botën e jashtme kishin emigruar një numër bukur i madh i “organizatorëve dhe iniciatorëve të njohur të veprimtarisë ilegale” në Kosovë dhe në viset tjera shqiptare nën Jugosllavi, të cilët me “veprimtarinë e tyre këmbëngulëse”, arritën të krijojnë një rrjetë të gjerë nga radhët e emigracionit dhe të punësuarit e përkohshëm shqiptarë në shtetet e Evropës Perëndimore. Për dallim nga grupimi i parë, Lëvizja, e cila siç thuhet në elaborat, pati “mbështetje të fuqishme nga RPSSH dhe përfaqësitë konsullore-diplomatike të saja”,

¹⁹ ДАРМ.1.1326.12/1-39, Savezni Sekretarijat za Inostrane Poslove, Str. pov. br. 54/1, 24 februar 1984 godine “Neki aspekti delovanja neprijateljske emigracije prema SFRJ u kontekstu savremenih medjunarodnih odnosa”.

në programin e vet parasheh “krijimin e Republikës së Kosovës në përbërje të Jugosllavisë”, që për regjimin komunist të Beogradit, kjo kërkesë nënkuptonte: “thirrje për përmbysje të integritetit dhe sovranitetit të RSFJ-së dhe insistim për një Kosovë etnikisht të pastër”²⁰.

Më pas, analiza ndalet në aktivitetin e gjerë të organizatave politike shqiptare në mërgim në harkun kohor 1982-1983, ku veç tjerash thuhet se në kohë të fundit, “duke ju përshtatur kushteve të reja në veprimtarinë e EASH-së gjithnjë e më tepër mbisundojnë format legale”, përkatësisht “aktivitete kundër RSFJ-së që në aspektin formal-juridik mund të quhen legale e që faktori ndërkombëtar i konsideron si të arritura demokratike”. “Prandaj aksioni aktual i emigracionit nationalist shqiptar - vazhdon analiza - është përqendruar që krahas përforcimit të radhëve të veta, të përfitoj sa më shumë qytetarë të Jugosllavisë me prejardhje shqiptare me punë të përkohshme në botën e jashtme, me çka ta internacionalizoj çështjen e Kosovës dhe atë shqiptare në Jugosllavi... ENSH, nëpërmjet promemorieve të ndryshme i është drejtuar Parlamentit Evropian, Sekretariatit të OKB-së në Nju Jork, Kongresit të Bashkësive Etnike Evropiane në Strasburg, Qendrës për të Drejtat Njerëzore në OKB në Gjenevë, misioneve pranë OKB-së të Arabisë Saudite, Kuvajtit dhe Izraelit...Duke e shfrytëzuar të drejtën e bashkësisë etnike në SHBA ose mundësinë e përfaqësuesve të partive politike, ju drejtohet personaliteteve politike (senatorit Persi, kongresistit Brumenfill), me qëllim që të ndikojnë në administratën e SHBA-së në drejtim të ndryshimit të qëndrimit politik të SHBA-së ndaj Jugosllavisë, për shkak të shkeljes së të drejtave njerëzore e nacionale në Kosovë. Më tej shfrytëzohen tubimet e Federatës evropiane të pakicave nacionale

²⁰*Po aty.*

(“Lidhja Kosovare” është anëtare formale), “Bllokut të kombeve antikomuniste” etj.”²¹.

Me ardhjen e Millosheviqit në krye të KQ të Lidhjes Komuniste të Serbisë (1986), situata politike dhe e sigurisë në Kosovë dhe në viset tjera shqiptare jashtë saj, skajshmërisht u përkeqësua. Nën pretekstin se në Kosovë “po bëhet pastrimi etnik”, ai i përkrahur edhe nga Akademia e Shkencave dhe Arteve të Serbisë si dhe nga qarqet e ndryshme serbomëdha, mbajti disa takime me elementët serbë e malazezë në Kosovë, në të cilat u vu në pah se “shpërngulja e tyre” ishte rezultat i “politikës oportuniste” të drejtuesve politikë kosovarë, të cilët, siç thuhet në një dokument të KQ të LKJ-së, “një periudhë të gjatë nuk kanë ndërmarrë asnjë aksion konkret për përmbysjen e nacionalizmit e separatizmit shqiptar”, që sipas tyre, “viteve të fundit veprimtaria e tyre po merr një agresivitet të skajshëm armiqësor”.²²

Me një konstatim të tillë nuk do të pajtohen drejtuesit politikë të Kosovës, të cilët ndryshe nga vlerësimi i KQ të LKJ-së, ishin thellë të bindur se përkeqësimi i situatës politike e të sigurisë në Kosovë vinte nga qarqet e ndryshme nacionaliste serbe. Kryesia e Komitetit Krahinor të LK të Kosovës, në Analizën e hartuar në mars të vitit 1986, vinte në dukje se në kohë të fundit në Kosovë po veprojnë “qarqet me pikëpamje të ndryshme - që nga ato burokratike, dogmatike-centraliste, neoinformbyroiste, borgjeze-liberaliste e gjer te forcat me pikëpamjet thjesht nacionaliste e shoviniste - të cilat situatën në Kosovë e shfrytëzojnë vetëm si shkas për një veprim më të gjerë kundër sistemit tonë në tërësi”. Sipas drejtuesve të atëhershëm

²¹*Po aty.*

²² ДАРМ.1.427.511.6/94-110, “Stavovi i zadaci u razvijanju socijalističkog samoupravljanja i jačanju bratsva, jedinstva i zajedništva na Kosovu”, Beograd, 3 qershor 1987.

partiak në Kosovë, “linjën qendrore të këtyre forcave dhe tendencave e përbën nacionalizmi serb”, i cili “ndaj Kosovës dhe posaçërisht ndaj shqiptarëve po manifestohet në formë të revanshizmit...”²³. Ata tërë këtë e mbështesnin në deklaratat publike të disa personaliteteve politike e kulturore serbe, në të cilat shqiptarët i paraqesin si “element i rrezikshëm dhe i pasigurt” për “bashkësinë jugosllave dhe stabilitetin e saj”, se “termi kombësi duhet të zëvendësohet si pakicë nacionale” dhe se “askund në botë pakicat nacionale nuk kanë aq të drejta sa te ne.. etj.”.²⁴

Këtë qëndrim, udhëheqja e atëhershme politike e Kosovës e shprehi edhe para Kryesisë së KQ të LK-së. Azem Vllasi në mbledhjen e kësaj Kryesie mbajtur në maj të vitit 1987, bëri të ditur se “fajin kryesor për revoltën e elementeve serbe në Kosovë e mbajnë nacionalistët serbë dhe ata instruktorë të cilët i sigurojnë nacionalistët serbë të cilët lëvizin nëpër territorin e Kosovës, i organizojnë edhe qendrat, përfshi këtu edhe “Francuska 7””²⁵. Kundër fjalimit të Vllasit dolën përfaqësuesit serbë, malazezë dhe ata maqedonas, si: Marko Orllandi, Vidoje Zharkoviç, Jakov L Lazarovski, Millan Pançevski etj. Sipas tyre “aktiviteti irredentist në Kosovë” nuk ishte ndërprerë, përkundrazi, atje “irredentizmi ekziston” se i njëjti “është infiltruar në të gjitha institucionet publike të sistemit politik...” dhe se “të njëjtat i

²³ AS. 1. 1589.IV shk. 1396, 25 Seja PK Kosova 19.3.1986; Komiteti Krahinor i Lidhjes Komuniste të Kosovës - Kryesia - Vlerësimet dhe qëndrimet e KK të LK të Kosovës lidhur me disa dukuri e tendenca aktuale në vlerësimin e situatës politike në Kosovë, Prishtinë, më 19 mars 1986.

²⁴ Po aty.

²⁵ ДАРМ.1.427.511.2/6-85: Стенограмски белешкиод Четириесет и третата /проширена/ седница на Претседателството на Централниот комитет на СКМ, одржана на 8 јуни 1987 година, Скопје, јуни 1987 година.

shfrytëzon si instrument dhe nëpërmjet tyre i shfrytëzon qëllimet e veta ideopolitike...”²⁶.

Pas shumë debateve dhe polemikave, Kryesia e KQ të LKJ-së formoi një grup pune prej 10 anëtarësh, ku për udhëheqës të grupit u caktua Marko Orlandiq²⁷. Së shpejti, Grupi Punues, hartoi Projekt konkluzionet, për siç thuhej, “realizimin e qëndrimeve të LKJ-së në zhvillimin e vetëqeverisjes socialiste, vëllazërim-bashkimin dhe unitetin në Kosovë”, të cilat u miratuan në mbledhjen e nëntë të KQ të LKJ-së, mbajtur më 3 qershor të vitit 1987. Në to, ndër të tjerave thuhej se: “...problemi i madh politik në Kosovë dhe mbarë shoqërinë jugosllave është ajo se politika e LKJ-së nuk realizohet në dy çështje esenciale: shpërngulja e serbëve e malazezëve vazhdon me intensitet të shtuar, ndërsa gjendja ndërnacionale po përkeqësohet...”. Sipas KQ të LKJ-së, frenuese serioze për “moszgjidhjen e këtyre problemeve” ishte “edhe ajo se jo çdo kund mbisundon vetëdija se Kosova është çështja e përbashkët e të gjithëve në Jugosllavi...”²⁸.

Në ndërkohë, edhe Kuvendi Federativ aprovoi një program të ngjashëm të titulluar “Programin jugosllav për Kosovën” në të cilin, ngjashëm si ai partiak, i përcaktonte masat dhe aktivitetet që duhej të ndërmerreshin në Kosovë për “ndërprerjen e shpërnguljes së serbëve dhe malazezëve”, pastaj për “kthimin sa më të shpejtë të atyre që e kanë lëshuar” Kosovën si dhe “ardhjen e të gjithë atyre të cilët dëshirojnë të jetojnë dhe punojnë në Kosovë”.²⁹ Në cilësinë e kryetarit të Komisionit për hartimin e tij, para deputetëve gjerësisht

²⁶*Po aty.*

²⁷*Po aty.*

²⁸ AS.1.1589.Shtaka 872-Kosovo, Centralni Komitet SKJ - Predsedništvo, “Zaključoci o ostvarivanju stavova SKJ u razvoju socijalističkog samoupravljanja, bratsva i jedinstva i zajedništva na Kosovu”, Beograd, qershor 1987.

²⁹ ДАРМ.1.427.520.2/11-40.

foli StojanAndovi, i cili tha se “shpërngulja e serbëve dhe malazezëve nga Kosova është problemi më i rëndë moral, politik dhe shoqëroro-ekonomik i shoqërisë jugosllave”, i cili “shprehet një periudhë të gjatë kohore, ndërsa pas ngjarjeve kundërrevolucionare në vitin 1981 vazhdoi me një intensitet edhe më të theksuar, që solli deri te ndryshimi i lartë dhe brengosës i strukturës nacionale të popullsisë në Kosovë”.

*“Në përputhje me vendimet e mbledhjes së nëntë të KQ të LKJ-së - përfundon fjalimin e tij Andovi - mbajtur më 26 korrik 1987, detyrimisht duhet të ndërmerren masa radikale nga ana e organeve shtetërore e vetëqeverisë në KSA të Kosovës, RS të Serbisë dhe nga mbarë bashkësia jugosllave, që për një afat sa më të shkurtë të mënjanojnë shkaqet e përkeqësimit serioz të marrëdhënieve ndërnacionale që është rezultat i veprimtarisë së stërzgatur të nacionalizmit e separatizmit shqiptar dhe me vendosmëri të realizohet politika e barazisë së plotë nacionale”.*³⁰

Programe operative të ngjashme sollën të gjitha organet partiake e shtetërore në nivelin federativ, republikan e krahinor, që me këtë rast po e veçojmë Programin operativ të Sekretariatit Federativ për Punë të Brendshme, përkatësisht UDB-së, pikat më të theksuara të të cilit ishin:

- zbulimi dhe pengimi i veprimtarisë subversive ilegale etj., të nacionalistëve e separatistëve shqiptarë në krijimin e kushteve të vështira të jetesës së serbëve e malazezëve dhe të komuniteteve tjera joshqiptare në Kosovë;

- përcjellja dhe hulumtimi i metodës, formës, kryerjes dhe prapavijës së të gjitha formave të shtypjes së orientuar kah shpërngulja;

³⁰ ДАРМ.1.427.520.1/1-10.

- hulumtimi i burimit të financimit të veprimtarisë së nacionalistëve e separatistëve shqiptarë si dhe burimi i mjeteve financiare për blerjen e pronave të serbëve e malazezëve me çmime shumë të larta;

- hulumtimi i lidhjeve të nacionalistëve e separatistëve shqiptarë me shërbimin sekret shqiptar dhe emigracionin armiqësor shqiptar dhe të aksioneve konkrete të shtypjes së orientuar në shpërnguljen e serbëve e malazezëve, me qëllim të krijimit të një Kosove etnikisht të pastër;

- zbulimi dhe analiza e burimit dhe formës së riprodaktivitetit të nacionalizmit e separatizmit shqiptar.

Për shkak të domosdoshmërisë së realizmit të këtyre detyrave angazhohen shërbimet e sigurimit shtetëror të mbarë sekretariateve republikane e krahinore për punë të brendshme, duke u nisur nga gjendja e rëndë e sigurisë, çështja e metodologjisë së veprimtarisë së mëtejshme është shqyrtuar në mbledhjet e sekretariateve federative, republikane e krahinore për punë të brendshme, ndërsa pas kësaj edhe në mbledhjet e drejtuesve të shërbimit sekret shtetëror të SFPB-së, SRPB-së, SKPB-së, duke i përfshi edhe përfaqësuesit e Drejtorisë së Sigurisë së Sekretariatit Federativ për Punë të Brendshme, Drejtorinë II të Forcave të Armatosur të RSFJ-së dhe Shërbimin për Hulumtim dhe Dëshmi pranë Sekretariatit Federativ për Punë të Jashtme.

- U vendosë që detyrat e SHSSH-së nga lëmi i çështjes së sigurisë në Kosovë, përveç tjerash, të zgjidhen edhe metodat e veprimtarisë së përbashkët, për çka në Programin e punës të SHSSH-së së SFPB-së është paraparë organizimi i punës së përbashkët të SHSSH-së të SFPB-së, SHSSH-së të SRPB-së të RS të Serbisë, RS të Maqedonisë, RS të Malit të Zi dhe SKPB të KSA të Kosovës në zbulimin dhe pengimin e aktivitetit të shërbimit sekret të RPS të Shqipërisë dhe organizimin e aktiviteteve zbuluese ndaj RPS të

Shqipërisë, përkatësisht qendrave nga ku kryhet propaganda më e theksuar subversive dhe veprimtaritë tjera armiqësore ndaj RSFJ-së.

- Në Program të SHSSH-së të SFPB-së, gjithashtu është paraparë ndërmarrja e inspektimit të pjesshëm dhe të jashtëzakonshëm të SHSSH-së të SFPB-së dhe të SHSSH-së të SKP-së së KSA të Kosovës, SHSSH-së së SRPB-së të RS të Maqedonisë, RS të Serbisë dhe RS të Malit të Zi në veprimtarinë kundërzbuluese ndaj shërbimit informativ shqiptar, emigracionit armiqësor shqiptar dhe organizimin e veprimtarisë zbuluese ndaj RPS të Shqipërisë”.³¹

Mbështetur në këto vendime, në Kosovë gjatë viteve 1988-1990 qenë stacionuar qindra agjent të shërbimit sekret nga Maqedonia, Serbia, Mali i Zi dhe Vojvodina, të cilët në mënyrë të paskrupullt e torturuan popullsinë e pafajshme shqiptare në Kosovë. Në anën tjetër, burimet e Shërbimit Sekret të armatës jugosllave KOS, njoftonin për aktivitetet “plotësuese” edhe të këtij shërbimi në Kosovë, ku thuhej se midis “periudhës 1981-1988 në APJ janë zbuluar 243 grupe të organizuara ilegale në të cilat janë përfshirë 1 627 përfaqësues të kombësisë shqiptare në APJ”. Sipas dokumentit “në gjashtë grupe të zbuluara janë përfshirë edhe oficerë, studentë të akademisë ushtarake dhe persona jashtë përbërjes së APJ-së, ndërsa grupet tjera përbëheshin nga ushtarë të kombësisë shqiptare...”.³²

Plane dhe programe speciale u hartuan edhe kundër mërgatës shqiptare në përgjithësi, e të organizatave të tyre politike në veçanti. Një ndër ta është edhe “Programi i veprimtarisë së Sigurimit Shtetëror

³¹ AS.1.1931.shk.1530.K4/13-88; Savezni Sekretarijat za Unutrašnje Poslove – Strogo poverljivo – Informacija o realizaciji zadataka iz jugoslovenskog Programa za zaustavljanja Srba i Crnogoraca sa Kosova, povratak onih kojih su napustili i dolazak svih koji žele da žive i rade na Kosovu”, Beograd, 10.06.1986.

³² AS.1.1589.shk.1469, Vojnatajna – Nacionalizam u jugoslovenskoj društvidanas i njegove refleksije u Jugoslovenskoj Narodnoj Armiji.

të SFPB-së” për vitin 1989, ku në pjesën ku bën fjalë për emigracionin politik shqiptar veç tjerash thuhet:

“SHSSH (Shërbimi i Sigurimit Shtetëror - Q.L.) gjatë veprimtarisë do ta harmonizojë punën e SHSSH-së të SRPB-së dhe të SKPB-së (Sekretariatit Republikan për Punë të Brendshme dhe Sekretariatit Krahinor për Punë të Brendshme - Q.L.) në zbulimin, përcjelljen, dokumentimin dhe pamundësimin e veprimtarisë së emigracionit armiqësor shqiptar, do t’i koordinoj masat ndaj organizatave kryesore të emigracionit - Lëvizja Popullore për Republikën e Kosovës, Organizatën Nacional Demokratike Shqiptare dhe Lidhjen Kosovare, përmes përpunimeve me prioritet, aksioneve dhe kombinimeve operative, hulumtimeve operative, rrjetit të bashkëpunëtorëve, aksioneve propagandistiko-psikologjike etj...”.

Duke u ndal në përndjekjen dhe përcjelljen e aktivitetit e të veprimtarisë së LPRK-së, në program shprehimisht thuhet:

“Do të harmonizohen masat dhe veprimtaritë e SHSSH-së të SRPB-së dhe të SKPB-së përmes përpunimeve prioritare, aksioneve e kombinimeve. Veçmas ndaj udhëheqjeve të fraksioneve të LPRK-së në Zvicër, RF të Gjermanisë, Suedi dhe SHBA, si dhe futjen dhe përforcimin e pozitave të bashkëpunëtorëve kualitativ (“Trigllav”, “Arton”, “Laborant”, “Riki”, “Adet”, “Hetam”, “Svera”, “Askona”, “Flaka”)...”³³.

Duhet të vëmë në dukje faktin se duke filluar nga viti 1988, Shtetet e Bashkuara të Amerikës (SHBA), problemit shqiptar në Jugosllavi, veçmas problemit të Kosovës iu qasën me një seriozitet më të madh. Ambasada e SHBA-së në Beograd, si asnjëherë më parë interesohej për ngjarjet dhe zhvillimet në Kosovë dhe në viset tjera

³³ AS. 1931, šk. 1429, Savezni Sekretarijat za Unutrašnje Poslove - Služba državne bezbednosti – Državna tajna, “Program rada Službe Državne Bezbednosti u SSUP u 1989 godini”, Beograd, jaar 1989.

shqiptare nën Jugosllavi. Veçmas ky interesim erdhi në shprehje në kohën kur autoritetet e Beogradit filluan fushatën e egër kundër popullsisë shqiptare në Kosovë, Maqedoni dhe Mal të Zi, duke sjellë konkluzione, rezoluta dhe programe operative të shumta në dëm të çështjes shqiptare, për të cilat u bë fjalë më lart.

Sekretariati Krahinor i Këshillit Ekzekutiv të Kosovës për marrëdhënie me botën e jashtme, njoftonte se më 29 shtator të vitit 1988 në Prishtinë kanë qëndruar “RutHansen, sekretare e parë në Ambasadën e SHBA-së në Beograd dhe MartinSletzing, këshilltar i Komitetit për politikë të jashtme të Dhomës përfaqësuese të Kongresit të SHBA-së” dhe në kuadër të kësaj “kanë zhvilluar bisedime të ndara me kryetarin e Shoqatës së Shkrimtarëve të Kosovës, Ahmet Rugova³⁴, me kryetarin e Konferencës Aksionare të Lidhjes Komuniste të Universitetit të Prishtinës, SkenderKarahoda dhe me nënkryetarin e Këshillit Ekzekutiv të Kuvendit të KSA të Kosovës, Hazër Susuri”. Është e rëndësishme të thuhet se diplomati amerikan, z. Slezinger, i njoftoi nikoqirët se ardhja e tij në Kosovë lidhej ngushtë me “emigracionin shqiptar në SHBA”, i cili “shtron kërkesa gjithnjë e më të shpeshta në Kongresin e SHBA-së në formë të shkruar dhe gojore për gjendjen e vështirë e të papërbalueshme në Kosovë dhe se ai dëshiron që në bisedat e drejtpërdrejta të përshkruhet gjendja e vërtetë”³⁵.

³⁴ Në dokument thuhet Ahmet Rugova, mirëpo në këtë periudhë kryetar i Shoqatës së Shkrimtarëve të Kosovës ishte dr. Ibrahim Rugova, prandaj me siguri se delegacioni amerikan ka zhvilluar bisedime me Ibrahim Rugovën, e jo siç thuhet në dokument me Ahmet Rugovën, sepse një person i tillë nuk figuronte në Shoqatën e Shkrimtarëve të Kosovës.

³⁵ ASHAK, F. Sekretariati Krahinor për marrëdhënie me jashtë (fondi i pa rregulluar). Shënim rreth bisedimeve të RutHansen, sekretares së parë të Ambasadës së SHBA-së në RSFJ dhe MartinSletsingerit, këshilltar i Komitetit për

Po ky Sekretariat, njoftonte për bisedimet e zhvilluara më 3 tetor 1988, në Kosovë, të ambasadorit të SHBA-së në RSFJ, Gjon Skanlan, zëvendës ndihmëssekretarit shtetëror për Evropë dhe Kanada, Tomson Simonson dhe sekretaren e parë të Ambasadës së SHBA-së në RSFJ, Rut Hansen, me udhëheqjen e atëhershme politike të Kosovës. Gjatë bisedës me Azem Vllasin, ambasadori Skanlan e njoftoi atë se arsye e vizitës kishte qenë “interesimi shumë i madh që ekziston për situatën politike në Jugosllavi, e veçmas në Kosovë” dhe se “Tomson Simonson paraprakisht është ngarkuar që për përshtypjet e tij në Kosovë drejtpërsëdrejti ta njoftoj Xhorxh Shulcin”. Ai, në vazhdim vuri në dukje “interesimin e SHBA-së për integritetin territorial, avancimin dhe respektimin e të drejtave njerëzore në Jugosllavi”, duke shtuar se “emigracioni shqiptar paraqitet në mënyrë shumë të organizuar në SHBA dhe ata theksojnë se të drejtat e njeriut në Jugosllavi janë të rrezikuara për çka e mbështet edhe emigracioni kroat”.³⁶

Në pjesën e dytë të vitit 1988, Millosheviqi e klika e tij serbomadhe ngriti iniciativën edhe për ndryshimin e Kushtetutës, e cila u realizua në fillim të vitit 1989, me të cilin ndryshim Kosovës iu morë autonomia e fituar në vitin 1974. E gjithë kjo politikë antishqiptare shkaktoi revoltë të madhe anembanë viseve shqiptare nën pushtimin jugosllav, e cila në fillim të vitit 1989 u manifestua në demonstrata masive në disa qytete të Kosovës si dhe në shtetet e Evropës Perëndimore dhe SHBA-së. Për shuarjen e tyre, shovinistët e

politikë të jashtme të Dhomës përfaqësuese të Kongresit të SHBA-së, në KSA të Kosovës, më 29 shtator të vitit 1988.

³⁶ ASHAK, F. Sekretariati Krahinor për marrëdhënie me jashtë, Shkresë nga bisedimet e zhvilluara më 3 tetor 1988 në KAS të Kosovës, të ambasadorit të SHBA-së në RSFJ, Gjon Skanlan, zëvendës ndihmës sekretarit shtetëror për Evropë dhe Kanada, Tomson Simonson dhe sekretaren e parë të Ambasadës së SHBA-së në RSFJ, Rut Hansen.

Beogradit dërguan forca të mëdha policore e ushtarake që, sipas burimeve jugosllave gjatë përleshjeve disaditore, ranë dëshmorë mbi 20 demonstrues shqiptarë, 44 u plagosën rëndë, ndërsa mijëra të tjerë u arrestuan të cilët më pas u dënuan me dënime të rënda³⁷. Shpërthimi i demonstratave për kryetarin e atëhershëm të Kosovës, RemziKolgeci, nuk ishte rezultat i “politikës shoviniste të zyrtarëve të Beogradit”, të cilët nëpërmjet ndryshimit të Kushtetutës tentonin që t’ua marrin edhe ato pak të drejta që i gëzonin shqiptarët në Kosovë, por se ato na paskan qenë të përgatitur, siç do të shprehet ai, “nga reaksioni armiqësor shqiptar”³⁸.

Gjatë vitit 1989, drejtuesit shovinistë serbë, të përkrahur nga shovinistët maqedonas e malazezë si dhe nga Shtabi i Përgjithshëm i APJ-së, ndërhyjnë edhe në organet partiake të Kosovës, ku në mënyrë të dhunshme u ndërruan qindra drejtues partiak të LK të Kosovës dhe në vend të tyre u vendosën disa shqiptarë lojalë ndaj pushtuesit shovinist serb, të tipit të Rrahman Morinës, SejdoBajramoviqit etj. Si rrjedhojë, me iniciativë të 215 intelektualëve shqiptarë, në dhjetor të vitit 1989, në Kosovë u formua Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), e cila në atë kohë në opinionin e gjerë të brendshëm e të jashtëm njihej si “alternativa kosovare”. Kryetar i LDK-së u zgjodh Ibrahim Rugova, ndërsa në kryesinë shumanëtarëshe u përfshinë kryesisht intelektualë dhe ish të burgosur politikë.

Menjëherë pas themelimit, LDK-ja zhvilloi një aktivitet të dendur, i cili u fokusua në dy drejtime: strukturimin e brendshëm të

³⁷ ДАРМ.1.427.536.62/433-488; Стенограмски белешки од Вондредната (проширена) седница на Председателството на Централниот комитет на Сојузот на Комунистите на Македонија, одржена на 29.ІІІ.година, Скопје, март, 1989 година.

³⁸ ДАРМ.1.427.536.79/557-562: Информација од проширенета седница на Председателството на ЦК СКМ за најновата ситуација во САП Косово (29.ІІІ.1989), Скопје, април 1989 година.

saj dhe në afirmimin ndërkombëtar të çështjes së Kosovës. Rreth këtyre aktiviteteve, Sekretariati Federativ për Punë të Brendshme, në fillim të muajit prill 1990, mbajti mbledhje me të gjithë sekretarët republikanë e krahinorë të punëve të brendshme, në të cilën është vlerësuar se “në KSA të Kosovës situata e përkeqësuar politike dhe e sigurisë edhe më tej po mbahet në rrjedhat e përgjithshme të sigurisë në vend”. Më tej, në mbledhje është konstatuar se “*krahas grupeve dhe organizatave ilegale, nga janari i këtij viti në rritje të dukshme është aktiviteti i alternativës kosovare, veçmas i Lidhjes Demokratike të Kosovës që, sipas tyre, në udhëheqjen e saj “gjenden kryesisht separatistë shqiptarë nga mjediset intelektuale si dhe një numër i madh i ish të dënuarve politikë*”³⁹. Më tej, në mbledhje është diskutuar edhe aktiviteti i mërgatës shqiptare, ku ndër të tjerave është theksuar:

“...Me qëllim të komprometimit të RSFJ-së dhe marrjen e përkrahjes nga faktori ndërkombëtarë, udhëheqja e emigracionit në kohën më të re posaçërisht është angazhuar në internacionalizimin e çështjes së Kosovës dhe pozitën e shqiptarëve në RSFJ, për çka kanë arrit suksese të dukshme. Përkrahje më të theksuar ju jepet dy figurave më të shquara të ENSH-së (emigracionit nationalist shqiptar - Q.L) Xhafer Shatrit dhe Emin Fazliut...Përkundër asaj se përfaqësuesit zyrtarë të vendeve perëndimore deklarohen në favor të stabilitetit të Jugosllavisë si faktor i sigurisë në Evropë, në praktikë tolerohet veprimtaria antijugosllave e emigracionit nationalist shqiptar (demonstrata, tubime të ndryshme të emigracionit dhe aktivitete tjera subversive-propaganduese), me arsyetimin tashmë të

³⁹AS.1.1931.shk.1427; Savezni Sekretarijat za Unutrašnje Poslove – Strogo poverljivo –Ocene i zaključci sa sastanka Saveznog sa republičkim i pokrajinskim sekretarima za unutrašnje poslove 27 februara i 23 marta 1990 godine, Beograd 2 april 1990 godine.

njohur se një veprimtari e tillë në vendet e tyre është e lirë dhe legale”.⁴⁰

Në një dokument tjetër i dalë në pjesën e dytë të prillit nga po ky Sekretariat, vihet në dukje mbështetja e fuqishme e aktiviteteve të diasporës shqiptare edhe në SHBA nga “disa anëtarë të trupave përfaqësues amerikanë (grupi i kongresistëve dhe të senatorëve: Diogardi, Krejn, Brumfild, Sajmon, Doll, Rigell, Lentosh), të cilët janë shumë të angazhuar në luftë për të drejtat e shqiptarëve në RSFJ”. Më tej, në dokument thuhet se “EASH në SHBA merr pjesë nën emrin Komuniteti Shqiptar në Amerikë dhe ka ndihmë dhe mbështetje të fuqishme nga i ashtuquajturi lobi shqiptar (disa kongresistë dhe senatorë të tashëm dhe të mëparshëm, intelektualë, profesorë të universiteteve, amerikanë të pasur me prejardhje shqiptare etj.). Krahas ndihmës për organizimin e demonstratave të shumë antijugosllave, EASH ka marrë ndihmë të dukshme financiare për hapjen e Zyrës në Uashington (Albanian American Edukation Fondation), e cila është në funksion të përfaqësimit zyrtar të shqiptarëve në SHBA”.⁴¹ Gjithnjë sipas dokumentit në fjalë, “këtë aksion e ka iniciuar dhe për gjithë kohën e ka mbështetur ish-kongresisti amerikan, J. Diogardi”, i cili gjatë qëndrimit të paradokohshëm në Prishtinë, kishte deklaruar “*se Kongresi Amerikan dhe personalisht ai, shumë është i interesuar për çështjen e Kosovës dhe se në Jugosllavi ka ardhur për ta ndihmuar kombin shqiptar*”⁴².

Në mars të vitit 1990, në Beograd u thirr Kongresi XIV i jashtëzakonshëm i LKJ-së, i cili i ndërpreu punimet për shkak se

⁴⁰ Po aty.

⁴¹ AS.1.1931. Po aty; Savezni Sekretarijat za Unutrašnje Poslove - Strogo poverljivo: “Uticaj stranog faktora na aktuelna zbivanja i bezbednosnu situaciju u SFRJ”, Beograd, prill 1990.

⁴² Po aty.

delegatët e LK të Sllovenisë e braktisën Kongresin, duke e shpallë pavarësinë e LK të Sllovenisë nga LKJ. Grupi për përgatitjen e Kongresit kishte hartuar një Projekt rezolutë për Kosovë. Në kaptinën e parë me nëntitull “Beteja për Kosovën - Beteja për Jugosllavinë”, përveç tjerash thuhej se “Lidhja Komuniste dhe mbarë shoqëria jugosllave, përfshi të gjitha forcat progresive, ftohen që në mënyrë të hapur dhe të guximshme, të ballafaqohet me të vërtetën - se në Kosovë në një periudhë më të gjatë veprojnë në mënyrë të organizuar nacionalistët e separatistët shqiptarë, të cilët përpiqen të realizojnë një Kosovë etnikisht të pastër, pastaj “Republikën e Kosovës”, përkatësisht shtetin e shqiptarëve në Jugosllavi dhe përfundimisht shkëputjen e Kosovës nga Serbia dhe RSFJ. Për këtë qëllim, ata kryejnë shtypje të fuqishme, madje edhe brutale për shpërnguljen e serbëve e malazezëve nga Kosova. Në këtë mënyrë, krahas problemeve të rënda zhvillimore, ekonomike e sociale, si destinacioni më i pazhvilluar në Jugosllavi, Kosova u bë edhe problemi i shkallës së parë politike të mbarë bashkësisë jugosllave...”⁴³.

Njëkohësisht, në zgjedhjet e para shumëpartiake që u mbajtën në Kroaci, fitoi krahu demokratik në krye me Bashkimin Demokratik Kroat (HDZ), e cila menjëherë doli me kërkesën për krijimin e “shtetit të pavarur kroat”. Rreth këtyre zhvillimeve, shërbimi sekret jugosllav vinte në dukje se “gjendja e përgjithshme politike dhe e sigurisë në vend është tepër e ndërlikuar, me shkallë shumë të lartë të jo stabilitetit, ndërsa në disa pjesë të vendit - si në Kosovë - gjendja është dramatike”.⁴⁴ Në kushte të tilla, më 2 korrik të vitit 1990, delegatët e Kuvendit të Kosovës, shpallën Deklaratën e Pavarësisë së Republikës së Kosovës. Një ditë më pas, mbledhje të

⁴³ AS.1.1589.shk.1488; Nacrt Rezolucija 14, vanrednog Kongresa SKJ o Kosovu”, Beograd, 29.12.1989.

⁴⁴ AS.1.1931.shk.1427, *Po aty*.

jashtëzakonshme mbajti Kryesia e atëhershme e RSFJ-së, e cila doli me këtë qëndrim: “Kryesia e RSFJ-së veçmas i shqyrtoi aspektet politike e të sigurisë si dhe ato kushtetuese juridike të shpalljes së deklaratës, e më pas edhe të Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Ajo vlerësoi se një akt i tillë është rezultat i veprimtarisë së organizuar shumëvjeçare të nacionalistëve e separatistëve shqiptarë, të orientuar kah cenimi i integritetit territorial të Republikës së Serbisë dhe RSFJ dhe pjesa përfundimtare e aktiviteteve për shpalljen e Kosovës. Pa marrë parasysh në faktin se si antikushtetuese nuk mund të prodhojnë as çfarë veprimtarie juridike, aktivitetet e tilla objektivisht ndikojnë mbi përkeqësimin e situatës dhe në eskalimin e veprimtarisë armiqësore. Kryesia e RSFJ është e vendosur se duhet energjikisht të ndërpriten të gjitha veprimtaritë antikushtetuese e antiligjore që mund të krijohen me rastin e shpalljes së Kushtetutës së Republikës së Kosovës...”⁴⁵.

Për rrjedhojë, më 5 korrik 1990, organet policore e ushtarake serbe, brutalisht ndërhyjnë në institucionet e pavarura kosovare, ku u vendosën masa të dhunshme. Nga këto masa më së shumti pësuan institucionet informative, siç ishin RTV i Prishtinës, Rilindja etj., ku u dëbuan nga vendi i punës mijëra shqiptarë dhe në vend të tyre u vendosën serbomëdhenjtë të ardhur nga vendet e ndryshme të Serbisë, Malit të Zi, Bosnjë-Hercegovinës etj.

⁴⁵ ДАРМ.1.158.549.3/27-112.

Qerim Lita

SUMMARY

The Kosovo Issue, 1981-1990

The student demonstrations that erupted during March-April 1981 in Pristina prompted the Yugoslavian communist leadership to impose a police and military curfew on Kosovo. According to Yugoslav, the numerous police and military units stationed in Kosovo, only during the violent crackdown of April 3, 1981 against Albanian demonstrators in Pristina and other cities in Kosovo, killed 8 (eight), wounded 75 and arrested over 800 demonstrators.

The Yugoslav violence and terror against the Albanian population in Kosovo alarmed the wider international public. Many Western media criticized the communist regime in Belgrade for the drastic violation of human rights in Kosovo, while some of them described Yugoslavia as a totalitarian state, which did not differ at all from other socialist countries in this respect. It is important to say that along with many other factors, great merit for such a position taken up by the western democratic media had the sensational activity of the Albanian diaspora in Western European countries, USA, Canada, Australia, etc. had. Yugoslavian secret diplomatic and party sources indicate that between April 1981-September 1982, 40 demonstrations were organized by various Albanian organizations in exile, with the participation of over 50,000 Albanian demonstrators. This was the main reason why the Yugoslavain communist leadership waged a wide and rude campaign against the activities of Albanian political organizations, mainly the Kosovo League (Lidhja Kosovare), the Movement for the Establishment of the Albanian Socialist Republic in Yugoslavia (LRSSHJ), Balli Kombëtar (The National Front), the 2-nd League of Prizren (Lidhja e II-tw e Prizrenit), the Albanian National Democratic Movement (LNDSH), etc.

It is important to note that the situation in Kosovo and other Albanian areas in Yugoslavia worsened with the nomination of Slobodan Milosevic – who enjoyed the full support of the Serbian Academy of Science and Arts – as Head of the Central Committee of the Communist League of Serbia (1986). At his insistence, the Yugoslavian party and state leadership drafted a series of projects and programs against Albanians in general and Kosovo in particular, such as: “Conclusions on the realization of the Communist League of Yugoslavia's positions for the development of the socialist selfgovernment, of brotherhood and unity in Kosovo”, “The Yugoslavain Program for Kosovo”, “The Operational Program for Kosovo” drafted by the Federal Secretariat for Internal Affairs, etc.

In the second half of 1988, Milosevic and his nationalist Serbian clique also launched the initiative to amend the Constitution, which would deprive Kosovo of the autonomy gained in 1974 when implemented in early 1989. This anti-Albanian policy caused a great revolt among the Albanian population, manifested in early 1989 through mass demonstrations in several cities of Kosovo. To quell the demonstrations, Belgrade chauvinists sent large police and military forces which during the crackdowns that lasted a few days, according to Yugoslavain sources killed more than 20 Albanian demonstrators, 44 were seriously injured, and thousands more were arrested and later handed harsh sentences.

As a result of the anti-Albanian policy, in December 1989, with the initiative of 215 Albanian intellectuals, the Democratic League of Kosovo (Lidhja Demokratike e Kosovës) was formed in Kosovo. At that time, to the general domestic and foreign public it was known as “*the Kosovo alternative*”. LDK’s activity focused on two directions: its internal organization and the internationalization of the Kosovo issue.

After Slovenia and Croatia declared their independence, it was deemed necessary for Kosovo to declare its independence as well. Consequently, on July 2, 1990, the delegates of the Assembly of Kosovo proclaimed the Declaration of Independence of the Republic of Kosovo. Three days later, on July 5, 1990 the Serbian police and military units undertook a brutal crackdown on the independent Kosovo institutions.

Hamit Kaba

Kosova në rrugën drejt pavarësisë dhe politika e SHBA-së

Firmosja e Marrëveshjes së Rambouillet (Rambujesë) i hapi rrugën procesit të gjatë të pavarësisë së Kosovës dhe ndreqjes së një padrejtësie pothuajse shekullore. Ajo i njohu Kosovës të drejtën e “autonomisë substanciale” dhe mundësinë që pas tre vjetësh populli dhe partitë politike të shpreheshin për gjetjen e mekanizmit për zgjidhjen përfundimtare të saj.¹

Më 9 qershor u nënshkrua në Kumanovë marrëveshja tekniko-ushtarake ndërmjet NATO-s dhe ushtarakëve jugosllavë për tërheqjen e forcave jugosllave nga Kosova.² Vetëm një ditë më pas, më 10 qershor, Këshilli i Sigurimit i Kombeve të Bashkuara miratoi rezolutën 1244, bazuar në planin ndërkombëtar të paqes, të pranuar edhe nga Millosheviqi. Më 11 qershor, trupat e KFOR-it [Kosovo Force] filluan të hynin në Kosovë.

¹ Artikulli i neni 3 i titulluar “Amendim dhe vlerësim gjithëpërfshirës i Marrëveshjes së Rambujesë përmendte: Tre vjet pas hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje do të thirret një takim ndërkombëtar për të përcaktuar mekanizmin për një zgjidhje përfundimtare të Kosovës, mbi bazat e vullnetit të popullit, opinioneve të autoriteteve përkatëse, përpjekjeve të çdo grupi në lidhje me zbatimin e kësaj Marrëveshjeje dhe të Aktit Final të Helsinkit për të marrë përsipër një vlerësim gjithëpërfshirës për zbatimin e kësaj Marrëveshjeje dhe për të marrë në shqyrtim propozimet e çdo pale për masa plotësuese”. Në: http://www.state.gov/www/regions/eur/ksvo_rambouillet_text.html, aksesuar më 16.07.2001.

²Steven Woehreland Julie Kim, CRC Issue Brief for Congress, Congressional Research Service.- Library of Congress, 22 June 2001, p. 4.

Rezultati final i ngjarjeve të Kosovës në vitet 1988-1999, falë kokëfortësisë së udhëheqjes së lartë serbe, metodave barbare të përdorura nga Millosheviqi dhe këmbënguljes së fortë të liderit të UÇK-së [Ushtria Çlirimtare e Kosovës], Hashim Thaçi, ishte i ndryshëm nga ai që kishin projektuar fillimisht Perëndimi dhe SHBA-ja.³ Pas kësaj kohe do të shtrohej problemi i së ardhmes së Kosovës, si një çështje për zgjidhje e cila do të kërkonte kohë dhe energji. Por, pavarësisht nga dëshirat e shqiptarëve të Kosovës për ta shpallur atë shtet të pavarur e ardhmja e saj mbetej e pasigurt. Sidoqoftë, Kosova kishte bërë një hap të madh përpara.

Pas qershorit të vitit 1999, Kosova funksionoi mbi bazën e statusit të miratuar me rezolutën 1244 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara. Rezoluta autorizonte një prezencë ndërkombëtare ushtarake e civile në Kosovë, zgjatja e të cilës ishte nën autoritetin e Këshillit të Sigurimit. Forca paqeruajtëse e NATO-s, KFOR, iu ngarkua ruajtja e një mjedisi të sigurt, ndërsa Misionit të Kombeve të Bashkuara (UNITED MISSION IN KOSOVO-UNMIK) iu ngarkuar roli drejtues i administrimit të Kosovës mbi baza të përkohshme. Rezoluta siguronte një periudhë të përkohshme autonomie për një afat të papërcaktuar për Kosovën, derisa të fillonin negociatat mbi të ardhmen e saj. UNMIK do të mbikëqyrë transferimin e autoritetit nga institucionet e përkohshme autonome drejt atyre të përhershme, pasi Kosovës t'i përcaktohej statusi i ardhshëm. Rezoluta 1244 nuk jepte një ide të qartë se si do të zgjidhej

³ Shtetet përbërëse të Grupit të Kontaktit mendonin se “autonomia substanciale” do të ishte zgjidhja e duhur për Kosovën. Por, pas refuzimit të vendosur të Hashim Thaçit dhe përfaqësuesve të UÇK-së në përbërje të delegacionit kosovar për të firmosur marrëveshjen e Rambujesë, faktori ndërkombëtar, më së pari ai amerikan reagoi dhe si rezultat në fund të marrëveshjes u shtua një amendament i posaçëm, i cili njihte të drejtën e organizimit të një takimi ndërkombëtar pas një periudhe trevjeçare, i cili do të përcaktonte statusin përfundimtar të Kosovës.

çështja e statusit, ajo thjesht fliste për një “proces politik” të paspecifikuar. Megjithëkëtë, rezoluta konfirmonte qartazi integritetin territorial të Federatës Jugosllave (të përbërë nga Serbia dhe Mali i Zi) dhe bënte fjale për “autonomi substanciale” për Kosovën brenda Republikës Federative të Jugosllavisë [RFJ], e cila u shpërbë përfundimisht pas ndarjes prej saj të Malit të Zi në vitin 2006. Rezoluta 1244 e linte të hapur betejën për zgjidhjen dhe përcaktimin e statusit të ardhshëm të Kosovës, duke u dhënë shpresë të dyja palëve, secila prej të cilave dukej se kishte në mendje një zgjidhje në favor të vet.

Për pothuajse 5 vjet Kosova u administrua nga komuniteti ndërkombëtar, ndërsa përpara përcaktimit përfundimtar të statusit iu kushtua interes të drejtave të minoriteteve.

Gjatë periudhës së pasluftës, angazhimi i SHBA-së në Kosovë erdhi duke u reduktuar. Rolin kryesor do ta kishte Evropa dhe Kombet e Bashkuara. Sidoqoftë, Kosova nuk mbeti jashtë vëmendjes së Qeverisë amerikane. Më 24 korrik 2001, presidenti Bush, do të deklaronte nga baza amerikane në Bondsteel: “Ne erdhëm së bashku në Evropën Lindore dhe së bashku do largohemi... kur në Kosovë të kemi paqe të qëndrueshme”⁴. Problemi më i rëndësishëm tani e tutje mbetej përcaktimi i statusit të ardhshëm të Kosovës, zhvillimi dhe stabilizimi i saj, si burim stabilitetit për Evropën e më gjerë akoma. Me gjithë dëshirën e madhe të popullit të Kosovës për të shpallur një orë e më parë pavarësinë, duhet thënë se rruga ishte ende e gjatë dhe e vështirë. Aktorët ndërkombëtarë, duke përfshirë edhe SHBA-në, e gjykonin të parakohshëm përcaktimin e statusit final të Kosovës. Administrata e Bushit shprehej zyrtarisht për autonominë e Kosovës brenda kuadrit të Republikës Federative të Jugosllavisë, por jo për

⁴Steven Woehrel and Julie Kim, CRC Issue Brif for Congress, Congressional Research Service.- Library of Congress, 22 June 2001, p. 4.

pavarësinë e saj.⁵ Përpara shpalljes së statusit, Kosovës do t'i duhej të bënte paraprakisht “detyrat e shtëpisë” dhe të plotësonte standardet. Qeveria amerikane e mbështeti këtë politikë, por caktoi vitin 2005 si afatin e vlerësimit të kësaj strategjie për përcaktimin e statusit të Kosovës.

Pritja e gjatë i lodhi të dyja palët, por në mënyrë të veçantë shqiptarët e Kosovës. Kjo qasje u përball me një shpërthim serioz të shqiptarëve në mars 2004, gjatë së cilës u sulmuan disa enklava etnike serbe, si dhe forcat e sigurisë që u përpoqën të kontrollonin trazirat. Gjatë dy ditëve u vranë 19 civilë dhe më shumë se 900 persona u plagosën, ndërsa 4 000 të tjerë u detyruan të largoheshin nga shtëpitë e tyre për shkak të dhunës. Trazirat shtruan çështjen e performancës së UNMIK-ut dhe KFOR-it, të vet institucioneve qeverisëse dhe të medias në Kosovë. Sipas zyrtarëve të Kombeve të Bashkuar dhe vëzhguesve të pavarur, ndikim në shpërthimin e trazirave kishte edhe mospërcaktimi i statusit të ardhshëm të Kosovës.

SHBA-ja edhe këtë herë e shtynë procesin përpara. Zëvendëssekretari amerikan i Shtetit, Nicholas Burns, e konsideroi vitin 2005 si “vitin vendimtar” për të përcaktuar të ardhmen e Kosovës. Vendet evropiane të Grupit të Kontaktit [U.S., U.K., France, Germany, Italy, and Russia] vazhduan të tregoheshin të matura dhe të ekuilibruara, duke u përpjekur që të tërhiqnin edhe Rusinë në përcaktimin e statusit përfundimtar të Kosovës. Në vitin 2005, Grupi Ndërkombëtar i Krizave në raportin e vet përcaktoi disa parametra ekzistencialë në lidhje me të ardhmen e Kosovës, të tilla si: moskthimi i saj në situatën e para vitit 1999, mosndarja dhe mosbashkimin e saj me ndonjë shtet tjetër, duke nënkuptuar Shqipërinë.

⁵*Po aty*, f. 1.

Në nëntor 2005, Sekretari i Përgjithshëm i KB, KofiAnnan, emëroi ish-presidentin finlandez, MarttiAhtisaari, si përfaqësues të posaçëm të tij për çështjen e Kosovës. Në dhjetor 2005, administrata amerikane shpalli diplomatin FrankWisner, si përfaqësues të SHB për negociatat e ardhshme për statusin e Kosovës.

Çështja kryesore gjatë bisedimeve për statusin, ishte sipas zyrtarëve amerikanë, nëse Kosova do të ishte e pavarur apo do të vazhdonte siç ishte si pjesë e Serbisë, me shkallë të gjerë autonomie. Udhëheqësit kosovarë e kishin thënë fjalën e tyre të pandryshueshme për pavarësi. Ata ishin shprehur se pavarësia e Kosovës do të ishte në përshtatje me dëshirat e shumicës dërrmuese të banorëve të provincës (mbi 90% e popullsisë së Kosovës ishte e përbërë nga shqiptarë etnikë) dhe të partive etnike që bënin pjesë në Parlamentin e Kosovës. Ata këmbëngulnin që e vetmja çështje që duhej të diskutonte komuniteti ndërkombëtar do të ishte njohja e pavarësisë së Kosovës. Pozicioni i Qeverisë serbe dhe i udhëheqësve serbë të Kosovës ishte që Kosova të mbetet brenda shtetit serb, çështje kjo sipas saj e fiksuar me shkrim në kushtetutën serbe. Udhëheqësit serbë e kanë përmbledhur qëndrimin e tyre mbi statusin me frazën “më shumë se autonomi, por më pak se pavarësi”.

Bisedimet ndërmjet përfaqësuesve të Kosovës e Serbisë filluan në Vjenë në shkurt 2006. Pozicioni i të dyja palëve ishte larg për shumicën e çështjeve, dhe kishte pak hapësirë dhe lëvizje për të gjetur zgjidhje kompromisi. Ahtisari paraqiti një draft nga ana e vet për çështjen e statusit për qeveritë e Kosovës e të Serbisë, më 2 shkurt 2007. Më 26 mars, Ban Ki Moon⁶ e paraqiti propozimin e Ahtisarit në

⁶ Ban Ki Moon-diplomat koreanojugor. Shërbeu si Sekretar i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara nga janari i vitit 2007 e deri në dhjetor 2016.

Këshillin e Sigurimit.⁷ Statusi i propozuar nga Ahtisari fliste për Kosovën si vend i pavarur, por i mbikëqyrur nga komuniteti ndërkombëtar. Kosova do të kishte të drejtën të përfundonte marrëveshje ndërkombëtare dhe t'u bashkohej organizatave ndërkombëtare. Ajo do të kishte të drejtën që të krijonte “forcën e sigurisë” dhe agjencinë e zbulimit. Megjithëkëtë, Kosova nuk do të lejohej që të bashkohej me ndonjë vend tjetër apo të ishte pjesë e ndonjë vendi tjetër. Dokumenti përmbante kushte që kishin si qëllim të garantonin të drejtat e serbëve dhe minoriteteve të tjera në Kosovë. Gjashtë komunave me shumicë serbe (disa të reja apo me kufij të ndryshuar), do t'u jepej pushteti i gjerë mbi çështjet e tyre. Ato do të kishin të drejtën që të formojnë assosacione me njëra-tjetrën dhe të përfitojnë fonde transparente nga Beogradi. Policët lokalë do të ishin pjesë e Shërbimit të përqendruar policor të Kosovës, por përbërja e policisë lokale të komunave do të ishte e përzier nga pikëpamja etnike, ndërsa komandantët e policisë lokale do të zgjidheshin nga komunat. Trupat qeveritare dhe të gjyqësorit do të reflektonin përbërjen etnike të Kosovës. Kosova do të kishte kushtetutë të re, e cila do të garantonte të drejtat e minoriteteve. Ligjet me interesa të veçanta për minoritetet etnike do të aprovohehin, nëse një shumicë e përfaqësuesve të minoriteteve në parlament votonte për ato. Plani përfshinte masa për mbrojtjen e fesë serbe, qendrave kulturore dhe të komuniteteve të tjera në Kosovë.

Pas miratimit të dokumentit të Ahtisarit parashikohej një periudhë katër-mujore tranzicioni, gjatë së cilës pushteti i UNMIK-ut [United Nations Mission in Kosovo] do të transferohej tek Qeveria e

⁷Kosovo's Future Status and U.S. Policy, by Steven Woehrel - Specialist in European Affairs, Foreign Affairs', Defense, and Trade Division, p. 3, CRS Report for Congress, (Ordered Code RS21721, updated August 8, 2007).

Kosovës. Gjatë kësaj kohe, Kosova do të miratonte kushtetutën e re dhe ligjet për zbatimin e marrëveshjes. Pas largimit të UNMIK-ut, një trupë e re Civile Ndërkombëtare (IRC -The International Rescue Committee) do të mbikëqyrë zbatimin e planit për Kosovën. Roli dhe fuqia e IRC duhet të modelohet si tek përfaqësuesi i lartë ndërkombëtar i Bosnjës. IRC do t'i përkasë një vendi evropian dhe personi i emëruar do të shërbejë si përfaqësues i Bashkimit Evropian në Kosovë. Një amerikan do të jetë si zëvendës apo zëvendëse e tij. Misioni Evropian do të monitorojë dhe këshillojë Qeverinë e Kosovës mbi të gjitha çështjet për ligjin, rregullin dhe veçanërisht për policinë, gjyqet, rregullat doganore dhe të burgosurit. Ai do të ketë gjithashtu aftësinë që të sigurojë “kufijtë e pushtetit ekzekutiv”, të sigurojë që këto institucione punojnë me efikasitet, gjithashtu edhe të ndërhyjë në rastet e veçanta për krimet, duke përfshirë referimin në lidhje me to në gjyqet dhe prokuroritë ndërkombëtare. Propozimi parashikon gjithashtu që KFOR do të vazhdojë të garantojë sigurinë në Kosovë, edhe pas dhënies së statusit. Ai do të ketë autoritet mbi Forcën e re të Sigurisë së Kosovës.

Pothuajse të gjithë udhëheqësit serbë të gjithë spektrit e refuzuan prerazi propozimin e Ahtisarit, sepse, sipas tyre, ai mbështet pavarësinë e Kosovës. Në kontrast, udhëheqësit etnikë shqiptarë në Kosovë, ndonëse nuk janë të kënaqur me vazhdimin e mbikëqyrjes ndërkombëtare dhe disa aspekte të tjera të këtij plani e kanë mbështetur atë, sepse ai u shërben qëllimeve të tyre afatgjata për pavarësi.

Në një dëshmi përpara Komitetit të Punëve të Jashtme të Shtëpisë së Bardhë, më 17 prill 2007, nënsekretari i Shtetit, Nicholas Burns, u shpreh se SHB dhe aleatët e tij do të paraqesin një draft-rezolutë në Këshillin e Sigurimit, e cila do të zëvendësojë Rezolutën 1244 dhe do të mbështesë planin e Ahtisarit. Në

kundërshtim me qëndrimin e Qeverisë amerikane, Rusia ishte shumë kritike ndaj propozimit të Ahtisarit. Zyrtarët rusë e kanë kundërshtuar atë, sepse shihnin tek ajo një përpjekje të shpejtuar për një zgjidhje në favor të Kosovës, dhe kanë ngulur këmbë që çdo propozim duhet që të ketë mbështetjen e Serbisë dhe të shqiptarëve të Kosovës, gjë shumë e vështirë për t'u arritur. Në muajt në vazhdim SHB dhe aleatët e saj në KS do të paraqitnin disa draft-rezoluta, të cilat do të qartësonin të ardhmen e Kosovës së pavarur. Me gjithë këto, në korrik 2007, SHBA dhe aleatët e saj i abandonuan përpjekjet për të miratuar një rezolutë në Këshillin e Sigurimit, pasi Rusia e bëri të qartë, se ajo do të vendoste veton kundër pavarësisë së Kosovës. Gjatë vizitës së tij në Shqipëri, në qershor 2007, presidenti Bush u deklarua kundër “dialogun pa fund” mbi statusin e Kosovës. Ai u shpreh se “është më mirë shpejt se sa vonë që të thuhet se, mjaft është mjaft, Kosova është e pavarur”.

Çështja e statusit të ardhshëm të Kosovës ka pasur interes të madh për anëtarët e Kongresit. Një shumicë prej tyre kanë favorizuar pavarësinë e Kosovës, sapo të jetë e mundur. Ata janë shprehur se kosovarët duhet të gëzojnë të drejtën e vetëvendosjes, sikurse edhe popujt e tjerë të rajonit dhe kudo tjetër në botë. Nga ana tjetër, disa anëtarë janë më shumë skeptikë. Ata u referohen mungesave të Qeverisë kosovare në lidhje me të drejtat e minoritetit dhe problemeve të tjera në lidhje me ndikimin që mund të ketë pavarësia e Kosovës mbi demokracinë e Serbisë dhe stabilitetin e rajonit. Sesioni i 109-të i Kongresit u mor me çështjen e Kosovës. Më 4 janar 2005, përfaqësuesi Tom Lantos, paraqiti H. Res. 24, e cila shpreh mendimin e Shtëpisë [House], se SHB duhet të mbështesin pavarësinë e Kosovës. Më 7 tetor 2005, Senati kaloi Res. 237, një rezolutë që mbështeste përpjekjet për “të punuar për një marrëveshje mbi statusin e ardhshëm të Kosovës”. Rezoluta thoshte se statusi i pazgjidhur i

Kosovës nuk sjell qëndrueshmëri. Ai nuk shprehu mbështetjen për ndonjë status të veçantë, por thotë se ai duhet “të përcjellë shqetësimin kryesor” të popullit të Kosovës, të Serbisë dhe të Malit të Zi. Një rezolutë e kësaj natyre u paraqit më 17 dhjetor 2005.

Legjislacioni mbi statusin e Kosovës u paraqit në fillim të sesionin të 110-të të Kongresit, më 5 janar 2007, kur përfaqësuesi Lantosh [Tom Lantos] paraqiti Rezolutën 36, e cila u drejtohet SHB për të shprehur mbështetjen për pavarësinë e Kosovës. Më 29 mars 2007, senatori Libebberman paraqiti Rezolutën 135, e cila shpreh qëndrimin e Senatit që SHB duhet të mbështesin pavarësinë e Kosovës. Ajo thotë se, nëse Këshilli i Sigurimit i KB nuk e kalon rezolutën Ahtisari për të mbështetur pavarësinë e Kosovës në kohën e duhur, SHB dhe vendet e të njëjtit mendim duhet të njohin pavarësinë e Kosovës nga ana e tyre. Një rezolutë me nr. 309, u paraqit nga Engel, më 27 prill. Më 24 maj përfaqësuesi Bean, paraqiti rezolutën 445, e cila shprehte opinionin se SHB duhej që të refuzonin një zgjidhje të njëanshme të ndërmarrë prej tyre, jashtë Kombeve të Bashkuara për pavarësinë e Kosovës.⁸

Në vazhden e aksionit të mëtejshëm të Këshillit të Sigurimit të KB, autoritetet e Kosovës përgatitën deklaratën e pavarësisë në fillim të vitit 2008, si pjesë e proceseve të koordinuara ngushtësisht me komunitetin ndërkombëtar. Me nxitjen e komunitetit ndërkombëtar, Prishtina priti derisa përfunduan të dy raundet e zgjedhjeve direkt presidenciale (20 janar dhe 3 shkurt). Drejtuesit e Kosovës kishin shprehur për një kohë të gjatë shqetësimet lidhur me vonesat e përsëritura gjatë statusit të procesit dhe disa kundërshtime të planit të Ahtisarit në Kosovë për kufizimin e sovranitetit; për shembull një

⁸ Julie Kim, Steven Woehrel, Kosovo and U.S. Policy: Background to Independence, prepared for Members and Committees of Congress, Updated June 20, 2008, p. 27.

tubim pro pavarësisë në shkurt 2007 u shndërrua në një përplasje të dhunshme me policinë e KB, duke lënë dy të vdekur.

Më 17 shkurt 2008, Parlamenti i Kosovës miratoi Deklaratën për Pavarësinë e Kosovës në “përputhje të plotë” me rekomandimet e përfaqësuesit special të KB, Martti Ahtisaari. Ai deklaroi se Kosova ishte një republikë demokratike, laike dhe multietnike, e cila kishte pranuar plotësisht detyrimet e planit të Ahtisarit për Kosovën. Në ditën në vazhdim, pavarësia Kosovës u njoh zyrtarisht nga SHBA-ja, Franca dhe Mbretëria e Bashkuar. Atyre iu bashkuan edhe një numër tjetër vendesh evropiane, në total mbi 40 vende nga gjithë bota. Ndërmjet vendeve anëtare të Këshillit të Sigurimit të KB, Rusia, Kina së bashku me Serbinë dhe disa vende të tjera, e denoncuan deklaratën e pavarësisë si dhunim të ligjit ndërkombëtar. Shumica, por jo të 27 vendet e Bashkimit Evropian, e njohën Kosovën, me përjashtim të Spanjës, Qipros, Rumanisë, Sllovakisë dhe Greqisë, të cilat shprehën rezerva të forta. Në të njëjtën kohë mungesa e unitetit të vendeve të Bashkimit Evropian [BE] për statusin e Kosovës nuk i ndaloi vendet e këtij Bashkimi që të vendosnin misionet e tyre në Kosovë.

Udhëheqësit e Kosovës e mirëpritën mbështetjen ndërkombëtare për zhvillimin e Kosovës në rrugën e demokracisë përmes prezencave ndërkombëtare. Kuvendi i Kosovës ka marrë disa vendime të shpejta për të mundësuar ligjet e reja në përshtatje me planin e Ahtisarit, duke përfshirë miratimin e Kushtetutës së re, e cila erdhi në fuqi më 15 janar 2008. Qeveria e Hashim Thaçit paraqiti agjendën e saj në mesin e muajit prill. Udhëheqësit e Kosovës kanë folur për integrimin Euro-Atlantik si prioritet kyç të vendit dhe janë përpjekur të ecin në këtë rrugë.

Serbia nuk e njohu pavarësinë e Kosovës, por përkundrazi më 15 gusht 2008, ajo i kërkoi zyrtarisht Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë që të shprehej “se a përbënte deklarata e pavarësisë së

Kosovës dhunim të legjislacionit ndërkombëtar”? Dhe përgjigja e mëvonshme e këtij institucioni ishte refuzuese. Gjatë vizitës së tij në Kosovë, më 21 maj 2009, zëvendëspresidenti amerikan, Joseph Biden, do të shprehej: “suksesi i pavarësisë së Kosovës është prioritet për SHBA-në”.

Angazhimi amerikan edhe pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës nuk u ndërpre, pavarësisht se rolin parësor do ta luante Bashkimi Evropian. Prania amerikane ishte e gjithanshme, si në sferën politike ashtu edhe në atë ligjore, ushtarake e ekonomike. Qeveria amerikane i ka mbështetur fort bisedimet Kosovë-Serbi, ndonëse ka pranuar se ajo nuk është pjesëmarrëse apo ndërmjetësuese e tyre. Por mbështetja amerikane për Kosovën dhe udhëheqësit e saj nuk ka munguar asnjëherë.

Hamit Kaba

SUMMARY

The paper “Kosovo the road to Independence and US policy” deals with a very important issue for the people of Kosovo, the statebuilding process and the Euro-Atlantic path of its integration. This process began in 1999 and culminated with the creation of the independent state of Kosovo in 2008, but the process is still unfinished. On his way he has encountered many obstacles and difficulties, due to the strong opposition of the Serbian state for its recognition, but also the lack of proper cohesion of the countries of the European Union. Even today, 5 of these countries do not recognize the state of Kosovo. This paper focuses on the role of the United States in ‘the journey’ of the state of Kosovo and its comprehensive political, legal, economic and military support. Although the US did not have the role of leader, but the European Union, its presence has been permanent, thanks to the great trust that they enjoy in the eyes of the Albanian people of Kosovo. The American presence has been very important, both politically and legally, militarily and economically. The US government has strongly supported its integration into Euro-Atlantic institutions and the Kosovo-Serbia talks on its recognition by Serbia.

Kalojan Metodiev & Anton Pançev

Qëndrimi i Bullgarisë ndaj Kosovës, fundi i shek. XX dhe fillimshkulli XXI

Bullgaria ka pasur marrëdhënie të ndërlikuara me Jugosllavinë gjatë shekullit XX. Në qendrën e politikës bullgare ndaj fqinjit perëndimor, natyrisht ka qenë Maqedonia, por me zhvillimin e proceseve politike në Krahinën Autonome të Kosovës, edhe çështja shqiptare në Jugosllavi ka hyrë në fokusin bullgar¹. Interesimi i Bullgarisë ndaj çështjes së Kosovës daton që nga vitet '70-ta të shek. XX, kur janë realizuar kontaktet e para joformale ndërmjet liderëve bullgarë dhe udhëheqësve shqiptarë të Krahinës. Shpërbërja e përgjakshme e Jugosllavisë dhe operacioni i NATO-s për çlirimin e Kosovës në vitin 1999, çuan deri në përfshirjen e Bullgarisë në aspektet politiko-ushtarake të krizës dhe e kanë kthyer Kosovën në prioritet kryesor të politikës së jashtme bullgare². Sjellja e autoriteteve bullgare gjatë luftës së Kosovës ka qenë me karakter vendimtar për integrimin euroatlantik të Bullgarisë dhe ka qenë tregues për pjekurinë e shoqërisë bullgare. Edhe pas përfundimit të operacionit ushtarak të NATO-s, Bullgaria ka vazhduar të luante një rol të rëndësishëm në zhvillimet politike të lidhura me Kosovën. Shteti bullgar ka marrë pjesë në operacionin paqeruajtës në Kosovë dhe i ka përkrahur përpjekjet për ndërtimin e institucioneve të vendit dhe shpalljen e pavarësisë, më 2008. Mbështetja bullgare ndaj

¹ Për aspektet gjeopolitike dhe ndërkombëtare të çështjes së Kosovës nga pikëpamja bullgare, shih: Карастоянов, Стефан. Косово – геополитически анализ. С., 2007.

² Për këto çështje shih: Найденов, Михаил. НАТО и кризата в Косово. С., 2000.

pavarësisë së Kosovës është paraqitur në forma të ndryshme, përfshirë edhe me deklaratën pozitive në favor të Kosovës në Gjykatën Ndërkombëtare të Drejtësisë. Gjatë gjysmës së parë të vitit 2018, Bullgaria si kryesuese e Këshillit të BE-së, deklaroi si prioritet kryesor integrimin e vendeve të Ballkanit Perëndimor në BE. Institucionet bullgare ndërmorën disa nisma, të cilat kanë ndikim direkt mbi zhvillimin dhe stabilitetin e Kosovës. Gjatë tërë kësaj periudhe, marrëdhëniet politike ndërmjet Bullgarisë dhe Kosovës janë në nivel shumë të lartë dhe vazhdojnë të zhvillohen³.

Për këto ngjarje dhe zhvillime ekzistojnë shumë informata dhe dokumente nga burime të ndryshme. Në vend të parë janë arkivat e Ministrisë së Punëve të Jashtme të Bullgarisë, si edhe të institucioneve të tjera, të cilat kanë pasur rol në formimin e politikës bullgare ndaj Kosovës. Me rëndësi të madhe janë edhe kujtimet dhe intervistat e diplomatëve dhe të politikanëve, që kanë marrë pjesë në këto procese. Natyrisht, të panumërta janë edhe lajmet, analizat, publikimet në mediat e shtypura dhe në ato elektronike. Këto burime shumë të pasura janë shfrytëzuar me sukses nga disa studiues bullgarë, të cilët kanë shkruar disa monografi dhe shumë punime të tjera, përmes të cilave hedhin dritë mbi aspekte të ndryshme të politikës bullgare ndaj Kosovës. Prandaj, kjo analizë ka për qëllim të paraqesë vetëm një vështrim të shkurtër mbi politikën e Bullgarisë ndaj Kosovës në dekadën vendimtare për mëvetësimin e Republikës së Kosovës - nga lufta deri te shpallja e pavarësisë së Republikës së Kosovës.

Faza e parë

³ Për marrëdhëniet politike midis Kosovës dhe Bullgarisë, shih: Kosova në kontekst rajonal: marrëdhëniet politike bilaterale. KIPRED, 3/14 - maj 2014, f. 62-36; f. 69-70.

Pas hyrjes së krizës së Kosovës në fazën e luftës së hapur në vitin 1998, ndjeshmëria e autoriteteve, por edhe e shoqërisë bullgare kundrejt zhvillimeve alarmuese rreth kufirit perëndimor bullgar, është rritur tepër shumë. Në këtë periudhë, vetë Bullgaria ka pasur shumë vështirësi ekonomike dhe sociale, duke përjetuar vite të mundshme në tranzicionin demokratik dhe ka qenë në fillim të rrugës euroatlantike. Për këto arsye, interesi jetësor bullgar ka qenë stabilizimi i rajonit dhe ndalimi i konflikteve në ish-Jugosllavi.

Përpjekjet e diplomacisë bullgare ishin përqendruar mbi angazhimin e palëve të interesuara në negociata përmes nismave të ndryshme rajonale për dialog. Nga muaj mars 1998, Qeveria bullgare ka punuar për një qëndrim të përbashkët të të gjitha vendeve fqinje të ish-Jugosllavisë. Problemi i Kosovës u bë njëri prej prioritetëve kryesorë të politikës së jashtme të Bullgarisë, në fund të viteve të ‘90-ta⁴. Ndërkohë, pala bullgare ka qenë në dijeni se nuk i ka kapacitetet të ndikonte në mënyrë vendimtare për zgjidhjen e çështjes së Kosovës, një detyrë e paarritshme edhe për Fuqitë e Mëdha.

Që nga fillimi i krizës në Jugosllavi, Bullgaria është orientuar ndaj politikës së mosndërhyrjes në punët e brendshme të këtyre shteteve, por me qëndrim të prerë se duhej të respektohej e drejta për vetëvendosje të popujve dhe se problemet duhej të zgjidheshin në mënyrë paqësore dhe të respektoheshin të drejtat e njeriut dhe të komuniteteve etnike⁵. Në këtë periudhë, ministrja e Jashtme bullgare, Nadezhda Mihajlova, është dërguar nga Qeveria bullgare në Beograd, ku ka zhvilluar takim me presidentin jugosllav, Slobodan Millosheviqin. Gjatë bisedimeve zyrtare është shqyrtuar edhe çështja e Kosovës. Millosheviqi e ka kritikuar Bullgarinë për shkak të

⁴Методиев, Калоян. Западните Балкани и България (политика, дипломация, сигурност). София, 2016, f. 58.

⁵Първанов, Антон. Косовският възел. С., 2011, f. 304.

insistimit të palës bullgare marrëdhëniet ndërmjet serbëve dhe shqiptarëve të Kosovës të mos shqyrtoheshin si një problem i brendshëm jugosllav, por si sfidë për komunitetin ndërkombëtar, i cili vetëm me përpjekje të përbashkëta do t'i mbronte të drejtat njerëzore të shqiptarëve të shtypur.⁶ Prandaj, qëndrimi i Bullgarisë gjatë krizës së Kosovës në vazhdimësi përfshinte mbështetje për veprimet e komunitetit ndërkombëtar kundrejt regjimit të Millosheviqit. Kjo i përshtatej interesit kombëtar bullgar që të ndërpriteshin sa më shpejt luftërat dhe efektet negative nga shpërbërja e dhunshme e ish-Jugosllavisë, të cilat i kanë shkaktuar shumë dëme Bullgarisë, e kanë ngadalësuar rrugën e vendit drejt integritetit në BE dhe kanë stimuluar përhapjen e krimit të organizuar.

Në këtë situatë të ndërlikuar, Bullgaria u orientua drejt ndërmarrjes së nismave për krijimin e një qëndrimi të përbashkët nga vendet e rajonit në lidhje me krizën e Kosovës, si kontribut ndaj përpjekjeve të komunitetit ndërkombëtar. Në tetor të vitit 1998, në rrjedhën e Samitit të dytë të krerëve shtetërorë të vendeve nga Evropa Juglindore, i cili i zhvilloi punimet në qytetin turk, Antalia, pala bullgare ka propozuar ndalimin e menjëhershëm të dhunës në Kosovë përmes një deklarate të veçantë⁷.

Në fund të vitit 1998 dhe në fillim të viti 1999, institucionet bullgare në mënyrë të përhershme e kanë deklaruar mbështetjen e tyre për zhvillimin e operacioneve paqeruajtëse në Kosovë. Në shkurt 1999, ministria e Jashtme e Bullgarisë e ka paraqitur nismën për zhvillimin e një takimi të përfaqësuesve parlamentarë nga vendet fqinje të Jugosllavisë (Bullgaria, Maqedonia, Rumania, Hungaria), në të cilin takim do të konfirmohej angazhimi i shteteve të rajonit për zgjidhje paqësore të krizës së Kosovës, por autoritetet serbe kanë

⁶Методиев, Калоян. Вepër e cituar, f. 58.

⁷Първанов, Антон. Вepër e cituar, f. 305.

refuzuar lejimin që një delegacion i tillë të vizitonte Beogradin dhe Prishtinën⁸.

Fillimi i operacionit ushtarak të NATO-s e ka vënë në sprovë Bullgarinë për shkak të mosmarrëveshjeve në Kuvendin bullgar⁹, të rrezikut nga zgjerimi i luftës, të humbjeve të mëdha ekonomike për Bullgarinë, të gjendjes së rëndë të pakicës bullgare në Serbi, mbi të cilën Beogradi shpesh ka bërë presion etj. Partia kryesore opozitare Partia Socialiste e Bullgarisë, ka qenë kundër lejes bullgare që aeroplanët e NATO-s ta përdornin hapësirën ajrore bullgare në sulmet e tyre kundrejt caqeve serbe. Në të njëjtën kohë, Bullgaria ka qenë në proces anëtarësimi në Aleancën Veriatlantike dhe duhej të tregonte lojalitetin e saj ndaj operacioneve të NATO-s. Pra, kriza e Kosovës ka qenë momenti vendimtar për marrëdhëniet e Bullgarisë me NATO-n.

Negociatat ndërmjet Qeverisë bullgare dhe NATO-s janë zhvilluar në mënyrë intensive. Nga Aleanca Veriatlantike është kërkuar qasje e plotë në hapësirën ajrore bullgare. Më 18 prill 1999, kryeministri bullgar dhe presidenti amerikan, Klinton, kanë zhvilluar një bisedë telefonike, kurse kryeministri i Bullgarisë e ka vizituar Brukselin, më 21 prill, ku ka zhvilluar bisedime me përfaqësuesit diplomatikë të NATO-s, të akredituar atje. Pas kësaj ofensive diplomatike, me debate të nxehta në Kuvendin bullgar, vendimi është marrë dhe në këtë mënyrë janë lehtësuar operacionet ajrore të Aleancës. Pas marrëveshjes ndërmjet Bullgarisë dhe NATO-s, Sofja ia ka dhënë NATO-s hapësirën ajrore rreth kufirit të saj perëndimor, si edhe korridore për aeroplanët ushtarakë dhe transportues¹⁰.

Operacioni "Patkua"

⁸*Po aty*, f. 306.

⁹ Për debatet në shoqërinë bullgare, shih: Горнев, Галин и др. Идентичност и криза. Случаят Косово: отвъд разбъгващите се интерпретации. С., 2004.

¹⁰ Методиев, Калоян. *Вер* е ситuar, f. 62-63.

Kontributi i Bullgarisë në lidhje me argumentimin e operacionit ushtarak të NATO-s ishte ashtuquajturë “Plan Patkua”. Në janar të vitit 1999, në qeverinë bullgare është dërguar raport nga strukturat e inteligjencës bullgare në Beograd, ku ka pasur informata për përgatitjen e një plani sekret nga qeverisja e Millosheviqit për spastrim etnik të Kosovës me emrin “Patkua”. Nga Bullgaria ky dokument i është dërguar Qeverisë gjermane, e cila e ka përdorur si pretekst për fillimin e bombardimeve mbi Jugosllavinë. Më vonë, këto informata janë përdorur edhe nga autoritetet e Britanisë së Madhe për ta tejkaluar rezistencën e opozitës për fillimin e operacionit ushtarak¹¹. Rreth kësaj ngjarjeje vazhdon të ketë shumë mosmarrëveshje a ka ekzistuar në të vërtetë ky plan ose ka pasur ndikime të ndryshme politike rreth paraqitjes së tij.

Faza e dytë

Pas përfundimit të luftës dhe me zhvillimin e operacionit paqeruajtës në Kosovë, për autoritetet bullgare në plan të parë kanë dalë përpjekjet për intervenimin politik te palët dhe ndërmjetësimi midis tyre në disa fusha. Ndoshta takimi i parë në këtë drejtim është zhvilluar në fund të janarit 2000, kur kryeministri bullgar, Ivan Kostov, ka pasur bisedime me Hashim Thaçin dhe me Arbën Xhaferin në Sofje, në lidhje me rregullimin e marrëdhënieve ndërmjet shqiptarëve dhe serbëve. Kostovi e ka përdorur zyrën partiake për realizimin e politikës bullgare ndaj Kosovës dhe Serbisë, sepse me këtë qasje u jepej një legjitimitet ndërkombëtar palëve, pa i angazhuar drejtpërdrejt institucionet shtetërore të Bullgarisë. Në këtë periudhë ka pasur takime intensive midis politikanëve bullgarë dhe Hashim Thaçit e Ibrahim Rugovës, si liderë të Kosovës pikërisht për këto çështje.

¹¹*Po aty*, f. 65-66.

Në muajin mars 2000, Kostovi ka zhvilluar takime edhe me liderët e serbëve të Kosovës, Momçillo Trajković dhe peshkopin Artemije, përsëri në zyrën partiake. Takimi ka përfunduar me një deklaratë të përbashkët për mediat. Trajković deklaroi se ka kërkuar nga pala bullgare të ndërmjetësojë për një takim me Ibrahim Rugovën¹².

Kryeministri bullgar e ka marrë përsipër angazhimin që t'i njihte pjesëmarrësit në Samitin e dytë të liderëve shtetërorë të fqinjëve të Jugosllavisë në Budapest, në lidhje me problemet e Kosovës. Dy javë më vonë, Ivan Kostovi, ka bërë vizitë njëditore në Kosovë, ku ka zhvilluar takime me të dyja palët dhe ka ndërmjetësuar për rifillimin e dialogut. Kryeministri bullgar i ka njoftuar palët se ai i ka informuar pjesëmarrësit e forumit në kryeqytetin hungarez me domosdoshmërinë për dialog midis dy komuniteteve etnike në Kosovë dhe për rifillimin e negociatave ndërmjet serbëve dhe komunitetit ndërkombëtar.

Të njëjtin vit, Qeveria bullgare e mori vendimin për hapjen e një përfaqësie diplomatike në Prishtinë, por ajo filloi të funksiononte në tetor të 2003, ku si qëllimi kryesor i punës së saj ka qenë mbajtja e lidhjes me kontingjentin bullgar të KFOR-it, UNMIK-ut dhe punës konsullore.

Sa u përket hapave fillestarë të Bullgarisë në rrugën e pajtimit të palëve, mund të vimë në përfundim se gjatë muajve të parë të vitit 2000, Bullgaria ka luajtur një rol shumë aktiv në ndërmjetësimin midis shqiptarëve dhe serbëve në Kosovë. Qeveria bullgare ka qenë ndër faktorët kryesorë për fillimin e negociatave ndërmjet serbëve dhe shqiptarëve në forume dhe formate të ndryshme.

¹²Първанов, Антон. Вепër e cituar, f. 308.

Edhe pas ndryshimit të qeverisjes në Bullgari, aktiviteti bullgar ndaj Kosovës dhe përpjekjet për zhvillimin e dialogut ndërmjet palëve ka vazhduar. Ministrat e Jashtëm të Bullgarisë kanë bërë disa vizita në Kosovë dhe në të njëjtën kohë e kanë zhvilluar dialogun edhe me kolegët e tyre në Beograd - mund të përmenden vizitat e Solomon Pasit (2004) dhe Ivajlo Kalfinit (2005)¹³.

Njëra prej temave, me të cilat ka pasur negociata ndërmjet Serbisë dhe Kosovës me lehtësimin bullgar, ka qenë ajo për trashëgiminë kulturore dhe historike. Bisedimet për këtë temë të rëndësishme edhe me prapaskena politike janë zhvilluar në Bullgari dhe ka pasur dy takime kryesore (në Arbanasi, më 8-9 nëntor 2005 dhe në Varna, më 24 qershor 2006). Procesi i negociatave është quajtur “Arbanasi” në lidhje me fshatin afër Veliko Tërnovos, ku kanë jetuar shqiptarë dhe është ruajtur arkitektura unike. Bisedimet kanë qenë në nivel ministrash dhe delegacioni i Kosovës ka marrë pjesë nën emrin e UNMIK-ut. Nikoqir zyrtar ishte ministri bullgar i Kulturës dhe janë diskutuar çështje të lidhura me statutin e kishave dhe të manastireve në Kosovë dhe përfshirja e Këshillit të Evropës në financimin e projekteve kulturore për ruajtjen e trashëgimisë. Ka qenë arritje vetë fakti se është zhvilluar dialog i drejtpërdrejtë ndërmjet përfaqësuesve zyrtarë të shqiptarëve dhe të serbëve në Kosovë dhe pala bullgare e ka përdorur me sukses kulturën si instrument i politikës dhe i diplomacisë¹⁴.

Qëllimi kryesor i diplomacisë bullgare ka qenë qetësimi i situatës dhe parandalimi i përplasjeve të reja të mundshme. Në Sofjen zyrtare ka pasur frikë se një destabilizim eventual do ta trazonte të tërë rajonin. Në kontekstin e anëtarësimit të Bullgarisë në BE, e cila ishte me afat 1 janar 2007, do të ekzistonte rreziku për shtyrjen e tij

¹³*Po aty*, f. 317.

¹⁴Методиев, Калоян. Вепër e cituar, f. 86-87.

në rast destabilizimi të rajonit. Për këtë arsye, pala bullgare ka përdorur çdo mundësi për ta vënë në diskutim çështjen e Kosovës. Kështu p.sh. në takimin e Internacionalit Socialist (në periudhën 2005-2009, Bullgaria qeverisej nga Partia Socialiste së bashku me partnerët e saj të koalicionit) për Evropën Juglindore në Sofje, në vitin 2005, kanë marrë pjesë përfaqësues të partive nga Kosova dhe Serbia, si njëra nga idetë ka qenë të fillohej një proces për përfshirjen e shqiptarëve nga Kosova në forume ndërkombëtare duke i bllokuar përpjekjet serbe për izolimin e palës kosovare.

Prandaj, në këtë periudhë (2004-2007) e tërë politika bullgare në lidhje me Kosovën i ishte nënshtruar idesë për ruajtjen e stabilitetit dhe për evitimin e çfarëdo konflikti.

Pas vitit 2005, shteti bullgar ka marrë pjesë me përfaqësues të tij në këshillat evropianë, forumi më i lartë i BE-së, pa të drejtë vote. Njëra prej temave në këto samite, në të cilat Bullgaria ka pasur një rol aktiv dhe ku e kanë kërkuar ekspetizën bullgare, ka qenë ajo për statutin e ardhshëm të Kosovës dhe për zgjidhjen e problemeve të saj.

Një arritje tjetër e Qeverisë bullgare në këtë periudhë është lidhur me Grupin e Kontaktit për Kosovën. Njëri prej takimeve të kësaj strukture, në të cilën janë përfshirë përfaqësues të Fuqive të Mëdha, është zhvilluar në Sofje, më 11 shtator 2006. Kjo ka qenë një njohje për kontributin bullgar për kërkimin e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve. Një kontribut tjetër kaqenë edhe vizita e shpeshtë e Ahtisarit në Sofje, ku ka zhvilluar konsultime me presidentin dhe kryeministrin bullgar¹⁵.

Në këto kushte dhe rrethana, duke parë se stabilizim i përhershëm i Kosovës dhe i tërë rajonit, mund të arrihej vetëm përmes mëvetësimit të Kosovës, Qeveria e Bullgarisë e ka mbështetur

¹⁵*Po aty*, f. 85-86.

shpalljen e pavarësisë së Republikës së Kosovës dhe ka njohur shtetin e ri, më 20 mars 2008. Me këtë vendim të Qeverisë bullgare ka mbaruar një etapë e rëndësishme në politikën bullgare ndaj Kosovës dhe ka filluar periudha e zhvillimit të marrëdhënieve ndërmjet dy shteteve.

Përfundime

Luftërat në ish-Jugosllavinë i kanë shkaktuar dëme të rënda ekonomisë bullgare dhe kanë çuar deri te izolimin politik i vendeve ballkanike nga proceset euro-integruese. Për këtë arsye, politika bullgare ndaj Kosovës në fund të viteve '90-ta i është nënshtruar idesë për arritjen e një zgjidhjeje të shpejtë të konfliktit dhe të vendosjes së paqes së përhershme, që ta lejonte stabilizimin e tërë rajonit dhe t'i hiqte pengesat para zhvillimit ekonomik dhe integritetit euroatlantik të vendit. Vetë Bullgaria ka pasur mosmarrëveshjeve ndërmjet qëndrimeve të ndryshme sa u përket mënyrave të zgjidhjes së krizës së Kosovës, të cilat janë rreshtuar në dy kampe politike - pro dhe kundër NATO-s. Pas fillimit të operacionit ushtarak, institucionet bullgare kanë marrë vendim që ta përkrahnin atë përmes mbështetjes logjistike ushtarëve të NATO-s. Bullgaria ka marrë pjesë në nismat rajonale për rregullimin e konfliktit, si edhe u ka dhënë mbështetje humanitare njerëzve në nevojë. Në etapën e ardhshme, pas luftës, Bullgaria e ka mbështetur operacionin paqeruajtës në Kosovë dhe ka bërë përpjekje të suksesshme që të ndihmonte vendosjen e kontakteve ndërmjet përfaqësuesve shqiptarë dhe serbë. Me ndërmjetësimin bullgar janë zhvilluar disa nisma të rëndësishme, të cilat kanë çuar deri në realizimin e dialogut në disa tema midis palëve. Në vazhdim të politikës së saj parimore në lidhje me çështjen e Kosovës, Bullgaria e ka njohur pavarësinë e Republikës së Kosovës, si dhe vazhdon mbështetjen e saj për shtetin e ri, duke i përdorur resurset e saj politike dhe diplomatike për këtë qëllim.

Kalojan Metodiev & Anton Pančev**SUMMARY**

The attitude of Bulgaria towards Kosovo, end of the century XX and beginning of century XXI The wars in the former Yugoslavia have caused severe damage to the Bulgarian economy and led to the political isolation of the Balkan countries from the Euro-integration process. For this reason, Bulgarian policy towards Kosovo in the late 1990s was subject to the idea of achieving a prompt resolution of the conflict and the establishment of lasting peace, which would allow the stabilization of the entire region and remove obstacles for the economic development and Euro-Atlantic integration of Bulgaria. Bulgaria itself has had disagreements between different positions on how to resolve the Kosovo crisis, which were lined up in two political camps - for and against NATO. Following the beginning of the military operation, Bulgarian institutions decided to support it through logistical support to NATO soldiers. Bulgaria has participated in regional conflict resolution initiatives, as well as provided humanitarian assistance to people in need. In the next post-war phase, Bulgaria supported the peacekeeping operation in Kosovo and made successful efforts to help establish contacts between Albanian and Serb representatives. With the mediation of Bulgaria, several important initiatives have been developed, which have led to the realization of dialogue on several topics between the parties. Continuing its principled policy on the issue of Kosovo, Bulgaria has recognized the independence of the Republic of Kosovo, and continues its support for the new state, using its political and diplomatic resources for this purpose.

KsenofonKrisafi*

Diplomacia e Shqipërisë në mbrojtje të Kosovës

Politika dhe diplomacia e Fuqive të Mëdha, në fillimet e shekullit të kaluar, vendosi t'i sakrifikonte Kosovën dhe trojet e tjera shqiptare në altarën e paqes evropiane, siç u shpreh Eduard Grey, në 12 gusht 1913, pas mbarimit të Konferencës së Londrës. Megjithatë, shqiptarët nuk i kanë reshtur asnjëherë përpjekjet për ta korrigjuar këtë padrejtësi. Ndryshimi i përkatësisë shtetërore, statusit juridiko-ndërkombëtar dhe të ardhmes së tyre, u shndërrua në preokupimin e tyre themelor dhe të qeverive që ata kanë pasur në krye. Edhe pse të ndarë, shqiptarët, brenda dhe jashtë kufijve etnikë, gjatë të gjitha kohërave janë ndjerë një komb, me përkatësi etnike, gjuhësore, me doke dhe zakone të njëjta dhe kanë aspiruar që të bëheshin një shtet, siç u bënë Italia dhe Gjermania pas përfundimit të procesit të unifikimit të tyre kombëtar, në vitet '70-ta të shekullit XIX dhe siç u bashkuan dy Gjermanitë, dy Vietnamët, dy Jemenët etj., pas gjysmës së dytë të shekullit të kaluar.

Në dekadat përmbyllëse të shekullit të kaluar, përpjekjet për Kosovën morën zhvillime cilësore. Për dëbimin e forcave ushtarake, policore, gjyqësore, administratës dhe gjithçkaje serbe, për afirmimin ndërkombëtar të çështjes së madhe të popullit të Kosovës, vepronte ish-presidenti Rugova, luftonte me heroizëm UÇK-ja, kontribuonte gjithë faktori shqiptar brenda e jashtë saj, bombardonin avionët e NATO-s, punonte intensivisht diplomacia botërore. Ishte gjithashtu në këmbë, i angazhuar maksimalisht në frontet politike, diplomatike

etj. shteti shqiptar me të gjitha strukturat e veta përkatëse. Veprohej bashkërisht dhe në fronte të gjerë sepse në Kosovë, në zemër të Evropës, në vigjilje të mijëvjeçarit të tretë, po kryhej një nga krimet më të rënda kundër njerëzimit, po bëheshin ekzekutime dhe vrasje masive, masakra dhe barbari, trajtime çnjerëzore, përdhunime të grave dhe vajzave të reja kosovare, shpërngulje dhe dëbime të qindra mijëra kosovarëve, që morën format e një spastrimi etnik pothuajse total në Kosovë.

Shqiptarët, viktimat të gjenocidit dhe valëve sistematike të spastrimeve etnike, të prirur nga interesat e të ardhmes së tërë popujve të gadishullit, nuk ndërmorën veprime simetrike hakmarrëse ndaj xhelatëve të tyre, por u përfshinë në përpjekje të sinqerta për krijimin e një mjedisi të pastër jo vetëm nga pasojat e luftimeve e të bombave, por edhe nga pikëpamja shoqërore ndëretnike.

Në vijën e parë të frontit politik ndërkombëtar, atje ku nuk luftohej me avionë, raketa e artileri, por me veprimtari të dëndur diplomatike, me debat të fuqishëm institucional dhe me argumente politike e juridike, gjendej e rreshtuar edhe diplomacia shqiptare. Ajo vepronte si pjesë e faktorit ndërkombëtar, i cili punonte për krijimin e kushteve për normalizimin e gjendjes në Kosovë dhe në ish-Jugosllavi.

Ngjarjet e ndodhura gjatë luftës së Kosovës dhe gjithë historia e përpjekjeve për çlirimin e saj nga zgjedha serbe, ishin provë e të vërtetës së madhe, që me këtë rast shqiptarët dhe veçanërisht forcat e tyre politike, mësuan më mirë atë që popujt e tjerë, veçanërisht fqinjët e dinë mirë dhe e zbatojnë me konsekuencë, se kur janë në lojë fatet e atdheut, duhet të prevalojnë mbi gjithçka Shqipëria, Kosova dhe shqiptarët. Për disa aspekte të veprimtarisë së saj, flitet në faqet vijuese të kësaj kumtese.

Ky punim, që i kushtohet kontributit të diplomacisë së Shqipërisë për çlirimin dhe pavarësinë e Kosovës, dy nga ngjarjet më të rëndësishme në historinë e shqiptarëve, pas shpalljes së pavarësisë së Shqipërisë, në nëntorin e 1912, është mbështetur kryesisht mbi përjetimet personale të autorit, i cili në periudhën e shpërthimit violent të krizës së Kosovës, luftës së popullit të saj për liri, ndërrhyrjes së NATO-s, si dhe përçapjeve të shumta të faktorit ndërkombëtar për gjetjen e zgjidhjeve, pati fatin dhe privilegjin të ishte ambasadori i jashtëzakonshëm dhe fuqiplotë, përfaqësuesi i përhershëm i Republikës së Shqipërisë në Zyrën e Kombeve të Bashkuara dhe në organizatat e tjera ndërkombëtare me seli në Gjenevë, duke u bërë kështu pjesë e një prej ngjarjeve më unike të historisë së shqiptarëve. Për aktivitetin dhe kontributet relative të misionit, si strukturë funksionale e politikës dhe diplomacisë shtetërore të Shqipërisë, nisur edhe nga fakti që mu dha mundësia të ndodhesha pranë instancave vendimmarrëse të politikës dhe diplomacisë botërore dhe të njihesha nga afër me hollësitë e diskutimeve dhe vendimeve që u morën, kam shkruar dhe botuar vitin e kaluar dy libra.¹ Bazuar në disa ide të tyre, të publikimeve të ndonjë prej drejtuesve kryesorë të shtetit shqiptar të asaj kohe, në shkrimet e personaliteteve të rëndësishme të politikës botërore, si dhe të studiuesve të ndryshëm, vendas e të huaj, jam përpjekur për të

*Autori është profesor i së drejtës ndërkombëtare, studiues i historisë diplomatike të çështjes shqiptare. Ai është anëtar i Akademisë Shqiptare të Arteve dhe Shkencave dhe presidenti i parë i saj.

¹Ksenofon Krisafi, *Lufta e Kosovës në labirintet diplomatike*, UMSH Press& ONUFRI, Tiranë, 2018 dhe Ksenofon Krisafi, *Në Gjenevë për Kosovën (1998-2002)*, UMSH Press& ONUFRI, Tiranë, 2018.

evidentuar shkurtimisht rolin e diplomacisë shqiptare për lirinë e Kosovës.

1. Në mbarim të dhjetëvjeçarit të fundit të shekullit të kaluar, çështja e Kosovës mori përmasa gati globale dhe u shndërrua në një temë me rëndësi e instancave botërore. Në atë kohë edhe politika dhe diplomacia shqiptare, të cilat merreshin vazhdimisht me ndjekjen e saj, intensifikuan dhe institucionalizuan bashkëpunimin me vendet e tjera si dhe me organizatat ndërkombëtare kompetente. Synimi ishte koordinimi sa më i mirë i përpjekjeve, nismave dhe aksioneve në dobi të trajtimit dhe zgjidhjes së suksesshme të së ardhmes së Kosovës.

Shqipëria e ka vuajtur gjithë kohën shkëputjen e dhunshme të Kosovës dhe trojeve të tjera shqiptare prej trungut të saj amtar, për shkak të vendimeve të diplomacisë së Fuqive të Mëdha në vitin 1913. Politika ndërkombëtare vendosi t'i muroste ato si kurban në altarin e paqes evropiane, siç u shpreh Eduard Grey, në mbarim të Konferencës së Londrës.² Megjithatë, Shqipëria nuk i ka reshtur asnjëherë përpjekjet politike e diplomatike për ta korrigjuar këtë padrejtësi. Ndryshimi i përkatësisë shtetërore, statusit juridiko-ndërkombëtar dhe të ardhmes së tyre, u shndërrua në preokupimin themelor të të gjithë shqiptarëve dhe të qeverive që ata kanë pasur në krye.

Edhe pse të ndarë juridikisht kundër dëshirës së tyre, shqiptarët, brenda dhe jashtë kufijve etnikë, gjatë gjithë kohërave janë ndjerë një komb, me përkatësi etnike, gjuhësore, me doke dhe zakone të njëjta. Lidhja e Prizrenit është një nga dëshmitë më të

²Grey, Edward,- Speeches on foreign affairs, London 1913, f. 212. Citohet nga Krisafi, Ksenofon (2014), Organizimi politik në trojet shqiptare, f. 90.

jashtëzakonshme, kur nga Arta dhe Preveza, deri në Ulqin e Kotor, nga Vlora e Durrësi, deri në Shkup e Vardar, ndjeheshin dhe shfaqeshin, siç ishin, një popull e një komb dhe donin të bëheshin një shtet, siç u bënë Italia dhe Gjermania pas përfundimit të procesit të unifikimit të tyre kombëtar, në vitet ‘70-të të shekullit XIX.

Kosova është konsideruar gjithmonë pjesë e natyrshme, shumë e rëndësishme e trungut etnik shqiptar. Filozofia dhe konceptet themelore të rilindësve të mëdhenj: AbdylFrashëri, Sami Frashëri, Pashko Vasa, SulejmanVokshi, Ymer Prizreni etj., projektues, drejtues dhe ideologë të së ardhmes politike të Shqipërisë, sikurse edhe themeluesit të shtetit të parë modern shqiptar, IsmailQemalit, përshkoheshin nga ideja se Shqipëria do të ishte shteti që do të përfshinte territoret dhe popullsinë shqiptare të katër vilajeteve osmane të hapësirës ballkanike. Në koherencë me këtë frymë, Kosova dhe trojet e tjera etnike shqiptare do të mbeteshin kurdoherë pjesë e padiskutueshme e politikës së jashtme të çdo qeverie të shtetit shqiptar, pas 28 nëntorit 1912. Çlirimi i saj nga zgjedha e huaj dhe bashkimi me trungun e shtetit amë ishte prioritet i tyre. Qeveria e përkohshme e Vlorës, e ngriti fort zërin në mbështetje të Kosovës në Konferencën e Londrës (1912-1913). Ajo do ta sanksiononte atë si çështje themelore të strategjisë së politikës së saj të jashtme, në vitet 1913-1914. Kosova do të mbetej një ndër angazhimet e përpjekjeve të delegacioneve shqiptare në Konferencën e Paqes në Versajë, në vitet 1919-1920, në Lidhjen e Kombeve, 1920-1939, në mbarim të Luftës së Dytë Botërore, si dhe në programet e qeverive të mëvonshme shqiptare. Ato nuk pushuan asnjëherë së denoncuari politikën shfarosëse dhe asimiluese të Beogradit të realizuar nëpërmjet politikave të gjenocidit, asimilimit dhe shpërnguljeve masive të

shqiptarëve në Turqi, në zbatim të platformës strategjike antishqiptare të Vasa Çubrilloviqit. Edhe gjatë dhe pas Luftës së Dytë Botërore, qeveritë shqiptare vazhduan të kërkonin nga udhëheqja e Beogradit zbatimin e parimeve të rëndësishme ndërkombëtare për të drejtën e vetëvendosjes deri në shkëputje të popullit shqiptar që kishte mbetur në ish-Jugosllavi. Më pas vijnë deklaratimet e fuqishme dhe veprimet e politikës së Tiranës, në mbështetje të demonstratave të vitit 1968 dhe sidomos të 1981.

Në vitet 1990 dhe 1991, drejtuesi i shtetit shqiptar, Ramiz Alia, do të takonte në fshehtësi, në selinë e Presidencës, përfaqësues të lëvizjes kosovare. Në një dokument që ka fiksuar disa nga çështjet e diskutuara dhe vendimet e miratuara në atë takim, thuhet se shteti shqiptar do të mbështeste veprimtarinë politike e ushtarake të grupeve të rezistencës. Për këtë qëllim ai ngriti struktura të posaçme.³ Erdhi në vijim përkrahja e pakufishme dhe e pamohueshme e Shqipërisë ndaj luftës heroike të UÇK-së. Është një e vërtetë e pamohueshme se, pavarësisht nga regjimet dhe qeveritë që janë alternuar kohë pas kohe në Shqipëri, politika shqiptare e ka pasur Kosovën kurdoherë në qendër të vëmendjes. Në vitet '80-'90 të shekullit të kaluar, një varg zhvillimesh politike, të brendshme e të jashtme, krijuan mundësitë që Shqipëria të vihej pa asnjë rezervë në mbrojtje të Kosovës. Pas rënies së sistemit monist, e çliruar nga vargojtë e dikurshëm politikë dhe ideologjikë, ajo i kishte tashmë mundësitë që të ndërhynte më lirshëm, në përmasa të shumëfishuara në kancelaritë e shteteve tjera, veçanërisht të Fuqive të Mëdha, protagoniste të politikës botërore.

Kur serbët dëbuan nga vatrat amtare dhjetëra e qindra mijëra njerëz, Shqipëria u çeli atyre dyert e shtëpive dhe të zemrave dhe, kur

³UDB-ja këmbëkryq në Tiranë, në gazetën *Dita*, June 3, 2019.

NATO ndërhyri në Kosovë dhe ish-Jugosllavi, ajo vuri në dispozicion portet, aeroportet, rrugët dhe gjithçka nga infrastruktura e saj. Hapi kufijtë për luftëtarët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, duke i trajtuar ata, ashtu siç ishin, si trima dhe heronj që i kishin vënë vetes një detyrë sublimë, çlirimin e atdheut.

Në vlerësim të përpjekjeve dhe kontributeve të Shqipërisë është pohuar se “kushdo që mund të ketë menduar se çështja shqiptare në Kosovë mund të zgjidhej pa Shqipërinë do të ishte jo vetëm i gabuar, por edhe i papërgjegjshëm. Nuk ishte thjeshtë shteti amë, por edhe e vetmja mundësi për të lëvizur, për të siguruar një mbështetje, politike, logjistike dhe në diplomacinë ndërkombëtare, do të ishte prapavija e saj, që shumë thjeshtë mund të shndërrohej në vijën e parë, si edhe ndodhi”.⁴

Në optikën juridike në kuadrin e kontributeve të shërbim të çështjes kombëtare, duhet përmendur hapi i rëndësishëm, i ndërmarrë nëpërmjet Kushtetutës shqiptare të vitit 1998. Ajo konsakroi shprehimisht “aspiratën shekullore të popullit shqiptar për identitetin dhe bashkimin kombëtar”, mbrojtjen e të drejtave “kombëtare të popullit shqiptar që jeton jashtë kufijve...”.⁵ Në përmbushje të këtij detyrimi sublim shpirtëror, kombëtar e konstitucional, qeveritë shqiptare të fundviteve ‘90-ta të shekullit të kaluar dhe fillimit të shekullit tonë, që ndiqnin me preokupim të veçantë zhvillimet dramatike në Kosovë, simptomat e të cilave paralajmëronin befasi me pasoja të paparashikuara, nuk i pushuan përpjekjet për të sensibilizuar opinionin e gjerë publik botëror si dhe për të vënë në lëvizje organizatat dhe institucionet ndërkombëtare.

⁴*Po aty.*

⁵ Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, Tiranë, 2017, f. 7, 11.

2. Diplomacia shqiptare ishte e pranishme dhe aktive sidomos në veprimtaritë që zhvilloheshin në OKB - në Nju Jork e në Gjenevë, në Komisariatit e Lartë të Kombeve të Bashkuara për Refugjatët (UNHCR), në Organizatën Ndërkombëtare të Migracionit (IMO), Organizatën Botërore të Shëndetësisë (WHO), Programin e Kombeve të Bashkuara për Mjedisin (UNEP), Komitetin Ndërkombëtar të Kryqit të Kuq (CICR), Organizatën për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSCE) etj., në NATO, KIE, BE etj. Aty, gjatë viteve 1998-2002, kur dhuna serbe në Kosovë shpërtheu tej çdo kufiri⁶, presidentët, kryeministrat, zëvendëskryeministrat, ministrat e punëve të jashtme, ambasadorët dhe diplomatët shqiptarë, përpiqeshin të sensibilizonin diplomacinë botërore, duke ekspozuar me fakte e prova realitetet që zhvilloheshin në Kosovë. Vëllezërve dhe motrave të tyre të përtej kufirit do t'iu dilnin në mbrojtje delegacionet shqiptare gjatë qindra fjalimeve, deklaratave dhe ndërhyrjeve në veprimtaritë e organizatave të mësipërme ndërkombëtare. Ata kërkonin me këmbëngulje ndërhyrjen e menjëhershme të faktorit ndërkombëtar për ndalimin e dhunës dhe zgjidhjen e menjëhershme të situatave.

Në pajtim me formulimet e përcaktuara nga diplomacia e Aleatëve të Mëdhenj, qeveria shqiptare ngulmonte që shqiptarëve të Kosovës, sikurse gjithë shqiptarëve në trojet e tyre jashtë kufijve të

⁶Agresionit serb iu kundërvu rezistenca e gjithë popullit të Kosovës dhe lufta e UÇK-së, ku u rreshtuan edhe 148 oficerë e ish-oficerë të Ushtrisë shqiptare dhe mjaft të rinj nga Shqipëria, 31 prej të cilëve ranë në frontin e luftës për lirinë e Kosovës. Të dhënat jepen sipas DilaverGoxhaj, i cili ishte një ndër oficerët shqiptarë që, së bashku me të birin dhe dhjetëra të tjerë, lanë familjet dhe punët në Tiranë, për t'u bashkuar me UÇK-në. Z. Goxhaj, i njohur me pseudonimin Shpëtim Golemi, mori pjesë në luftën e Kosovës, duke mbajtur funksionin e zëvendëssefit të Shtabit të Përgjithshëm.

shtetit shqiptar, t'iu garantoheshin të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, të sanksionuara në kartat e mëdha të së drejtës ndërkombëtare, që ata të shpëtoheshin nga masakrat e politikës së Beogradit, të konsideroheshin dhe të trajtoheshin si gjithë shtetasit e ish-Jugosllavisë. Në këtë kuadër mbështeti pa rezervë kërkesat e tyre për vetëvendosje deri në shkëputje nga ish-Jugosllavia. Në vijim, kur u poqën kushtet e brendshme e të jashtme për krijimin e shtetit të pavarur të Kosovës, si një nga zgjidhjet më të natyrshme, më të qëndrueshme e më të pranueshme, përveç alternativës tjetër asaj të bashkimit me Shqipërinë, ajo e përkrahu atë pa hezitim edhe pse në Tiranë pati ndonjë drejtues të forcave të caktuara politike, që insistoi që Kosova të kënaqej me të ashtuquajturën autonomi substanciale. Përfaqësuesit e Shqipërisë ishin të pranishëm kudo ku diplomacia mund merrte vlerë dhe mund të shfaqej si faktor në dobi të Kosovës.

Shumica dërmuese e veprimtarive, ku diplomacia botërore në Gjenevë diskutonte për Kosovën, zhvillohej në organet dhe organizmat e OKB, kryesisht në Pallatin e Kombeve, një ndër tempujt e diplomacisë botërore të periudhës së para dhe pas Luftës së Dytë Botërore. Pallati i Kombeve, ky “dëshmitar i heshtur dhe hijerëndë”, ku ishin projektuar skenarë të ngjarjeve të rëndësishme për fatet e popujve të botës, përfaqësonte arenën gjigante virtuale të kacafytjeve diplomatike, polemikave, shqiptimit të mijëra fjalimeve, deklaratave, zhvillimit të debateve dhe arritjes së kompromiseve, vendin ku ishin diskutuar e nënshkruar qindra traktate e konventa ndërkombëtare. Aty, në mjediset e tij të panumërta, gjatë viteve 1998-2002, do të përmendej me mijëra e ndoshta dhjetëra mijëra herë emri i Kosovës, Shqipërisë dhe shqiptarëve, gjatë debateve që zhvilloheshin në kërkim të zgjidhjeve të përshtatshme.

3. Gjeneva është një prej qendrave më të rëndësishme të politikës, diplomacisë dhe shërbimeve inteligjente botërore, ku haptas ose nëpër kulisat e fshehta agjenturore, u zhvilluan veprimtari që patën ndikimet e veta në ngjarjet e Kosovës.

Çështja e Kosovës, e shndërruar në ato kohë në një prej pikave kryesore të rendit të ditës së punimeve të organizatave ndërkombëtare të Gjenevës, zuri një pjesë të konsiderueshme të angazhimeve dhe të veprimtarive diplomatike të misionit shqiptar. Si pjesë e tij, i ndodhur në kohën dhe në vendin e duhur, pata rastin dhe përgjegjësinë, që ta përjetoja nga afër atë periudhë të luftës heroike e të lavdishme të shqiptarëve të Kosovës. Shërbimi im diplomatik në Gjenevë iu përkushtua asaj në një masë të madhe, aq sa shpesh disa nga kolegët e huaj më drejtoheshin në mënyrë figurative “ambasadori i Kosovës”.

4. Në dekadat përmbyllëse të shekullit të kaluar betejat diplomatike për Kosovën morën përhapje dhe zhvillime me përmasa cilësore. Për dëbimin e të gjitha forcave ushtarake, policore, gjyqësore, administratës dhe gjithçkaje të importuar ose të ngritur nga pushteti serb, për shpëtimin dhe lirinë e saj, për afirmimin e vazhdueshëm ndërkombëtar të çështjes së madhe kombëtare të popullit të Kosovës, vepronte ish-presidenti Rugova, luftonte me heroizëm UÇK-ja, kontribuonte gjithë faktori shqiptar brenda e jashtë saj, bombardonin avionët e NATO-s për paralizimin e fuqisë ushtarake të Beogradit, punonte intensivisht diplomacia botërore. Ishte gjithashtu në këmbë, i angazhuar maksimalisht në frontet politike, diplomatike etj. shteti shqiptar me të gjitha strukturat e veta përkatëse. Në vijën e parë të frontit politik ndërkombëtar, atje ku nuk luftohej me avionë, raketa e artileri, por me veprimtari të dëndur

diplomatiqe, me debat të fuqishëm institucional dhe me argumente politike e juridike, gjendej e rreshtuar edhe diplomacia shqiptare.

Aty nga mesi i vitit 1998, situatat në kufirin shqiptaro-kosovar dhe marrëdhëniet ndërmjet Shqipërisë dhe ish-Jugosllavisë, po shkonin me shpejtësi drejt acarimit të skajshëm. Për këtë arsye, më 22 qershor 1998, ish-kryeministri Fatos Nano, deklaronte se vendi i vet ishte “në prapun e një lufte” me Serbinë dhe i kërkonte NATO-s ndërhyrjen e saj në krizën kosovare. Ai u shpreh zyrtarisht në favor të ruajtjes së lidhjeve ndërmjet grupeve politike shqiptare dhe grupeve të armatosura në Kosovë.⁷ Më 18 dhe 19 korrik 1998, në kufirin shqiptaro-jugosllav pati luftime të ashpra ndërmjet Ushtrisë Federale jugosllave dhe luftëtarëve të UÇK, gjatë të cilave u vranë rreth njëqind vetë. Predhat e obusëve jugosllavë ranë edhe në territorin e shtetit shqiptar. Tirana e akuzoi Jugosllavinë për “kërcënim të integritetit dhe sovranitetit” të Shqipërisë, duke deklaruar se operacionet serbe, që përbëjnë një agresion fashist të Beogradit, kundër popullsisë shqiptare në Kosovë, synojnë ta përfshijnë Shqipërinë në një konflikt rajonal shumë të rrezikshëm. Por ajo nuk nguronte të theksonte se ishte gati dhe e aftë ta ruante integritetin e saj territorial.⁸

Pas ndërhyrjesh të paprera në forumet e OKB-së dhe të organizatave të tjera, në seancën plenare të 2 tetorit 1998, të sesionit të zakonshëm të Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së, ministri i Jashtëm shqiptar, Paskal Milo, e vlerësoi gjendjen në Kosovë tepër të rëndë dhe të rrezikshme. Ai deklaroi se: “... Millosheviqi ka urdhëruar në fakt zbatimin e një politike të spastrimit etnik kundër shqiptarëve...

⁷*La crise en Kosove et ses conséquences en Albanie*, Reuters, 22.6.1998.

⁸*Po aty*, (AFP 18.6.1999, 20.7.1999).

Qeveria shqiptare dënon me vendosmëri këtë politikë dhe deklaroi haptas se Millosheviqi duhet të përgjigjet për krimin e gjenocidit. Ne kërkojmë me ngut krijimin e mekanizmave të kontrollit dhe të ndihmës nga ana e bashkësisë ndërkombëtare në Kosovë dhe ndërhyrjen e menjëhershme ushtarake nga ana e NATO-s...”.⁹

Muaj më vonë, ish-presidenti shqiptar Rexhep Meidani, gjatë një vizite zyrtare në Paris, propozoi hartimin dhe zbatimin e një *Plani Marshall* për rajonin e Ballkanit. Ai foli edhe për nevojën e një ndihme ekonomike që Bashkimi Evropian duhet t’i akordonte Shqipërisë për të kapërcyer vështirësitë dhe për t’iu rikthyer zhvillimit, siç shprehej në atë kohë presidenti francez, ZhakShirak (JacquesChirac). Ai vlerësoi “fisnikërinë e jashtëzakonshme” të Shqipërisë, në pritjen e 360 000 refugjatëve kosovarë, të dëbuar si bagëti nga trupat serbe. Shiraku theksonte vendosmërinë e vendeve të NATO-s për të vazhduar sulmet ajrore ndaj forcave të represionit serb deri në nënshkrimin e një marrëveshjeje politike”. Theksonte se ishte koha që drejtuesit e Beogradit t’i riktheheshin arsyes.¹⁰ Meidani, duke pasur parasysh idetë e Shirakut, përsëriti se autoritetet shqiptare ishin

⁹ *Communiqué de Presse*, AG/809 , 2 octobre 1998, Assemblée générale, Plénière, L’Albanie demande l’intervention militaire de l’OTAN au Kosovo et la mise en accusation de Milosevic pour crimes de guerre, 1998/ 10/ 02. Në fillim të fjalës së vet, ministri i Punëve të Jashtme, Paskal Milo, përshkroi situatën e rënduar të ngjarjeve të dhunshme në shtatorin e vitit 1998 në Shqipëri gjatë përpjekjeve për grusht shtet, duke thënë se “ka tre javë që Shqipëria gjendet në qendër të vëmendjes së bashkësisë ndërkombëtare për shkak të ngjarjeve të dhunshme që synojnë të përmbysin institucionet e brishta demokratike. Ne kemi vlerësuar gjerësisht dhe falënderojmë bashkësinë ndërkombëtare për mbështetjen që na dha në këto kohë të vështira”. AMPJ, Fondi i OKB, Misioni Gjenevë, Dosja e vitit 1998. 10AP 27

¹⁰ AP 27.4.1999.

në kontakte të rregullta me UÇK-në dhe shprehu dëshirën që Aleanca Atlantike ta ndihmonte atë në luftën kundër forcave serbe.¹¹

Në fjalën e mbajtur, më 28 maj 1999, në Parlamentin Evropian, në Strasburg, ai u shpreh se lufta e re në Ballkan nuk është “një luftë ndërmjet dy shteteve, ndërmjet dy etnive, por një konflikt ndërmjet dy mentaliteteve,... një luftë ndërmjet politikës së spastrimit etnik nga njëra anë dhe demokracisë, respektit të të drejtave të njeriut dhe të drejtave politike nga ana tjetër. Hodhi poshtë akuzat e propagandës serbe, e cila pretendonte se Shqipëria kërkonte ta përfshinte Kosovën në një “Shqipëri të Madhe”.¹²

Ndërkohë, teksa zhvillohej Konferenca e Rambujesë, Qeveria shqiptare kishte dërguar në Paris një ekip politikanësh dhe studiuesish të shquar, që nëse do të ishte nevoja, të asistonin delegacionin e Kosovës me këshilla ose materiale. Në krye të këtij grupi ndodhej ish-ministri i Jashtëm, historiani Paskal Milo dhe ish-zëvendësministri i Jashtëm, historiani tjetër Pëllumb Xhufi.

Punimet e Rambujesë dhe veprimtarinë e delegacionit të Kosovës i ndiqte me vëmendje të posaçme dhe me shqetësim të jashtëzakonshëm shkrimtari i madh Ismail Kadare. Në momentet vendimtare të zhvillimeve të Konferencës ai iu drejtua anëtarëve të delegacionit duke i këshilluar me një gjuhë të karakterizuar nga shqetësimi i sinqertë, qartësia shembullore dhe konsekuenca logjike e pakontestueshme.¹³ Veproi pikërisht atëherë kur duhej përcaktuar me maturi, atdhetarizëm dhe largpamësi qëndrimi që duhej mbajtur. Pati

¹¹*Po aty*, AP 27.4.1999, 28.4.1999, *Le Monde* 28.4.1999.

¹²AP 27.4.1999. AP 27.4.1999, 28.4.1999, *Le Monde* 28.4.1999.

¹³*Courrier International*, Paris, 24 shkurt 1999, përmbledhur në librin Kadare, Ismail, - *Mbi krimin në Ballkan*, Shtëpia botuese: Onufri, - maj 2011.

sërish drejtues të forcave të caktuara politike, që u përpoqën me çdo kusht ta intimidonin dhe ta kërcënonin delegacionin e Kosovës që të mos dëgjonte këshillat e SHBA-së dhe të BE-së dhe të mos e nënshkruante marrëveshjen e Rambujesë. Insistuan vazhdimisht, deri në çastet e fundit, duke u shprehur se ata që do të hidhnin firmat mbi atë dokument ishin tradhtarë.¹⁴ Shqiptarët e shpërfillën këtë “këshillë” ultimative dhe djallëzore. Patën urtësinë dhe maturitetin politik t’i besonin diplomacisë euro-atlantike dhe fjalëve të Ismail Kadaresë dhe në ceremoninë e organizuar në qendrën Kleber, në Paris, më 19 mars 1999, nënshkruan marrëveshjen e Rambujesë. Me firmën e tyre mbi tekstin e marrëveshjes i bënë vendit shërbimin më të madh, e kthyen Rambujenë në preludin e pavarësisë dhe tërhoqën mbi vete bekime dhe vlerësime pozitive për kurajën dhe pjekurinë e treguar. Negociatat dhe nënshkrimi i marrëveshjes i hapën rrugën zyrtarizmit juridik të lirisë dhe më tej pavarësisë së Kosovës.

Drejtuesit e faktorëve politikë të Kosovës u bashkuan në ato ditë në Rambuje, pritën me konsideratë gjithashtu asistencën e vazhdueshme dhe të kualifikuar, të ofruar me përkushtim e preokupim nga Qeveria shqiptare nëpërmjet delegacionit të saj në Paris. Vlerësuan këshillat për gjetjen e zgjidhjeve optimale, që vinin nga rekomandimet e Uashingtonit, Brukselit dhe shteteve të tjera aleate.

5. Për strukturat kompetente të shtetit shqiptar, përfshirë edhe misionin e tij diplomatik në Gjenevë, ky ishte një angazhim i rëndësishëm, delikat, i jashtëzakonshëm dhe voluminoz. Ne,

¹⁴Halili, Përparim - *Marrëveshja e Rambujesë, si luajti Sali Berisha misionin në interes të serbëve dhe i cilësoi tradhtarë ata që do të firmosnin Pavarësinë e Kosovës*, Gazeta Sot, 03.08.2013.

diplomatët e Shqipërisë, që rastësia na dha përgjegjësinë dhe privilegjin të shfaqeshim e të vepronim në dobi të çështjes së Kosovës, rendnim e trokisnim me ankth e shqetësim në kancelaritë diplomatike, në Gjenevë dhe në metropolet e tjera kryesore të globit, për të sensibilizuar forumet ndërkombëtare për ndërhyrje të vendosur dhe ndihmë të menjëhershme.

Aty në Gjenevë, si kudo në të gjitha qendrat e tjera të diplomacisë dy e shumëpalëshe, Shqipëria, i bënte thirrje faktorit ndërkombëtar për ta akuzuar Millosheviqin zyrtarisht si kriminel lufte dhe për t'ia kaluar gjykatave ndërkombëtare, për ta hetuar, gjykuar dhe dënuar, për krimet e kryera.

I mbushur me shqetësim e dhimbje të thellë nga aktet e shumta të kësaj tragjedie që luhej me fatet e vëllezërve tanë përtej kufirit, më 1 prill 1999, do t'i drejtohesha seancës plenare të Komisionit për të Drejtat e Njeriut, aktualisht Këshilli i të Drejtave të Njeriut (KDNJ), në atë që u quajt *Debat special për Kosovën*, duke thënë ndër të tjera se:

“Ajo që po ndodh sot në Kosovë nuk është një episod i izoluar dhe as i rastit. Është vazhdim i një politike konstante dhe i përpjekjeve të dështuara të Beogradit për të realizuar ëndrrën shekullore të qarqeve shoviniste serbe, spastrimin etnik në Kosovë. Është një nga aktet më të rënda në historinë e popullit shqiptar të Kosovës, i cili që prej gjysmës së dytë të shekullit të kaluar ka qenë sistematikisht viktimë e shovinizmit serb...”¹⁵

¹⁵ Deklaratë e bërë nga z. Ksenofon Krisafi, kryetar i delegacionit shqiptar në debatin e posaçëm mbi Kosovën, të organizuar në KDNJ, në Gjenevë, më 1 prill 1999. AMPJ, Fondi OKB, Misioni Gjenevë, Dosja e vitit 1999. Ksenofon Krisafi,

Të ndikuar nga zhvillimet tragjike në Kosovë, rastiste që fjalimet dhe deklarinimet tona të para 20 vjetëve, të ishin disi të forta. Në disa prej tyre dallohen ndjenja të fuqishme dhe formulime jo aq të zakonshme, për ligjërimin, gjuhën e drunjtë dhe stilin diplomatik të të shprehurit në forume të kësaj natyre. Shkaku ka të bëjë me faktin që pasazhe të caktuara janë përshkrime të situatave të ngarkuara emocionale, të përjetuara nën ndikimin e zhvillimeve rrëqethëse në Kosovë. Lajmet nga Kosova, tregimet e dhimbshme të vëllezërve dhe motrave kosovare që vinin në mjediset e misionit shqiptar në Gjenevë, komentet, njoftimet e mediave dhe dokumentet e forumeve ndërkombëtare, krijojnë një atmosferë që shtonte shqetësimin dhe përgjegjësitë institucionale. Edhe pse të “veshur me kostumin” e diplomatit, ishte e vështirë, në mos e pamundur, që ato të mposhteshin dhe të dominoheshin në mënyrë të mjaftueshme. Prandaj, në tribunat ndërkombëtare të Gjenevës, deklarinimet janë formuluar dhe janë shprehur siç janë ndjerë, përgjithësisht pa censurën rigoroze diplomatike, doemos pa përjashtuar kujdesin e nevojshëm institucional. Janë shqiptuar në një kohë kur në Kosovë kryheshin akte të tmerrshme të spastrimit etnik dhe gjenocidit të pashembullt. Kjo vihet në dukje edhe në fjalën e mbajtur në mbledhjen e KDNJ, në Gjenevë, më 20 korrik 1999, me cilësinë e kryetarit të delegacionit shqiptar. Aty vura në dukje se aventura e përgjakshme që regjimi fashist i Millosheviqit ka ndërmarrë kundër shqiptarëve të Kosovës që nga ardhja e tij në pushtet, ka zgjuar kujtimet dhe mitet e të kaluarës. Prej një shekulli një strategji permanente që përmban politikën mizore të vrasjeve, masakrave,

Në Gjenevë për Kosovën, Fjalime në institucionet ndërkombëtare (1998-2002), UMSH-Press, ONUFRI, Tiranë 2018, f. 29-31

reprezaljeve dhe deportimeve masive, helmon dhe përgjak marrëdhëniet ndërmjet grupeve etnike në Ballkan. Ishte bërë e qartë se në Kosovë, në zemër të Evropës, në vigjilje të mijëvjeçarit të tretë, po kryhej një nga krimet më të rënda kundër njerëzimit, po bëheshin ekzekutime dhe vrasje masive, masakra dhe barbari, trajtime çnjerëzore, përdhunime të grave dhe vajzave të reja kosovare, shpërngulje dhe dëbime të qindra mijëra kosovarëve, që morën format e një spastrimi etnik pothuajse total në Kosovë.¹⁶

6. Nuk kishte ditë, së paku gjatë periudhës së luftës, 1998 dhe 1999, por edhe në vitet të vazhdim, që në të gjithë arkitekturën institucionale ndërkombëtare të Gjenevës të mos flitej për Kosovën, që si asnjëherë tjetër më parë çështja e saj të mos shpalosej vazhdimisht dhe të mos mbetej gjatë në fokusin e saj.

Fjalimet dhe ndërhyrjet tona në forumet e Gjenevës duhen parë si dëshmi e shqetësimit të skajshëm, e kujdesit të përhershëm, e përkushtimit të madh dhe interesimit të vazhdueshëm për Kosovën, e shtetit shqiptar dhe e gjithë shqiptarëve kudo që ndodheshin, në trojet e tyre ose në mërgim, në Evropë e SHBA. Ata merrnin pjesë në dhimbjen e saj dhe përpiqeshin me sa mundeshin, për të kontribuar në realizimin e kauzës çlirimtare, shkëputjes nga zgjedha serbe. Ato janë gjithashtu dëshmi të kontributeve të shtetit shqiptar në fushën e diplomacisë.

¹⁶ Deklaratë e bërë nga z. Ksenofon Krisafi, kryetar i delegacionit shqiptar në mbledhjen e KDNJ, në Gjenevë, më 20 korrik 1999. AMPJ, Fondi OKB, Misioni Gjenevë, Dosja e vitit 1999. Ksenofon Krisafi, *Në Gjenevë për Kosovën, Fjalime në institucionet ndërkombëtare (1998-2002)*, UMSH-Press, ONUFRI, Tiranë 2018, f.42-44.

Ne vepronim në një konstelacion të caktuar institucional ndërkombëtar. Mozaiku politiko-etnik i strukturave të OKB-së, siç merret me mend lehtë, formohet nga një spektër shumëngjyrësh, i cili duhet mbajtur parasysh mirë në çdo ndërrhyrje që ndërmerret, në çdo fjalim që shqiptohet. Duhet llogaritur paraprakisht reagimi, kundërveprimi dhe qëndrimi që duhet mbajtur nga ana jonë në vijim. Gjithçka do të duhet të ishte llogaritur me kujdesin dhe saktësinë maksimale, që të mos lejohej asnjë gabim që mund të shkaktonte pasoja të dëmshme asimetrike. Në Gjenevë kishte përfaqësues shtetesh që, të porositur nga “qendra” e vet, i shtronin problemet dhe i mbanin qëndrimet në mënyrë objektive. Kishte të tjerë që, sërish sipas udhëzimeve që merrnin, flisnin me një gjuhë që shkelte mbi dhimbjen e një populli që përleshej e masakrohej përditë e përnatë me një armik mizor, siç ishin bandat serbe. Misioni do të duhet t’i ndiqte ato me kujdes dhe të gjente mundësitë për reagimin e duhur.

7. Diplomacia shqiptare vepronte si pjesë e faktorit ndërkombëtar, i cili punonte për krijimin e kushteve të nevojshme për normalizimin e gjendjes në Kosovë dhe në ish-Jugosllavi, për largimin nga drejtimi i vendit të Millosheviqit dhe ekipit të tij kriminal, që shpërtheu e zhvilloi luftën ndaj popujve të Jugosllavisë. Në kuadrin e fushatës së presioneve ndaj Beogradit, por edhe të afirmimit publik të qëndrimeve të Aleancës Perëndimore ndaj Millosheviqit, në atë kohë bëheshin deklarime të rëndësishme rreth vendosmërisë për t’i shkuar qëllimit deri në realizimin e objektivit final. Si shprehës i këtij qëndrimi, kancelari gjerman GerhardSchroder, në një fjalim drejtuar popullit të vet, deklaroi se “nuk do të ketë asnjë hezitim në vendosmërinë tonë për t’iu dhënë fund vrasjeve në Kosovë”. Vetëm

forca mund ta ndalojë Millosheviqin në plotësimin e operacionit të tij famëkeq “Patkoi”, për spastrimin e Kosovës nga shqiptarët dhe realizimin e ëndrrës së tij për Serbinë e Madhe.¹⁷ Në ato kohë, Joshka Fisher, njoftonte se Këshilli i BE-së, kishte miratuar unanimisht në Berlin një Rezolutë, me të cilën shprehej përkrahja pa rezervë e bombardimeve të NATO-s.¹⁸ Marc Weller duke analizuar këtë fazë të re të reagimit ndërkombëtar në Kosovë, që kishte çuar te Plani i Paqes G-8, i 6 majit dhe Rezoluta 1244 e Këshillit të Sigurimit të OKB, e datës 10 qershor 1999, del në konkluzionin se, tashmë filloi një formë e re më e avancuar në politikën ndërkombëtare.¹⁹ Qëndrime të prera do të shprehnin në atë kohë edhe presidenti Klinton dhe Javier Solana, sekretari i përgjithshëm i NATO-s. Millosheviqi, tashmë pa asnjë shpresë se mund të vazhdonte ta mashtronte akoma bashkësinë ndërkombëtare, u shpreh për zgjidhje nëpërmjet një “procesi politik”.

UÇK-ja, e deziluzionuar nga përvoja negative e së kaluarës në marrëdhëniet me Beogradin, e hodhi poshtë planin e 6 majit të G-8, për negocimin e krizës, sepse, sipas saj, marrëveshja e G-8 “nuk garantonte një zgjidhje të qëndrueshme të problemit as edhe përfundimin e tragjedisë në Kosovë”. Zëdhënësi i UÇK-së në Tiranë, deklaroi se shumë nga pikat e tekstit të G-8, ishin të papranueshme.

Ato ditë na mbërriti në Gjenevë njoftimi se Qeveria shqiptare i kishte kërkuar faktorit ndërkombëtar që, ndryshe nga sa parashikonte plani i G-8, “ta armatoste UÇK-në dhe jo ta çarmatoste atë”, lajm ky

¹⁷Toni Blair, *Për shqiptarët*, “ALBPAPER”, Tiranë, 2005: 7.

¹⁸Fischer Joschka, *Vitet kuq-gjelbër*, Koha, Prishtinë, 2008: 161.

¹⁹Weller Marc, *Shtetësia e kontestuar*, Koha, Prishtinë, 2009:35.

që u publikua ato ditë edhe në gazetën *Le Monde*.²⁰ Kjo na dha një argument tjetër të fuqishëm për ta përdorur në takimet me kolegët e vendeve të tjera dhe me titullarët e organizatave ndërkombëtare të Gjenevës si dhe ta trajtonim, kur ishte rasti, në fjalimet ose ndërhyrjet tona gjatë punimeve të tyre.

8. Kontributet dhe veprimtaritë mbështetëse të Fuqive të Mëdha, shteteve mike dhe organizatave ndërkombëtare, si dhe ndjenjat e simpatisë dhe të solidaritetit ndërkombëtar, vlerësoheshin me respekt maksimal, gati në çdo rast nga diplomacia dhe politika shqiptare, përfshirë edhe misionin në Gjenevë. Në fjalimin e mbajtur në emër të delegacionit shqiptar, në sesionin e 55 të zakonshëm të KDNJ, në Gjenevë, më 6 prill 1999²¹, deklarova ndër të tjera se “barbaritë serbe tërhoqën vëmendjen e mbarë opinionit ndërkombëtar, i cili me të drejtë kërkonte dhe kërkon ndaljen e dhunës. Shumë përpjekje u bënë nga bashkësia ndërkombëtare, përfshirë edhe thirrjet e rezolutat e shumta të miratuara nga ky Komision. Për fat të keq, ato ranë në veshin e shurdhër të Beogradit. S’mbeti gjë tjetër veç rrugës së forcës për ta detyruar atë që të ulej në tryezën e bisedimeve. Goditjet që NATO ndërmori kundër objektivave ushtarake serbe janë një veprim i bazuar mbi vlerat themelore të demokracisë dhe mbi

²⁰ *Le Monde*, 07.05.1999, 08.05.1999.

²¹ Shih E/CN.4/1999/SR.18, page 3, 6, - Question of the violation of human rights and fundamental freedoms in any part of the world, on Tuesday, 6 April 1999, page 3, si dhe Deklaratë e z. Ksenofon Krisafi, ambasador i Republikës së Shqipërisë, pranë Zyrës së Kombeve të Bashkuara në Gjenevë, në emër të delegacionit shqiptar në sesionin e 55 të zakonshëm të Komisionit të të Drejtave të Njeriut, në mbledhjen e dt. 6 prill 1999. AMPJ, Fondi i OKB, Misioni Gjenevë, Dosja e vitit 1999. Ksenofon Krisafi, Në Gjenevë për Kosovën, Fjalime në institucionet ndërkombëtare (1998- 2002), UMSH-Press, ONUFRI, Tiranë 2018, f. 32-36. 32-36.

respektin e dinjitetit të qenies njerëzore. Kjo është përgjigja më e mirë që bota demokratike iu jep regjimeve gjakatare e pushtuese”.²²

Atyre që vinin pikëpyetje për legjitimitetin e ndërhyrjes së NATO-s në Kosovë, iu përgjigja, duke theksuar se “Nuk mund të mos ndjesh keqardhje kur dëgjon zëra që e paraqesin në mënyrë të gënjeshtër ndërhyrjen e NATO-s, e cila ishte bërë e domosdoshme për t’i dhënë fund planeve djallëzore të spastrimit etnik, të parashikuara prej shumë kohësh, të përpunuara dhe të zbatuara nga Millosheviqi kundër shqiptarëve në Kosovë. Ne do të dëshironim t’i kujtonim opinionit publik se këto zëra heshtën kur granatat serbe shkatërronin shtëpitë e shqiptarëve dhe falangat e Millosheviqit digjnin me zjarr gjithçka gjenin përpara, ata heshtën kur masakroheshin gratë dhe fëmijët kosovarë, heshtën kur shqiptarët largoheshin me qindra e me mijëra drejt maleve, pa ushqim e pa strehë, për t’i shpëtuar vdekjes, heshtën kur policia, ushtria serbe dhe bandat e neofashistit Arkan vrisnin shqiptarët për të vetmen arsye se ishin shqiptarë. Me të drejtë shtrohet pyetja, kush nga këta që sot luajnë rolin e avokatit në mbrojtje të Millosheviqit, foli në vitin 1989, kur Kosovës iu hoq autonomia, kur iu mbyllën shkollat dhe universiteti, radioja dhe televizioni, gazetatat, revistat dhe gjithë botimet e tjera në gjuhën shqipe? Kush e ngriti zërin kur Kosova iu nënshtrua për vite të tëra një regjimi të pashpirt të terrorit shtetëror? Si mund të tolerohet që një regjim gjakatar të mbajë peng një popull prej më shumë së dy milionë banorësh nën pretekstin absurd të domosdoshmërisë së respektimit të “sovrانيتit” të papërligjur? Paragjykimet e këtij zhvillimi dhe spekulimet false të kësaj natyre nuk mund dhe nuk duhen lejuar që t’i kundërvihen paqes, ligjit dhe

²²*Po aty.*

drejtësisë. Delegacioni shqiptar dënon ashpër regjimin e Millosheviqit dhe kërkon që ai dhe bashkëpunëtorët e tij t'i kalojnë Gjykatës Ndërkombëtare të Hagës për t'u gjykuar si kriminelë lufte. Ai kërkon gjithashtu që t'i njihet popullit të Kosovës e drejta e pamohueshme për të vendosur vetë për të ardhmen e tij, kundër pushtimit serb dhe kundër planeve për copëtimin dhe ndarjen e territorit të vet".²³

Në fjalën e mbajtur një ditë më pas, më 7 prill 1999, në mbledhjen e grupit të ambasadorëve të Organizatës së Konferencës së Vendeve Islamike, theksova se u bënë rreth 10 vjet që ky regjim sfidon me kokëfortësi bashkësinë botërore, shkel normat e së drejtës ndërkombëtare dhe parimet elementare të moralit njerëzor... Beogradi i shpërfilli përpjekjet e bashkësisë ndërkombëtare që synonin ta bindnin të ndalonte barbaritë ndaj kosovarëve. Ai refuzoi të pranonte të bisedonte për zgjidhjen paqësore, politike të çështjes, duke lënë si alternativën e vetme të mundshme rrugën e forcës. Goditjet e NATO-s ndaj objektivave ushtarake serbe janë konsideruar si një veprim i drejtë, i bazuar mbi parimet themelore dhe normat e së drejtës ndërkombëtare, mbi vlerat themelore të demokracisë, mbi domosdoshmërinë e respektit të dinjitetit të qenies njerëzore. Ato u cilësuan si përgjigja më e mirë e mundshme, që bota demokratike u jep regjimeve gjakatare. Vetëm kështu mund të mposhtet dhe dorëzohet Millosheviqi dhe vetëm kështu shqiptarët e Kosovës do të kenë mundësi të jetojnë si njerëz në trojet e tyre amtare. Është kjo arsyeja pse Qeveria shqiptare i mbështet ato pa asnjë rezervë... dhe falënderon bashkësinë ndërkombëtare... për ndihmën dhe përkrahjen vëllazërore politike e morale, që i kanë dhënë popullit martir kosovar. Spastrimi etnik, të cilin Beogradi dhe zëra të tjerë të vetmuar e lidhin

²³*Po aty.*

me sulmet e NATO-s, ka filluar prej kohësh dhe përbën një vijë politike të ideuar e zbatuar nga shovinistë të deklaruar të tipit Millosheviq, Sheshel, Drashković, Arkan etj.²⁴

Duke u rikthyer sërish te fjala e datës 20 korrik 1999, mbajtur në mbledhjen e KDNJ, vura në dukje se “në Kosovë, në zemër të Evropës, në vigjilje të mijëvjeçarit të tretë, po kryhej një nga krimet më të rënda kundër njerëzimit, po bëheshin ekzekutime dhe vrasje masive, masakra dhe barbari, trajtime mizore dhe çnjerëzore, përdhunime seksuale të grave dhe vajzave të reja kosovare, shpërngulje dhe dëbime të qindra mijëra kosovarëve, që morën format e një spastrimi etnik pothuajse total në Kosovë”.²⁵ Në vijim theksova se “me kapitullimin e regjimit serb dhe të Millosheviqit si rezultat i ndërhyrjes së forcave të NATO-s dhe në sajë të luftës heroike dhe gjakut të derdhur nga vajzat dhe djemtë e popullit të vet, të rreshtuar në radhët e UÇK-së, sot Kosova po merr frymë lirisht. Ajo po punon tani për të shëruar plagët e luftës dhe ato të shpirtit të vet, për t’u çliruar nga ndjesitë e revanshit dhe të hakmarrjes, çka nuk është e lehtë. Shqiptarët në përgjithësi dhe kosovarët në veçanti, në tërësinë e tyre janë një popull i qytetëruar, të cilët kanë dëshmuar që edhe pse nuk i harrojnë padrejtësitë, dinë të falin. Liderët e popullit kosovar kanë deklaruar shumë herë se janë kundër ikjes së serbëve të pafajshëm nga Kosova, kundër çdo akti dhune dhe hakmarrjeje ndaj tyre dhe se ata do të marrin çdo masë të nevojshme për t’iu garantuar të gjithëve respektimin e të drejtave të veta”.²⁶

²⁴*Po aty*, f. 37-39.

²⁵*Po aty*, f. 42-44.

²⁶*Po aty*.

Duke e marrë fjalën në punimet e sesionit të 50 të Komitetit Ekzekutiv të UNHCR, më 6 tetor 1999, vura në dukje se është e sigurt që ndonjë akt sporadik dhune, i vërtetuar në ndonjë rajon të Kosovës, nuk pajtohet me ndërgjegjen kolektive paqësore të popullit të Kosovës. Si të tilla janë dënuar nga opinioni i gjerë kosovar dhe liderët politikë të shqiptarëve të Kosovës. Por, dua gjithashtu të theksoj faktin se autorët e këtyre akteve jo gjithmonë janë identifikuar. Ata mund të jenë fare mirë edhe agjentë të Millosheviqit, i cili përpiket me çdo kusht të kultivojë farën e urrejtjes etnike e racore dhe të sabotojë përpjekjet e komunitetit ndërkombëtar në Kosovë për qetësimin e situatës dhe krijimin e kushteve të nevojshme për një jetë normale. Është një fakt i njohur që popullsia serbe në Kosovë në një shumicë dërmuese përqafoi gjerësisht platformën e spastrimit etnik ndaj shqiptarëve, megjithatë çdo gjykim globalist është i gabuar, sepse, siç dihet, përgjegjësia është individuale dhe ajo duhet vërtetuar. Prandaj është imperative të shpejtohet puna për të nxjerrë para gjyqit ata që i kanë lyer duart me gjak. Vënia e fajtorëve para drejtësisë do të kontribuojë për të qetësuar përfundimisht shpirtrat e trazuar të shqiptarëve nga dhimbja e madhe që iu shkaktonte mungesa e njerëzve të tyre të masakruar nga okupatorët serbë. Kjo do të kontribuojë me siguri edhe për të qartësuar dhe lehtësuar pozitën e grupeve etnike serbe apo rome në Kosovë.²⁷

Në sesionin e 20 të Këshillit Administrativ të UNEP-it, vura në dukje se “duke folur për ndotjen e mjedisit natyror e gjeografik në Kosovë e përreth saj, nuk mund të mos përmendim edhe një lloj tjetër ndotjeje, që vështirë se rimëkëmbet me fonde financiare apo edhe me mjete materiale. Është fjala për ndotjen masive të shkaktuar aty nga

²⁷*Po aty*, f. 69-72.

kufomat e mijëra njerëzve të pafajshëm, të pushkatuar e të masakruar barbarisht nga ushtria, policia serbe dhe forcat e bandave fashiste të kriminelit Arkan. Siç po bëhet e njohur nga zbulimet që dalin në dritë përditë, një pjesë e tyre janë mbuluar nëpër varre masive, ku janë gjetur ndër të tjerë edhe nëna me fëmijë në gji e foshnja me biberonë në gojë, një pjesë janë lënë rrugëve e përrenjve, të tjerë janë djegur nëpër krematoriume të sajura në shkretoret e Trepçës, kurse pjesa tjetër janë hedhur nëpër pusët e ujit. Kuptohet, kjo është një ndotje *suigeneris*, e cila, më tepër se gjithçka ka ndotur dhe helmuar rënd marrëdhëniet midis shqiptarëve dhe etnive të ndryshme në Kosovë. Për pastrimin e saj do të duhet punë e përpjekje të sinkerta. Për sa u përket shqiptarëve ata kanë mbi një shekull që dëshmojnë se dinë të falin dhe se janë të gatshëm të punojnë për një mjedis ndëretnik të pastër, por duhet pasur parasysh se nuk mund t’iu kërkohet të harrojnë se ç’kanë hequr e ç’ka ndodhur me ta. Sidoqoftë interesat e të ardhmes së tërë popujve të gadishullit imponojnë që të punohet seriozisht e sinqerisht për një mjedis të pastër jo vetëm nga pikëpamja natyrore, jo vetëm nga pasojat e luftimeve e të bombave, por edhe nga pikëpamja shoqërore ndëretnike”.²⁸

9. Në forumet e Gjenevës, nuk ishte e lehtë të përballohej ngarkesa e madhe dhe intensive që mbushte hapësirën e çdo dite. Aty kishte edhe raste kur duhej përplasur dhe ndeshur me personalitete ose personazhe me emra të përveçëm, shfaqja e të cilëve në podiumet e sallave të Pallatit të Kombeve, shkaktonte a priori impresione të caktuara. Patëm rast të ndeshemi aty me ish-presidentin e ndjerë të ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë, Boris Trajkovski,²⁹ ose me

²⁸*Po aty*, f. 106-108.

²⁹*Po aty*, f. 62-63.

ish të dërguarin special - raportuesin e posaçëm të sekretarit të përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut në ish-Jugosllavi, të ndjerin Jiri Dienstbier etj. Në fjalën e mbajtur më 30 mars 2000, në sesionin e 56 të KDNJ, për raportin e Dienstbier, të cilën mendoj ta sjell këtu disi më gjatë, theksova se “nuk mund të mos shfaqim habinë dhe keqardhjen tonë për përmbajtjen e politizuar të raportimit të raportuesit të posaçëm, të datës 28 mars të këtij viti, fryma e të cilit është e ndryshme nga ajo e raporteve të komisaresh së lartë. Me sa dimë ne, një deklaratë e tillë nuk është dëgjuar ndonjëherë në këtë auditor nga një raportues i posaçëm, i cili e ka mandatin që të punojë për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe jo të bëjë politikë. Kur thotë se situata sot është më e keqe se një vit më parë, ai me siguri harron se para një viti rreth një milionë shqiptarë ishin dëbuar nga vatrat e tyre, qindra mijëra të tjerë ndiqeshin nëpër male nga vrasësit profesionistë të Millosheviqit, mbi dhjetë mijë vetë u vranë, dhjetëra mijëra u burgosën, nga të cilët disa mijëra janë akoma nëpër burgjet serbe dhe nuk dihet asgjë për fatin e tyre, dhjetëra mijëra shtëpi u dogjën e shkatërruan”.³⁰ Theksova më tej se “në kundërshtim me të vërtetën, duket se kjo tragjedi e dhimbshme, nga e cila na ndan më pak se një vit, konsiderohet si diçka normale dhe e zakonshme. Madje, për t’i hedhur një vel harrese, nuk përmendet asgjë prej saj. Përkundrazi, me tone krejtësisht nihiliste mohohet çdo arritje e shënuar në Kosovë. Iu kërkohet komunitetit ndërkombëtar dhe kosovarëve që brenda 8 muajve të bëjnë mrekullira, të ndërtojnë nga hiçi një shoqëri me institucione bashkëkohore, duke harruar se kur shqiptarët u kthyen në shtëpi gjetën vetëm gërmadha dhe kufomat e njerëzve të tyre më të dashur.

³⁰*Po aty*, f. 47-50.

Ndërkaq, janë qëmtuar me një kujdes që të bën përshtypje, incidente të ndryshme, me autorë të paidentifikuar dhe përdoren për të damkosur me vulën e përgjegjësisë këtë popull, që meriton më shumë se respekt. Elementë të veçantë që s’dihej se kush janë nuk mund të identifikohen me një popull të tërë, i cili, pas një rezistence dhjetëvjeçare paqësore shembullore, u “shpërblye” nga regjimi i Millosheviqit me masakra e barbari çnjerëzore. Këto krime nuk ka të drejtë t’i lejë në harresë askush. Përkundrazi është detyrë e gjithsecilit për t’i denoncuar, aq më tepër e atyre që kanë paraqitur në publik qindra faqe me fakte tronditëse. Shqetësimi për mbrojtjen e të drejtave të pakicës serbe në Kosovë, nuk duhet të bëjë që të harrohen kaq shpejt krimet e kryera kundër kosovarëve, as edhe të zhvendosë vëmendjen nga fakti që kriminelët enden të lirë dhe janë akoma në pushtet. Ai nuk duhet gjithashtu të bëjë që të vihen në një plan viktima me xhelatin. Ne mendojmë se nuk duhet të spekulohet as me vuajtjet e serbëve të veçantë në Kosovë për të provokuar sërish urrejtje e konflikte në Ballkan. Në deklaratë bie në sy mungesa e objektivitetit dhe sidomos, kuraja me të cilën raportuesi i posaçëm guxon të kërcënojë dhe të fyejë popullin e Kosovës dhe bashkësinë ndërkombëtare, të cilën e etiketon “e ashtuquajtura bashkësi ndërkombëtare”. Dua t’i kujtoj atij se ishte kjo bashkësi që mundi Millosheviqin, që siguroi kthimin në trojet e veta të familjeve të përgjysmuara shqiptare e që sot është angazhuar për të ndërtuar jetën e re në atë vend. Dhe kjo, ndryshe nga sa mendon z. raportues i posaçëm apo të tjerë si ai, ishte një arritje madhështore e bashkësisë ndërkombëtare. Shqiptarët kanë mirënjohje të thellë për bashkësinë ndërkombëtare, për SHBA-në, BE-në dhe doemos për KFOR-in, UNMIK-un dhe OSBE-në, për francezin BernardKushner, që po

punojnë me përkushtim si dhe gjithë shtetet, qeveritë, organizatat ndërkombëtare, strukturat shtetërore e joshtetërore që ndihmuan popullin shqiptar të Kosovës për çlirimin e vendit dhe përballimin e vështirësive të mëdha që shkaktoi lufta. Janë pikërisht këta dhe përfaqësuesit e tyre ata që drejtojnë në Kosovë dhe jo struktura kriminale, siç shprehet deklarata e raportuesit të posaçëm. Kriminelët dhe mafiozët drejtojnë në Beograd. Është e çuditshme me z. raportues, i cili ndërsa e paraqet bashkësinë ndërkombëtare si fiksion, e pikturon Millosheviqin si të vetmin realitet në rajon, të cilit duhet t'i trembemi të gjithë. Ne kemi një vlerësim të kundërt. Millosheviqi është i fortë vetëm për ata që e duan të tillë, sepse në realitet ai është tirani i mjerë dhe i vetmuar i Ballkanit, një kriminel lufte i akuzuar nga Gjykata Ndërkombëtare Penale”.³¹

10. Në fjalimet tona nuk mungonim që të vinim në dukje me shumë kënaqësi, krenari dhe entuziazëm edhe përpjekjet e jashtëzakonshme të popullit të Kosovës si dhe arritjet e tij të paimagjinueshme në ringritjen e jetës. Gati një vit pas luftës, në fjalën e mbajtur në seancën plenare të sesionit të 56 të KDNJ, në Gjenevë, më 6 prill 2000, ritheksova se “brenda më pak se 10 muajve në Kosovë, një popull prej 2 milionë vetash që ka fituar lirinë, po përpiqet të rindërtojë jetën mbi gërmadhat që lanë pas hordhitë serbe. Sot nuk shkallmohen më portat e shtëpive pas mesnate nga kriminelët, nuk masakrohen më prindërit para fëmijëve, nuk përdhunohen më gratë e vajzat e mitura para prindërve, nuk hidhen më njerëz me gjymtyrë të prera nëpër puse, nuk digjen më njerëz të gjallë nëpër furra, nuk dëbohen më si një vit më parë një milionë vetë

³¹*Po aty.*

nga shtëpitë e tyre etj.”.³² Po aty vura në dukje se “shqiptarët e Kosovës, bashkë me gëzimin e fitores së madhe, lirinë e ëndërruar, të asistuar edhe nga faktori ndërkombëtar, po punojnë me vendosmëri për krijimin e kushteve të nevojshme institucionale e juridike për sanksionimin dhe garantimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, jo vetëm për shqiptarët, popullsinë mazhoritare, por edhe për pakicat etnike, serbët, romët, ashkalitë, egjiptianët, turqit etj. Por, siç është e kuptueshme ka shumë punë për të bërë dhe lypset ende shumë kohë”.³³ Sidoqoftë, kjo është një fitore e madhe e bashkësisë ndërkombëtare, e cila meriton vetëm homazhe e mirënjohje.³⁴

11. Fjalimet dhe ndërhyrjet tona në forumet e ndryshme në strukturat diplomatike të Gjenevës ishin gati në sinkron të plotë me konkluzionet që vinin nga organizma të ndryshme ndërkombëtare ose nga takime të Fuqive të Mëdha të kohës, të cilat kanë përcaktuar ose kanë pasur ndikime të rëndësishme në zhvillimet në Kosovë. Midis tyre është teksti i Rezolutës së propozuar nga Organizata e Konferencës Islamike *Situata e të drejtave të njeriut në Kosovë*, miratuar në seancën plenare të Komisionit të të Drejtave të Njeriut (KDNJ) në Gjenevë, më 13 prill 1999. Në tekstin e preambulës dhe të përmbajtjes së saj, me një gjuhë veçanërisht të fortë dhe të pacensuruar, gjenden formulime të tilla si: KDNJ, “i tronditur dhe i tmerruar nga masakrat dhe aktet e tjera të represionit brutal të kryera në Kosovë nga forcat serbe të sigurisë dhe paraushtarakët me qëllimin e *spastrimit etnik*, në shkelje flagrante të normave ndërkombëtare në fushën e të drejtave të njeriut dhe të drejtës ndërkombëtare

³²Po aty, f. 51-52.

³³Po aty, f. 53-54.

³⁴Po aty.

humanitare, që kanë shkaktuar humbje të jetëve njerëzore dhe një tragjedi njerëzore masive që prek gjithë rajonin;

Dënon *krimet e luftës* dhe shkeljet e rënda dhe të tmerrshme të të drejtave të njeriut, që vazhdojnë të ndodhin në Kosovë, posaçërisht shtypjen e dhunshme të shprehjes jo violente të opinionëve politike, *përdorimin sistematik të terrorit kundër shqiptarëve dhe të tjerëve, torturat, vdekjet e ndodhura në paraburgim, ekzekutimet masive dhe burgosjet e paligjshme të shtetasve shqiptarë, shkatërrimet e gjeneralizuara të shtëpive, pasurive dhe fshatrave dhe faktin që forcat serbe ndërmarrin sistematikisht ndaj popullsisë civile në Kosovë, duke ndërmarrë zhvendosje masive të detyrueshme, dëbime dhe dhunime, duke e vendosur popullsinë civile në kushte jetese të tmerrshme*, sikurse edhe ngacmimet, intimidimet, mbyllja e organeve të shtypit të pavarur në Kosovë nga ana e autoriteteve serbe; dënon gjithashtu përshkallëzimin e ofensivës ushtarake serbe kundër popullsisë civile në Kosovë që po zhvillohet këto javët e fundit,.... Nënvizon shqetësimin e madh të shteteve anëtare ndaj *spastrimit etnik, krimeve të luftës dhe krimeve kundër njerëzimit*... Nënvizon se personat e gjykuar si fajtorë të shkeljeve të rënda të së drejtës ndërkombëtare humanitare dhe të *krimeve të tjera të luftës dhe krimeve kundër njerëzimit* do të duhet të japin llogari, të përgjigjen përpara bashkësisë ndërkombëtare dhe nuk do t'i shpëtojnë dot drejtësisë”.³⁵

³⁵*Po aty*, f. 111- 113.

Ksenofon Krisafi

SUMMARY

The diplomacy of Albania in defence of Kosovo

The Kosovar people and the vast majority of our sisters and brothers in Kosovo are aware, appreciate and proudly admit the unceasing and unstinting support of official Albania, not only for this case, but for all their wars and extraordinary efforts for freedom and independence since the time they remained outside the borders of Albania. It is time to state clearly that Albania does not claim to have done anything for which she seeks medals and decorations. It has done in an exemplary way only as its national duty, because, until then, Albania was an icon of the state, the homeland for all Albanians. At that time, the Albanian politics, from the top of the state, together with the whole system of economy, defence, security, public order and diplomacy, in and abroad, along with the internationals, proved full commitment on finding a quick solution, and a suitable for difficult situation in Kosovo.

All mentioned above were proofs of a great truth, that the Kosovo war taught Albanians, and especially their political forces, what other peoples and especially the neighbours know well and apply consistently, that when the fate of the homeland is at stake, Albania, Kosovo and the Albanians prevail over everything.

Frashër Demaj

Sensibilizimi dhe ndërkombëtarizimi i çështjes së Kosovës, 1990-1996

Kosova shtrihet në pjesën juglindore të Evropës, në Gadishullin Ballkanik. Në jug dhe jugperëndim kufizohet me Shqipërinë, në veri me Serbinë, në perëndim me Malin e Zi dhe në juglindje me Maqedoninë Veriore. Kosova historikisht është e banuar me një shumicë të popullsisë autoktone shqiptare e cila ka kontinuitet historik dhe etnik që nga periudha iliro-arbërore. Ky vend edhe sot banohet me mbi 93 për qind me popullsi shqiptare, kurse pjesa tjetër janë serbë, malazezë, boshnjakë, turq, RAE (romë, shkali dhe egjiptian)¹ si dhe një komunitet i vogël kroat, i cili është i koncentruar kryesisht në Janjevë. Kosova ka një shtrirje gjeografike prej rreth 10 906 km² me një popullsi me rreth 2 milionë banorë. Për nga sipërfaqja dhe numri i popullsisë, bën pjesë në grupin e shteteve të vogla të Evropës, mirëpo për nga dendësia e popullsisë hyn në vendet me dendësi relativisht të madhe për shkak të sipërfaqes së vogël².

Historia e zhvillimeve politike e Dardanisë-Kosovës, që nga antika e deri në vitin 1912-1913, shpjegohet si pjesë përbërëse e zhvillimeve të përgjithshme të historisë së popullit shqiptar. Kurse,

¹ Pas luftës në Kosovë më 1999, vendosjes së UNMIK-ut, United Nations Mission i Kosovo dhe trupave të NATO-s, komunitet RAE (romë, ashkali dhe egjiptian) u bënë kategori kushtetuese duke avancuar të drejtat e tyre dhe duke fituar vende të rezervuara në institucionet e Kosovës.

² Kosova, vështrim monografik, botuar nga Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës (ASHAK), Prishtinë 2011, f. 21.

nga Konferenca e Ambasadorëve në Londër (1912-1913) e më tutje, Kosova ka një zhvillim historik të ndryshëm nga Shqipëria. Në Shqipërinë e njohur nga Konferenca e Ambasadorëve në Londër, bëheshin përpjekje për ngritjen e institucioneve të cilat konsideroheshin si shtylla të shtetit siç ishte policia, ushtria, administrata shtetërore, funksionimi i resorëve ministrore, arsimi dhe fusha tjera të rëndësishme të veçantë. Kurse, shqiptarët e Kosovës dhe viseve tjera etnike të shpëputura nga trugu shqiptar, duhej të përballeshin me dhunën dhe terrorin e ushtruar nga Serbia, e cila kishte për qëllim dëbimin, shkombëtarizimin dhe asimilimin e shqiptarëve. Këtë pushtim e kishte njohur edhe bashkësia ndërkombëtare përkatësisht shtetet që përbënin grupin e Fuqive të Mëdha të cilat në këtë Konferencë ridestinuan interesat e tyre politike dhe gjeostrategjike. Pas Luftës së Parë Botërore, bazuar në vendimet e Konferencës së Versajës të vitit 1919, Kosova sërish mbeti nën sovranitetin serb. Shpresat e shqiptarëve të Kosovës për të realizuar të drejtat kombëtare ishin shtuar gjatë Luftës së Dytë Botërore, kur ata u bënë pjesë e luftës së përbashkët antifashiste jo vetëm me popujt e Jugosllavisë, por pjesë e rëndësishme e koalicionit botëror që luftonte nazifashizmin. Mbi bazën e marrëveshjes për luftë të përbashkët dhe të drejtën e popujve për vetëvendosje i zhvilloi punimet edhe Konferenca e Parë e Këshillit Nacionalçlirimtar për Kosovë e Rrafsh të Dukagjinit ose Konferenca e Bujanit, që u mbajt më 31 dhjetor 1943, dhe 1 e 2 janar 1944, në Bujan të Malësisë së Gjakovës. Në të morën pjesë 49 delegatë, 43 shqiptarë dhe 6 serbë, që përfaqësonin forcat politike të rreshtuara në Frontin Antifashist Nacionalçlirimtar. Konferenca zgjodhi kryesinë prej 9 vetash me Mehmet Hoxhën kryetar dhe Rifat Berishën e Pavle Joviqeviqin nënkryetarë, kurse

anëtarë u zgjodhën: Xheladin Hana, Fadil Hoxha, Hajdar Dushi, Zekeria Rexha, Milan Zeçar dhe Ali Shukriu. Pas diskutimeve të shumta, Konferenca miratoi njëzëri Rezolutën ku pos tjerash thuhet: “Kosova e Rrafshi i Dukagjinit është krahinë e banuar me shumicë nga populli shqiptar, i cili gjithmonë, ashtu edhe sot, dëshiron me u bashku me Shqipërinë”.³

Pas çlirimit nga pushtuesit nazifashist, në Kosovë e vise tjera shqiptare depërtuan njësitet partizane serbo-malazeze-maqedone të cilat ushtruan dhunë e terror ndaj popullit shqiptar. Gjenocidi serb filloi sërish nga vjeshta e vitit 1944. Ushtria serbe kreu krime nga më të ndryshmet, pothuajse në të gjitha fshatrat dhe qytetet e Kosovës, duke përfshirë këtu edhe vendbanime shqiptare në territoret që përfshiheshin në Maqedoni dhe Mal të Zi. Krimet më të rënda u kryen në Karadak, në Drenicë, në Llap, në Pejë, në Mitrovicë, në Gjilan, në Ferizaj, në Prishtinë, në Tivar, në Gostivar, në Preshevë, në Shkup, në Kumanovë etj., ku u vranë mijëra shqiptarë.

Më 8 shkurt 1945, Josip Broz Tito, me pretekst të shuarjes së “kundërrevolucionit”, vendosi pushtetin në Kosovë përmes administrimit ushtarak. Në krye të këtij pushteti vendosi Sava Dreleviqin. Pas këtyre akteve, terrori ndaj shqiptarëve u intensifikua sidomos në Drenicë, ku gjatë pranverës së vitit 1945, njësitet partizane të UNÇJ (Ushtrisë Nacionalçlirimtare të Jugosllavisë) vranë e masakruan mbi 4 000 veta dhe dogjën mbi 20 fshatra. Në Tivar, më 1 prill 1945, gjithashtu u vranë dhe masakruan mijëra shqiptarë të mobilizuar, shumica prej të cilëve kishin marrë pjesë në luftën e përbashkët antifashiste.

Pas përfundimit të Luftës së Dytë Botërore, shqiptarët e

³ Më gjerësisht, shih Rezolutën e Konferencës së Bujanit.

Kosovës e të viseve tjera në Jugosllavi u ndanë në katër njësi të Federatës Jugosllave, në atë të Kosovës, të Maqedonisë, të Serbisë dhe të Malit të Zi.

Territori i Kosovës mbeti si krahinë e veçantë në kuadër të Serbisë. Për të realizuar këtë dhe për të përligjur pushtimin e trojeve shqiptare para opinionit botëror, udhëheqja shtetërore jugosllave në bashkëpunim me udhëheqjen partiake e ushtarake në Kosovë, e cila ishte krejtësisht në duart e kuadrove serbo-malazeze, organizoi më 8-10 korrik 1945, në Prizren, Konferencën e Këshillit Nacionalçlirimtar të Kosovës e të Dukagjinit. Në këtë Konferencë morën pjesë 142 delegatë dhe të ftuar, shumica e të cilëve ishin serbë e malazezë. Kuvendi u mbajt në rrethana të jashtëzakonshme dhe miratoi rezolutën e hartuar në Beograd për aneksimin e Kosovës nga Serbia federale. Të gjithë ata që kundërshtuan këtë akt u dënuan me burgim shumëvjeçar dhe shumë të tjerë u likuiduan fizikisht.

Pas Plenumit të Brioneve (01.07.1966) dhuna dhe terrori ndaj shqiptarëve nuk u ndërpre, por u reduktua në masë më të vogël. Kjo krijoi mundësi që shqiptarët të riorganizoheshin politikisht duke shtuar kërkesat për zgjerimin e autonomisë së Kosovës në kuadër të Federatës Jugosllave, si hap i parë drejt lirisë dhe realizimit të pretendimeve politike.

Dy vjet më vonë, në vitin 1968 në Prizren, Therandë dhe Pejë, u organizuan demonstrata të cilat u zgjeruan më 27 nëntor në Prishtinë, në Gjiilan, në Ferizaj dhe në Podujevë. Demonstrata më masive u organizua në Prishtinë. Kërkesat kryesore ishin: vetëvendosja, barazia, bashkimi, kushtetuta, universiteti dhe mbi të gjitha republika.

Demonstratat e vitit 1968 nxorën në shesh problemin e madh shqiptar në Jugosllavi, që deri atëherë ishte kamufluar përmes propagandës së organizuar shtetërore nga ana e regjimit jugosllav. Sakrificat qenë të mëdha, sepse pati të vrarë të plagosur, të burgosur, të dëbuar nga puna etj. Por, edhe efektet qenë të jashtëzakonshme, sepse mbi bazën e kërkesave të shqiptarëve të manifestuara me kërkesa nga tubimet protestuese u shpejtua themelimi i Universitetit, u miratua Kushtetuta e Kosovës e vitit 1974, si bazë e rëndësishme juridiko-politike e cila krijoi hapësirë për veprim politik mbi bazën e të cilit u themelua Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, u formatuan Instituti i Historisë dhe Instituti Albanologjik, u rrit veprimtaria botuese, kulturore, shkencore dhe arritje tjera në shumë fusha të jetës.

Më 1 prill 1981, në Prishtinë u organizua një nga demonstratat më masive, ku morën pjesë disa dhjetëra mijëra vetë nga të gjitha shtresat e popullit shqiptar. Me gjithë vendosjen e gjendjes së jashtëzakonshme dhe të orës policore, më 2 prill vazhduan demonstratat edhe në Gjiilan, Vushtrri, Lipjan, Gjakovë etj. E fundit ishte demonstrata e 18 majit 1981, kur rreth 1 000 studentë demonstruan në Qendrën e tyre.

Kërkesat e shqiptarëve për Republikën e Kosovës në kuadër të Jugosllavisë të shprehura posaçërisht në demonstratat e vitit 1981, ishin marginalizuar nga ana e institucioneve të Republikës Socialiste të Serbisë dhe Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë. Përpjekjet e pushtetit ishin të orientuara kryesisht në dy aspekte të rëndësishme të cilat do të pengonin depërtimin e informacionit dhe sensibilizimin e kërkesave të popullsisë shqiptare të Kosovës brenda Jugosllavisë.

E para: akterët e ngjarjeve të demonstratave dhe intelektualët që shtronin kërkesa politike, u akuzuan, u burgosen dhe u dënuan me burgim të rëndë. Shumë të tjerë u detyruan të kalonin në ilegalitet në Kosovë, por edhe të tjerë që u detyruan të kërkonin azil politik në vende të ndryshme evropiane, kryesisht në Gjermani, Zvicër, Belgjikë, Austri etj. Me këto veprime pretendohej të ndëshkoheshin bartësit e këtyre ngjarjeve dhe të frikoheshin ata të cilët pretendonin të trasonin këtë rrugë.⁴

E dyta: Republika Socialiste e Serbisë dhe Republika Socialiste Federative e Jugosllavisë, duke shfrytëzuar autoritetin e shtetit të krijuar në kohën e udhëheqësit komunist, Josip Broz Tito, propagandonin në dëm të integritetit dhe identitetit kombëtar të shqiptarëve në Kosovë dhe Jugosllavi, duke i akuzuar ata si popull i paemancipuar e primitiv që kanë pretendime të denigronin Jugosllavinë dhe që kishin prirje me pretendime destruktive e seperatiste⁵. Në këto rrethana, Jugosllavia po dezintegrohej pikërisht për shkak të mosrespektimit të drejtave të popujve, më saktësisht për arsye se sistematikisht po privoheshin shqiptarët si populli i tretë për nga numri (pas serbëve dhe kroatëve) në Jugosllavi⁶. Problemi i shqiptarëve dhe Kosovës iu dha “shkas” edhe republikave tjera, përveç Serbisë që të shqyrtonin seriozisht statusin e tyre në Jugosllavi. Mospajtimi i sllovenëve, kroatëve dhe popujve tjerë joserbë shtroi nevojën e ridefinimit të marrëdhënieve brenda

⁴Edita Tahiri, “Diplomacia e Kosovës në periudhën e okupimit”, Kumtesë e lexuar në Simpoziumin shkencor “Çlirimi i Kosovës”, mbajtur më 12 qershor 2009, në Prishtinë, f. 3.

⁵Po aty.

⁶Shqiptarët që jetonin në RSFJ ishin të tretët për nga numri. Ata jetonin në Kosovë (popullsia shumicë), në Maqedoni në Serbi dhe në Malin e Zi.

Federatës Jugosllave. Në këtë situatë u shtruan tri opsione politike të cilat do ta ridefinonin RSFJ-në: 1. ridefinimi i marrëdhënieve në Federatë; 2. kalimi nga sistemi federativ në konfederatë; dhe 3. opsioni i fundit do të ishte shpërbërja e Federatës dhe krijimi i shteteve të pavarura.⁷

Dhuna dhe represioni serb në Kosovë shënoi shkallë të lartë të zhvillimit që nga akti antikushtetues i Kuvendit të Republikës së Serbisë i vitit 1989, me të cilin ishte suprimuar Autonomia e KSA të Kosovës, që ishte e garantuar me Kushtetutën e vitit 1974. Veprimet antikushtetuese i dhanë mundësi Serbisë të shpallte “krijimin e Serbisë unike”. Në këto rrethana, përderisa në Beograd festohej, në Kosovë shqiptarët po manifestonin indinjatën dhe kundërshtimin e tyre përmes protestave dhe demonstratave. Nga këto protesta rezultuan shumë të arrestuar, të marrë në biseda informative, të rrahur dhe të burgosur shqiptarë. Ata trajtoheshin nga policia, sigurimi shtetëror serb dhe instanca tjera të ndjekjes në mënyrat më çnjerëzore. Qëllimi ishte që të arrestuarit dhe të burgosurit të pranonin se u takonin grupeve të ndryshme ilegale separatiste e terroriste që luftonin kundër “shtetit ligjor të Serbisë dhe Jugosllavisë”. Lidhur me këto kualifikime dhe tortura, Ibrahim Rugova ishte shprehur se: “këto etiketa nuk e shprehin realitetin, por ishin kualifikime për të justifikuar represionin, sepse ato po mbysin ide, po e mbysin realitetin, po mbysin edhe njerëz fizikisht, por edhe në pikëpamje psikike, sociale...”.⁸ Torturat ishin nga më të ndryshmet, duke filluar që nga maltretimet psikike, rrahja në pjesë të ndjeshme të trupit, heqja e thonjve nga mishi, futja e gjilpërave nëpër trup, varja me kokë

⁷*Po aty.*

⁸*Fjala*, Prishtinë, më 15 maj 1990.

teposhtë dhe metoda tjera të torturës.⁹ Një formë tjetër e dhunës dhe represionit serb ndaj shqiptarëve ishte edhe helmimi masiv i nxënësve dhe studentëve shqiptarë me helme të luftës në periudhën mars-maj 1990.¹⁰ Këto ngjarje nxitën reagimin e komunitetit ndërkombëtar, sidomos të organizatave që merreshin me liritë dhe të drejtat e njeriut në Evropë dhe SHBA. Edhe media ndërkombëtare trajtonte në faqet e para protestat dhe demonstratat e shqiptarëve si dhe dhunën e Serbisë dhe Jugosllavisë ndaj tyre.

Si kundërpërgjigje ndaj suprimimit të Autonomisë së Kosovës, delegatët e Kuvendit të Kosovës u mbledhën më 2 korrik 1990, për të mbajtur seancë plenare. Kuvendi i Kosovës ishte i rrethuar me pjesëtarë të policisë dhe sigurimit shtetëror të Serbisë dhe Jugosllavisë.¹¹ Delegatët shqiptarë nuk u lejuan të futeshin në ambientet e Kuvendit. Për këtë arsye, ata u detyruan që në hyrje të Kuvendit të Kosovës të miratojnë Deklaratën Kushtetuese sipas së cilës Kosova shpallej Republikë në kuadër të Federatës apo konfederatës së Jugosllavisë, varësisht për cilën nga këto variante do të vendosnin subjektet kushtetuese të Jugosllavisë (Sllovenia, Kroacia, Bosnjë-Hercegovina, Mali i Zi, Serbia, Kosova, Vojvodina dhe Maqedonia)¹².

Më 5 korrik, Kuvendi i Serbisë suprimoi Kuvendin e Kosovës, Këshillin Ekzekutiv, institucionet administrative e gjyqësore, mbylli

⁹ Më gjerësisht, Raportet ditore dhe njoftimet e Këshillit për Mbrojtjen e Lirive dhe të Drejtave të Njeriut (KMLDNJ), në Prishtinë.

¹⁰ Frashër Demaj, *Afrim Gjuraj, Jeta dhe vepra*, Prishtinë 2009, f. 62.

¹¹ Jusuf Bajraktari, *"Dimensioni historik i pavarësisë së Kosovës"*, botuar në Pavarësia e Kosovës dhe sfidat e shtetndërtimit, ASHAK, Prishtinë 2019, f. 15.

¹² Arkivi i Institutit të Historisë-Prishtinë, (më tej: AIHP), Shih: Deklarata Kushtetuese e 2 korrikut 1990.

Radiotelevizionin e Prishtinës, ndaloi gazetën “Rilindja”, të vetmen në gjuhën shqipe dhe ndërmori masa të tjera të dhunshme kudo nëpër institucione. Pas Shpalljes së Republikës, nevojitej harmonizimi legjislativ në përputhje me statusin politik të Kosovës. Për këtë arsye, më 7 shtator 1990, në Kaçanik delegatët e Kuvendit të Kosovës, pa u hetuar nga policia serbe, u tubuan në qytezën e Kaçanikut dhe miratuan Kushtetutën e Republikës së Kosovës, siç njihet ndryshe Kushtetuta e Kaçanikut¹³. Në vazhdimësinë e veprimeve politike, bazuar në Kushtetutën e Kaçanikut, nga 26 deri më 30 shtator të vitit 1991, u organizua referendumi për Kosovën shtet i pavarur dhe sovran. Pa u mbushur një vit nga referendumi, më 24 maj 1992 u organizuan zgjedhjet parlamentare dhe presidenciale, me të cilat pretendohet të legjitimohej rendi kushtetues dhe demokratik i Kosovës bazuar në Kushtetutën e Kaçanikut¹⁴. Mbi bazën e rezultateve zgjedhore u konstitua Parlamenti i Republikës së Kosovës me 115 deputetë, u zgjodh Qeveria e Kosovës e drejtuar nga dr. Bujar Bukoshi, kurse president i Republikës së Kosovës u zgjodh dr. Ibrahim Rugova. Këto institucione për popullsinë e Kosovës ishin legjitime, por nuk u njohën nga bashkësia ndërkombëtare, përfshirë këtu edhe shpalljen e Republikës së Kosovës.¹⁵ As serbët lokalë nuk morën pjesë dhe nuk i pranuan rezultatet e zgjedhjeve dhe autoritetin e institucioneve të Republikës së Kosovës. Sidoqoftë, dr. Ibrahim

¹³ AIHP, Kushtetuta e Republikës së Kosovës e miratuar më 7 shtator, në Kaçanik.

¹⁴ Këto zgjedhje Serbia i konsideronte ilegale dhe paralele, kurse shqiptarët i konsideronin si zgjedhje legjitime në bazë të të cilave u krijuan institucionet e pavarura kosovare.

¹⁵ Arkivi i Kosovës-Agjencioni Shtetëror i Arkivave të Republikës së Kosovës, (më tej: AK), Referendumi për Kosovën shtet i pavarur dhe sovran, 26-30 shtator të vitit 1991.

Rugova u njoh dhe u trajtua si lider i shqiptarëve të Kosovës dhe kjo i dha mundësi që të përfaqësonte Kosovën, të takonte deputetë, senatorë, kongresmenë, ministra, kryeministra, presidentë dhe bartës fronesh të monarkive, të cilët i njoftonte me situatën në vend dhe bënte sensibilizimin e çështjes së Kosovës në skenën politike e publike ndërkombëtare.¹⁶ Rugova arriti ta takonte edhe Papa Gjon Palin II në Vatikan, nga i cili kishte kërkuar që ta ndihmonte Kosovën dhe popullin e saj për t'u çliruar nga Serbia.

Pas shpalljes së Deklaratës Kushtetuese dhe Kushtetutës së Kaçanikut, Kosova, sikurse edhe republikat e tjera të RSFJ-së, më 21 dhjetor 1991, parashtroi kërkesë për njohjen ndërkombëtare të pavarësisë së saj tek kryesuesi i Konferencës për Jugosllavinë, Lordi P. Carrington, dhe tek ministrat e Jashtëm të 12 shteteve anëtare të Komunitetit Evropian. Kosova zyrtarisht nuk mori as përgjigje pozitive e as negative, gjë që në përgjithësi u interpretua si refuzim i kërkesës për pavarësinë e Kosovës.¹⁷

Sfidat për sensibilizimin dhe ndërkombëtarizimin e çështjes së Kosovës dhe sigurimin e përkrahjes për pavarësinë e saj ishin nga më të ndryshmet.¹⁸ Situatën e vështirësonte edhe më shumë fushata intensive e diplomacisë serbe kundër çështjes së Kosovës, meqë autoriteti i Jugosllavisë në marrëdhëniet ndërkombëtare ishte në nivel shumë të lartë. Vështirësitë më të shumta vinin nga paradigma e krijuar nga tri momente definuese: e para, sepse bashkësia

¹⁶ Më gjerësisht: Munish Hyseni, *Kështu foli Rugova* (Intervista 1990-2005), Prishtinë, 2019.

¹⁷ Arben Hajrullahu, *Paqja afatgjatë në Ballkanin Perëndimor përmes integritetit në BE- Procesi i Integritetit në BE si mundësi për tejkalimin e konfliktit serbo-kosovar*, Prishtinë: 2015, f.85.

¹⁸ Jusuf Bajraktari, *"Dimensionin historik i Pavarësisë së Kosovës... f. 16.*

ndërkombëtare fillimisht ishte kundër zhbërjes së ish-Jugosllavisë, sepse druhej nga shpërthimi i konflikteve të armatosura dhe krijimi i precedentit, pra përpiquej me çdo kusht ta ruante atë; e dyta, çështja e Kosovës shihej e reduktuar në çështjen e të drejtave të njeriut, pra pa të drejtë për subjektivitet të pavarur; dhe e treta, sepse në perceptimet e hershme ndërkombëtare, Kosova shihej si çështje e brendshme e Serbisë¹⁹.

Në rrethana të vështira, por të bindur në filozofinë paqësore, me sensibilizimin dhe ndërkombëtarizimin e çështjes, pretendohej përkrahja ndërkombëtare dhe krijimi i miqësisë me SHBA-në, vënia e kontakteve të përhershme me kryeqendrat e Evropës, me vendet më të zhvilluara në botë.²⁰

Sensibilizimit dhe ndërkombëtarizimit të problemit të Kosovës i kontribuan edhe aktivitetet e asociacioneve shqiptaro-amerikane që funksiononin në Uashington, Nju Jork dhe shtete tjera amerikane si dhe aktiviteti i shqiptarëve në qytete të rëndësishme të Evropës Perëndimore si në: Berlin, Londër, Paris, Romë, Bruksel, Vjenë, Gjenevë, Bernë, Amsterdam etj. Rritja e nivelit të njohjes së çështjes së Kosovës në Uashington D.C. ishte pjesë e strategjisë së gjithmbarshme për ndërkombëtarizimin e kësaj çështje në qeveritë dhe parlamentet e shumë vendeve.²¹ Si rezultat këtyre aktiviteteve në maj 1990, kongresmeni Tom Lantos dhe Joe DioGuardi, udhëhoqën një delegacion amerikan për vizitë në Kosovë. Ata shpërthyen kundër

¹⁹Edita Tahiri, *Diplomacia e Kosovës në periudhën e okupimit*, Kumtesë e lexuar në Simpoziumin shkencor “Çlirimi i Kosovës”, mbajtur më 12 qershor 2009, në Prishtinë, f. 7.

²⁰*Po aty*.

²¹David L. Phillips, *Çlirimi i Kosovës*, Diplomacia këmbëngulëse dhe ndërhyrja e SHBA-së, Tetovë 2015, f. 83.

Milloseviqit, duke e cilësuar atë tiran modern dhe armik të demokracisë në Jugosllavi. Në korrik 1990, DioGuardit zyrtarisht iu ndalua nga ana e regjimit të Milloseviqit hyrja në Jugosllavi, me motivacionin për “akte armiqësore ndaj shtetit”.²²

Në gusht të vitit 1991, me kërkesën e Ligës Qytetare shqiptaro-amerikane, Bob Dole dhe gjashtë senatorë të tjerë të SHBA-së, vizitojnë Prishtinën, duke parë nga afër brutalitetin e Milloseviqit dhe gjendjen e popullatës shqiptare që po vuante nga represioni shtetëror dhe masat e dhunshme të instaluar nga Serbia”.²³

Lëvizja për pavarësi e viteve të ‘90-ta, e udhëhequr nga dr. Ibrahim Rugova, ishte një projekt madhor kombëtar shqiptar që rezultoi nga fuqia mendore e elitës intelektuale e politike shqiptare si kundërpërgjigje ndaj okupimit të Kosovës nga Serbia. Rugova deklaronte se është optimist racional, pra ai nuk mbërthehej nga optimizmi i tepruar dhe nuk ekzagjeronte rezultatet e takimeve të tij dhe delegacioneve kosovare me diplomatë të rëndësishëm të rangut të lartë ndërkombëtar.²⁴ Koncepti i tij bazohej në demokracinë perëndimore dhe vlerat e saj duke besuar se “Kosova nuk mund të jetë oazë e pushtuar në detin e Evropës demokratike” dhe “... durimi i tij ka kufijtë e vet dhe ai do të na shpie drejt fitores...” deklaroi Rugova në paraqitjet e tij publike.²⁵ Okupimi jo vetëm që nuk arriti t’i gjunjëzojë shqiptarët, por përkundrazi ripërtëriu fuqinë dhe

²²Albanian American Civil League, <http://www.aacl.com/our-25-year-history>, shikuar më 03.02.2018.

²³Howard Clark, *Civil Resistance in Kosovo*, London 2000, f. 89.

²⁴*Kosovarja*, Prishtinë, qershor 1990, Intervistë me dr. Ibrahim Rugova, kryetar i LDK-së.

²⁵*Zëri i Rinisë*, Prishtinë, 11 gusht 1990, Intervistë me dr. Ibrahim Rugova, kryetar i LDK-së.

potencialet e tyre për organizimin e lëvizjes për liri, pavarësi dhe demokraci²⁶. Lidhja Demokratike e Kosovës kishte hartuar edhe projektin rezervë përveç dy opsioneve të mëhershme politike (federatë apo konfederatë), ku përfshihej opsioni i bashkimit kombëtar si një zgjidhje e natyrshme që mund të bëhej e mundur në rast të hapjes së çështjes e kufijve në Ballkan.²⁷ Madje, në vitin 1991-1992, kishte filluar edhe përgatitja për vetëmbrojtje. Mbështetur në një dokument të Ministrisë së Punëve të Jashtme të Shqipërisë, në fillim të viteve 90-të, ishte një grup i djemve të rinjë nga Kosova dhe viset tjera shqiptare që përbehej nga 43 veta, që kishin shkuar për stërvitje ushtarake në një bazë të Ushtrisë shqiptare, në Labinot të Elbasanit. Nga ta 11 veta kishin patur rekomandimin e përfaqësisë së Qeverisë së Kosovës në Tiranë, e 3 prej këtyre rekomandime nga degët e LDK-së, në Kosovë.²⁸

Stërvitja e rekrutëve nuk u arrit të mbahej e fshehtë dhe me t'u kuptuar, disa kancelari evropiane i kishin bërë presion Qeverisë shqiptare që të mbyllte dy kampe të stërvitjes së paraushtarakëve nga Kosova.²⁹

Në vitin 1992 u organizuan nëpër fshatra dhe qytete, roje nate dhe rekrutime grupesh të gatshme për rezistencë të armatosur në rast

²⁶ Edita Tahiri, *Diplomacia e Kosovës në periudhën e okupimit...*, f. 7.

²⁷ AIHP, QIK (Qendra Informative e Kosovës), Shih "Deklarata politike e Këshillit Koordinues të Partive Politike Shqiptare në Jugosllavi" e miratuar më 12 tetor 1991, Albanian Democratic Movement in Former Yugoslavia, Documents: 1990-1993, Kosova Information Center, Prishtina, 1993, 21-23.

²⁸ Sabit Syla, "Alternativat për zgjidhjen e çështjes së Kosovës në dhjetëvjeçarin e fundit të shekullit XX", botuar në *Jasharajt dhe Lufta Çlirimtare*, Instituti i Historisë - Prishtinë 2019, f. 95.

²⁹ Enver Bytyçi, *Diplomacia imponuese e NATO-s në konfliktin e Kosovës*, Instituti i Studimeve të Evropës Juglindore, Tiranë 2012, f. 280.

se Serbia do të tentonte të hapte front të drejtpërdrejtë me shqiptarët. Mirëpo, si shkak pasojë e dekonspirimit shumë drejtues, oficerë ushtarakë dhe policorë shqiptarë, u arrestuan, burgosen dhe u dënuan me shumë vite burg nga ana e Serbisë. Në rrethanat e shtimit të represionit serb, Rugova i druhej përhapjes së luftës nga Kroacia dhe Bosnjë-Hercegovina dhe duke pasur parasysh se Kosova ishte e papërgatitur për luftë, ai në pamundësi ishte i detyruar të ndiqte kursin paqësor. Megjithatë, ai në një nga deklaratimet e tij publike shprehej: "... ne jemi këtu, do të qëndrojmë, duam dhe mund të mbrohemi...".³⁰ Pra, Rugova nuk ishte pacifist me çdo kusht, por politikën paqësore e shihte si mundësi të vetme për të avancuar çështjen e Kosovës në diplomacinë ndërkombëtare.

Për sa i takon zgjidhjes me negociata të çështjes së Kosovës, shqiptarët kishin ideuar një platformë që përmbante dy parime kryesore: që negociatat të jenë të ndërmjetësuara nga një palë e tretë ndërkombëtare me fuqi garantuese, duke kërkuar rolin udhëheqës të SHBA-së në bashkëpunim me BE-në dhe që negociatat të zhvillohen mbi parimin e mosprejudikimit të statusit final të Kosovës. Përkrahje u kërkuua po ashtu për implementimin e diplomacisë preventive, përkatësisht për vendosjen e forcave të NATO-s që do të siguronin paqen, do të parandalonin një luftë me përmasa shkatërruese dhe të shmangnin spastrimin etnik të shqiptarëve. Shqiptarët e shihnin te SHBA-ja partnerin e fuqishëm, i cili historikisht i kishte ndihmuar popujt e shtetet në nevojë. Këtë e simbolizonte edhe shembulli i presidentit, Wudrou Wilson, në përkrahje të shqiptarëve pas përfundimit të Luftës së Parë Botërore, në Konferencën e Paqes së Versajës (1919).

³⁰Zëri, Prishtinë, 1 prill 1992, Intervistë me dr. Ibrahim Rugovën.

Në vitet 1990-1993, simpatia perëndimore e krijuar për rezistencën aktive paqësore në Kosovë, nuk u shndërrua në mbështetje konkrete dhe të fuqishme politiko-diplomatike që mund ta zgjidhte këtë çështje. Diplomacia perëndimore mundahej t'i menaxhonte pritjet e shoqërisë kosovare, duke miratuar disa rezoluta ndërkombëtare dhe qëndrime që e dënonin dhunën e regjimit serb në Kosovë, por pa diskutuar për statusin final të Kosovës.

Në dy konferenca ndërkombëtare, në vitet '90-të, u dëshmuar qartë se rezistenca paqësore për arritjen e qëllimeve politike po rezultonte si një pritje naive dhe e stërzgatur. E para ishte Konferenca e Londrës, e cila u përjetua si fyerje dhe injorim nga ana e popullit të Kosovës. Në vitin 1992, kishte shpresa se Kosova do të ftohej në Konferencën për Jugosllavinë, e cila do të mbahej në Londër, në muajin gusht.³¹ Këto shpresa u bënë realitet në momentin kur u ftua dr. Ibrahim Rugova, që në atë kohë ishte zgjedhur kryetar i Kosovës.³² Mirëpo, ftesa ishte me hile, sepse delegacioni i Kosovës nuk mori pjesë aktive në punimet e Konferencës, meqë nuk ishte i ftuar i barabartë me të tjerët. Për delegacionin e Kosovës ishte organizuar një dhomë e veçantë, e emëruar si “sallë dëgjimi” (*salla d'ecoute*).³³ Megjithatë, delegacioni kosovar kishte rastin të bisedonte herë pas here me Lordin Carrington, që ishte udhëheqës i Konferencës së Londrës dhe me diplomatë të tjerë. Për këtë arsye, skeptikët dhe kundërshtarët politikë e kishin “këshilluar” Rugovën që të mos merrte pjesë në këtë Konferencë, ku Kosova nuk po trajtohej

³¹ Më gjerësisht shih: Marc Weller, *Shtetësia e kontestuar: administrimi ndërkombëtar i luftës së Kosovës për pavarësi*, Prishtinë, 2009, f. 93-127.

³² Marc Weller, *Shtetësia e kontestuar: administrimi ndërkombëtar i luftës së Kosovës për pavarësi*, Prishtinë 2009, f. 103.

³³ *Po aty*, f. 104.

me dinjitet dhe nuk ishte pjesëmarrëse aktive e Konferencës. Megjithatë, presidenti Rugova vendosi që pavarësisht kritikave, skepticizmit dhe statusit të të ftuarit, të merrte pjesë në një takim të rëndësishëm ndërkombëtar, ku ishte e fokusuar e gjithë politika dhe diplomacia botërore. Ai në një nga intervistat e tij deklaronte: “Ne e pranuan ftesën më shumë për kooperim. Unë e kam thënë edhe publikisht se nuk jemi të kënaqur me statusin, por marrë në përgjithësi nuk mund të jemi të pakënaqur”.³⁴ Rugova më tej vlerësonte se Konferenca e Londrës për shqiptarët ishte një hap përpara, ndërsa formimi i Grupit të posaçëm për Kosovën në Gjenevë është edhe një sukses i radhës. Edhe vizita e Vensit dhe Ovenit në Kosovë, kanë rëndësi të veçantë, sepse u kërkua prej tyre që të respektohet vullneti i shumicës. Ne do të kërkojmë që shqiptarët të kenë të drejtë plebishitare që të deklarohen për vetëvendosje, por do të bëjmë çmos që edhe më tej t’i shpëtojmë luftës shprehej Rugova, më 6 nëntor të vitit 1992.³⁵ Shqiptarët duhet të qëndrojnë dhe të rezistojnë në rrugën që kanë zgjedhur, sepse çështja e Kosovës do të zgjidhet përmes një procesi që mund të jetë i gjatë dhe i mundimshëm.³⁶

Pavarësisht mungesës së trajtimit të barabartë, politika kosovare po e fuste gradualisht në agjenda ndërkombëtare çështjen e Kosovës, po rriste simpatinë perëndimore dhe përkrahjen ndaj saj, po krijonte bindjen absolute se çështja e Kosovës ishte një problem që

³⁴Zëri, Prishtinë, 26 shtator 1992, Intervistë me presidentin e Republikës së Kosovës, dr. Ibrahim Rugova.

³⁵Bujku, Prishtinë, 6 nëntor 1992, “Qëndrojmë në opsionin tonë për Kosovën e pavarur dhe neutrale”, Intervistë e presidentit të Kosovës, dr. Ibrahim Rugova.

³⁶Bujku, Prishtinë, 27 shtator 1993, Organizimi ynë kërkon një reformist të brendshëm, intervistë e presidentit, dr. Ibrahim Rugova.

nuk mund të neglizhohej gjatë dhe kërkonte zgjidhje të shpejtë e substanciale.³⁷

Moment përcaktues që e sfidoi me sukses marginalizimin dhe i hapi rrugë ndërkombëtarizimit dhe trajtimit të çështjes së Kosovës si një problem ndërkombëtar, ishte dalja e presidenti George H. W. Bush, me qëndrimin e “vijës së kuqe” për Kosovën, në fund të vitit 1992.³⁸ Ky qëndrim i presidentit amerikan u njoh edhe si “kërcënim i Krishtlindjeve” që ishte vërejtja më serioze ndaj Serbisë dhe Jugosllavisë, në rast të përshkallëzimit të dhunës në Kosovë. Disa muaj më vonë, sekretari i Shtetit i Administratës Clinton, Warren Christopher, deklaroi se SHBA-ja është e shqetësuar, nëse dhuna serbe zgjerohet drejt Kosovës, ajo do të përfshinte në konflikt vende të tjera të rajonit, si: Shqipërinë, Greqinë dhe Turqinë. SHBA-ja është e bindur se duhet të parandalojnë zgjerimin e konfliktit që do të përfshinte aleatët tanë të NATO-s dhe të çonte pjesë të gjera të Evropës në luftë dhe ndoshta, siç ka ndodhur më parë, kjo do të eskalonte në një luftë botërore.³⁹ Christopher aludonte në “Atentatin e Sarajevës” (më 1914), nga i cili mori shkas fillimi i Luftës së Parë Botërore.

³⁷Beqir Meta, “Konteksti ndërkombëtar i rezistencës paqësore të shqiptarëve të Kosovës i udhëhequr nga presidenti Rugova në vitet e ‘90-ta”, botuar në *Pavarësia e Kosovës dhe sfidat e shtetndërtimit*, ASHAK, Prishtinë 2019, f. 29.

³⁸ AIHP, QIK (Qendra Informative e Kosovës), Shih “Deklarata politike e Këshillit Koordinues të Partive Politike Shqiptare në Jugosllavi”, e miratuar më 12 tetor 1991, *Albanian Democratic Movement in Former Yugoslavia, Documents: 1990-1993*, Kosova Information Center, Prishtina, 1993, 21-23.

³⁹Stephen Engelberg, *Weighing Strikes in Bosnia, US Warns of Wider War*, The New York Times, 25 prill 1993; Mark Danner, “Endgame in Kosovo: Ethnic Cleansing and American Amnesia”, në botimin: *Kosovo: Contending Voices on Balkan Interventions*, Edited by William Joseph Buckley, f. 69..

Sidoqoftë një mbështetje e tillë e fuqishme amerikane hapi perspektiva të mëdha sa i takon sensibilizimit dhe ndërkombëtarizimit të çështjes së Kosovës. Mirëpo, pavarësisht paralajmërimeve amerikane, SlllobodanMilosheviqi nuk pushoi së ushtruari dhunë, vrasje, arrestime, burgosje dhe trajtime tjera çnjerëzore ndaj shqiptarëve.

Nga janari i vitit 1993, u krijua një klimë e re në marrëdhëniet ndërkombëtare. Deklarimet e presidentit amerikan Bush, ndikuan në avancimin e pozicionit ndërkombëtar të Kosovës, sepse filluan takime të shpeshta me personalitetet të rëndësishme të politikës ndërkombëtare, me pjesëmarrje në konferenca e forume të ndryshme ndërkombëtare dhe në të njëjtën kohë me negociatat për çështjet e veçanta në kuadër të Konferencës së Gjenevës. Ndër takimet më të rëndësishme të nivelit të lartë të udhëhequr nga presidenti Rugova në SHBA, ishin ato me sekretarët e shtetit, WarrenChristopher dhe MadeleineAlbright; në Gjermani me ministrin e Jashtëm, KlausKinkel; në Britaninë e Madhe me ministrat e Jashtëm, DouglasHurd dhe MalcomRifkind; në Francë me ministrin e Jashtëm, HubertVedrine; në Belgjikë me ministrin e Jashtëm, ErikDerycke; në Austri me ministrin e Jashtëm, WolfgangSchüssel; në Itali me ministrin e Jashtëm, Lamberto Dini; në Holandë me ministrin e Jashtëm, HansvanMierlo; në Luksemburg me ministrin e Jashtëm, JacquesPoos; në Danimarkë me ministrin e Jashtëm, NielsPetersen; në Suedi me ministren e Jashtëme, LenaHjelm-Wallén; në Finlandë me kryeministren, TarjaHalonen; në Spanjë me ministrin e Jashtëm, JavierSolana; Në Zvicër me ministrin e Jashtëm, FlavioCotti etj.⁴⁰ Takime të rëndësishme të delegacioneve kosovare u zhvilluan edhe

⁴⁰*Po aty.*

në nivele tjera përfaqësuese të institucioneve të përbashkëta evropiane me të gjithë kryesuesit e radhës së BE-së, komisarin politik, HansvandenBroek; kryetarin e Komisionit Evropian, JacquesSanter; me kryesuesin e radhës së OSBE-së, F. Cotti⁴¹, e takime tjera të cilat në formën dhe përmbajtjen e tyre treguan interesin e Kosovës për ndërkombëtarizimin e çështjes së tyre dhe interesimin e përfaqësuesve evropianë, për t'u njoftuar nga përfaqësuesit e popullit të Kosovës me kërkesat e tyre politike. Një rol të rëndësishëm në avancimin e çështjes patën edhe intervistat në televizione prestigjioze dhe media të shkruara. Për çështjen e Kosovës dhe kërkesat politike të shqiptarëve u transmetuan edicione televizive, në: Euronews, ZDF, RTL, CNN, BBC, RaiUno, VoiceofAmerica, DeutscheWelle, dhe agjencione tjera ndërkombëtare si: Herald Tribune, Washington Post, NewYorkTimes, Tageszeitung, FrankfurterAllgemeineZeitung, Le Parisien, Liberation, DerSpiegel, Le Figaro, Corrieredela Sera etj. Rugova nuk e fshehte optimizmin e tij pas takimeve me diplomatët amerikanë dhe evropianë. Ai këmbëngulte që në këto takime të mirëkuptohej kërkesa e shqiptarëve që problemi i Kosovës të zgjidhej në përputhje me referendumin për pavarësi dhe orientimet për krijimin e një shoqërie moderne në mënyrë që brezave të rinj t'u lihen sa më pak çështje të pazgjidhura.⁴² Presidenti i Kosovës ishte shprehur me tone optimiste edhe nga takimet në Kongres dhe Senatin Amerikan, në vitin 1994. Ai deklaronte se vizita në SHBA ishte vizita më e suksesshme, sepse u zhvilluan takime të rëndësishme me zyrtarët më të lartë të administratës së presidentit Clinton. Për herë të

⁴¹*Po aty*, f. 17.

⁴²*Bota e re*, Prishtinë, 18 maj 1994, "Me politikë pragmatike drejt realizimit të pavarësisë", Intervistë e presidentit, dr. Ibrahim Rugova.

parë bisedat ishin të hapura miqësore dhe të përzemërta. Edhe këtë herë u rikonfirmua se kërcënimi i presidentit Bush dhe ai i presidentit Clinton, janë garanci se SHBA-ja është e gatshme të bëjnë çmos për ta ndaluar konfliktin në Kosovë dhe të intervenojnë nëse Serbia tenton të bëjë luftë të hapur kundër Kosovës. Republikanët dhe demokratët ishin zotuar që edhe më tej të përkrahin çështjen e Kosovës dhe zgjidhjen e saj në përputhje me interesat e popullit të saj.⁴³ Edhe në gjysmën e parë të vitit 1995, Kosova ishte në qendër të vëmendjes në agjendat ndërkombëtare të institucioneve dhe organizatave politike e diplomatike. Rugova deklaronte se: “Ne si shtet duhet të kemi sa më shumë kontakte, të bëjmë sa më shumë miq, të jemi krenarë për përkatësinë tonë kombëtare, të krijojmë mundësi për brezin e ri, të cilin unë e quaj brezi i republikës dhe ta inkuadrojmë shtetin tonë në proceset integruese shqiptare, ballkanike dhe evropiane”.⁴⁴

Kosova nuk u ftua në Konferencën e Dejtonit, ku më 21 nëntor 1995, në bazën ushtarake amerikane “WrightPeterson” në Ohajo, u arrit marrëveshja për ndarjen e Bosnjë-Hercegovinës në 51 për qind në territorin e Federatës së Bosnjë-Hercegovinës dhe 49 për qind të territorit në Republika Srpska.⁴⁵ Dejtoni zbehu kursin politik paqësor të ndjekur nga dr. Rugova dhe nxiti qarqet radikale në Kosovë dhe jashtë saj që të proklamnin luftën e armatosur si të vetmen alternativë për çlirimin e Kosovës.

⁴³Koha, Prishtinë, 29 dhjetor 1994, “Zgjidhja premtuese - administrimi civil”, Intervistë e presidentit, dr. Ibrahim Rugova.

⁴⁴Zëri, Prishtinë, 13 maj 1995, “Bashkësia ndërkombëtare po punon intensivisht për fillimin e bisedimeve për Kosovën”, Intervistë e presidentit, dr. Ibrahim Rugova.

⁴⁵www.zeriamerikes.com, “Marrëveshja e Dejtonit, vështrim retrospektiv nga aktorët kryesorë”. Hulumtuar më 10 janar 2018.

Fakti se në Dejton nuk u bë fjalë për çështjen e Kosovës, u interpretua në mënyra të ndryshme në Prishtinë dhe Beograd si dhe nga vëzhguesit politikë dhe nga zyrtarët politikë të vendeve të ndryshme evropiane.⁴⁶ Opinioni publik dhe politik ndërkombëtar, u nda në dysh. Disa mendonin se mosftesa e Kosovës në Dejton ishte indiferencë totale ndaj kësaj çështjeje që mund të kishte kosto jo vetëm për rajonin e Ballkanit, por edhe më gjerë. Të tjerë mendonin se diplomacia ndërkombëtare e kishte fokusuar gjithë energjinë e vet në zgjidhjen e çështjes së Bosnjë-Hercegovinës, sepse lufta e pamëshirshme e kishte shkatërruar këtë vend. Edhe në Serbi pati reagime. Disa qarqe politike mungesën e Kosovës në Dejton e konsideruan si provë të tezës së lansuar serbe se Kosova është “çështje e brendshme e Jugosllavisë” dhe se shqiptarët duhet ta braktisnin shpresën për ndërkombëtarizimin e këtij problemi.⁴⁷ Analizat gjeopolitike dhe gjeostrategjike të disa zyrtarëve evropianë, mbështeteshin në idenë se ende ekzistonte mundësi për një zgjidhje paqësore të problemit të Kosovës.⁴⁸

Për Konferencën e Dejtonit ishte deklaruar edhe presidenti Rugova, i cili ishte treguar i matur dhe optimist. Ai më 28 nëntor 1995, deklaronte se Marrëveshja e Dejtonit do të reflektonte në mënyrë pozitive. Qëllimi i parë i Dejtonit ishte që të ndërpritet lufta në Bosnjë, e pastaj të gjinden zgjidhje për të gjitha problemet në Jugosllavi e Ballkan. “Kam të drejtë të jem optimist si president i Kosovës dhe si qytetar i saj. Optimizmin e mbështes te përkrahja e

⁴⁶Muhamedin Kullashi, “Evoluimi i opinionit publik ndërkombëtar rreth Pavarësisë së Kosovës” botuar në *Pavarësia e Kosovës dhe sfidat e shtetndërtimit*, ASHAK, Prishtinë 2019, f. 62.

⁴⁷*Po aty*, f. 63.

⁴⁸*Po aty*.

miqve të Kosovës, sepse ata flasin gjithkund me simpati dhe tone pozitive për kauzën tonë”, - vlerësonte dr. Rugova.⁴⁹

Rezistenca paqësore e drejtuar nga dr. Ibrahim Rugova rriti simpatinë dhe mbështetjen e opinionit perëndimor ndaj shqiptarëve dhe të drejtave të tyre qytetare e kombëtare; rezistenca paqësore e diskreditoi përfundimisht shovinizmin serb në Evropë dhe në botë, duke i hequr maskën përfundimisht. Nga ana tjetër, personaliteti prej lideri i presidentit Rugova, arriti suksese edhe brenda faktorit shqiptar: e organizoi shoqërinë kosovare në një lëvizje masive politike patriotike, e pashembullt më parë në histori, krijoi institucione politike, arsimore, kulturën etj., shtetërore, rriti ndjenjat patriotike të shqiptarëve në Republikën e Shqipërisë, Maqedoni, Mal të Zi dhe në diasporë.⁵⁰

Pavarësisht këndvështrimeve pro dhe kontra, sa i takon rëndësisë së sensibilizimit dhe ndërkombëtarizimit të çështjes së Kosovës në periudhën mes viteve 1990-1996, përfundimisht mund të konkludohet se rezistenca paqësore e shqiptarëve të Kosovës e udhëhequr nga dr. Ibrahim Rugova, akademik Fehmi Agani dhe personalitete tjera politike dhe diplomatike, analizuar në kontekstin e rrethanave të kohës, arriti rezultate të konsiderueshme si në planin e brendshëm po ashtu edhe në atë ndërkombëtar. Pa periudhën e sensibilizimit dhe ndërkombëtarizimit të çështjes së Kosovës, nuk do të arriheshin rezultatet e dëshiruara të popullit të Kosovës. Kjo

⁴⁹Bujku, Prishtinë, 28 nëntor 1995, “*Të koncentrohemi të gjithë në çështjen e Kosovës*”, Intervistë e presidentit, dr. Ibrahim Rugova.

⁵⁰Beqir Meta, “*Konteksti ndërkombëtar i rezistencës paqësore të shqiptarëve të Kosovës i udhëhequr nga presidenti Rugova në vitet e ‘90-ta*”...f. 41.

periudhë është hallkë shumë e rëndësishme në vargun e ngjarjeve dhe zinxhirin e Pavarësisë së Kosovës.

Frasher Demaj

SUMMARY

THE AWARENESS AND INTERNATIONALIZATION OF THE KOSOVO ISSUE

The unconstitutional act of 1989 enforced by the Assembly of the Republic of Serbia, which abolished the autonomy of Kosovo, was followed by a high level of violence and repression, exercised by Serbian authorities in Kosovo. In such circumstances, when celebrations were going on in Belgrade, the Albanians in Kosovo were expressing their dissatisfaction through protests and demonstrations. As a result many Albanians were arrested, beaten and imprisoned. They have been treated by Serbian police, the State Security Agency and other prosecuting authorities, in the most inhumane manner. In response to the abolition of Kosovo's autonomy, the deputies of the Kosovo Assembly convened on July 2, 1990, and adopted the Constitutional Declaration, promulgating Kosovo as a republic within the federation or confederation of Yugoslavia. On the September 7, 1990 the Kosovo Assembly deputies gathered in the city of Kaçanik and approved the Constitution of the Republic of Kosovo. From 26 to 30 September 1991 a referendum was held for Kosovo as an independent and sovereign state. On the May 24, 1992 the parliamentary and presidential elections were held. Based on election results the Parliament of Kosovo with 115 deputies and the government were constituted, whereas dr. Ibrahim Rugova has been elected for the President of the Republic of Kosovo. Rugova was recognized as a

leader of Kosovo Albanians, and this provided him an opportunity to represent Kosovo in the international politics.

In difficult circumstances, but convinced by the philosophy of peace, the awareness and internationalization of the issue aimed to gain an international support, establishment of a friendship with USA and permanent links with European capitals and other most developed countries in the world. A determining moment, that successfully challenged the marginalization and paved the way for the internationalization and treatment of the Kosovo as an international issue, was the appearance of President George H. W. Bush with his “Red line” on Kosovo at the end of 1992. The period January 1993 – 1996 marks establishment of favourable circumstances for Kosovo in the international relations.

Ibrahim Gashi

**Kontribut në periodizimin historik të lëvizjes për
pavarësinë e Kosovës**

Periodizimi i historisë i referohet mënyrës si historianët e ndajnë të kaluarën në periudha të ndryshme. Ashtu si tregimi, shkrimi i historisë kërkon një strukturë. Periodizimi është një nga teknikat kryesore të përdorura nga historianët për të krijuar këtë strukturë. Megjithatë, e kaluara është e rrjedhshme, komplekse dhe e vazhdueshme, kështu që çdo përpjekje për ta ndarë atë në pjesë kronologjike të pastra duket të jetë artificiale. Periodizimi gjithmonë bën dhunë ndaj realitetit kompleks të së kaluarës, madje edhe përpjekjet më të kujdesshme dhe më të ndershme në ndarjen e së kaluarës përfshijnë disa shtrembërime. Çdo skemë duhet të bëjë kompromis midis kërkesave shpesh kontradiktore të qartësisë, koherencës, saktësisë dhe ndershmërisë. Periodizimi paraqet probleme teorike sepse çdo skemë kronologjike nxjerr në pah disa aspekte të së kaluarës dhe errëson disa aspekte tjera.

Historiani i madh britanik, Bernard Lewis, në një ligjëratë të mbajtur në Universitetin e Tel Avivit, lidhur më periodizimin e historisë do të shprehej: *“Periodizimi më i akceptuar i historisë, në periudhën antike, mesjetare, modern dhe bashkëkohore është ndarje që e bënë evropianët për të klasifikuar pjesët e ndryshme të historisë evropiane, por si shumë gjëra tjera edhe kjo iu dha ose iu imponua edhe pjesëve tjera të botës, pavarësisht sa ishte e drejtë apo jo”*. Për të argumentuar se kjo ndarje nuk ju përgjigjet historisë së popujve të

ndryshëm, Lewis më tej vazhdon: *“Kur e pyeta një studente, që donte të studionte historinë e Kinës, se cilën periudhë antike, mesjetare apo modern doni ta studioni? - Ajo ma ktheu: A ekziston vallë kjo ndarje në historinë kineze? Sepse, tha ajo, unë nuk e kam hasur në leximet e mia. Unë vërtet u skuq nga pyetja e pavend që bëra”*, - përfundon Lewis.¹

Përtej këtij makroperiodizimi, historianët imponojnë edhe periodizime më të limituara, që iu referohen ngjarjeve të mëdha që i kanë dhënë vulë një periudhe kohore. Mjafton të kujtojmë, në historiografinë britanike, periudhën e Elizabetës, apo periudhën viktoriane apo emërtimin tjetër dinastik në historinë franceze si periudha e Napoleonit, dhe të kuptojmë se një periodizim i tillë i limituar mund të aplikohet edhe në historiografitë tjera.

Kur jemi tek periodizimi i historisë së Kosovës, ka një konsensus brenda komunitetit të historianëve dhe studiuesve shqiptarë se ajo duhet të formatohet brenda periodizimit standard si periudhë antike, mesjetare, moderne dhe bashkëkohore. Ndërsa, kur flasim për periodizime të limituara, brenda historisë më të re të Kosovës, synimi i këtij punimi është që të trajtojë një periodizim që si objekt ka lëvizjen e Kosovës për pavarësi.

Duke analizuar me shumë vëmendje se si lindi dhe u zhvillua nga ideja tek veprimi dhe realizimi pavarësia e Kosovës, konsiderojmë se kjo trajektore historike që ne e kemi emërtuar si lëvizja për pavarësi, ka kaluar nëpër disa faza, apo etapa referuar standardeve të periodizimit të limituar.

¹Bernard Lewis- Periodization of History: <https://www.youtube.com/watch?v=OS7-ZRFwVxM>

Kriteri bazik që duhet marrë në konsideratë për periodizimin e kësaj lëvizjeje është intensiteti apo shkalla e masivizimit të lëvizjes, e matur me efektet konkrete dhe arritjet e saj. Pikënisje kohore e këtij periodizimi është momenti i parë i paraqitjes publike të kërkesës për pavarësi dhe si kufi kohor përmbyllës të këtij periodizimi do të merret arritja kulmore e kësaj lëvizjeje me Shpalljen e Pavarësisë dhe krijimi e shtetit të Kosovës, më 17 shkurt 2008.

Një përpjeke krejt fillestare për ta periodizuar lëvizjen e pavarësisë, pashmangshëm kërkon një njohje solide të kontekstit historik të problemit të Kosovës dhe shqiptarëve të viseve tjera të okupuara, që nga 1913 e tutje dhe mënyrën si ka evoluar ai gjatë momenteve kyçe të historisë shqiptare në përgjithësi. Krahas kontekstit historik, duhet njohur gjithashtu edhe kontekstin e aktualitetit politik ndërkombëtar dhe brenda shqiptar dhe evoluimet e tij, veçmas në mbarim të luftës së ftohtë dhe fillimit të shpërbërjes së Jugosllavisë.

Studimi, e rrjedhimisht edhe periodizimi i lëvizjes kosovare për pavarësi, duhet shpjeguar duke ju referuar këtyre dy konteksteve (historike dhe aktuale), të cilat determinuan lindjen dhe kahet e kësaj lëvizjeje.

Periudha e autonomisë politike dhe administrative e Kosovës, e bazuar në Kushtetutën e vitit 1974, krijoi premisa për lindjen e kërkesës për pavarësinë e saj, jo nga mungesa totale e lirisë dhe të drejtave, por nga efektet që dhanë liritë dhe të drejtat ekzistuese në ngritjen e shkallës së emancipimit të përgjithshëm të shqiptarëve dhe emancipimit të tyre politik në veçanti.

Demonstrata studentore të vitit 1981, nga një këndvështrim krahasimtar, janë produkti i parë i drejtpërdrejtë i këtij emancipimi

dhe vetëdijesimi politik të shqiptarëve. Në funksion të këtij periodizimi që po trajtojmë, ato mund të konsiderohen si momenti i paraqitjes publike për herë të parë të kërkesës për pavarësi të Kosovës. Këtë e pohon edhe studiuesi francez, Jacques Baudouin, në librin e tij, *Lindja e një demokracie*, të sapo botuar, ku mes tjerash shkruan: “*Synimet e para kosovare për pavarësi u shfaqën në shkurt dhe mars 1981, as një vit pas vdekjes së Titos*”.²

Në fund të viteve të ‘80-ta, situata agravoj për shkak të ridaljes së hapur të nacionalizmit dhe shovinizmit serb në krye me S. Millosheviqin, ASHAS dhe Kishën serbe. Një shpërbërje paqësore e Jugosllavisë federale, dukej e vështirë, pikërisht se udhëheqja serbe nxori kërkesën e unifikimit të serbëve në një shtet, kërkesë që sakrifikonte tërësisht dy krahinat, Kosovën dhe Vojvodinën, por afektonte edhe Bosnjën dhe Kroacinë. Ky synim i dha shtytje procesit të shkëputjes së njëanshme fillimisht të republikave veriore të Sllovenisë dhe Kroacisë, e pastaj edhe republikave tjera. Kjo lëvizje për shkëputje dhe pavarësi që po ndodhe, krijoi shtegun e vetëm që edhe Kosova të deklaroi më 2 korrik 1990, pavarësinë e saj në kuadër të Federatës apo konfederatës së Jugosllavisë. Nisur nga tema që kemi në shqyrtim, 2 korriku 1990 përbën momentin e zyrtarizmit të kërkesës për pavarësi. Kjo nga këndvështrimi i periodizimit të lëvizjes për pavarësi, përbën fazën e dytë të lëvizjes për pavarësinë e Kosovës, që si kufij përmyllës kohor ka vitin 1997.

Lëvizja e protestave studentore të vitit 1997, shprehet studiuesi Howard Clark, është veprimi i fundit paqësor i shqiptarëve

²Jasques Baudouin, *Lindja e një demokracie - Hashim Thaçi dhe rruga drejt Kosovës së pavarur (1987-2008)*, Buzuku, Prishtinë, 2019, f. 96.

për realizimin e pavarësisë, që paralajmëroi fillimin e një strategjie më të vendosur që nga stadi i zyrtarizmit idenë e pavarësisë do ta lëviz me sukses drejt realizimit të saj.³ Me të drejtë, studiues si James Pettifer⁴ apo Lester Bruno,⁵ konstatojnë se lufta e UÇK-së i dha shpirt apo e vitalizoi lëvizjen për pavarësi. Nisur nga këto konstatime, besoj me të drejtë, se lufta çlirimtare dhe epilogu i saj i suksesshëm e quan shumë pranë realizimit lëvizjen e pavarësisë së Kosovës, e që nga këndvështrimi i periodizimit kjo do të përbënte fazën e tretë, më kruciale, që kaloi kjo lëvizje.

Faza finale e realizimit të plotë të lëvizjes për pavarësinë e Kosovës, që më saktë mund të konsiderohet si fazë përgatitore për shpalljen e saj është periudha e administrimit ndërkombëtar të Kosovës nga misioni i OKB-së. Gjatë kësaj faze u vendos një kornizë dhe strukturë juridike shtetërore dhe filluan të kryhen shumë aktivitete të rëndësishme shpërnderuese. Studiuesi Simon Chesterman, i disa shembujve në botë, kishte konstatuar se: *“Është e mundur të legjitimohen kushte për legjitimimin e qeverisjes nacionale, pra të kryhen punë shtetërore, gjatë periudhës së një protektorati të Kombeve të Bashkuara”*.⁶

Si perfundim përmes këtij vështrimi kemi mëtuar të japim një kontribut modest për periodizimin e lëvizjes për pavarësinë e Kosovës, e cila siç e thamë, ka kaluar nëpër katër faza të rëndësishme

³ H. Clark, *Civil Resistance in Kosovo*, Pluto Press, London, 2000, f. 153.

⁴ James Pettifer, *The Kosovo Liberation Army: Myth and Origin, Kosovo: The Politics of Delusion*. United Kingdom: Frank Cass, 2001, f. 26-29.

⁵ Lester Bruno, *Kosovo Intervention and US Policy*, San Francisco, 2001, f. 78.

⁶ Simon Chesterman, ed., *Transitional administration, state building and UN in Making States Work* (United Nations University Press: Tokyo, New York, Paris, 2005), f. 339.

me ç'rast efektet dhe arritjet e kësaj lëvizjeje, strategjia dhe mjetet që janë përdorur për sendërtimin e saj dhe momentum dhe involvimi ndërkombëtar që kanë ndikuar dhe ndihmuar në realizimin e suksesshëm të saj, përbejnë kufij distinktivë (dallues) të këtyre fazave.

Si përmbyllje, ky periodizim do të dukej si vijon: faza e parë apo paraqitja publike e kërkesës për pavarësi (1981-1989); faza e dytë apo zyrtarizmi me përpjekje për institucionalizimin e idesë së pavarësisë 1989-1997; faza e tretë apo lufta e armatosur dhe çlirimi i Kosovës, si faza e sendërtimit real të idesë së pavarësisë (1997-1999) dhe faza e katërt apo administrimi ndërkombëtar i Kosovës, si faza përgatitore për arritjen *de jure* të pavarësisë përmes shpalljes së saj në Parlamentin e Kosovës.

Ibrahim Gashi

SUMMARY

Contribution to the historical periodization of the Kosovo independence movement The issue of periodization of history was and remains one of the serious challenges and preoccupations of historians worldwide. Eminent scholars of history have tried to provide a periodic framework based on chronological identifying factors, related to great developments and events, which have identified certain eras. Despite the fact that today we have a widely accepted macro periodization of human history, there are still people and states that do not recognize this standard periodization as ancient, medieval, modern and contemporary. Consequently the debate over periodization has never ended. In regards to the Albanian historiography we can conclude that the debate related to the micro periodization of some important historical periods continues. This work should be considered as the first effort for micro-periodization of the history of independence movement of Kosovo. Certainly, the debate related to this topic will continue.

Zeqirja REXHEPI

Shqiptarët e Maqedonisë dhe roli i tyre gjatë kohës së çlirimit të Kosovës

Shthurja e Jugosllavisë socialiste ishte një proces i pashmangshëm, sepse ajo nuk ishte krijesë e bashkimit të lirë të popujve konstituentë të saj dhe si e këtillë ajo në mënyrë permanente mbante potencialin e natyrshëm të shpërbërjes. Propaganda demagogjike e komunistëve jugosllavë për “vëllazërim-bashkim” të popujve arriti që ta mbajë këtë shtet derisa ishte gjallë J. B. Tito. Pas vdekjes së Titos doli në skenë nacionalizmi i shfrenuar serb, nën udhëheqjen e qarqeve nacionaliste në krye me Slllobdan Millosheviqin, me çka u përshpejtua procesi i shpërbërjes së Jugosllavisë socialiste. Nacionalistët serbë angazhoheshin për prishjen e sistemit federal dhe kthimin në konceptin unitarist dhe atë të hegjemonisë serbe, të periudhës midis dy luftërave botërore. Akti i parë i shpërbërjes së Jugosllavisë socialiste filloi kur Kosovës dhe Vojvodinës, të cilat ishin njësi konstituive të Federatës jugosllave, iu grabit autonomia, me çka ato u shndërruan në njësi regjionale administrative të Serbisë¹. Gjatë tërë kësaj kohe, qarqet politike kroato-slllovene taktizonin në kurriz të Kosovës dhe shqiptarëve, duke u përpjekur të kënaqnin orekset e nacionalizmit serb, për të shpëtuar veten. Mirëpo, taktika e tyre u tregua e gabuar, sepse qarqet nacionaliste serbe pasi “rivendosën Serbinë e unifikuar” nuk u ndalën

¹Sofokli Lazri, *Apologjia e dhunës në Kosovë*, 8. Shih: “E vërteta mbi Kosovën dhe shqiptarët në Jugosllavi”, Tiranë, 1990.

me kaq, por me tërë egërsinë e tyre u hodhën drejt Sllovenisë, Kroacisë dhe Bosnjës.

Shqiptarët e Maqedonisë dhe kontributi i tyre

Gjatë procesit të shpërbërjes së Jugosllavisë socialiste, Maqedonia si njësi konstituive e saj përpiquej të pavarësohet dhe të formohet si shtet sovran. Por, faktori politik maqedonas nuk dëshironte që sovranitetin e shtetit ta ndajë me popullin shqiptar që jetonte shekuj me radhë në trojet e veta etnike. Ai përpiquej që konceptin e shtetit nacional maqedonas t'ia imponojë edhe popullit shqiptar që jetonte në hapësirat e Maqedonisë. Kjo përpjekje hasi në kundërshtim permanent të faktorit politik shqiptar, gjë që pak nga pak solli deri te riciklimi i krizave të kontrolluara, të cilat në vitin 2001 shpërthyen në konflikt të hapur, të armatosur.

Në kohën kur tashmë lufta çlirimtare për çlirimin e Kosovës kishte filluar, në Republikën e Maqedonisë u mbajtën zgjedhjet e treta parlamentare, në tetor 1998². Në këto zgjedhje morën pjesë 17 parti politike. Subjektet shqiptare politike, Partia për Prosperitet Demokratik dhe Partia Demokratike Shqiptare, duke pasur parasysh rrethanat e krijuara në Kosovë, i lanë mënjane mosmarrëveshjet dhe lidhën një marrëveshje, me çka elektorati shqiptar u relaksua tërësisht në këto zgjedhje, duke e përqendruar tërësisht vëmendjen në çështjen e Kosovës.

Marrëveshja në mes faktorit politik shqiptar u lidh në prag të shpërthimit të luftës çlirimtare të Kosovës. Marrëveshja i zbuti në

²“Reshënie za raspishuvanje na izbori za pratenici vo sobraniето na Republika Makedonija, nr. 08-3073/1, 6 gusht, 1998, “Slluzhben vesnik na Republika Makedonija”, nr. 40, 8 gusht, 1998.

masë shumë të madhe kundërthëniet e vjetra në mes këtyre dy forcave rivale të shqiptarëve të Maqedonisë. Për subjektet politike shqiptare çështja e çlirimit të Kosovës ishte parësore. Në Kosovë kishin filluar përpjekjet e para të luftës heroike të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës³.

Vlen të theksohet se shqiptarët në përgjithësi, bartnin një përgjegjësi shumë të madhe historike për veprimet e tyre në këto momente vendimtare. Ata duhej me çdo kusht të ruanin stabilitetin e vendeve ku jetonin, me qëllim që t'i mundësonin veprim të suksesshëm logjistikës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Marrëveshja midis dy subjekteve shqiptare kishte rëndësi shumë të madhe, sepse çështja e Kosovës i tejkalonte të gjitha mosmarrëveshjet politike. Marrëveshja pati jehonë shumë të gjerë dhe ndikoi dukshëm në relaksim të raporteve ndërmjet shqiptarëve të Maqedonisë, por njëkohësisht, sinjalizoi se, në luftën eventuale shqiptaro-serbe, populli shqiptar do të kundërpërgjigjet si një komb i tërë⁴. Në fakt, marrëveshja midis subjekteve politike shqiptare të Maqedonisë ishte vazhdimësi e makroprojekteve politike kombëtare shqiptare. Udhëheqësit politikë shqiptarë, me këtë marrëveshje, dëshmuar se janë të përgjegjshëm dhe dinë të luajnë rolin e tyre, në momente vendimtare historike.

Marrëveshja në mes të PDSH dhe PPD, u nënshkrua në sallën e Komunës së Tetovës, më 9 shtator, 1998, në praninë e një numri të

³UÇK - Ushtria Çlirimtare e Kosovës, Formacioni ushtarak që luftonte me armë në dorë për çlirimin e Kosovës.

⁴Rilindja (Tiranë), *“Shqiptarët do të reagojnë ashpër dhe vendosmërisht si një komb”*, 31 janar 1998.

madh gazetarësh. Atë e nënshkruan dy liderët politikë shqiptarë: Arbën Xhaferi dhe Abdurrahman Aliti.⁵

Në dokumentin e marrëveshjes në mes PDSH dhe PPD, thuhet:

“Sot PPD dhe PDSH, nënshkruajnë Marrëveshjen për bashkëpunim dhe veprim të përbashkët politik në periudhën e ardhshme, të motivuar nga vullneti reciprok për të shtuar efikasitetin politik të shqiptarëve në Maqedoni, në mënyrë që me energji të përbashkët politike të realizojnë aspiratat e tyre për dinjitet të barabartë, individual dhe kolektiv, në këtë vend. Me këtë marrëveshje strukturohet një angazhim politik i shqiptarëve në realizimin e objektivave fundamentale politike të tyre dhe që deri më tash kanë funksionuar si pika konvergjente programore ndërmjet këtyre dy partive. Me këtë marrëveshje po ashtu vihen themelet e një bashkëpunimi institucional ndërmjet këtyre dy partive, me të cilën palët nënshkruese marrin obligime dhe përgjegjësi të përbashkëta për çështjet e definuara në të. Zhvillimet politike që i lamë pas na mësuan se s’duhet vepruar ndaras politikisht, sa kohë që kemi një minimum fundamental të objektivave të përbashkëta. Së këndejmi, aktin e sotëm, ne e konsiderojmë si një akt të pjekurisë sonë politike, të shqiptarëve këtu dhe si hap me rëndësi për ta kuptuar politikën si art të pajtimit, brenda një kolektiviteti dhe me të tjerët. Imperativi shqiptar tash dhe në të ardhmen është uniteti politik mbi baza të parimeve demokratike. Është ky një hap për ta kristalizuar peizazhin politik në dy parti të strukturuar qartë dhe me kredibilitet, në mënyrë që të mbyllet procesi i fragmentarizimit politik të shqiptarëve

⁵“Marrëveshje midis PPD dhe PDSH”- Arsyeimi i Marrëveshjes është lexuar nga aktivistja e Prosperitetit Rinor, Zejnepe Alili, Flaka e vëllazërimit, 10.09.1998, f. 3.

nëpër parti apo grupime politike që s'mbajnë peshë, por vetëm shkapërderdhin energjinë politike të popullatës në alternativa të padefinuara politike. Akti i sotëm, me të cilin dy partitë më relevante të shqiptarëve, krijojnë konvergjencën demokratike të veprimit politik, është me rëndësi edhe për faktin se krijon një vizion të përbashkët, legjitim dhe demokratik mbi çështjen shqiptare në Maqedoni dhe zgjidhjen e saj”.⁶

Kjo marrëveshje, përveç daljes në zgjedhje të përbashkëta i obligonte subjektet politike nënshkruese për të bashkëpunuar në realizimin e objektivave të përbashkëta, siç ishin:

- *garantimi i statusit të barabartë politik të shqiptarëve në ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë;*

- *arsimimi në gjuhën shqipe në të gjitha nivelet, sidomos në zgjidhjen e çështjes së arsimit superior në gjuhën shqipe dhe statusin e Universitetit të Tetovës;*

- *zgjerimi i hapësirës për përdorim zyrtar të gjuhës shqipe në nivel qendror dhe lokal;*

- *përfshirja proporcionale e shqiptarëve në institucionet politike e shtetërore, në administratën publike në rrafsh qendror dhe lokal dhe në qendrat e vendosjes ekonomike e financiare në rrafsh qendror dhe lokal;*

- *decentralizimi real i pushtetit qendror dhe forcimi i pozitës dhe të rolit të pushtetit lokal; dhe,*

- *angazhimi i të dyja partive në lirimin e të burgosurve politikë.⁷*

⁶Po aty.

⁷Po aty, f. 3.

Sipas marrëveshjes, midis PPD-së dhe PDSH-së u bë ndarja e mandateve të përfaqësuesve shqiptarë për Kuvendin republikan, në shtatëmbëdhjetë njësi zgjedhore, në raport: 10 kandidatë për Partinë për Prosperitet Demokratik dhe 7 për Partinë Demokratike Shqiptare, (modeli i shumicës)⁸. Gjithashtu, u hartua lista e përbashkët proporcionale e të dy partive politike, sipas parimit, përfaqësuesi me numër “tek” i takonte Partisë Demokratike Shqiptare, ndërsa numri “çift” i takonte Partisë për Prosperitet Demokratik (modeli proporcional)⁹.

Partitë nënshkruese të kësaj marrëveshjeje dhe simpatizuesit e tyre obligoheshin që të mos përkrahin kandidatë e pavarur¹⁰.

⁸*Marrëveshja e PPD dhe e PDSH*, Pika 2.2. Sipas saj, PPD do të nxjerrë kandidatë në këto njësi zgjedhore: në njësinë zgjedhore nr. 21 (Likovë); në njësinë zgjedhore nr. 44 (Strugë, Dollogozhdë, Llabunisht, Veleshtë); në njësinë zgjedhore nr. 52 (Gostivar, Çegran, Negotinë, Vrapçisht); në njësinë zgjedhore nr. 53 (Gostivar, Vrutok, Negotinë dhe Vrapçisht); në njësinë zgjedhore nr. 55 (Kamjan, Bogovinë, Bërvenicë); në njësinë zgjedhore nr. 56 (Tetovë, Kamjan, Bogovinë dhe Shipkovicë); në njësinë zgjedhore nr. 60 (Zhelinë, Jegunovcë, Bërvenicë); në njësinë zgjedhore nr. 64 (Haraçinë, Hasanbeg, Gazi-Babë); në njësinë zgjedhore nr. 75 (Qendër) dhe në njësinë zgjedhore nr. 81 (Saraj dhe Kondovë). Ndërsa, PDSH do të nxjerrë kandidatë në këto njësi zgjedhore: në njësinë zgjedhore nr. 42 (Kërçovë, Oslomej, Zajas, Sërmnovë); në njësinë zgjedhore nr. 43 (Dibër dhe Zhupë); në njësinë zgjedhore nr. 54 (Gostivar dhe Banjicë e Poshtme); në njësinë zgjedhore nr. 58 (Tetovë); në njësinë zgjedhore nr. 59 (Xhepçisht dhe Tearcë); në njësinë zgjedhore nr. 66 (Karshiakë) dhe në njësinë zgjedhore nr. 84 (Çair dhe Qendër). Dokumenti i Marrëveshjes, (kopja) ruhet në Arkivin e PDSH, në Tetovë.

⁹Sipas Ligjit për zgjedhjet e deputetëve, në zgjedhjet e treta parlamentare në Maqedoni, për Kuvendin e Republikës, zgjidheshin gjithsej 120 deputetë, prej të cilëve 85 zgjidheshin sipas principit të shumicës, ndërsa 35, sipas principit proporcional, Slluzhbenvesnik na RM, br. 24, 28 maj, 1988, *Zakon zaizbor na pratenicivo Sobranieto na Republika Makedonija, neni 2*.

¹⁰*Marrëveshja e PPD dhe e PDSH*, Pika 2.3.

Marrëveshja e nënshkruar jepte shpresë për një kthesë në integritet e reja dhe për procese që do të jenë më frytdhënëse jo vetëm për shqiptarët e Maqedonisë, por edhe për tërë hapësirën shqiptare. Ajo ishte një ngjarje e madhe politike, sepse partitë politike shqiptare synonin arritjen e të drejtave kombëtare përmes mjeteve demokratike. Njëkohësisht, ajo kishte për qëllim konsolidimin e radhëve të forcave politike të shqiptarëve që ishte garanci e paqes në Republikën e Maqedonisë.

Marrëveshja PDSH-PPD, pati dy efekte pozitive: nga njëra anë u maksimalizua vota shqiptare në Maqedoni¹¹, me të cilat u zgjodhën 25 deputetë republikanë dhe nga ana tjetër u parandaluan të gjitha konfliktet e mundshme brenda elektoratit shqiptar. Por, efekti më i madh historik, ishte se marrëveshja e subjekteve politike shqiptare dhe urtësia e popullit shqiptar të Maqedonisë, i cili i kontribuoi çështjes më madhore kombëtare, strehimit të të dëbuarve nga Kosova në Maqedoni dhe ndihmës së pakursyer që dhanë shqiptarët e këtij vendi për çlirimin e Kosovës nga pushtuesi serbë.

Zgjedhjet e treta parlamentare në Maqedoni sollën ndryshime në bllokun politik maqedonas. Në këto zgjedhje humbi Lidhja Socialdemokrate, ndërsa fitoi poli tjetër, koalicioni VMRO-DPMNE dhe Alternativa Demokratike. Faktorit politik shqiptar iu dha mundësia për reforma në interes të arritjes së barazisë së shqiptarëve në Maqedoni, përmes procesit demokratik parlamentar.

Zgjedhjet e treta parlamentare në Maqedoni, në momentin vendimtar historik e hoqën nga pushteti një strukturë maqedonase që ishte trashëgimtare e mendësisë së vjetër, të Lidhjes famëkeqe të

¹¹Flaka e vëllazërimit, 3 nëntor, 1998, “Në zgjedhjet e treta parlamentare partitë shqiptare së bashku fituan 25 deputetë”.

komunistëve. Ajo, për tetë vjet me radhë, gjatë tërë periudhës së sistemit pluralist kishte ngritur shtetin e ri, si shtet kombëtar maqedonas, pa e përfillur interesin kombëtar të popullit shqiptar. Në politikën e jashtme, struktura politike socialdemokrate, asnjëherë nuk ishte distancuar nga dhuna dhe terrori fashizoid serb, që ishte ushtruar kundër Kosovës dhe shqiptarëve të atjeshëm. Struktura e Lidhjes Socialdemokrate të Maqedonisë, haptazi mbante anën e qarqeve nacionaliste serbe kur ishte në pyetje “çështja e Kosovës”. Ky pohim u bë publik qysh në fillim të vitit 1998, kur edhe vetë kryetari Gligorov, propozoi “korridorin” famëkeq për transportimin e kosovarëve nëpër Maqedoni. Deklarata e Gligorovit, që u dha gjatë vizitës së tij në Moskë, më 1998¹², në fakt, ishte “komplot” i qarqeve serbo-maqedonase kundër shqiptarëve. Ajo manifestonte strategjinë e përbashkët serbo-maqedonase për pastrimin etnik të Kosovës. Pra, vetë presidenti i Maqedonisë, vihej në funksion të aleatit të Serbisë së Millosheviqit, që përmes dhunës serbe të mund të shpopullohej popullata shqiptare nga Kosova. Mirëpo, këtë plan antikosovar dhe antishqiptar e penguan zgjedhjet e treta parlamentare, të cilat nuk e legjitimuan strukturën politike që mbështeste platformën antikosovare të kryetarit Gligorov, por legjitimuan një strukturë politike që ishte në kundërshtim me të. Pra, zgjedhjet e treta parlamentare dhe humbja e aleatëve të qarqeve nacionaliste serbe në Maqedoni, ishte një moment vendimtar historik, si për popullin e Kosovës ashtu edhe për popullin shqiptar në tërësi.

Me humbjen e forcave të majta politike në zgjedhjet e treta parlamentare në Maqedoni, të socialdemokratëve dhe aleatëve të tyre,

¹²Rilindja, “Oferta e Gligorovit për korridorin nëpër IRJM është fashizoide”, Tiranë, 30 janar, 1998.

në Parlamentin republikan u ndërrua raporti i forcave në favor të faktorëve të djathtë politikë, VMRO-DPMNE, Partisë Demokratike Shqiptare dhe Aleancës Demokratike. Ky raport forcash politike mundësoi formimin e Qeverisë së LupçoGeorgievskit¹³.

Qeveria e Georgievskit u formua më 30 nëntor 1998¹⁴. Forcat politike që morën pjesë në këtë qeveri kishin pikëpamje identike për shumë çështje që ishin të lidhura me interesin shtetëror dhe kombëtar, si të shqiptarëve ashtu edhe të maqedonasve. Ja disa karakteristika të pikëpamjeve identike:

- të dy partitë i takonin proviniençës antikomuniste, me orientime perëndimore;
- të dy partitë i takonin qendrës së djathtë;
- të dy partitë i takonin proviniençës kombëtare dhe nuk përfaqësonin iluzionet e “bashkëjetesave” të mendësisë së vjetër komuniste;

¹³ Qeveria e Georgievskit përbëhej prej këtyre dikastereve: Ministrja e Mbrojtjes, Nikolla Klusev; Ministria e Punëve të Brendshme, Pavle Trajanov; Ministria e Drejtësisë, Vllado Kambovski; Ministria e Punëve të Jashtme, Aleksandar Dimitrov; Ministria e Financave, Boris Stojmenov, Ministria e Ekonomisë, Zhanko Çado; Ministria për Zhvillim, Miljana Danevska; Ministria për Urbanizëm, Ndërtimtari dhe Mbrojtjen e Ambientit Jetësor, Dushko Kadievski; Ministria për Bujqësi, Pylltari dhe Ekonominë e Ujërave, Vlladimir Xhabirski; Ministria për Arsim dhe Kulturë Fizike, Nenad Novkovski; Ministria për Kulturë, Dimitar Dimitrov; Ministria për Shëndetësi, Stojan Bogdanov; Ministria për Punë dhe Politikë Sociale, Bedredin Ibrahim; Ministria për Shkencë, Merie Rushani; Ministria e Pushtetit Lokal (që u formua ndërkohë), Xhevdet Nasufi; Ministria për Informata, Rexhep Zllatku dhe ministrat tjerë, Georgi Boev, Nikolla Gruevski, Martin Trenevski, Georgi Naumov, Radmilla Kiprijanova-Radovanoviç, Toni Popovski, Adnan Qahil, Ernad Fejzullahu. Vendimi i Kuvendit me nr. 08-4006, 30.11.1998, Sluzhben vesnik na Republika Makedonija, br. 58, 1 dekmvri, 1998.

¹⁴ Sluzhben vesnik na Republika Makedonija, br. 58, 1 dhjetor, 1998

- të dy partitë ishin për afri jo vetëm me boshtin Veri-Jug, por edhe me atë Lindje-Perëndim;

- të dy partitë ishin shumë të interesuara për integritet në strukturat euroatlantike...¹⁵

Në politikën e jashtme të partnerëve të Qeverisë së Georgievskit, dy çështje kyçe ishin identike:

Një nga vendimet më të rëndësishme që solli Qeveria e Georgievskit ishte instalimi i trupave logjistike të NATO-s, në Republikën e Maqedonisë¹⁶. Ky vendim hapi rrugë për forcat ushtarake të NATO-s, të cilat gjatë luftës çlirimtare të Kosovës hyjnë në IRJM. Për Kosovën, sikurse edhe për tërë rajonin, ky vendim i Qeverisë së Georgievskit kishte rëndësi strategjike¹⁷.

Partnerët qeveritarë e konsideronin rrezik potencial Serbinë e Millosheviqit. Lideri i VMRO-DPMNE, Lupo Georgievski, shumë herët e pati konsideruar Serbinë dhe politikën e saj si shumë të dëmshme për interesat kombëtare maqedonase. Qysh në vitin 1991, ai pati deklaruar, se: *“Rreziku më i madh për Maqedoninë dhe popullin maqedonas mund të vijë nga Serbia...”*¹⁸. Nga ana tjetër, faktori shqiptar ndikoi dukshëm që pikëpamjet e këtilla të Georgievskit, si kryetar i Qeverisë, të menaxhohen në funksion të çlirimit të Kosovës, duke e akorduar politikën e qeverisë me atë të bashkësisë ndërkombëtare.

Në momentin kur u formua Qeveria e Georgievskit, prioritet i politikës shqiptare ishte Kosova dhe çlirimi i saj nga okupatori serb.

¹⁵Kongresi i Tretë i Partisë Demokratike Shqiptare, *“Raporti i punës”*, Tetovë, 12 korrik 2003.

¹⁶Republika Makedonija i begalskata kriza ‘99, Shkup, 2000, f. 9.

¹⁷Po aty, f. 17.

¹⁸Zëri, *“Serbia është armiku më i madh”*, Prishtinë, 28 shtator 1991.

Kosova dhe populli shqiptar përjetonte momentet më të rënda të historisë së vet. Andaj, ky prioritet e shtyri Partinë Demokratike Shqiptare të marrë pjesë në Qeveri, pikërisht në kohën kur kriza e Kosovës hynte në fazën përfundimtare. Interesi strategjik dhe global shqiptar, për këtë fazë, ishte që t'i jepet hapësirë vepruese NATO-s në Maqedoni, si dhe të ruhej qetësia dhe stabiliteti i brendshëm. Subjekti politik shqiptar me përgjegjësinë më të madhe e kreu misionin e vet historik që ia kishte caktuar vetes dhe historikisht e arsyetoi ekzistimin e vet si formacion politik.

Që nga janari, 1998, pas sinjaleve të para të shpërthimit të luftës në Drenicë, faktori politik shqiptar në Maqedoni, i formoi shtabet e emergjencës, të cilat në kohën e krizës së refugjatëve u vunë në shërbim të zbutjes së pasojave të luftës. Kështu, në momentin kur filloi fluksi i refugjatëve nga Kosova, ky organizim perfekt dha efekte më të mëdha sesa angazhimi i organizatave të ndryshme humanitare botërore. Të gjithë organizmat ndërkombëtarë ishin të befasuar nga niveli i organizimit dhe nga pjekuria politike e shqiptarëve të Maqedonisë.

Pas bombardimeve të para të NATO-s mbi Jugosllavi, në Kosovë filloi hakmarrja e forcave militare serbe. Mijëra kosovarë të të gjitha rrethëve të ndryshme të Kosovës u përzunë me dhunë nga vatrat e tyre shekullore drejt Shqipërisë dhe Maqedonisë. Ky proces kishte për qëllim spastrimin etnik të Kosovës.

Numri më i madh i kosovarëve të dëbuar me dhunë nga shtëpitë e tyre, ishte nisur në dy drejtime, drejt Shqipërisë dhe drejt kufirit të Maqedonisë. Por, kalimi në këtë të fundit u vështirësua tej mase, sidomos në kufirin e Bllacës. Qarqet e caktuara maqedonase përpiqeshin të mbajnë kufirin e mbyllur, gjë që e revoltoi faktorin

politik shqiptar. Qarqet e këtilla udhëhiqeshin nga presidenti aktual, Kiro Gligorov. Ai, në këto momente të rënda për popullin e dëbuar kosovar, e mblodhi Këshillin për Siguri Kombëtare dhe mori vendim, në emër të sigurisë, që t'i mbyllë kufijtë hermetikisht. Ky vendim në fakt e prodhoi “Bllacën” dhe të gjitha maltretimet e kosovarëve në kufij¹⁹. Ndërkohë, në kohën e krizës kosovare, u mbajt takimi Klinton-Gligorov, në Uashington, në të cilin presidenti amerikan e kritikon ashpër presidentin maqedonas, për qëndrimin jomiqësor ndaj kosovarëve²⁰.

Numri i madh i të dëbuarve nga Kosova në Maqedoni filloi të regjistrohet qysh më 2 mars 1999. Sipas evidencës së Kryqit të Kuq të Tetovës, në këtë datë ishin regjistruar rreth 1 547 persona, të cilët vendoseshin kryesisht nëpër familjet shqiptare²¹. Me fillimin e bombardimeve të NATO-s mbi Jugosllavi, numri i të dëbuarve nga Kosova rritej në mënyrë rapide. Më 26 mars 1999, numri arriti në 13 626 persona²².

Nga 1 prilli 1999, filloi kolona e gjatë e të dëbuarve nga Kosova që hynin në ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë. Një ditë më vonë, ky numër, sipas Shoqatës Humanitare “ElHilal”, arriti në 50 000 persona, të vendosur në Kumanovë, Shkup, Tetovë dhe Gostivar²³. Më 16 prill, Ministria e Punëve të Brendshme të Maqedonisë, kishte regjistruar numrin e përgjithshëm të të dëbuarve

¹⁹“Raporti i punës”, i Kongresit II të Partisë Demokratike Shqiptare, Tetovë, 30-31 korrik 1999. Në IRJM u organizuan protesta masive dhe brutale antishqiptare dhe anti NATO. Presidenti Gligorov e kritikonte zëshëm Qeverinë VMRO-PDSH, pse ka lejuar shfrytëzimin e hapësirës ajrore të Maqedonisë, nga ana e NATO-s.

²⁰Arben Kondi, *Krimi i fundshekullit*, Tiranë, 2003, 45.

²¹*Republika Makedonija i begalskata kriza '99*, Skopje 2000, 16.

²²Po aty, f. 23.

²³Po aty, f. 26.

nga Kosova, që kishin hyrë në Maqedoni, prej 122 895 persona²⁴. Më 27 prill, ky numër u rrit në 180 000²⁵.



Kampet e refugjatëve kosovarë në Maqedoni.

²⁴Po aty, f. 37.

²⁵Po aty, f. 49.



Kampi i Neproshtenit në afërsi të Tetovës.

Gjatë majit 1999, me intensitet të shtuar vazhdonte të rritej numri i të dëbuarve kosovarë që hynin në Maqedoni. Më 3 maj, Ministria e Punëve të Brendshme, informonte se në Maqedoni janë

vendosur 221 000 të dëbuar nga Kosova²⁶. Një ditë më vonë filloi një valë e re e të dëbuarve. Sipas informatave të Ministrisë së Punëve të Brendshme, numri i përgjithshëm tanimë kishte arritur në 224 357 persona. Informatat e përditshme e organizatave humanitare, të vendit dhe ato të jashtme, si dhe të organeve shtetërore të Maqedonisë, informonin se numri i të dëbuarve vazhdimisht rritej edhe gjatë gjysmës së dytë të majit 1999. Sipas “Radio Internacional” të 28 majit 1999, vazhdonte hyrja e kosovarëve në Maqedoni. Sipas saj, numri i përgjithshëm kishte arritur në mbi 250 000 persona²⁷.

Edhe gjatë muajit qershor të vitit 1999, në Maqedoni hynë një numër i madh i të dëbuarve kosovarë. Kështu, numri i përgjithshëm i shqiptarëve dhe i të gjithë të dëbuarve nga Kosova, që hynë në Maqedoni, arriti në 379 523 persona. Prej tyre 92 100, u transferuan nëpër vende tjera, 154 989 u vendosën nëpër familjet e shqiptarëve të Maqedonisë, ndërsa 112 434 persona u vendosën nëpër kampet speciale, që u ndërtuan apostafat, nga fillimi i krizës kosovare.

Gjatë kohës së krizës kosovare, ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë ndërtoi kampe speciale për të dëbuarit kosovarë. Gjithsej u ndërtuan nëntë kampe: kampi i Bllacës²⁸, kampi i Stenkovcit 1 dhe Stenkovci 2, në të cilët u vendosën rreth 79 000 persona²⁹, kampi i

²⁶Po aty, f. 54.

²⁷Arben Kondi, *Krimi i fundshekullit*, Tiranë, 2003, 125.

²⁸Bllaca ishte kampi më i madh në hyrje të Maqedonisë prej nga të ikurit nga Kosova hynin në Maqedoni. Ky kamp shfrytëzohej për vendosje të përkohshme të të ikurve, prej nga më vonë bëhej shpërndarja e të ikurve nëpër kampe tjera ose nëpër familjet shqiptare (*Republika Makedonija i begalskata kriza '99*, 187).

²⁹Kampi Stenkovci 1 dhe Stenkovci 2 ishin të vendosur në rrugën Shkup-Kaçanik, drejt Bllacës (po aty, 187).

Neproshtenit, rreth 6 800³⁰, kampi i Senokosit, rreth 6 500³¹, kampi i Çegranit, rreth 69 000³², kampi i Bojanës, rreth 5 800³³ dhe kampi i Radushës, në të cilin u vendosën rreth 5 000 persona të dëbuar³⁴.

Më në fund, më 9 qershor 1999, pas miratimit të rezolutës në OKB, për ndërhyrje të forcave ndërkombëtare në Kosovë, nën komandën e NATO-s, u nënshkrua marrëveshja paqësore midis gjeneralit Xhekson dhe gjeneralëve serbë³⁵. Sipas “Zërit të Amerikës”, pritej që 50 000 trupa ushtarake të NATO-s të hyjnë në Kosovë.

Pas nënshkrimit të marrëveshjes, përmes “Zërit të Amerikës”, u dëgjua mesazhi historik i kryetarit të SHBA-së, drejtuar popullit shqiptar të Kosovës, BillKlintonit:

*“Ju do të ktheheni në shtëpitë tuaja. Ju do të keni shkollat tuaja dhe do të ushtroni fenë tuaj. Ju do të zgjidhni udhëheqësit që dëshironi dhe do të vendosni vetë të ardhmen tuaj. Ju nuk do t’i paguani taksa Jugosllavisë. Ju nuk do t’i çoni djemtë tuaj ushtarë për Jugosllavinë. Ju do të keni si monedhë tuajën markën ose dollarin”.*³⁶

Meritë të veçantë historike, për zbutjen e pasojave të krizës së Kosovës, padyshim kishin shqiptarët e Maqedonisë. Në këto

³⁰Kampi i Neproshteni ishte i vendosur katër kilometra në verilindje të Tetovës, në rrugën Tetovë-Jazhincë (po aty, 187).

³¹Kampi i Senokosit ishte i vendosur në fshatin Senokos, në rrugën që lidh fshatrat e rrëzës së Sharrit, në mes Tetovës dhe Gostivarit (po aty, 188).

³²Kampi i Çegranit ishte i vendosur rrëzë Malit të Thatë, rreth fshatrave Çegran dhe Forinë, katër kilometra larg Gostivarit (po aty, 188).

³³Kampi i Bojanës ishte i vendosur në veri të rrugës Shkup-Tetovë, afër fshatit Bojanë (po aty, 188).

³⁴Kampi i Radushës është ndërtuar afër fshatit Radushë të Shkupit (po aty, 188).

³⁵Arben Kondi, *Krimi i fundshekullit*, Tiranë, 2003, 152.

³⁶Po aty, f. 156.

momente të rënda historike, shqiptarët nuk kursyen asgjë për të ndihmuar vëllezërit nga Kosova. Në fakt, Kosova dhe kosovarët, gjatë tërë historisë më të re kombëtare, ishin sakrifikuar më shumë se kushdo tjetër, andaj Kosova dhe kosovarët e meritonin ndihmën dhe ngrohtësinë mbarëkombëtare.

Shqiptarët e Maqedonisë gjatë krizës së Kosovës hynë në radhët e popujve që dhanë më së shumti kontribut në zgjedhjen e çështjes së Kosovës. Nën presionin e popullit shqiptar dhe faktorit politik të tij, në Maqedoni, përveç numrit të madh të të dëbuarve kosovarë, të cilët u mbajtën kryesisht afër kufijve me Kosovën, Maqedonia u detyrua të pranojë më shumë se 20 000 trupa ushtarake të NATO-s, të cilët këtu u përgatitën për misionin paqësor në Kosovë³⁷. Ishte kjo një ndihmesë e madhe për tërë rajonin, e në veçanti për Kosovën dhe kombin shqiptar në tërësi.

³⁷*Republika Makedonija i begalskata kriza '99*, 187.

Zeqirja REXHEPI

SUMMARY

The Albanians in Macedonia and their role during the liberation of Kosovo

The fight for the liberation of Kosovo had to be supported by Macedonia as well. This could be greatly achieved by new anti-communist structures of the state. Macedonia has been used as an experimental range regarding the anti-Albanian policy during the socialist epoch. Throughout the lifespan of socialist Yugoslavia, Macedonia followed an identical approach, as Serbia did, towards the issue of Kosovo. The political structures that rose on power after the first pluralism elections of 1991, were remnants of the old mentality. Therefore, the Macedonia's policy towards the Kosovo didn't change at all, even after the proclamation of its independence. This policy continued its course throughout the Macedonia was ruled by social-democrats and Kiro Gligorov as its President. The approach towards Kosovo changed fundamentally only after the victory of new political forces following the third parliamentary elections. Observed from the Macedonian angle, the new foreign policy was also in their interest, because it didn't clash with the geostrategic policy of international community. But, such a policy was also in exact line with the national interests of Albanians.

On the other hand, the Georgievski Government, under the influence of the Albanian political factor, indirectly recognized

Kosovo as the fifth neighbor of the Former Yugoslav Republic of Macedonia. During and after the Kosovo crises the first meeting between two Prime Ministers, of two states emerging from Socialist Yugoslavia, took place: the Macedonian Prime Minister, Ljupce Georgievski, and the Kosovo Provisional Government Prime Minister, Hashim Thaqi, met in Skopje and Prishtina. On the contrary, the previous government of social-democrats and Kiro Gligorov, sharing identical views with Serbia nationalists, considered an independent Kosovo as potential threat to Macedonian state, therefore they firmly denied to accept Kosovo as the fifth neighbor of Former Republic of Macedonia. Additionally, Georgievski's meeting with Hashim Thaqi was considered harmful for Macedonia and was severely condemned by President Gligorov³⁸.

During the Kosovo war, the Albanian political entity articulated the Kosovo cause properly in the diplomatic sphere, while within the Former Yugoslav Republic of Macedonia it prevented the formation of Serbian or pro-Serbian projects and infrastructure. As it is known, the Kosovo crisis ended with the victory of the National Liberation War of Kosovo and the defeat of the colonialist regime of Milosevic. This marked an ending episode of oppression of Albanians in the former Yugoslavia.

³⁸ *Makedonija e se shto imame*, Kultura, 2002, f. 463.

Afrim Krasniqi

Kosovanë aktet zyrtare të shtetit shqiptar, 1991-2008

Analiza e akteve shtetërore dhe institucionale midis Shqipërisë e Kosovës përpara pavarësisë zyrtare (2008) bazohet në dy burime referuese: në dokumentacionin zyrtar të shtetit shqiptar, si dhe në dokumentacionin informal të ish-zyrtarëve të lartë, medias, raporteve dhe burimeve të tjera informative. Dokumentacioni zyrtar, sidomos ai që ka të bëjë me elementët më të rëndësishëm të bashkëpunimit, me strategjitë, planet, bisedimet, shkëmbimet dhe problematikat, janë pjesë e dokumentacionit “sekret shtetëror” dhe ende pa akses publik për shfrytëzim. Të tilla sidomos janë mbledhjet e mbyllura të Këshillit të Ministrave dhe të Këshillit të Sigurimit Kombëtar, urdhrat dhe vendimet e konsideruara sekret shtetëror të Ministrisë së Brendshme, Ministrisë së Mbrojtjes, Shërbimit Informativ Kombëtar, Ministrisë së Jashtme, Policisë së shtetit, Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, procesverbalet e takimeve midis udhëheqjes politike në Tiranë e Prishtinë, bisedimet me palët e treta për problematikën e Kosovës, etj. Për efekt studimi dhe për shkak të përvojës profesionale, kam pasur rastin të njihem me pjesën më të madhe prej tyre, por pa të drejtë aksesit të përcjelljes së plotë në publik.

Dokumentacioni tjetër publik lidhet me aktet zyrtare, si rezoluta, deklarata, kujtime të ish-zyrtarëve, njoftime dhe fjalime në forume ndërkombëtare, intervista dhe të dhëna teknike në sektorë të veçantë, sidomos në fushën e politikës së jashtme, arsimit, kulturës, rendit publik, sigurisë, bashkëpunimit ekonomik etj. Në lidhje me Kosovën kanë shkruar libra të dedikuar ose analiza me vlerë referuese tre presidentë të Shqipërisë, dy kryeministra, një ministër i jashtëm,

disa ambasadorë të rëndësishëm, si dhe një numër i madh studiuesish, ekspertësh, gazetarësh apo funksionarësh të niveleve të ndryshme. Megjithëse pjesa dominuese e tyre janë reflektime e përjetime personale, ato sjellin të dhëna dhe së bashku plotësojnë një pjesë të madhe të mozaikut lidhur me zhvillimet e tranzicionit dhe Kosovën si pjesë integrale të saj.

1990-1991, dritëhijet dhe tiparet e ritakimit me Kosovën

Shqipëria është shteti i vetëm që njohu pavarësinë e Kosovës, më 1991. Më 21 tetor 1991, Kuvendi miratoi unanimisht një deklaratë përmes të cilës Republika e Shqipërisë *“njuh Republikën e Kosovës si shtet sovran e të pavarur mbi bazën e lirisë dhe barazisë së plotë me të gjithë popujt e tjerë. Ai njuh, gjithashtu, si legjitime Qeverinë e re të Përkohshme të Republikës së Kosovës nën drejtimin e doktor Bujar Bukshit. Ai u bën thirrje opinionit demokratik ndërkombëtar dhe shteteve pjesëmarrëse të KSBE-së që të njohin dhe të respektojnë vullnetin e ligjshëm të popullit shqiptar të Kosovës. Kjo do të ishte një provë tjetër e angazhimit të tyre të singertë e pa paragjykime për zgjidhjen e drejtë të krizës jugosllave¹”*. Në maj 1992 u organizuan zgjedhjet në Kosovë duke u dhënë institucioneve përfaqësuese legjitimitetin demokratik. Të vetëdijshëm se ky proces nuk do të kishte njohje zyrtare ndërkombëtare dhe se institucionet e Kosovës do të ishin më shumë përfaqësuese sesa funksionale, Tirana dhe Prishtina e përdorën aktin e njohjes si bazë referimi për marrëdhënie me intensive dhe më institucionale. Në të gjitha aktet zyrtare që pasuan referimi ligjor ishte vendimi i Kuvendit i tetorit 1991 dhe detyrimi kushtetues i RSH për t’u kujdesur për shqiptarët jashtë kufijve shtetërorë.

Fazat e bashkëpunimit midis Shqipërisë dhe Kosovës përpara shpalljes zyrtare të pavarësisë, në shkurt 2008, lidhen mekurbëne

¹Kuvendi i Shqipërisë, Viti 1991, Punime të Kuvendit, Legjislatura e 12-të, f. 1873.

zhvillimeve politike në dy vendet. Në periudhën 1990-1992, ndodhi procesi i ritakimit të Shqipërisë me Kosovën, një proces më shumë deklarativ sesa institucional. Shqipëria ishte e vonuar në procesin e demokratizimit, e izoluar nga pjesa tjetër e botës, në varfëri ekonomike dhe pa fuqi reale politike, ekonomike dhe strukturore për të ndikuar dhe ndihmuar zhvillimet në Kosovë. E vetëdijshme për këtë, udhëheqja shtetërore e Tiranës e përdori çështjen e Kosovës për të ndikuar në zhvillimet e brendshme politike. Disa delegacione politike e kulturore, përfshirë edhe udhëheqësi i LDK-së në atë kohë, Ibrahim Rugova, realizuan vizita zyrtare në Shqipëri dhe u takuan me të gjithë spektrin politik. Këto vizita u pritën me kritika nga SHBA-ja dhe partnerë të tjerë perëndimorë pasi, R.Alia synonte pengimin e procesit të demokratizimit dhe për këtë *“ta shfrytëzonte ndikimin e Kosovës që gjoja të tregojë se ishin pikërisht kosovarët dhe lëvizja e tyre që kërkonin maturi politike në Shqipëri e jo kurs radikal kthesash”*².

Pikëpamja kritike amerikane kishte një bazë solide. Dokumentacioni arkivor i kësaj periudhe sjellë dëshmi të shumta të faktit se midis ligjërimit zyrtar e publik dhe ligjërimit e vendimmarrjes brenda strukturave të larta drejtuese të regjimit kishte një diferencë të madhe. Ndryshimi i sistemit politik në Shqipëri në dhjetor 1990 dhe vendosja e pluralizmit politik, solli ndryshime rrënjësore edhe në raportet midis shqiptarëve të Shqipërisë dhe atyre në Kosovë dhe në ish-republikat e Jugosllavisë. Prej grevës së minatorëve, në shkurt 1989, media zyrtare në Shqipëri nisi raportime të shumta mbi zhvillimet në Kosovë. Shqetësimi kryesor lidhej me gjendjen e të drejtave të njeriut dhe pozitën e shqiptarëve atje, duke akuzuar regjimin serb për dhunën dhe reprezalje. Për shkak të zgjedhjes për të qenë jashtë proceseve integruese dhe pozitës së dobët në raport me shtetet kryesore ndërkombëtare, Tirana zyrtare në shkurt-gusht 1990, nuk adresoi

²Jusif Buxhovi, *Kthesa historike*, Faik Konica, Prishtinë 2010, f. 309.

kërkesa për rol më të madh ndërkombëtar në Kosovë dhe as për ngritjen e kësaj problematike në OKB dhe në organizma të tjerë ndërkombëtarë.

Në korrik 1990, Byroja Politike i përdori zhvillimet në Kosovë për të akuzuar kryesisht shtetet perëndimore se kanë përgatitur krizën e ambasadave në Shqipëri dhe vetë qytetarët që hynë në ambasada si viktimë të skenarëve antishqiptarë. Në gusht 1990, gjatë takimit me senatorin amerikan, De Koncini, ndonëse Alia kërkoi presion më të madh ndërkombëtar për zhvillimet në Kosovë, refuzoi kërkesën e palës amerikane për ndryshime të shpejta politike në Shqipëri, lejimin e organizatave të të drejtave të njeriut dhe pranimin e kriterëve të KSBE-së. Në javën e fundit të muajit shtator 1990, kryetari i shtetit Ramiz Alia, mori pjesë në punimet e Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së, vizita e parë e një kryetari shteti shqiptar prej krijimit të saj. Në fjalimin në seancën plenare, ai foli gjatë për Kosovën, duke deklaruar se: *“Në Kosovë dhe në viset e tjera të Jugosllavisë ku banojnë shqiptarët po bëhen krime që edhe për mesjetën e errët do të ishin të shëmtuara”*. Ai apeloi komunitetin ndërkombëtar të mos qëndrojë indiferent ndaj kësaj gjendjeje dhe shtoi se shqiptarët *“nuk kërkojnë asnjë të drejtë më shumë nga ç’kanë serbët, sllovenët, kroatët ose maqedonasit. Po ata nuk kanë pranuar dhe nuk do të pranojnë të kenë dhe më pak. Ata duan të jenë subjekt i barabartë si dhe kombet e tjerë që përbëjnë Jugosllavinë. Shqiptarët duan t’ju njihet e drejta, të vendosim vetë për fatin e tyre”*³.

Fjalimi e vendosi shtetin shqiptar në një pozicion të ri në aspektin ndërkombëtar dhe në raport me Jugosllavinë, si dhe solli një ndryshim të rëndësishëm në diskursin politik të Tiranës zyrtare ndaj Kosovës. Megjithatë, në takimin e kryetarit të Presidiumit të Kuvendit Popullor, Ramiz Alia, me ministrin e Jashtëm të Jugosllavisë, Budimir Lonçar, më 26 tetor 1990, ky i

³Ramiz Alia, *Jeta ime*, Toena, Tiranë 2010, f. 353.

fundit u shpreh i befasuar nga fjalimi në OKB dhe akuzat ndaj Jugosllavisë. Sipas procesverbalit të takimit, Lonçar tha se: *“Kjo nuk ka qenë gjë e mirë. Unë mendoj se kjo ka qenë e njëanshme dhe e internacionalizon çështjen tonë, marrëdhëniet tona. Praktikisht fjalimi juaj marrëdhëniet me Jugosllavinë i ka reduktuar në çështjen e Kosovës, gjë që bien në kontradiktë me atë që ju saktësisht dhe në mënyrë të drejtë e thoni tani”*⁴. Nga ana tjetër, Alia këmbënguli në interesin e Shqipërisë për marrëdhënie të mira me Jugosllavinë si dhe iu përgjigj: *“Lidhur me fjalimin tim në OKB me çështjen e Kosovës unë nuk kam gjë të veçantë, po nuk jam unë që e institucionalizoj këtë problem. Për çështjen e Kosovës po flet tërë Evropa, flet Parlamenti Evropian, flet Konferenca e Helsinkit, flet Senati Amerikan. Tani si gjykoni ju, shqiptarët duhet të heshtin?”*.

Ndryshe nga ligjërimi publik (fjalimet dhe deklaratat) në mbledhjet e strukturave të larta të regjimit, Kosova dhe problematika rreth saj trajtohej në një prizëm tjetër ku parësore ishte nevoja e ruajtjes së kontrollit politik në Shqipëri. Për shembull, në mbledhjen e Byrosë Politike, më 23 gusht 1990, u fol gjatë mbi impaktine zhvillimeve në Kosovë ndaj agjendës politike në Shqipëri. Në këtë këndvështrim, udhëheqja shtetërore e Tiranës ndjehej e frustruar nga sjellja e elitës së re politike shqiptare në Kosovë, siç ajo e cilësonte alternativa kosovare, ku citohet Rugova, Qosja, Cana⁵, të cilët u akuzuan se nuk kanë kërkuar mbështetjen e Shqipërisë, por të Perëndimit. Shqetësimi kryesor lidhej edhe me impakti që kanë në Tiranë deklaratimet e intelektualëve të Kosovës për nevojën e një Shqipërie demokratike. Ramiz Alia ishte i qartë në shprehjen e këtij shqetësimi kur u shpreh: *“Rreth Kosovës po përvijohet edhe një plan djallëzor, që duhet ta kemi mirë parasysh. Po përhapet mendimi se zgjidhja e çështjes së Kosovës varet nga RPSSH. Në ç’mënyrë?”*

⁴ Arkivi i MPJ. Viti 1990. Fondi i Presidiumit të KP, Dosja 338, f. 22.

⁵ AQSH. Viti 1990, Fondi 14, Dosja 16. Mbledhja e Byrosë Politike 23.8.1990, f. 44.

Shqipëria të ç'ideologjizohet, të heqë dorë nga socializmi, të pranojë sistemin pluripartiak, të bëjë pajtimin kombëtar, pra të pajtohet me vijën e politikën e organizatës së Ballit Kombëtar e të Legalitetit, shkurt të shndërrohet në një vend kapitalist"⁶. Sipas tij, tezat në mbështetje të ndryshimit në Shqipëri janë në favor të regjimit serb dhe Millosheviqit. Ai akuzoi ndikimin e elitës kosovare në rrethet intelektuale në Tiranë, si dhe kërkoi rol më aktiv të Sigurimit të Shtetit kundër shtetasve nga Kosova që ndodhen në Shqipëri. Tezat e tij u mbështet nga të gjithë folësit. Këshilltari i tij kryesor politik, Sofokli Lazri, u shpreh me tone kritike, ndër të tjera kundër faktit se *"kosovarët tani na kërkojnë të respektojnë të gjitha ato që përmban Karta e Helsinkit"*, ndërsa sekretari i ri i KQ, Spiro Dede, tha se intelektualët i kanë shtruar shpesh pyetjen *"pse nuk dalin me deklarata për mbrojtjen e çështjes së Kosovës? Pse nuk e shtrojmë çështjen e Kosovës në OKB?"*⁷, si dhe konfirmoni se media zyrtare, përfshirë gazeta *"Zëri i popullit"* nuk ka pasur botime për Kosovën sipas një udhëzimi të ardhur nga Komiteti Qendror. Edhe artikujt që mund të vinin, sipas udhëzimit, duhej të kalonin më përpara në vlerësimin e shefit të propagandës në Komitetin Qendror, S. Lazri, përpara botimit në gazetë.

Një detaj tjetër domethënës ishte debati rreth pranimi ose jo të Shqipërisë në procesin e KSBE (Konferencës për Sigurinë e Bashkëpunimin në Evropë). Në relacionin e ministrit të Jashtëm, Reis Malile, mbajtur në këtë mbledhje, ai informoi argument plus për hyrjen në këtë organizatë ishte edhe mundësia për të folur aty edhe në lidhje me shqetësimet për situatën në Kosovë. Në përgjigje të kësaj teze, disa anëtarë të rëndësishëm të udhëheqjes, përfshirë anëtari i Byrosë Politike dhe ministri Pali Miska, kundërshtoi duke thënë

⁶AQSH. Viti 1990, Fondi 14, Dosja 16. Mbledhja e Byrosë Politike 23.8.1990, f. 44.

⁷AQSH. Viti 1990, Fondi 14, Dosja 16. Mbledhja e Byrosë Politike 23.8.1990, f. 89.

se: “Për Kosovën të sakrifikojmë shumë gjëra ne?”⁸. Po ashtu, në të njëjtën mbledhje u fol edhe për bisedimet midis Tiranës e Beogradit në kuadër të Samitit të Ministrave të Jashtëm që do të zhvillohej në tetor 1990, në Tiranë. Ministri Malile, informoi Byronë Politike se në funksion të konferencës së Ministrave të Jashtëm të Ballkanit u dakordua për të evituar problemet e mprehta dypalëshe, duke specifikuar se “*çështja e Kosovës nuk do të ngrihet me emër, por në kuadrin e respektimit të të drejtave të tërë popujve në një shtet shumëkombësh. Për këtë qëndrim, përfundimisht do të bihet dakord në mbledhjen e zv.ministrave të jashtëm në shtator në Bukuresht, e cila do të merret edhe me përgatitjet e takimit të Tiranës*”⁹. Ky qëndrim u mbështet nga të gjithë anëtarët e Byrosë dhe u pasqyrua edhe gjatë Samitit të Ministrave, ku asnjë palë, përfshirë Shqipërinë, nuk foli për ngjarjet në Kosovë dhe problematikat që lidhen me to.

Shkëmbimet intensive midis Shqipërisë e Kosovës, më 1991-1992, ndodhënnë kushtet kur dy vendet, për motive të ndryshme, ndodheshin në gjendje jashtëzakonisht të vështirë. Kosova ishte në përpjekjet për të krijuar elitën politike përfaqësuese dhe për të sensibilizuar Perëndimin, e Shqipëria ishte në fazën e jetësimit të ndryshimit të sistemit. Tipari kryesor i kësaj periudhe është përpjekja e Tiranës dhe Prishtinës për të vendosur ura bashkëpunimi, por edhe keqkuptimet e dyanshme. Prishtina kishte shumë më tepër pritshmëri ndaj Tiranës zyrtare sesa kapacitetet dhe potenciali i saj real, ndërkohë që elitat në Tiranë e përdorën Kosovën për të përfituar politikisht dhe shmangur përgjegjësitë ndaj të kaluarës. Adem Demaçi kishte pritshmëri maksimale, më 1992, kur deklaroi: “*Funksioni i Shqipërisë është kardinal, është rrënjësor, është qenësor. Pa u angazhuar Shqipëria me krejt potencialin që ka në mbrojtje të vëllezërve të vet, jo që të pushtojë Jugosllavinë, jo që ta*

⁸AQSH, Viti 1990, Fondi 14, Dosja 16. Mbledhja e Byrosë Politike 23.8.1990, f. 53.

⁹AQSH, Viti 1990, Fondi 14, Dosja 16. Mbledhja e Byrosë Politike 23.8.1990, f. 12.

*prishë kufirin, por që të organizohet në mbrojtje, t'i mbrojë kërkesat e tyre që janë krejtësisht legjitime, nuk do të ishin të gjitha këto përparime serioze*¹⁰. Nga ana tjetër, udhëheqësi i opozitës shqiptare, më 1991, ishte i bindur se “*vetëm një sistem demokratik në Shqipëri ka të drejtën zyrtare dhe morale që të luftojë për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të shqiptarëve kudo që janë*”¹¹. Teza dominuese e linjave reformatore në Tiranë e Prishtinë, ishte se roli i Shqipërisë në mbështetjen e Kosovës mbetej i rëndësishëm, si dhe shumë më efektiv nëse Shqipëria do të ishte më demokratike, më e integruar dhe më e pranishme në vendimmarrjet politike të kohës.

Gjatë 6 muajve të parë të vitit 1991, procesi politik në Shqipëri u shoqërua me kriza të thella politike, rënien e tri qeverive, trazira masive në vend, valë emigrimi dhe vetëm në mesin e qershorit 1991 me një qeveri të përbashkët midis mazhorancës komuniste dhe opozitës antikomuniste. Kjo periudhë shënoi edhe takimet e parë publike midis udhëheqjes shqiptare në Kosovë dhe asaj në Tiranë.

Bilanci: dominuese aktet deklarative sesa institucionale

Referuar vitit 1991, pas ndryshimit të sistemit politik në Shqipëri, aktet zyrtare të kësaj periudhe vijuan të jenë më shumë deklarative sesa institucionale. Qeveria Çarçani (janar-shkurt), ajo Nano (shkurt-maj) nuk arritën të ndërmarrin akte zyrtare bashkëpunimi ndaj Kosovës, për shkak edhe të rrethanave të jashtëzakonshme të punës së tyre dhe afatit të shkurtër kohor në funksion. Mungesa e tyre u plotësua nga bashkëpunimi jo publik i koordinuar midis presidentit Alia, shërbimit sekret shqiptar, si dhe i dakorduar me opozitën kryesore, Partinë Demokratike. Në

¹⁰ Adem Demaçi, *Organizimi, kusht për fitore*, Intervistë më 24-24 gusht 1992,

“Nyja shqiptare”, M. Emërllahu, Eurorilindja 2001, f. 221.

¹¹ Sali Berisha, *Bashkimi, ide udhëheqëse e shqiptarëve*, Intervistë më 23 maj 1991, “Nyja shqiptare”, M. Emërllahu, Eurorilindja 2001, f. 177.

dokumentacionin zyrtar nuk ka ligje, vendime të Këshillit të Ministrave apo urdhra të publikuar në Fletoren Zyrtare mbi këtë bashkëpunim, por në dëshmi të shumta të ish-zyrtarëve të lartë dhe personave pjesëmarrës është pranuar dakordësia për strehimin në Shqipëri sipas nevojës të të gjithë deputetëve e zyrtarëve që ishin në kërkim nga policia serbe, të strehimit të të rinjve kosovarë që i largohen shërbimit ushtarak, të trajnimit të të rinjve të interesuar për veprime të mundshme ushtarake etj. Zyrtarisht u njoftua vetëm miratimi nga Qeveria e daljes së gazetës “Kosova”, e cila luajti një rol të madh informues dhe sensibilizuese në Shqipërinë e viteve ‘90-ta¹².

Akti i parë zyrtar i përket mbledhjes së Këshillit të Ministrave, më 6 korrik 1991, gjatë të cilës u raportua dhe u debatua me detaje për zhvillimet e asaj periudhe në Kosovë dhe rajon¹³. Në javën e fundit të qershorit, Kroacia e Sllovenia shpallën shkëputjen, akt që pritej të kishte impakt në nisjen e një konflikti të gjerë në Jugosllavi. Fakti që Qeveria përbëhej nga i gjithë spektri politik¹⁴ dhe drejtues, ishin kryeministri Bufi (PS) dhe zv.kryeministri Pashko (PD), i dha vlerë të veçantë debatit sepse hodhi bazat e një bashkëpunimi shtetëror mbipartiak me Kosovën. Në përfundim të mbledhjes, Qeveria doli me një deklaratë, sipas të cilës shprehu “*shqetësimin e saj për situatën e krijuar në Jugosllavi pas ndërhyrjes me dhunë të forcave të Ushtrisë federative jugosllave kundër shpalljes së pavarësisë prej Sllovenisë dhe Kroacisë*”, si dhe theksoi se “*për popullin dhe Qeverinë shqiptare, për Shqipërinë si vend ballkanik e fqinj i Jugosllavisë, ky shqetësim merr përmasa dhe rëndësi të veçantë, duke pasur parasysh që në Jugosllavi jetojnë aktualisht 3*

¹² AQSH, Fondi i Këshillit të Ministrave, Dosja 596, “Lejimi i botimit i gazetës “Kosova””, 17.06.1990, f. 2.

¹³ AQSH, Fondi i Këshillit të Ministrave, Dosja 230, “Për çështjen e Kosovës”, 06.07.1991, 2-34.

¹⁴ Qeveria “Bufi” u krijua në qershor 1991 deri në dhjetor 1991. Ajo është qeveria e parë e koalicionit të gjerë partiak në Shqipëri, e krijuar për periudhë tranzitore deri në zgjedhjet e ardhshme dhe zyrtarisht u cilësua “Qeveria e Stabilitetit”.

milionë bashkatdhetarë tanë, pra, gjysma e kombit shqiptar. Pas 10 vjetësh represioni të egër dhe kufizimit të pandërprerë të të drejtave kombëtare, aktualisht Kosova ndodhet e pushtuar ushtarakisht nga Serbia”¹⁵. Sipas pikëpamjes së Qeverisë shqiptare, alarmues është fakti se popullsia serbe po armatohet, banda paraushtarake po provokojnë në çdo çast, duke kërkuar pretekste për shkallëzimin e gjenocidit kundër shqiptarëve, gjë e cila “për një Evropë që ecën drejt paqes, sigurimit e bashkëpunimit në shkallë kontinenti, plane të këtilla janë të papranueshme. Akoma më të papranueshme janë ato për popullin dhe Qeverinë shqiptare. Natyrisht, është e drejta e popujve të Jugosllavisë që të vendosin vetë për fatin dhe për të ardhmen e shtetit të tyre”¹⁶.

Në muajit në vijim, Shqipëria bëri përpjekje për të tërhequr vëmendjen e bashkisë ndërkombëtare ndaj gjendjes në Kosovë. Ajo apeloj zyrtarisht përmes disa akteve: deklarata, raportime në parlament, letra drejtuar kryetarëve të qeverive, nisma në kuadër të OKB-së e KSBE, takime zyrtare etj., “për një zgjidhje politike të problemit në përputhje me kartën e OKB-së dhe me dokumentet e Helsinkit” dhe që faktori ndërkombëtar “të mos lë kurrësi jashtë këtij interesimi problemin e shqiptarëve që jetojnë në Jugosllavi, si një nga aspektet më të mprehta të krizës jugosllave”¹⁷. Fushata pati efekt pozitiv në rritjen e nivelit të sensibilizimit por dështoi të sigurojë pjesëmarrjen e saj në Konferencën e Hagës mbi Jugosllavinë. Lidhur me këtë fakt, shteti shqiptar reagoi edhe publikisht. Më 5 shtator u deklarua se: “Qeveria e Republikës së Shqipërisë përkrahë dhe vlerëson vendimin për mbajtjen e Konferencës së Paqes për Jugosllavinë, duke e konsideruar atë si një hap të rëndësishëm drejt zgjidhjes paqësore të krizës jugosllave. Ajo i përmbahet fort

¹⁵ AQSH, Fondi i Këshillit të Ministrave, Dosja 230, “Për çështjen e Kosovës”, 06.07.1991, 30-31.

¹⁶ Deklaratë e Qeverisë shqiptare, ATSH / TVSH, 8 korrik 1991.

¹⁷ Ylli Bufi, *Në fillimet e tranzicionit*, UET, Tiranë, 2016, f. 130.

pikëpamjes se në Konferencën e Paqes për Jugosllavinë në Hagë duhet të marrin pjesë dhe të thonë fjalën e tyre, bashkë me të tjerët, përfaqësuesit e popullit shqiptar në Jugosllavi. Ajo deklaroi se lënia jashtë kësaj konference e shqiptarëve, popullsia e tretë, për nga numri, në Jugosllavi, pas serbëve e kroatëve, do të ishte e pajustificueshme dhe do të vinte në diskutim suksesin e vërtetë të saj. Në rast se historia vlerësohet si një mësuese e mirë, nuk duhet të përsëriten gabimet e kaluara të saj”¹⁸. Përveç Qeverisë, presidenti Alia u investua në takime dhe në lobim, përfshirë në letrën zyrtare që më pas u bë publike adresuar Lordit Carrington, përmes të cilës apelonte pjesëmarrjen e shqiptarëve të Jugosllavisë në këtë Konferencë.

Kuvendi i Shqipërisë ishte gjithashtu mjaft aktiv në debatet mbi Kosovën dhe në iniciimin e disa deklaratave dhe rezolutave në mbështetje të saj, më 1991. Në rezolutën e parë të lexuar nga deputeti Esat Myftari, diplomat në MPJ dhe me origjinë nga Kosova theksohej: “Populli shqiptar i Kosovës e ka shprehur qartë vullnetin e tij sovran në vendimet e Kuvendit të Kosovës, më 2 korrik 1990”, dhe në emër të Kuvendit të RSH u kërkua: “Shqiptarët, në trojet e veta, brenda shtetit federativ jugosllav, të njihen si popull e si komb dhe të garantohet pjesëmarrja e tyre në bisedime për marrëveshjen e re si të barabartë me popujt e tjerë të Jugosllavisë; të mos lejohet rajonizimi i Kosovës, si dhe të njihen e të respektohen të gjitha të drejtat e vëllezërve tanë shqiptarë me banim në trojet e veta në Jugosllavi, që garantohen nga Kushtetuta e Jugosllavisë dhe nga të drejtat e Helsinkit, përfshirë këtu edhe të drejtën e vetëvendosjes”. Rezoluta i kërkoi Qeverisë shqiptare të bëjë demarshe pranë shteteve dhe organizatave ndërkombëtare për garantimin e këtyre të drejtave, duke apeluar opinionin evropian e atë botëror “t’u bëjmë apel për mirëkuptim më të madh, për një angazhim më të plotë e konkret, në mënyrë që të parandalohet ndezja e zjarrit nga shovinistët

¹⁸ Deklaratë e Qeverisë shqiptare, ATSH / TVSH, 5 shtator 1991.

serbomëdhenj, se një zjarr i tillë nuk do të njihte kufij”¹⁹. Po ashtu, Kuvendi i Shqipërisë në një rezolutë të posaçme në korrik 1991, përmes të cilës u deklarua se “shqiptarëve në Jugosllavi t’u njihet statusi i republikës së tyre në kuadrin e Jugosllavisë së re; asnjë problem që lidhet me të ardhmen e Jugosllavisë nuk mund të zgjidhet me pjesëmarrjen e organeve legjitime të Republikës së Kosovës, e cila shpreh vullnetin e popullit shqiptar të Kosovës”, si dhe apeloi “të gjithë parlamentete të shteteve të Evropës, të SHBA-së dhe të shteteve të tjera të botës, për zgjidhjen në mënyrë paqësore demokratike të mosmarrëveshjeve midis kombeve në Jugosllavi, ku Republika e Kosovës do të jetë e barabartë me republikat e tjera të Jugosllavisë”²⁰.

Në mediat e Tiranës u botua në vjeshtën e vitit 1991 letra e 324 intelektualëve, përmes të cilës apelohej njohja zyrtare e Republikës së Kosovës nga ana e shtetit shqiptar, si dhe bëhej thirrje për një politikë më aktive ndaj Kosovës e çështjes shqiptare në përgjithësi. Ky ishte një tregues i rritjes së sensibilitetit publik për zhvillimet në Kosovë. Pas referendumit për pavarësi, në shtator Qeveria shqiptare mbajti një mbledhje të veçantë, ku u diskutua lidhur me referendumin dhe impaktin, rolin e Ministrisë së Jashtme në trajtimin e tezave dhe problematikave të Kosovës, çështje të sigurisë në raportet midis Shqipërisë dhe Jugosllavisë, si dhe nevojën e një fushate lobuese më të madhe ndërkombëtare nga ana e shtetit shqiptar²¹. Më 28 shtator, Qeveria shqiptare lëshoi një deklaratë zyrtare mbështetëse për rezolutën e Kuvendit të Shqipërisë lidhur me situatën në Kosovë, referendumin dhe kërkesat legjitime të shqiptarëve atje. Gjatë vitit 1991, MPJ raportoi edhe se përfaqësuesi

¹⁹Kuvendi i Shqipërisë, Viti 1991, Punime të Kuvendit, Legjislatura e 12-të, f. 277.

²⁰Kuvendi i Shqipërisë, Viti 1991, Punime të Kuvendit, Legjislatura e 12-të, f. 1200.

²¹AQSH, Fondi i Këshillit të Ministrave, Dosja 293, “Referendumi në Kosovë”, 25.09.1991, f. 2-6.

shqiptar e ngriti shqetësimet në sesionin e Këshillit Ekonomik e Social të OKB-së për të drejtat e njeriut²². Ajo lëshoi një deklaratë zyrtare proteste ndaj vendimit të Kuvendit të Serbisë kundër Kosovës²³ apo përmes saj autoritetet shqiptare ranë dakord me drejtuesit e Kosovës për hapjen e zyrës së Kosovës në Tiranë²⁴.

Vitet '90-ta dhe krijimi i marrëdhënieve intensive me Kosovën

Një ndryshim i rëndësishëm në bashkëpunimin Shqipëri-Kosovë ndodhi pas rotacionit politik në Shqipëri, në mars 1992. Presidenti i ri Berisha, dhe Qeveria e re e drejtuar nga A.Meksi, ku bënë pjesë edhe komunistët e moderuar të rigrupuar në Partinë Socialdemokrate, mbështetën plotësisht proceset politike që morën jetë me zgjedhjet e para në Kosovë, në maj 1992 dhe institucionet e dala prej tyre. Kjo ishte faza ku Tirana zyrtare ishte e avancuar në qëndrimet politike ndaj Kosovës dhe zyrtarisht krijoi të gjithë mekanizmat dhe lehtësirat në dispozicion të tyre. Në janar, Kuvendi mbështeti manifestimin e parë të madh të rinisë studentore në Tiranë në mbështetje të Kosovës. Kuvendi miratoi një përshëndetje, të cilën e përcolli edhe si qëndrim politik të tij. Në tekstin e dokumentit thuhet: *“Ky miting është një shprehje tjetër e gjallë e ndjenjave të rinisë dhe gjithë popullit tonë në mbështetje të të drejtave legjitime të shqiptarëve në bazë të dokumenteve ndërkombëtare, siç janë Karta e Helsinkit dhe ajo e Parisit”*²⁵.

Një prej akteve të para politike ishte konfirmimi i njohjes së pavarësisë së Kosovës dhe legjitimitetit të institucioneve përfaqësuese të saj, përfshirë legjitimin e presidentit Rugova, Kuvendin e Kosovës, Qeverinë Bukoshi etj. Më 1 qershor 1992, Kuvendi i RSH-së miratoi

²² Arkivi i MPJ, Viti 1991, Dosja 1610, kutia 47, f. 2.

²³ Arkivi i MPJ, Viti 1991, Dosja 1616, kutia 47, f. 2-3.

²⁴ Arkivi i MPJ, Viti 1991, Dosja 1617, kutia 47, f. 2-3.

²⁵ Kuvendi i Shqipërisë, Legjislatura e 12-të, Viti 1991, f. 2250.

një deklaratë mbështetëse për Kuvendin e Kosovës të përgatitur nga Komisioni i Përhershëm i Punëve të Jashtme. Sipas tekstit të deklaratës: *“Kuvendi i RSH-së mbështet fuqimisht përpjekjet dhe luftën politike për vetëvendosje të popullit të Kosovës për të ndrequr paqësisht padrejtësitë historike, të 3 milionë shqiptarëve që jetojnë në këtë fundshekull në trojet e tyre autoktone, në ish-Federatën Jugosllave, ku duhet të kenë po aq të drejta sa të gjithë popujt e tjerë, për të gëzuar brenda shtetit të tyre, lirinë, demokracinë, barazinë si kërkesa themelore të rendit të ri të bashkësisë evropiane”*²⁶. Po ashtu, Kuvendi miratoi edhe një deklaratë mbështetëse për presidentin Rugova pas zgjedhjes së tij në maj 1992. Në tekstin zyrtar thuhej se *“kjo ngjarje e shënuar erdhi si rrjedhojë e punës dhe vullnetit të asaj politike që treguat në planin evropian dhe ndërkombëtar, për të bërë të njohur çështjen kosovare dhe për t’i mbrojtur e trajtuar me kompetencë të drejtat e nëpërkëmbura të tij”*²⁷.

Në gusht 1992, midis dy qeverive nisën diskutimet mbi bashkëpunimin institucional. Produkti i parë ishin përpjekjet për krijimin e komisionit koordinues me Republikën e Kosovës për bashkëpunimin në fushën e ekonomisë²⁸. Qëllimi kryesor ishte krijimi i një shtrati bashkëpunimi midis institucioneve, në mënyrë që t’i jepej më shumë mbështetje edhe Qeverisë së Kosovës, e cila e ushtronte aktivitetin e saj në mërgim. Pjesë e këtij bashkëpunimi ishin edhe projektet konkrete, për shembull, takimet e ekspertëve për rrugën lidhëse midis Durrësit e Kukësit apo për shfrytëzimin e mineralit të feronikelit²⁹. Më 1993, vullneti për bashkëpunim ekonomik u zgjerua me një program konkret dhe të gjithanshëm që përfshiu sektorë më të shumtë të ekonomisë dhe çështjeve sociale³⁰, por pa impakt konkret

²⁶Kuvendi i Shqipërisë, Viti 1992, Punime të Kuvendit, Legjislatura e 13-të, f. 579.

²⁷Kuvendi i Shqipërisë, Viti 1992, Punime të Kuvendit, Legjislatura e 13-të, f. 580.

²⁸AQSH, Viti 1992, Dosje 860, Fondi i Këshillit të Ministrave, 18.08.1992, f. 1-11.

²⁹Aleksandër Meksi, *Rrugë e vështirë*, Nr.1, Tiranë, 2015, f. 349.

³⁰AQSH, Viti 1993, Dosje 623, Fondi i Këshillit të Ministrave, 27.08.1993, f. 4.

për shkak të gjendjes në Kosovë. Në korrik 1992, presidenti inicioi ndryshime në legjislacionin për shtetësinë, duke lejuar dy ose më shumë shtetësi për shtetasit shqiptarë. Sipas dekretit *“personat që do të rezultojnë me më shumë se një shtetësi, si pasojë e zbatimit të këtij dekreti, do të gëzojnë të drejtat dhe do të përmbushin detyrat që parashikohen nga Kushtetuta dhe legjislacioni shqiptar në fuqi për çdo shtetas të Republikës së Shqipërisë”*³¹. Në vijim të këtij akti gjatë fundit të vitit 1992 dhe më pas më 1993 janë disa urdhra, vendime që rregullojnë trajtimin e qytetarëve të Kosovës me të drejta politike e financiare të njëjta me qytetarët e Shqipërisë. Për shembull, me vendim nr. 294, Qeveria ndërhyri për trajtimin si shtetas shqiptar në marrëdhëniet financiare në hotelet e qyteteve ku do të strehohen artistët pjesëmarrës te *“Java kulturore e Kosovës”*³².

Gjatë vitit 1992, MPJ raportoi kryesisht për aktivitete lobuese të presidentit, kryeministrit, ministrit të Jashtëm etj., si p.sh. letra e presidentit dërguar kryetarëve të shteteve, qeverive dhe organizmave ndërkombëtarë lidhur me situatën në Kosovë e ish-Jugosllavi³³ në korrik 1992, letra e presidentit dërguar sekretarit të përgjithshëm të OKB-së mbi rezolutën e 30 majit 1992, të Këshillit të Sigurimit, për vendosjen e sanksioneve ekonomike ndaj Jugosllavisë e Malit të Zi³⁴, etj. Gjithashtu, aktiviteti shtetëror ka raporte të shumta e të detajuara të takimeve të nivelit të lartë lidhur me Kosovën, siç është p.sh. takimi midis presidentit e shefit të KE,ZhakDelor³⁵. Në arkivin e MPJ-së ka dokumentacion të plotë rreth nismës për përjashtimin e Kosovës nga embargo e Këshillit të Sigurimit ndaj Serbisë dhe Malit të Zi³⁶, mbi

³¹QBZ, Ligji 7613, Fletore Zyrtare nr.6, Dekreti i presidentit të Republikës nr.255, datë 17.07.1992 *“Për disa plotësime në dekretin nr.1874, datë 07.06.1954 “Mbi shtetësinë shqiptare”, 1992.*

³²AQSH, Viti 1993. Dosje 364, Fondi i Këshillit të Ministrave, 25.06.1993, f. 2.

³³ Arkivi i MPJ, Viti 1992, Dosja 917, kutia 22, f. 44.

³⁴ Arkivi i MPJ, Viti 1992, Dosja 1089/1, kutia 38, f. 3.

³⁵ Arkivi i MPJ, Viti 1992, Dosja 942, kutia 23, f. 9.

³⁶ Arkivi i MPJ, Viti 1992, Dosja 1089/2, kutia 28, f. 2.

dislokimin e disa kosovarëve në një repart të Divizionit të Elbasanit³⁷, mbi kërkesa të shumta për të drejta studimi nga studentë shqiptarë në ish-Jugosllavi për në Universitetin e Tiranës³⁸, mbi protesta të ndryshme të MPJ-së, si p.sh. për përdorimin e dhunës policore në rastin e fshatit Leshan të Komunës së Pejës³⁹, etj. Po ashtu, Qeveria dhe kryetari i Kuvendit të Kosovës, i dërguan ftesë formale Shqipërisë për të ndjekur zhvillimin e zgjedhjeve të lira në Kosovë, më 24 maj 1992⁴⁰, si dhe midis palëve u diskutuan në raste të ndryshme problematika që lidhen me gjendjen në Kosovë dhe fenomene të veçanta, siç ishte dezertimi i të rinjve kosovarë nga ushtria dhe lëvizja e lirë e qytetarëve kosovarë⁴¹.

Gjatë vitit 1993, fokusi kryesor i MPJ-së ishte aktiviteti sensibilizues ndërkombëtar, sidomos në OKB dhe në Këshillin e Sigurimit⁴², lobimi për Rezolutat e KS në OKB⁴³, si dhe takime, deklarime dhe aktivitete të tjera kryesisht nga misionet kryesore diplomatike në OKB, në SHBA, në Bon, Paris, Londër, Romë, OSBE, KE etj. Midis dy vendeve pati përpjekje për të institucionalizuar raportet e bashkëpunimit, duke krijuar mekanizma koordinimi dhe takimesh periodike, sidomos në Tiranë dhe në shtetet ku qeveria e Kosovës ishte prezente. MPJ ka një arkiv të pasur të marrëdhëniet politike Shqipëri-Kosovë gjatë vitit 1993⁴⁴ ku përfshihen edhe bilanci i bashkëpunimit ekonomik (dosja 878), aktiviteti e bilanci i raporteve shtetërore midis dy vendeve dhe dy qeverive (dosja 877), bashkëpunimi kulturor dhe në fushën e arsimit (dosja 879) etj. Po ashtu, gjatë vitit 1994, ka disa dhjetëra takime,

³⁷ Arkivi i MPJ, Viti 1992, Dosja 1102, kutia 29, f. 3.

³⁸ Arkivi i MPJ, Viti 1992, Dosja 1103, kutia 29, f. 1-20.

³⁹ Arkivi i MPJ, Viti 1992, Dosja 1126, kutia 29, f. 1-3.

⁴⁰ Arkivi i MPJ, Viti 1992, Dosja 1111, kutia 29, f. 1-3.

⁴¹ Arkivi i MPJ, Viti 1992, Dosja 1113, kutia 29, f. 1-20.

⁴² Arkivi i MPJ, Viti 1993, Dosja 553, kutia 17, f. 1-160.

⁴³ Arkivi i MPJ, Viti 1993, Dosja 567, kutia 18, f. 1-48.

⁴⁴ Arkivi i MPJ, Viti 1993, Dosja 876, kutia 33, f. 1-131.

dokumente, konsultime dhe vlerësime dypalëshe, kryesisht të fokusuara në lobimin ndërkombëtar dhe bashkëveprimin në politikën e jashtme, të tilla si përpjekjet e misionëve shqiptarë në Nju Jork dhe Gjenevë lidhur me problematikat dhe informimin mbi situatën e shkeljeve të drejtave të njeriut në Kosovë⁴⁵. Më 1993, institucioni i RTSH-së nënshkroi një akord bashkëpunimi me Ministrinë e Informacionit të Kosovës për të angazhuar punonjës të televizionit të mbyllur të Prishtinës në televizionin shtetëror në Tiranë. Marrëveshja parashikonte edhe mbështetjen për emisione të posaçme të dedikuara Kosovës, asistimin e stafeve nga Kosova për emisionet që kanë përgatitur, në studiot e RTSH. Sipas drejtuesve të këtij institucioni, pas nënshkrimit të marrëveshjes *“redaksitë e RTSH-së të përbëra nga punonjësit e Radiotelevizionit të Prishtinës, funksionojnë në Kosovë e në diasporë”*⁴⁶.

Një aspekt i bashkëpunimit ishte vendimi i dy qeverive për të mundësuar studimet në universitetet e Shqipërisë së të rinjve nga Kosova. Të rinjtë kandidatë për studentë përzgjidheshin nga vetë autoritetet e Kosovës (MAS) dhe shteti shqiptar, përmes kuotave të lira dhe me kritere të ndryshme nga studentët e tjerë nga Shqipëria, mundësonte regjistrimin e tyre në universitetet shtetërore. Jetësimi i këtij procesi hasi edhe në vështirësi që lidheshin kryesisht me kuotat e pamjaftueshme në raport me kërkesat, si dhe me kriteret e përzgjedhjes dhe rekomandimeve të ardhura nga institucionet e arsimit të Qeverisë së Kosovës. Këto problematika u konfirmuan edhe gjatë një debati parlamentar më 1994, gjatë të cilit ministri i Arsimit deklaroi se: *“Shqiptarët e pranuar në universitetin tonë këto vite banojnë në Kosovë, në Maqedoni, në Mal të Zi dhe në zona të tjera të ish-Jugosllavisë. Ne për këta kemi caktuar kuota përkatëse pa bërë ekuivalentimin e masës së studimeve, sepse kërkesat kanë qenë mjaft të mëdha dhe ne praktikisht nuk kemi mundur t’i përballojmë, duke i*

⁴⁵ Arkivi i MPJ, Viti 1994, Dosja 779, kutia 20, f. 1-195.

⁴⁶ Skënder Buçpapaj, Kuvendi i Shqipërisë, Viti 1993, Legjislatura e 13-të, f.149.

trajtuar ata, si po trajtohen studentët tanë. Ky është një proces që do të zgjidhet me statutet e universiteteve”⁴⁷.

Në një vlerësim të përmbledhur të bashkëpunimit midis dy qeverive, kryeministri Bukoshi, në një intervistë në dhjetor 1993, konfirmonte: *“Me Shqipërinë i koordinojmë të gjitha veprimet, veçanërisht ato të politikës së jashtme. Kemi gjetur mbështetje pa rezerva nga shteti shqiptar dhe Qeveria e tij demokratike. Për Kosovën kjo është me vlerë të pamatshme e për mua personalisht është kënaqësi që punoj bashkë me personalitetet shtetërore të Shqipërisë. Strategjia themelore dhe pikat më të rëndësishme të veprimit koordinohen. Edhe Shqipëria është e detyruar të ndjekë politikë reale të kushtëzuar nga rrethanat e brendshme dhe nga konteksti i jashtëm politik. Ajo vërtetë bën atë që mund të bëjë në këto rrethana. Të them se në këtë plan nuk ka divergjencë dhe mendoj se janë të pabaza akuzat se Shqipëria për Kosovën nuk po bën asgjë, se shqiptarët në ish-Jugosllavi i gjetën pa mbështetjen e shtetit shqiptar”*.⁴⁸

Të kësaj periudhe janë edhe projektet e përbashkëta kulturore e politike, si dhe vendimi i Qeverisë shqiptare që çdo ambasadë e RSH në botë të ketë një përfaqësues të ngarkuar për çështjet e Kosovës, kurse në kryeqytetet kryesore perëndimore mundësisht një zyrtar të emëruar në koordinim me Qeverinë e Kosovës. Kapacitetet e shtetit u vunë edhe në funksion të aktiviteteve sensibilizuese ndërkombëtare, siç ishin mitingje, protesta, manifestime kulturore, peticione, lobime etj., kryesisht në vendet perëndimore. Çdo vizitë e rëndësishme politike në Shqipëri që lidhej me rajonin, përfshirë edhe vizita të rëndësishme të ish-kryeministrit jugosllav apo drejtuesve nga Mali i Zi etj., bëhej në koordinim paraprak midis dy qeverive. Tirana zyrtare ishte e pranishme edhe në vendimmarrjet ndërkombëtare që

⁴⁷XhezairTeliti, Viti 1994, Kuvendi i Shqipërisë, Legjislatura e 13-të, f.370.

⁴⁸Bujar Bukoshi, *Realizimi i aspiratave varet nga organizimi i ynë*, Intervistë më 22 tetor 1993, Në “Nyja shqiptare”, M.Emërllahu, Eurorilindja 2001, f.228.

lidheshin me Kosovën, sidomos ato që lidhen me aspekte funksionale dhe administrative. Për shembull, Tirana zyrtare e kushtëzoi anulimin e vizitës së presidentit të Italisë në Shqipëri me kërkesën e saj për të mos miratuar një marrëveshje me palën italiane për kthimin në Kosovë të të rinjve që iknin nga shërbimi ushtarak⁴⁹.

Analiza e periudhës 1992-1996, në marrëdhëniet Shqipëri-Kosovë dominohet nga zhvillimet pozitive dhe intensiteti, si dhe bilanci pozitiv sidomos në drejtim të sensibilizimit ndërkombëtar, njohjes e bashkëveprimit institucional dhe përfshirjes së Kosovës në agjendën e përhershme zyrtare të të gjithë strukturës shtetërore të Shqipërisë. Në aspektin kritik këto marrëdhënie u kushtëzuan edhe nga raportet midis dy qeverive dhe zhvillimet e brendshme politike në dy vendet. Shumë prej marrëveshjeve mbeten vetëm deklarative dhe se rezolutat e Kuvendit apo deklaratimet qeveritare thuajse nuk patën impakt shtetëror. Në disa elementë bashkëpunimi shtetëror Shqipëri-Kosovë, u rivalizua nga bashkëpunimi politik PD-LDK, duke i konsideruar partitë politike si kanale komunikimi shtetëror, si dhe marrëdhëniet e personalizuara dominuan marrëdhëniet institucionale. Kriza e raporteve personale Berisha-Rugova, më 1996, çoi në krisje të marrëdhënieve shtetërore, raportet e ftohta midis të majtës në Shqipëri e të djathtës në Kosovë, midis 1992-2000, ndikuan dukshëm edhe bashkëpunimin mes dy vendeve edhe pas rotacionit politik të vitit 1997, si dhe rivalitetet e brendshme edhe brenda Kosovës, përfshirë ajo Rugova-Bukoshi, patën reflektim negativ edhe në raportet e Tiranës ndaj tyre. Përpjekja e Tiranës zyrtare për të qenë në akordancë të plotë me pikëpamjet e SHBA-së e BE-së ndaj Kosovës, por edhe presioni përëndimor për të qenë të tillë, sollën ndryshime edhe në ligjërimin dhe objektivin e saj politik ndaj Kosovës. Krizat e refugjatëve të luftës më 1997-1999, ishin dëshmi se midis perceptimit qytetar të dy vendeve dhe elitave politike kishte diferencë të thellë,

⁴⁹ Vili Minarolli, *Ngjarje që nuk harrohen*, “Dituria”, 2017, f. 105-106.

dhe se këto të fundit humbën kohë e energji për të njësuar perceptimin qytetar me sjelljen e nevojshme institucionale shtetërore.

Vitet 1997-1999 dhe vendi i Kosovës në agjendën shtetërore

Periodha 1997-1999, njohu numrin më të madh të akteve zyrtare të Qeverisë dhe Parlamentit shqiptar lidhur me Kosovën. Midis vitit 1997-1998, Kuvendi miratoi një deklaratë dhe katër rezoluta mbi gjendjen dhe problematikën në Kosovë. E fundit rezolutë theksonte se: *“Evetmja rrugë për ndaljen e gjenocidit, spastrimit të egër etnik dhe përhapjes së konfliktit në rajon, mbetet ndërhyrja e trupave të NATO-s në Kosovë”*⁵⁰. Raportet e reja intensive nuk u ndikuan vetëm nga interesi zyrtar i shtetit shqiptar, por edhe nga ndryshimet gjeopolitike në rajon. Nëse në vitet 1992-1996, aleatët perëndimorë të Shqipërisë ishin të interesuar, këshillonin dhe ushtronin presion për një qëndrim sa më të moderuar ndaj zhvillimeve në Kosovë, pa lejuar ndërhyrjen në “punët e brendshme” të Jugosllavisë së mbetur, pas 1997 kërkesat dhe këshillat ndërkombëtare ndryshuan gradualisht, derisa në fundin e vitit 1998 dhe fillimin e vitit 1999, Shqipërisë iu kërkuar të jetë aktive në përballimin e valës së refugjatëve, në qasjen e kapaciteteve ushtarake për përdorimin e tyre nga forcat e NATO-s dhe për një qëndrim sa më të unifikuar dhe aktiv në krah të nismave SHBA-BE-NATO në kuadrin e zgjedhjes politike dhe ushtarake në Kosovë. Nëse deri më 1996-1997, çdo deklaratë e politikanëve të Tiranës, adresuar Kosovës, analizohej në detaje dhe qortohej në rast të shenjave nacionaliste, gjatë 1998 dhe sidomos gjatë vitit 1999, me asistencën ndërkombëtare Tirana luajti një rol aktiv në të gjitha drejtimet. Në Shqipëri u vendosën trupa të rregullta të UÇK-së dhe FARK-ut, u

⁵⁰ Sabri Godo, Viti 1998, Kuvendi i Shqipërisë, Legjislatura e 15-të, f. 2188.

vendosën shtabe koordinimi dhe udhëheqësit kryesorë të luftës në Kosovë, u vendosën redaksi mediatike dhe njësi humanitare, si dhe erdhën një numër i madh krerësh të shteteve perëndimore, përfshirë kancelarin gjerman, kryeministrin britanik, kryeministrin italian, të gjithë drejtuesit e NATO-s dhe të BE-së, drejtues të rëndësishëm të OKB-së, OSBE-së, KE-së, etj.

Duke përfitur nga rrethanat e reja dhe duke pasur konsensus të gjerë politik në vend, Qeveria shqiptare u tregua shumë aktive në denoncimin e përshkallëzimit të masave represive në Kosovë, të masakrave dhe vrasjeve ndaj civilëve, në menaxhimin e valës së emigrimit nga Kosova në drejtim të Shqipërisë dhe rajonit, si dhe në mbështetjen e ndërhyrjes së NATO-s. Në këtë kuadër, qeveritë shqiptare të kësaj periudhe patën angazhime të shumëfishta që lidheshin me sensibilizimin ndërkombëtar, me deklarime politike, me nisma diplomatike, me masa administrative për prirjen dhe kujdesin ndaj refugjatëve të luftës, si dhe me elementë të tjerë të sigurisë dhe masave të jashtëzakonshme. Kështu për shembull, Qeveria zhvilloi një mbledhje të veçantë në tetor 1997, për të analizuar situatën në Kosovë dhe për të përcaktuar masat që duhen ndërmarrë në aspektin diplomatik e politik. Mbledhja me tematikë “Mbi situatën e rënduar në Kosovë në aspektin social-politik”⁵¹, e ka që në titull fokusin dhe qëllimin e saj, ndërkohë që vijoi me adresim zyrtar të problematikave tek disa qeveri perëndimore dhe zyrtarë të lartë ndërkombëtarë, përfshirë tek sekretari i përgjithshëm i NATO-s, Solana.

Gjatë gjysmës së parë të vitit 1999, pati disa akte të Këshillit të Ministrave të marra si VKM ose akte normative, siç ishin VKM mbi zhvillimet e ndodhura dhe rolin e Shqipërisë në mbarëvajtjen e takimit të Rambujesë për zgjidhjen e problemit të Kosovës⁵²; VKM mbi masat për përballimin e situatës emergjente të krijuar nga ardhja e popullsisë shqiptare nga Kosova, si debatet shoqëruese mbi këto

⁵¹ AQSH, Viti 1993, Dosje 636, Fondi i Këshillit të Ministrave, 02.10.1997, f. 1-32.

⁵² AQSH, Viti 1999, Dosje 174, Fondi i Këshillit të Ministrave, 04.02.1999, f. 1-4.

masa⁵³; VKM mbi masat për furnizimin me grurë të Prefekturës së Kukësit dhe përdorimin e tij, për përballimin e situatës emergjente, të krijuar nga ardhja e popullsisë shqiptare nga Kosova⁵⁴; VKM mbi ndryshim në vendimin për disa masa për përballimin e situatës emergjente, të krijuar nga ardhja e popullsisë shqiptare nga Kosova⁵⁵; VKM për furnizimin e të ardhurave nga Kosova, nga Drejtoria e Përgjithshme e Rezervave të Shtetit, relacion dhe procesverbali i mbledhjes përkatëse⁵⁶; VKM për caktimin e një territori në rrethin e Durrësit për ngritjen e një kampingu, për të ardhurit nga Kosova⁵⁷; VKM mbi procedurat e evidentimit, përdorimit dhe raportimit të ndihmave financiare të donatorëve të ndryshëm, për të ardhurit nga Kosova⁵⁸; VKM për blerje mallrash, në ndihmë të të ardhurave nga Kosova, me procedurë e prokurimit të drejtpërdrejtë⁵⁹; VKM për miratimin e memorandumit financiar, ndërmjet Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Komisionit Evropian për ndihmën buxhetore për të ardhurit nga Kosova⁶⁰; VKM për miratimin e modelit të memorandumit të mirëkuptimit, me qeveri të ndryshme donatore për administrimin dhe shpërndarjen e ndihmave për popullsinë shqiptare, të ardhur nga Kosova⁶¹; Nisma ligjore për përdorimin e përkohshëm të tokës bujqësore, shtetërore për ndërtimin e kampingjeve, për strehimin e popullatës së dëbuar forcërisht nga Kosova⁶²; VKM për miratimi e grantit dhënë nga Qeveria e Japonisë

⁵³ AQSH, Viti 1999, Dosje 289, Fondi i Këshillit të Ministrave, 25.03.1999, f. 1-82.

⁵⁴ AQSH, Viti 1999, Dosje 296, Fondi i Këshillit të Ministrave, 29.03.1999, f. 1-4.

⁵⁵ AQSH, Viti 1999, Dosje 297, Fondi i Këshillit të Ministrave, 29.03.1999, f. 1-9.

⁵⁶ AQSH, Viti 1999, Dosje 299, Fondi i Këshillit të Ministrave, 01.04.1999, f. 1-8.

⁵⁷ AQSH, Viti 1999, Dosje 305, Fondi i Këshillit të Ministrave, 01.04.1999, f. 1-7.

⁵⁸ AQSH, Viti 1999, Dosje 312, Fondi i Këshillit të Ministrave, 02.04.1999, f. 1-8.

⁵⁹ AQSH, Viti 1999, Dosje 340, Fondi i Këshillit të Ministrave, 16.04.1999, f. 1-6.

⁶⁰ AQSH, Viti 1999, Dosje 401, Fondi i Këshillit të Ministrave, 19.05.1999, f. 1-5.

⁶¹ AQSH, Viti 1999, Dosje 403, Fondi i Këshillit të Ministrave, 12.05.1999, f. 1-8.

⁶² AQSH, Viti 1999, Dosje 466, Fondi i Këshillit të Ministrave, 03.06.1999, f. 1-9.

për përballimin e situatës së krijuar për shkak të krizës në Kosovë⁶³; VKM për mbulimin e shpenzimeve të kryera nga Drejtoria e Përgjithshme e Rezervave Shtetërore, për përballimin e situatës emergjente, për të ardhurit nga Kosova⁶⁴; VKM për miratimin në parim të marrëveshjes, ndërmjet Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Kombeve të Bashkuara, lidhur me trajtimin e personelit dhe pajisjeve të Misionit të Kombeve të Bashkuara për administrimin e përkohshëm në Kosovë⁶⁵; VKM për heqjen e embargos së naftës dhe nënprodukteve të saj për Republikën e Malit të Zi dhe Kosovën⁶⁶ etj.

Të rëndësishme gjithashtu në këtë periudhë janë mbledhjet e Këshillit të Ministrave të datave 22, 23 dhe 24 mars 1999, për zhvillimet e ngjarjeve në Kosovë dhe situatën e krijuar në veri të vendit si rezultat i këtyre ngjarjeve⁶⁷, mbledhje e dedikuar të qeverisë me objekt miratimin e ndihmës financiare të jashtëzakonshme të Qeverisë së Republikës së Kosovës për Qeverinë shqiptare për përballimin e nevojave të të ardhurve nga Kosova⁶⁸, si dhe debati e vendimi i Qeverisë së RSH për hapjen e Zyrës së Ndërlidhjes së Republikës së Shqipërisë në Kosovë, shoqëruar me relacion e vlerësim të Ministrisë së Punëve të Jashtme për këtë çështje⁶⁹.

Kryeministri Majko, nxori në atë periudhë një numër të madh aktesh administrative që kishin të bënin me transportin e qytetarëve nga Kosova të ardhur në rrethet e veriut, shpërndarjen në destinacion dhe mbulimin financiar të këtij aksioni⁷⁰; me detyrat e përgjegjësitë e organeve të pushtetit vendor në shpërndarjen dhe sistemimin e të

⁶³ AQSH, Viti 1999, Dosje 519, Fondi i Këshillit të Ministrave, 10.06.1999, f. 1-6.

⁶⁴ AQSH, Viti 1999, Dosje 527, Fondi i Këshillit të Ministrave, 25.06.1999, f. 1-9.

⁶⁵ AQSH, Viti 1999, Dosje 702, Fondi i Këshillit të Ministrave, 09.09.1999, f. 1-10.

⁶⁶ AQSH, Viti 1999, Dosje 972, Fondi i Këshillit të Ministrave, 20.12.1999, f. 1-6.

⁶⁷ AQSH, Viti 1999, Dosje 262, Fondi i Këshillit të Ministrave, 22.03.1999, f. 1-58.

⁶⁸ AQSH, Viti 1999, Dosje 348, Fondi i Këshillit të Ministrave, 01.04.1999, f. 1-6.

⁶⁹ AQSH, Viti 1999, Dosje 809, Fondi i Këshillit të Ministrave, 01.11.1999, f. 1-13.

⁷⁰ AQSH, Viti 1999, Dosje 13, Fondi i Këshillit të Ministrave, 28.03.1999, f. 2.

ardhurve nga Kosova⁷¹; për përcaktimin e standardeve të shërbimeve shëndetësore, të arsimit dhe të mbështetjes psiko-sociale për fëmijët dhe gratë, në kampet dhe në qendrat e banimit, të krijuara për popullsinë shqiptare, të ardhur nga Kosova⁷²; për masat që duhen marrë për grumbullimin e provave dhe dëshmimeve dhe përgatitjen e procedurave për shkeljet e të drejtave të njeriut në Kosovë⁷³; për administrimin dhe dorëzimin në Drejtorinë e Përgjithshme të Rezervave të Shtetit, të mallrave dhe pajisjeve të përdorura në kampet e ngritura për strehimin e popullsisë shqiptare të ardhur nga Kosova⁷⁴; për aktivitetin e Komisionit Qeveritar për përballimin e situatës së emergjencës të krijuar nga ardhja e popullsisë shqiptar nga Kosova, dhe më pas për mbarimin e mandatit dhe aktivitetit të këtij Komisioni⁷⁵ etj.⁷⁶

⁷¹ *AQSH*, Viti 1999, Dosje 14, Fondi i Këshillit të Ministrave, 30.03.1999, f. 3.

⁷² *AQSH*, Viti 1999, Dosje 29, Fondi i Këshillit të Ministrave, 21.05.1999, f. 4-5.

⁷³ *AQSH*, Viti 1999, Dosje 31, Fondi i Këshillit të Ministrave, 05.06.1999, f. 2.

⁷⁴ *AQSH*, Viti 1999, Dosje 37, Fondi i Këshillit të Ministrave, 07.07.1999, f. 2-3.

⁷⁵ *AQSH*, Viti 1999, Dosje 74, Fondi i Këshillit të Ministrave, 31.03.1999 dhe 26.11.1999, f. 2.

⁷⁶ Gjithashtu ekzistojnë një listë e gjatë aktesh të tjera, përfshirë akte të Komisionit Qeveritar (KQ) dhe strukturave drejtuese mbështetëse. Të tilla janë urdhri i KQ për krijimin e zyrave operative dhe të informimit të publikut, pranë të gjitha bashkive, me qëllim sistemimin e pjesshëm të popullsisë shqiptare të Kosovës, ardhur në Shqipëri, si rezultat i represionit serb; urdhri për financimin e shpenzimeve të transportit dhe administrimin e mallrave, ndihmë për të ardhurit nga Kosova; urdhri për caktimin e të ngarkuarit të posaçëm, pranë Komisionit Qeveritar për përballimin e situatës emergjente të krijuar nga ardhja e popullsisë shqiptare nga Kosova; urdhri për krijimin e grupeve të punës pranë Komisionit Qeveritar për përballimin e situatës emergjente të krijuar nga dëbimi i popullsisë shqiptare nga Kosova; urdhri për caktimin e të ngarkuarit të posaçëm për bashkërendimin e marrëdhënieve ndërmjet pushtetit vendor dhe UNHCR-së; urdhri për caktimin e koordinatorëve të posaçëm të Komisionit Qeveritar për përballimin e situatës emergjente të krijuar nga ardhja e popullsisë shqiptare nga Kosova; urdhri për kompetencat e koordinatorit të posaçëm pranë Komisionit Qeveritar për Përballimin e Situatës Emergjente të krijuar nga dëbimi i popullsisë shqiptare nga Kosova; urdhri për

Akteve të Qeverisë, Parlamentit, kryeministrit, ministrave dhe Komisionit Qeveritar, u shtohen edhe disa qindra akte të tjera administrative të ministrave dhe institucioneve kryesore qendrore e lokale, si dhe disa dhjetëra akte diplomatike të MPJ-së, si p.sh. adresimi zyrtar i qeverisë tek Grupi i Kontaktit për nxitje të një zgjidhje të shpejtë dhe efikase në Kosovë⁷⁷ apo letërkëmbimi i kryeministrit dërguar sekretarit të përgjithshëm të NATO-s dhe zyrtarëve të tjerë të lartë për kontributet e dhëna për zgjidhje e krizës në Kosovë⁷⁸.

Aktet zyrtare në raportet midis Shqipërisë e Kosovës, kryesisht vendime të Këshillit të Ministrave (VKM) dhe urdhra të kryeministrit, vijuan me ritme më të ulëta gjatë vitit 2000 dhe në vijim. Të tilla p.sh, mund të përmenden VKM për miratimin në parim të marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Republikës Federale të Gjermanisë: “Për lejimin e kthimit transit të detyruar të shtetasve jugosllave (shqiptare të Kosovës) për në Kosovë⁷⁹; VKM për lejimin e udhëtimit transit, vullnetar, të shtetasve jugosllave (shqiptare të Kosovës) për në Kosovë⁸⁰; VKM për mundësinë e nisjes së veprimtarisë së INSIG sha në Kosovë⁸¹; VKM

kompetencat e grupit të menaxhimit të emergjencës si dhe të nëngrupeve që veprojnë pranë Komisionit Qeveritar për përballimin e situatës emergjente të krijuar nga dëbimi i popullsisë shqiptare nga Kosova; urdhri për përballimin e situatës emergjente të krijuar nga ardhja e popullsisë shqiptare nga Kosova, për disa masa në luftën kundër korrupsionit; urdhri për krijimin e komisionit teknik për bashkëpunimin e punëve për lehtësimin e procedurave të lëvrimit të ndihmave humanitare për popullsinë shqiptare të ardhur nga Kosova; urdhri për caktimin e të ngarkuarit të posaçëm të Komisionit qeveritar në prefekturën e Kukësit për përballimin e situatës emergjente të krijuar nga ardhja e popullsisë shqiptare nga Kosova, etj.

⁷⁷ AQSH, Viti 1999, Dosje 7, Fondi i Këshillit të Ministrave, 13.02.1999, f.1-3.

⁷⁸ AQSH, Viti 1999, Dosje 16, Fondi i Këshillit të Ministrave, 05.04.1999, f.1.

⁷⁹ AQSH, Viti 2000, Dosje 182, Fondi i Këshillit të Ministrave, 21.01.2000, f.1-17.

⁸⁰ AQSH, Viti 2000, Dosje 184, Fondi i Këshillit të Ministrave, 21.01.2000, f.1-14.

⁸¹ AQSH, Viti 2000, Dosje 261. Fondi i Këshillit të Ministrave, 02.03.2000, f.1-11.

për hapjen e zyrës së ndërlidhjes së Republikës së Shqipërisë në Kosovë⁸²; urdhri i kryeministrit për ngritjen e grupit të punës për kontrollin dhe dokumentimin e shpenzimeve për pritjen e kosovarëve⁸³, etj.

Bashkëpunimi midis periudhës 1999-2008

Çlirimi i Kosovës më 1999 dhe realiteti politik i ri atje patën impakt të ndjeshëm në raportet e reja midis dy vendeve. Për herë të parë Shqipëria e Kosova shkëmbyen vizita të niveleve të larta, zhvilluan mbledhje të përbashkëta dhe patën rastin të koordinonin aktivitetin bashkëpunues në të gjithë sektorët. Ekzistenca e UNMIK-ut si institucion i tretë ndërmjetës nuk e pengoi procesin e bashkëpunimit intensiv, madje duhet thënë se në disa aspekte, e ndihmoi atë, duke e çliruar nga retorikat dhe nismat populiste dhe politike ditore. Tipari kryesor i kësaj periudhe është kalimi nga bashkëpunimi partiak Shqipëri-Kosovë (PD-LDK dhe PDK-PS) në bashkëpunim shtetëror midis institucioneve, marrëveshje e projekte konkrete midis dy parlamenteve, midis dy qeverive, midis ministrive dhe institucioneve të tjera shtetërore. Tabela bashkëngjitur paraqet marrëveshjet më të rëndësishme zyrtare të periudhës 2000-2008 dhe secila prej tyre shoqërohet edhe me akte të tjera plotësuese në funksion të marrëveshjes. Shumica e tyre ishin marrëveshje kuadër, dhe pas pavarësisë 2008, kërkonin rishkim tërësor për t'ia përshtatur realitetit të ri të shtetit të Kosovës. Në funksion të klimës së re ndërshtetërore janë disa dhjetëra akte të qeverive, ministrive dhe institucioneve të tjera, të rëndësishme për klimën e bashkëpunimit konkret, por të natyrshme në raportet midis dy shteteve dhe dy vendeve fqinje.

⁸² *AQSH*, Viti 2000, Dosje 878, Fondi i Këshillit të Ministrave, 06.09.2000, f.1-6.

⁸³ *AQSH*, Viti 2000, Dosje 25, Fondi i Këshillit të Ministrave, 23.03.2000, f.1-3.

Prioritetet kryesore të bashkëpunimit të kësaj periudhe nga pikëpamja e Tiranës zyrtare ishte mbështetja e jetësimit dhe forcimit të shtetit në Kosovë, asistenca shtetërore në të gjithë sektorët, mbështetja ndërkombëtare e lobimitdrejt pavarësisë, njësimi i praktikave dhe shërbimeve për qytetarët, lehtësimi i shkëmbimeve të mallrave e njerëzve, si edhe roli aktiv në evitimin e ndikimeve të palëve të treta jo perëndimore në Kosovë apo të krizave politike lokale apo incidenteve si ai i vitit 2004. Në dallim nga periudha përpara 1999, në fazën e re të bashkëpunimit çdo shtetar perëndimor që vizitoi Tiranën ose priti drejtuesit politikë e shtetërorë të Shqipërisë, e trajtoi çështjen e Kosovës si pjesë të rëndësishme të agjendës politike me Shqipërinë. Rasti i presidentit Bush, më 2007, në Tiranë, dhe insistimi i tij që Tirana zyrtare të jetë aktive në vendimmarrjet pozitive në Kosovë është shprehja më e lartë e këtij realiteti të ri politik midis dy vendeve shteteve.

MARRËVESHJET SHQIPËRI-KOSOVË, 2001-2006	
	VITI
Protokolli midis dhomave të tregtisë	2000
Memorandumi në fushën e shëndetësisë	2001
Protokolli midis administratave doganore	2001

Marrëveshje midis KEK dhe KESH	2001
Marrëveshje midis Albtelekom dhe PTK	2001
Marrëveshje midis BSH - Autoritetit Bankar Kosovë	2002
Marrëveshja e Interkonjeksionit	2002
Marrëveshje për transportin rrugor	2002
Memorandum në bashkëpunimin ekonomik	2002
Marrëveshje në fushën e kulturës e sporteve	2002
Memorandum lidhur me fushën e sigurimeve	2002
Memorandum për bashkëpunim policor	2002
Deklarim mbi marrëveshjen e Tregtisë së lirë	2002
Marrëveshja e Tregtisë së Lirë	2003
Marrëveshje për bashkëpunim në bujqësi	2003
Marrëveshje në fushën e shërbimit veteriner	2003
Marrëveshje për mbrojtjen/nxitjen e investimeve	2004
Marrëveshje për shmangien e taksave të dyfishta	2004
Marrëveshje midis Akademisë së Shkencave	2004
Marrëveshje bashkëpunimi midis arkivave	2004
Marrëveshje në fushën energjetike (400 kv)	2005
Protokoll për bashkëpunimin policor	2005
Marrëveshje e transferimit të personave të dënuar	2005
Marrëveshje bashkëpunimi mes universiteteve	2005

Marrëveshje për ruajtjen e kufirit & luftë krimi	2006
Protokoll midis instituteve të monumenteve	2006
Protokoll bashkëpunimi mes galerive të arteve	2006
Marrëveshje midis ministrive të arsimit e shkencës	2005
Memorandum bashkëpunimi në turizëm	2006
Protokoll bashkëpunimi mes ministrive të punës	2006
Marrëveshje për mjedisin e planifikimin	2007
Marrëveshje midis bankave qendrore	2007
Marrëveshje midis ministrive të shëndetësisë	2007

Tiparet pozitive të bashkëpunimit Shqipëri-Kosovë gjatë viteve 2000-2008, shfaqën edhe mangësi, sidomos në drejtim të konkretizimit dhe ndjekjes permanente të detyrimeve në marrëveshje dhe problematikave që lidhen me to. Në një vlerësim të MPJ-së në fillimin e vitit 2008, konfirmohej për shkak të neglizhencës nga të dy palët, shumë prej marrëveshjeve të nënshkruara nuk janë ndjekur dhe konkretizuar në vazhdimësi. Sipas raportit analitik të MPJ-së *“kontaktet e deritanishme në drejtim të veprimtarive artistike, muzikore, teatrore, sportive, rinore si dhe të marrëdhënieve shkencore, arsimore, studimore dhe botuese janë realizuar më së shumti në rrugë spontane, njohjesh dhe traditë sesa si aktivitete të organizuara institucionalisht nga ministrinë dhe nga institucionet e kulturës, shëndetësisë, sporteve etj.”*⁸⁴

Ndryshimet pas 2008 ishin sasiore (2.5 herë më shumë marrëveshje sesa në periudhën përpara pavarësisë), dhe cilësore (marrëveshje konkrete bashkëpunimi për çdo sektor e për çdo çështje

⁸⁴ Arkivi i MPJ, Viti 2008, Dosja e marrëdhënieve me Kosovën, nr. 18, f. 1-12.

me interes reciprok, mbledhje të përbashkëta të qeverive dhe marrëveshje kuadër të qëndrueshme midis dy shteteve).

Afrim Krasniqi

SUMMARY

Kosova in the Official Acts of the Albanian State 1991-2008
Over 30 years, Albania's relations with Kosovo have reflected a vibrant interplay of ever-changing political realities of the two countries, intrinsically linked to the geopolitical developments in the region and to a still incomplete process of transition from (merely) patriotic rhetoric to a more sensible rhetoric of institutional cooperation. The dynamics of the Kosovo-Albanian cooperation has gone through three main phases, - the “return to each-other” phase roughly coinciding with the change of the political systems of Kosovo and Albania in the period 1990-1992, the “closing up with each-other phase” focused on the growing Kosovo-Albanian cooperation aimed at raising international awareness on Kosovo and on establishing common official positions in the period 1992-1998, and the “institutional partnership” phase focused on relations of an institutional nature in the period 1999-2008. Because of its history and symbolism, Albania played a special role throughout the phases of recognition, promotion, liberation, independence and state building of Kosovo. Kosovo and Albania often ran on parallel agendas built on different priorities. Nonetheless, the first stages of cooperation of the years after Kosovo’s independence have been integrated into agendas with growingly common features between the two countries.

This paper analyzes the history of institutional relations and institutional acts between Albania and Kosovo before the latter’s official independence (2008) mainly based on two reference sources: the official documentation of the Republic of Albania, and the informal documentation and notes made by former senior officials, media, reports and other information sources. The paper concludes

that the balance of state acts and the database of cooperation between the two countries, despite their mutual achievements, fails to fulfil the expectations of the public of Kosovo and Albania, as it is unable to meet the political promises and needs of both states and societies. The achievements to date have come mainly as a result of the coincidence of interests of Kosovo and Albania with those of their main Western partners. The Albania-Kosovo relations have still a long way to go in terms of establishing a functional interstate relationship so as to overcome the highly fragmented cooperation patterns that still build mostly on the personal preferences of their ruling political elites. The lesson of 30 years of experience of Albania-Kosovo relations is that a mutual concept of strategic partnership requires vision, consistent actions and strategic approaches. Only a strategic institutional framework poised on long-term cooperation, accompanied by a strong political will for its implementation, can guarantee a stable and functional cooperation in the long run.

Haki Kasumi

Masakra në Burgun e Dubravës (Maj 1999)

Hyrje

Gjendja e përgjithshme e popullatës shqiptare gjatë gjithë periudhës së robërisë serbe ishte e rëndë. Situata në momente kohore, kishte oscilime të vogla, por synimet antishqiptare të pushtetit okupues serb, ishin konstante dhe të pandryshueshme gjatë gjithë kësaj periudhe. Përkeqësimi i gjendjes kishte arritur një nivel të lartë në pjesën përfundimtare të fundshekullit XX. Apetitet nacionaliste dhe hegjemoniste të udhëheqjes së lartë politike të Serbisë me në krye ultranacionalistin, Slobodan Milosheviq, nuk kishin të ndalur dhe quan në përshkallëzim të gjendjes në të gjithë Federatën Jugosllave.

Politika nacional-shoviniste, hegjemoniste dhe unitare serbe, hapi rrugën e shkatërrimit të Federatës Jugosllave, shkëputjen e Republikës së Sllovenisë dhe të Kroacisë, si dhe fillimin e luftës së armatosur. Në vazhden e këtyre zhvillimeve pas një kohe të shkurtër, lufta u zgjerua edhe në Kosovë.

Gjatë viteve të zhvillimit të luftimeve në Kosovë, më 1998 dhe 1999, forcat e armatosura policore dhe ushtarake të Serbisë kanë bërë krime të rënda kundër njerëzimit me përmasa gjenocidi në të gjithë territorin e Kosovës. Krimet e këtilla kanë përfshirë gjithë popullsinë e Kosovës. Këto krime, në rend të parë, kanë të bëjnë me shqiptarët, të cilët përbënin 97, 33% të të inkriminuarve në këtë periudhë. Krimet e këtilla kanë përfshirë edhe pjesëtarët e pakicës

turke, boshnjake, egjiptiane, rome etj.¹ Format e krimeve kanë qenë ndër më të ndryshmet. Ndër to po veçojmë: dëbimet, dhunimet, kidnapimet, vrasjet dhe zhdukjet. Gjithashtu duhet veçuar se formë më të rendë të krimit kundër njerëzimit paraqesin masakrat (400 sosh), ku në mesin e tyre po veçojmë: masakrën e Reçakut, e Izbicës, e Krushës së Madhe dhe të Vogël, e Likoshanit, e Mejës, e Pastaselës, e Lybeniqit dhe sidomos ajo në burgun e Dubravës, e të tjera.

Burgjet dhe trajtimi i të burgosurve

Shqiptarët dhe pakicat e tjera nacionale gjatë gjithë periudhës së robërisë nga pushtetet e Serbisë-Jugosllavisë, nuk janë trajtuar sipas rregullave, ligjeve dhe konventave ndërkombëtare. Vrasja dhe mbytja me torturë e të burgosurve shqiptarë ishte një dukuri e shpeshtë. Veprimet e tilla ishin shpeshtuar sidomos gjatë dhjetë vjetëve të fundit të shekullit të lënë pas. Regjimi serb para dhe gjatë luftës së fundit mbante në burgje me mijëra shqiptarë, të arrestuar në mënyra dhe forma të ndryshme. Shqiptarët mbaheshin në burgje me aktakuza dhe pa to, për vepra të imagjinuara, si “bashkim për veprimtari armiqësore” dhe “terrorizëm”, ndaj shtetit. Gjatë periudhës së përmendur, si pasojë e dhunës së ushtruar nga forcat policore dhe autoritetet e tjera serbe të burgjeve, dhjetëra e qindra të burgosur shqiptarë janë kthyer në shtëpitë e tyre në arkivole. Përderisa vrasjet dhe vdekjet e të burgosurve shqiptarë në burgjet serbe në të kaluarën e mëhershme ishin individuale, në vitet e luftës së viteve 1998-1999 në Kosovë, ato u bënë kolektive, në masë, dhe

¹ Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave e të Lirive të Njeriut, *Krimet e luftës në Kosovë, 1998- 1999*, Monografi 1, Prishtinë, 2010, f. 13-14.

një dukuri e shpeshtë. Ndër rastet më të rënda të ekzekutimit të njerëzve me duar të lidhura të burgosurve shqiptarë në burgjet serbe, padyshim se është rasti i masakrës në masë, i të burgosurve shqiptarë në burgun e Dubravës, që ishte pjesë e sistemit të organeve dhe të institucioneve të Serbisë së viteve të ‘80-ta e ‘90-ta, të shekullit XX. Përshkallëzimi i situatës së përgjithshme në Kosovë dhe veçanërisht i situatës politike dhe ushtarake, ndryshoi pas përballjes së forcave të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK) me forcat e pushtetit okupues të Serbisë në Likoshan të Drenicës, më 28 shkurt 1998, dhe sidomos pas betejës heroike në Prekaz të Ulët të familjes Jashari, me makinerinë ushtarako-policore të Serbisë, më 5-7 mars 1998.

Përkeqësimi i gjendjes së përgjithshme hetohej edhe brenda burgjeve në Kosovë. Në hapësirat e burgut të Dubravës, tashti filluan të zbrisnin helikopterët ushtarakë dhe vërehej qartë se ky burg po kthehej në një bazë të fortë ushtarake. Era e luftës tashti po fyente edhe në burg dhe pritej vetëm dita e transferimit të të burgosurve në ndonjë burg tjetër, e gjetkë. Ajo ndodhi më 29 dhe 30 prill 1998, kur do të transferohet grupi i parë i të burgosurve shqiptarë nga Dubrava në burgjet e Serbisë. Të gjithë këta të transferuar ishin të burgosur politikë. Në vijimësi u transferuan edhe të burgosurit e tjerë ordinerë.² Ky veprim i drejtë, u ndërmor mbështetur në obligimet e dala nga Konventa për Mbrojtjen e Personave Civilë në luftë më 1949 dhe protokollet shtesë I dhe II të Konventës së Gjenevës të vitit 1977! Veprimi për largim nga vatra e luftës ishte gjë e mirë, por sjellja dhe torturat e shumta që përjetuan këta të burgosur gjatë atyre zhvillimeve, ishin shkelje flagrante e saj. Pritja dhe obligimi i të burgosurve shqiptarë për të kaluar nëpër të ashtuquajturin “korridor i

² Ukë Thaçi, *Masakra në burgun e Dubravës (Skenarët e masakrës)*, Prishtinë, 2011, f. 172, (Deklaratë e të mbijetuarit të kësaj masakre, BajrushXhemajli e të tjerë).

tmerrit”, i ngritur nga udhëheqja e burgut ku të burgosurit shqiptarë “mirëpriteshin” nga gardianët dhe të tjerë me lloj-lloj mjetesh të forta në duart e tyre, me të cilat goditeshin nëpër të gjitha pjesët e trupit.³ Veprimet e tilla ishin shkelje të rënda të konventave dhe dokumenteve të tjera juridike ndërkombëtare.

Burgu i Dubravës për një vit të plotë (prill 1998 - prill 1999), ishte shndërruar në një qendër të forcave ushtarake prej nga dilnin në territorin e Dukagjinit njësite të shumta policore, ushtarake dhe paramilitare, të cilat bënin krime të shëmtuara mbi popullatën civile joserbe në Kosovë. Pas dështimit të versionit serb, të Konferencës së Rambujesë, forcat politiko-ushtarake serbe, ndërruan strategjinë e tyre të krimeve të hapura ndaj masave të popullatës civile shqiptare. Një plan për një krim të rëndë ishte menduar edhe për të burgosurit politikë shqiptarë, të cilët do të ktheheshin e grumbulloheshin në burgun e Dubravës, i cili ishte shënuar si qendër e madhe e forcave ushtarake policore serbe nga shërbimet zbuluese ushtarake të Paktit Veriatlantik - NATO-s, e cila tashmë kishte filluar të sulmoi caqet e forcave serbe në Serbi dhe Kosovë. Pikërisht në fund të prillit 1999 “me urdhër të Ministrit të Drejtësisë të Republikës së Serbisë, Dragolub Janković, ishte urdhëruar që të dënuarit dhe të arrestuarit, pengjet shqiptarë të transferohen nga burgjet e Serbisë në Kosovë në burgun e Dubravës, mu në kohën e bombardimeve”.⁴ Ky veprim i shëmtuar i institucioneve serbe ishte në kundërshtim me veprimin e para një viti, pra në kundërshtim flagrant me Konventën për Mbrojtjen e Personave Civilë në luftë, më 1949, dhe protokollet

³ Deklarata të njëjta dhanë shumë të mbijetuar të burgosur shqiptarë të kësaj masakre: Ukë Thaçi, Asllan Selimi etj.; më gjerësisht shiko: Ukë Thaçi, *Masakra ...*, vepër e cituar, f. 139.

⁴ Dëshmi nga avokati i njohur shqiptar me banim në Beograd, Hysni Bytyqi, 9 maj 2005, botuar në internet. Si fusnota nr. 2, f. 19.

shtesë I dhe II të Konventës së Gjenevës të vitit 1977, të nënshkruar nga udhëheqja e lartë e shtetit, të cilit i përkisnin urdhërdhënësit serbë. Të nënshkruash konventën e këtillë dhe nga ana tjetër të konceptosh dhe të realizosh terrorizëm shtetëror ndaj qytetarëve që në dokumentet personale të tyre kanë qenë të shënuar qytetarë të shtetit serb, do të thotë të mohosh dhe të injorosh themelin e lirisë, të drejtësisë dhe të paqes njerëzore të një familjeje njerëzore të vendit të vet, e cila zhvillimin e vet kurrë nuk e ka mbështetur në mohimin e të drejtave dhe lirive të serbëve dhe të askujt tjetër.⁵ Në këto momente, trysnia ndërkombëtare për ndërprerje të terrorit ndaj shqiptarëve dhe të shkallës së përvuajtjes së të burgosurve, shkonte në raport të zhdrejtë me shkallëzim të torturës, në raport të zhdrejtë me llahtarinë e paparë dhe me shkallëzim gjithnjë e më të madh të torturës ndaj të burgosurve. “Derisa me të Drejtën Humanitare, të sëmurit dhe të plagosurit i takojnë grupit të personave të mbrojtur, në burgun e Dubravës, të burgosurit shqiptarë janë plagosur, janë thyer eshtrash nga rrahjet, janë lënduar dhe janë vrarë”.⁶ Nga deklaratat e të mbijetuarve të kësaj masakre të tmerrshme, rastet e tilla ishin bërë dukuri e zakonshme dhe permanente në shumë situata të çdo përballje qoftë ajo, më e zakonshmeja ndërmjet palëve brenda këtij burgu - të ngjashme në plotni me raportet e viktimës me xhelatin. “Me që burgu i Dubravës ka qenë pjesë e sistemit të organeve dhe të institucioneve të Serbisë së viteve ‘80-ta e ‘90-ta, shteti i Serbisë në instancë të fundit mbanë përgjegjësinë për gjithë masakrën që ka ndodhur në burgun e Dubravës, pa marrë parasysh përgjegjësinë individuale që mban personi që ka shkelur konventat për mbrojtje të të burgosurve”.⁷

⁵ Si shënimi 2, f. 372-373, PajazitNushi, Analizë psikologjike, Prishtinë, 19.05.2008.

⁶*Po aty*, f. 373.

⁷*Po aty*.

Gjithashtu, “shkallëzimi i terrorit të ushtruar ndaj të burgosurve në këtë burg, në shkallë të lartë të torturave, ngritja e kësaj shkalle në krim ndërkombëtar përmes bombardimeve të NATO-s dhe ekzekutimi kolektiv i të burgosurve, tregon karakterin programor të sjelljeve të shtetit serb ndaj shqiptarëve të burgosur”.⁸ Është ky konstatim real në raport me normat ndërkombëtare dhe obligimet e shteteve nënshkruese të dokumenteve të përmendura më sipër. Për të qenë ironia edhe më e madhe, ja çka deklaroi pala serbe në informatën që mban datën 19 maj 1999: “Rrethanat e zbulimit. Kjo lëndë përmban informacione për bombardimet nga NATO të burgut të Dubravës. Në bazë të informatave në burg ishin të akomoduar 1 004 të dënuar dhe nga pasojat e bombardimit janë vrarë 97, ndërsa 196 të tjerë janë plagosur rënd dhe lehtë. Nga bombardimet, gjithashtu janë rrënuar të gjitha objektet si dhe është shkaktuar dëm material jashtëzakonisht i madh... Trupat e viktimave janë bartur në varrezat shqiptare në fshatin Sushicë e Ulët në drejtim të Mitrovicës së Kosovës. Në lokacionin e përmendur, trupave u është bërë trajtimi tekniko-kriminalistik dhe janë varrosur në varreza të veçanta individuale”.⁹

Nga e gjitha ajo që ceket në këtë raport, e vërtetë është vetëm një gjë, se ka ndodhur bombardimi i parë nga avionët e NATO-s në burgun e Dubravës, më datën 19 maj 1999, dhe se nga ai sulm: “në pavijonin “C-1” janë vrarë 3 të burgosur dhe 19 ishin plagosur, prej të cilëve 4 shumë rënd, njëri prej tyre do të vdes në Spitalin e Pejës”.¹⁰ Ndërsa, për zhvillimet e tjera dhe krimet e rënda ndaj të burgosurve shqiptarë të kryera nga gardianët dhe forcat e tjera serbe (paramilitarë

⁸*Po aty.*

⁹ Dokument i proveniencës serbe: Lënda: NATO bombardovanje, mesto: Pec-Istok, vreme: 19.05. 1999, (kopja e këtij dokumenti ndodhet te autori).

¹⁰ Si shënimi 2, f. 173-174.

serbë, serbë të burgosur të dënuar për krimet e luftës në Kroaci e Bosnjë të tjerë, do të bëhet fjalë në vijim të këtij studimi.

Ndërsa, gjatë tri ditëve të bombardimeve të NATO-s, në burgun e Dubravësjanë vrarë gjithsej 23 të burgosur shqiptarë dhe janë plagosur 200 vetë, prej të cilëve 120 kishin marrë plagë të rënda. Të burgosurit e tjerë shqiptarë u ekzekutuan nga gardianët dhe kriminelët e tjerë, nga afërsia.¹¹ Këtë të vërtetë e dëshmojnë edhe “të dhënat e ekspertëve mjeko-ligjorë të kontingjentit spanjoll të KFOR-it, të cilët bënëekzaminimindhe ekspertizënmjeko-ligjore, në së paku një varr masiv të të burgosurve shqiptarë, të vrarë në Qendrën Korrektuese të burgut të Dubravës, në Istog. Aty janë gjetur plumba pushkësh, të përshtatshme për ekspertizë, copa bombash dhe të mjeteve të tjera shpërthyes, dhe shihet se kush me çka është vrarë. Prokuroria e krimeve të luftës (e Serbisë H. K.) posedon reversët për armët, kush dhe me çfarë arme është ngarkuar. Janë shënuar numrat e pushkëve, numrat serik të tyre, lloji i armës dhe emrat e personave që i kanë marrë në posedim”.¹² Mbështetur në të dhënat që ofron autori i shkrimit të përmendur paraprakisht thuhet: “Në kohën kritike nga burgu i Pozharevcit, për në burgun e Istogut janë dërguar një grup të burgosurish të dënuar për vepra të rënda penale. Nga ky grup, së paku 13 prej tyre ishin të dënuar, jo me më pak se 20 vjet. Paralel me këta të dënuar, transportohet dërgesa me armë prej 39 pushkësh automatike, 12 pushko-mitraloza dhe një sasi e konsiderueshme bombash të dorës dhe municion, të gjitha këto nga rezervat e KPD Zabela të Pozharevcit, destinuar për rojet e burgut në Istog”. Në vazhdim të kësaj informate thuhet: “Atyre trembëdhjetë vetave u janë

¹¹PajazitNushi, *Dubrava dhe etika e të ngjuarve në burgun e saj*, (Si shënimi 2, f. 373-.374).

¹² Adem MujëNimani, *Ballkanikus - shqiptarët dhe serbët*, Prishtinë, 2020, f. 36.; Dosja e patologëve spanjollë për këtë rast.

ndarë armët e përmendura dhe ata janë ngarkuar me to, për çka ekzistojnë reversët dhe nënshkrimet... sipas njohurive të Prokurorisë (serbe) për krime të luftës, së paku 93 të dënuar shqiptarë, të burgosur në KPZ Dubrava, janë vrarë në periudhën prej 19 deri më 21 maj të vitit 1999, me plumba armësh të këmbësorisë dhe me bomba dore”.¹³

Për krimet e tjera dhe veprimet e atyre që ishin të detyruar t'i mbronin të burgosurit, do të ofrojmë: fakte dhe dëshmi nga të mbijetuarit e kësaj masakre të veçantë, të cilët në deklaratat e tyre evokojnë përjetimet e tyre në mënyrë reale dhe objektive.

Bombardimet dhe pasojat - përshkrim

Sipas mendimit të shumë të burgosurve shqiptarë të mbijetuar të masakrave në burgun e Dubravës, fillet e kësaj masakre të veçantë, datojnë nga 16 maji 1999, kur në kundërshtim me të gjitha rregullat ligjore, lirohet i burgosuri politik dhe veprimtari i dalluar i çështjes kombëtare, prof. Ukshin Hoti,¹⁴ një ditë para se të mbushte pesë vjet të vuajtjes së burgut të padrejtë, dhe atë lirohet në ditën e diel, kur administrata e burgut nuk punonte si dhe kur kësaj i shtohet edhe gjendja e jashtëzakonshme e luftës, mund të kuptohet qëllimi. Ishte ky një ogur i zi dhe paralajmërim për të gjithë të burgosurit shqiptarë që ndodheshin brenda këtij burgu. Këto ditë, thuhet se u liruan edhe Rasim Plava e Shkëlzen Pepshi, të cilët sipas disa deklaratave të mëvonshme, me të dalë jashtë burgut ata ishin ekzekutuar.¹⁵ Në ditët

¹³Po aty, f. 35.

¹⁴ Vendimi i drejtorit të burgut të Dubravës, AleksandarRakoceviq, datë 16. 05.1999, Ukshin Hoti, nga kjo ditë e kobshme, figuron në listën e personave të zhdukur të luftës dhe familja e tij nuk ka marrë asnjë informacion zyrtar se ku ndodhet apo cili është statusi i tij.

¹⁵ Si shënimi 2, f. 25.

vijuese vazhdojnë veprimet provokuese të forcave serbe ndaj aeroplanëve të NATO-s.

Pas veprimeve të shumta provokuese të forcave të armatosura serbe, të cilat qëndronin jashtë rrethojave të burgut, më 19 maj 1999, në orët e paradites (rreth orës 10:00), ndodhi sulmi i parë i forcave ajrore të NATO-s. Ishte goditur pavijoni “C” me dy raketa nga krahu i majtë dhe një nga krahu i djathtë. Sërish rrotullohet i njëjti aeroplan dhe e godet pavijonin në radhë. Pavijoni “B-1” u godit me një raketë të krahut të djathtë, nga se të dytën të këtij krahut e kishte hedhur, ndoshta gabimisht. “Në sallën e pavijonit “C”, ishin vrarë tre të burgosur e plagosur disa të tjerë”¹⁶. I njëjti vazhdon të rrëfej: “Pas kësaj tragjedie të papritur, u krijua panik e rrëmujë te të gjithë të burgosurit e këtij pavijoni, ku ishin të ngujuar 360 shqiptarë. Në atë huti të përgjithshme, mendonim ç’të bënim, si të dilnim jashtë grilave të shumta. Vërejtëm lëvizjet e të burgosurve shqiptarë të pavijoneve të tjera. Ata lëviznin në drejtim të pavijonit ku ishim ne. Vrapojnë më kasma në duar për t’i thyer bravat e dyerve të grilave. Bashkërisht, ia arritëm dhe i hapëm një pjesë të dyerve e grilave dhe dolëm jashtë. Kishte ndodhur diçka që nuk mund të besonim”¹⁷. “Pyetnim ç’të bëjmë tutje. U drejtuam kah pavijoni “C”, kaluam përkaj pavijonit “B-1” që për fat ishte i zbraztë dhe e kishin goditë me një raketë. Arritëm te pavijoni “C”. Vepruam me shpejtësi pa u hamendur, thyem bravat e grilave dhe hymë brenda, ende nuk kishte rënë poshtë pluhuri i strukturës së ndërtesës, britma e trishtim i paparë. Filluam të ofrojmë ndihmë të plagosurve të shumtë të cilët i nxorëm jashtë. Më

¹⁶ Deklaratë e Ukë Thaçit, i mbijetuar i kësaj masakre dhe autor i librit të përmendur më parë, *Masakra në burgun e Dubravës*, f. 34; Enver Dugolli, *Qark i (pa)mbyllur burgjesh*, Botues, Shoqata e ish të Burgosurve Politikë e Kosovës (SHBPK), Prishtinë, f. 131.

¹⁷ Deklaratë e Ukë Thaçit dhe të tjerëve, vepër e cituar, f. 35.

vonë u morr vesh se ishin të vrarë 3 të burgosur: Enver B. Topalli nga Gremja e Ferizajt, Avdullah Ramadan Tahiri nga Malisheva e Gjilanit dhe Xhokë Matej Ndreca nga Bitishi i Gjakovës”¹⁸. Për shumë të plagosurit, përveç kujdesit profesional, mungonte edhe çdo gjë tjetër. “Në ato kushte nga të pranishmit u lind ideja e improvizimit të një spitali të emergjencës. Përpjekje maksimale bënë individë që kishin sado pak përvojë në këto punë. Në krye të këtyre përpjekjeve u vunë: Bislim Zogaj me Sherif Haqifin e Sherif Ilazin e disa të tjerë”¹⁹. Është bindje e shumë të burgosurve të mbijetuarve se ajo ndihmë e ofruar në ato kushte dhe momente të vështira ka shpëtuar shumë jetë të të plagosurve.

“Më 20 maj 1999, gjatë kësaj dite nuk kishte granatime nga NATO, por edhe personeli i kampit (burgut), nuk dukej gjëkund. Ne u vetorganizuam dhe qëndronim jashtë, në oborrin e burgut. Për dallim nga dita e mëparshme ishte një ditë më e qetë..”²⁰. - shkruan në ditarin e tij, i burgosuri Asllan Selimi.

Dita e 21 majit 1999, ishte e qetë nga sulmet e aeroplanëve të NATO-s. Qendra e Aleancës Veriatlantike në Bruksel kishte pranuar bombardimin dhe kishte deklaruar: “Dubrava ishte një, “kamp stërvitje ushtarake”. Në një konferencë për shtyp, majori Walter Jertz shpjegoi: “Ajo (Dubrava) është një objektiv i rëndësishëm ushtarak. Ne e dimë se ajo është një kompleks i sigurimit ushtarak dhe ky objektiv është sulmuar, ngase ishte një objektiv legjitim ushtarak dhe ne nuk kemi të dhëna që goditjet ranë në ndonjë vend tjetër apo që pilotët kanë gabuar shënjestrën. Mund të shtojë se ne përdorim bomba

¹⁸ Si shënim 2, f. 39.

¹⁹ *Po aty*, f. 39.

²⁰ Pjesë nga Ditari në dorëshkrim i të burgosurit Asllan Selimi, *Tmerri pa emër*, Rrëfim për masakrën në burgun e Dubravës.

me precizitet të lartë”.²¹ Oficeri i lartë i NATO-s, ngulte këmbët me të drejtë në profesionalizmin dhe precizitetin e teknikës së tij ushtarake, por në ato momente nuk ndalej të mendonte se pilotët e tij kishin rënë në grackën e mashtrimeve dhe manipulimeve serbe.

Në të njëjtën kohë, Ministria e Punëve të Jashtme e Jugosllavisë (së cunguar), lëshon komunikatën me plotë të pavërteta: “NATO-ja bombardoi forcat e Ushtrisë jugosllave, e të Policisë serbe në afërsi të burgut, në ora 13:15, më 19 maj, duke vrarë tre civilë. Sipas raportimeve, tri bomba goditën burgun, duke vrarë dy të burgosur e një roje”.²² Një komunikatë e këtillë në kushtet e luftës arrin të krijoj huti në opinionin ndërkombëtar.

Në komunikatën e zëdhënësit të NATO-s, JemieShea, të datës 22 maj, thuhej: “Siç e dini tashmë në Istog, Kosovë, forcat e NATO-s sulmuan një zonë të kazermave, e cila ishte përdorur për një kohë të gjatë nga Ushtria jugosllave dhe nga forcat e policisë speciale të (MPB) Ministria e Punëve të Brendshme, si pjesë e operacioneve kundër UÇK-së dhe kundër civilëve kosovarë. Kjo zonë gjendet pranë një burgu, por unë dua të theksoj, ashtu siç bëra edhe dje, që fjala është për një zonë ushtarake. Burgu është pjesë e kësaj zone, por përbën vetëm një pjesë të vogël të një kompleksi të madh ushtarak.”²³ Kjo e vërtetë qëndronte, por se ishin bërë lojërat dhe manipulimi nga ushtarakët serbë, kjo e vërtetë nuk kishte arritur në opinionin ndërkombëtar.

Edhe pse më 21 maj, në orët e hershme të paradites, mendonim se nuk do të ketë bombardime nga avionët e NATO-s, të burgosurit u terrorizuan nga gardianët, të cilëve po u ndihmonin të

²¹ Nën pushtetin e urdhrave, Krimet e luftës në Kosovë, “HumanrightsWatch”, f. 261.

²² *Po aty*, f. 261.

²³ Si shënimi nr. 17. f. 263.

burgosurit serbë, të cilët kishin ndërruar pozitën dhe statusin e tyre. Ata ishin mobilizuar dhe maskuar nga udhëheqësit e burgut dhe ishin ngarkuar me detyra kriminale, të torturonin e vrisnin të burgosurit shqiptarë. Po përmendim emrat e disa të dënuarve serbë për krimet e luftës në Kroaci e Bosnjë, e të cilët ishin në vuajtje të dënimit në burgun e Dubravës. Ata ishin armatosur dhe maskuar dhe po bënë krime tash edhe në Kosovë: Sinisha Petroviq-Zenica, nga Zenica e Bosnjës; Milosh Gjuriq nga Burimi, po ashtu i burgosur për krime në Bosnjë e Kroaci; Ilija Mishkoviq nga Nikshiqi i Malit të Zi; Aca i Vogël nga Burimi, zv.komandant, pjesëtar i gardës së Arkanit; Milovan Milosheviq-Tale nga lagjja “Ulpiana”, Prishtinë; Igor Gerkoviq, ish-polic nga Peja; Hranislav Kukurekoviq nga Gushterica, Lipjan; Miga Llaleviq nga Mali i Zi, e disa të tjerë.²⁴

“Pas orës 10:30 të po asaj dite, filluan fluturimet e aeroplanëve të NATO-s, të cilët silleshin mbi burgun e Dubravës. Pritej ku do të hedhin raketat e tyre. Në ndërkohë, shpërthimi i parë godet objektin e ngrohtores së burgut, që ishte jashtë rrethojës, por ku kishte makineri luftarake të maskuar. Në goditjen e dytë, po në të njëjtin vend, i tërë objekti u rrafshua për toke dhe grimcat e ndryshme arrinin tek ne. Pas pak kohe një aeroplan ishte drejtuar nga turma e të burgosurve, dhe lëshoi një raketë e cila vrau disa njerëz të cilët nuk ditën të shtrihen për toke. Vrasja po vazhdonte nga gardianët të cilët po hulumtonin të burgosur, të cilët ishin fshehur në skuta të ndryshme nga frika e tmerri që po u kanosej.

Për të ndihmuar të plagosurit e shumtë, duheshin barna e material sanitar, të cilat mungonin. Një grup i të burgosurve të mbijetuar u vërsulen të minispitali i burgut, ku thyen xhamat e dyerve dhe hynë brenda ambulancës. Ata kishin mbushur disa thasë me barna

²⁴ Si shënimi nr. 2, f. 42.

të cila iu shpërndan të plagosurve. Me këtë rast, sipas deklaratës së Sherif Hamzës. nga snajperistët vriten dy të burgosur. Në këto rrethana të vështira ishte dëgjuar lajmi se BillKlintoni, i kishte kërkuar falje Hashim Thaçit, për gabimet e sulmit në burgun e Dubravës. Ky ishte një lajm i mirë për ne, se kuptuam se dikush është në dijeni për këtë masakër me të cilën po përballeshim ne, të burgosurit shqiptarë”.²⁵ Në këto kushte të rënda, një pjesë e të burgosurve shqiptarë ishte grumbulluar në fushën e sportit ku po i sillnin të plagosurit dhe po i rendisnin të vrarit. Përveç barnave e mjeteve të tjera sanitare na mungonte edhe ushqimi. Disa prej nesh e kishin thyer kuzhinën dhe kishin nxjerr një pjesë të ushqimeve për ne që po ndihmonim dhe për të plagosurit. Në këto momente kishte filluar improvizimi i spitalit në pavijonin “C”, ku po mjekonin BislimZogajn, Haqif e Sherif Ilazin, Dëfrim Rifajn e disa të tjerë”.²⁶ “Ishte kohë e pasdites së premtë (21 maj 1999), me që ishim numër i madh i njerëzve të ngjuar, disa filluan të bisedojnë për gjetje të vendeve për strehim gjatë natës. Ideja e improvizimit të pusetave si vendstrehim ishte e pranueshme, por ato kishin hapësirë jo të mjaftueshme, si dhe problem ishte maskimi i tyre nga se gardianët dhe grupe paramilitaresh po i vrisnin të burgosurit që fshiheshin kudo. Gardianët i kishin vëzhguar dhe identifikuar nga larg vendet ku ishin strehuar disa nga pengjet e burgosur. Me gjakftohtësinë e vrasësit serik, afroheshin dhe hidhnin bomba dore e granata në puseta. Aty mbetën shumë të vrarë e të plagosur”.²⁷ Ngjashëm u veprua edhe nëpër bodrume të objekteve, që nuk ishin shembur. “Një masakër e tmerrshme këtë natë ishte kryer nga kriminelët serbë ndaj të burgosurve shqiptarë të strukur në puseta dhe në bodrumin e shtëpisë

²⁵ *Po aty*, f. 47.

²⁶ *Po aty*, f. 48.

²⁷ Enver Dugolli, *Qark i (pa)mbyllur burgjesh...* vepër e cituar, f. 155.

së kulturës. “Bodrumi i shtëpisë së përmendur ishte mbushur me gjakun e të vvarëve dhe të masakruarve këtë mbrëmje”²⁸, - rrëfen XhavitMala, i mbijetuar i kësaj llahtarie.

“Të nesërmen, më 22 maj, në orët e hershme të mëngjesit nga disa të burgosur u shpërndanë lajme se duhet të dalim jashtë të gjithë në fushën e sportit dhe të rreshtohem në rend nga katër veta, ngase do të na transferojnë. Nuk kishim kah t’ia mbajmë. Filluam të dilnim e të rreshtoheshim. Kërkohej që të afrohem sa më afër murit, kjo tek disa kishte ngjallë dyshim të bazuar. Nuk vonoi shumë dhe gardianët të mbështetur nga paramilitarët serbë dolën nga karaullat - (kullat e vrojtimit) mbi mure dhe filluan të shkrepin tromblone, mitraloz, snajperë e armë të tjera”. Një i burgosur rrëfen se “shkreptima e parë me tromblon nga karakolli i rrethojës së burgut u bë nga (Dritan Martini) tani SfetlanMartinoviq, me prejardhje nga Vrraka e Shkodrës”.²⁹ Një i mbijetuar tjetër në librin e tij të kujtimeve kështu i përshkruan këto mizori. Ai e titullon “Pushkatim masiv”.³⁰ “Gjatë shkrepjeve, nga prapa mureve, hidheshin bomba e granata të panumërta nga e tërë hapësira e prapa murit të fushës sportive, në drejtim të të burgosurve të rreshtuar detyrimisht. Të tmerronte britma e ulërime e njerëzve. U alarmuam. S’dinim se ç’po ndodhte. Veprimi i mendimit aty për aty, bëhej nga të mbijetuarit. Edhe këtu pati shumë

²⁸ Si shënimi 2, f. 49-50.

²⁹ *Po aty*, f. 50; Deklaratë e BajrushXhemajlit, i mbijetuar i kësaj masakre.(Vrrakasi, ishte dikur shqiptar ortodoks, tani ishte serbizuar. Ky kishte ndërruar kombin dhe ruajtur ritin fetar, nga ortodoks shqiptar në ortodoks serb, për të gëzuar privilegje tek okupatori serb... Këtij tani i duhej për të dëshmuar se vërtet është transferuar në ortodoks serb dhe të dallohej si servil ndaj komandantit, kryekriminelit MirolubVidiq-Miki, gjatë tërë skenarit të masakrës. Kështu edhe kishte urdhërua nga lartë, për t’u shpërblyer menjëherë pas krimit gjoja me 15-20 ditësh, për të mos u kthyer më kurrë në vendin e vuajtjes së dënimit - të krimit.).

³⁰ Enver Dugolli, *Qark i (pa)mbyllur burgjesh...*, vepër e cituar, f. 147.

të vrarë”.³¹Më tej vazhdon: “Një pjesë e të burgosurve filloi të largohej, disa kërkonin strehim kudo që mundnin e shumë të tjerë u futën në pusetat e afërta të kësaj hapësire. Një i mbijetuar tjetër e përshkruan kështu këtë mizori: “Serbët kishin hipur në karakoll, mbi muret përreth, mbi kamionët dhe traktorët dhe gjuanin me gjithë ç’kishin, me bomba e granata”³². Ishte edhe kjo një ployë e paparë ndaj njerëzve duarlidhur e të ngujuar në burgun e Dubravës, që në atë kohë menaxhohej nga pushteti okupues i Serbisë. Të mbijetuarit që i shpëtuan vdekjes të stresuar e të trishtuar e kaluan atë natë nën qiellin e hapur.

“Në ditën e 23 majit, në orët e hershme të mëngjesit, u dëgjuan thirrjet në gjuhën serbe, “Dilni jashtë nga objektet!. Do t’ju transferojmë...”. Ç’të bëjmë, pyetnim njëri-tjetrin?! Fillimisht nuk kishte përgjigje nga ne. Më pastaj, pas çdo thirrje dëgjoheshin breshëri automatikësh dhe armesh më të rënda. Ato goditën disa herë ndërtesën, duke shkaktuar zhurma e dridhje të mëdha aty brenda. Pas shumë hezitimeve vendosëm të dalim, pasi nuk kishin alternativë

³¹*Po aty*, f. 51; Dëshmia e kolonelit, Radovan Paponjak, kryeshef i Policisë serbe në Pejë. Në dëshminë e tij, me rastin e gjykimit të Slobodan Milosheviqit në Hagë, ai të ilustruar me video-incizime paraqet shkaqet e bombardimit në këtë burg. Ai ngarkon personelin e burgut se, më 22 maj 1999, të burgosurit shqiptarë janë thirrur që me mjete personale që posedonin, të rreshtohen në terrenin sportiv me qëllim gjoja të numërimit për transferim në burgun e Nishit. Kur disa qindra të burgosur janë rreshtuar në poligonin e sporteve, afër karakollit, nga karakolli i rojeve është shkrepur në të burgosur me pushkëmitraloz dhe mjete tjera zjarri, ku shumë nga të burgosurit janë vrarë e plagosur (për të vrarët jep numrin 50). Në përgjigjen e tij, i akuzuari (kryekrimineli Millosheviq), këtë akuzë e quan absurde, duke shtuar se burgu i Dubravës ka qenë i bombarduar disa ditë nga NATO, ku gjatë këtij bombardimi janë rrënuar 7 pavijone, e nga këto rrënoja janë nxjerr trupat e 93 të vrarëve.

³²Bujar Dugolli, *Qark i (pa)mbyllur burgjesh*, vepër e cituar, f. 146, 149; Dosja e patologëve spanjollë që ekzaminuan hapësirën e burgut të Dubravës, pas përfundimit të luftës në Kosovë, foto nr. 6, dok nr. KO173952.

tjetër. Dolëm jashtë. Para nesh ishin pozicionuar qenie me trup njeriu. Ishin shumë. Mbanin uniforma të ndryshme. Të gjithë ishin me maska në kokë. Ata ishin të gjithë të armatosur me armë të llojeve të ndryshme. Rresht për dy vazhduam andej nga na urdhëruan. Gjatë ecjes, nga dolëm derisa ndalum, rreth 30-40 metra, pamë shumë shqiptarë të vrarë. Ata ishin vrarë gjatë natës që sa po kishte kaluar. Ne më urdhër ndalum në një hapësirë, tutje objekteve të shkatërruara, qëndronim ashtu të rreshtuar. Ata qëndronin rreth 50-60 metra larg nesh me armë në gjendje gatishmërie. Për një çast pamë që atje nga maskat, po hidhej diçka me dorë në drejtim tonë. Ishin paketa cigaresh. Në fillim askush nuk u turr për të marrë ndonjë. Dikush, atje kah maskat, foli: “Kështu siç jeni rresht, nisuni për në sallën e sportit”!. Ashtu bëmë. Të përcjellë nga shumë tyta armësh, nga të dy anët e rreshtit, u nisëm andej... I sollën edhe të tjerët nga vendstrehimet ku ishin strehuar gjatë natës. Me ne i kishin urdhëruar të jenë edhe të plagosurit. Na mbajtën “ligjëratë” duke na thënë: “Këtë ua ka bërë NATO!. Ne ju shpëtuam!. Tash rrini këtu, derisa të krijohen kushtet për t’ju dërguar në një vend të sigurt...! NATO ju vrau. E shihni, që ata janë kriminelë, kurs ju , mendoni që i keni miq...”, - sugjeronin xhelatët.! Pas asaj “ligjëratë”, ata dolën nga aty.³³ Ndërsa, ne mbetëm në ankth për të pritur çka do të ndodhte me ne. Krejt në fund, një gardian paramilitar na tha: “Po i presim autobusët. Do t’ju dërgojmë në një burg tjetër. Nuk ka mundësi të qëndroni më këtu”. Na i gjuajtën disa pako të cigareve dhe i thirrën disa të burgosur që të na japin ujë.³⁴ Pas këtyre veprimeve të pazakonshme nga xhelatët, dikush prej tyre na tha: “Sot nuk mund të shkojmë, për shkak se nuk kanë ardhur autobusët. Sot gjenduni si të

³³*Po aty*. Shiko gjerësisht te libri Ukë Thaçi, *Masakra...*f. 161.

³⁴NaserHusaj, *Dubrava rruga drejt vdekjes*, Shoqata e të Burgosurve Politikë të Kosovës ; Lidhja e historianëve e Kosovës “AliHadri”, Prishtinë, 2005, f. 86.

mundeni. Askush më nuk do t'ju vras. Përgatitni vetë ushqimin. Nesër, në ora 06:00 të mëngjesit, do të vinë ata. Do t'ju transferojmë në burgun e Lipjanit.”³⁵ Ne mbetëm në pritje dhe u morëm me hallet tona deri të nesërmen në mëngjes, u kujdesëm për të plagosurit e shumtë dhe i sistemua si mundëm. Po ashtu edhe të vrarët e shumtë nga gardianët dhe paramilitarët serbë e malazezë.

Në mëngjesin e 24 majit, u dëgjuan zëra duke thënë, erdhën...! Dolëm jashtë për të parë se çfarë kishte. Pamë shumë të uniformuar, por edhe “civilë”. Kishin sjellë edhe disa autobusë e kamionë. Njëri nga ata civilët që dikush tha se ishte komandant i UDB-së për qarkun e Pejës, e mbase ishte edhe udhëheqësi i atij operacioni, u drejtua nga ne duke thënë: “E shihni se çfarë ju bënë miqtë tuaj...? Kjo është NATO, që ju mendoni se i keni miq! Por mos keni frikë ...! Asgjë e keqe nuk do të ju ndodhë më, ju siguroj...!”³⁶ Pas kësaj ligjërate, na urdhëroi që t'i marrim të plagosurit e t'i vendosim në kamion, ndërsa ju të tjerët vendosuni në autobusë. “Miqësia” dhe “mirësia” e tij po shihej në urdhrin për vendvendosjen e të plagosurve. Ashtu sa më shpejt që mundëm, tërhoqëm të plagosurit dhe i vendosëm në kamionët që ishin jashtë, para sallës. Kishte shumë të plagosur... Në kamionin e fundit, bashkë me 31 të plagosurit, u vendosëm edhe disa nga ne, që ishim të paprekur nga plumbat ose granatat. Deri jashtë mureve rrethuese të kampit, na përcollën njerëz me uniformë e maska në kokë, me armë të ndryshme në gjendje gatishmërie për të shtënë. Që nga nisja e deri jashtë mureve të kampit pashë edhe shumë të vrarë. Edhe jashtë hyrjes kishte të vrarë! Ata ishin vrarë brenda mureve. Mbase, kishte edhe të atillë, që ishin përpjekur për t'u arratisë dhe ishin varë... Që në metrat e para jashtë mureve rrethuese të kampit, pashë një grumbull të madh (mund të ishin 20-30 vetë,

³⁵ *Po aty*, f. 86- 87.

³⁶ Ukë Thaçi, *Masakra në Burgun e Dubravës....*, vepër e cituar, f. 168.

njeri mbi tjetrin në formë kryqi) pengje shqiptarë të vrarë, më tutje pash forca të shumta ushtarake e paraushtarake. Ata ishin të pozicionuar pranë istikameve, pranë mjeteve të rënda luftarake. Përderisa ne po vazhdonim rrugën, sipas të gjitha gjasave drejt burgut të Lypjanit që ishte marrë vesh se do të jetë destinacioni i parë, prej nga më vonë (më 10 qershor 1999) na shpërndan nëpër të gjitha burgjet e Serbisë. Dhuna fizike e psikologjike për pengjet shqiptare, nuk përfundoi as pas këtyre transferimeve nga burgu në burg, madje nuk ishin kursyer as të plagosurit që mbijetuan nga masakra e veçantë në burgun e Dubravës. Kështu silleshin “miqtë” në ato ditë të luftës tonë për jetë a vdekje”.

Në vazhdim lista e 120 të burgosurve, të vrarëve dhe të zhdukur në masakrën e burgut të Dubravës, me emër, mbiemër, vend të lindjes dhe komuna të cilës i përkasin, të evidentuar deri në vitin 2011. Kjo listë nuk konsiderohet përfundimtare

1. Gazmend Jahir Kolgeci, Vraniq, Suharekë; 2. Ilir Halil Luzha, Vraniq, Suharekë; 3. Nexhat Shaqir Kokollari, Savrovë, Suharekë; 4. Sahit Fezë Krasniqi, Savrovë, Suharekë; 5. Fazli Sahit Kabashi, Mohlan, Suharekë; 6. Kadri Rrahman Morina, Rreshtan, Suharekë; 7. Ali Hysen Gashi, Shirokë, Suharekë (i zhdukur); 8. Avdullah Ramadan Tahiri, Malishevë, Gjilan; 9. Sylejman Shaip Badallaj, Zhur, Prizren; 10. Lush Ndue Përlazi, Velezhë, Prizren; 11. Jonuz Mehmet Krasniqi, Arbanë, Prizren; 12. Gjon Mark Gjini, Prizren; 13. Man Karavidaj, Mazrek, Prizren; 14. Afrim B. Krasniqi, Tusus, Prizren; 15. Mehmet Qunaj, Kojush, Prizren; 16. Habib Azem Mehani, Gllanasellë, Drenas; 17. Zahir Sadik Agushi, Drenoc, Klinë; 18. Mujë Jashar Tafilaj, Siqevë, Klinë; 19. Bajram Jonuz Berisha, Valljakë, Klinë; 20. Agim Ajeta Duraku, Burojë, Klinë; 21. Gani Isufi,

Suka e Gashit, Klinë; 22. Bedri Sejdë Hasani, Pejë; 23. Fadil Smajl Bezeraj, Raushiq, Pejë; 24. Sahit Sali Brahimaj, Kodrina, Pejë; 25. Ali Avdyl Kelmendi, Kusurik, Pejë; 26. Avni Bajram Gashi, Buqan Pejë; 27. Artan Tafë Gjekaj, Zillopek, Pejë; 28. Iber Dinë Gërgoci, Kusurik, Pejë; 29. Nazmi Hysen Shala, Pejë; 30. Haki Z. Dinaj, Rushiq, Pejë (i zhdukur); 31. Idriz Niman Zhutaj, Raushiq, Pejë; 32. Osman Husein Rastoder, Vitomiricë, Pejë; 33. Ramiz Smajl Shala, Babaj, Pejë; 34. Kolë Berisha, Pejë (ekzekutuar nga Boban Bashqareviq); 35. Naim Rexha, Strelc, Deçan; 36. Dervish Sylë Sylaj, Rashiq, Pejë; 37. Zekë Haxhi Hasanmetaj, Strelc i Epërm, Deçan; 38. Gani Ibish Lekaj, Lumbardhë, Deçan; 39. Metë Ibish Osmanaj, Isnig, Deçan; 40. Adem Idriz Jasiqi, Deçan; 41. Hajdar Pepaj, Kodrali, Deçan; 42. Latif Hasanmetaj, Strelc, Deçan; 43. Shkelzen Miftar Pepshi, Junik, Deçan; 44. Sefedin Brahim Hoti, Sibofc, Obiliq; 45. Besim Aziz Kabasshi, Apterush, Rahovec; 46. Avni Behxhet Thaçi, Reti, Rahovec; 47. Lulzim Hashim Hajda, Rahovec; 48. Qemajl Hajdar Bytyqi, Dejë, Rahovec (vdiq nga plagët e masakrës, në burgun e Lypjanit); 49. Gani Elez Morina, Dejë, Rahovec; 50. Isuf R. Berisha, Drenaj, Rahovec; 51. Ukshin Nazyf Hoti, Krushë e Madhe, Rahovec; 52. Xhemajl H. Eminhajzeri, Rahovec; 53. Besim Hazir Paçarizi, Dragobil, Malishevë; 54. Enver Avdyl Zogaj, Bellanicë, Malishevë; 55. Nikë Ndue Kola, Gjakovë; 56. Hasan Miftar Hoda, Gjakovë; 57. Zef Isuf Kqiraj, Zhub, Gjakovë; 58. Iber Sherif Metaj, Hereq, Gjakovë; 59. Krist Mark Përvorfi, Dujakë, Gjakovë; 60. Hysen Avdyl Ademaj, Mulliq, Gjakovë; 61. Ilir Damon Damoaga, Gjakovë; 62. Qaush Haxhi Ahmeti, Shermetaj, Gjakovë; 63. Besnik Shani Kastrati, Gjakovë; 64. Blerim Adem Hoda, Gjakovë; 65. Xhevdet Gani Bistriva, Gjakovë; 66. Napoleon Qemajl Guta, Gjakovë; 67. Valentin Mark Nikollbibaj, Brekoc, Gjakovë; 68. Gazmend Fazli Imeraj, Ponoshec, Gjakovë; 69. Xhokë

Metaj Ndreca, Bitish, Gjakovë; 70. Anton Pashk Maksuti, Vogovë, Gjakovë; 71. Bujar Adem Himaj, Skivjan, Gjakovë; 72. Fadil Hysen Beqiraj, Rracaj, Gjakovë; 73. Gani Fazli Imari, Ponoshec, Gjakovë; 74. Halit Sadri Ademaj, Rracaj, Gjakovë; 75. Hamdi Adem Ademaj, Rracaj, Gjakovë; 76. Krist Pren Nokaj, Moklik, Gjakovë; 77. Muhamet Ymer Shala, Blinishtë, Gjakovë; 78. Myhedin Xhelal Guta, Gjakovë; 79. Ramë Rexhep Ibrahim, Stubëll, Gjakovë; 80. Ramiz Himë Bajrami, Osek Hyla, Gjakovë; 81. Rasim Demë Plava, Cërmjan, Gjakovë (i liruar më 16 maj 1999, është gjetur i vrarë); 82. Përparim Efendiu, Gjakovë (i ekzekutuar nga Boban Bashqareviq); 83. Ali Guta, Gjakovë (i ekzekutuar nga i njëjti kriminel serb); 84. Naim Zenel Zahiti, Sumë, Vushtri; 85. Nexhat Tahir Pllana, Martirët, Vushtri; 86. Zejnullah Mujë Elshani, Bajincë, Drenas; 87. Hasan Beqir Shala, Nënkala, Drenas; 88. Shani Avdyl Shala, Nënkala, Drenas; 89. Xhafer Hysen Gllareva, Fortesë, Skenderaj; 90. Qamil Abaz Thaçi, Llapushnik, Drenas; 91. Petrit Halim Kiqina, Rezistencë, Drenas; 92. Dan Brahim Leku, Rezistencë, Drenas; 93. Sahit Halit Thaçi, Grykë, Drenas; 94. Valdet Çerkin Sopi, Llapushnik, Drenas; 95. Afrim Jusuf Sahiti, Drenori, Drenas; 96. Bajram Miftar Kiqina, Rezistencë, Drenas; 97. Habib Azem Mahani, Shkabaj, Drenas; 98. Nasuf Mehmet Bylykbashi, Qëndresë, Drenas; 99. Musa Idriz Morina, Hodonoc, Kamenicë; 100. Enver Bajram Topalli, Greme, Ferizaj; 101. Rrahim Smajl Murseli, Greme, Ferizaj; 102. Ahmet Hysen Hoxha, Pleshinë, Ferizaj; 103. Tefik Salih Spahiu, Varosh, Ferizaj; 104. Mejdi Hajrush Dasholli, Sopot, Kaçanik; 105. Danush Miftar Kurtaj, Gabrricë, Kaçanik; 106. Tefik Bafti Raka, Kaçanik; 107. Avdylgafurr M. Luma, Gllloboqicë, Kaçanik; 108. Suad Isen Brava, Puset e Nikës, Kaçanik; 109. Arsim Murat Rrahmani, Podujevë; 110. Bashkim Emin Maloku, Dardhishtë, Podujevë; 111. Xhevat Azemi, Podujevë; 112. Shaban Bajram Qosa, Mitrovicë; 113.

Fezë Rexhë Spahija, Runik, Skënderaj; 114. Ramiz Rexhepi, Prishtinë; 115. Gazmend Idriz Gashi, Prishtinë; 116. Arsim Krasniqi, Prishtinë; 117. Ramiz Ramë Memia, Myhejan, Tropojë (Shqipëri); 118. Arsim Ahmet Zogiani, Harilaq, Fushë-Kosovë; 119. Isuf Qerim Hoxha, Myzeqinë, Shtime; 120. Bahri. Kryeziu, Gjakovë.³⁷

³⁷ Ukë Thaçi, Masakra në burgun e Dubravës..., vepër e cituar, fq. 65-68.

Haki Kasumi

SUMMARY

Massacre in Dubrava Prison (May 1999) During the years of fighting in Kosovo in 1998 and 1999, the Serbian police and military armed forces committed numerous crimes and serious crimes against humanity on a genocidal scale throughout the territory of Kosovo. The forms of crimes have been among the most diverse. Among them on this occasion we are highlighting: Deportations, rapes, kidnappings, murders and disappearances. It should also be remembered that such massacres in Kosovo (over 400) are a serious form of crime against humanity. Among the many atrocities committed by the Serbian armed forces against Albanians was the special massacre in Dubrava Prison which took place from 19 to 24 May 1999. Within a few days, hundreds were killed, massacred and wounded. Albanians, most of them (120 identified, their names at the end of this paper, as well as over 200 seriously injured). According to the data collected so far, a number of 20 people were killed unintentionally during the bombing of Serbian targets by NATO planes, and several dozen were injured. While the rest, ie most of the Albanian prisoners, were killed and tortured by official and paramilitary personnel on the orders of the leaders of Dubrava Prison. Thus, international and state legal norms have been violated, for which no one has yet been held accountable by international or local justice for crimes. These criminal actions of the Serbian armed forces and the lack of justice against them, are actions against the peace and future of the democratic and peace-loving population of the world.

Fati Iseni

Debati për Kosovën në parlamentin britanik gjatë krizës së viteve të ‘90-ta

Britania e Madhe si njëra nga Fuqitë e Mëdha botërore, aleat i ngushtë i SHBA-së dhe kundërshtues historik i politikave ruse në Ballkan dhe më gjerë, në shumë raste edhe nëpërmjet fushatave ushtarake kundër ndikimit rus në Lindje si edhe në rastin e Kosovës, do të jetë mjaft aktive. Debatet e rregullta në Parlamentin britanik përfshirë edhe Qeverinë, respektivisht Foreign Office dhe Ministrinë e Mbrojtjes, si dhe raportet e rregullta me analiza të detajuara për Kosovën përfshirë edhe aspektin historik dhe diskriminimin që është bërë ndaj saj, pasqyrojnë qartë orientimin strategjik në raport me Kosovën. Debatet për çështjen e Kosovës hasen që nga gjysma e parë e viteve ‘90-ta, por më të shpeshta dhe më të hapura do të jenë nga fundi i këtyre viteve. Nga debatet dhe raportet që prezantohen mund të perceptojmë se sikurse Qeveria, por edhe opozita britanike, kanë qëndrim pozitiv dhe mbështetës të çështjes së Kosovës, duke ndëshkuar në vazhdimësi udhëheqësin serb Millosheviq, përderisa për Kosovën japin tone të solidarizimit. Fjalimet e kryeministrit, sekretarëve të ForeignOffice dhe Ministrisë së Mbrojtjes, lënë të kuptosh se kanë për qëllim edhe informimin e publikut, duke e përgatitur atë për momente më ekstreme, si ajo e intervenimit ushtarak. Këto dokumente flasin se si asnjëherë më parë politikat britanike në çerekun e fundit të shek. XX, kanë interes të veçantë për

Kosovën dhe shihet qartë por me maturi simpatia dhe solidarizimi ndaj shqiptarëve në përpjekjet që bëjnë për të avancuar statusin e tyre.

Debati për Kosovën në Parlament dhe Foreign Office britanik, gjatë krizës së viteve 1990-1993

Britania e Madhe si një nga epiqendrat politike globale, politikën e saj të jashtme edhe pse e kishte mjaft të rrjetëzuar në një shtrirje të gjerë, ajo theks të veçantë kishte edhe në Evropën Lindore. Nga vet fakti se ajo kishte departament të veçantë për çështjet e Evropës Lindore dhe Bashkimit Sovjetik (Departamenti për Evropën Lindore dhe Bashkimin Sovjetik), nënkuptohet se ajo i ndiqte nga afër zhvillimet politike në këtë zonë, duke bashkëpunuar ngushtë edhe me SHBA-në.¹ Territori i ish-Jugosllavisë paraqiste vijën ndarëse të Evropës nga ndarja e Perandorisë Romake në dy pjesë në vitin 395.² Kjo ndarje vazhdoi me kishën në vitin 1054, atë të Perëndimit (Katolike) dhe atë të Lindjes (Ortodokse), shtrirja e Perandorisë Osmane deri në Bosnjë dhe Hungari, më pas edhe lindja e ideologjisë bolshevike-komuniste ruse nga viti 1917, e cila gjithashtu u shtri ngadalë deri në pjesën e poshtme të detit të Zi, detin Jon dhe Adriatik, detin Baltik dhe deri te marrja e një pjese të Gjermanisë, ngriti kërshtëritë politike të Perëndimit në pikën e vlimit.³ Jugosllavia komuniste e ndodhur në zonën e nxehtë të

¹Challenges to New Democracies, Edited by Slobodan G. Markovich, Eric Beckett Weaver and VukasinPavlovic, Belgrade, 2004, f. 208.

²Crises in the Balkans, Edited by Constantine P. Danopoulos, Westview Pres, Colorado, SHBA, f.20.

³Daniel N. Nelson, Balkan Imbroglio, Politics and Security in Southeastern Europe, Westview Press, Boulder, OO, 1991, f. 17.

përplasjes së madhe, Bashkimi Sovjetik- SHBA dhe Evropë, kaloi nëpër dhëmbët e makromekanizmave të mëdha politike dhe si e tillë ajo me mjeshtëri përfitoi në periudha të caktuara me gjithë rrezikun që barti me vete.

Historik i shkurtër i marrëdhënieve Britani e Madhe- Jugosllavi

Menjëherë pas pushtimit të Mbretërisë së Jugosllavisë, në prill 1941, mbreti Petri II, do të formojë qeverinë në ekzil, në Londër.⁴ Drazha Mihajloviqi u bë ministër i Luftës me ndihmën e britanikëve. Mihajloviqi do të ekzekutohet nga regjimi i Titos në vitin 1946.⁵ Brenda territorit të Jugosllavisë vepronin njësitet partizane të Titos, e cila krijoi konfuzitet të politikave britanike, me që Tito ishte një lider i ri dhe i panjohur me orientim komunist prosovjetik, ndërsa më parë të dy mbretëritë kishin pasur raporte korrekte. Gjatë Konferencës së Teheranit, në nëntor 1943, kryeministri britanik Winston Churchill, e pranoi Titon si udhëheqës të vetëm të luftës në Jugosllavi dhe filloi të ndërpret ndihmën ndaj Drazha Mihajloviqit.⁶ Bashkëpunimi i ngushtë në mes Titos dhe anglo-amerikanëve vazhdoi deri në përfundim të Luftës së Dytë Botërore, përderisa Tito i përforcoi lidhjet me Stalinin dhe në Jugosllavi vendosi sistemin politik komunist sipas modelit sovjetik. Ky veprim e largoi Jugosllavinë nga raporti i ngushtë me britanikët dhe amerikanët. Tani

⁴John R. Lampe, *Yugoslavia as History*, Cambridge University Press, 1999, f. 223.

⁵Sabrina P. Ramet, *Balkan Babel*, Westview Press, Boulder, Colorado, SHBA, 2002, f. 37.

⁶John R. Lampe, *vep. e cit.*, f. 215.

kaluan në fusha të hapura konflikti dhe shkuan deri aty saqë gjatë luftës civile në Greqi dy aeroplanë ushtarakë amerikanë, gjatë vitit 1946, u rrëzuan mbi Jugosllavi dhe trupat britanike në Greqi ishin sulmuar nga rebelët të përkrahur nga Tito.⁷ Po ashtu, porti i Triestes u bë mollë sherri mes Titos dhe aleatëve perëndimorë që pretendonin ta kishin nën kontroll.

Stalini me që kishte vështirësi që ta kontrollonte Titon, në vitin 1948, e largoi nga Kominterni, më shumë ndoshta për t'i bërë presion që ai të disiplinohej dhe të ndiqte linjën politike sovjetike ashtu siç vepronin liderët komunistë të Evropës Lindore, por kjo metodë si duket nuk rezultoi produktive, ngaqë Tito u kthye menjëherë nga perëndimi dhe kërkesës për ndihmë, e ata iu përgjigjën menjëherë.⁸ Në vitin 1951, në Britani të Madhe do të rikthehej në pushtet Winston Churchill, miku i vjetër i Titos. Ishin ditët e para të Luftës së Ftohtë dhe akoma vijat e frontit mbaheshin të gjalla, prandaj Jugosllavia ishte mjaft e rëndësishme për Britaninë e Madhe për shkak të pozitës gjeostrategjike të saj, nga dalja në detin Adriatik. Gjithashtu, ajo ishte një mur që ndalonte shtrirjen e sovjetikëve drejt ujërave të nxehta.

Ftesën për të vizituar Mbretërinë e Bashkuar e kishte sjell sekretari i Jashtëm, Anthony Eden, në shtator 1952.⁹ Një pjesë e mirë e zyrtarëve dhe popullatës kundërshtonin hapur vizitën e një lideri komunist, i cili ishte një diktator dhe shkelte të drejtat elementare të njeriut. Më i zëshmi që mbështeste këtë vizitë kontroverse edhe

⁷Po aty, f. 237.

⁸Julie A. Mertus, *Kosovo How Myths and Truths Stared a War*, University of California Press, 1999, f. 288.

⁹Arkivat britanike, FO, 371/102179; PREM 11/577.

historike ishte kryeministri britanik, Churchill, i cili insistonte se do të ishte vizitë zyrtare dhe joshetërore. Në vitin 1953, ende pa u bërë inaugurimi i Elisabetës II në fronin mbretëror britanik, ishte organizuar vizita e Titos në Londër. Nga pritja që iu bë Titos në kryeqendrën britanike dhe vetë prezenca e gruas së tij në Pallatin Mbretëror të Buckingham, më shumë i ngjante një vizite shtetërore sesa zyrtare. Me këtë vizitë të parë, Tito e nxori Jugosllavinë nga izolimi dhe hapi dyert drejt Perëndimit, duke siguruar edhe përkrahjen e Churchill në rast të ndonjë sulmi sovjetik mbi Jugosllavinë do të intervenonte Perëndimi (Britania e Madhe, SHBA dhe Franca) në krah të Jugosllavisë. Kjo ishte fitore e madhe e Titos nga takimi bilateral që kishte me Churchill, më 17 mars 1953, në selinë qeveritare britanike.¹⁰

Ndjekja e trazirave në Kosovë nga diplomacia britanike gjatë vitit 1981

Ambasada Britanike në Beograd do të jetë mjaft aktive gjatë trazirave në Kosovë në vitin 1981. Kryesisht ambasada do të mbledh informacione nga burimet e saja, do t'i përpunojë dhe do t'i përcjell në Ministrin e Jashtme të Mbretërisë së Bashkuar në formë të përshkrimit të ngjarjeve, do të hartojë analiza që janë bërë nga zyrtarët e Ambasadës si dhe nga vetë ambasadori, Bolland. Gjatë periudhës prill-dhjetor 1981, do të hasim edhe në shumë materiale që

¹⁰ Më detajisht shiko në: FO 371/102179 Eden note to Churchill, 14 July 1952; PREM 11/578 FO report to Churchill, March 1953; PREM 11/578 Wellington letter to Colville, 17 Feb 1953; FO 371/102184 Eden minute, Belgrade telegram to FO, 1 December 1952; PREM 11/577 Report on meeting at 10 Downing Street, 17 March 1953.

janë përpiluar në Qeverinë britanike, si analiza, konkluzione të ndryshme që e mbajnë shenjën “sekret” e “të besueshme”, por ka raste kur dokumenti në fjalë është përcjellë edhe te Ambasada britanike në Uashington, që më pas të përcillet te administrata amerikane si dhe te delegacioni britanik në NATO, në Bruksel.¹¹

Këto marrëdhënie ndërshtetërore do të zhvillohen me korrektësi deri kah mesi i viteve të ‘80-ta, kur do të krijohen rrethana të reja në rrafshin politik global, respektivisht kriza e thellë financiare në bllokun sovjetik dhe humbja e garës në armatim, si rrjedhojë edhe ulja e ndikimit politik të sovjetikëve në rajon dhe në botë. Mbretëria e Bashkuar tani përveç që do të përcjellë ndryshimet politike, po ashtu do të jetë mjaft aktive në procesin e shembjes së komunizmit në Evropën Lindore dhe Juglindore. Jugosllavia do të ishte një zonë interesi e saj dhe nga marrëdhëniet e mira që deri tani i kishte pasur, dhe joshja që i ishte bërë Jugosllavisë vetëm që t’i bënte ballë Bashkimit Sovjetik, kishte reflektuar në indiferencën e saj për t’i bërë presion Beogradit për shkak të shkeljes flagrante të të drejtave individuale të njeriut në Kosovë si dhe të të drejtave kolektive si bashkësi etnike, por edhe si njësi e veçantë federative në kuadër të shtetit të përbashkët, që tani në fakt asaj i ishin suprimuar. Mirëpo, ashtu siç shfaqeshin një nga një trazirat antikomuniste në Evropën Lindore, britanikët në forma të ndryshme asistuan popujt e kësaj zone në procesin e reformave në drejtim të demokratizmit të plotë dhe largimit përfundimtar nga ndikimi sovjetik.

¹¹ FCO28/4645, Telegrami nr. 041, të protokolluar, më 13 prill 1981, me shifrën ENU 015/3.

Debatet për Kosovën në Parlamentin britanik

Në Dhomën e Përfaqësuesve (Parlament) të Britanisë së Madhe, kishte mjaft interes për atë që ndodhte në Evropën Lindore dhe në Jugosllavi në përgjithësi. Duke e marrë parasysh se nga viti 1989 dhe më tej, shënoheshin ndryshimet më të mëdha në botë që nga Lufta e Dytë Botërore, duke u riformësuar jo vetëm sistemet politike në shumë vende të botës, por njëkohësisht edhe ndryshimi i sferave të interesit, me që shumë shtete lëviznin nga një ekstrem në tjetrin, ku interesi i Britanisë ishte gjithkund prezent dhe vështirë të ishte prezent politika e saj në çdo cep të botës në të njëjtën kohë, por ajo nuk u shkëput nga Ballkani.

Përfaqësuesi i sekretarit shtetëror për Çështje të Jashtme dhe të Komonuelth, z. Waldegrave, para deputetëve, më 2 shkurt 1990, deklaroi: “Ne kemi thënë që ne do të zgjerojmë fondin për vendet e tjera të Evropës Lindore, pasi ato të jenë plotësisht të përkushtuara për t’u reformuar. Ndërkohë, ne gjithashtu do të mbështesim reformat përmes një programi të zgjeruar të kontakteve, vizitave, seminareve dhe skemave të ministrave. Ne do të vazhdojmë të luajmë një rol të madh në përpjekjet ndërkombëtare për të mbështetur procesin e reformës”.¹²

Në të njëjtën seancë parlamentare, deputeti z. Bowis, do të pyet sekretarin e Shtetit për Çështje të Jashtme të Komonuelth dhe se çfarë paraqitjesh i ka bërë Qeverisë së Jugosllavisë për të drejtat e njeriut në Kosovë. Ndërsa, z. Waldegrave deklaroi: “Ne shpesh kemi ngritur çështje të të drejtave të njeriut me autoritetet jugosllave. Shoku im

¹²<https://publications.parliament.uk/pa/cm198990/cmhansrd/1990-02-07/Writtens-6.html>

sekretari i Shtetit për Punë të Jashtme dhe Komonuelth diskutoi çështjen e Kosovës me ambasadorin jugosllav, z. Rikonoviq, më 22 nëntor.”¹³

Lordi Fanshawe nga Riçmondi do të bëjë një analizë të gjatë të ngjarjeve në Evropën Lindore, nga rënia e Perdes së Hekurt deri te rënia e Murit të Berlinit dhe ndryshimet në sistemin politik që ndodhin në të njëjtën kohë. Ai thekson faktin se në Jugosllavi nuk lindin parti demokratike siç është rasti me Gjermaninë Lindore, të cilat lidhen me CDU apo SDP e pjesës perëndimore, por atje lindin parti nacionaliste. Ai do të theksojë: “Sidoqoftë, kur njeriu shikon më thellë në këtë çështje, shpejt zbulon se ai sistem mund të mos përhapet në pjesën tjetër të Evropës Lindore. Ekziston një tendencë në vendet sllave që të mos zgjedhin një sistem politik si partitë perëndimore. Për shembull, në Jugosllavi, për aq kohë sa kishte një udhëheqje të fortë dhe vigjilente, siç ekzistonte për shumë vite nën presidentin Tito një konglomerat i jashtëzakonshëm i kombeve të mbajtura së bashku shumë fort. Por, kur Tito shkoi, vendi priret të ndahet. Partitë e reja në shtetet sllave kanë tendencë të mos ndjekin stilin perëndimor, bëhen parti nacionaliste. Dikush gjen nacionalizmin që po shfaqet te tmerret e sulmeve nacionaliste, siç ndodhi në mënyrë dramatike në Bashkimin Sovjetik Jugor që përfshiu Azerbajxhanin dhe Armeninë vetëm disa javë më parë”.¹⁴

¹³<https://publications.parliament.uk/pa/cm198990/cmhansrd/1990-02-07/Writtens-6.html>

¹⁴<https://api.parliament.uk/historic-hansard/lords/1990/mar/21/eastern-europe-and-the-soviet-union>

HL Deb 21 March 1990 vol 517 cc314-83314

Lordi Beloff do të theksojë: “... Është e vërtetë që ata kanë hequr qafe shtypësin e tyre, por nuk është e qartë se ka pasur një zhdukje totale të Partisë Komuniste... Prandaj, unë besoj se ne kemi akoma mundësi të shohim një trazirë shumë më të madhe përpara se të kemi një pamje të Evropës së re drejt së cilës ne mund të kornizojmë politikën... Kështu, mbetet ende shumë për t’u shqetësuar në të ardhmen”.¹⁵

Lord Hankey do të deklarojë: “Lord Eccles, bëri një pikë jashtëzakonisht të mirë për rëndësinë e mbajtjes së interesit amerikan. Ne nuk duhet të harrojmë se Lidhja e Kombeve dështoi sepse ishte shumë e kufizuar dhe sepse amerikanët nuk ishin në të.

Ju ofroj një paralajmërim serioz, pasi kam punuar me këto vende për vite me radhë. Ata kanë tendencë të urrejnë njëri-tjetrin. Trajtimi i turpshëm i pakicës hungareze në Rumani që nxiti revolucionin rumun është tipik. Çrregullimet në Kosovë me pakicën shqiptare nuk janë shumë më të mira. Ne duhet të kujtojmë se Lufta e Parë Botërore u ndez nga vrasja e një arkiduke austriak nga Serbia dhe se Lufta e Dytë Botërore filloi në Danzig, tani në Gdansk”.¹⁶

Ndryshimet e mëdhanë sistemin politik në ish-Blllokun Komunist, shihet qartë se reflektojnë një shqetësim të politika britanike dhe ata synojnë qetëngrejnjë alarmin me kohëpërtë marrë masa mbrojtëse para se të bëhet vonë dhe të shpërthej ndonjë konflikt me përmasa të mëdha.

¹⁵<https://api.parliament.uk/historic-hansard/lords/1990/mar/21/eastern-europe-and-the-soviet-union>

HL Deb 21 March 1990 vol 517 cc314-83314

¹⁶<https://api.parliament.uk/historic-hansard/lords/1990/mar/21/eastern-europe-and-the-soviet-union>

HL Deb 21 March 1990 vol 517 cc314-83314

Fillimi i krizës në Jugosllavi, më 1991

Më 27 qershor 1991, debatohet gjatë për situatën në Jugosllavi, për shpalljen e pavarësisë nga Sllovenia dhe Kroacia, turbulencat politike dhe ushtarake që janë në zhvillim, duke shprehur qëndrime të ndryshme për organizimin e ri të Jugosllavisë, ku një pjesë e deputetëve mendonin se duhet të ruhet tërësia territoriale, përderisa të tjerët mendonin se duhet të respektohet qëndrimi i popujve të Jugosllavisë. Kështu, z. David Howell nga Guildford, do të shprehet: “(...) megjithëse copëzimi i Jugosllavisë mund të ketë rreziqet e saj, ne duhet të jemi të kujdesshëm në lidhje me llojin e unitetit që mbrojmë? Uniteti që kërkohet ka një anë brutale dhe reaksionare ndaj tij... që ne ndoshta duhet ta analizojmë me kujdes dhe të kuptojmë se Sllovenia dhe Kroacia meritojnë ca simpati në dëshirën e tyre për të shpëtuar nga ai dominim? ...Ky është theksi i duhur, në vend se thjesht të mbështesni në mënyrë të fshehtë përpjekjet e tanishme për të imponuar unitet ndaj popullit kroat dhe slloven”.¹⁷

Zoti Lennox-Boyd gjatë debatit të tij, do të theksojë: “Ne dhe partnerët tanë perëndimorë, kemi një preferencë të qartë për vazhdimin e një entiteti të vetëm politik jugosllav - ato fjalë janë zgjedhur me kujdes dhe janë të mundura të zhvillohen dhe interpretohen më tej. Mund të konfirmoj se ne jemi të shqetësuar për abuzime të vazhdueshme të të drejtave të njeriut në disa pjesë të Jugosllavisë, veçanërisht në provincën shqiptare të Kosovës”.¹⁸

¹⁷<https://api.parliament.uk/historic-hansard/commons/1991/jun/27/yugoslavia>
HC Deb 27 June 1991 vol 193 cc1137-4011373.31 pm§Mr. Peter Fry (Wellingborough)

¹⁸<https://api.parliament.uk/historic-hansard/commons/1991/jun/27/yugoslavia>

Zoti GeraldKaufman, në lidhje me dezintegrimin e Jugosllavisë do të shprehet: “...nuk ka asgjë për të fituar për Evropën, për sigurinë evropiane ose për popujt e ndryshëm të Jugosllavisë nga shpërbërja e këtij vendi ose nga paqëndrueshmëria që do të rridhte nga Ballkani në pjesën tjetër të Evropës. S’është e lehtë të krijosh një analogji midis shteteve baltike, të cilat u aneksuan kundër vullnetit të tyre nga Bashkimi Sovjetik, dhe republikat përbërëse të Jugosllavisë, të cilat u bashkuan vullnetarisht. Nëse do të ketë ndonjë ndryshim në strukturën e Jugosllavisë, ajo duhet të bëhet me marrëveshje tëlirë të pjesëve përbërëse të Jugosllavisë nën kornizën e saj federale”.¹⁹

Nga këto debate vërejmë se ligjvënësit britanikë në një mënyrë e favorizojnë shpërbërjen jugosllave.

Z. Douglas do të pyet sekretarin e Shtetit për Çështjet e Jashtme dhe të Komonuelthit, se çfarë planesh ka ai për të njohur shtetet e dala si pasojë e zhvillimeve në Unionin e Shteteve Sovrane të Bashkimit Sovjetik dhe Jugosllavisë. Zoti Hurd do të përgjigjet: “Më 16 dhjetor ne dhe partnerët tanë të Komunitetit vendosëm udhëzime për të informuar vendimet tona për njohjen e shteteve të reja në Evropën Lindore dhe Bashkimin Sovjetik. Ne ende nuk kemi marrë vendime për njohjen e republikave të Bashkimit Sovjetik - përveç shteteve baltike - pasi ata (F. I. njësit tjera federale) ende po diskutojnë mes tyre për marrëdhëniet e ardhshme. Ministrat e jashtëm ranë dakord të njohin republikat jugosllave që të plotësojnë disa kushte. Komisioni i arbitrazhit i Konferencës për Jugosllavinë, i kryesuar nga Lordi Carrington, do të këshillojë nëse republikat i plotësojnë ato kushte.

HC Deb 27 June 1991 vol 193 cc1137-4011373.31 pm

¹⁹<https://api.parliament.uk/historic-hansard/commons/1991/jun/27/yugoslavia>

HC Deb 27 June 1991 vol 193 cc1137-4011373.31 pm

Një vendim përfundimtar për zbatim do të merret më 15 janar, pas këshillës nga komisioni i arbitrazhit”.²⁰

Z. Galloway do të pyet sekretarin e Shtetit për Çështjet e Jashtme dhe të Komonuelthit se cilat janë qëndrime e fundit që i ka bërë Qeverisë së Jugosllavisë mbi situatën e popullatës shqiptare në atë vend.²¹

Z. DouglasHogg shprehet: “Ne e dënojmë me forcë abuzimin serb të të drejtave të njeriut në Kosovë. Është e qartë se çdo zgjidhje e qëndrueshme për Jugosllavinë duhet të përfshijë garanci për komunitetet pakicë siç janë shqiptarët e Kosovës”.²²

Z. Galloway më tej vazhdon: “Shqiptarët në Jugosllavi nuk janë një popullsi pakicë, por grupi i tretë më i madh kombëtar në vend; ka më shumë se 3 milionë prej tyre, por të drejtat e tyre kombëtare janë shfuqizuar prej kohësh nga Qeveria jugosllave. Ministri duhet ta dijë që nëse Kroacia dhe Sllovenia lejohen të njihen ndërkombëtarisht muajin tjetër, popullsia shqiptare - dhe vetë Shqipëria, vetëm përtej kufirit - nuk do të qëndrojnë të qetë, përderisa sundimi brutal i terrorit të Kosovës të imponuar nga autoritetet serbe vazhdon. Më shumë se 600 000 njerëz kanë kaluar nëpër duar të ashpra të autoriteteve serbe. Janë arrestuar dhe marrë në pyetje që nga koha kur Parlamenti u shfuqizua. Rreth 90 000 janë pushuar nga puna e tyre për arsye politike dhe mijëra janë burgosur me dënime të gjata ose rezultojnë se janë vrarë apo mungojnë. Çfarë mund të bëjë Qeveria britanike, si në mënyrë bilaterale, ashtu edhe në komunitetin evropian, për të siguruar

²⁰<https://api.parliament.uk/historic-hansard/commons/1991/dec/18/yugoslavia>
HC Deb 18 December 1991 vol 201 cc260-3260

²¹Po aty.

²²<https://api.parliament.uk/historic-hansard/commons/1991/dec/18/yugoslavia>
HC Deb 18 December 1991 vol 201 cc260-3260

që të drejtat kombëtare të shqiptarëve dhe të kombeve të tjera në Jugosllavi të merren plotësisht në konsideratë në tërë rrëmujën e përgjakshme”?²³

Z. Hogg vazhdon: “Mbrotjtja e të drejtave kombëtare dhe minoritare është një nga çështjet më të rëndësishme që duhet të adresohen në përpjekjen për një zgjidhje të përgjithshme. Shqiptarët janë me shumicë të madhe në Kosovë - mbi 90 për qind të popullsisë totale. Ekziston gjithashtu një pakicë e konsiderueshme e shqiptarëve në Maqedoni. Zotërinjtë do ta dinë, se projekt traktati që miku im fisnik, Lordi Carrington, ka përgatitur, identifikon një sërë masash mbrojtëse të cilat duhet t’u ofrohen pakicave etnike në Jugosllavi. Qeveria serbe duhet të pranojë që saktësisht të drejtat dhe privilegjet që kërkojnë t’i sigurojnë për serbët në Kroaci, duhet t’i sigurojnë edhe shqiptarët në Kosovë”.²⁴

Më 8 maj 1992, gjatë debatit në Parlament, deputeti Russell Johnston (Inverness, Nairn and Lochaber) bëri dy pyetje për sekretarin e Jashtëm. Së pari, a ka ai kontakt direkt me serbët? Nëse po, a u ka thënë ai atyre ndonjë çështje në lidhje me problemet e veçanta të Kosovës, që padyshim është shembulli i theksuar i shtypjes serbe? Së dyti, siç përmendi ai duke biseduar me presidentin e Maqedonisë një ditë tjetër, a ka ndonjë zbutje të opozitës greke?

Z. Hurd u përgjigj: “Në pikën e parë, ne sigurisht që jemi në kontakt me serbët përmes ambasadorit tonë në Beograd. Ata e dinë qëndrimin tonë të fortë se ata duhet të sigurojnë të drejtat e pakicave

²³<https://api.parliament.uk/historic-hansard/commons/1991/dec/18/yugoslavia>
HC Deb 18 December 1991 vol 201 cc260-3260

²⁴<https://api.parliament.uk/historic-hansard/commons/1991/dec/18/yugoslavia>
HC Deb 18 December 1991 vol 201 cc260-3260

në Kosovë, përgjatë vijave të përcaktuara në planin e paqes të Lord Carrington. Ndërsa, për Maqedoninë jo. Ka një bllokim. Maqedonasit propozojnë ta quajnë veten maqedonas. Grekët besojnë, siç kryeministri grek na shpjegoi me pasion fundjavën e kaluar, se kjo nënkupton një kërcënim për Greqinë. Ekziston një bllokim i çështjes, e cila bën dëm, prandaj presidenca po përpiqet ta zhblllokojë”.²⁵

Më 1 korrik 1992, z. Waterson do ta pyet sekretarin e Shtetit për Çështjet e Jashtme dhe të Komonuelthit se çfarë planesh ka Qeveria e Madhërisë së Saj për të njohur Republikën e Kosovës. Zoti Hurd u shpreh se nuk kemi plan të njohim Republikën e Kosovës.

Zoti Waterson përsëri pyet duke dhënë informacione rreth shtypjes serbe në Kosovë: “A e di të vërtetën që 90 për qind e popullatës etnike shqiptare në Kosovë është shtypur rregullisht dhe mizorisht nga ushtria dhe policia serbe, dhe ajo në një sondazh të kohëve të fundit - me pjesëmarrje prej afro 80 për qind, që është e besueshme nga standardet tona demokratike, 99 për qind e popullsisë votuan për autonomi”?²⁶ Më pas, zoti Hurd tha: “...se kjo me siguri duhet të jetë përgjigjja e duhur. Jam dakord me mikun tim. Siç thotë ai, Kosova është kryesisht e banuar nga njerëz me origjinë shqiptare, por ajo gjithashtu konsiderohet nga serbët si zemra e vendit të tyre. Disa muaj më parë, Konferenca e Paqes e Lord Carrington sugjeroi të njëjtën përgjigje si miku i nderuar, autonomi e plotë”.²⁷

²⁵<https://publications.parliament.uk/pa/cm199293/cmhansrd/1992-05-08/Debate-1.html>

²⁶<https://api.parliament.uk/historic-hansard/commons/1992/jul/01/kosova>
HC Deb 01 July 1992 vol 210 cc841-2841

²⁷<https://api.parliament.uk/historic-hansard/commons/1992/jul/01/kosova>
HC Deb 01 July 1992 vol 210 cc841-2841

Gjendja e rënduar në Kosovë gjatë vitit 1992 dhe debati në Parlamentin britanik

Debatet për çështjen e Kosovës ishin të shumta nëtë dy Dhomat e Parlamentit britanik. Vetëm disa pjesëjanë shkëput përtëparë interesin e politikave britanike ndaj çështjes shqiptare. Kështunënjë nga seancat e rregullta, z. Waterson pyet sekretarin e Shtetit për Çështje të Jashtme dhe të Komonuelthit, nëse ai do të bëjë një paraqitje për qëndrimin e Qeverisë ndaj Kosovës.

Ministri i Shtetit, Zyra e Jashtme dhe Komonuelthi (z. Douglas Hogg) tha: “Grupi special për Kosovën në kuadër të Konferencës ndërkombëtare për ish-Jugosllavinë po punon intensivisht me përfaqësuesit serbë dhe kosovarë. Ne mbështesim fuqimisht përpjekjet e saj. Ne besojmë se autoritetet serbe duhet t’u japin autonomisë kosovare të drejta të plota civile, dhe se kosovarët duhet ta pranojnë atë”.²⁸

Zoti Waterson vazhdon me komentin dhe pyetjen: “...Miku im të pranojë që Kosova mund të jetë viktima e radhës e ekspansionizmit serb? Cilat masa të tjera ai mendon se mund të merren, si çështje urgjente, për të zvogëluar tensionin në këtë zonë dhe për të mbrojtur 90 për qind të shqiptarëve etnikë në Kosovë, të cilët po shtypen dhe u mohohen liritë e tyre civile”?²⁹

Zoti Hogg u përgjigj: “Miku i nderuar ka vënë një theks të rëndësishëm. Çështja e kosovarëve u adresua drejtpërdrejt nga Konferenca në Londër, dhe tani po diskutohet nga grupi i punës në Gjenevë. Ajo gjithashtu ka qenë subjekt i bisedimeve në vetë

²⁸<https://api.parliament.uk/historic-hansard/commons/1992/nov/25/kosovo>

²⁹*Po aty.*

Kosovën. I nderuari mik mund ta dijë, tani ekziston një ekip i Konferencës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë në Kosovë, funksioni kryesor i të cilit është të përpiqet të zbeh tensionin. Ne do të shqyrtojmë mundësi të tjera në përpjekjet tona për të zvogëluar rrezikun e shpërthimit të dhunës”.³⁰

Zoti Wareing pyet: “A do të japë ministri një garanci, në emër të Qeverisë së Madhërishe të Saj, se pa asnjë llogari do të lejojë Qeveria eksportimin e armëve dhe pajisjeve ushtarake në Shqipëri, pajisje që mund të përdoren për të prodhuar zjarr në Kosovë, duke i dhënë kështu mbështetje ekstreme nacionalistëve në të dy anët e ndara në atë krahinë të trazuar?” Ndërsa, Zoti Hogg do të përgjigjet: “Do të shqetësoheshim shumë nëse do të shihnim ndonjë provë që Qeveria shqiptare po kërkonte në çfarëdo mënyre për të nxitur probleme në Kosovë. Ky do të ishte një zhvillim shumë serioz”.³¹

Zoti Cormack pyet: “Miku im e pranon që mënyra se si trajtohet shumica dërmuese e popullsisë në Kosovë është krejtësisht e pafalshme dhe e papranueshme? A e pranon më tej që shumë prej nesh mendojnë se, nëse Perëndimi do të kishte ndërmarrë një veprim më të fortë dhe më të bashkuar vitin e kaluar, tragjedia e Bosnjës mund të ishte parandaluar? Tani ne përballemi me tragjedi të mundshme jo vetëm në Kosovë, por edhe në Maqedoni... ?”³²

Z. Hogg përgjigjet: “Veprimi shtypës nga forcat serbe në Kosovë do të ishte vërtet një përshkallëzim serioz i asaj që është tashmë një situatë shumë e rëndë - jo vetëm për shkak të rrezikut që një veprim i tillë mund të paraqiste për shtetet fqinje. Ky fakt sigurisht që do të

³⁰*Po aty.*

³¹*Po aty.*

³²*Po aty.*

ishte në mendjen e anëtarëve të Këshillit të Sigurimit, nëse ata do të përcaktonin se cila mund të jetë përgjigja e duhur për një shpërthim dhune në Kosovë”.³³

Zoti Russell Johnston shprehet: “Në fund të përgjigjes së tij në pyetjen kryesore, ministri tha se njerëzit në Kosovë duhet të pranojnë sundimin serb, duke pasur parasysh disa kushte për të drejtat e njeriut. Kjo, me siguri, është një pozicion i papërcaktueshëm. Nëse 90 për qind e popullsisë në një zonë të caktuar dëshirojnë të pohojnë vetëvendosje, kjo është e drejta e tyre, dhe kjo është ajo që ne kemi nënshkruar në Kombet e Bashkuara. A do ta ndryshojë ministri mendimin e tij?”³⁴

Zoti Hogg do të përgjigjet: “Kjo nuk është ajo që kemi nënshkruar në Kombet e Bashkuara; as nuk është një përmbledhje e saktë e asaj për të cilën jemi regjistruar në CSCE. Ekziston një problem serioz: nëse dikush është i përgatitur apo jo për të zhvendosur kufijtë që tashmë janë pajtuar dhe që kanë ekzistuar për një kohë shumë të gjatë. Nëse do të fillonim atë politikë, do të krijonim shumë vështirësi më të mëdha në Evropën Qendrore dhe Lindore në përgjithësi. Ne besojmë se mënyra e duhur për të adresuar pozicionin e kosovarëve është përmes autonomisë. Kjo është ajo për të cilën po punojmë”.³⁵

Zonja Olga Maitland konsideron se mënyra e vetme për të garantuar paqen e vërtetë për popullin e Kosovës është të sigurohet që ka zgjedhje vërtet të lira dhe të ndershme në Beograd më 20 dhjetor? Në atë mënyrë, z. Millosheviq mund të ndërpritej në përpjekjet e tij

³³*Po aty.*

³⁴*Po aty.*

³⁵<https://api.parliament.uk/historic-hansard/commons/1992/jul/01/kosova>
HC Deb 01 July 1992 vol 210 cc841-2841

për të vazhduar me shtypjen e tij (...) pra, konsideroni t'i jepni mbështetje me gjithë zemër z. Panic".³⁶

Zoti Hogg do të përgjigjet se pajtohet që është e rëndësishme që të ketë zgjedhje të ndershme dhe të lira, më 20 dhjetor në Serbi, por nuk duhet të supozohet se zgjedhjet përkatëse nuk do të fitoheshin nga z. Millosheviq. Ai ndoshta mund t'i fitojë ato, u shpreh z. Hogg.

Zoti George Robertson do të kthej debatin te shitja e armatimit nga Britania e Madhe në Shqipëri, të cilat sipas tij, mund të përdoren në Kosovë, si dhe duke cituar ambasadorin britanik në Shqipëri se situata në Kosovë ishte jashtëzakonisht e rrezikshme. Gjithashtu, pyeti se çfarë mund të thoni për të siguruar Parlamentin që Kosova nuk do të jetë Bosnja tjetër.³⁷

Z. Hogg do të deklarojë: "Unë e kam bërë të qartë, në përgjigje të një laramanie pyetjesh, se i kushtojmë shumë rëndësi përpjekjes për të shuar tensionin në Kosovë. Nëse do të kishte një shpërthim dhune, ajo mund të përfshijë një numër shtetesh fqinje. Kjo është arsyeja pse ne vendosëm një përparësi kaq të lartë në këtë temë në Konferencën në Londër, pse jemi kaq të vendosur pas bisedimeve që po ndodhin në Gjenevë dhe pse mirëpresim vendosjen e ekipit CSCE në Kosovë. Ne me siguri do të kërkojmë të eksplorojmë mënyra të tjera për të zvogëluar rrezikun e shpërthimit të dhunës në Kosovë".³⁸

Nënjëseancëtjetër, më 10 dhjetor 1992, Lordi Renfrew nga Kaimsthorn, e pyeti Qeverinë nëse ata do të konsiderojnë përkrahjen e pretendimeve të mazhorancës për pavarësinë e Kosovës, pas

³⁶*Po aty.*

³⁷*Po aty.*

³⁸<https://api.parliament.uk/historic-hansard/commons/1992/nov/25/kosovo>
HC Deb 25 November 1992 vol 214 cc851-3851

mundësisë sëfortë që forcat serbe mund të fillojnë një politikë të “spastrimit etnik”.³⁹ Përderisa ministri i Shtetit, nga Zyra e Komonuelthit (Baronesha Chalker) do të përgjigjet: “Lordët e mi, ne mbështesim plotësisht përpjekjet e grupit special për Kosovën të vendosur në Konferencën ndërkombëtare mbi ish-Jugosllavinë për të ndërmjetësuar një zgjidhje politike në Kosovë bazuar në një autonomi të mirëfilltë”.⁴⁰

Lordi Finsberg do të pyes: “Lordët e mi, a pajtohet miku im fisnik që ajo e cila ka ndodhur deri më tani në Kosovë me fillimin e pastrimit dhe çfarë ka ndodhur në pjesën tjetër të ish-Jugosllavisë, tregon se sa e trishtuar është që CSCE ka qenë krejtësisht e pafuqishme? A beson ajo se bota do të jetë në gjendje t’i dëbojë serbët jashtë territorit që ata e kanë marrë në mënyrë të paligjshme dhe kaq brutale”? Përderisa, Baronesha Chalker do të përgjigjet: “Lordët e mi, miku im fisnik është paksa shumë kritik ndaj CSCE. Në Kosovë ajo ka krijuar një prani të monitorimit afatgjatë të banorëve me qëllim të promovimit të një dialogu midis autoriteteve në fjalë dhe përfaqësuesve të popullatës lokale. Ai gjithashtu do të mbledhë informacione mbi shkeljet e të drejtave të njeriut dhe do të promovojë zgjidhje. Sidoqoftë, unë e kuptoj zhgënjimin e ndjerë nga shumë anëtarë. Ne duhet të punojmë me shumë kujdes me çdo aspekt të mundshëm të Konferencës së Londrës për të parandaluar përhapjen e konfliktit”.⁴¹

³⁹<https://hansard.parliament.uk/Lords/1992-12-10/debates/fl7c1ec0-6c17-4f62-8dda-664bcb7e9069/Kosovo>

⁴⁰*Po aty.*

⁴¹*Po aty.*

Earl Jellicoe do të pyet: “Lordët e mi, pasi kam vizituar dy herë muajt e fundit Shqipërinë dhe diskutova për këto çështje me ministrat shqiptarë dhe presidentin e aftë të vendit, mund të shpreh frikën time shumë të vërtetë që situata aktuale në Kosovë përmban brenda saj farat jo vetëm të një lufte tjetër civile, mbase të menjëhershme, por edhe të një tjetër përplasje të madhe të Ballkanit që mund të përhapet edhe jashtë Ballkanit? Nisur nga këto rrethana, a mundet që shoku im fisnik të thotë së pari se çfarë përparimi është bërë në vendosjen e vëzhguesve të komunitetit evropian rreth kufijve të Kosovës, përfshirë kufirin shqiptar? Së dyti, duke pasur parasysh përgjigjen e saj në pyetjen e mikut tim fisnik, Lord Renfrew, cilat qëndrime i ka paraqitur Qeveria e Madhërisë së Saj së fundmi në Beograd, në lidhje me restaurimin të një autonomie të vërtetë në Kosovë, një autonomi që mori nën Titon”? Baronesha Chalker nga Wallasey do të përgjigjet: “Lordët e mi, miku im fisnik ka bërë një numër pyetjesh të ndërlikuara e të ndërlidhura. Operacionet e misionit monitorues të KE janë duke u zgjatur. Aktualisht jemi në negociata për një shtrirje në Shqipëri dhe në të vërtetë, përgjatë kufijve që përmendi ai. Është për keqardhje të madhe që kosovarët nuk po marrin pjesë në zgjedhjet që do të mbahen më vonë në këtë muaj. Mjerisht ata kanë humbur të drejtën për të kandiduar për kandidatët kosovarë. Ne e kuptojmë pse, por ata akoma mund të votonin në zgjedhjet federale. Unë besoj se Kosova duhet të ketë përfaqësim”.⁴²

⁴²<https://hansard.parliament.uk/Lords/1992-12-10/debates/f17c1ec0-6c17-4f62-8dda-664bcb7e9069/Kosovo>

Debati për Kosovëngjatë vitit 1993

Debati për Kosovën do të jetë i pandërprerë edhe gjatë vitit 1993. Kështu, më 10 shkurt 1993, zoti Russell Johnston, do të pyes se çfarë veprimesh po merren për të ulur tensionin në Kosovë dhe se sipas tij, a nuk është koha që të lëmë anash kundërshtimet anakronike të Greqisë për njohjen e Maqedonisë?

Zoti Hurd do të deklarojë: “...ka shumë diskutime që po zhvillohen në Nju Jork aktualisht për mënyrën në të cilën ai vend mund të pranohet në Kombet e Bashkuara. Ky është hapi thelbësor që të arrihet marrëveshje e shpejtë. Zotëria i nderuar ka mjaft të drejtë: Kosova është një vend i rrezikshëm. Të gjithë pranojnë se është pjesë e Serbisë dhe të gjithë duhet të pranojnë se ajo ka të drejtë në llojin e një autonomie të denjë që kishte para vitit 1988”.⁴³

Z. Zhak Arnold do ta pyes sekretarin e Shtetit për Çështjet e Jashtme dhe të Komonuelthit nëse ai do të bëjë një deklaratë mbi perspektivat e paqes në Ballkan.

Zoti Douglas Hogg do të përgjigjet: “Ne dhe partnerët tanë të KE kanë sqaruar mbështetjen tonë pa ekuivoke për punën e Konferencës ndërkombëtare për ish-Jugosllavinë. Suksesi i saj do të ishte një hap i rëndësishëm drejt sigurimit të stabilitetit në të gjithë Ballkanin. Ne po punojmë gjithashtu për të parandaluar shtrirjen e konfliktit në Kosovë ose Maqedoni dhe për të siguruar ndihmë humanitare për ata që janë të kapur në luftime”.⁴⁴

⁴³<https://api.parliament.uk/historic-hansard/commons/1993/feb/10/yugoslavia>
HC Deb 10 February 1993 vol 218 cc967-70968

⁴⁴*Po aty.*

Debati zhvillohet te Dhoma e Lordëve, më 1 prill 1993, dhe është mjaft i zgjeruar dhe shumë përmbajtjesor, duke paraqitur një retrospektivë të ngjarjeve si nga aspekti politik ashtu edhe nga ai historik. Kryesisht debati është në favor të Kosovës, duke e paraqitur si viktimë të Serbisë dhe rrezikun e zgjerimit të konfliktit nga Kroacia dhe Bosnja në Kosovë.

Lordi Reado të diskutojë gjatë për çështjen e Kosovës në aspektin kronologjik të historisë së saj dhe në atë analitik. Në mes tjerash tha: “Nëse ata do të kërkojnë të rritin presionin ndërkombëtar ndaj Serbisë për të rikthyer të drejtat dhe liritë themelore të njeriut për shumicën shqipfolëse të ish-Krahinës Autonome Jugosllave të Kosovës, e okupuar ilegalisht nga Serbia që nga viti 1990 (...). Sot ne po diskutojmë përsëri për një popull, të drejtat themelore të të cilit janë shkelur me shekuj, do të përshkruajë në detaje disa nga historitë e sundimit serb ndaj popullit shqiptar të Kosovës dhe përtej Kosovës ndër shekuj”.⁴⁵ Ndërmjet tjerash do të theksojë: “Shqiptarët janë me prejardhje nga populli i lashtë i Ilirisë që pushtuan bregdetin e Adriatikut në veri të Greqisë nga kohërat e epokës së bronzit, apo edhe më herët dhe gjithashtu në kohërat antike një vijë e gjerë e masivit malor që shtrihet mirë në atë që është tani Serbia. Ata arritën t’i rezistojnë grekëve, por jo romakëve dhe u është dashur të heqin dorë nga disa prej tokave të tyre përgjithmonë për serbët në mesjetë. Regjioni rreth Nishit, i cili dikur ishte shqiptar, tani është përgjithmonë pjesë e Serbisë dhe është popullzuar nga serbët. Pastaj erdhën turqit që më 1389, mposhtën serbët në Betejën e Kosovës. Për shkak të trimërisë së ushtrisë së tyre në atë betejë, ajo datë është e

⁴⁵<https://hansard.parliament.uk/Lords/1993-04-01/debates/033b5e7b-9e7a-4d43-8eb1-d2cdb5b46569/KosovoHumanRights>

nderuar në Serbi, unë mendoj si ne që kujtojmë trimërinë e trupave tona në Dunkirk. Pas kësaj, turqit dominuan në tërë Ballkanin Jugor për disa shekuj, deri në fillim të këtij shekulli, dhe ata ia bartën fenë e tyre, islamin, popullit shqiptar.

Unë po shtroj çështjen e popullit të Kosovës, 90 për qind prej të cilëve flasin shqip dhe janë etnikisht identikë me vetë shqiptarët e Shqipërisë, sepse pata privilegjin të kërkoja të bashkohem me një grup parlamentarësh që shkonin në atë vend për tre ditë në mesin e shkurtit të këtij viti nga Fondacioni i Kongresit për të Drejtat e Njeriut, një organizatë me qendër në Uashington, ngjashëm me grupin tonë parlamentar për të drejtat e njeriut - por mund të them me financim më të mirë”.⁴⁶ Lordi Rea do të vazhdojë fjalimin në mënyrën më të mirë të mundshme për të bindur kolegët nëpërkrahjetë Kosovës: “Krahu ndërkombëtar i kësaj organizate është Rrjeti Ndërparlamentar për të Drejtat e Njeriut, IPN, i cili ka anëtarë nga 106 vende (...). Grupi përbëhej nga shtatë anëtarë: unë nga Mbretëria e Bashkuar, dhe deputetë nga Holanda, Gjermania, Austria, Franca dhe Kanada. Që nga fundi i Luftës së Parë Botërore, Kosova ka qenë pjesë e Jugosllavisë pavarësisht faktit se atëherë ekzistonte një shans që të gjithë shqiptarët etnikë të bashkohen. Sidoqoftë, fuqitë që kanë qenë në atë kohë, që përfshinin Britaninë, pranuan kërkesat serbe - Serbia ishte larg ndikimit të fortë në atë pjesë të Ballkanit - kështu që Shqipërisë i lejohej të përfshinte vetëm 2 milionë nga 5 milionë shqiptarë që jetuan në rajon. Kosovarët kishin një kohë shumë të keqe nën serbët në vitet ndërmjet luftërave, me deportimin e

⁴⁶<https://hansard.parliament.uk/Lords/1993-04-01/debates/033b5e7b-9e7a-4d43-8eb1-d2cdb5b46569/KosovoHumanRights>

detyruar, veçanërisht për në Turqi. Nën Jugosllavinë e Titos, ata fituan një shkallë autonomie, veçanërisht pas Kushtetutës së 1974, kur u bë një rajon plotësisht autonom. Sidoqoftë, ato ishin gjithmonë pjesa e dobët e pjesës tjetër të Jugosllavisë, me të ardhurat më të ulëta dhe statistikën më të këqija shëndetësore në Federatë. Situata u përkeqësua vazhdimisht pas vdekjes së Titos, dhe më në fund pas shpërbërjes së Jugosllavisë u hoqën ingjerenat e fundit të autonomisë prej tyre, dhe Kosova u aneksua ilegalisht nga Serbia, më 1990. Parlamenti i Kosovës u pezullua, siç ishin qeveria (e cila tani ka kaluar në mërgim të brendshëm) si dhe administratën, gjyqësorin dhe presidencën. Kishte demonstrata të mëdha kundër kësaj që u rrënuan ashpër, me shumë gjakderdhje dhe humbje jete.

Një vit apo më shumë pas kësaj, zgjedhjet u mbajtën nga popullsia shqiptare që votuan pothuajse unanimit për të shpallur pavarësinë nga Serbia. Prandaj, nuk është për t'u habitur që popullata bojkotoi zgjedhjet për Kuvendin e Serbisë në fund të vitit të kaluar. Më parë, në zgjedhje alternative, nën hundët (e serbëve) por kundër vullnetit të serbëve, qeveria në mërgim u zgjodh, që pakica serbe prej 10 për qind e bojkotuan. Presidenti i Qeverisë në ekzil është dr. Ibrahim Rugova, një shkrimtar me mendje të butë dhe studiues i cili flet pesë gjuhë, dy prej të cilave janë anglisht dhe frëngjisht, kështu që ne kemi mundur të kemi biseda të dobishme me të, si dhe me anëtarët e tjerë të qeverisë së tij në mërgim.

Serbët tani do të duket se po dëmtojnë sistematikisht ekonominë e Kosovës, si dhe institucionet e saj sociale dhe arsimore. Për shembull, i gjithë arsimi në gjuhën shqipe është ndaluar. Mësuesit e shkollës dhe të universitetit që e kundërshtuan këtë, të gjithë u larguan nga puna e tyre, siç ishin pothuajse të gjithë mjekët e spitalit. Këto janë

zëvendësuar nga mjekë serbë që janë më të rinj dhe më pak të kualifikuar. Sistemi i shëndetit publik është shembur; nivelet i imunizimit ka rënë dhe na u tha që poliomieliti, i cili ishte zhdukur praktikisht tani ka filluar të rishfaqet.

Na u tregua një shembull dramatik sesi popullata shqipfolëse po përballlet me mbylljen e shkollave. Në një shtëpi të madhe private, një shkollë e mesme prej 1 300 studentësh, mësohej në tre ndërrime. Kushtet ishin vërtet themelore. Të gjithë nxënësit duhej të uleshin në dysHEME, por atmosfera ishte e vëmendshme dhe e mirë. Unë mendoj se do ta kishte bërë çdo drejtor shkolle britanike shumë krenar. Universiteti i Prishtinës është akoma duke funksionuar me 23 000 studentë, megjithëse stafi nuk po paguhet dhe ata nuk kishin qasje në ndërtesat e universitetit. Përsëri, mësimi u bë në shtëpi private.

Shumica e ndërmarrjeve publike ishin mbyllur, me largimin nga puna të rreth 100 000 punëtorëve. Për shkak se familjet janë të mëdha, kjo do të thotë se gati gjysma e popullsisë është e varfër, dhe nëse nuk do të ishte për një rrjet të gjerë të ndihmës reciproke, të ndihmuar shumë nga dërgesat nga jashtë, do të kishte uri të përhapur. Rastësisht, të gjithë kosovarët jashtë shtetit pritet të kontribuojnë të paktën 10 për qind të fitimeve të tyre dhe për t'i dërguar ata për t'i ndihmuar bashkatdhetarët e tyre në shtëpi për të mbijetuar.

Sikur të mos mjaftonte kjo, neve na u dhanë raporte me fjalë për rrahje të shpeshta dhe vdekje si rezultat i keqtrajtimit të popullatës nga ushtria serbe. Një mënyrë e zakonshme e milicisë është të kërkojë hyrje në shtëpi private me pretekstin e kërkimit të armëve. Banorët trajtohen keq duke i rrahur ashpër nëse rezistojnë. Na u tha që 700 000 njerëz, gati gjysma e popullsisë, në një mënyrë ishin marrë në pyetje nga policia (...). Para përmbledhjes, duhet të përmend se ne

takuam anëtarët e ekipit monitorues të CCSE, (Konferenca për Bashkëpunim dhe Siguri në Evropë) në Kosovë. Këta janë ish-diplomatë ose oficerë të lartë të stafit ushtarak; ata që takuam erdhën nga Kanadaja, Greqia dhe Suedia. Mendimi i tyre ishte se megjithëse kishte pohime për abuzime të të drejtave të njeriut, nuk kishte një mundësi të menjëhershme të përshkallëzimit për të shpërthyer konfliktin ngaqë të dyja palët kishin shumë për të humbur dhe ne nuk pamë asgjë që të na bëjë të mos pajtohemi me atë pikëpamje, të paktën për momentin. Ne kemi ndjerë se prania e vëzhguesve ndoshta po i bënte serbët të vepronin më me kujdes dhe se ka pak dyshime se Serbia dëshiron ta bëjë Kosovën një pjesë integrale të territorit të saj dhe të heqë qafe popullsinë rezidente shqiptare, spastrimi etnik nuk po bëhej si në atë shkallën boshnjake. Në fakt, ka qenë mjaft e vështirë të bindësh serbët që të vendosen në Kosovë; ka pasur një rrjet emigrim të serbëve nga ai territor. Politika dukej më tepër për ta bërë Kosovën kaq të pakëndshme për të jetuar, përmes masave ekonomike dhe terrorit, sa që popullsia shqiptare të emigrojë. Në fakt, rreth 300 000 tani jetojnë dhe punojnë jashtë shtetit, por shumica kanë qëllimin të kthehen kur situata të përmirësohet. Ndërkohë, dërgesat e tyre po ndihmojnë për të mbështetur popullsinë banuese.

Ndërsa, nuk ka asgjë specifike që Qeveria e Lartmadhërisë së Saj, mund të bëjë drejtpërdrejt. Unë mendoj se do të ishte shumë inkurajuese për popullin e Kosovës nëse baronesha fisnike mund të deklarojë në termat më të fortë të mundshëm që Qeveria të dënojë veprimet antikushtetuese dhe arbitrare të Serbisë në Kosovë. Ato janë jashtë kërkesave të Konventës së Gjenevës për trajtimin e popullatës civile nga një fuqi okupuese. Ndoshta unë mund të pyes baroneshën fisnike nëse, si palë e lartë nënshkruese e konventave të Gjenevës, ne

mund të padisim zyrtarisht Jugosllavinë, e cila ishte gjithashtu një palë kontraktuese, për shkeljen e Konventës (Jugosllavia sigurisht që tani përfaqësohet nga dy republikat federale të mbetura, Serbia dhe Mali i Zi).

Në shumë raste në shtëpinë tuja të lordëve, kemi diskutuar për rrethanat në të cilat rregulli i mosndërhyrjes në punët e një shteti tjetër mund të mos jetë më i përshtatshëm. Në rastin e Kosovës që mezi zbatohet pasi që kosovarët kurrë nuk e kanë pranuar që ata duhet të bëhen pjesë e Serbisë. Siç e përmenda, 87 për qind e popullsisë shqiptare votoi për pavarësi në 1991. Unë besoj se ne mbajmë njëfarë përgjegjësie historike, pasi ne ishim palë në disa traktate të cilat, besoj gabimisht, fiksuan kufijtë e Jugosllavisë pas Luftës së Parë Botërore, në mënyrë që një shumicë e shqiptarëve të jetojnë jashtë Shqipërisë.

Si përfundim, unë kërkoj nga baronesha fisnike të deklarojë në emër të Qeverisë, mendimin e tyre për sjelljen e Serbisë në këtë pjesë të ish-Jugosllavisë. A pajtohen ata që veprimet janë plotësisht në kundërshtim me tekstin dhe shpirtin e Deklaratës së Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut dhe a do t'i dënojnë ata sa më fuqishëm”?⁴⁷

Lord Selsdon në fjalimin e tij do të theksojë: “Lordët e mi, unë jam i interesuar për një filozofi që është shfaqur dhe një pyetje që duket se përgjithmonë do të më kërkohet nga unë. Pse ata që kërkuan të prishnin komunizmin në Evropën Lindore dhe Azinë e Vogël nuk menduan shumë për atë që do të vendosnin në vend të tij? Ne po

⁴⁷<https://hansard.parliament.uk/Lords/1993-04-01/debates/033b5e7b-9e7a-4d43-8eb1-d2cdb5b46569/KosovoHumanRights>

flasim për një pjesë të botës, ku është përhapur fisi i egër dhe i rrezikshëm...”.⁴⁸

Lordi Selsdon tregon se kishte vizituar Shqipërinë dhe se atje flitej për çështjen e Kosovës. Sipas tij: “Por kjo zonë (Kosova F. I.) ka qenë gjithmonë territor shqiptar. Një vështrim për qytetin e saj kryesor, Prizrenin, lordët fisnikë mund të kujtojnë AubreyHerbert dhe EdithDurham më mirë se unë. Ata shkruan se Prizreni kishte një popullsi shqiptare para më shumë se 100 vjet. Cilat janë të drejtat e njeriut, të cilave u referohemi? Çfarë ka ndodhur edhe gjatë javëve që kur isha atje? Raporti i të cilit është referuar zoti fisnik, Lord Rea, është i vërtetë, por pozicioni është edhe më i keq. Goditja ka filluar të shkallëzohet. Së pari, dikush admiron frenimin e kosovarëve që flasin shqip që janë atje, duke kryer shtypje dhe duke i lënë duart e Arkanit. Ai është i njohur për kryerjen e “krimeve të luftës”. Ai është akuzuar për mizoritë më të mëdha në lidhje me Bosnjën. Ai është vënë në krye të një qyteti që historikisht është shqiptar. Ai ka fuqi absolute. Më është thënë që ai kërkohet nga gjashtë ose shtatë forca policore evropiane për krime të ndryshme. Kjo ka të ngjarë të bëjë që një popullatë të mos ndjehet shumë e sigurt. Nëse kombinohet me atë heqjen nga jeta publike jo vetëm të anëtarëve të profesionit arsimor dhe mjekëve, por të gjithë kosovarëve që flasin shqip, mendoni që në vitet e ‘30-ta popullsisë hebraike të Gjermanisë, kur akademikët inkurajoheshin gradualisht dhe sistematikisht për të ikur. Kur kosovarët shqiptarë lëvizin për në Shkup ose Republikën Jugosllave të Maqedonisë, ato ndalen, kontrollohen dhe u merren të gjitha gjërat e çmuara të tyre. Ata nxirren jashtë pa asgjë. Unë besoj se ka më

⁴⁸<https://hansard.parliament.uk/Lords/1993-04-01/debates/033b5e7b-9e7a-4d43-8eb1-d2cdb5b46569/KosovoHumanRights>

shumë policë atje në rrugë sesa në çdo pjesë tjetër të Ballkanit. Këto janë të gjitha shenja shqetësuese nëse nuk u shfaqet atyre rezistencë. Ne po flasim për ambicet territoriale dhe potencialin për përfitim të vet interesit të Serbisë, që ata si unë, të cilët vetëm kohët e fundit kanë studiuar historinë, mund t'i kuptojnë, por nuk mund t'i respektojnë apo mbështesin. Do të bënim gjithçka që mundim për ta ndaluar vazhdimin e saj (...). Kosova mund të jetë një pikë e madhe e krismave. Shqiptarët, për të cilët kam studiuar, janë njerëz trima. Ata kanë qenë nga ushtarët më të mëdhenj gjatë historisë në atë pjesë të botës. Unë besoj se 200 nga gjeneralët kryesorë në Perandorinë Osmane ishin shqiptarë (...).⁴⁹ Ai më tej vazhdoi: “Unë e kujtoj ministrin për diçka që ndodhi pas Luftës së Parë në Ballkanike, kur një delegacion shqiptar erdhi për të parë Lord Curzon në përpjekje që të inkurajonte mbështetjen e tij për një Shqipëri të pavarur. Lord Curzon priti delegacionin në këmbë. Unë besoj që kjo do të thotë se njeriu (Lordi Curzon) nuk ka ndërmend të kalojë një kohë të gjatë me vizitorin. Kreu i delegacionit shqiptar - një njeri i arsyeshëm dhe shumë inteligjent - u pyet nga Lord Curzon: “Çfarë është me rëndësi për Shqipërinë”? Udhëheqësi i delegacionit tha: “Zoti im, Shqipëria ka sasi të mëdha nafte”. “Merrni një karrige, ju lutem”, - tha Lord Curzon (...).⁵⁰

Lordi McNair do të theksojë disa momente të rëndësishme historike në vazhdimin e luftës institucionale serbe ndaj shqiptarëve. Do të shkëpusim vetëm disa segmente që janë me interes: “Kontributi keqdashës i Çubriloviq në historinë e rajonit përfshinte një projekt të

⁴⁹https://hansard.parliament.uk/Lords/1993-04-01/debates/033b5e7b-9e7a-4d43-8eb1-d2cdb5b46569/Kosovo_Human_Rights

⁵⁰Po aty.

dorëzuar në Klubin Kulturor Serb, më 7 mars 1937. Në Memorandum ai i referohej “problemit shqiptar”, një qetësim paralel me retorikën e njëkohshme të Hitlerit për “problemin hebre”. Ai i referohej një zone sikur ishte “pastruar rrënjësisht nga shqiptarët”. Më 1937 ai tha: “Në një kohë kur Gjermania mund të dëbojë dhjetëra mijëra hebrenj dhe Rusia mund të zhvendos miliona njerëz nga një pjesë e kontinentit në një tjetër, zhvendosja e disa mijëra shqiptarëve nuk do të çojë në shpërthimin e një lufte botërore” (...). Lordët fisnikë mund të mendojnë se kjo është e gjitha në të kaluarën, por Vasa i Çubriloviq jetoi deri në vitin 1990 dhe idetë e tij pasqyrohen në një rrjedhë të vazhdueshme të politikës shumë më përpara asaj dite, në qershor 1914, dhe deri në ditën e sotme”.⁵¹

Lordi McNair do të vazhdojë: “Çubriloviq shfaqet më 1944, duke paraqitur një projekt të ri për regjimin e sapoardhur të presidentit Tito, me titull: “Problemi i minoriteteve në Jugosllavinë e Re (...)”. Situata në Kosovë për momentin është nën presion intensiv. Serbët, edhe pse përbëjnë vetëm rreth 8 për qind të popullsisë së Kosovës, e kanë plotësisht nën kontroll atë. Ata kontrollojnë pothuajse gjithçka dhe mbi të gjitha kanë armë të cilat shqiptarët, kosovarët nuk i kanë (...). Sipas një artikulli në revistën franceze “L’Express” në 1986, DobricaQosiq, një hero tjetër i luftës, dhe disa akademikë të tjerë botoi atë që ata e quajtën “Memorandum”. Ishte një broshurë me 20 faqe, e cila në njëfarë mase është e krahasueshme me MeinKampf të Hitlerit (...). Ishte një deklaratë që përshkruan sesi të organizohet një Serbi e Madhe. Qosiq është president i Federatës Jugosllave (Serbi dhe Mali i Zi) që nga maji 1992 (...). Ai rajon i mëparshëm autonom

⁵¹ https://hansard.parliament.uk/Lords/1993-04-01/debates/033b5e7b-9e7a-4d43-8eb1-d2cdb5b46569/Kosovo_Human_Rights

(Kosova) i Serbisë, kishte status gati të barabartë si anëtar i Federatës Jugosllave, derisa ky status u revokua nga Serbia në 1990 (...). Populli i Kosovës dëshiron të shkëputet nga Serbia dhe të formojë një shtet të pavarur. Si shtet i pavarur, Kosova do të ishte e hapur si për Serbinë ashtu edhe për Shqipërinë (...). Kosovarët nuk donin të merrnin pjesë në aventurat serbe. Ata ishin të përgatitur të ishin pjesë e Jugosllavisë si një entitet i barabartë. Por, meqenëse Federata është e shpërbërë dhe duke qenë se njësitë e tjera po promovohen në statusin e shteteve sovrane, ata nuk shohin asnjë arsye pse kjo të mos zbatohet për Kosovën (...). Le t'i bindim Kombet e Bashkuara të veprojnë tani dhe të parandalojnë një tragjedi të mëtejshme”.⁵²

Paraqitjet publike ishin shumë të qarta dhe të favorshme për Kosovën. Raportimi i projekteve serbe “Memorandumi” përtë gllabëruar toka të huaja u krahasuan me MeineKampftëHitlerit. Gjithashtu, për formën e diskriminimit që i bëhet popullit shqiptar flitet me gjuhën e dënimit të ashpër. Nuk ngel pa u theksuar edhe statusi juridik që kishte Kosova para suprimimit të autonomisë, ku Lordi McNairqartëthotë se ishte njësi e barabartë e Federatës.

⁵²[https://hansard.parliament.uk/Lords/1993-04-01/debates/033b5e7b-9e7a-4d43-8eb1-d2cdb5b46569/Kosovo Human Rights](https://hansard.parliament.uk/Lords/1993-04-01/debates/033b5e7b-9e7a-4d43-8eb1-d2cdb5b46569/Kosovo%20Human%20Rights)

Fati Iseni

SUMMARY

Debate on Kosovo in the British Parliament during the crisis of the 90s

Debate on Kosovo in the British Parliament during the crisis of the 90s The interstate relations between Great Britain and Yugoslavia will develop correctly until the mid-1980s, when new circumstances will be created in the global political arena, namely the deep financial crisis in the Soviet bloc and the loss of the arms race by Soviets, thus reducing the impact policy of the Soviets in the region and in the world. The Great Britain now, in addition to following political changes, will also be quite active in the process of overthrowing communism in Eastern and South-Eastern Europe. Yugoslavia would be an area of interest to her, and from the good relations she had had so far, and the lure of Yugoslavia just to confront the Soviet Union, had reflected in its indifference to pressure Belgrade due to the flagrant violation of individual human rights in Kosovo. But as the anti-communist riots in Eastern Europe unfolded one by one, the British in various ways assisted the peoples of this area in the process of reforms towards full democratization and the eventual removal from Soviet influence. Great Britain as one of the Great Powers of the world, a close ally of the United States and a historical opponent of Russian policies in the Balkans and beyond, in many cases through military campaigns against Russian influence

will be quite politically active. Regular debates in the British Parliament, including the Government, clearly reflect the strategic orientation in relation to Kosovo. Debates on the Kosovo issue have been going on since the first half of the 1990s, but will be more frequent and open from the late 1990s. From the debates and reports that are presented we can perceive that both the government and the British opposition have a positive and supportive stance on the issue of Kosovo, constantly punishing the Serbian leader Milosevic, while for Kosovo they give tones of solidarity. These documents show how never before have British policies in the last quarter of the twentieth century, have a special interest in Kosovo and can be clearly seen but prudently sympathy and solidarity with Albanians in their efforts to advance their status.

Minir Ademi¹
Avni Avdiu²

Pjesëmarrja e shqiptarëve të Maqedonisë në luftën e UÇK-së për çlirimin e Kosovës

Edhe pse në shikim të parë tema e këtij studimi duket e thjeshtë, në esencë është mjaft komplekse dhe e vështirë për t'u trajtuar në kohën e sotme. Kjo, për faktin se një numër i madh i të dhënave nuk janë publikuar ende dhe shumë studiues nga frika e shtrembërimit të ngjarjeve e në mungesë së materialeve arkivore, nuk merren me dëshmitë e njerëzve të gjallë, të cilët e shohin atë kohë nga këndvështrime të ndryshme.

Bëhet fjalë për një periudhë të afërt, kur ende i freskët është bari i njomë me gjakun e të rënëve, të cilëve ende nuk u ka ra dheu fytyrës. Edhe plagët e invalidëve ende janë të freskëta. Akoma nënat nuk i kanë gjetur eshtrat e bijve e bijave të zhdukur. Ato vazhdojnë të vajtojnë për fëmijët e masakruar përpara syve të tyre. Fëmijët e mbetur gjallë e të traumatizuar kujtojnë me mall prindërit dëshmorë. Shumë gra, të cilave u janë vrarë burrat e janë dhunuar nga forcat serbe, akoma mbetën me shami të zeza në kokë. E pas të gjitha këtyre ndodhive makabre, e një rëndësie të madhe historike është që sa më shumë të jetë e mundur të ndriçohen faktet nën dritën e argumenteve autentike të dëshmitarëve okularë të kohës, të të mbeturve gjallë që përjetuan ato ngjarje, të invalidëve e veteranëve të UÇK-së, e të tjerëve.

¹ Instituti i Trashëgimisë Kulturore Shqiptare.

² Universiteti "Nënë Tereza" - Shkup.

Organizimet e para antijugosllave

Historia e shqiptarëve të Maqedonisë është pjesë e pandarë e trashëgimisë së popullit shqiptar, çështja kombëtare e të cilit ka mbetur gjithnjë e hapur, e pazgjidhur dhe si e tillë tejet e dhimbshme. Shqiptarët e Maqedonisë, si mbarë populli shqiptar, dëshmuar nivelin e lartë politik, duke u shprehur përkrah luftës së vëllezërve kosovarë për të marrë pjesë në çlirimin e Kosovës nga thundra shekullore serbe³.

Rruga politike, luftarake dhe sakrifica për liri e shqiptarëve të Maqedonisë, daton menjëherë pas Luftës së Dytë Botërore. Lufta e Dytë Botërore mbaroi me krijimin e një harte të re ushtarako-politike⁴. Pas LDB pushteti sllavo-komunist e ndau Kosovën me mbi 90% popullsi shqiptare në katër pjesë. Kosova mbeti si njësi autonome territorial-administrative brenda Serbisë, ndërsa pjesët e tjera iu shkëputen trevave etnike shqiptare në Maqedoninë Perëndimore, në Mal të Zi, Preshevë, Bujanovc dhe Medvegje. Periudha e viteve 1945-1966, ishte më e vështira për shqiptarët që jetonin në Jugosllavinë e Titos. Rivendosja e pushtetit jugosllav në trojet etnike shqiptare dhe aneksimi i Kosovës nga Serbia ngjalli pakënaqësi dhe qëndresë të shqiptarët. Një nga format e qëndresës ishte formimi i grupeve dhe organizatave politike. Ndër organizatat më të rëndësishme të asaj kohe ishte Organizata Nacional-

³Iseni, A. Mair, *Zhvillimet në Maqedoni dhe lindja e Ushtrisë Çlirimtare Kombëtare*, Tetovë, 2003, f.5

⁴Gëzim Ostreni, *Shpresa dhe zhgënjimi i shqiptarëve në Maqedoni gjatë dhe pas Luftës së Dytë Botërore*, Prishtinë, 2000, f.201.

Demokratike Shqiptare (NDSH)⁵. Në romanin bestseller të Donna Tartit, “Historia sekrete”, një personazh vrojton se si historia është “si një ëndërr e gjatë e keqe”...Në këtë kuptim, e gjithë historia e shkruar me përgjegjësi është e rrezikshme për sundimtarët jodemokratikë⁶.

Në të gjitha ngjarjet e rëndësishme për kombin shqiptar dhe Kosovën e aneksuar, shqiptarët e Maqedonisë ishin pjesë e pandashme e zhvillimeve, duke u përfshirë në mënyrë direkte sa në pjesëmarrje aq edhe në organizimin e tyre. Disa u ndëshkuan me burg, të tjerët u maltretuan dhe u internuan. Ata ishin pjesëmarrës aktiv edhe në organizimin e demonstratave të vitit 1968, të cilat ngjarje i nxorën në dritë padrejtësitë që u bëheshin shqiptarëve në Jugosllavinë e Titos dhe të cilat ngjarje ndikuan në avancimin e të drejtave të shqiptarëve me miratimin e Kushtetutës së 1974. Viti 1968, ishte vit i kthesave të mëdha në të gjithë hapësirën shqiptare të ish-Jugosllavisë. Ishte një frymë e përgjithshme e krenarisë dhe guximit, ku hapur shqiptarët filluan t’i paraqesin kërkesat legjitime të tyre, të cilat ishin ngulfatur nga komunistët jugosllavë. Në demonstratat popullore të 27 nëntorit të vitit 1968, në vigjilje të Festës së Flamurit shqiptar, u gjendën edhe shumë shqiptarë të viseve të tjera të Jugosllavisë, nga të cilët dominuan shqiptarët e Maqedonisë. Në vitin 1968, numri i studentëve nga Struga ka qenë simbolik, ndërsa të burgosur kanë qenë: Shefit Iljazime 8 vjet burg, Olloman Sela me 4 vjet, Xhevat Lena me 3 vjet dhe Sejdi Llogame 3 vjet⁷.

⁵Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve, Demonstratat popullore të vitit 1968, Tetovë, Shkup, 2018, f.39.

⁶Pettifer, James, *Ushtria Çlirimtare e Kosovës- nga një luftë e fshehtë në një kryengritje të Ballkanit, 1948-2000*, Tiranë, 2013, f.20.

Pastaj u vazhdua me organizimin e demonstrative të vitit 1981, të cilat ngjarje patën një bujë brenda dhe jashtë RSFJ-së. Edhe në demonstratat e vitit 1981, në Prishtinë dhe në viset e tjera të Kosovës, aktiviteti i shqiptarëve të Maqedonisë ishte i madh, si në vend, po edhe në mërgim. Këto demonstrata mbi të gjitha u karakterizuan me kërkesën “*Kosova Republikë!*”, e pas të cilave pasuan presionet politike dhe ekonomike, diferencimet kadrovike dhe diskriminimet e të gjitha formave gjer në suprimimin e autonomisë dhe vendosjen e masave të dhunshme serbe.

Gjatë gjithë kësaj periudhe nuk është zhvilluar ndonjë ngjarje historike, kombëtare e atdhetare e të mos kenë qenë në të pjesëmarrës shqiptarët nga Maqedonia. Këtë e vërtetojnë edhe dënimet e 50 studentëve me nga 60 ditë, për pjesëmarrje në demonstratat e vitit 1981. Të burgosur si anëtarë të grupeve të ndryshme, ishin: Alit Naxhaku 13 vjet, Shpëtim Pollozhani 13 vjet, Tahir Hani 12 vjet, Ibrahim Dauti 11 vjet, Kadri Pollozhani 6 vjet, Agni Dauti 5 vjet, Murat Lumani 5 vjet, Baftijar Elmazi 5 vjet, Medi Dauti 5 vjet, Minir Asani 5 vjet, Garip Kaba 5 vjet, Ylber Velu 4 vjet dhe Xhemaili 5 vjet⁸. Nga Kërçova me burg u dënuan edhe Hasan Bekteshi e Fadil Bajrami. Po ashtu, të burgosur për pjesëmarrje në demonstratat e studentëve të vitit 1981, kishte nga të gjitha qytetet e Maqedonisë. Me burg u ndëshkuan Fatmir Bekteshi dhe Shenur Osmani, studentë të Universitetit të Prishtinës. Ata ishin bashkë me një numër me mbi 30 shokë nga Kumanova, të cilët ishin evidentuar përmes fotokamerave. Ata në burgun e Kumanovës vuajtën dënimin me 60 ditë⁹. Në

⁸ Shpëtim Pollozhani, i lindur 12.02.1950, Intervistë e zhvilluar më 20 maj 2019.

⁹ Shenur Osmani, i lindur 1959 dhe Fatmir Bekteshi, i lindur 1960, Intervista e zhvilluar më 28.05.2019, Kumanovë.

veprimtarinë ilegale ishin të përfshirë shumë studentë nga Maqedonia edhe atë jo vetëm meshkuj, por në mesin e tyre kishte edhe femra, siç ishte rasti me mjeken Teuta Bekteshin nga Kumanova, e cila në maj të vitin 1982 u burgos bashkë me shumë veprimtarë. Ky vrull për të drejta e liri nuk u ndal as në ngjarjet e viteve 1987, '88, '89, '90, kur në skenën politike të Jugosllavisë erdhi diktatori më i madh, kasapi i Ballkanit, Slobodan Millosheviqi, kryekrimineli serb, i cili synonte ta dëbojë e shfarosë popullin shqiptar nga Kosova.

Formimi i grupeve të para guerile

Gjatë diskutimeve për ndryshimet kushtetuese, populli filloi të kuptojë lojën serbe për heqjen e autonomisë së Kosovës. Kundër këtyre ndryshimeve, populli u ngrit në mbi 4 300 tubime, ku morën pjesë mbi 40 000 veta. Në këto lëvizje gjithëpopullore të vitit 1988, u dalluan minatorët, studentët, po edhe inteligjenca shqiptare nga Maqedonia. Gjatë gjithë kësaj periudhe të viteve 1981-1988, që ishin vitet më të vështira nëpër të cilat kalonte populli shqiptar i Kosovës dhe i Maqedonisë, Kumanova u bë poligoni i parë eksperimental. U rrënuan muret e oborreve shqiptare, u mbyllën shkollat shqipe, u burgosën dhe u keqtrajtuuan shumë shqiptarë vetëm me një qëllim: që të shpërngulen nga trojet e tyre stërgjyshore. Mirëpo, këto tortura nuk i frikësuan shqiptarët kudo që jetonin në viset e tyre në Maqedoni. Përkundrazi ato i motivuan, i trimëruan dhe i organizuan si një trup i vetëm. Në periudhë 10-vjeçare, 1987 -1997, shqiptarët e Maqedonisë u bënë edhe më të vetëdijshëm se rruga e vetme e shpëtimit nga kjo politikë e shfarosjes ishte pjesëmarrja e tyre në organizimin ushtarak të shqiptarëve në të gjitha trojet e tyre stërgjyshore ku ata jetonin.

Shqiptarët e Maqedonisë duke i mbështetur e përkrahur vëllezërit kosovarë, njëherësh shprehnin edhe mospajtimin e tyre për padrejtësinë, shtypjen dhe mohimin që u bëhej atyre nga pushteti serb. Kjo e nxiti nevojën e angazhimit të shumë shqiptarëve në vend e diasporë, si në ngjarjet e viteve 1987, '88 dhe '89, por në veçanti për të dalë në ndihmë edhe gjatë formimit të celulave të para dhe grupeve guerile¹⁰. Në këto vite, shqiptarët e Maqedonisë u përfshinë në të gjitha përgatitjet, aksionet dhe aktivitetet e intensifikuara në formimin e një numri të madh të celulave. Aksionet u shtuan dhe zbatoheshin në konspiracion të thellë. Pasi përfshirja e shtresave më të gjera të lëvizjes, gatishmëria e familjeve të shumta që të hapnin dyert në mbështetje të aktivistëve dhe vullnetarëve shqiptarë nga Maqedonia që sakrifikonin çdo gjë për të vepruar si një trup i përbashkët gjithëshqiptar. Veprimtaria ilegale, me të gjitha vështirësitë dhe rreziqet, ishte sfidë e madhe. Vlerat që karakterizonin veprimtarët ishin: serioziteti, përgjegjësia dhe vetëmohimi. Nga ana tjetër, shërbimet sekrete serbo-maqedone i shtonin përndjekjet kundrejt tyre. Edhe pse ishin të vetëdijshëm për pasojat, arrestimet, burgosjet, torturat fizike e psikike dhe përballjen me vdekje, represioni serb nuk pati mundësi t'i ndalë as shqiptarët e Maqedonisë, të cilët kishin pjesëmarrje aktive në zgjidhjen e çështjes shqiptare të Kosovës¹¹. Gjatë kësaj periudhe, 1981-1989, edhe popullata shqiptare e Maqedonisë ishte viktimë e politikës maqedono-serbe, që dirigjohej nga po e njëjta qendër - Beogradi zyrtar.

¹⁰ Instituti Albanologjik Prishtinë, *Veprimtaria e gruas në Lëvizjen Kombëtare për Çlirim*, Prishtinë, 2010, f.137.

¹¹ Po aty, f.138.

Pas mëvetësimit të Maqedonisë, të drejtat e shqiptarëve u nëpërkëmbën edhe më tepër, kurse u shënuan edhe ngjarje të përgjakshme: në Bit Pazar, Ladorishtë, Reçicë të Vogël e Gostivar. Të anashkaluar e të denigruar, shqiptarët e Maqedonisë krahas rrugës paqësore përmes partive politike zhvillonin edhe linjën e përgatitjes luftarake¹². Në ilegalitet u angazhuan njësite të mbrojtjes civile që stërviteshin në Shqipëri, bartnin armatim në Maqedoni dhe mbanin lidhje me njësite të tjera nga Kosova. Ishte ky organizim ilegal nga organizmat legale të partive shqiptare, PPD dhe PP. Pushteti maqedonas e zbuloi këtë organizim të njohur me emrin “*Afera e armëve*” 1991/1994. Burgosi dhjetëra persona, në mesin e të cilëve funksionarin e lartë të PPD-së, Mitat Emini, si organizator. Aktivisti i njohur i ilegales, mësuesi Arif Seferi, u mbyt në burg nga torturat. Gjatë kësaj kohe në Shkup qëndroi përkohësisht edhe Adem Jashari, i cili më pas nëpërmjet vendkalimit në Dibër u fut në Shqipëri, ku i bënte stërvitjet përgatitore luftarake.

Formimi i zonave operative të UÇK-së

Sipas planit operativ ushtarak, veprimet u ndan në 5 zona: zona nr.2 ishte caktuar Maqedonia. Gjatë vitit 1997 në territorin e Maqedonisë me një taktizim dhe me një organizim tepër sekret, vepronte *Grupi i Kërçovës*, i përgatitur politikisht dhe ushtarakisht e duke vepruar në celula në viset me popullatë shqiptare. Figura kryesore e *Grupit të Kërçovës* në zonën operative nr.2, ishte Beqir Limani, i cili njëherësh është edhe dëshmori i parë i kësaj zone. Ai gjatë tentimit për ta arrestuar nuk u dorëzua dhe në luftim e sipër me

¹²Minir Ademi, *Dëshmorët e kombit (UÇK, 2001)*, Kumanovë, 2001, f.14.

policinë maqedonase ra dëshmor, më 18 shtator 1998. Në të njëjtën kohë e mënyrë, ra edhe Fadil Rufati nga Tetova. Veprimtari më i shkathtë në *Grupin e Kërçovës* ishte dëshmori Harun Aliu, i cili arriti të arratisej. Ai u largua në Shqipëri prej nga vazhdoi angazhimin për realizimin e idealit të tij në organizimin e luftës në Kosovë.

Nëse gjykojmë, zhvillimet e vitit 1997 në Ballkan dhe sipas studimeve e analizave të politikës së përgjithshme në botë, me ndryshimet e politikës globale, nuk u dha drita jeshile për një veprim luftarak gjithëkombëtar. Kujtojmë këtu faktin se Shqipëria në të njëjtin vit po kalonte momente mjaft krizalide pas shembjes së firmave piramidale, me ç'rast nga kazermat dolën sasi të mëdha armatimi. Kështu, shumë shpejt *Grupi i Kërçovës* në zonën nr.2, u sulmua dhe u shpartallua, me ç'rast u burgosën 9 nga 11 që ishin të përgatitur si bërthamë e UÇK-së. Që të gjithë ishin studentë të Universitetit të Tetovës, ku qendër takimi për organizim e kishin UT-në¹³.

Më 28 nëntor të vitit 1997, për herë të parë u paraqit publikisht UÇK-ja, emblemës së të cilës iu bashkëngjiten një numër i madh i shqiptarëve nga të gjitha trojet, por edhe nga Maqedonia. Kjo ushtri vullnetare shqiptare e Kosovës, ishte ëndërr e shqiptarëve të Maqedonisë. Shumë shpejt ata u organizuan si brenda Maqedonisë, por edhe në mërgatën shqiptare në diasporë. Vepruan si në logjistikë po ashtu edhe në mobilizimin e vullnetarëve që ishin të gatshëm për të kapur armët dhe për t'i dalë atdheut në ndihmë në momentet më vendimtare.

¹³ Granit Osmani, i lindur më 17.08.1975, Intervistën e zhvilluar, më 06.06.2019, Shkup.

Ende pa pushuar gjëmat nga tragjedia e shkaktuar në fshatrat Likoshan e Qirez, pas mesnatës së datës 5 mars 1998, forcat e shumta të policisë dhe ushtrisë serbe, sulmuan familjen e Jasharajve në Prekaz, me ç'rast bashkë me komandantin legjendar Adem Jasharin, u vranë edhe 56 anëtarë të tjerë të familjes. Pas kësaj ngjarjeje dhe masakrave në Reçak e vende të tjera, UÇK-ja u rrit me shpejtësi të madhe dhe u shtri në të gjitha viset e Kosovës, duke hapur shtigje të reja të lirisë.

UÇK-ja me organizimin e saj në gjirin e vet përfshiu 30 brigada të shpërndara në 7 zona operative, edhe atë: Zona Operative e Drenicës me 4 brigada, Zona Operative e Pashtrikut me 6 brigada, Zona Operative e Dukagjinit me 8 brigada, Zona Operative e Shalës me 4 brigada, Zona Operative e Llapit me 4 brigada, Zona Operative e Nerodimës me 3 brigada dhe Zona Operative e Karadakut me një brigadë.

Dëshmorët e UÇK-së nga Maqedonia

Në të gjitha këto zona operative ishin të përfshirë edhe vullnetarët shqiptarë nga Maqedonia. Një rol kyç dhe shumë të rëndësishëm në UÇK luajti Ismet Jasharit-Kumanova, i cili edhe para se të merrte vendimin për t'iu bashkangjitur shokëve të lirisë në Kosovë, kishte arritur të organizojë shumë demonstrata, të cilat organizoheshin nga bashkatdhetarët tanë në diasporë. Ismeti ishte ai bir i atdheut e popullit që ndër të parët, më 11.03.1998, u nis drejt Kosovës për t'iu bashkëngjitur radhëve të njësiteve të UÇK-së në Kosovë. Në rrugën përmes Shqipërisë, Ismeti së bashku me shumë shokë të tij hynë në Kosovë, ku u vendos në malet e Drenicës.

Më pastaj kaloi në Kleçkë, ku me urdhër të Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së, themeloi njësitin “Çeliku”, ku Ismeti u emërua zëvendëskomandant i këtij njësi.¹⁴ Ra dëshmorë në altarin e lirisë, më 25 gusht 1998, në një aksion të guximshëm, duke luftuar ballë për ballë me kriminelët serbë¹⁵. Pothuajse në të gjitha zonat e luftës në Kosovë kishte djem trima pjesëmarrës aktivë në pikat e frontit. Operacioni “Shigjeta 1” e kishte për detyrë që veprimtarinë luftarake ta bëjë në pjesën e Kosharës, kurse drejtimi i parë dhe i katërt taktik kishin për synim Malin e Pashtrikut dhe Luginën e Drinit të Bardhë. Kjo ishte faza e parë e këtyre drejtimeve. Në këto aksione të këtij operacioni, ishte aktiv dhe shumë i guximshëm edhe djali i ri nga Kumanova, dëshmori Beqir Sadiku, si dhe Ibrahim Shaqiri nga Llojani i Kumanovës, i cili në operacionin “Shigjeta” ishte zëvendëskomandant i Batalionit II. Ishte ushtar me shumë provojë, e njëherësh edhe pjesëmarrës në luftën në Kroaci kundër ushtrisë serbe¹⁶.

Në mesin e shumë shokëve nga Maqedonia ishte edhe IsmetMustafa nga Kumanova, i cili në mars të vitit 1999, me disa shokë u nis për t’iu bashkëngjitur shokëve të luftës. Ai u nis për në Shqipëri, konkretisht në vendin e quajtur Vlonë-Krumë, ku u përfshi në përgatitjet psiko-fizike dhe stërvitjet ushtarake për luftë. “Pas dy javësh stërvitjesh me disa komandantë, Bilall Sylja, Sami Ukshini, Agim Haziri, Esat Krasniqi, Bashkim Ladrovci, Shaban Musliu, Ramadan Bytiçi etj., IsmetMustafa u rreshtua në luftime”, - rrëfen bashkëluftëtari i Ismetit, Abdylqerim Lutfiu. Ismet Mustafa me

¹⁴ Kumanova për Flamur NDSH-UÇK, Kumanovë, 2019, f.197.

¹⁵ Jahiu, Nehat, *Orizarja ndër shekuj*, Tetovë, 2010, f.195.

¹⁶ *Zëri i Kosovës*, nr.1739, 27 maj 2000, Maqedoni.

shokët e tij në një rezistencë kundër forcave serbe gjatë 14-15 prillit 1999, duke luftuar ballë për ballë me armikun, arritën që t'i dëbojnë forcat serbe nga pozicionet e tyre. Në mëngjesin e 16 prillit 1999, filloi ofensiva më e rëndë e forcave serbe mbi forcat e UÇK-së. Ishte mëngjesi i kobshëm, ku në këto granatime dhe luftime të ashpra në pikën e frontit ra dëshmor Ismet Mustafa¹⁷.

Trimi nga Kumanova, Safet Ajeti, i inkuadruar në UÇK-së, më 05.05.1998, në Zonën Operative të Shalës në Brigadën 142, në Bivolak-Vushtrri, u gjet në vijat e para të frontit, në betejat më të përgjakshme me armikun. Ai ra në altarin e lirisë, më 14.06.1999. Në nderim të veprës së dëshmorit, sot në qytetin e Vitisë një rrugë e mban emrin Safet Ajeti.

Nga shumë trima që ju gjetën kombit në ditët e vështira, ishte edhe trimi nga Tetova, Mujdin Aliu. Ishte i guximshëm para armikut dhe duke luftuar ballë për ballë me armikun, ra dëshmor heroikisht, më 14 prill 1999, në luftën për thyerjen e kufirit shqiptaro-shqiptar, duke e mbrojtur nderin e Kosovës në Koshare të Gjakovës.

Po ashtu, gjatë kësaj lufte të tmerrshme ballë për ballë me armikun, në altarin e lirisë ranë katër dëshmorët nga Shkupi: Shabi Kajolli, Remzi Xhaferi dhe Zekir Dardhishta. Trimi nga Kërçova të cilit nuk i trembej syri e që ra në fushën e betejës ishte, Aliriza Selmani, në Zonën Operative të Pashtrikut¹⁸.

¹⁷Lajm, 17 prill 2014, Speciale, shkrimi i përgatitur nga Minir Ademi.

¹⁸Emrat e shumë dëshmorëve nga të gjitha trojet shqiptare e në veçanti ata nga Maqedonia i gjejmë në librin: *Fisnikët e lirisë - dëshmorët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës: SHVLUÇK*, Prishtinë, 2002, f.52.

Kosova u shprehu mirënjohje për kontributin, shqiptarëve të Maqedonisë

Sipas evidencës statistikore në OVL-UÇK-Prishtinë, ku të dhënat janë siguruar nga kryetari i kësaj organizate, Hysni Gucati, ushtarë që u përfshinë në pikat e luftës kishte nga të gjitha vendet e Maqedonisë ku jetonin shqiptarët. Ishin 435 luftëtarë dhe mbi 200 ushtarë të angazhuar në logjistikë, që kryenin punë të rënda e të rrezikshme gjatë bartjes së armatimit dhe të gjitha mjeteve të nevojshme për luftë. Pra, numri i përgjithshëm arrin mbi 600 ushtarë të lirisë, me dokumentacionet që i posedojnë nga OVL-UÇK-Prishtinë. Mirëpo, sipas burimeve gojore të disa ushtarëve që sot janë me punë në diasporë, numri i tyre është edhe përmbi 300 të tjerë, pra pjesëmarrja e shqiptarëve të Maqedonisë, sipas Hysni Gucatit arrin afër 900. Nga këto ushtarë të lirisë me rastin e 20-vjetorit të daljes në skenë të UÇK-së, në vitin 2017, kryetari i OVL-UÇK-së, Hysni Gucati, 10 dëshmorëve të rënë në luftën e Kosovës iu ndau dekorata e mirënjohje postmortum: Rahim Samiut-Zogu, Isa Lika-Iliri, Nuri Mazari-Struga, Ismail Memeti-Fisheku, Baftjar Jakupi dhe Samedin Guri.

Në veprimet luftarake në të gjitha zonat operative të Kosovës mbi 80 janë plagosur, ku një numër prej tyre kanë edhe statusin e invalidit të luftës. Vetëm në pjesën e luftës në Koshare janë 68 ushtarë të lirisë nga Maqedonia, 35 të plagosur dhe 5 dëshmorë.

Në vazhden e aktiviteteve nën organizimin e OVL-UÇK, përveç dekoratave u janë ndarë mirënjohje edhe anëtarëve të Shtabit të Përgjithshëm dhe afër 200 invalidëve dhe veteranëve të luftës nga Maqedonia. Kjo vazhdon deri në përfshirjen e të gjithë veteranëve

dhe invalidëve të UÇK-së nga Maqedonia. Sipas të dhënave të komandantëve të Zonës Operative të Pashtrikut, Bilall Sylës, Binak Gashit dhe Fazli Berishës numri i përgjithshëm i ushtarëve të lirisë nga Maqedonia në këtë zonë arrinte nga 60 deri 80 ushtarë të lirisë. Sipas deklaratës së Rufki Sumës në Zonën Operative të Nerodimës në Hanin e Elezit, nga Maqedonia ishin të përfshirë në vijat e frontit mbi 50 ushtarë të lirisë si dhe 45 të angazhuar në logjistikë.

Në bazë të ligjit për njohjen e statusit të dëshmorit, invalidit dhe veteranit luftëtar të UÇK-së, të gjitha familjet e dëshmorëve, invalidët dhe veteranët luftëtarë e gëzojnë të drejtën e pensionit nga Republika e Kosovës.

Tre veteranë të UÇK-së që ranë dëshmorë në luftën në Maqedoni 2001: Naser Ademi, Imri Elezi dhe Beqir Sadiku kanë fituar statusin e dëshmorit nga Republika e Kosovës.

Ndihma në thyerjen e territ informativ

Vlen të theksohet se për ta hequr terrin informativ në Kosovë, përgjegjësinë përsipër e mori drejtori i RTV private “Zëri i Kumanovës”, Ismet Bexheti. Në vitin 1998, teknika e radios nga Kumanova u bart në zonën e luftës në malet e Berishës, prej ku filloi të transmetohen valët e radiostacionit “Kosova e lirë”. Ismet Bexheti kishte vendosur kontaktet e para me njerëzit udhëheqës në Shqipëri për iniciativën që dëshironte ta ndërmernte, por për shkak të vonesës së përgjigjes nga Shqipëria, ai ra në kontakt me Shaqir Shaqirin, i cili ishte i caktuar nga Shtabi i Përgjithshëm si përgjegjës i korridorit furnizues të UÇK-së: Shqipëri-Maqedoni-Preshevë-Kosovë. Përmes këtij korridori, pas një periudhe gati 6-mujore u arrit qëllimi dhe

synimi për transmetimin e ngjarjeve luftarake nga kjo medie¹⁹. Një kontribut të dukshëm në planin informativ e kanë dhënë edhe radiotelevizionet shqiptare lokale në Maqedoni (veçojmë TV “Festën” në Kumanovë), të cilat krahas informimit të popullatës lidhur me zhvillimet në Kosovë, i mobilizuan shqiptarët në mbledhjen e ndihmave emergjente për refugjatët në Bllacë si dhe për strehimin e një pjese të tyre nëpër shtëpitë e veta.

Ndihmat humanitare

Menjëherë pas shpërthimit të luftës në Kosovë dhe shpërthimit të krizës me refugjatë, shqiptarët e Maqedonisë u mobilizuan në një organizim të paparë. U aktivizuan të gjitha organizatat humanitare si Shoqata Humanitare Bamirëse “Nëna Terezë”, “El Hilal”, “Kalliri i Mirësisë” etj..., si dhe grupe e individë të shumtë, të cilët iu bashkëngjiten aktivitetit me moton “Familja ndihmon familjen”, duke mbledhur tonelata ndihmash në miell e artikuj ushqimorë, veshmbathje e gjëra të tjera për nevoja emergjente, si dhe sasi të mëdha të hollash devizore (kryesisht: dollarë, marka, franga etj.). Me të holla u ndihmuan shkollat e mesme, sindikatat, shëndetësia etj. Ky mobilizim i shqiptarëve të Maqedonisë, nuk u shkonte përshtati nacionalistëve maqedonas. Shtypi maqedonas i kohës “Вечерни Новости”, “Нова Македонија” dhe “Наш Весник” dilnin me tituj pezhorativ, ku në faqet e para ku shkruanin: “Aksion i suksesshëm i organeve të rendit dhe sigurisë për konfiskimin e ndihmave për Kosovën”²⁰. Po ashtu edhe gazeta “Наш Весник”, doli me një shkrim

¹⁹ Ismet Bexheti, i lindur 10.08.1965, Intervistën e zhvilluar, më 25.05.2019, Kumanovë.

²⁰ Veçerni Novosti, 3 0.08.1990, Shkup, f.4.

tendencioz me titull: “Српска Фронт Косова”, ku villte vrer kundër aktiviteteve humanitare për Kosovën²¹. E vetmja gazeta ditore që dilte në gjuhën shqipe “Flaka e vëllazërimit”, e cila gjithashtu e kishte njëfarë censure, përmbahej dhe ishte e matur në raportimet e saj për ndihmat humanitare në Kosovë. Komuna e Kumanovës, Likovës si dhe qytetet e tjera të Maqedonisë pranuan me qindra refugjatë nga Kosova në shtëpitë e tyre. Nga ana tjetër, përderisa intensifikoheshin aktivitetet humanitare, shumë të rinj e humbnin durimin dhe orvateshin individualisht të kalonin kufirin për t’iu bashkangjitur luftëtarëve të UÇK-së në Kosovë. Në mesin e tyre veçojmë dëshmorin BeqirSadiku, i cili me disa shokë u zu në verën e vitit 1998, nga forcat serbe në tentim të kalimit të kufirit. Pas disa ditëve ai gjeti rrugë të tjera dhe iu bashkëngjit radhëve të UÇK-së²².

²¹NashVesnik, 30.08.1990, Kumanovë,f.3.

²²Minir Ademi, *Beqir Sadiku-komandant Sllupçani*, Kumanovë,2014, f.29.

Minir Ademi
Avni Avdiu

SUMMARY

The Albanians of Macedonia, although separated by geographical borders, have always felt connected with the Albanians of Kosovo. This connection is emotional and spiritual, but also kinship because there are many families that are also connected through marriage. Throughout history, the Albanians of Macedonia have always been side by side with their brothers from Kosova in various organizations, legal, illegal, humanitarian, cultural, educational and even military, acting as one body for common national goals. The multifaceted connection of the Albanians of Macedonia with those of Kosovo was most proved during the war of 1999, and with all forms of mutual organization.

Isamedin Azizi

Zhvillimet politike në Maqedoni në kohën e luftës së Kosovës

Është një parim historik që shpjegon domosdoshmërinë e shfaqjes së kauzave etnike pas shkatërrimit të perandorive. Së këndejmi, edhe me shthurjen e Jugosllavisë, u hapën çështjet etnike, pra edhe ajo shqiptare. Jugosllavia e atëhershme tregoi se nuk kishte vlera stabile, dhe këtu gjithnjë e më tepër filloi të zbulohet tendenca për dominimin e një kombi mbi kombin tjetër. Derisa ishte në fuqi partia, pra ideologjia, kjo tendencë për dominim bëhej përmes institucionit të diferencimit ideopolitik, e pasi u harxhuan këto mekanizma, tendenca për dominim mori trajtën e represionit të hapur. Hapja e çështjes shqiptare nuk është pasojë e projektit komplotist shqiptar, por pasojë e shthurjes së Jugosllavisë, e cila erdhi si rezultat i aspiratave serbe që të dominojnë mbi të.

Gjatë këtij procesi të shthurjes së Jugosllavisë u shfaqën dy lloj modelesh: ai i vetëvendosjes etnike që përfaqësohej nga politika serbe, dhe ai i së drejtës për vetëvendosje të njëjësive konstituive administrative të ish-Federatës që përfaqësohej nga politikanët shqiptarë. Ata kërkuan të drejtën e vetëvendosjes për Kosovën si njësi konstituive e Federatës, ndërsa shqiptarët e Maqedonisë edhe pas lufte nuk kërkuan zgjidhje territoriale për çështjet etnike dhe nuk e ndoqën shembullin e serbëve të Bosnjës dhe të Kroacisë, por kërkuan të drejta të barabarta, pra demokraci konsensuale. Përfaqësuesit politikë shqiptarë të Maqedonisë gjatë procesit të shthurjes së Jugosllavisë dhe procesit të pavarësimit të Maqedonisë bënë dy

kompromise fundamentale: 1. Evotuan Deklaratën për Pavarësi të Maqedonisë pa kushte, pra i dhanë krah maqedonasve të kenë shtetin e tyre dhe, 2. Hoqën dorë nga federalizmi i Maqedonisë, ose nga jetësimi i referendumit për autonomi politike-territoriale. Ata u treguan shumë kooperativë në krijimin e këtij shteti, duke i dhënë shanse paqes, ata hoqën dorë nga kërkesa për krijimin e shtetit nacional, me shpresë se në këto hapësira do të instalohen konceptet multikulturore. Me procedurë demokratike, ku shumica mbivoton pakicën, shteti dhe institucionet u bënë maqedonase. Përmes kushtetutës shteti që dikur ishte i përbashkët, tani u përkufizua si shtet i maqedonasve. Përmes Ligjit për administrim lokal, u eliminua mundësia e qeverisjes në pushtetit lokal, ndërsa përmes agjencive për privatizim u përvetësua prona e përbashkët, ajo shoqërore, që u ngrit edhe me një pjesë të konsiderueshme të kapitalit të shqiptarëve.

Pushtetarët maqedonas arritën të fshehin realitetin e vrazhdë të çpushtetizimit të popullit shqiptar në Maqedoni me përfshirjen e shqiptarëve të caktuar në poste të larta. Në Qeverinë e Maqedonisë, shqiptarët merrnin pjesë me 5 ministra, ose me 1/3 e Qeverisë, në Parlament proporcioni i tyre ishte 1/6, ndërsa në administratën shtetërore shqiptarët ishin të përfaqësuar me vetëm 2%.¹ Me këtë Maqedonia arriti të krijojë një sistem politik-shoqëror që garanton dominimin e një kolektiviteti mbi tjetrin. Atë që serbët e arritën me luftë, maqedonasit e arritën me kushtetutë dhe ligje që shprehin vullnetin e tyre për dominim mbi shqiptarët, pra çdo kërkesë e shqiptarëve për barazi ndeshej me sanksione ligjore.

¹Arbën Xhaferi, *Vepra - Intervista 1995-2005*, A kutërbon Maqedonia, Tiranë, 2017, Vëll. IV, 57. Intervista e Arbën Xhaferit për gazetën "Koha", 8 gusht 1996.

Si rrjedhojë e një situate të tillë në të cilën u ndodhën shqiptarët, Maqedonia do të ballafaqohet me kriza të vazhdueshme, që nga momenti i pavarësimit të saj e deri më 2001, kur pakënaqësia e shqiptarëve do të kulmojë në luftë të armatosur. Protestat e para të shqiptarëve pas shthurjes së Jugosllavisë, do fillojnë që nga viti 1990 në Tetovë kundër diskriminimit shtetëror, për të vazhduar në vitin 1992 në sheshin e Shkupit me qëllim të sensibilizimit të faktorit ndërkombëtar për diskriminimin dhe padrejtësitë që u bëheshin shqiptarëve të Maqedonisë. Intervenimi i policisë maqedonase në Bit Pazar të Shkupit, më 6 nëntor 1992, rezultoi me 4 civilë të vrarë, 37 të plagosur dhe 87 shqiptarë të burgosur.² Nga shumë analistë e gazetarë, kjo ngjarje u pa si inskenim i shërbimeve serbe, ku këto të fundit ende kishin ndikim shumë të fuqishëm në institucionet e Maqedonisë, sidomos në institucionet e sigurisë, në drejtorinë e sigurimit shtetëror, por edhe në disa segmente të Ministrisë së Punëve të Brendshme. Këtë qëndrim e mbështet edhe Ibrahim Rugova, i cili deklaroi se shërbimi serb kishte nxitur një skenar të tillë për qëllime strategjike, për të shpërthyer një luftë të re në jug të Jugosllavisë, me të vetmin qëllim, zhvendosjen e vëmendjes nga luftimet në Bosnjë e Kroaci.³

Se Qeveria e Maqedonisë kishte bashkëpunim të ngushtë me Millosheviqin, kur bëhej fjalë për shqiptarët, e dëshmon edhe akuza që i bën lideri i opozitës maqedonase, Ljubčo Georgievski, ministrit të Punëve të Brendshme nga foltorja e Parlamentit të Maqedonisë

² Fati Iseni, *Rrethanat politike-shoqërore të shqiptarëve në Maqedoni 1989-2001*, disertacion i doktoratës, Tiranë, 2013, 60.

³ “Нова Македонија” – Идентични Шпекулации, gazetë ditore në gjuhën maqedonase, 11 nëntor 1992.

rreth pjesëmarrjes së forcave policore maqedonase në Kosovë, më konkretisht në Prishtinë për arrestimin e shqiptarëve të Kosovës.⁴ Maqedonia në mënyrë të fshehtë do t'i dalë në ndihmë Millosheviqit edhe gjatë embargos për derivateve të naftës që i vendoset Serbisë nga OKB-ja.⁵

Fatin e shqiptarëve të Kosovës nga regjimi i Millosheviqit do ta përfshijnë edhe shqiptarët e Maqedonisë. Varësisht se si zhvilloheshin aktivitetet politike e ushtarake në regjion, në Maqedoni rritej dhuna shtetërore ndaj shqiptarëve. Në korrik të '97-së, policia maqedonase dhunshëm hyri në zyrat e kryetarëve të komunave në Tetovë e Gostivar për heqjen e flamurit shqiptar. Si rrjedhojë, kemi tre të rinj shqiptarë të vrarë, dhjetëra të plagosur dhe rreth 400 të arrestuar.⁶ Rreth kësaj ngjarje ashpër do të reagojnë Tirana dhe Prishtina. Nënkryetari i LDK-së, Fehmi Agani, në një konferencë për shtyp mes tjerash do të deklarojë: *“ekzistojnë indicie të mjaftueshme që tregojnë se ky aksion u ndërмор, jo vetëm sipas modelit, por edhe me ndikim të drejtpërdrejtë të regjimit serb, është iluzore të mendohej se mund të shuhen lidhjet organike të nacionalshovinizmit serb dhe*

⁴Fatih Iseni, *Rrethanat politike-shoqërore.....*, 73, Стенографски белешки шеесет и деветтата седница на Собранието на Република Македонија, одржана на 15 ноември 1993 година, Доста Димовска. f. 7. 152 Стенографски белешки од Шеесет и деветтата седница на Собранието на Република Македонија, одржана на 15 ноември 1993 година, Љубчо Георгиевски, f. 173.

⁵*“Fllaka e vëllazërimit”*, Afera e armëve për ta harruar aferën e naftës, gazetë ditore në gjuhën shqipe, 14 nëntor 1993.

⁶Zeqirja Rexhepi, *Zhvillimet politiko-shoqërore te shqiptarët në Maqedoni 1990-2001*, Tetovë, 2005, 123.

atij maqedonas”.⁷ Kjo le të kuptojmë se politikat shtetërore të këtyre dy vendeve kishin koordinim të shkëlqyer mes veti.

Ngaqë shumë procese politike në Maqedoni kishin marrë drejtimin e gabuar, në mos edhe kishin përfunduar në dëm të shqiptarëve, krijoi hapësirën për daljen në skenën politike edhe të një partie tjetër shqiptare, asaj të Partisë Demokratike të Shqiptarëve të udhëhequr nga Arbën Xhaferi. Ajo doli me idenë për marrëveshje historike në mes shqiptarëve dhe maqedonasve.⁸ Ky opsion ashpër kundërshtohet nga maqedonasit. Çdo politikan maqedonas që mund të përkrahte ndonjë ide të tillë, akuzohej nga pala maqedonase se ishte kontaminuar nga idetë shqiptare.

Për shkak të përshkallëzimit të situatës në Kosovë, në shkurtin e vitin 1998, liderët e partive politike në Maqedoni do t'i koordinojnë veprimet e tyre politike duke kërkuar nga faktori ndërkombëtar që të fillojë dialogu në mes Beogradit dhe lidërshiptit kosovar, meqë sipas tyre, Kosova ngadalë rrëshqet drejt luftës dhe çdo konflikt në Kosovë, do të kishte ndikim të drejtpërdrejtë edhe në Maqedoni.

Masakra e Prekazit, përveç se alarmoi qendrat e vendosjes në botë, ajo përnjëherë mobilizoi edhe faktorin politik shqiptar në Maqedoni. Për këtë arsye, subjektet politike shqiptare më 10 qershor 1998, do të organizojnë një protestë masive në Shkup me moton “NATO në Kosovë”, ku morën pjesë një numër shumë i madh

⁷ “*Flaka e vëllazërimit*”, Aksion policor nën ndikimin e regjimit serb, 12 korrik 1997.

⁸ Arbën Xhaferi, *Vepra - Intervista 1995-2005*, Ofertë për marrëveshje historike, Tiranë, 2017, Vëll. IV, 9-12.

pjesëmarrësish, e cila ndoshta edhe është protesta më e madhe e organizuar ndonjëherë nga shqiptarët e Maqedonisë.⁹

Në artikullin e gazetës “NovaMakedonija” me titull “Terrorizmi nuk njih mëshirë”, të botuar më 22 shtator 1998, autori i tekstit, duke cituar deklaratën e drejtorit për Zbulim dhe Kundërzbulim, VlladoPopovskit, vlerëson se edhe në Maqedoni, Ushtria Çlirimtare e Kosovës ka strukturat e saja.¹⁰ Këtë vlerësim ai e mbështet edhe në deklaratën e përfaqësuesit politik të UÇK-së, z. Jakup Krasniqit, i cili Maqedoninë e ka përcaktuar si Zona numër 2. Në një preskonferencë të mbajtur më 21 shtator 1998, drejtori i Agjencisë për Zbulim dhe Kundërzbulim, z. Vllado Popovski, thekson se Maqedonisë i kanosen dy kërcënime serioze. Ajo e refugjatëve nga Kosova dhe ajo e aktiviteteve diversante, atentateve dhe të ngjashme.¹¹ Më tej ai shton se pjesëtarë të UÇK-së janë të pranishëm në Maqedoni, dhe se kanë “infrastrukturë të organizuar në Maqedoni”, por ai mendon se nuk do të jetë aktive, meqë situata në këtë shtet është shumë më e mirë se sa në Kosovë ose Shqipëri.¹²

Përshkallëzimi i luftimeve në Kosovë, rritja e numrit të refugjatëve kosovarë, mobilizimi i shqiptarëve të Maqedonisë e sidomos vendimi i dy subjekteve politike shqiptare që së bashku të dalin në zgjedhjet parlamentare, shqetësoi tej mase udhëheqësinë shtetërore maqedonase. Nuk kishte dilema se interesi strategjik i ngulitur në kokat e krerëve të shtetit maqedonas ishte që Kosova të jetë sa ma e dobët, të jetë më në kontroll dhe sa më e shthurur. Ideja e

⁹ “Нова Македонија”, Против НАТО во Македонија а за НАТО во Косово, 11 qershor 1998.

¹⁰ “Нова Македонија”, Тероризмот нема милост, 22 shtator 1998.

¹¹ “Нова Македонија”, Две безбедносни закани за Македонија, 22 shtator 1998.

¹² По ату.

Gligorovit për hapjen e korridorit ishte një refleks i shfryrjes së mllefrit të tij ndaj shqiptarëve me tendencë për spastrim etnik. Gligorovi si një politikan i formatit jugosllav, nga frika se refugjatët kosovarë mund të mbeteshin në Maqedoni, gjë e cila do të ndryshonte strukturën etnike e demografike të shtetit, “shpiku” projektin e tij për hapjen e një korridori për refugjatët kosovarë, të cilët në mënyrë të organizuar do të barteshin nga kufiri i Kosovës për në Shqipëri, për të realizuar në mënyrë të suksesshme planin për pastrimin etnik të Kosovës, plan i cili realizohej ndoshta edhe në koordinim të mirë me Millosheviqin. Skenari i Gligorovit dhe i partisë së tij LSDM-së, dështoi jo vetëm nga kundërshtimi i madh i shqiptarëve, por edhe për shkak të ndryshimeve politike që ndodhën në Maqedoni pas zgjedhjeve parlamentare në vitin 1998, kur në pushtet erdhën VMRO-ja e Ljubčo Georgievskit dhe PDSH-ja e Arbën Xhaferit.¹³

Përcaktimi strategjik i PDSH-së pas marrjes së pushtetit ishte tendenca për bindjen e maqedonasve se shqiptarët nuk ishin të rrezikshëm, as ata të Maqedonisë, as refugjatët kosovarë. Kjo ishte një tendencë për bindjen e maqedonasve se zgjidhja pozitive e çështje së Kosovës dhe pavarësia e saj stabilizojnë Maqedoninë.

Në momentet më të vështira të historisë së Kosovës, e cila po digjej flakë, te shqiptarët e Maqedonisë që janë pjesë e një trangu të ndarë, të një mendësie kombëtare, ekzistonte një gatishmëri e madhe për mbështetje të pakursyer të kauzës kosovare. Së këndejmi ishin iluzore idetë se Kosova mund të kthehej në një kasaphane të izoluar nga territoret e tjera shqiptare. Në fundamentin kombëtar të shqiptarëve të Maqedonisë nuk kishte kufij administrativ dhe nuk kishte dallime në mes shqiptarëve në Kosovë dhe në Maqedoni sa i

¹³Fatih Iseni, *Rrethanat politike-shoqërore...*, 134.

përket krizës në Kosovë. Ata në luftën e Kosovës do të implikohen në tri faza: 1. Në fazën e parë nëpërmjet manifestimit të solidaritetit politik jo vetëm përmes prononcimeve të ndryshme politike, por edhe përmes mitingjeve dhe protestave që u përmendën më lartë; 2. Përmes ndihmave financiare dhe humanitare; dhe 3. Përmes dimensionit militar apo pjesëmarrjes aktive në formacione luftarake në Kosovë.

PDSH-ja e Arbën Xhaferit me tërë kapacitetin e saj politik, intelektual e njerëzor u vu në shërbim të çështjes së Kosovës. Strukturat e saj partiake ishin të përfshira në të gjitha fazat e luftës së Kosovës, dhe ishte subjekt i vetëm i cili që nga fillim i luftës së Kosovës kishte një strukturë shumë mirë të organizuar, si në pritjen dhe menaxhimin me refugjatë, po ashtu edhe nëpërmjet organizimit dhe formave tjera të ndihmave për Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës.

Prononcimi i kryetarit të PDSH-së, Arbën Xhaferit, për gazetatat gjermane “Zydojçe Cjtung”, “Frankfurt allgemeine” dhe “Dietageszeitung Berlin”, dhe të tjera, në vitin 1998,¹⁴ opinionit gjerman dhe atij evropian i dërgoi mesazhe të qarta se shqiptarët nga Maqedonia nuk do të rrinë duarkryq nëse Beogradi edhe më tutje do të përshkallëzojë dhunën ushtarake ndaj popullatës civile në Kosovë. Ai më tej shton se “kriza e Kosovës mund të bartet edhe në Maqedoni, dhe se kjo varet nga qëndrimi i faktorit ndërkombëtar ndaj Beogradit, por njëkohësisht edhe nga qëndrimi i faktorit politik maqedonas”.¹⁵

Këto mesazhe të kryetarit të PDSH-së z. Xhaferit, bënë jehonë të konsiderueshme në qarqet e caktuara politike dhe diplomatike, dhe

¹⁴ Arbën Xhaferi, *Vepra - Intervista 1995-2005*, vëll. IV, Perëndimi dhe kriza e Kosovës, 111-114.

¹⁵ *Po aty*.

shtojnë dronë se kosovizimi i Maqedonisë jo vetëm që është i mundshëm, por edhe i pashmangshëm.

Mesazhi i shqiptarëve të Maqedonisë ndaj faktorit ndërkombëtar ishte shumë i qartë: jepjani pavarësinë Kosovës dhe ne garantojmë stabilitetin e Maqedonisë. Ky mesazh u lexua shumë mirë nga ndërkombëtarët.

Gjermania vlerësonte se me zhvillimet e mëtutjeshme luftarake në Kosovë mund të preket edhe Maqedonia, madje edhe ta involvojnë atë. Ministri gjerman, Kinkel, theksoi shkallën e saj të rrezikshmërisë për Maqedoninë dhe kërkoi që të ndërmerren të gjitha masat për parandalimin e saj. Sipas tij, mënyra më e mirë që flaka e Kosovës të mbahej e izoluar nga Maqedonia, por edhe nga Shqipëria, do të ishte krijimi i ashtuquajturit “korridor sanitar” në kufijtë e saj me anën e trupave ndërkombëtare dhe vëzhguesve të tjerë. Bindja se “karanitmi” i Kosovës mbase mund të jetë ilaçi më i mirë për t’u mbrojtur Maqedonia nga “virusi i konfliktit kosovar” flet për mungesën e një koncepti të qartë evropian për trajtimin integral të çështjes shqiptare, si dhe flet për konfuzitetet që shfaqen brendapërbrenda faktorit evropian ndërkombëtar. Pikërisht ky konfuzitet ka stimuluar Beogradin të provojë modelet e përdorimit të luftës dhe të pastrimit etnik.¹⁶

¹⁶ Arbën Xhaferi, *Vepra - Intervista 1995-2005*, 112, Gazeta konservative “*Frankfurter allgemeine*” në një raport analitik të reporterit të saj ballkanik, Matias Ryb, bëri të ditur se i ashtuquajturi “kosovizim” i Maqedonisë Perëndimore është në zhvillim e sipër, dhe se ai do të përcaktohet nga kahet e zhvillimeve në Kosovë, por edhe nga sjellja e Qeverisë maqedonase. Ryb me këtë përkujton lidhjet tepër të ngushta kulturore, ekonomike dhe shpirtërore të Kosovës me ata të Maqedonisë, si dhe faktin se inteligjencia e gjithmbarshme shqiptare në Maqedoni frymon kosovarçe si për nga shkollimi, por edhe për nga mentaliteti, andaj është e

Pas fillimit të fushatës ajrore të NATO-s, Millosheviqi u mundua që përmes deportimit të dhunshëm të shqiptarëve të Kosovës të destabilizojë edhe vendet fqinje. Qëllimi i tij ishte shumë i qartë, që të krijojë rrathë krizash përreth forcave të stacionuara të NATO-s, sidomos në Maqedoni. Ekspoziturat e tij të moçme në Maqedoni fuqishëm u aktivizua jo vetëm në institucionet e vendit, por edhe jashtë tyre, siç ishin: tentimi për të sulmuar dhe djegur Ambasadën amerikane në Shkup, sulmet ndaj Ambasadës së Britanisë së Madhe dhe Gjermanisë etj.¹⁷ Por, këto ishin përpjekjet e fundit të infrastrukturës serbomadhe, e cila dëshironte që luftën e humbur të Millosheviqit në terrenin e vet, ta fitonte në Maqedoni, duke e përfshirë edhe Maqedoninë në valë lufte. Por pushteti i ri në Maqedoni arriti që atë ta ankorojë në ujërat e qeta evropiane.

Bashkësia ndërkombëtare, SHBA, BE dhe NATO, pas përfundimit të suksesshëm të krizës kosovare, është tejet e vetëdijshme dhe falënderuese për kontributin e madh të Maqedonisë.

Kryeministri i Maqedonisë, z. Ljubço Georgievski, më 30 qershor 1999, priti në takim me të gjitha ceremonitë shtetërore, siç thotë Arbën Xhaferi në intervistën dhënë gazetës “Nova Makedonija”, jo më liderin e UÇK-së, z. Hashim Thaçin, por kryeministrin e Qeverisë së Kosovës.¹⁸ Kjo situatë shkaktoi protesta në Shkup që u organizuan nga ana e opozitës maqedonase dhe nga ata që fuqimisht donin fitoren e Millosheviqit kundër NATO-s, nga ata

kuptueshme nëse ata janë të interesuar si shumë rreth fatit të Kosovës dhe statutit të saj të ardhshëm.

¹⁷*Po aty.*

¹⁸“*Нова Македонија*”, дневен весник, 30 јуни 1999, интервју со Арбен Џафери: “Косово треба да биде независна република”, Kosova duhet të bëhet republikë e pavarur, Intervistë e Arbën Xhaferit dhënë gazetës ditore “Nova Makedonija”..

që në zemër kishin serbizimin, për faktin se sipas tyre, takimi i kryeministrit të Maqedonisë me kryeministrin e Kosovës nënkupton edhe pranimin e Kosovës nga ana e Maqedonisë.

Kriza me refugjatët

Përshkallëzimi i luftimeve në Kosovë pati refleksione të shpejta edhe në Maqedoni. Kjo për faktin e lidhjeve të shumta që kishin shqiptarët e Maqedonisë me ata të Kosovës, sidomos në rrafshin familjar.

Politikat shtetërore maqedonase ishin haptazi kundër ardhjes së refugjatëve kosovarë në Maqedoni, me justifikimin se shteti nuk kishte kapacitet të mjaftueshëm për t'i bërë ballë kësaj situate.

Me një politikë të tillë shtetërore asnjëherë nuk u pajtuan shqiptarët e Maqedonisë. Nga frika se largimi i kosovarëve në vendet e Evropës Perëndimore dhe të SHBA-së mund të kenë fatin e njëjtë sikurse refugjatët e Bosnjës e të Kroacisë, e që u dëshmuar se një pjesë e konsiderueshme e tyre asnjëherë nuk u kthyen në vendet e tyre. Arbën Xhaferi dhe partia e tij insistonin që me çdo kusht refugjatët kosovarë të mbeteshin në Maqedoni, qoftë edhe në kushte të vështira, për faktin se pas mbarimit të luftës refugjatët kosovarë menjëherë do të ktheheshin në shtëpitë e tyre. Arbën Xhaferi këtë e dëshmon edhe në një intervistë dhënë për gazetën “Nova Makedonija” më 30 qershor 1999, ku ndër të tjera thotë se, refugjatët kosovarë deri në fillim të gushtit të viti 1999, të gjithë do të kthehen në shtëpitë e tyre.¹⁹

¹⁹*Po aty.*

Se politika shtetërore maqedonase, ose segmente të saja të caktuara ishin në funksion të realizimit të planit të Millosheviqit nëpërmjet mbylljes së kufirit me Kosovën, dëshmon edhe rasti i krizës në fshatin Bllacë.

Edhe pas 20 vjetësh parashtrohet pyetje se pse ndodhi rasti i Bllacës?

Trajtimi në Bllacë ishte tejet nënçmues e nënshtues. Sindromi i Bllacës ishte paragjykim i thellë, stereotip i një mentalitet ksenofob. A ndodhi kjo për shkak të paaftësisë së faktorit politik në pushtet dhe dobësisë në organizim, apo për shkak të sabotimit të disa strukturave të brendshme të shtetit që dëshironin ta përfshijnë Maqedoninë në grykën e krizës së përgjithshme ballkanike, apo ishte ndonjë strategji që Bllaca të jetë lajm i botës për t'i treguar asaj për pastrimin etnik që bëhej në zemër të Evropës, e me këtë të arsyetohet intervenimi i NATO-s në Kosovë karshi opinionit botëror, mbetet të shihet në studime më serioze që kërkojnë kohë.

Pas një trysnie të fuqishme nga ana e qytetarëve shqiptarë në Maqedoni, Qeveria e saj detyrohet që të sjellë vendim për formimin e disa kampeve për vendosjen e refugjatëve kosovarë.

Sipas statistikave oficiale të “Kryqit të Kuq” të Maqedonisë në periudhën gusht-dhjetor të vitit 1998 në Maqedoni, mbështetje nga “Kryqit i Kuq” kishin kërkuar vetëm 800 refugjatë, ndërsa me fillimin e vitit 1999, numri i tyre dukshëm do të rritet. Numri i përgjithshëm i personave që kanë marrë mbështetje nga ana e “Kryqit të Kuq” gjatë krizës kosovare ishte rreth 440 000 persona, ndërsa ne mendojmë se numri i tyre mund të jetë edhe më i madh, për shkak se shumë familje, që në Maqedoni kanë hyrë jo nga vendkalimet kufitare në Bllacë e Jazhincë, ku kryesisht është bërë edhe regjistrimi i tyre,

kanë hezituar të paraqiten në zyrat e “Kryqit të Kuq”, për faktin se shqiptarët e Maqedonisë hezitonin t’i paraqesin familjarët e tyre të ardhur nga Kosova si refugjatë, por ata i trajtonin si mysafirë. Ndërsa, numri i përgjithshëm i qytetarëve kosovarë që kanë braktisur Kosovën gjatë luftës, sipas “Kryqit të Kuq” të Maqedonisë ka arritur në 920 000.

Nga 440 000 mijë refugjatë të ardhur në Maqedoni, gjithnjë sipas “Kryqit të Kuq” të Maqedonisë, 60% e tyre ishin vendosur në familje private, ndërsa pjesa tjetër e refugjatëve ishte vendosur në kampet: Stenkovec, Bojanë, Çegran, Radushë, dhe në disa pushimore dhe qendra të “Kryqit të Kuq” të Maqedonisë.

Deri në fund të verës së vitit 1999, sipas informatave zyrtare të “Kryqit të Kuq” të Maqedonisë, 70% e refugjatëve kosovarë janë kthyer në shtëpitë e tyre, ose kanë shkuar në vende të treta. Sot në Maqedoni, si refugjatë nga kriza e Kosovës kanë mbetur rreth 1500 persona, ku 99% e tyre janë të komunitetit rom, që për arsye të ndryshme nuk mund të kthehen në shtëpitë e tyre.

Isamedin Azizi

SUMMARY

During the process of disintegration of Yugoslavia ,the Albanians from Macedonia as Albanians of Kosovo, will face with ongoing crises. Depending on how political and military activities were developing in the region, state violence was increasing against the Albanians of Macedonia , which will culminate in armed warfare in 2001.

Due to escalation of the situation in 1998 in Kosovo, leaders of political parties in Macedonia will coordinate their political actions looking forward international factor that will (intervene) in Kosovo, since according them Kosovo was slowly going towards war and every conflict from Kosovo would have direct impact also in Macedonia. As the results of this, in June 1998 the Albanians of Macedonia will organize massive protest with the motto “Nato in Kosovo“.

The Albanians of Macedonia in the war of Kosovo will be implicated in three phases: through manifestation of political solidarity, through financial and humanitarian assistance, and through military dimensions or active participation of combat formations in Kosovo. Escalation of combat in Kosovo, had (rapid or fast) reflections in Macedonia as well.

Macedonian state policies were openly against the arrival of the Albanians of Kosovo refugees in Macedonia ,with the justification that the state does now have enough capacity to face the situation. But after a strong civic pressure, Macedonia was forced to make a

decision for organization of several camps for the placement of Albanians Kosovo refugees. According to the official data of Macedonian red cross, the total number of the Albanians refugees in Macedonia, were about 440.000 people, which from 60% of them were placed in private families, while the rest of them were settled in the camps at Stenkovec, Bojanë, Cegran, Radushë, in some resorts and centres of the Macedonian red cross.

Yüksel Hoş¹

Analizë politike dhe socio-kulturore e qasjes së medias turke ndaj luftës së Kosovës për pavarësi

Media gjithmonë ka qenë një mjet informimi për masën kur kanë ndodhur ngjarjet (luftërat, të drejtat e njeriut, shpërnguljet etj.) që i kanë dhënë formim gjeografisë politike në mbar botën. Përveç që është një mjet informimi, media është gjithashtu një mjet propagandistik, dhe kanë dy karakteristika të kundërta që: ose i bëjnë masat e vetëdijshme, ose manipulojnë. Ekzistojnë tre lloje mediash: media audio-vizuale, media e shkruar dhe media e internetit. Kur analizohet zhvillimi historik i mediave, shihet se gazetatat të cilat më parë ishin shtypur nga shteti, më vonë u morën nga ndërmarrjet private. Në vendet komuniste, dhe në disa diktatura dhe demokracitë arabe, media është në ndikim të monopolit shtetëror dhe nuk mund të jetë e zëshme në këto vende. Zëshmëria nuk është diçka që shihet në demokracitë perëndimore. Në fakt, vihet në dyshim se në çfarë mase është “kaq e zëshme media?”, ngaqë në demokracitë perëndimore shumica e mediave janë blerë nga kompanitë globale të shtypit. Në vitin 1990, me ndikimin e globalizmit kemi zhvillimin e industrisë së medias. Në veçanti disa kompani gjigande të tilla, si: FOX, Disney, American Online, Time Warner, Viacom, General Electric, News

¹¹Universiteti i Trakjas - Instituti i Kërkimeve të Ballkanit.

Corporation, Sony, AT & T dhe Bertelsmann, janë shembuj² të këtyre perandorive të medias. Megjithatë, në shtete si Turqia mund të kemi media të pavarura nga “kapitalizmi global”. Këto lloje mediash reflektojnë shumëzeshmërinë në Turqi, gjithashtu na tregojnë që ka një diversitet të madh midis grupeve të ndryshme ideologjike, politike, fetare dhe sociale. S’duhet harruar që media është një biznes me formën e tij të veçantë. Për bizneset, lexuesi është një “klient” dhe sipas pikëpamjeve politike të lexuesve, çdo organ mediatik është një “biznes”, kurse gazetat, programet televiziv dhe lajmet janë “produkt”. Produkti vlerësohet për sa kohë që korrespondon me ndjekësit politikë të asaj medie. Është e natyrshme që të shpjegohet kjo gjë me shumëzeshmërinë politike.

Kjo shumëzeshmëri ka qenë që në kohën e Perandorisë Osmane. Gazeta e parë zyrtare e shtetit ka qenë “Takvimi i Vekaji” e shtypur në vitin 1831, në kohën e Sulltan Mahmutit II. Në fakt, gazeta e parë në Perandorinë Osmane ka qenë “Vekaji Misrije” e shtypur nga shqiptari Mehmet Ali Pasha në Egjipt. Pas këtyre dy gazetave, kemi media (gazeta) të hapura njëra pas tjetrës. Gazeta më aktive ka qenë “Tanin”, e shtypur nga Partia e Bashkimit dhe Progresit, e cila dilte kundër autoritetit të Sulltanit. Kishte gjithashtu gazeta të shtypur nga të gjitha llojet e grupeve minoritare, grupeve politike dhe madje edhe komuniteteve që kundërshtonin hapur ekzistencën e shtetit. Në Perandorinë Osmane, e cila ishte një vend monarkik, liria e medias ishte një lloj lirie që mund të jetë një shembull edhe për kohët

² Sarı, G. (2017), Türkiye’de Özel Televizyon Yayıncılığının Gelişimi ve Medyada Mülkiyet Yapısı. Volume 5, Issue 18 s. 2089.

moderne (përveç në kohën e Abdylhamitit II).³ Në periudhën e Republikës së Turqisë, mediat kanë arritur progres në arenën kombëtare, në fillim kryesisht në kontrollin e shtetit, e me zhvillimin e demokracisë dhe me ekzistencën e ndërmarrjeve private, media është pasuruar dhe është përforcuar. Në fushën e medias auditoriale dhe vizuale, i vetmi stacion ka qenë stacioni shtetëror TRT në Turqi, i cili filloi të luaj rol pas vitit 1990. Sepse me krijimin e radiove dhe televizioneve private në vitin 1990, ka filluar edhe shumëzshmëria në median audio-vizuale. Është e çuditshme që shqiptarët në Turqi nuk kanë pasur asnjë efekt mbi mediat turke gjatë kësaj periudhe. Sidoqoftë, nga figurat kosovare kemi gazetaren, Burbuqe Rushiti, që dinë turqisht mjaft mirë. B. Rushiti ka bërë të mundur që mediat kryesore të marrin informacione të besueshme dhe të sakta nga Kosova. Ndërsa, publiku turk gjithmonë ka qëndruar pranë popullit të Kosovës me një kujtesë historike. Vetëm një numër i vogël i mediave kanë mbajtur një qëndrim proserb në luftën e Kosovës. Me fjalë të tjera, disa grupe ekstremiste me pikëpamje të ndryshme politike, zgjodhën të përçojnë një histori të ndryshe të luftës në Kosovë nga pikëpamjet e tyre. Ky është një fakt i gjeografisë mediatike. Media, e cila tani është një aktor në gjeografinë politike botërore, ka një pozicion të rëndësishëm (figura 1). Sipas kësaj, media e cila është një aktor efektiv në një shtet, shndërron realitetin ekzistues në të dhëna dhe në informacion. Informacioni i gjeneruar në media bëhet “realiteti i preferencës”. Kjo d.m.th. transformim në gjeografinë politike që do të ndezë ose të pasivizojë njerëzit dhe masat. Gjithashtu, ka të bëjë se

³Taşbaş, Erdal., “Tanin Gazetesi ve Huseyin Cahitin Gorusleri Dogrultusunda Ittihat ve Terakki Politikolari 1908 1914” Volume: 15, Issue: 60, s: 205-217-218.

çfarë kërkon klienti i mediave? Dëshiron të lexojë lajmet në përputhje me pikëpamjet e tij politike apo të vërtetën? Në këtë rast, sa më politike të jetë media, aq më larg është nga vërteta.




Figura 1: Të dhënat në shtete: informacioni, transformimi i informacionit dhe efekti i medias ndaj transformimit.⁴

Media turke gjatë luftës në Kosovë

Qëndrimi i mediave turke ndaj kësaj lufte mund të shpjegohet në terma të përgjithshëm si “pro Kosovës”. Në mediat turke, transformimi i mësipërm nuk ka qenë shumë. Pra, lufta e Kosovës në Turqi, ka qenë “realitet ekzistues”. Sepse “realiteti i preferuar” nga masa, ka qenë të kuptojë tragjedinë ekzistuese. Gjithashtu, media kryesore nuk ka manipuluar ose nuk është munduar që të manipulojë çështjen. Arsyet kryesore për këtë janë:

- Lidhjet historike të Turqisë me shqiptarët dhe me Kosovën;
- Distanca gjeografike midis Kosovës dhe Turqisë;
- Qëndrimi i Qeverisë turke me popullin e Kosovës;

⁴Wellar, Berry., (2005) “Geography and the Media: Strengthening the Relationshi” Symposium on Projecting Geography in the Public Domain in Canada. p. 9.

- Komunikimi me burime të besueshme dhe burime të pasura për lajmet rreth Kosovës;
- Rritja e vetëdijes për gjeografinë ballkanike, me luftën e mëparshme në Bosnjë-Hercegovinë;
- Gjithashtu, për këto arsye mediat turke kanë qenë të interesuar për ngjarjet që kanë ndodhur në Kosovë.

Media e shtypit në Turqi

Në vitin 2013 tirazhi i përgjithshëm i 4.9 milionë gazetave ditore në Turqi, ka rënë në 2.8 milionë (38%).⁵ Nga këto gazeta të shtypura ditore, shiten 1.5 milionë (55%). Rreth 4 mijë e 500 lajme botohen çdo ditë në 41 gazeta të përditshme kombëtare. Këto shifra tregojnë madhësinë e medias së shtypit në Turqi. Gazetat kryesore në Turqi dhe tirazhet e tyre ditore janë si më poshtë (figura 2).

SABAH	SABAH	296.679	STAR	STAR	101.358	MILLI GAZETE	MILLI GAZETE	25.580
Hürriyet	HÜRRİYET	280.836	FANATİK	FANATIK	82.730	ÖZGÜR HABER	ÖZGÜR HABER	24.970
SOZCU	SOZCU	266.454	Yeni Birlik	YENİ BİRLİK	57.189	İSTİKLAL	İSTİKLAL	11.327
POSTA	POSTA	212.097	KORKUSUZ	KORKUSUZ	55.132	ÖZGÜR SUTUN	ÖZGÜR SUTUN	10.324
Milliyet	MİLLİYET	128.752	DIRİLİŞ POSTASI	DIRİLİŞ POSTASI	54.969	GÜLBAYRAK	GÜLBAYRAK	10.320
Türkiye	TÜRKİYE	125.463	KARAR	KARAR	52.361	YENİ SÖZ	YENİ SÖZ	10.290
Yeni Şafak	YENİ ŞAFAK	111.622	YENİ ÇAĞ	YENİ ÇAĞ	51.466	YENİ ASYA	YENİ ASYA	10.000
Takvim	TAKVİM	111.256	AYDINLIK	AYDINLIK	51.170	SÖK	SÖK	9.848
AKSAM	AKŞAM	103.888	MILAT	MILAT	50.750	DAILY SABAH	DAILY SABAH	8.588
GÜNEŞ	GÜNEŞ	103.790	HARBİ	HARBİ	50.192	BİRGÜN	BİRGÜN	7.540
fotoMuc	PAS FOTOMAÇ	102.590	Yeni Asır	YENİ ASIR	50.109	Yeni Mesaj	YENİ MESAJ	6.538
VATAN	VATAN	102.514	Cumhuriyet	CUMHURİYET	35.344	HÜRRİYET DAILY NEWS	HÜRRİYET DAILY NEWS	6.310
						AKR MERT KORKUSUZ	AKR MERT KORKUSUZ	6.056
						EVRENSEL	EVRENSEL	5.521
						ÖZGÜR DÜĞÜ	ÖZGÜR DÜĞÜ	3.021
						YURT	YURT	2.552

Figura 2: Gazetat kryesore që botohen në Turqi.⁶

⁵<http://www.milliyet.com.tr/turkiye-deki-gazetelerin-tiraji-yuzde-istanbul-yerelhaber-2952065/>

⁶<http://gazetetirajlari.com/>

Media e shkruar në Turqi për UÇK-në

Retorikët kryesorë, dallimet e titujve kryesorë i identifikonin anëtarët e UÇK-së me guerilë, luftëtarë, ushtarë. Konceptet që përdorën për të përshkruar pjesëtarët e UÇK-së nga organet e medias liberale zakonisht janë “luftëtarë”, kurse socialistët përdornin termin “guerilë”.

- **Guerilë:** është përdorur për disa luftëtarë në zona të caktuara të cilët kanë pak apo aspak afërsi historike me turqit, sikurse janë guerilët tamilë në Sri Lanka, apo guerilët zapatista në Meksikë.
- **Luftëtarë:** përdoret për fusha të veçanta ku njerëzit tregojnë respekt dhe vlerësim, si edhe mbështetin çështjet e tyre (luftëtarët vietnamezë kundër Amerikës. Ato të cilat luftojnë për atdheun).
- **Muxhahidë:** përdoret kryesisht për luftëtarët të cilët në i mbështesim ose ndiejmë afrimetet të plotë në kuptimin e afrimitetit fetar ose kombëtar, siç janë: muxhahidët boshnjakë, muxhahidët palestinezë, muxhahidët afganë, muxhahidët e Qipros Turke etj.



Figura 3: *Cumhuriyet* (ataturkist-kemalist). Etiket: “Guerilë” (31.07.1998).⁷

Në këtë lajm gazeta bën lidhjen e liberalëve të Kosovës së bashku me disa “**ekstremistë islamikë**”. Në lajmin e mësipërm është shkruar: “Rexhep Daçaj, i plagosur me plumb nga një serb, mbahet nën mbikëqyrjen e islamikëve shariatistë që banojnë në Stamboll, diku në Fatih”. Po e njëjta gazetë, gjithashtu ishte kundër copëzimit të Jugosllavisë, duke akuzuar të gjitha udhëheqjet etnike. Kjo gazetë shet mesatarisht 30 mijë kopje çdo ditë.

⁷ Arkivi online i gazetës “Cumhuriyet”, 31.07.1998.



Figura 4: *Milliyet* (ataturkist - socialdemokrat). Etiketë: “Guerilë” (22.04.1999).⁸

Në këtë lajm, gazeta njofton rreth kërkesës për armë të guerilëve të UÇK-së. Termi “gueril”, “Duke përfaqësuar një pikëpamje të butë ndaj luftëtarëve të UÇK-së, “Milliyet” gjithashtu tregon një qëndrim “neutral” midis palëve, asaj shqiptare dhe serbe, e duke mos i përshkruar serbët si “agresorë”. Kjo gazetë shet mesatarisht 130 mijë kopje çdo ditë. Gjithashtu është gazeta me pikëpamje më mesatare midis gazetave tjera që kanë analizuar luftën e Kosovës. Pyetja e vetme që duhet të bëhet këtu, është: “Çfarë d.m.th. të shikohen gjërat në një pikëpamje të përbashkët midis agresorit dhe viktimës”? Megjithatë, pyetja që duhet shtruar këtu, është: “Ç’do të thotë që në raste masakrash, të kesh vështirë të baraslarguar mes agresorit dhe viktimës”?

⁸ Arkivi online i gazetës “Milliyet”, 22.04.1999.



Figura 5: *Evrensel* (marksist-komunist). Etiketë: “Anëtarët e UÇK-së”.⁹

Kjo gazetë në mënyrë sistematike shpërndan pretendimet serbe mbi Kosovën dhe një retorikë që “janë masakruar 14 civilë serbë...”, ndërsa në disa lajme në këtë gazetë, thuhet se shqiptarët janë “agresorë”. “Sipas serbëve, armiqet e rinj të UÇK-së, janë minoritetet e Kosovës. Qyteti i Prizrenit, i njohur si kryeqyteti i tolerancës, tashmë tronditet nga dhuna kundër minoriteteve nga UÇK-ja dhe grupeve të lidhura”. UÇK-ja është përgjegjëse për sulmet ndaj civilëve. “E ashtuquajtura Ushtria Çlirimtare e Kosovës e cila kontribuoi me një përpjekje të madhe për imperialistët për të marrë kontrollin e Kosovës, tani kryen sulmet e saj në territoret serbe”, 28.02.2000.

⁹ Arkivi online i gazetës “Evrensel”, 28.02.2000.



Figura 6: *Yeni Şafak* (Konservativİslamiste) Etiket: “Kryengritës” (19.06.1999)-(21.04.1999).

Kjo gazetë zakonisht përqendrohet në çështjen e etiketimit të shqiptarëve si një viktimë e kombit myslimanqë i nënvizon ata në “shqiptarë myslimanë” dhe më interesantja është se nuk i etiketojnë ato si muxhahidë, por shpesh përsërisin fjalën “kryengritës” (Direnışçi). Sot, gazeta njihet si organi më i afërt i medias që mbështet partinë e presidentit të Turqisë. Kjo gazetë shet 110 000 kopje çdo ditë dhe kishte një tirazh shumë më të ulët gjatë luftës në Kosovë, të viteve 1998-1999. Kjo gazetë u themelua me shqetësimin për të tërhequr intelektualët islamikë dhe për këtë arsye ka pasur një gjuhë më të butë se sa gazetatat tjera islamike. Gjithashtu, islamikët në këtë periudhë nuk kanë qenë në pushtet në Turqi dhe mund të themi që ka pasur një presion sipër tyre. “Yeni Şafak” është një ndër gazetatat që kanë përfaqësuar një ideologji që ka qenë në opozitë në atë periudhë.




Figura 7: Türkiye (konservatore, kombëtare, islamike). Etiketë: “Ushtarët e UÇK-së” (26.04.1999).¹⁰

Kjo gazetë dhe kanali televiziv i lidhur me të, ishte i njohur si organi mediatik i një grupi mysliman “ışıkçılar” (duke marrë emrin nga udhëheqësi shpirtëror, Hysein Hilmi Eshek, me origjinë boshnjake) dhe i famshëm për të qenë media me e interesuar për Ballkanin, gazeta kishte një politikë të rreptë për t’i thirrur serbët si “çetnikë” dhe luftëtarët e UÇK-së, ose “ushtarë të UÇK-së” si një ushtri e rregullt dhe e njohur. Përveç kësaj, gazeta po përhapte një

¹⁰ Arkivi online i gazetës “Türkiye”, 26.04.1999.

ndërgjegjësim publik dhe heroizëm për UÇK-në dhe denoncoi masakrat serbe kundër shqiptarëve. Ky komunitet dhe organi i këtyre mediave, sot janë në rënie. Kjo gazetë shiste çdo ditë përafërsisht 135 000 kopje dhe ka pasur gjithmonë marrëdhënie miqësore pothuajse me çdo qeveri në Turqi.



Figura 8: *Hürriyet* (Liberal-Democrat-Left-Ataturkist) Etiketë: “Luftëtarë” (19.04.1999).¹¹

Një shembull tjetër është gazeta “Hürriyet”. Pozita e kësaj gazete për Kosovën është jashtëzakonisht interesante. Vëmendja e gazetës më shumë është për detaje të vogla se sa për tragjedinë e Kosovës.

¹¹ Arkivi online i gazetës “Türkiye”, 26.04.1999.

Ndërsa, media kryesore liberale “Hürriyet”, ishte gjithmonë një gazetë prokapitaliste, duke i quajtur anëtarët e UÇK-së si “luftëtarë”, e serbët duke i quajtur si “zyrtarë jugosllavë” ose “qeveri jugosllave” ose “ushtri jugosllave”. Kur lajmet analizohen me kujdes, është e qartë se UÇK-ja dhe lufta e saj janë injoruar me disa fjalë të cilat gazetatat më së shumti kanë dashur të tregojnë paraqitjen luksoze të komandantëve të UÇK-së, duke nënvizuar telefonin e dobishëm *Ericsson*, xhipin dhe mjetet 4x4 në shumë pjesë të artikullit. Në këtë artikull, gazetari pretendonte të shihte një luftëtar të pajisur me armë, por u trondit kur pa një burrë që quhej Xhavit Haliti, i cili dilte nga një xhip 4x4 dhe kishte një telefon të kromuar *Ericsson*. Gazeta ka qenë gjithmonë kundër popullit konservator dhe fetar të Turqisë, deri në vitet e fundit kur është dorëzuar. Gazeta u bë flamuri i shtypit turk me një tirazh prej 285 mijë dhe njihet për marrëdhëniet e mira me kapitalistët turk. Ajo ka pasur një lloj aleance me institucione të tilla, si TÜSIAD (Shoqata e Biznesmenëve dhe Industrialistëve të Turqisë).

Media vizuale dhe radio

Në Turqi, ka 553 kanale televizive dhe 1 120 stacione radiosho (jovizuale). Nëse nevojitet të grupohen sipas mjediseve nga të cilat orientohen në aspektet politike, fetare e sociologjike, shpërndarja e tyre është si më poshtë: 33% nostalgjike (përfshirë edhe mediat shtetërore), 18% liberale, 14% kombëtare, 13% nga pikëpamja e diasporës, 11% vetëm turistike, e tjera.




Figura 9:Türkiye’dekiGörüntülü ve Sesli Medyanın Hedef Kitlesine (ndikues) Göre Dağılımı.

Pikëpamja e medias turke (vizuale) në lidhje me çlirimin e Kosovës: 49% përfaqësohet të interesuar (nostalgjikë, fetarë, kombëtarë), 29 % të interesuar (demokratët, liberalët, socialdemokratët), 13 % të interesuar nga pikëpamje socialiste (socialdemokratët & socialistët), 9 % aspak të interesuar.




Figura 10: Türk Medyasının Kosova Savaşına Olan İlgi.

Interesimi i popullit turk për Kosovën dhe lufta në Kosovë u bë edhe përmes një anketimi. Përgjigjet në këtë anketë tregojnë se njerëzit kanë lidhje me Kosovën. Më shumë se gjysma e njerëzve dinë për vendndodhjen e Kosovës, ndërsa 15% pothuajse nuk dinë asnjë gjë për Kosovën.




Figura 11: I është bërë pyetje popullit turk ku ndodhet Kosova (2 330 persona).¹²




Figura 12: I është bërë pyetje popullit turk: Çfarë nënkupton Kosova për ju?

¹² Anketimi i zhvilluar midis datave 20.08.2018-27.08.2018.




Figura 13: I është bërë pyetje popullit turk: A do të luftonit për shqiptarët?

15% deri 17% e kësaj tablele ka të bëjë me përgjigjet nga Anadolli Qendror dhe Lindor dhe Anadolli Juglindor, ku turqit kanë pak vëmendje për Kosovën. Njohja e Kosovës fillon të bie duke filluar nga Turqia e Mesme, pothuajse e panjohur në shume zona në vendet lindore dhe juglindore të Turqisë. Kjo lidhet gjithashtu me faktin se këto rajone janë zona ku kosovarët nuk kanë migruar shumë. Për disa qytetarë turq me origjinë kurde me tendenca të ndryshme, Kosova nuk do të thotë asgjë, ndërsa për qytetarët turq me origjinë kurde dhe reflekse islame, Kosova është një vend vëlla dhe shqiptarët e Kosovës janë si vëllezër. Për turqit, ekzistojnë tri pikëpamje të ndryshme për Kosovën. Këto janë:

1. Turqit që kanë një ndjenjë vëllazërore për Kosovën për shkak të historisë së tyre osmane edhe pse nuk janë me origjinë nga Kosova.
2. Afërsia, dashuria dhe përkatësia për Kosovën nga qytetarët turq me origjinë kosovare, shqiptare.

3. Ndjenja e një vendi vëllezër të paqartë, shpesh të zbehtë të përfaqësuar nga grupe laike dhe kemaliste.

Media e internetit dhe media sociale

Nga mbi 17 000 webfaqe të internetit mbi 150 000 lajme të reja futen (në internet).¹³ 85% e portaleve në Turqi, janë në pronësi të kompanive udhëheqëse mediatike. Ka disa nga ato të cilat janë të pavarura dhe të rëndësishme, sepse nuk kanë asnjë lidhje me ndonjë kompani, si p.sh.: Odatv, Mediascope dhe Mynet.

¹³<http://www.bursadabugun.com/haber/turkiye-deki-gazetelerin-tiraji-azaldi-990005.html>

Yüksel Hoş

SUMMARY

Political and socio-cultural analysis - Turkish media approach to Kosovo's struggle for independence

The events "the Turkish flag was burned in Kosovo" or "the Turkish symbol was damaged in Albania", should not be attributed to all Albanians or Kosovans, similarly an article in Turkish media doesn't mean that Turkish people think negatively about Kosovo, taking into account the large population of Turkey embracing various groups and cultures. However, Kosovo and Turkey are two separate and sovereign countries. The Turkish interest in Kosovo are: Kosovo's stability, coexistence of society in peace and harmony, and prosperity of Turkish population in Kosovo. Although, Turkey has not expansionist aims in Kosovo, some anti-Turkish circles may want to demonstrate the opposition, or that "Turkey has expansionist aims". Certainly, some people might have spoken ill about the Turkish society in general, and this may serve as a reply to them. The Turkish printed media, which has a circulation of 2-5 million, from time to time demonstrates a huge diversity, including a large series of factions. There are currently 553 TV channels in the country. In addition, there are more than 40 newspapers with significant circulation. In case these TV channels, newspapers and radios would be subject of classification, then we would have following classification: state media, conservative media, republican media

(Kemalist or Atatürk), national media, national religious media, national socialist media, non-religious national media, religious media, Shiite religious media, socialist media, liberal media, social-democratic media, democratic media, ethnic media (socialist, national and religious), minority media, Sufi media. The approach of this media towards the War in Kosovo was direct and proportional. In general the Turkish people have a positive, fraternal and supportive approach towards the Kosovo and Albanians. This public support was also shown in the policy of Republic of Turkey, as a state policy. Turkey continues to be close to Kosovo in every platform or situation. Turkey is a friendly country for Kosovo; if we observe, in general there is no negative attitude against Kosovo and Albanians in the Turkish media, and even the Turkish nationalist circles do not show any negative attitude. Unfortunately, some communist media (there are few) have pro-Serbian and anti-Kosovan tendencies. It must be taken into account that these newspapers represents extremely minority groups. Furthermore, various polls indicate that these press has a very small circulation. Turkey has tried to support Kosovo since the time of the liberation war. Turkey is also trying to support Kosovo through various infrastructural and economic investments, aiming to help Kosovo to build a stable economy. All these could be a subject of another research or study. TIKA and Eximbank have invested a lot; in addition to student scholarship there is a need for other projects and works, but this part is proportional to the current economic situation in Turkey. However, we could not minimize the works that have been done. Additionally, the lack or abundance of current investments may be subject of critics, but you should not forget that Turkey is an important investing factor in Kosovo.

Armend Mehmeti

**Qëndrimi i klasës politike të Kosovës ndaj ndryshimeve
kushtetuese të vitit 1989**

Procesi i decentralizimit të Jugosllavisë që u manifestua me Kushtetutën e vitit 1974, kishte shkaktuar një pakënaqësi tek qarqet politike dhe intelektuale serbe. Kompetencat që kjo Kushtetutë ua njohu krahinave autonome, sikurse: e drejta për të miratuar apo ndryshuar kushtetutën e saj; e drejta për të vendosur për kufijtë e saj; e drejta e organizimit autonom të qeverisjes; e drejta për rregullimin e funksioneve kushtetuese; pavarësia e sistemit gjyqësor dhe e drejta e themelimit të gjykatës kushtetuese¹; autonomia në organizimin e sistemit gjyqësor; shërbimit e sigurisë publike dhe të mbrojtjes territoriale; sistemit arsimor, doganor dhe marrëdhënieve me jashtë, si dhe të qenit subjekt federativ i barabartë me republikat tjera me të drejtën e vetos dhe lidhja formale e jo hierarkie e Kosovës me Serbinë, i kishte bindur qarqet e lartcekura serbe se Kosova ishte vetëm një hap larg transformimit në një subjekt të pavarur nga Serbia që mund të realizohej në rrethana të përshtatshme politike.

Por, brenga e qarqeve politike e intelektuale serbe nuk kishte të bënte vetëm me statusin e krahinave autonome. Shumë udhëheqës të Partisë Komuniste serbe e vështruan Kushtetutën e vitit 1974 në dy aspekte: (1) dobësim i pozitës së Serbisë në federatë apo në raport me republikat tjera, ngaqë kjo kushtetutë ia ndalonte Serbisë të ndërhynte

¹*Kosovo: pravo i politika, Kosovo u normativnim aktima pre i posle 1974. godine*, Helsinki odbor za ljudska prava u Srbiji, Beograd, 1998, f. 10-12.

në çështjet krahinore kundër vullnetit të kuvendeve krahinore në Prishtinë e Novi Sad²; dhe (2) si thellim të ndarjes së kombit serb, sepse kufijtë administrativë midis republikave mund të merrnin tipare shtetërore dhe në rast të shpërbërjes së Jugosllavisë serbët do të copëtoheshin në pesë shtete. Në Serbi, shumica kushtetutën e re e konsideruan si ftesë për serbët që të luftojnë për “identitetin dhe integritetin e rrezikuar kombëtar”. Njëkohësisht qarqet nacionaliste serbe filluan të shtjellojnë teza të ndryshme kombëtare që do të çonin në promovimin e programit nacional serb.³

Në këto rrethana, elita politike serbe ende pa kaluar një vit nga miratimi i kushtetutës, filloi me veprimet politike për ta ndryshuar kushtetutën. Në janar të 1975, Kryesia e Republikës Socialiste të Serbisë kërkoi zyrtarisht rishikimin e kësaj kushtetute. Ndër arsyt kryesore për rishikimin e saj ishin: jo uniteti i Serbisë i promovuar nga kjo kushtetutë dhe ishte vetëm Serbia, në mesin e njësisë federale, që nuk e kishte siguruar “të drejtën e saj historike për një shtet kombëtar” në mesin e Federatës jugosllave.⁴ Në vazhden e këtyre përpjekjeve, lidërshipi serb bëri thirrje për ndryshimin e statusit të republikës, respektivisht për rikthimin e krahinave nën juridiksionin e saj të plotë. Nevoja për këto ndryshime u parashtrua përmes “Librit të kaltër”, i vitit 1977, që ishte sekret për opinionin

² Miranda Vickers, *Midis serbëve dhe shqiptarëve*, Botimet Toena, Tiranë, 2004, f. 219.

³ Sonja Biserko, “Srpska elita i realizacija srpskog nacionalnog programa”, Ćosićev Rat, Zbornik radova sa naučne i stručne rasprave o knjizi “Bosanski Rat” Dobrice Ćosića, održane 3. Maja 2012 godine u Rektoratu Univerziteta u Sarajevu, Sarajevo 2013, f. 96-97.

⁴ Momčilo Pavlović, “Kosovo under autonomy 1974-1990”, *Research Team 1*, <https://www.cla.purdue.edu/si/Team1Reporte.pdf>, f. 22.

publik. Por, tentativat serbe hasën në reagimin negativ të qarqeve jugosllave të kohës, përfshirë edhe lidhshin shqiptar të Kosovës. Pas takimit midis Titos, përfaqësuesve të Lidhjes Komuniste të Serbisë, të Vojvodinës e të Kosovës, Tito doli me qëndrimin për mosndryshimin e pozitës së krahinave në Jugosllavi. Në këtë mënyrë, ai mbrojti parimin e balancës etnike dhe dobësimin të fuqisë së njësisë më të madhe federative dhe të aspiratave të saj për centralizim dhe unitarizëm.⁵

Pajtimi i qarqeve politike serbe me arbitrazhin e Titos kishte qenë i përkohshëm. Tentativat për rishikimin e Kushtetutës së vitit 1974, do të marrin një dimension të ri pas vdekjes së Titos dhe demonstratave shqiptare të vitit 1981. Shpallja e gjendjes së jashtëzakonshme dhe fillimi i diferencimit ideopolitik në Kosovë i krijuan avantazhe klasës politike serbe e cila vazhdoi me projektin e saj kushtetues. Tentativat konkrete në këtë drejtim paraqiten në tetor të vitit 1984 kur në emër të pakos gjithëpërfshirëse të “reformave” të propozuara nga subjektet republikane, Lidhja Komuniste e Serbisë paraqiti programin prej katër pjesësh që ndër të tjera parashihte forcimin e qeverisë federale dhe reduktimin e të drejtave të veçanta dhe të autonomisë së përgjithshme të dy krahinave autonome. Kërkesa e fundit arsyetohej me argumentin se republika kishte vështirësi specifike në miratimin e ligjeve të rëndësishme, dhe se krahinat po i shkaktonin asaj obstrukcione. Ky qëndrim u mbrojt hapur në mbledhjen e Kryesisë së Komitetit Qendror të Lidhjes Komuniste të Jugosllavisë (më tej: KQ LKJ), nëntor 1984, nga DushanÇkrebiq, anëtar i kësaj Kryesie. Por, një prononcim i tillë i mbështetur edhe nga kryetari i Lidhjes Komuniste të Serbisë,

⁵ Po aty, f. 22.

PetarStamboliq, hasi në reagimin e fuqishëm nga delegatët e dy krahinave, të cilët në përgjigje i karakterizuan propozimet serbe si “*të nxituara dhe të pastudiuara mjaftueshëm*”.⁶

Refuzimi i krahinave nuk i kishte dekurajuar qarqet politike të Serbisë, të cilat tentuan t’i përdorin edhe mekanizmat ndërkombëtarë në arritjen e qëllimit të saj. Gjatë mesit të viteve 1980 Jugosllavia po përballej me një krizë ekonomike gjithnjë në rritje. Ndër shkaqet kryesore të kësaj krize renditen deficitit tregtar dhe rritja e borxhit të jashtëm, i cili më 1980 shkonte deri në 15 miliardë dollarë, kurse inflacioni arriti masën prej 20%.⁷ Në përpjekje për të dalë nga kriza, Jugosllavia u orientua kah Fondi Monetar Ndërkombëtar në kërkim të një kredie. Por, institucioni në fjalë, pasi shqyrtoi rrethanat ekonomike dhe politike në të cilat gjendej Jugosllavia, ofrimin e kredisë e kushtëzoi me heqjen e vetos në nivel federal, e në veçanti heqjen e vetos nga krahinat. Këtë kusht Stamboliqi u përpoq ta shfrytëzonte për t’i bindur republikat tjera në nevojën e ndryshimeve kushtetuese, të cilat kishin frikë se ndryshimet kushtetuese mund të hapnin çështje të reja apo të cenonin gjendjen politike në territoret e tyre. Në këtë mënyrë, gjatë viteve 1985/86, ai bëri përpjekje të vazhdueshme në këtë drejtim, derisa arriti t’i bindë njësitë federale për miratimin e nismës për ndryshime kushtetuese të vetëm atyre pjesëve në kushtetutën e Jugosllavisë që kishin të bënin me raportet e krahinave me Serbinë dhe Federatën.⁸

⁶Sabrina P. Ramet, *The Disintegration of Yugoslavia from the death of Tito to the War for Kosovo*, Westview Press, 1999, f. 14.

⁷Viktor Meier, *Fundi i Jugosllavisë*, Liria, Lubjanë, 2007, f. 25.

⁸S. Biserko, “Srpska elita i realizacija srpskog nacionalnog programa...”, f. 127.

Pas një debati dyvjeçar midis mbrojtësve të gjendjes aktuale dhe reformatorëve, pas një presioni të fuqishëm nga Fondi Monetar Ndërkombëtar, Kryesia e KQ LKJ më 21 janar 1987, u propozoi republikave dhe Kuvendit Federativ ndryshimin e 120 amendamenteve në Kushtetutën e vitit 1974, të cilat do të dilnin në diskutim publik tek në shtator. Por, vetëm dhjetë ditë pas paraqitjes së fjalimit të tij në Kuvendin e Serbisë mbi propozimet për ndryshimin e gjendjes kushtetuese të krahinave, në shtator 1987, Stamboliqi pësoi disfatë të rëndë politike në mbledhjen e tetë të Komitetit Qendror të Lidhjes Komuniste të Serbisë.⁹

Rënia e Stamboliqit ishte rezultat i një klime ekstreme nacionaliste zanafilla e së cilës datonte që nga ndryshimet kushtetuese të vitit 1968, kur qarqet intelektuale nacionaliste e kishtarë serbe kishin filluar organizimin e fshehtë i cili do të merrte tipare mobilizuese kah mesi i viteve 1980. Ishte kjo, ajo lulja serbe me tre fletë (Lidhja e Shkrimtarëve të Serbisë-Akademia Serbe e Shkencave e Arteve-Kisha Ortodokse Serbe), era dehëse e së cilës shumë serbëve do t'ua merrte mendjen.¹⁰ Veprimtaria propagandistike e këtij trekëndëshi mbi shpërnguljet e serbëve nga Kosova, gjendjen e padurueshme të tyre dhe krime të ndryshme kundër tyre të ushtruara nga shqiptarët, duke instrumentalizuar lëvizjen serbe në Kosovë, dhe pozitën e pabarabartë të Serbisë e të popullit serb në Jugosllavi, kishte

⁹Rade Dragović, *Osmasednica CK KP Srbije*, Fejton elektronik, http://www.novosti.rs/dodatni_sadržaj/clanci.119.html:686773-Terror-nad-Srbima-na-Kosovu_qasja_15_maj_2019.

¹⁰Millorad Tomaniq, *Kisha serbe në luftë dhe luftërat brenda saj*, Camaj-Pipa, Shkodër, 2006, f. 16.

arritur kulmin me Memorandumin* e vitit 1986 të Akademisë Serbe të Shkencave dhe Arteve.

Në këto rrethana, në skenën politike të Serbisë paraqitet Slobodan Millosheviqi, i cili shquhej për kah energjia dhe vendosmëria, tipare këto që konsideroheshin shpresëdhënëse nga qarqet nacionaliste serbe në mundësinë e centralizimit të serishëm të Jugosllavisë dhe në zbatimin e këtij plani që paraprakisht ishte përgatitur nga qarqet akademike, kishtare, partiake dhe ushtarake serbe.¹¹

Paraqitja e Millosheviqit shoqërohet edhe me një fakt interesant. Klasa politike e Kosovës kishte qëndruar neutrale në ballafaqimet e brendshme politike në Serbi me besimin se qoftë Millosheviqi apo Stamboliqi, kanë qëllim të njëjtë ndaj Kosovës. Në një intervistë dhënë javores “Zëri i Rinisë”, ish-Kryetari i Kryesisë së Kosovës, Remzi Kolgeci, jep të kuptohet për mungesën e vizionit politik të klasës politike të Kosovës, pasi ajo në kuadër të institucioneve të kohës nuk kishte bërë asnjë analizë mbi efektet e këtyre ndryshimeve. Mungesa e vizionit dhe parashikimit të zhvillimeve përforcohet edhe më tepër me heshtjen e krerëve politikë shqiptarë në Kosovë në fushatën denigruese serbe kundër Fadil

* Memorandumi i vitit 1986 i hartuar nga ASSHA theksin kryesor e vë tek problemet që lindën nga decentralizimi i Jugosllavisë dhe statusi i Serbisë dhe popullit serb në Federatën Jugosllave. Duke pretenduar se Serbia dhe serbët ishin dëmtuar në gjitha aspektet në Jugosllavi, nën parullën e restaurimit të padrejtësive ndaj serbëve, Memorandumi do të shndërrohet në një nxitës të politikës serbomadhe në rajon që rezultoi me luftëra dhe viktima të shumta si shkak i agresionit serb...për më tepër rreth Memorandumit shih: Kosta Mihailovic, Vasilije Krstic, *Memorandum of the Serbian Academy of Sciences and Arts - Answers to Criticisms*, Serbian Academy of Sciences and Arts, Belgrade, 1995.

¹¹ S. Biserko, “Srpska elita i realizacija srpskog nacionalnog programa...”, f. 128.

Hoxhës.¹² Fushata ndaj tij nuk kishte qenë e rastësishme, por e projektuar me kujdes dhe hakmarrje ndaj kontributit të tij në arritjen e autonomisë së Kosovës, progresit të Kosovës në gjitha fushat, duke qenë njëkohësisht edhe zëri më i fuqishëm kundër përpjekjeve të elitës politike serbe për ndryshimin e Kushtetutës së vitit 1974.¹³

Këto qëndrime paraqesin fillimin e thyerjes së klasës politike shqiptare të Kosovës, që do të thellohet gradualisht krahas forcimit të pozitës së Millosheviqit në krye të elitës politike serbe. Në fakt, Millosheviqi ishte i pari politikan komunist serb që kishte guximin të shfrytëzojë ndjenjat e pakënaqësisë midis serbëve duke hartuar një strategji politike për Kosovën bazuar në atë çfarë shihej si interesi nacional serb. Mënyra e tij e arsyetimit ishte e thjeshtë: nëse Serbia nuk arrin ta rimerr kontrollin mbi Kosovën, atëherë ky do të jetë fundi i kombit serb. Vite më vonë, do të bëhej e qartë se Kosova kishte qenë vetëm fillimi i fushatës nacionaliste dhe ekspansioniste për t'i bashkuar “gjithë serbët në një shtet”.¹⁴

Në këtë mënyrë, ndryshimi i Kushtetutës së vitit 1974 bëhet çelësi i qëllimit të cekur më lart, pra të bashkimit të gjithë serbëve në një shtet. Kështu, që nga fundi i shtatorit 1987 dalin në diskutim publik projekt-propozimet për ndryshimet kushtetuese, të propozuara nga Kuvendi i Republikës së Serbisë. Në mesin e këtyre propozimeve pikat 15-21 përfshinin çështjet që kishin të bënin me raportet midis

¹²Zëri i Rinisë, nr. 1341, 12-19 maj 1990, f. 27.

¹³R. Dragović, *Osmasednica CK KP Srbije*, Fejton elektronik, http://www.novosti.rs/dodatni_sadržaj/clanci.119.html:686773-Terror-nad-Srbima-na-Kosovu_qasja_15_maj_2019.

¹⁴Nevenka Tromp Vrkić, “Kosovo and the desintegration of Yugoslavia”, *KosovoKosova, Confrontation or Coexistence*, edited by Greg Duijzing, Peace Research Centre, University of Nijmegen, 1996, f. 50.

krahinave dhe Serbisë, si: Serbia ta ketë planin unik të mbrojtjes në gjithë territorin e saj, përfshirë edhe krahinat; Serbia të ketë kompetenca të plota mbi sigurinë publike në gjithë territorin e saj; Prokuroria Publike e Serbisë të ketë kompetenca në gjithë territorin e saj; Serbia të ketë kompetenca të plota në politikën e jashtme, sistemi ligjor të jetë unik etj. Pavarësisht formulimit të këtyre pikave, qeveritarët në dy krahinat autonome ishin të bindur se prapa tyre fshihej rrënimi i autonomive krahinore. Prandaj, në mbledhjen e Kuvendit Krahinor të Vojvodinës, të mbajtur më 5 nëntor 1988, u hodhën poshtë shumica e këtyre pikave. Një qëndrim të njëjtë mbajti edhe Kosova. Komisioni kushtetues krahinor, ndonëse ishte për ndryshime kushtetuese, nuk ishte për ndryshimin e atyre dispozitave që cenonin autonominë e Kosovës. Qëndrimi i udhëheqjes së Kosovës acaroi klasën politike serbe në Beograd. Aleksandër Mitroviq, shef i Komisionit kushtetues republikan u shpreh me kritikë ndaj udhëheqjes krahinore e cila sipas tij, të gjitha organet republikane i konsideronte si organe të Serbisë së ngushtë: *“përmbajtja e dokumentacionit të parashtruar tregon qartë qëndrimin se krahinat po konsiderohen pjesë e R. të Serbisë vetëm në aspekt minimal të legjislacionit unik dhe përdorimit të disa formave dhe simboleve të caktuara, kurse në aspektin tjetër ato e konsiderojnë vetën të barabartë me republikën”*.¹⁵

Deklarata e mësipërme tregon këndvështrimin e klasës politike shqiptare mbi perceptimin e statusit juridik të krahinës. Në këtë frymë, Kuvendi i Kosovës miratoi më 6 nëntor 1987, propozimin

¹⁵ Kosta Nikolić, “Iliće Srbija biti republika, ili će prestat i da postoji”, Ustavne promene u Srbiji (I), Institut za Savemenu Istoriju, Beograd, Br. 2/2012, f. 167-168.

¹⁶ Rilindja, 7 nëntor 1987, f. 4.

për ndryshimin e Kushtetutës së Kosovës. Miratimi i këtyre ndryshimeve ishte i pjesshëm pasi që Kuvendi nuk i miratoi ato pika që shtrinin sovranitetin e Serbisë mbi Kosovën.¹⁶

Njëkohësisht vazhduan debatet mbi ndryshimet kushtetuese. Gjatë këtyre debateve del në pah një zhvillim interesant. Udhëheqja politike e Vojvodinës, edhe pse kryesisht e përbërë nga serbë, i rezistoi fuqishëm përpjekjeve të Beogradit për ndryshime kushtetuese, kurse pala kosovare qëndroi e përmbajtur.¹⁷ Arsytet e një qëndrimi të tillë mund të jenë të natyrave të ndryshme, sidomos presionit politik nga Beogradi. Sidoqoftë, qëndrimi i tillë i Vojvodinës bëri që Millosheviqi të ndërmarr masa për ballafaqimin përfundimtar me udhëheqjen e kësaj krahine. Në këtë mënyrë, që nga 9 korriku i vitit 1988, në qytete të ndryshme të Vojvodinës dhe Serbisë filluan mitingjet e solidaritetit me serbët nga Kosova.* Në fakt këto mitingje ishin forma presioni kundër udhëheqjes krahinore të Vojvodinës. Në ndërkohë, më 25 korrik 1988, Kuvendi i Serbisë i miratoi draft-propozimet për ndryshimin e amendamenteve kushtetuese të Republikës së Serbisë. Përmes këtyre amendamenteve duhet të sigurohej kushtetutshmëria në gjithë republikën. Tezat kryesore për këto ndryshime ishin se populli serb kishte të drejtë në republikë sikurse popujt tjerë dhe se autonomia e krahinave nuk guxon të cenojë shtetësinë e republikës dhe të funksioneve të saj unike. Duke tentuar t'i shmanget krijimit të pakënaqësisë në Serbi, e pjesërisht edhe për shkak të frikës nga ndryshimet e përgjithshme,

¹⁶ *Rilindja*, 7 nëntor 1987, f. 4.

¹⁷ K. Nikolić, "Iliće Srbija biti republika, ili će prestatida postoji...", f. 173.

* Në vitin 1988 u zhvilluan protesta të mëdha të popullatës serbe nëpër të gjitha viset e ish-Jugosllavisë nën parullën "E vërteta për Kosovën", duke aluduar se nuk kishte bashkëjetesë me shqiptarët, të cilët, sipas tyre, ishin terroristë nacionalistë, separatistë, dhunues etj. Për më tepër, shih: *Gazeta Zëri i Rinisë*, 1 tetor 1988...

Kryesia e KQ LKJ, më 30 shtator 1988, mbështeti ndryshimet kushtetuese në Serbi.¹⁸

Akti i mësipërm shënon kapitullimin e Federatës përballë Millosheviqit. Një akti i tillë i dha hov mitingjeve të solidaritetit në Vojvodinë. Qysh në ditët e para të tetorit, demonstruesit serbë qëndruan disa ditë përballë ndërtesës së qeverisë krahinore, derisa më 7 tetor 1988, udhëheqja e Vojvodinës dha dorëheqje kolektive.¹⁹

Ndryshimi i garniturës udhëheqëse në Vojvodinë dhe instalimi i vartësve të tij në pozita drejtuese të kësaj krahine i dha dorë të lirë Millosheviqit që vëmendjen ta drejtojë kah Kosova. Hapi i parë në këtë drejtim ishte shkatërrimi i garniturës udhëheqëse kosovare. Duke shfrytëzuar orientimin e përgjithshëm të KQ LKJ për ndryshime kuadroviqe, me pretekstin se udhëheqja krahinore nuk kishte punuar në përmirësimin e gjendjes në Kosovë, ashtu sikurse kishte kërkuar Plenumi IX dhe Mbledhja XVIII e KQ LKJ për përcaktimin e përgjegjësisë së secilit, në mbledhjen e Komitetit Krahinor të Lidhjes Komuniste të Kosovës të mbajtur më 17 nëntor 1988, vjen deri tek lirimi i Kaqusha Jasharit dhe Azem Vllasit nga funksionet e tyre si kryetare, respektivisht si anëtar i Kryesisë së Komitetit Krahinor të Lidhjes Komuniste të Kosovës.²⁰

Krahas figurave të cekura më lartë, nga pozitat politike u larguan edhe një numër funksionarësh shqiptarë. Klasa politike shqiptare hezitoi të reagojë ndaj ndryshimeve të tilla kuadroviqe, për më tepër tek ajo kishte filluar paraqitja e shenjave të hezitimit të kundërvënies ndaj Millosheviqit, kurse serbët në pozita udhëheqëse

¹⁸ K. Nikolić, "IlićeSrbija biti republika, ili će prestatida postojiti...", f. 184.

¹⁹ *Политика*, 7 Октобар 1988, f. 1; *Rilindja*, 7 tetor 1988, f. 1.

²⁰ Zekeria Cana, "Rrënimi i Autonomisë", Fejton (I), *Kosova Sot*, 11 shtator 2000, f. 10.

në institucionet e Kosovës tanimë ishin pozicionuar haptas pro Millosheviqit. Në anën tjetër, zëvendësimi i këtyre kuadrove me figura të dëgjueshme politike sikurse Rrahman Morina, Ali Shukria dhe Hysamedin Azemi, ishte indikacion i mjaftueshëm se përpjekjet e Millosheviqit për rrënimin e Autonomisë së Kosovës po shkonin drejt fazës finale, prandaj për ta parandaluar një akt të tillë minatorët e Trepçës qysh të njëjtën ditë, 17 nëntor 1988, marshuan në këmbë për në Prishtinë²¹, për ta mbrojtur udhëheqjen krahinore, akt me të cilin u solidarizuan edhe studentët, klasa punëtore, qytetarët etj.

Situata politike dhe e sigurisë në Kosovë kishte arritur kulmin e rrezikshmërisë, nga njëra anë demonstratat shqiptare e nga ana tjetër mitingjet e serbëve. Situata acarohet edhe më tej nga një miting i madh i organizuar nga Millosheviqi në Beograd, më 19 nëntor 1988, ku morën pjesë mbi një milion njerëz. Ndonëse mitingu organizohej nën maskën e “vëllazërim-bashkimit”, Millosheviqi nuk hezitoi të transmetojë mesazhe kërcënuese dhe të shpreh hapur vullnetin për realizimin e qëllimeve të tij qoftë edhe përmes luftës, duke theksuar ndër të tjera se: *“Asnjë forcë në tokë nuk mund ta ndalojë popullin serb. Njerëz të Serbisë - do të luftojmë për kauzën tonë dhe do të fitojmë”*.²²

Kërcënimi i hapur i Millosheviqit pati jehonë në hapësirën gjithë jugosllave, e në veçanti në Kosovë sidomos kur po vazhdonte debati publik mbi ndryshimet kushtuese. Në këto rrethana, pra kur ishte shkatërruar udhëheqja krahinore e kur kërcënimi serb tanimë

²¹ Azem Vllasi, “Minatorët e kthyen vëmendjen e botës demokratike nga Kosova”, <https://www.koha.net/arberi/146835/vllasi-minaret-e-kthyen-vemendjen-e-botes-demokratike-nga-kosova/>, qasja 25 gusht 2019.

²² *The Death Of Yugoslavia 1/6 Enter Nationalism - BBC Documentary*, <https://www.youtube.com/watch?v=vDADy9b2IBM>, qasja 20 maj 2019.

nuk kishte asnjë maskë, vjen deri tek zbutja edhe e klasës intelektuale shqiptare ndaj ndryshimeve kushtetuese. Një fakt i tillë mund të vërehet nga deklarata e profesorit të së Drejtës Juridike, SyrjaPupovci, i cili theksonte se çdo gjë qëndronte brenda parimeve të Kushtetutës së vitit 1974 dhe se njëkohësisht duhet t'u mbylleen kanalet gjithë atyre që mendojnë të imponojnë mendimet dhe tezat e tyre armiqësore, nacionaliste ekstreme.²³

Një konstatim i tillë sigurisht që ishte paradoksal sidomos kur bëhej nga një jurist i njohur. I gjithë populli shqiptar ishte i vetëdijshëm që çështja konsistonte në ndryshimet e raporteve midis krahinës dhe republikës apo thjeshtë tendencave serbe për centralizim të Serbisë. Prononcime të njëjta u bënë edhe nga intelektualë tjerë apo nga funksionarë tjerë politikë shqiptarë.

Për më tepër edhe vetë kryetari i Kryesisë së Kosovës, Remzi Kolegeci, derisa po bisedonte me minatorët të cilët që nga 20 shkurti 1989 ishin ngujuar në zgafellet e Trepçës në mbrojtje të Kushtetutës së vitit 1974, dhe në kërkim të largimit të Rrahman Morinës (kryetar i Kryesisë së Komitetit Krahinor të Lidhjes Komuniste të Kosovës), Ali Shukrisë (anëtar i Kryesisë së KQ LKJ) e Hysamedin Azemit (anëtar i Kryesisë së Komitetit Krahinor të Lidhjes Komuniste të Kosovës) nga funksionet e tyre, kishte deklaruar se: *“Nuk do të ndryshohen parimet themelore të kushtetutës së vitit 1974... kurrësi nuk do të lejojmë që me ndryshimet, të cilat do të pasojnë të cenohet barazia e kombeve dhe kombësive në Kosovë, përdorimi i gjuhës dhe i shkrimit, simboleve kombëtare dhe veçoritë e tjera të autonomisë....”*²⁴

Një deklaram i tillë ishte bërë në kohën kur Kuvendi i Serbisë, qysh më 3 shkurt 1989, kishte miratuar amendamentet që i jepnin

²³ Z. Cana, *Apeli 215 i intelektualëve shqiptarë*, Rilindja, Prishtinë 2001, f. 14.

²⁴ *Rilindja*, Prishtinë, 22 shkurt 1989, f. 3-4.

Serbisë kontroll më të drejtpërdrejtë mbi sektorin e sigurisë, financave, drejtësisë dhe të planifikimit shoqëror të krahinave autonome.²⁵ Në fakt, rrënimi i autonomisë pothuaj ishte akt i kryer dhe pritej akti formal në këtë drejtim.

Sakrificat e minatorëve dhe të popullsisë shqiptare në mbrojtje të Kushtetutës por edhe frika nga agresioni gjithnjë e më i hapur serb, nxitën opinionin politik e publik në republikat demokratike jugosllave, si të Sllovenisë e të Kroacisë, të solidarizoheshin me shqiptarët në Kosovë. Gazetarët sllovenë ishin ndër të rrallët që u lejuan të futen në zgafelle për të raportuar mbi grevën e minatorëve, kurse në mbështetje të minatorëve në Lubjanë, më 27 shkurt 1989, u mbajt mitingu mbi të “vërtetën dhe solidaritetin”, duke nënshkruar një petition prej 450 000 vetëve. Greva e minatorëve e kishte edhe mbështetjen e udhëheqjes politike sllovene. Kryetari i Lidhjes Komuniste të Sllovenisë, Milan Kučan, lidhur me grevën e minatorëve deklaronte se: *“grevistët nuk po mbrojnë vetëm të drejtat e shqiptarëve në Kosovë, por po e mbrojnë Jugosllavinë dhe çdo republikë duke përfshirë edhe Slloveninë”*.²⁶

Greva e minatorëve zgjoi edhe interesimin e opinionit dhe të mediave ndërkombëtare. Gazeta “Rilindja” e datës 24 shkurt 1989, paraqet disa përmbledhje të raportimeve nga agjencitë më të njohura botërore. Sipas kësaj gazete, agjencia angleze e lajmeve “Rojters” përmend zotimin e punëtorëve se do të bëjnë grevë përderisa nuk do të marrin me shkrim garanci se me ndryshimet e Kushtetutës së Serbisë nuk do të zvogëlohet Autonomia e Kosovës. Raportim të hollësishëm bënte edhe agjencia e lajmeve amerikane “Asoshtied

²⁵ M. Vickers, *Midis serbëve dhe shqiptarëve...*, f. 286.

²⁶ The Death Of Yugoslavia 1/6 Enter Nationalism - BBC Documentary, <https://www.youtube.com/watch?v=vDADy9b2IBM>, qasja 20 maj 2019.

Pres”. Korrespondenti i kësaj agjencie raportonte nga Mitrovica se 10 mijë punëtorë anembanë Krahinës, u hodhën në grevë. Mbi 1 000 punëtorë të Minierës së Trepçës edhe më tutje qëndrojnë në Galeri të Minierës, vazhdon raportin kjo agjenci.²⁷

Interesimi dhe presioni publik e ndërkombëtar dhe këmbëngulja e minatorëve bëri që tre të apostrofuarit të paraqesin dorëheqjet e tyre.²⁸ Por, ky akt ishte një lojë politike pasi që dorëheqjet e tyre nuk u pranuan nga udhëheqja politike jugosllave. Ata në fakt vazhduan ushtrimin e funksioneve të tyre derisa të përmbyllej në Kuvendin e Kosovës ratifikimi i ndryshimeve kushtetuese. Njëkohësisht, për të parandaluar çdo kundërshtim tjetër të mundshëm, Millosheviqi dhe udhëheqja kosovare e nënshtuar ndaj tij, ndoqën një politikë të persekutimit dhe të arrestimit të atyre që etiketoheshin si “kundërrevolucionarë” dhe prishës të rendit shoqëror dhe politik. Në këtë mënyrë, më 1 mars 1989, nën akuzat e cekura më lart pasoi arrestimi i Azem Vllasit, udhëheqësve të Trepçës, si Burhan Kavaja e Aziz Abrashi, si dhe arrestime tjera të aktivistëve politikë shqiptarë.²⁹

Përveç arrestimeve, qarqet serbe të udhëhequra nga Millosheviqi u siguruan që të zbatojnë një propagandë speciale që për synim kishte presionin mbi gjitha masat politike në Kosovë. Në opinion filluan të dalin skenarë mbi dështimin e një kundërrevolucionari të udhëhequr nga Azem Vllasi e pasuesit e tij, duke i shfrytëzuar edhe minatorët në këtë skenar. Presioni serb bëhej

²⁷ *Rilindja*, Prishtinë, 24 shkurt 1989, f. 3-4.

²⁸ Arkivi: Greva e Minatorëve 1989, <https://www.youtube.com/watch?v=Ihi0DgWZtYA>, qasja 10 gusht 2019.

²⁹ 25 vjet nga suprimimi i autonomisë, <https://www.gazetaexpress.com/lajme-25-vjet-nga-suprimimi-i-autonomise-se-kosoves-4441>, qasja 20 korrik 2019.

edhe më i fuqishëm sa afrohej dita e mbledhjes së Kuvendit të Kosovës për t'i votuar apo refuzuar ndryshimet kushtetuese. Prandaj, nuk është rastësi edhe deklarata e Jusuf Karakushit, ministrit të Punëve të Brendshme të Krahinës Socialiste Autonome (më tej: KSA) Kosovës, i cili gazetës “Rilindja” më 22 mars 1989, jo rastësisht një ditë para mbledhjes së Kuvendit të Kosovës, i deklaronte se: “...sipas shënimeve të Shërbimit të Punëve të Brendshme në ngjarjet e nëntorit dhe të shkurtit, rol kyç kanë disa persona në strukturat politiko-shoqërore nga Krahina, komunat dhe nga disa organizata punuese, si dhe persona që kanë qenë ose gjenden në vende kyçe në organizatat punuese të ekonomisë dhe në organizata tjera....”.³⁰

Një deklaram i tillë nuk ishte i rastësishëm por i planifikuar mirë dhe ishte në funksion të arritjes së dy objektivave: (1) që për shkak të situatës së rrezikshme që buronte nga organizimet e “separatistëve” shqiptarë të vihej rendi dhe rregulli përmes “masave të posaçme” të rekomanduara nga Kryesia e RSFJ në mbledhjen e datës 8 janar 1989, si dhe (2) të bëhej presion edhe më i fuqishëm në prag të mbledhjes së Kuvendit të Kosovës. Fakti i dytë mund të vërtetohet nga deklarata e kryetarit të Kuvendit të Kosovës, VukashinJokanoviq, një ditë para mbledhjes së Kuvendit i paralajmëroi delegatët se “... gjitha organizatat dhe forumet kishin dhënë pëlqimin për ndryshimet kushtetuese, prandaj delegatët duhet ta vërtetojnë këtë në mbledhjen e nesërme”, dhe se “...votimi do të jetë i hapur....”.³¹

Nuk ka asnjë dyshim se ky akt shmangte mundësinë e shprehjes së vullnetit real të delegatëve përmes votimit të fshehtë.

³⁰Rilindja, Prishtinë, 23 mars 1989, f. 3-4.

³¹Rilindja, Prishtinë, 22 mars 1989, f. 4.

Votimi i hapur sigurisht se do t'i ekspozonte ata para një rreziku të drejtpërdrejtë fizik në qoftë se do të votonin kundër. Presioni u bë edhe më i fuqishëm kur më 23 mars 1989, ditën kur do të mbahej seanca, ndërtesa e Kuvendit të Kosovës ishte e rrethuar me tanke e autoblanda dhe me një numër të madh policësh, të ndihmuar edhe nga agentët civilë që u bënë presione dhe provokime të formave të ndryshme gjatë legjitimitetit të delegatëve shqiptarë tek porta e hyrjes për në Kuvend.³²

Zbatimi i këtyre masave nën pretekstin e ofrimit të sigurisë përveç se kishte për qëllim presionin psikologjik mbi delegatët shqiptarë, kishte për qëllim edhe të mundësojë hyrjen e një numri të madh agentësh serbë të infiltruar si mysafirë, vëzhgues apo gazetarë, të cilët u përzierin me delegatët. Detyrë e personave të infiltruar ishte votimi dhe sigurimi i dy të tretave të nevojshme për të kaluar ndryshimet kushtetuese.³³

Në rrethana të tilla, më 23 mars 1989, hapi punimet Kuvendi i Kosovës që në rend dite kishte shqyrtimin e amendamenteve 9-49 në Kushtetutën e RS të Serbisë dhe dhënien e pëlqimit apo refuzimit të këtyre ndryshimeve. Vlen të ceket se Komisioni për çështje kushtetuese i KSA të Kosovës kishte dhënë pëlqimin për ndryshimet e cekura më lart. Interesimi për monitorimin e kësaj mbledhjeje kishte zgjuar kërshërinë e qindra gazetarëve, fotoreporterëve dhe xhiruesve nga gjithë Jugosllavia, e sidomos të qytetarëve të Kosovës. Legjislatura e kohës e Kuvendit të Kosovës përbëhej nga tre dhoma: Dhoma e Punës së Bashkuar të Kuvendit të KSA të Kosovës (gjithsej: 90 delegatë), (2) Dhoma e Komunave e KSA të Kosovës (gjithsej: 47

³²*Zëri i Rinisë*, 16 maj 1990.

³³Noel Malcolm, *Kosova një histori e shkurtër*, Koha, Prishtinë, 2001, f. 359.

delegatë), dhe (3) Dhoma Shoqërore-Politike e Kuvendit të KSA të Kosovës (gjithsej: 49 delegatë), pra në total 186 delegatë.³⁴

Në fjalimin e tij të hapjes, Vukashin Jokanoviq, kryetar i Kuvendit të KSA të Kosovës, ndër të tjera u fokusua në gjashtë pika: (1) amendamentet e propozuara nuk ndryshojnë parimet themelore kushtetuese; (2) mënjanohej dallimet në mendime; (3) pikëpamjet e papranueshme nuk përfshihen në amendamente; (4) sigurohet barazia e plotë e gjuhëve; (5) me amendamente precizohen autorizimet legjislativ të republikës; (6) nuk ndryshohen pozita, të drejtat dhe obligimet e krahinave autonome të përcaktuara në kushtetutën e Jugosllavisë.³⁵

Sigurisht që deklarimi i mësipërm i VukashinJokanoviqit nuk përmbante të vërtetat e ndryshimeve kushtetuese, por ishte një deklaram demagogjik për ta mashtruar opinionin publik se ndryshimet nuk preknin çështjet për të cilat ishte i brengosur populli shqiptar në Kosovë. Për më tepër, gjatë kryesimit të seancës u vu në pah tendenca e Jokanoviqit për të anuar kah ndryshimet kushtetuese. Në këtë mënyrë, ai favorizonte delegatët që shpreheshin pro ndryshimeve dhe mendohej t'i neglizhonte ata që mund të ishin kundër. Si duket ai kishte përgatitur në listë të tillë të delegatëve, pasi gjashtë delegatët e parë që diskutuan, në mesin e të cilëve katër shqiptarë, ishin pro ndryshimeve duke u shpreh se amendamentet e propozuara nuk e vinin në pyetje Autominë e Kosovës.³⁶

³⁴Z. Cana, "Rrërimi i autonomisë", Fejton (II), *Kosova Sot*, 12 shtator 2000, f. 12; *Zëri i Rinisë*, 16 qershor 1990.

³⁵Po aty, f. 12.

³⁶Po aty, Fejton (III), *Kosova Sot*, 13 shtator 2000, f. 18.

Por, gjatë seancës morën fjalë edhe delegatë që ishin kundër ndryshimeve. Delegati Ukë Bytyqi vuri theksin tek shmangia nga diskutimi publik i amendamentit 47.³⁷ Amendamenti në fjalë anulonte dhënien e pëlqimit nga krahinat për ndryshimet e ardhshme në Kushtetutën e Serbisë. Me këtë ndryshim, Serbia do të arrinte atë çfarë po kërkonte që sa kohë, prandaj duke ditur reagimin negativ të shqiptarëve ajo e kishte fshehur atë nga diskutimi publik dhe e kishte futur në listë të ndryshimeve në momentet e fundit. Në këtë mënyrë filloi një debat lidhur me amendamentin në fjalë. Delegatët serbe iu kundërvunë ashpër atyre që ishin kundër amendamentit 47. Nuk munguan as vërejtjet kundër amendamenteve tjera, të parashtruara nga delegatët shqiptarë. Ndër të tjera u përmend prioriteti që kishte gjuha serbe si gjuhë zyrtare dhe kompetencat e Krahinës që sipas ndryshimeve ishin të barabarta me ato të kuvendeve komunale.³⁸ Në vazhdim të këtyre debateve përsëri doli në skenë loja e Jokanoviqit. Tani ani filloi me leximin e “telegrameve” nga organizata të ndryshme punuese në mbështetje të ndryshimeve kushtetuese, sikurse organizata Metalac nga Janjeva, Lidhja Komuniste në organizatën Termoelektrana etj.³⁹ Gjithë kjo përpjekje ishte për t’i treguar delegatëve se “populli dhe klasa punëtore po i mbështesë këto ndryshime”.

Seanca vazhdoi me diskutime dhe argumentime pro dhe kundër. Por, një tipar negativ që e karakterizoi seancën në fjalë, ishte kundërvënja midis vetë shqiptarëve. Një pjesë e delegatëve shqiptarë anuan kah ndryshimet kushtetuese dhe sulmonin shqiptarët tjerë që

³⁷Po aty, f. 18.

³⁸ Po aty, Fejton (VIII), *Kosova Sot*, 19 shtator 2000, f. 18.

³⁹ Po aty, f. 18.

tentonin ta mbronin Kushtetutën. Një nga ata i replikoi Riza Llukës me theksin se Rizai po fliste në emër të tij dhe se baza e Pejës kishte miratuar propozimin për ndryshime.⁴⁰

Në mënyrë të njëjtë reaguan edhe disa delegatë tjerë shqiptarë që haptas dolën në mbështetje të ndryshimeve. Sidoqoftë, pas përfundimit të debatit kryesuesi i mbledhjes, VukashinJokanoviq, hodhi në votim propozimin e Komisionit të çështjeve kushtetuese që të jepet pëlqimi për tekstin e amendamenteve 9-49 në Kushtetutën e Republikës Socialiste të Serbisë. Votimi ishte i hapur dhe sipas versionit zyrtar vetëm 10 delegatë votuan kundër, dy abstenuan dhe gjithë të tjerët ishin pro.⁴¹

Por, nëse analizojmë disa fakte atëherë del se nuk ishte epilogu i vërtetë i votimit. Së pari, Jokanoviq në shpejtësi kishte numëruar 10 kundër, pa u vërtetuar nëse mund të kishte më tepër. Qëllimi i tij ishte ta përmbyllte seancën me votimin pro. E dyta, Jokanoviq qëllimisht nuk kishte verifikuar delegatët me të drejtë vote, dhe në mesin e votuesve sigurisht që kishte pasur edhe njerëz tjerë të ngarkuar me këtë mision. E treta, mënyra e votimit të hapur ishte në kundërshtim me rregulloren e punës së Kuvendit të Kosovës. Sigurisht, një pjesë e delegatëve mund të kenë votuar pro shkaku i presionit dhe frikës, por ndoshta edhe për shkak të premtimeve të ndryshme. Kjo dëshmohet nga studiuesi Pierre Dufour, i cili shkruante: *“Deputetët janë të detyruar të votojnë me dorën lart, nën mbikëqyrjen e ngushtë të autoriteteve policore, të cilat kishin deklaruar se po i mbanin peng familjet e tyre...”*⁴²

⁴⁰ Po aty, Fejton (IX), *Kosova Sot*, 21 shtator 2000, f. 18.

⁴¹ Po aty, Fejton (XIV), *Kosova Sot*, 26 shtator 2000, f. 19.

⁴² Pierre Dufour, *Kosova - paqja e shpërfillur*, Rozafa, Prishtinë, 2010, f. 25.

Pavarësisht të gjithave, qoftë kërcënimeve, presionit, premtimeve apo mashtrimeve, akti në fjalë paraqet kapitullimin e klasës politike të Kosovës, të viteve 1980. Në kundërshtim me vullnetin e qytetarëve, u ndryshua Kushtetuta e vitit 1974, me çka u suprimua Autonomia e Kosovës në Federatën Jugosllave, duke e lënë Kosovën pjesë përbërëse të Serbisë.

Derisa klasa politike shqiptare e Kosovës u tregua e paaftë që ta mbronte Kushtetutën e vitit 1974, ishte populli i Kosovës ai që u ngrit në mbrojtje të saj. Në gjithë Kosovën filluan demonstratat shqiptare, të cilat u shtypën ashpër nga ndërhyrjet policore. Sipas studiuesit Noel Malcolm, gjatë demonstratave të marsit u vranë 21 demonstrues dhe dy policë, kurse deri në fund të prillit numri i demonstruesve të vrarë arriti në 100.⁴³

Në kohën kur në Kosovë po zhvilloheshin demonstrata të ashpra në kundërshtim të suprimimit të autonomisë së vitit 1974, Kuvendi i RS të Serbisë, në një mbledhje solemne të mbajtur më 28 mars, në Qendrën e Kongreseve “Sava”, shpalli amendamentet në Kushtetutën e RS të Serbisë. Autonomia e Kosovës tani ishte reduktuar vetëm në një kujtim.

⁴³Noel Malcolm, *Kosova një histori e shkurtër*, Koha, Prishtinë, 2001, f. 359.

Armend MEHMETI

SUMMARY

The Kosovan political class during the years 1975-1987 successfully opposed to efforts of Serbian political circles to amend the Constitution of 1974 and thus protected Kosovo's autonomy. But, during the year 1988 and first quarter of 1989, when the position of Milosevic and his apparatus had been strengthened, the Serbian efforts were followed by an unprecedented aggressiveness and propaganda. The Kosovan political class remained weak and unorganized, particularly when Serbs holding positions in Kosovo institutions were clearly profiled alongside Milosevic. In these circumstances, while not being unified although the lack of unity may have been a result of pressures and threats from Serbia, negligence, personal ambitions or lack of political awareness, made the political class of Kosovo Albanians fall under dictates from Serbia. Consequently, the adoption of constitutional amendments represents the act of capitulation of the Kosovo political class.

Teuta Shala-Peli

Krimet serbe në rajonin e Pejës, mars-qershor 1999

Gjatë luftës në Kosovë 1998-1999, forcat serbe përdorën forma të ndryshme të dhunës dhe terrorit ndaj popullsisë civile shqiptare. Dhuna dhe vrasjet në masë ndaj civilëve shqiptarë në Kosovë në përgjithësi e me këtë rast edhe në rajonin e Pejës, është përshkallëzuar sidomos gjatë muajve mars-qershor të vitit 1999, kohë e cila përkon me ndërhyrjen e forcave të NATO-s. Gjatë asaj kohe, saktësisht prej 25 marsit e deri më 14 qershor të vitit 1999, nga forcat policore e ushtarake serbe, në rajonin e Pejës në vazhdimësi janë kryer krime dhe vrasje në masë në shënjestër të cilave ishin civilët shqiptarë pa dallim moshe e gjinie. Meqë jemi te 21-vjetori i çlirimit të Kosovës dhe 21-vjetori i ndërhyrjes së forcave të NATO-s, e pamë të arsyeshme që në këtë punim të trajtojmë krimet serbe në rajonin e Pejës gjatë muajve mars-qershor të vitit 1999, duke u ndalur vetëm te krimet që ju referohen vrasjeve në masë, të cilat synim kryesor kishin zhdukjen e popullsisë shqiptare në Kosovë. Me anë të këtij punimi synohet të ndriçohen ngjarjet e tmerrshme, terrori dhe krimet që bënë forcat policore dhe ushtarake serbe mbi popullsinë civile shqiptare në territorin e Komunës së Pejës, konkretisht në Fushë të Pejës, Katund i Ri, Qyshk, Pavlan, Zahaq, Nakëll, Llabjan, Ramun, Leshan dhe Kliçinë, gjatë muajve mars-qershor të vitit 1999. Punimi kryesisht është i bazuar në dëshmitë e atyre personave që i mbijetuan këtyre krimeve, pa dëshmitë e të cilëve nuk do të mund të ishte dëshmuar

dhe argumentuar me fakte tërë ai krim, që ndodhi në periudhën mars-qershor të vitit 1999.

Menjëherë pas ndërhyrjes së forcave të NATO-s, forcat serbe filluan me aksionet e tyre ndaj qytetit të Pejës. Më 25 mars 1999, nisën sulmet e armatosura ndaj lagjeve “Kapeshticë” dhe “Zatra”, si dhe dëbimi i popullsisë civile shqiptare nga këto lagje, e po ashtu një numër i banorëve u vranë.¹ Forcat serbe gjatë muajve mars-qershor 1999, kryen krime edhe në lagje tjera të këtij qyteti. Që nga 26 marsi e deri më 29 maj të vitit 1999, forcat serbe në lagjen “Fusha e Pejës”, ndërmorën katër aksione të armatosura ndaj popullsisë civile shqiptare me ç’rast u vranë 39 civilë. Vetëm më 13 maj 1999, në këtë lagje nga forcat serbe u vranë 13 civilë shqiptarë, kufomat e të cilëve më pas u dogjën.

Më 26 mars të vitit 1999, forcat serbe në bashkëpunim me banorët serbë të lagjes “Fusha e Pejës” ndërmorën një sulm ndaj popullsisë civile të kësaj lagjeje. Gjatë këtij aksioni, i cili nuk zgjati më shumë se dy orë, u vranë 14 persona: Adem Lajçi (54), Bekë Shala (55), Eshref Krasniqi (50), Fane Shabanaj (74), Haki Lajçi (20), Haxhi Nikçi (65), Isuf Muriqi (68), Mehmet Bajraktari (65), Mustafë Lajçi (56), Nimon Shabanaj (53), Ramë Shabanaj (52), Skënder Alushaj (32), Valdet Krasniqi (21) dhe Xhafer Alushaj (62), ndërsa dy u plagosën, e po ashtu në forma të ndryshme u maltretuan shumë të tjerë, të cilët përveçse u plaçkitën, u dëbuan me dhunë nga shtëpitë e tyre.²

¹ Nën pushtetin e urdhreve. Krimet e luftës në Kosovë, Human Rights Watch, Tiranë 2002, f. 317.

² Deklaratë e Lumnije Alushaj, dhënë KMDLNJ-së, më 23.05.2000, në Pejë; Deklaratë e Nurijsë Shabanajt, dhënë KMDLNJ-së, më 29.05.2000, në Pejë; Deklaratë e Tabe Shalës, dhënë KMDLNJ-së, më 28.09.1999, në Nakëll; Deklaratë

Më 29 mars të vitit 1999, forcat serbe në lagjen “Fusha e Pejës” gjatë një sulmi vrasin 3 persona: Bashkim Berisha (32), Hilmi Zeqiri (34) dhe Skënder Zeqiri (46).³ Ndërsa, më 13 maj të vitit 1999, në po këtë lagje nga forcat serbe u vranë 13 persona: Adem Nikçi (28), Ali Nikçi (65), Arben Qerkinaj (22), Fatjana Marmellaku (2), Mehmet Nikçi (60), Musli Zekaj (70), Nurie Qerkinaj (60), Ramë Qerkinaj (68), Sadik Duraku (78), Sali Gashi (30), Smajl Beqiraj (77), Shaban Nikçi (76) dhe Zahide Qerkinaj (26). Gjatë këtij sulmishumica e kufomave janë djegur, si dhe u bastisën dhe dogjën shumë shtëpi.⁴ Sulmi i katërt dhe i fundit në këtë lagje është ai i 28 majit, ku vriten 6 persona, 5 nga të cilët janë nga e njëjta familje: Adrian Kastrati (23), Alban Kastrati (17), Hasan Muratagiqi (39), Sokol Kastrati (56), Valdet Kastrati (29) dhe Xhafer Kastrati (52).⁵ Vlen të theksohet se sulmet e forcave serbe ndaj popullsisë civile në lagjen “Fusha e Pejës” në periudhën mars-qershor

e Afërdita Krasniqit, dhënë KMDLNJ-së, më 24.05.2000, në Pejë; Deklaratë e Jakup Krasniqit, dhënë KMDLNJ-së, më 10.09.1999, në Pejë; Deklaratë e Florim Lajçit, dhënë KMDLNJ-së, më 16.12.1999, në Pejë; Deklaratë e Feride Lajçit, dhënë KMDLNJ-së, më 23.05.2000, në Pejë; Deklaratë e Ismet Gashit, dhënë KMDLNJ-së, më 12.11.1999, në Pejë.

³ Deklaratë e Shaban Kaliqanit, dhënë KMDLNJ-së, më 05.06.2000, në Pejë.

⁴ Deklaratë e Haxi Ukaj, dhënë KMDLNJ-së, më 24.05.2000 në Pejë; Deklaratë e Bajram Ukaj, dhënë KMDLNJ, më 25.05.2000 në Pejë; Deklaratë e Shaban Gashit, dhënë KMDLNJ-së, më 19.10.1999 në Pejë; Deklaratë e Salih Leshnjanin, dhënë KMDLNJ-së, më 19.10.1999 në Pejë; Deklaratë e Nimon Qetina KMDLNJ-së, më 20.10.1999, në Pejë; Deklaratë e Haxhi Ukajt, dhënë KMDLNJ-së, më 24.05.2000, në Pejë; Deklaratë e Shaban Gashit, dhënë KMDLNJ-së, më 19.10.1999 në Pejë; KMDLNJ-Pejë, Procesverbal i mbajtur në Fushë të Pejës më 28.07.1999, në lagjen “Fusha e Pejës”, me rastin e zhvarrosjes dhe ekzaminimit të kufomës së Smajl Beqirajt, të vrarëve nga forcat serbe, më 13.05.1999, në “Fushë të Pejës”.

⁵ Deklaratë e Sevdije Muratagiqit, dhënë KMDLNJ-së, më 26.05.2000, në Pejë; Deklaratë e Lendita Krasniqit, dhënë KMDLNJ-së, më 01.06.1999, në Ulqin.

1999, i kanë disa karakteristika: e para, forcat serbe krimet i kanë kryer në bashkëpunim me banorët serbë të lagjes, ku një gjë e tillë përmendet pothuajse në të gjitha dëshmitë e bëra nga ata që i përjetuan dhe i mbijetuan sulmeve të forcave serbe në këtë lagje. Po ashtu, pjesëmarrjen e banorëve serbë të lagjes “Fusha e Pejës”, në sulmet e forcave serbe ndaj popullsisë civile shqiptare të kësaj lagjeje e dëshmon edhe fakti se në shumicën e rasteve gjatë aksioneve të armatosura nëpër shtëpitë ku kryenin krimet, zakonisht kanë hyrë nga 5-6 veta të armatosur, madje në disa raste duke i kërkuar në emër kryefamiljarët apo ndonjë anëtar tjetër të familjes, gjë që na lë të kuptojmë se personat e armatosur e kanë njohur mirë si lagjen ashtu edhe banorët e saj. E dyta, të gjitha këto krime janë kryer në prezencë të familjarëve, kryesisht femrave. Ka raste kur prezent kanë qenë edhe fëmijët. E treta, në aksionin e 13 majit 1999, për dallim prej aksioneve tjera në këtë lagje, shumica e kufomave janë djegur, ndërsa në aksionin e 28 majit shihet se cak i sulmit ishte vetëm familja Kastrati.⁶Forcat serbe gjatë muajve mars-qershor të vitit 1999, ushtruan dhunë si dhe kryen krime edhe ndaj popullsisë civile shqiptare në fshatin Katund i Ri. Dhuna ndaj popullsisë civile në këtë fshat u intensifikua sidomos gjatë muajve maj dhe qershor të vitit 1999. Gjatë asaj kohe, saktësisht më 11, 12 dhe 13maj si dhe me 4, 5 dhe 7 qershor të vitit 1999, forcat serbe gjatë disa aksioneve të armatosura vranë 14 persona: AliTafilaj (82), Bajram Alushaj (44), Bardh Aliu (58), Gëzim Aliaj (27), Gëzim Muçaj (14), HavëAhmetaj (75), Imer Ahmetaj (46), Mehmet Zekaj (69), Miradie Aliu (47),

⁶Teuta Shala-Peli, *Gjenocidi serb në rajonin e Pejës mars-qershor 1999*, Instituti i Historisë “AliHadri”-Prishtinë, Prishtinë, 2019, f. 86. (më tej: Teuta Shala-Peli, *Gjenocidi serb*).

Rukë Tafilaj (60), Sadik Tafilaj (70), Shaban Tafilaj (67), Xhafer Grabovci (49) dhe Xhevdet Bajraktari (40), si dhe u plaçkitën, burgosën dhe u dëbuan me dhunë banorët e këtij fshati.⁷ Edhe në Katund të Ri, forcat serbe pasi i vranë civilët shqiptarë, kufomave ua vunë zjarrin, duke i djegur së bashku me vendin ku edhe e kryenin krimin. Këtë formë të krimit, forcat serbe në Katund të Ri e përdorën në sulmin e 11 majit 1999, ku pasi vrasin tre civilë shqiptarë, një femër e dy meshkuj, ia vunë zjarrin shtëpisë ku e kryen krimin, duke djegur të tri kufomat së bashku me shtëpinë.⁸

Në periudhën mars-qershor 1999, një ndër krimet më të mëdha ndaj civilëve shqiptarë, ndodhi më 14 maj 1999, në fshatrat Qyshk, Pavlan dhe Zahaq, ku vetëm brenda disa orëve, forcat serbe vranë 73 persona, 41 në fshatin Qyshk, 10 në Pavlan dhe 22 në fshatin Zahaq, të moshave dhe të gjinive të ndryshme, e pastaj kufomave ua kishin vënë zjarrin, e forcat serbe një pjesë të kufomave i kishin larguar nga vendi i ngjarjes, duke i dërguar në drejtim të panjohur për familjarët e të vrarëve. Përveç këtij krimi, gjatë ndërhyrjes së forcave të NATO-s, mars-qershor të vitit 1999, pjesëtarë të forcave serbe në fshatin Qyshk, gjithsejtë kanë vrarë 44

⁷*Krimet e luftës në territorin e komunës së Pejës, mars-qershor 1999*, KMDLNJ, Pejë 2002, f. 86 (më tej: *Krimet e luftës*); Deklaratë e Xhelal Bajraktarit, dhënë KMDLNJ-së, më 02.11.1999, në Pejë; Deklaratë e Demë Aliut, dhënë KMDLNJ-së, më 20.03.2000, në Pejë; Deklaratë e Halil Veselit, dhënë KMDLNJ-së, më 20.06.2000, në Pejë; Deklaratë e Shaban Sadikut, dhënë KMDLNJ-së, më 08.02.2000, në Pejë; Deklaratë e Rexhep Ademajt, dhënë KMDLNJ-së, më 20.06.2000, në Pejë; KMDLNJ-Pejë, Procesverbalimbajtur në fshatin Katundi i Ri, me rastin e zhvarrosjes dhe ekzaminimit të të vrarëve nga forcat serbe, më 11.05.1999, ekzaminimi është bërë nga patologët danezë dhe ekipi i KMDLNJ-së, Pejë, më 13.09.1999; Deklaratë e Arif Tafilajt, dhënë KMDLNJ-së, më 02.11.1999, në Pejë.

⁸Teuta Shala-Peli, *Gjenocidi serb*, f. 33.

persona: Ahmet Gashi (35), Arian Lushi (20), Avdi Berisha (65), Avdullah Lushi (59), Aziz Sharapolli (72), Besim Kelmendi (37), Brahim Sh. Gashi (60), Brahim D. Gashi (56), Brahim Kelmendi (40), Demë Kelmendi (41), Emin Gashi (60), Emrush Krasniqi (49), Erdogan Kelmendi (19), Gani Avdyli (41), Haki Gashi (38), Halil Gashi (55), Hasan Avdylaj (39), Hasan Çeku (69), Ibër Kelmendi (52), Ibish Gashi (56), Ismet Dinaj (32), Isuf Shala (45), Jashar Gashi (47), Kadri Çeku (68), Mentor Kelmendi (23), Muhamet Shala (50), Musa Gashi (64), Nerxhivane Sharapolli (62), Osman Lushi (47), Qaush Lushi (50), Ramë Gashi (60), Ramë Kelmendi (91), Ramiz Lushi (40), Rasim Rama (40), Sefedin Lushi (40), Selim Gashi (42), Skënder Gashi (36), Skënder Kelmendi (47), Skënder Lushi (44), Sylë Gashi (49), Ukë Lushi (57), Xhafer Gashi (42), Xhafer Lushi (46)dhe Zeqir Alijaj (39).⁹

Në fshatin Pavlan në periudhën mars-qershor të vitit 1999, janë vrarë 13civilë shqiptarë, në mesin e të cilëve ishin edhe tri femra:Agim Selmanaj (47), Ajshe Kelmendi (77), Brahim Nikçi (53), Gjejrane Nikçi (57), Halil Nikçi (29), Hatixhe Nikçi (55), Haxhi Dreshaj (41), Muçë Lulaj (64), Nimon Gashi (53), Shaban Kelmendi (52), Ukshin Kelmendi (77), Zenun Shala (58)dhe Zymer Gashi

⁹*Krimet e luftës*, f. 62; *Krimet serbe në fshatin Qyshk të Pejës*, Bota Sot, 22 nëntor 2003, f. 17, 62; Vjollca Ferizi, *Njeriu që mbijetoi djegien*, Rilindja 28.04.2001, f. 8; Deklaratë e Hazir Berishës dhënë KMDL NJ-së, më 28.07.1999, në Pejë; Deklaratë e Rexhë Kelmendit, dhënë KMDL NJ-së, më 28.07.1999, në Pejë; Deklaratë e Erzen Lushit, dhënë KMDL NJ-së, më 28.07.1999, në Pejë; Deklaratë e Hazir Berishës, dhënë EULEX-it, më 12.01.2010, në Pejë; Deklaratë e Hazir Berishës, dhënë Tribunalit të Hagës, më 22 maj 2008; Deklaratë e Isa Gashit, dhënë KMDL NJ-së, më 28.07.1999, në Pejë.

(67).¹⁰ Ndërsa, në fshatin Zahaq janë vrarë 27 persona: Agim Hyseni (28), Ajshe Kastrati (50), Bajrush Hyseni (24), Bekim Delia (21), Demë Atashi (21), Faton Rama (24), Fazli Dobra (46), Fehmi Gjoka (23), Gëzim Cukaj (19), Halit Dobra (31), Hamëz Murati (31), Haxhi Dobra (46), Hysen Gjoka (21), Ismet Hyseni (41), Luljeta Kastrati (24), Muhamet Dobra (33), Naim Hyseni (38), Sabit Hyseni (31), Sadri Rama (54), Shaban Neziri (41), Shaban Rama (45), Shaban Smajlaj (23), Shpend Hyseni (31), Valdet Rama (36), Xhevrie Shala (13), Zenel Neziri (66) dhe Zymer Smajlaj (26).¹¹ Secili krim i kryer nga forcat serbe, më 14 maj 1999, i kishte karakteristikat e veta. Krimi në fshatin Zahaq për dallim prej krimeve në Qyshk dhe Pavlan,

¹⁰ *Krimet e luftës*, f. 62-63; Deklaratë e Gjylë Selmanajt, dhënë KMDL NJ-së, më 14.09.1999, në Pavlan; Deklaratë e Servete Selmanajt, dhënë KMDL NJ-së, më 14.09.1999, në Pavlan; KMDL NJ, Pejë, Procesverbal i mbajtur në fshatin Pavlan me rastin e zhvarrosjes dhe ekzaminimit të te vrarëve nga forcat serbe, më 14.05.1999, ekzaminimi është bërë nga patologët e angazhuar nga Tribunali Ndërkombëtar i Hagës dhe ekipi i KMDL NJ-së-Pejë, më 21.08.1999.

¹¹ *Krimet e luftës*, 68; Deklaratë e Shaban Alijajt, dhënë KMDL NJ-së, më 04.03.2000, në Pejë; Deklaratë e Ahmet Delia, dhënë KMDL NJ-së, më 05.08.1999 në Zahaq; Deklaratë e Ibrahim Nezirit, dhënë KMDL NJ-së, më 05.10.1999 në Zahaq; Deklaratë e Bajram Ramës, dhënë KMDL NJ-së, më 06.10.1999 në Zahaq; Deklaratë e Fejzo Hysenit, dhënë KMDL NJ-së, më 28.09.1999 në Zahaq; Deklaratë e Hajrullah Hysenit, dhënë KMDL NJ-së, më 28.09.1999 në Zahaq; Deklaratë e Bajram Smajlajt, dhënë KMDL NJ-së, më 03.12.1999 në Zahaq; Deklaratë e Zade Smajlajt, dhënë KMDL NJ-së, më 28.09.1999 në Zahaq; Deklaratë e Ahmet Delijajt, dhënë KMDL NJ-së, më 05.08.1999 në Zahaq; Deklaratë e Azem Mehmetaj, dhënë KMDL NJ-së, më 29.09.1999 në Zahaq; Deklaratë e Avdyl Hysenit, dhënë KMDL NJ-së, më 06.09.1999 në Zahaq; Deklaratë e Rashit Gjokaj, dhënë KMDL NJ-së, më 01.10.1999 në Zahaq; Deklaratë e Shehide Dobrës, dhënë KMDL NJ-së, më 28.09.1999 në Zahaq; Deklaratë e Zyle Dobra, dhënë KMDL NJ-së, më 20.09.1999 në Zahaq; Deklaratë e Hajrie Nezirit, dhënë KMDL NJ-së, më 05.08.1999 në Zahaq.

kufomat u morën dhe u dërguan në drejtim të panjohur, e po ashtu u morën edhe persona të gjallë.

Forcat ushtarake e policore serbe gjatë muajve mars-qershor të vitit 1999, ushtruan dhunë si dhe kryen krime edhe ndaj popullsisë civile në fshatin Nakëll. Duke ju referuar dëshmime lidhur me krimet e forcave serbe ndaj popullsisë civile në fshatin Nakëll, gjatë muajve mars-qershor të vitit 1999, forcat serbe disa herë hynë në fshat ku vranë, maltretuan, plaçkitën dogjën shtëpi dhe dëbuan me dhunë banorët e këtij fshati. Në muajt mars-qershor të vitit 1999, janë evidentuar dhjetë persona të vrarë nga fshati Nakëll: Ali Cukaj (82), Bekë Shala (55), Cucë Nikçi (58), Elfete Shala (23), Gëzim Cukaj (19), Hamëz Murati (31), Rexhep Nikçi (71), Sadik Shala (61), Shaban Smajlaj (23) dhe Zymer Smajlaj (26).¹²

Me vrasjet, dëbimet, plaçkitjet si dhe format e tjera të dhunës të ushtruara nga forcat serbe, u përballën edhe banorët e fshatit Llabjan. Sulmet dhe njëkohësisht krimet e forcave serbe ndaj popullsisë civile në fshatin Llabjan u përshkallëzuan sidomos më 1, 2 dhe 3 maj të vitit 1999. Duke ju referuar këtyre të dhënave, vlen të përmendim se banorët e fshatit Llabjan, që nga fillimi i sulmeve të NATO-s, vazhdimisht u provokuan nga pjesëtarë të forcave serbe si dhe provokimet ishin edhe më të mëdha, meqenëse banorët serbë të

¹² Deklaratë e Pranvera Shalës, dhënë KMDLNJ-së; Deklaratë e Nezir Nikçit, dhënë KMDLNJ-së, më 12.12.1999, në Nakëll; KMDLNJ-Pejë, Procesverbalimbajtur në fshatin Zahaq me rastin e zhvarrosjes dhe ekzaminimit të të vrarëve nga forcat serbe, më 12.05.1999, ekzaminimi është bërë nga patologët danezë dhe ekipi i KMDLNJ-së - Pejë, më 13.09.1999; Deklaratë e Zekie Cukajt, dhënë KMDLNJ-së, më 10.11.1999, në Nakëll; Deklaratë e Bajram Smajlajt, dhënë KMDLNJ-së, më 03.12.1999, në Pejë; Deklaratë e Ramë Ramës, dhënë KMDLNJ-së, më 01.10.1999, në Pejë; Deklaratë e Zade Smajlajt, dhënë KMDLNJ-së, më 28.09.1999, në Pejë.

cilët ishin inkuadruar në radhët e forcave serbe në këtë fshat, kishin vendosur shtabin e tyre.¹³

Epilogu tragjik i vrasjeve në këtë fshat ndodhi gjatë muajit maj 1999, ku vriten gjithsej 16 persona të gjinisë mashkullore, të moshës 14-101 vjeç, dy prej të cilëve janë të pidentifikuar: Arif Lajçi (61), Bekim Kelmendi (28), Besim Nikçi (28), Cenë Kelmendi (63), Halil Kelmendi (60), Isuf Kelmendi (65), Kapllan Lajçi (64), Kreshnik Berisha (14), Muharrem Veseli (48), Musë Maloku (50), Rifat Veseli (31), Shaqir Lajçi (57), Tahir Krasniqi (74) dhe Zhuj Lajçi (101).¹⁴ Shumicës së të vrarëve në këtë fshat gjatë muajit maj 1999, nga forcat policore e ushtarake serbe, u janë djegur kufomat. Për dallim nga fshatrat tjera të cilat janë objekt studimi në këtë punim, pjesëtarë të forcave serbe krimet në fshatin Llabjan i kryen në orët e vona të mbrëmjes, siç është sulmi më 1 dhe 2 maj, ku aksioni i forcave serbe ndaj popullsisë civile filloi rreth orës 22:00, më 1 maj, ndërsa më 2 maj rreth orës 23:30.¹⁵ Dhuna, plaçkitja, dëbimi nga shtëpitë si dhe djegia e shtëpive nga forcat serbe vazhduan edhe në fshatrat Ramun, Leshan dhe Kliçinë. Si pasojë e dhunë së ushtruar nga forcat serbe ndaj popullsisë civile shqiptare në këto fshatra, gjatë muajve mars-qershor të vitit 1999, në fshatin Ramun është vrarë

¹³Teuta Shala-Peli, *Gjenocidi serb*, f. 225.

¹⁴*Krimet e luftës*, f. 68, 69, 70, 75; KMDL NJ, Buletini, mars-shtator 1999, Viti IX, nr. 11-12, f. 59; Jusuf Osmani, *Krimet e Serbisë në Kosovë, 1998-1999*, Prishtinë 2012, f. 70; Josef Martinsen, *Çfarë ndodhi në Kosovë? 1998-1999*, Një dokumentim, 2013, f. 295; Fondi për të Drejtën Humanitare, *Libër kujtimi i Kosovës 1998-2000*, Prishtinë 2011,

http://www.liberkujtimiiikosoves.org/db/kkp_sq/index.html.

¹⁵Teuta Shala-Peli, *Gjenocidi serb*, f. 225.

Besim Vrenezi (18).¹⁶ Në fshatin Leshan janë vrarë Haxhi Sahiti (73) dhe Rukmane Sahiti(68),¹⁷ ndërsa në fshatin Kliçinë është vrarë Gëntrit Sheqeri (4).¹⁸

Në fund, duhet të theksojmë se gjatë muajve mars-qershor të vitit 1999, në Fushë të Pejës, Katund i Ri, Qyshk, Pavlan, Zahaq, Nakëll, Llabjan, Ramun, Leshan dhe Kliçinë, pjesa më e madhe e popullsisë civile shqiptare u vra në shtëpitë e tyre apo në shtëpitë ku ata ishin të strehuar. Madje, kishte raste kur forcat serbe i gruponin popullsinë civile shqiptare dhe grupe-grupe i dërgonin në shtëpi apo vende të ndryshme ku ata i shihnin si me të përshtatshme për të kryer krimin, e mandej për të zhdukur gjurmët e krimit në shumë raste iu vënin zjarrin kufomave së bashku me ato shtëpi apo vende ku kryheshin krimet në fjalë.¹⁹ Gjatë periudhës mars-qershor 1999, ka raste kur forcat serbe nga kolona e të dëbuarve ndalonin civilët shqiptarë të cilët më pas i vrisnin. Gjithashtu, forcat serbe shumë kufoma i zhvendosën nga vendi ku e kryen krimin duke i dërguar në drejtime të panjohura për familjarët e të vrarëve, edhe sot pas 21 vjetëve disa persona akoma figurojnë në listën e të pagjeturve.²⁰

¹⁶KMDLNJ-Pejë, Lista e të ekzaminuarve dhe të identifikuarve nga ekipi mjekësor i Tribunalit të Hagës dhe ekipit të KMDLNJ-së, në Pejë, filluar më 02.08.1999, Pejë, 19.08.1999, f. 2.

¹⁷*Krimet e luftës*, f.75.

¹⁸*Po aty*,f. 127; KMDLNJ, Buletini, mars-shtator 1999, Viti IX, nr. 11-12, f. 59; Jusuf Osmani, *Krimet e Serbisë ndaj fëmijëve në Kosovë, 1998-1999*, Prishtinë 2012, f. 213.

¹⁹Teuta Shala-Peli, *Gjenocidi serb*, f. 34.

²⁰ Në vëllimin e pestë të librit për personat e pagjetur publikuar nga Komiteti Ndërkombëtar i Kryqit të Kuq në prill të vitit 2013, në listën e të pagjeturve figurojnë ende emrat e këtyre personave: Esma Demaku, Halit Dobra, Kreshnik Berisha, Muhamet Dobra, Muharrem Veseli, Shpend Hyseni, Valdet Berisha;

Për 78 ditë me radhë sa zgjatën bombardimet e NATO-s, forcat serbe në vazhdimësi kryen vrasje në masë, plaçkitën, dëbuan dhe maltretuan në forma të ndryshme popullsinë civile shqiptare në Fushë të Pejës, Katund i Ri, Qyshk, Pavlan, Zahaq, Nakëll, Llabjan, Ramun, Leshan dhe Kliçinë. Gjatë muajve mars-qershor 1999, forcat serbe në vazhdimësi kryen krime, të cilat në të shumtën e rasteve kanë qenë të drejtuara kundër familjeve, me ç'rast forcat policore e ushtarake serbe vranë anëtarë të të njëjtës familje, duke synuar kështu zhdukjen e familjeve të tëra. Si rezultat i hulumtimeve kemi arritur të evidentojmë 12 raste ku forcat serbe gjatë muajve mars-qershor 1999, kanë vrarë në masë anëtarë të të njëjtës familje, konkretisht 3 deri në 12 anëtar.²¹Saktësisht, prej 25 marsit e deri më 14 qershor të vitit 1999, nga forcat policore e ushtarake serbe, ndaj popullsisë civile shqiptare në Fushë të Pejës, Katund i Ri, Qyshk, Pavlan, Zahaq, Nakëll, Llabjan, Ramun, Leshan dhe Kliçinë, u vranë 162 civilë të moshave dhe gjinive të ndryshme, nga këta 17 janë femra, 145 meshkuj, 7 fëmijë, 7 persona akoma janë të pagjetur, si dhe 13 persona janë plagosur.

Pothuajse të gjitha këto krime janë kryer në prezencë të familjarëve, kryesisht femrave, ku ka raste kur janë kryer edhe në prezencën e fëmijëve. Po ashtu, viktimat të krimeve serbe ishin edhe të moshuarit, femrat madje edhe fëmijët. Struktura e të vrarëve i takon moshës 2-101 vjeç. Gjithashtu, një pjesë të krimeve, forcat serbe e kanë kryer në bashkëpunim me serbët lokalë, të cilët me fillimin e luftës në Kosovë janë inkuadruar në masë të madhe në

ICRC, Persons missing in relation to the events in Kosovo, Fifth edition issued in April 2013, office in Pristina, f. 13, 12, 18, 20, 32, 70.

²¹Teuta Shala-Peli, *Gjenocidi serb*, f. 38.

radhët e forcave serbe. Krimet që u trajtuan në këtë punim janë vetëm disa nga rastet e tilla të shumta që ndodhën në rajonin e Pejës gjatë muajve mars-qershor të vitit 1999.

Teuta Shala - Peli**SUMMARY**

During the NATO bombing, Serbian forces consistently massacred, robbed, expelled and maltreated in various forms Albanian civilian population in Kosovo. With this violence perpetrated by Serbian forces was also faced Albanian civilian population in the region of Pejë in general, including here also the region which is the subject of treatment of this studies. Places included in this studies are: Fusha e Pejë, Katund i Ri, Qyshk, Pavlan, Zahaq, Nakëll, Llabjan, Leshan and Kličinë, compared to other places of Peja municipality, before NATO intervention, the overall situation was relatively calm, as well as violence exerted by Serbian forces was in small size. Murders, numerous maltreatments, violence in general got bigger and bigger and in particular after the NATO intervention on 24 March 1999. Therefore, since the early days after NATO intervention, Serbian police and military forces, many times accompanied by local Serb population, have killed civilians massively, both during deportation from their houses and deportation to Montenegro and Albania, as well as that part of population which had remained in Kosovo during the intervention of NATO forces, 24 March – 12 June 1999.

During the months of March-June 1999, in Fushë të Pejë, Katund i Ri, Qyshk, Pavlan, Zahaq, Nakëll, Llabjan, Leshan and Kličinë we have identified 162 killed civilians from Serbian police and military forces, out of which 162 civilians. Based on the evidence

in relation with crimes of Serbian forces against the civilian population in the places addressed in this monography, we can conclude that in the period of March-June 1999, Serbian forces almost used the same strategy of action in all crimes against the civilian population in general. In many cases, Serbian police and military forces killed civilians, burned corpses, or removed them from the crime scene by sending them to unknown destinations for the families of those killed and as a consequence of these actions even today after 20 years some of the killed ones during the months of March-June 1000 are still on the list of missing persons. Almost all of these crimes were committed in the presence of their family members, mainly women and there are cases when crimes were committed in the presence of children. Adults, women and even children were also victims of Serbian crimes. Structures of those killed belong the age 2 – 101 years old. Also, some crimes were committed by Serbian forces in cooperation with local Serbs who at the beginning of the Kosovo war were largely engaged in Serbian forces. We are reiterating once more that from 25 March until 14 June 1999 in Fushë të Pejës, Katund i Ri, Qyshk, Pavlan, Zahaq, Nakëll, Llabjan, Leshan and Kliçinë, 162 people were killed by Serbian forces, from these 17 women, 145 men, 7 children, 7 people are still missing and 13 people wounded.

Fitim RIFATI & Naim MUSLIU**Krimet serbe ndaj shqiptarëve në Anamoravë (1998-1999)**

Lufta e viteve 1998-1999 në Kosovë, preku ndjeshëm edhe Anamoravën, e cila shtrihet në juglindje të Kosovës dhe në kuadër të saj përfshihet rrethina e Gjilanit, Vitisë, Kamenicës dhe Novobërdës. Në tërësi, në fund të shekullit XX, Anamorava kishte rreth 200 000 banorë, shumica prej të cilëve ishin me përkatësi kombëtare shqiptare. Pasojat në njerëz, vrasjet, plagosjet, dhuna, spastrimi etnik, shkatërrimet në të mira materiale, shtëpi, shkolla, shtëpi të kulturës, biblioteka, institucione shëndetësore, objekte të kultit, lloje automjesh, fonde bujqësore e blegtorale, fonde të amvisërisë, infrastrukturë etj., përbëjnë thelbin kryesor brenda këtij punimi të paraqitjes në formë fragmentare të akteve të krimeve të gjenocidit serbo-jugosllav ndaj shqiptarëve dhe dëmeve të luftës nga shkurti i vitit 1998 deri në qershor të vitit 1999 në Anamoravë.

Që në fillim duhet sqaruar se me togfjalëshin “serbo-jugosllav”, nënkuptohet përfshirja e elementëve të armatosur kombëtarë serbë, malazezë dhe me kombësi të tjera, që kanë qenë të përfshirë në kryerjen e akteve dhe krimeve të gjenocidit në Anamoravë. Më pas, emërtimi politik dhe organizativ shtetëror i Republikës Federative të Jugosllavisë, e themeluar në vitin 1992, përbëhej nga dy shtete: Serbia dhe Mali i Zi. Prandaj, nocioni juridik, politik dhe kombëtar “serbo-jugosllav”, i përdorur në këtë punim studimor, i përshtatet organizimit shtetëror të kohës dhe bënë përgjegjës këtë shtet, sepse të gjitha operacionet janë hartuar,

mbikëqyrur dhe realizuar nën kujdesin dhe kontrollin e plotë të komandës dhe organeve shtetërore. Dhe, së treti, përkufizimi i akteve të krimeve me nocionin “gjenocid”, përputhet në të gjitha konditat me Konventën për Parandalimin dhe Dënimin e Krimit të Gjenocidit, të miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Organizatës së Kombeve të Bashkuara, më 9 dhjetor 1948, sipas të cilës gjenocidi nënkupton vrasjen e anëtarëve të grupit; cenimin e rëndë të integritetit fizik ose mendor të anëtarëve të grupit; vënien e grupit qëllimisht në kushte të tilla të jetës, që sjellin zhdukjen e plotë fizike ose të pjesshme të tij; imponimi i masave me qëllim të pengimit të lindjeve brenda grupit; transferimi i dhunshëm i fëmijëve nga njëri grup në tjetrin.¹ Faktet, dëshmitë dhe provat konkrete argumentojnë se forcat serbo-jugosllave kryen gjenocid në Anamoravë, sepse kishin për qëllim shkatërrimin e tërësishëm ose të pjesshëm të shqiptarëve si grup kombëtar, etnik ose fetar i ndryshëm nga serbo-jugosllavët. Veç kësaj, nëse merret për bazë Statuti i Aktualizuar i Tribunalit Penal Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë, shteti serbo-jugosllav ndaj shqiptarëve të Anamoravës gjatë viteve 1998-1999 ka bërë shkelje të rënda të Konventave të Gjenevës të vitit 1949 (neni 2), ka bërë shkelje të ligjeve ose zakoneve të luftës (neni 3), ka kryer gjenocid (neni 4) dhe krime kundër njerëzimit (neni 5).² Midis tyre, sipas Statutit të Romës për Gjykatën Penale Ndërkombëtare, Republika

¹ Convention of the Prevention and Punishment of the Crime of the Genocide, Approved and proposed for signature and ratification or accession by General Assembly resolution 260 A (III) of 0 December 1948, Article II, f. 1. Ky përkufizim i gjenocidit shprehet edhe në Statutin e Romës të Gjykatës Penale Ndërkombëtare (neni 6), 1998, dhe Statutin e Aktualizuar i Tribunalit Penal Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë (neni 4), 2009.

² Statuti i Aktualizuar i Tribunalit Penal Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë, 2009, f. 9-10.

Federative e Jugosllavisë ka kryer krime lufte në Anamoravë gjatë viteve 1998-1999.³ Të gjitha këto krime serioze plotësojnë, argumentojnë dhe afirmojnë shkallën më të lartë të krimit siç është gjenocidi.

Veprimtaria publike e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK) dhe ndërkombëtarizimi i çështjes së Kosovës, u përdorën si pretekst nga organet policore e ushtarake serbo-jugosllave, për të ndërmarrë aksione bastisjeje, kontrolli, arrestimi dhe ekzekutimi ndaj familjeve e civilëve shqiptarë. Këto masa, si akte në kuadër të krimeve kundër njerëzimit dhe krimeve të luftës, u aplikuan edhe në viset e Anamoravës.⁴ Gjatë vitit 1998, në Anamoravë ekzistonte një situatë e pasigurt dhe e tensionuar, ku jeta institucionale e shoqërore për shqiptarët ishte vështirësuar e paralizuar, ndërsa organet okupuese shtetërore, policore e ushtarake serbo-jugosllave ndërmorën aksione bastisjeje, ndalimesh arbitrare, kontrolli, arrestimi e burgosjeje ndaj familjeve e civilëve shqiptarë. Papunësia, mungesa e të hyrave, diskriminimi etnik në shtëpi shëndeti e spitale, mungesa e ushqimit të mjaftueshëm, mjeteve higjienike dhe lëvizja e kufizuar, rëndonin çdo ditë mbi supet e shqiptarëve. Megjithëkëtë, gjatë kësaj kohe në Anamoravë gjenin strehë qindra familje shqiptare të dëbuara nga zonat e luftës në Kosovë, me theks të veçantë nga Drenica. Rrjedhimisht, pushteti shtetëror serbo-jugosllav diktoi dhe imponoi kushte të atilla të jetesës që duhej të provokonin një fazë fillestare të

³ Statuti i Romës për Gjykatën Penale Ndërkombëtare, 1998, f. 5-9.

⁴ Komuna e Gjilanit, *Komisioni për grumbullimin e fakteve dhe dëmeve të luftës të vitit 1999*, Pjesa I, Gjilan, 2013, f.111, Deklaratë e Fetije Shabanit nga Tërstena mbi vrasjen e Nijazi Osmanit nga Gadishi, Gadish, më 25.08.1999.

shkatërrimit fizik të tërësishëm ose të pjesshëm të popullsisë shqiptare të kësaj treve.

Në fund të vitit 1998 dhe në pranverë të vitit 1999, sidomos nga 24 marsi, gjoja për të zbuluar forcat e armatosura të UÇK-së, që vepronin në kuadër të Zonës Operative të Karadakut (ZOK), formacione ushtarake e policore, në përbërje të një pjeseje të serbëve e romëve lokalë, shpeshherë të maskuar, madje edhe me mercenarë nga vendet sllavo-lindore, filluan një fushatë të madhe krimesh serioze, të shoqëruara me plaçkitje, grabitje, granatime, djegie, dëbime, dhunë, arrestime, burgosje, vrasje e masakra ndaj popullsisë shqiptare në fshatra e qytete. Një rol frymëzues për të kryer akte të ndryshme krimesh serioze ndaj shqiptarëve të Anamoravës patën edhe kishat ortodokse, në të cilat strehoheshin e bekoheshin ushtarakët serbo-jugosllavë, ndërsa një numër fshatrash me shumicë serbe në këtë trevë, morën karakteristikat e shtabeve ushtarake e policore. Duhet theksuar se vrasjet ndaj civilëve të paarmatosur shqiptarë, janë kryer me paramendim dhe ekzekutimi është bërë në formë të ndryshme nga njësitë ushtarake e policore serbo-jugosllave.⁵

Më 24 mars 1999, ditën kur Aleanca Ushtarake Veri-Atlantike (NATO) sulmoi nga ajri caqet ushtarake serbo-jugosllave, forcat ushtarake të Federatës Jugosllave nga “Zabeli i Sahit Agës” në Gjilan, ku ndodhej edhe një kazermë e tyre, granatuan me katër predha Malishevën e Epërme, me ç’rast pati të vrarë e të plagosur.⁶ Atë natë,

⁵*Po aty*, f. 145, 174, 300-347, Deklarata të Zekri Ajetit dhe Vlora Shabanit, 10 e 13.08.1999, si dhe Propozim lidhur me parashtrimin e fletëkallximeve penale kundër të dyshuarve për krime lufte dhe vepra tjera penale të kryera në Komunën e Gjilanit dhe rrethinë gjatë periudhës së luftës mars-qershor 1999.

⁶Nijazi Idrizi, *I tillë ishte Hushi (Kujtime dhe dëshmi për Ibrahim Uruçi - Hushi)*, Gjilan: “Kurora”, 2017, f. 116.

forcat serbo-jugosllave përdorën edhe armë laserike, prej të cilave iu vu flaka disa shtëpive të këtij fshati.⁷ Një ditë pas bombardimeve të NATO-s në Kosovë, lëvizje tankesh e automjeteve policore dhe ushtarake serbo-jugosllave, nisën të qarkullonin me shpejtësi nëpër qytete e fshatra të Anamoravës.⁸ Në Gjilan, u granatua lagja “Çenar-Çeshme”, por nuk konfirmohej nëse kishte dëme njerëzore.⁹ Forcat ushtarake dhe policore u stacionuan nëpër rrugë lokale e magjistrale, për të mbajtur nën kontroll çdo lëvizje të popullsisë. Njëherësh, ato gjatë kontrolleve rrugore që i bënin shqiptarëve, kryenin edhe akte vrasjeje, plagosjeje e plaçkitjeje. Krahas kësaj, në fshatrat Vërban e Gërlicë të Vitisë vendosën edhe sisteme raketore.¹⁰

Marrjet peng, keqtrajtimet, grabitjet, dëbimet dhe vrasjet në fshat e qytet

Një fenomen që ka shoqëruar fushatën dhe kategorinë e krimeve serioze serbo-jugosllave ndaj shqiptarëve, ishte kidnapimi

⁷Intervistë e realizuar me NaserSelmanin (1965) nga Pogragja, përgjegjës i Logjistikës në Njësitin e UÇK-së në Pogragjë dhe ndërlidhës me njësite të tjera, Gjilan, 8 qershor 2019.

⁸*Arkivi i Luftës i Agjencisë Shtetërore Informative “Kosovapress”*, Vëllimi i parë (4 janar - 28 shkurt 1999), Prishtinë: Instituti i Historisë - Prishtinë, 2016, f. 350, Kronikë e luftës nga Zona Operative e Neredimes, Ferizaj, 25 mars 1999.

⁹*Po aty*, f. 408, Granatohet një lagje e qytetit të Gjilanit, Gjilan, 29 mars 1999.

¹⁰*Po aty*, f. 528, Tre të vrarë në Novosellë të Vitisë, Viti, 20 prill 1999. Pas pak ditësh raportohej se në fshatin Terstenik të Vitisë, formacione ushtarake serbo-jugosllave kishin ekzekutuar një grua dhe dy burra të moshës mbi 50-vjeçare, ndërsa në Smirë ato vranë 5 shqiptarë. Shih:*Arkivi i Luftës i Agjencisë Shtetërore Informative “Kosovapress”*, Vëllimi i tretë (11 prill - 15 maj 1999), Prishtinë: Instituti i Historisë - Prishtinë, 2016, f.167, Janë djegë fshatrat e Malësisë së Gjilanit, Gjilan, 23 prill 1999.

ose marrja peng e shqiptarëve. Këto raste kanë ndodhur zakonisht gjatë lëvizjeve të detyruara të shqiptarëve, për arsye të nevojave familjare, që ata i bënin gjatë kësaj kohe nga një fshat në tjetrin ose nga fshati në qytet e anasjelltas. Gjatë mbajtjeve, ata përballeshin me presione e keqtrajtime psiko-fizike, madje edhe kërcënime të drejtpërdrejta. “*Kjo është Serbi!*”, “*Të gjithëve do t’ju mbysim!*”, “*Me çfarë plumbash dëshironi t’ju mbysim?*”, “*Ne jemi këtu!*” etj., ishin shprehjet e disa prej pjesëtarëve të një njësi ushtarak serbo-jugosllav në fshatin Pasjan, i banuar me popullatë serbe, derisa i vërsuleshin Emrush Selimit nga Llashtica, i mbajtur peng për disa orë, më 28 mars 1999.¹¹ “*Do t’ju dërgojmë tek grupi tjetër, i cili është* (ka për detyrë, F. R. & N. M.) *vetëm për të prerë* (shqiptarë, F. R. & N. M.)” - deklaroi Rexhep Selmani nga Sllubica, derisa po mbahej peng për dy orë nga një grup ushtarak serbo-jugosllav, më 5 prill 1999 në Sllubicë.¹² Gjuha dhe format e kërcënimeve, që janë drejtuar ndaj civilëve shqiptarë të paarmatosur, nënkupton se elementët ushtarakë dhe policorë serbë kanë vepruar në përputhje me një platformë paraprake shtetërore, e cila ka qenë e hartuar dhe koncentruar ekskluzivisht për shkatërrimin e shqiptarëve.

Midis të keqtrajtuarve e të rrahurve, si pasojë e dhunës, pati raste kur viktimat nuk i bënë ballë dhimbjeve dhe pas pak ndërronin

¹¹ Komuna e Gjilanit, *Komisioni për grumbullimin...*, Pjesa I, f. 184, Deklaratë e Emrush Selimit për krimin e kryer në vendin e quajtur “Likovat” të fshatit Lashticë, Gjilan, 13.08.1999.

¹² Fragment nga faksimili i deklaratës së Rexhep Selmanit (1968) nga Sllubica e Gjilanit, dhënë Naser Selmanit (1965) nga Pogradja e Gjilanit, Pogradje, 09.09.2000. Faksimili i është dërguar autorëve nga Naser Selmani (1965) në formë elektronike.

jetë.¹³ Kuptohet, synimi i forcave serbo-jugosllave ishte të ngjallnin frikë tek shqiptarët e kidnapuar e keqtrajtuar, që përmes tyre të përcillnin mesazhe negative në fshatra e qytete, se ata nuk ishin të dëshirueshëm në Anamoravë. Pra, përmes këtyre akteve synohej kalimi gradual tek faza e spastrimit etnik të Anamoravës. Ata që kundërshtonin urdhrat, potencialisht edhe vriteshin.

Aktiviteti i grupeve ushtarake e policore serbo-jugosllave, për të vrarë shqiptarë brenda e jashtë shtëpive, ishte shtrirë edhe në qytete. *“Hoqesh li josh?”* (*“Doni më shumë?”*), kishte deklaruar Nenadi, njëri nga të uniformuarit serbë, më 28 mars 1999, kur kishte goditur me armë automatike dhe 5 plumba MelekeRashitin (15-vjeçare) në Gjilan. *“Spitali ishte i mbyllur... U munduam... t’i ofronim ndihmë, por... nuk jetoi më shumë se 3 orë prej momentit kur u qëllua. Të nesërmen e kemi varrosur... në varreza të qytetit vetëm me disa pleq”* - deklaronte babai i Melekes, Xhelali.¹⁴ Njësitë dhe grupet ushtarake e policore serbo-jugosllave, i kishin duart e lira për të vepruar e kryer krime ndaj shqiptarëve, një numër i madh i të cilëve detyrohej të braktiste shtëpitë dhe të merrte rrugën e dëbimit nga vendbanimet. Pra, vrasjet, bllokimi i institucioneve shëndetësore dhe presioni i vazhdueshëm, ishin akte kriminele të forcave serbo-jugosllave, që kishin për qëllim krijimin e kushteve për eliminimin e tërësishëm ose të pjesshëm të shqiptarëve.

¹³ Ushtria Çlirimtare e Kosovës - Zona Operative e Karadakut, Shërbimi për Informim Publik, Informatë e Sokol Gashit për TVSH-në, 9 qershor 1999. Dokumenti i është ofruar autorëve nga arkivi i Ismet Sylejmanit, përgjegjës për informim në Zonën Operative të Karadakut.

¹⁴Komuna e Gjilanit, *Komisioni për grumbullimin...*, Pjesa I, f. 120, Deklaratë e Xhelal Rashitit për krimin e kryer ndaj vajzës së tij, Melekes.

Grabitje dhe plaçkitje, si elemente krimesh në kuadër të kategorive të krimeve serioze, nga të gjitha forcat e armatosura serbo-jugosllave kishte pothuajse në secilin qytet e fshat me shqiptarë të Anamoravës. Aksionet e tilla i nënshtroheshin një plani paraprak të menduar mirë. Fillimisht vlerësohej rreziku dhe pasojat eventuale para se të fillonte aksioni. Në anën tjetër, qëllimi i aksionit ishte vlerësimi i reaksionit dhe pikësynim dëbimi i dhunshëm i shqiptarëve nga shtëpitë, që i hynte në funksion pushtimit të territorit dhe strategjisë politike të spastrimit etnik, e cila bazohej në planin operacional shtetëror serbo-jugosllav “Patkoi”.¹⁵ Kësisoj, në mëngjesin e 16 prillit 1999, forca të armatosura dhe të uniformuara serbo-jugosllave, urdhëruan shqiptarët e fshatit Malishevë që brenda dy orësh të braktisnin shtëpitë e tyre dhe të niseshin drejt Maqedonisë. Dëbimi i tyre drejt Gjilanit u shoqërua me vrasje, plagosje, grabitje makinash, parash e bizhuterish, rrahje dhe kërcënime me vdekje. Rrjedhimisht, kolona e tyre vetëm në rrugën Gjilan-Klllokot u ndal nëntë herë. Dëshmitarët pohojnë se “ata (forcat e armatosura serbo-jugosllave, F. R. & N. M.) morën granatat e dorës e zunë të na thoshin se do t’i hidhnim në mes të grumbullit të fëmijëve, nëse do të dilnin duarbosh”.¹⁶ Kësisoj, qëllimi për të shkatërruar hapësirën e domosdoshme jetësore të shqiptarëve të Anamoravës, përmes dëbimit të planifikuar të tyre dhe plaçkitjes së pasurisë, përbën një nga aktet e gjenocidit që strukturat shtetërore,

¹⁵ Bardhyl Mahmuti, *Mashtrimi i madh*, Tetovë: “Çabej”, 2015, f. 241-256.

¹⁶ *Nën pushtetin e urdhrave - krimet e luftës në Kosovë*, Human Rights Watch, Përktheu nga origjinali anglisht: Mustafa Nano & Virgjil Muçi, Tiranë: “Korbi”, 2002, f. 157.

ushtarake dhe policore serbo-jugosllave kanë kryer ndaj shqiptarëve në Anamoravë.

Më 18 prill 1999, një kolonë me mbi 500 traktorë dhe rreth 30.000 shqiptarë nga Gjilani, Velekinca, Llashtica, Lladova, Livoçi i Poshtëm, Livoçi i Epërm, Përlepnica, Kmetoci, Verbica, Dobërqani, Bukoviku, Uglari, Pogragja, Llovca, Sllubica, Kokajt, Bilinica, Stublina etj., mori rrugën malore nga Dobrosini drejt Preshevës dhe Maqedonisë. Në momentin kur kolona kishte arritur në zonën neutrale afër Preshevës, nisi maltretimi i saj nga forcat ushtarake dhe policore serbo-jugosllave. Kjo kolonë u vëzhgua në mënyrë klandestine nga ushtarë të UÇK-së të Zonës Operative të Karadakut. Disa prej tyre, ftuan dhe ndihmuan depërtimin e një grupi gazetarësh të një televizioni francez, brenda radhëve të kolonës, i cili bëri intervistimin e popullsisë së dëbuar dhe raportimin televiziv për nisjen e kësaj kolone drejt Maqedonisë. Raportimi në televizion reflektoi në nisjen e dhjetëra autobusëve maqedonas në kufirin midis Miratocit dhe Llojanit. Rrjedhimisht, për fatin e mirë, kolona i shpëtoi krimeve të mëtejme, por nuk munguan fyerjet dhe ofendimet në drejtim të shqiptarëve, që nga Presheva në këmbë u nisën drejt zonës kufitare.¹⁷

Pra, gjatë muajve mars-qershor 1999, popullsia shqiptare e Anamoravës u detyrua të ndiqte rrugët fushore, malore dhe hekurudhore drejt vendkalimeve kufitare me Maqedoninë, si nga ana e Grykës së Karadakut (Bellanoc - Stançiç), ajo e Bujanocit dhe Preshevës (Miratoc - Llojan), si dhe ato në drejtimin Han i Elezit - Bllacë dhe Glloboçicë - Jazhincë. Në Maqedoni u sistemuan në

¹⁷ Intervistë e realizuar me Naser Selmanin (1965) nga Pogragja, përgjegjës i Logjistikës në Njësitin e UÇK-së në Pogragjë dhe ndërlidhës me njësite të tjera, Gjilan, 8 qershor 2019.

kampe refugjatësh në rrethinën e Shkupit e të Tetovës dhe tek të afërm e familje shqiptare. Procesin e dëbimit të dhunshëm të shqiptarëve e ka karakterizuar mungesa e ushqimeve, kushtet e papërshtatshme klimatike, terreni i mundimshëm gjeografik, mjetet e pamjaftueshme të transportit, mungesa e mjeteve sanitare, higjienës, ujit etj. Mirëpo, solidarizimi me strehim, ushqim e veshmbathje i familjeve, fshatrave e qyteteve nëpër të cilat kalonin kolonat e të dëbuarve, zvogëloi pjesërisht katastrofën humanitare.

Në anën tjetër, forcat ushtarake e policore serbo-jugosllave, duke respektuar platformën shtetërore të planit operacional “Patkoi”, për spastrimin etnik të Anamoravës, detyronin civilët shqiptarë të lëviznin drejt zonave ku dyshohej se vepronin njësite të UÇK-së, për t’i izoluar ato dhe për t’ua bërë të pamundur funksionimin e të gjitha rrugëve të furnizimit dhe për të paralizuar aktivitetin e tyre në Zhegoc e Marec, ku vepronte Shtabi i ZOK-ut.¹⁸ Në këtë kontekst, pas Betejës së Zhegocit, e zhvilluar më 15 prill 1999, midis forcave të UÇK-së dhe forcave ushtarake e policore serbo-jugosllave, këto të fundit meqë pësuan dëme materiale e njerëzore, për të zbatuar politikën e krimeve serioze për shkatërrim të tërësishëm ose të pjesshëm të shqiptarëve, në shenjë hakmarrjeje dhe meqë nuk kontrollonin këtë zonë, i vunë zjarrin fshatrave të Malësisë së Zhegocit: Verbicë, Zhegoc, Plitkoviq, Vrellë, Sllakoc i Muhaxherëve, Sllakoc i Jerlive, Gadish e Kishnapole. Largimi paraparak i civilëve shqiptarë nga vendbanimet në fjalë dhe dëbimi drejt Gadimes së Lipjanit, pjesërisht dhe përkohësisht i shpëtoi nga akte të tjera

¹⁸N. Idrizi, *I tillë ishte Hushi...*, f. 115.

kriminele.¹⁹ Mirëpo, pas ofensivës policore e ushtarake serbo-jugosllave, në këto treva u vranë e masakruan dhjetëra civilë të paarmatosur shqiptarë e dhjetëra të tjerë u arrestuan.²⁰

Zgjerimi gjeografik i krimeve në Anamoravë

Gjatë muajit maj 1999, në Anamoravë u zgjeruan krimet serbe qe morën trajtën e gjenocidit serbo-jugosllav ndaj shqiptarëve. Agjencia Informative “Kosovapress”, sipas një njoftimi të datës 10 maj 1999 nga Vitia, shkruan: *“Një grup i madh paraushtarësh* (strukturë e armatosur nën dirigjimin e organeve shtetërore të mbrojtjes dhe sigurisë, F. R. & N. M.) serbë pardje kanë hyrë në fshatin Verban, komuna e Vitisë, ku e kanë sulmuar popullsinë civile, duke e detyruar atë që menjëherë ta lëshojë fshatin. Popullata e këtij fshati është detyruar të tërhiqet në drejtim të fshatrave tjera dhe të bjeshkës, ku ka improvizuar tenda. Merret vesh se dje paraushtarët serbë në këtë fshat kanë vranë mësuesin, me mbiemrin Emërllahu*.”*²¹ Rastet kur forcat e armatosura serbo-

¹⁹ Arkivi i Luftës i Agjencisë Shtetërore Informative “Kosovapress”, Vëllimi i tretë (11 prill-15 maj 1999), Prishtinë: Instituti i Historisë - Prishtinë, 2016, f. 83, Në Terstenik tre, në Smirë pesë të vranë nga forcat serbe, Viti, 16 prill 1999.

²⁰ Po aty, f.339, Lista e civilëve të vranë nga serbët në malësinë e Zhëgocit, Gjilan, 5 maj 1999.

*Republika Federative e Jugosllavisë, nën dirigjimin e Serbisë, për të minimizuar dhe mohuar krimet e gjenocidit ndaj shqiptarëve, formoi struktura të veçanta dhe të armatosura, në kuadër të të cilave bënë pjesë edhe anëtarë të organeve ushtarake, policore dhe të shërbimit sekret. Shih më gjerësisht: B. Mahmuti, *Mashtrimi...*, f. 287-288.

* Bëhet fjalë për Rexhep Halim Emërllahun (1972-1999). Për vrasjen e tij dyshohet Millosh Jokiq (1979), malazez, pjesëtar i formacioneve paraushtarake serbo-jugosllave, ndaj të cilit është ngritur edhe aktakuzë nga Gjykata e Qarkut në Gjilan.

jugosllave, të të gjitha organizimeve dhe strukturave, futeshin brenda fshatrave dhe shtëpive shqiptare, ishin tepër frikësuese dhe tronditëse për civilët e paarmatosur, fëmijët, gratë dhe të moshuarit. I mbetej meshkujve të moshës së burrërisë të diskutonin kryesisht në gjuhën serbe me forcat serbo-jugosllave e rrjedhimisht t'i përgjigjeshin urdhrave të tyre. Në rast të kundërt, ata kërcënoheshin, keqtrajtoheshin fizikisht ose ekzekutoheshin.

Në bazë të një kronike të sektorit për Informim me Publikun të Zonës Operative të Karadakut, për Agjencinë Informative “Kosovapress”, më 17 maj 1999, raportohet për një shkallë të lartë krimi të gjenocidit të forcave serbo-jugosllave ndaj fshatrave dhe popullsisë shqiptare. Dëbime masive, dhunë, plaçkitje, djegie shtëpish, vrasje e masakra, e karakterizuan Anamoravën. Forca të shumta serbo-jugosllave, më 11 maj 1999, i bënë një rrethim fshatrave të Kamenicës: Hogosht, Topanicë, Shipashnicë, Rogaçicë, Koretin, Karaçevë dhe fshatra të tjera, për të kryer mizori me karakter gjenocidi ndaj popullsisë shqiptare. Sipas kësaj kronike: “*Në këtë aksion në Rogaçicë e kanë vrarë dhe masakruar Nevzat Kryeziun (1936),... në oborrin e tij... Pastaj ia ndezën shtëpitë e dy djemve të tij, të Bajramit dhe të Refikut*”. Të njëjtën ditë, forcat serbo-jugosllave nuk u mjaftuan me kaq dhe vazhduan aksionin edhe në fshatra të tjera. Kësisoj, “*në Hogosht milicët vranë Mehmet Abedinin** dhe

Shih më gjerësisht: *Pasqyrë e gjykimeve për krimet e luftës në Kosovë në periudhën 1999-2018*, Prishtinë: Fondi për të Drejtën Humanitare në Kosovë, 2018, f. 22-25.

²¹*Arkivi i Luftës i Agjencisë Shtetërore Informative “Kosovapress”, Vëllimi i tretë (11 prill - 5 maj 1999)*, Prishtinë: Instituti i Historisë-Prishtinë, 2016, f. 420, Paraushtarët serbë detyruan popullatën ta lëshojë fshatin, Viti, 10 maj 1999.

*Bëhet fjalë për Mehmet Sali Sabedinin (1950-1999) nga Hogoshti, i vrarë në Karaçevë.

*Ramadan Latifin**, të cilëve edhe ua dogjën shtëpitë”. Në të njëjtin fshat, forcat serbo-jugosllave i vunë zjarrin edhe disa shtëpive të tjera. Atë ditë “*në fshatin Kopernicë vritet Ismail Ismaili* (44) dhe plaçkitën e dogjën dy shtëpi*”.²²

Sikurse ndaj fshatrave Rogaçicë, Hogosht e Kopernicë, forcat serbo-jugosllave zbatuan një metodë djegieje, plaçkitjeje dhe tortureje psikike e fizike në fshatrat Koretin e Topanicë, për ta detyruar popullsinë e Kamenicës dhe fshatrave përreth jo vetëm të braktiste shtëpitë, por përgjithnjë të dëbohej nga vendbanimet e saj. Për më tepër, ato nisën edhe regjistrimin e popullsisë që vazhdonte të qëndronte nëpër fshatrat e Kamenicës.²³ Pas regjistrimit, të regjistruarit i lëshohej një vërtetim dypjesësh “*për pranimin e lajmërimit - ç’lajmërimit të vendbanimit*”, në të cilin jepeshin të dhëna mbi identitetin e të regjistruarit dhe shënohej se i njëjti është refugjat dhe se është larguar me dëshirë nga vendbanimi i tij. Pra, ata konsideroheshin se nuk ishin banorë rezidentë, por të ardhur nga vendbanime të tjera të Kosovës. Ata porositeshin që vërtetimin në fjalë t’ia prezantonin policisë serbo-jugosllave çdoherë që rastisnin me të. Në fakt, në fshatra të Kamenicës ekzistonte një numër i konsiderueshëm shqiptarësh të dëbuar nga fshatra të rrethinës së Prishtinës e viseve të tjera. Rrjedhimisht, shumica e shqiptarëve nga

* Bëhet fjalë për Ramadan Asllan Latifaj (1950-1999) nga Hogoshti, i vrarë në Karaçevë të Epërme.

* Bëhet fjalë për Ismail Xhavit Ismailin (1954-1999) nga Kopërnica, mjek i Shoqatës “Nënë Tereza”.

²² Arkivi i Luftës i Agjencisë Shtetërore Informative “Kosovapress”, Vëllimi i katërt (16 maj - 17 qershor 1999), Prishtinë: Instituti i Historisë - Prishtinë, 2016, f.53, Kronikë lufte nga Zona Operative e Karadakut, Kamenicë, 17 maj 1999.

²³ Po aty, f.53, Kronikë lufte nga Zona Operative e Karadakut, Kamenicë, 17 maj 1999.

këto fshatra u detyruan të dëboheshin në drejtimin Bujanoc-Preshevë-Kumanovë, një pjesë të strehoheshin përkohësisht në male dhe një numër t'i bashkoheshin UÇK-së në kuadër të Zonës Operative të Karadakut.²⁴ Pra, veç katastrofës humanitare, e cila kërcënonte mbijetesën njerëzore të shqiptarëve, organet okupuese serbo-jugosllave nuk iu njohën atyre as statusin e popullatës rezidente. Për më keq, shqiptarët u detyruan të firmosnin dokumente që theksonin largimin me dëshirë nga shtëpitë e tyre. Pra, të gjitha këto forma e metoda krimesh serioze, pikësynim kryesor kishin shkatërrimin e shqiptarëve të kësaj treve.

Rrjedhimisht, edhe popullata e fshatrave Gadish, Kishnapole, Sllakoc, një pjesë e Zhegocit dhe Verbicës, u detyrua të merrte rrugën hekurudhore nga Rubovci i Lipjanit në drejtim të Maqedonisë. Për pasojë, më 23 maj 1999, në Zhegoc të Epërm u plagosën dy civilë shqiptarë (plaka Sabrije Baftiu dhe Përparim Bajrami, 16-vjeçar) dhe u plaçkit e më pas u dogj shtëpia e Sabit Bajramit. Represioni dhe dhuna e forcave serbo-jugosllave me një intensitet të lartë u koncentrua në fshatrat Bresalc, Ponesh, Livoç i Epërm etj.²⁵ Më 8 qershor 1999, ndaj fshatrave Verbicë, Zhegoc i Epërm, Zhegoc i Poshtëm, Sllakoc dhe Kishnapole, forcat serbo-jugosllave ndërmorën një fushatë të re granatimi me arsenalin më të fuqishëm, nga

²⁴ Deklaratë dhe dokument i prezantuar para autorëve nga Nazmi Mujaj, i lindur në Hogosht (1972) të Kamenicës (tani drejtor i Arkivit Ndërkomunal të Gjilanit), Gjilan, 25 maj 2019.

²⁵ *Arkivi i Luftës i Agjencisë Shtetërore Informative "Kosovapress"*, Vëllimi i katërt (16 maj - 17 qershor 1999), Prishtinë: Instituti i Historisë - Prishtinë, 2016, f. 228-229, Dhunë e represion i forcave serbe në Malësinë e Zhegocit, Gjilan, 29 maj 1999.

pozicionet e tyre në Parallovë, Bresalc, Ponesh dhe nga “Pishat”, në krahun e majtë të liqenit të Livoçit.²⁶

Arrestimi dhe burgosja e intelektualëve, krim serioz për shkatërrimin e mëtejshëm të shqiptarëve

Forcat ushtarake, policore dhe njësi të tjera të armatosura serbo-jugosllave, mbi bazën e një platforme të dirigjuar nga politika shtetërore, nisën një fushatë të re krimesh serioze, për të keqtrajtuar e burgosur një pjesë të intelektualëve dhe aktivistëve të Anamoravës, që vazhdonin të qëndronin në shtëpitë e tyre. Ata përçmoheshin, fyheshin e keqtrajtoheshin çdoherë që rastisnin me komisionet e posaçme, në kuadër të kontroleve nëpër shtëpi dhe regjistrimeve mbi popullsinë, që bëheshin në muajt maj-qershor 1999.²⁷

Fushata e regjistrimit, veç tjerash kishte për qëllim edhe identifikimin profesional dhe intelektual të shqiptarëve, që për shtetin dhe forcat serbo-jugosllave përbënin rrezik dhe kërcënim serioz. Rrjedhimisht, nga 10-12 maj 1999, në Gjilan u arrestuan dhe u burgosën mbi 20 intelektualë, veprimtarë e aktivistë të shoqërisë civile. Midis tyre ishin: FazliAbdullahu, kryetar i Këshillit për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut (KMDL NJ) në Gjilan; SelajdinAbdullahu, vëllai i Fazliut, të dy ish të burgosur politikë; Masar Morina, avokat; HivziRamadani, veprimtar; Muharrem Bajrami, veprimtar; XhemajlXhemajli, historian; NaimShaqiri,

²⁶*Po aty*, f. 360, Edhe sot luftime në fshatrat e komunës së Gjilanit, Gjilan, 8 qershor 1999.

²⁷Deklaratë e Nazmi Mujaj, i lindur në Hogosht (1972) të Kamenicës (tani drejtor i Arkivit Ndërkomunal të Gjilanit), dhënë autorëve në Gjilan, 25 maj 2019.

veprimtar; Xhevdet Demiri, mjek; Enver Ramizi, ish-polic dhe ish i burgosur politik; Mehmet Kurteshi, veprimtar dhe veteran i arsimit; Sabit Kurteshi, djalë i Mehmetit, profesor; Ahmet Aliu, profesor, ish i burgosur politik; Riza Syla, pedagog nga Bresalci etj. Veç tyre, midis të arrestuarve kishte edhe një numër të madh nga Drenica, që ishin strehuar përkohësisht në Gjilan.²⁸

Në ditët e para të muajit qershor 1999, u raportua se numri i të arrestuarve ishte 36 vetë, prej të cilëve 15 po mbaheshin në burg.²⁹ Pas kapitullimit serbo-jugosllav, të burgosurit politikë, që mbaheshin në burgun e Gjilanit, i transferuan në burgun e Vrajës.³⁰ *“Më 11 maj 1999, rreth tetë policë erdhën dhe më arrestuan në shtëpi. Pasi më dërguan në burgun e Gjilanit, më rrahën e keqtrajtuan fizikisht. Shumë shpejt, si pasojë e torturave, humba në peshë fizike dhe pësova probleme shëndetësore. Policët më kërcënonin dhe më thoshin se unë e kam ftuar NATO-n në Kosovë dhe më thoshin se unë isha komandanti kryesor i UÇK-së në Gjilan. Pasi na dërguan në Vrajë, më 23 qershor 1999 na liruan nga burgu”* - rrëfen Xhemajl Xhemajli, profesor, historian, veprimtar aktiv, themelues e bashkëthemelues i pluralizmit politik në Gjilan dhe anëtar i Shoqatës së Historianëve të Kosovës. Sipas tij, 37 veprimtarët dhe intelektualët e Gjilanit, u arrestuan dhe u burgosën pas një urdhri të gjeneralit serb,

²⁸ *Arkivi i Luftës i Agjencisë Shtetërore Informative “Kosovapress”*, Vëllimi i katërt (16 maj - 17 qershor 1999), Prishtinë: Instituti i Historisë - Prishtinë, 2016, f. 228. Arrestime masive në qytetin e Gjilanit, Gjilan, 29 maj 1999.

²⁹ *Po aty*, f. 335. Nuk ka tërheqje, ka përforcime të forcave serbe, Gjilan, 7 qershor 1999.

³⁰ *Po aty*, f. 408. Në Gjilan kanë hyrë trupat franceze dhe ato britanike, Gjilan, 13 qershor 1999.

NebojsaPavković, që kishte kërkuar spastrimin etnik të Anamoravës dhe gjithë Kosovës.³¹

Është e rëndësishme të theksohet se veç intelektualëve e veprimtarëve, që ishin kategori e posaçme të burgosurish, në Anamoravë janë arrestuar e burgosur edhe dhjetëra e qindra civilë të tjerë shqiptarë, që më pas forcat serbo-jugosllave, paralelisht me keqtrajtimet e ndryshme, i detyruan të angazhoheshin në punë të rënda fizike, siç ishte hapja e llogoreve në zona fushore dhe kodrinore-malore etj.³² Arrestimet dhe burgosjet, si akte krimesh serioze, kishin për qëllim shkaktimin e lëndimeve serioze trupore ose mendore të shqiptarëve, nxitjen e pretekstit për vrasjen e tyre, pengimin ose zhvillimin e formimit të tyre biologjik dhe imponimin e qëllimshëm të kushteve të atilla, për të shkaktuar shkatërrimin e tyre fizik ose mendor të plotë ose të pjesshëm. Rrjedhimisht, ky qëllim i forcave serbo-jugosllave argumenton gjenocidin ndaj shqiptarëve të Anamoravës.

Masakra e Llashticës, akt kulmor i gjenocidit në Anamoravë

Ndër masakrat më të njohura për nga përshkallëzimi i krimit të gjenocidit dhe numri i të masakruarve, janë: masakra e Llashticës,

³¹ Intervistë e realizuar me mr. Xhemajl Xhemajlin (1942), historian, profesor dhe veprimtar, Gjilan, 22 qershor 2019.

³² Intervistë e realizuar me NaserSelmanin (1965) nga Pogradja, përgjegjës i Logjistikës në Njësitin e UÇK-së në Pogradje dhe ndërlidhës me njësite të tjera, Gjilan, 8 qershor 2019.

masakra e Zhegrës³³, masakra e Llovçës, masakra e Zhegovcit dhe masakra e Lladovës.³⁴ Masakra e vrasje u shënuan edhe në vendbanime të tjera të Anamoravës. Mirëpo, për nga numri, shkalla e krimit dhe metodat e mjetet e përdorura për të kryer krimin, në Anamoravë veçohet masakra e Llashticës, e kryer gjatë muajit prill 1999.

Më 27 mars 1999, forcat serbo-jugosllave kishin kryer një aksion granatimi ndaj fshatit Llashticë, që detyroi popullsinë të braktiste shtëpitë dhe të strehohej përkohësisht në male, ndërsa një pjesë u zhvendos në fshatra të tjerë të Anamoravës.³⁵ Në këtë fshat, forcat ushtarake, policore dhe njësi të tjera të armatosura serbo-jugosllave, vranë 26 civilë shqiptarë të paarmatosur, prej tyre 13 civilë i vranë dhe i dogjën brenda një shtëpie.³⁶ Në këtë masakër u vranë shqiptarë nga mosha e foshnjërisë, siç ishte Lirim N. Shabani, i lindur më 23 mars 1999. Pra, vetëm 21 ditë jetë. Ai, në prehrin e nënës së tij, Sevdijes, u godit në kokë me bajonetë nga një ushtar serb dhe pas pak ndërroi jetë. Veç tij, ishte edhe Fisnik S. Shabani, i lindur më 20 dhjetor 1996 dhe i djegur së gjalli me familje, më 30 prill 1999. Pra, vetëm 2 vjeç e gjysmë. Më pas edhe masakrimi i Lulzim F.

³³Për vrasjet dhe masakrat në Zhegër është akuzuar e dënuar edhe Vllado Zmajeviq (malazez). Shih më gjerësisht:

<http://www.rtcg.me/vijesti/hronika/242799/zmajevicu-14-godina-za-ratni-zlocin-na-kosovu.html>

³⁴Musa Sabedini, *Vrasje dhe dëshmi (Gjilan, Kamenicë, Viti)*, Prishtinë: Këshilli për Mbrojtjen e Lirive e të Drejtave të Njeriut (MKDLNJ), 2010, f. 20.

³⁵N. Idrizi, *I tillë ishte Hushi...*, f. 117.

³⁶M. Sabedini, *Vrasje dhe dëshmi...*, f. 26; Fetnete Ramosaj, *Kundër harresës - gjenocidi i Serbisë në Kosovë 1998-1999*, Prishtinë: Instituti për Hulumtimin e Krimeve të Luftës, 2017, f. 175.

Musliut, i lindur më 18 shkurt 1988 dhe i masakruar më 13 prill 1999. Pra, vetëm 11-vjeçar.³⁷

Dëshmitarët okularë paraqesin një tablo tronditëse të kujtimeve mbi momentet e përjetuara gjatë masakrës në Llashticë. Një fakt që i ka shqetësuar strukturat shtetërore serbo-jugosllave ishte fshehja e krimit të gjenocidit, duke tentuar që përmes strategjisë së zhdokjes së krimeve të mohojë përfshirjen e ushtrisë dhe policisë serbo-jugosllave në vrasjen dhe masakrimin e civilëve shqiptarë të paarmatosur në Llashticë. *“Pasi e ekzekutuan nënën dhe u vërtetua se të gjithë jemi të vdekur, i dëgjova duke thënë se duhet ndezur shtëpia për t’i humbur gjurmët...”* - rrëfen Deli Hyseni, i mbijetuar i masakrës së Llashticës, të datës 30 prill 1999.³⁸ Krimin e gjenocidit ndaj shqiptarëve të Llashticës organet politike serbo-jugosllave u përpoqën ta fshihnin dhe për paradoks t’ia atribuonin UÇK-së.³⁹ Veç fshatit Llashticë, paralelisht në fund të marsit e në fillim të muajit prill, u sulmuan edhe fshatra të tjerë të Anamoravës. Rrjedhimisht, civilë

³⁷ Masakra e Llashticës 13 prill 1999 (Dokumentar i transmetuar në Radio Televizionin e Kosovës - RTK), autor: Nusret Pllana, Publikuar, më 13 prill 2019, në kanalin e RTK-së:

<https://www.youtube.com/watch?v=Y0wqhOv0gWc&fbclid=IwAR1kEZJr1byao0K0NE14PWp1bR3fcgQBLbphU3ArejBysF8LZX2V9CLNvqU>

³⁸ Komuna e Gjilanit, *Komisioni për grumbullimin...*, Pjesa I, f. 176, Deklaratë e Deli Hysenit për krimin e kryer në fshatin Llashticë, Gjilan, 13.08.1999. Deliu, si pasojë e masakrës në Llashticë, më pas ka humbur shikimin. Shih për këtë: Masakra e Llashticës, 13 prill 1999 (Dokumentar i transmetuar në Radio Televizionin e Kosovës - RTK), autor: Nusret Plana, publikuar, më 13 prill 2019, në kanalin e RTK:

<https://www.youtube.com/watch?v=Y0wqhOv0gWc&fbclid=IwAR1kEZJr1byao0K0NE14PWp1bR3fcgQBLbphU3ArejBysF8LZX2V9CLNvqU>

³⁹ B. Mahmuti, *Mashtrimi...*, f. 543-545.

shqiptarë të vrarë nuk kishte vetëm në zona rurale, por edhe në ato urbane.⁴⁰

Pavarësisht formës se si janë kryer aktet kriminele të vrasjes së civilëve të paarmatosur shqiptarë në Llashticë e lokalitete të tjera të Anamoravës, që në opinion gjejnë zbatim me termin “masakër”, qëllimi kryesor i forcave serbo-jugosllave ka qenë shkatërrimi i shqiptarëve përkatësisht zbatimi i politikës gjenocidare ndaj tyre.

Një lloj krimesh serioze në Llashticë, që futen në kategorinë e krimeve kundër njerëzimit dhe krimeve të luftës, por që ilustrjnë dhe argumentojnë akte krimi me qëllime gjenocidare, janë edhe përdhunimi e abuzimi ndaj gruas e femrës shqiptare. *“Torturat dhe rrahjet vazhduan tërë kohën, pastaj filluan t’i ndajnë meshkujt nga femrat, të rinjtë nga të moshuarit..., duke kërcënuar se do t’i vrasin... Disa prej tyre (vajzave dhe nuseve) i morën nëpër vetura dhe i dërguan në një shtëpi tjetër... Pas kthimit të nuseve dhe vajzave komandiri (komandanti i njësitit të armatosur serbo-jugosllav, F. R. & N. M.) më tha që t’i pyes të njëjtat se a janë dhunuar dhe maltretuar, disa prej tyre thanë se po”* - rrëfen Qamil Ramushi, i mbijetuar i masakrës së 13 prillit 1999 në Llashticë.⁴¹ Vlen të theksohet se veç Llashticës, në Anamoravë u shënuan edhe raste të tjera të ngjashme ndaj gjinisë femërore shqiptare. Midis tyre, akte të tilla krimi janë shënuar edhe ndaj gjinisë mashkullore. Pra, ekzistojnë raste të krimit serioz, ku janë shkaktuar lëndime serioze trupore ose mendore ndaj shqiptarëve të Anamoravës. Rrjedhimisht, përmes dhunimeve synohet

⁴⁰ N. Idrizi, *I tillë ishte Hushi...*, f. 118-119.

⁴¹ Komuna e Gjilanit, *Komisioni për grumbullimin...*, Pjesa I, f. 178, Deklaratë e Qamil Ramushit për krimin e kryer në fshatin Llashticë, Gjilan, 13.08.1999.

shkatërrimi fizik e mendor i viktimave, i anëtarëve të familjeve e rrethit të tyre familjar dhe i shqiptarëve në tërësi.

Minimi i rrugëve, tërheqja e forcave serbo-jugosllave, hyrja e forcave të NATO-s dhe çlirimi i Anamoravës

Minimi i rrugëve fushore e malore, si akt brenda krimeve serioze serbo-jugosllave në Anamoravë, ka nisur që prej marsit deri në gjysmën e parë të muajit qershor 1999. Pas kapitullimit serbo-jugosllav dhe nënshkrimit të Marrëveshjes së Kumanovës, më 10 qershor 1999, një dukuri që e shoqëronte tërheqjen policore dhe ushtarake serbo-jugosllave ishte plaçkitja, djegia dhe minimi i zonave dhe rrugëve malore e fushore në Anamoravë. U minuan fshatrat Radivojc, Budrikë e Epërme, Ramjan, Tankosiq, Zllatar e Mirasalë. Konfirmimin se këto fshatra ishin të minuara, e paralajmëronin trupat e pajetë të bagëtive, që çdo ditë binin mbi mina.⁴² Edhe fshatra të tjerë të Moravës dhe Karadakut, përfshi rrugët malore e fushore, ishin minuar nga forcat serbo-jugosllave. Pas tërheqjes së forcave serbo-jugosllave në disa raste pësoi me jetë popullsia e kësaj treve si dhe frymë kafshësh.⁴³ Kësisoj, minimi i rrugëve kishte për qëllim shkatërrimin e gjithë zonës gjeografike shqiptare, për t'ia pamundësuar atyre zhvillimin e mëtejshëm të jetës në Anamoravë e

⁴² Ushtria Çlirimtare e Kosovës - Zona Operative e Karadakut, Shërbimi për Informim Publik, Informatë e IsmetSylejmanit, Gjilan, 28 qershor 1999. Dokumenti i është ofruar autorëve nga arkivi i IsmetSylejmanit, përgjegjës për informim në Zonën Operative të Karadakut.

⁴³ *Po aty*, Informatë e Sokol Gashit për TVSH-në, 9 qershor 1999. Dokumenti i është ofruar autorëve nga arkivi i IsmetSylejmanit, përgjegjës për informim në Zonën Operative të Karadakut.

rrjedhimisht për shkatërrimin fizik të tërësishëm ose të pjesshëm të tyre.

Më 12 qershor 1999, në Anamoravë hynë trupat francezë të NATO-s, të cilat u vendosën në shkollën fillore “AbazAjeti” në jug të Gjilanit, ndërsa trupat britanikë kishin hyrë në malësinë e Zhegocit dhe ishin vendosur në majën malore të fshatit Plitkoviq.⁴⁴ Forcave ushtarake, policore, paraushtarake e civile të armatosura serbo-jugosllave, nuk u mjaftoi plaçkitja dhe djegia e fshatrave shqiptare gjatë tërheqjes. Ato, jo vetëm që shtinin me armë ndaj shtëpive dhe fshatrave shqiptare, por, më 13 qershor 1999, duke u tërhequr nga Gjilani, në fshatin Dobërqan, 13 kilometra në lindje të Gjilanit, vranë hoxhën e fshatit, Nysret F. Hajdarin (1968), plagosën dy të tjerë dhe dogjën xhaminë. Mjaftoi që forcat paqeruajtëse franceze të NATO-s, të ndërhyenin ditën e nesërme, për të mundësuar varrimin e të vranit, për shkak të pasigurisë dhe frikës që ekzistonte tek popullata.⁴⁵

⁴⁴ *Arkivi i Luftës i Agjencisë Shtetërore Informative “Kosovapress”*, Vëllimi i katërt (16 maj - 17 qershor 1999), Prishtinë: Instituti i Historisë - Prishtinë, 2016, f. 408, Në Gjilan kanë hyrë trupat franceze dhe ato britanike, Gjilan, 13 qershor 1999.

⁴⁵ Ushtria Çlirimtare e Kosovës - Zona Operative e Karadakut, Shërbimi për Informim Publik, Informatë e Sokol Gashit për TVSH-në, 14 qershor 1999. Dokumenti i është ofruar autorëve nga arkivi i Ismet Sylejmanit, përgjegjës për informim në Zonën Operative të Karadakut; AssociatedPressArchive, Kosovo: Dobercan: NATO peacekeeping mision: Imam, June 14, 1999. Për më shumë hollësi, vizito kronikën e agjencisë së lajmeve në fjalë: <https://www.youtube.com/watch?v=hbJGP3TSBF4>. Gjenocidi serbo-jugosllav ndaj shqiptarëve të Anamoravës vazhdoi edhe në pjesën e dytë të muajit qershor. Rrjedhimisht, më 18 qershor 1999, në Leshtar të Kamenicës, ata vranë Basri Canollin (ushtar i UÇK-së nga Mareci), Sabri Krivaqën (ushtar i UÇK-së), Driton Krivaqën, Agush Isufin (nga Kamenica) dhe plagosën Gëzim Limanin, Arsim Hotlanin (nga Kamenica) dhe Arben Matoshin (nga Koretini). Shih: Ushtria Çlirimtare e Kosovës - Zona Operative e Karadakut, Shërbimi për Informim Publik, Informatë e Sokol Gashit, 21 qershor 1999. Dokumenti i është ofruar autorëve nga

Më 15 qershor 1999, në bazën e KFOR-it në Gjilan, zbarkuan marinsat amerikanë. Ata morën përsipër zbatimin e ruajtjes së paqes në këtë zonë, që pak ditë më parë e kishin marrë trupat ushtarake francezë, që do të lëviznin drejt bazës së tyre në Mitrovicë.⁴⁶ Të njëjtën ditë, në Gjilan hynë edhe trupat ushtarake të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), që vepronin në kuadër të Zonës Operative të Karadakut (ZOK) dhe komandoheshin nga Ahmet Isufi - Rexha, i cili para popullit shpalli të lirë qytetin e Gjilanit.⁴⁷ Veç Gjilanit, trupat ushtarake të UÇK-së në kuadër të ZOK-ut kishin hyrë edhe në Viti, më 14 qershor 1999, në Kamenicë, më 18 qershor 1999 dhe në Novobërdë, më 19 qershor 1999.⁴⁸

Kësisoj, me Marrëveshjen e Kumanovës, hyrjen e forcave të NATO-s në Kosovë, largimin e trupave ushtarake e policore serbo-jugosllave nga Kosova dhe futjen e trupave të UÇK-së nëpër qytete, u shënua përfundimisht çlirimi i Anamoravës dhe i Kosovës nga okupimi serbo-jugosllav.

arkivi i Ismet Sylejmanit, përgjegjës për informim në Zonën Operative të Karadakut.

⁴⁶ AssociatedPressArchive, Yugoslavia: Kosovo: Gnjilane: US marinës arrive, June 15, 1999. Për më shumë hollësi, vizito raportin e agjencisë së lajmeve në fjalë: <http://www.aparchive.com/metadata/youtube/e752622e144d5aab243b4e72bd374bf4>.

⁴⁷ Ushtria Çlirimtare e Kosovës - Zona Operative e Karadakut, Shërbimi për Informim Publik, Informatë e Sokol Gashit, 16 qershor 1999. Dokumenti i është ofruar autorëve nga arkivi i Ismet Sylejmanit, përgjegjës për Informim në Zonën Operative të Karadakut; Grup autorësh, *Gjilani me rrethinë - studim monografik*, Gjilan: Kuvendi i Komunës së Gjilanit, 2012, f. 176-177.

⁴⁸ Grup autorësh, *Gjilani me rrethinë...*, f. 177-178.

Dëmet njerëzore dhe materiale si pasojë e gjenocidit në Anamoravë

Gjatë periudhës së luftës në Anamoravë (shkurt 1998 - qershor 1999) janë vrarë ose masakruar 139 civilë shqiptarë të paarmatosur (112 të gjinisë mashkullore dhe 27 të gjinisë femërore). Mosha e civilëve të ekzekutuar ose masakruar sillet nga ajo e foshnjërisë deri tek ajo e pleqërisë, të të dy gjinive. Veç tyre, janë plagosur qindra të tjerë, ndërsa një numër i konsiderueshëm vazhdon të përballet me probleme shëndetësore dhe pasoja posttraumatike. Mijëra familje janë keqtrajtuar, ndërsa mijëra të dëbuar dhe emigruar në Evropë, Amerikë, Australi e Zelandë të Re, edhe pas 20 vjetësh nuk janë kthyer në shtëpitë e tyre. Për pasojë, u reduktua numri i shqiptarëve.

Vetëm nga 24 marsi deri më 12 qershor 1999, në rrethinën e Gjilanit janë plagosur më shumë se 102 shqiptarë, ndërsa pas 20 qershorit deri më 27 korrik 1999, janë plagosur 9 shqiptarë.⁴⁹ Midis të dëbuarve me dhunë, që u larguan në Maqedoni dhe nga atje në vende të ndryshme të botës, në Evropë, Amerikë, Australi e Zelandë të Re, një numër i konsiderueshëm edhe sot nuk është kthyer në shtëpitë e vendbanimet e tij. Kësisoj, nga 94 534 banorë sa mendohej të ketë pasur Gjilani e rrethina para luftës së viteve 1998-1999, në gusht 1999 numri i banorëve në këtë komunë sillej rreth 81 822 frymë.⁵⁰

⁴⁹Komuna e Gjilanit, *Komisioni për grumbullimin...*, Pjesa I, Regjistri i familjeve që kanë të plagosur gjatë periudhës së luftës prej 24 mars - 20 qershor 1999 dhe 20 qershor - 27 korrik 1999.

⁵⁰Komuna e Gjilanit, *Komisioni për grumbullimin e fakteve dhe dëmeve të luftës të vitit 1999*, Pjesa II, Gjilan, 2013, f. 18, Raport lidhur me pasojat e luftës në Kosovë të shkaktuar nga agresioni serb në Komunën e Gjilanit, Gjilan, më 18.08.1999.

Kështu, në Gjilan e rrethinë kanë humbur jetën 94 civilë shqiptarë të paarmatosur (72 meshkuj dhe 22 femra)⁵¹; në Kamenicë kanë humbur jetën 14 civilë shqiptarë të paarmatosur (të gjithë meshkuj)⁵²; në Viti e rrethinë kanë humbur jetën 29 civilë shqiptarë të paarmatosur (24 meshkuj dhe 5 femra)⁵³; në Novobërdë e rrethinë kanë humbur jetën 2 civilë shqiptarë të paarmatosur (të gjithë meshkuj)⁵⁴. Ende janë të pagjetur edhe 10 shqiptarë,⁵⁵ prej tyre të pagjetur nga Gjilani e rrethina janë 7 shqiptarë (të gjithë meshkuj)⁵⁶, në Kamenicë e rrethinë janë 2 shqiptarë (të gjithë meshkuj)⁵⁷ dhe në rrethinën e Vitisë është 1 shqiptar (meshkull).⁵⁸

Krahas viktimave e dëmeve njerëzore, gjatë viteve 1998-1999, në Anamoravë pati shkatërrim ose përvetësim të të mirave materiale, sulme e bombardime të fshatrave e qyteteve, të banesave e shtëpive të pambrojtura, që nuk ishin caqe ushtarake. U dogjën, u shkatërruan dhe u plaçkitën mijëra shtëpi, objekte ndihmëse, shkolla, spitale, shtëpi shëndeti, shtëpi të kulturës, objekte të trashëgimisë kulturore, zyra të gjendjes civile, biblioteka, objekte e institucione fetare, lokale afariste, stalla etj. U plaçkitën fonde bujqësore, blegtorale e kafshësh

⁵¹Jusuf Osmani, *Krimet e Serbisë në Kosovë 1998-1999*, Vëllimi 1, Prishtinë: Agjencia Shtetërore e Arkivave të Kosovës, 2012, f. 348.

⁵²*Po aty*, f. 433.

⁵³Jusuf Osmani, *Krimet e Serbisë në Kosovë 1998-1999*, Vëllimi 2, Prishtinë: Agjencia Shtetërore e Arkivave të Kosovës, 2012, f. 391.

⁵⁴*Po aty*, f. 7.

⁵⁵ Shih më gjerësisht: Ismet Salihu & Pajazit Nushi, *Personat e zhdukur gjatë luftës në Kosovë 1998/99*, Prishtinë: Instituti për Hulumtimin e Krimeve të Luftës, 2015.

⁵⁶ J. Osmani, *Krimet e Serbisë në Kosovë...*, Vëll. 1, f. 348.

⁵⁷*Po aty*, f. 433.

⁵⁸ J. Osmani, *Krimet e Serbisë në Kosovë...*, Vëll. 2, f. 391.

shtëpiake dhe u plaçkitën ose u shkatërruan dhjetëra e qindra lloje automjesh.

Në Gjilan e rrethinë u dogjën 950 shtëpi, 452 shtëpi u dogjën pjesërisht. Gjithashtu, u dogjën 288 objekte ndihmëse, 31 lokale, 380 pleme, 323 stalla, u plaçkitën 3 979 shtëpi.⁵⁹ Të shkatërruara ose dëmtuara janë 10 objekte shkollë, 4 zyre të gjendjes civile, 5 biblioteka, 2 shtëpi shëndeti dhe 11 xhami.⁶⁰ Në Kamenicë e rrethinë janë shkatërruar plotësisht 89 shtëpi dhe pjesërisht 91 shtëpi, 75 objekte të tjera janë shkatërruar plotësisht dhe 32 pjesërisht. Të shkatërruara janë edhe 18 lokale afariste, 1 shkollë, 3 zyre të gjendjes civile, 1 bibliotekë dhe 2 xhami.⁶¹ Në Viti e rrethinë janë shkatërruar 366 shtëpi dhe 143 objekte ndihmëse. Janë djegur e rrënuar tërësisht 2 shkolla fillore dhe 1 është dëmtuar, po ashtu 6 zyre të gjendjes civile, 1 bibliotekë dhe 4 xhami.⁶² Në Novobërdë e rrethinë janë shkatërruar 68 shtëpi dhe 15 objekte ekonomike-familjare.⁶³

Në Gjilan e rrethinë pati edhe automjete të plaçkitura, si: 14 kombanja, 657 traktorë, 878 vetura, 35 furgonë, 39 kamionë, 8 kamionë me rimorkio, 5 autobusë, 528 motokultivatorë, 1 eskavator dhe 2 makina shirëse për grurë. Veç tyre, u plaçkitën edhe 3 043 kafshë të trasha dhe 3 200 kafshë të imta.⁶⁴ Raste të tilla pati edhe në

⁵⁹ Komuna e Gjilanit, *Komisioni për grumbullimin...*, Pjesa II, f. 18, Raport lidhur me pasojat e luftës në Kosovë të shkaktuar nga agresioni serb në Komunën e Gjilanit, Gjilan, më 18.08.1999.

⁶⁰ J. Osmani, *Krimet e Serbisë në Kosovë...*, Vëll. 1, f. 347.

⁶¹ *Po aty*, f. 433.

⁶² J. Osmani, *Krimet e Serbisë në Kosovë...*, Vëll. 2, f. 391.

⁶³ *Po aty*, f. 11.

⁶⁴ Komuna e Gjilanit, *Komisioni për grumbullimin...*, Pjesa II, f. 18, Raport lidhur me pasojat e luftës në Kosovë të shkaktuar nga agresioni serb në Komunën e Gjilanit, Gjilan, më 18.08.1999.

Viti, Kamenicë dhe Novobërdë. Në mesin e objekteve të shkatërruara ka objekte të trashëgimisë kulturore⁶⁵ dhe shtëpi të kulturës. Në Anamoravë dëme materiale, grabitje të lëndës arkivore, librave kadastralë dhe të regjistrit civilë, pësuan edhe institucionet arkivore, si: Arkivi Regjional/Ndërkomunal i Gjilanit, Arkivi Komunal i Vitisë, Arkivi Komunal i Kamenicës dhe Arkivi Komunal i Novobërdës.⁶⁶

Vlera e përgjithshme monetare mbi dëmet materiale, në ekonomi familjare dhe infrastrukturë, sipas vlerësimeve institucionale të komisioneve të ndryshme, i afrohet shifrës prej 1 miliard eurosh. Në këto vlerësime monetare nuk llogariten dëmet njerëzore dhe pasojat shëndetësore. Pra, dëmet njerëzore dhe materiale janë dëshmi e ekzistencës së qëllimit për të shkatërruar shqiptarët e Anamoravës.

Për sa më sipër, në luftën e viteve 1998-1999, në Anamoravë, sikurse në tërë Kosovën, gjithçka që u takonte shqiptarëve, jeta dhe pasuria, ishin në shënjestër të forcave serbo-jugosllave, për të kryer shkatërrime sistematike dhe për t'ua mohuar shqiptarëve ardhmërinë në atdheun e tyre.

⁶⁵FejazDrançolli, *Trashëgimia e shkatërruar në Kosovë 1998/99*, Prishtinë: Instituti për Hulumtimin e Krimeve të Luftës, 2017, f. 37.

⁶⁶ Shih më gjerësisht: BakiSvirca, *Plaçkitja dhe shkatërrimi i fondit arkivor të Kosovës nga Serbia, para dhe gjatë luftës 1998-1999*, Prishtinë: Instituti për Hulumtimin e Krimeve të Luftës, 2016.

Fitim Rifati & Naim Musliu

SUMMARY

GENOCIDE AGAINST ALBANIANS IN ANAMORAVA (1998-1999)

The fact that in Anamorava, from February 1998 to June 1999, the military forces, polices and other formations and units of the Serbo-Yugoslav armed forces, have insulted, offended, threatened, arrested, imprisoned, mistreated, tortured, raped in all forms, expelled, killed, burned and massacred Albanians, as well as have looted, confiscated, destroyed and burned houses and other movable and immovable property, are constituent elements that argue the acts and types of the crime of genocide. The abandonment forced of homes and forced eviction from the settlements of thousands of unarmed Albanian civilians, wounding hundreds of others, opening the abyss to bury the bodies of dead Albanians, killings and massacres of tens and hundreds of others, attempts for the camouflage and disappearance of those killed and massacred, comprise acts of genocide, that military machinery, police and other Serbo-Yugoslav armed units have realized against unarmed Albanian civilians, in special way during the months of March-June 1999 in Anamorava. Burning, demolition and destruction of buildings of all kinds, even the destruction and undermining of roads, plains and mountains areas, are arguments proving that the Serbo-Yugoslav state intended to

complete transformation and destruction of this Albanian territory. The orchestration and realization of the Serbo-Yugoslav genocide in this region, as in the entire territory of Kosovo, has been subjected to a state-run platform, which is realized in a cyclical form, but unstoppable and concentrated exclusively against Albanians. So, during this time ascertain completely that a classical and systematic genocide was committed against Albanians.

Miftar KURTI

**Ushtria Çlirimtare e Kosovës sipas Henry H.
Perritt Jr. dhe James Pettifer**

Lufta e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), ka zgjuar kërkimin e studiuesve, historianëve, analistëve politikë dhe ushtarakë si dhe publicistëve të ndryshëm. Për UÇK-në dhe luftën e saj është shkruar nëpër gazeta e revista vendore e ndërkombëtare, nga më prestigjiozet në botë. Janë shkruar libra publicistikë dhe historikë, e janë shkruar dhe monografi. Janë shkruar dhe një numër jo i vogël i ditarëve të luftës nga poetë, shkrimtarë, studiues, historianë, politikanë, ambasadorë, gjeneralë e diplomatë karriere. Janë mbrojtur edhe tema diplome, të masterit dhe disertacion doktoratash. Nga kjo shumësi shkrimesh e veprash, kësaj radhe kam veçuar për trajtim dy monografi: *“Ushtria Çlirimtare e Kosovës: rrëfim prej brenda për një kryengritje”* me autor Henry H. Perritt Jr., Koha, Prishtinë, 2008, dhe *“Ushtria Çlirimtare e Kosovës: nga një luftë e fshehtë në një kryengritje të Ballkanit 1948-2001”* të James Pettifer, Onufri, 2013.

Karakteri çlirimtar i luftës së UÇK-së

Ideja për të shkruar librin *“Ushtria Çlirimtare e Kosovës: rrëfim prej brenda për një kryengritje”*, sipas autorit Henry H. Perritt Jr., erdhi pas një bisede me një ish-ushtar të UÇK-së. Libri hapet me një “Hyrie” dhe disa të dhëna “Shkurtimisht për librin”. Libri është i ndarë në tri pjesë: UÇK para luftës (pjesa e parë), gjatë

luftës (pjesa e dytë) dhe pas luftës (pjesa e tretë), kurse përbëhet prej njëmbëdhjetë kapitujve, ku trajtohen një mori çështjesh që kanë të bëjnë me luftën e UÇK-së dhe zhvillimet në Kosovë e më gjerë. Autori fokusohet dhe rrëfen për disa nga fytyrat (ushtarë, komandantë e prijës të luftës) e kësaj organizate politike-ushtarake dhe kundërshtarët e saj; për mënyrën se si u arrit të krijohet dhe formësohet opinioni dhe të ruhet mbështetja publike për të; për rekrutimin e luftëtarëve dhe komandantëve; për mënyrën se si ajo arriti t'i bëjë ballë sulmeve të Millosheviqit dhe t'i shpëtojë atij nga asgjësimi dhe shfrytëzimi; për mënyrën se si u financua ajo; për stërvitjet e organizuara; për furnizimin dhe mënyrat e sigurimit të linjave për furnizim me pajisjet e nevojshme në rrethana të luftës; për mënyrën se si u bind, si u formësua opinioni ndërkombëtar dhe raportet e saj me faktorin relevant ndërkombëtar; për politikat e pasluftës dhe për UÇK-në në "kutitë e votimit"; për akuzat, arrestimet dhe dënimet e disa ushtarëve dhe komandantëve të saj nga gjykata vendore (të mbikëqyrura nga UNMIK-u) e deri edhe te Tribunali për Krime të Luftës në Hagë. Pjesë e librit janë edhe tabela e akronimeve, emrat e organizatave dhe emrat e individëve që ka konsultuar gjatë hartimit të kësaj monografie. Në fund jepet bibliografia mjaft e pasur dhe një falënderim për ata që e kanë ndihmuar.

Rrëfimin për temën e trajtuar në këtë monografi, autori e ndërton kryesisht përmes zërit të atyre që organizuan, udhëhoqën dhe luftuan në radhët e kësaj organizate ushtarake dhe politike, si dhe përmes zërit të kritikëve të saj. Luftën e kësaj organizate autori e quan kryengritje. Kjo kryengritje, sipas tij, ishte një përzierje e motiveve të shekullit nëntëmbëdhjetë me teknikat e shekullit njëzetënjë. Nacionalizmi, ishte ideologjia kryesore e saj, edhe pse, sipas tij,

“UÇK-ja kishte tri ideologji që mund t’i përdorte: marksizëm-leninizëm, nacionalizëm shqiptar dhe islami. Nacionalizmi i la në hije dy të tjerat”. Rrëfimi këtu nuk na del thjesht një kronologji ngjarjesh a përjetimesh. Ai ndërtohet duke ia nënshtruar një skeme të formësuar nga njohuritë teorike dhe empirike rreth kryengritjeve të tjera, duke konkluduar se përvoja e UÇK-së ndriçon karakteristikat e përgjithshme të kryengritjeve.

Autori shfaq pikëpamjen se “tri grupe të rëndësishme udhëheqësish brenda shoqërisë shqiptare të Kosovës e kanë definuar UÇK-në dhe rrugën e saj drejt suksesit: “Institucionalistët e rrugës paqësore” (të udhëhequr nga I. Rugova dhe B. Bukoshi - M.K.), “Planifikuesit në ekzil” (Xhavit Haliti dhe Hashim Thaçi - M.K.) dhe “Mbrotjesit në shtëpi” (në krye me Adem Jasharin - M.K.)”¹. Më tutje ai flet edhe për “filozofinë” dhe karakteristikat e njërit dhe grupit tjetër, për portretet e kryesuesve të “grupeve”. Për krerët e UÇK-së thotë se ishin “nacionalistë shqiptarë” dhe se asnjëri nga ta nuk pati rrënjë fetare. Kjo dëshmon se lufta e UÇK-së kishte karakter çlirimtar e jo karakter fetar a të një ideologjie tjetër, siç është përpjekur t’ia vesh dikush.

Te ky libër, si rrallë kund tjetër gjën aq shumë të dhëna për mbështetjen dhe pengesat që pati UÇK-ja (nga vendorë dhe të huaj) në luftë; për mënyrën se si u organizua kryengritja; për format e luftës dhe strategjinë e ndjekur, qëllimet dhe objektivat e saj; për shtrirjen e luftës në zona operative; për komandën dhe kontrollin; për organizimin e stërvitjeve dhe llojin e tyre; për intensitetin e luftimeve; për sigurimin e fondeve dhe mënyrën e financimit të luftës, furnizimi

¹Henry H. Perritt Jr, *Ushtria Çlirimtare e Kosovës: rrëfim prej brenda për një kryengritje*, Koha, Prishtinë, 2008, f.27.

me armë dhe pajisje të tjera; për profilin e ushtarit dhe komandantit të UÇK-së; për raportet e saj me popullatën, me subjektet politike, me faktorin ndërkombëtar, deri edhe te shpërbërja e saj dhe formimi i Trupave Mbrojtëse të Kosovës (TMK); si dhe akuzat e ngritura ndaj tyre nga UNMIK-u, nga gjykata e Hagës etj.

Një kapitull më vete, mjaft interesant, që do veçuar me këtë rast, është edhe trajtimi i raporteve të UÇK-së me faktorin ndërkombëtar, krijimin dhe formësimin e opinionit ndërkombëtar se lufta e UÇK-së ishte e drejtë. Mbështetja e parë për këtë organizatë politike-ushtarake, sipas autorit, erdhi nga Republika e Shqipërisë. Pastaj, erdhi mbështetja nga segmente te Qeverisë gjermane, shumë kohë para se këtë gjë ta bënte SHBA-ja, Britania e Madhe apo Franca, derisa solli edhe intervenimin e NATO-s. Të dhënat e publikuara te ky libër tregojnë se intervenimi ndodhi vetëm për shkak se *rezistenca e UÇK-së rriti rrezikun e mosintervenimit* dhe se Ushtria Çlirimtare e Kosovës ngadhënjeu më në fund më 1999, për shkak se solli intervenimin ndërkombëtar në formën e fushatës së bombardimeve të NATO-s.

Këtu janë trajtuar edhe çështje të pasluftës, çështje që lidhen, në një mënyrë apo tjetër, me UÇK-në dhe fatin e pjesëtarëve të saj. Përvoja e kësaj organizate, sipas autorit, e definoi politikën e pasluftës në Kosovë. Popullariteti që i kishte mundësuar UÇK-së të jetë aktive nuk u shua, por kjo organizatë pushoi së ekzistuari. Fatet e pjesëtarëve të saj, siç shprehet me të drejtë autori, ishin të ndryshme: disa u inkuadruan në politikë, disa në radhët e trupave Mbrojtëse të Kosovës (TMK), disa në Shërbimin Policor të Kosovës (SHPK); ndaj disave filluan ndjekjet penale, u ngritën akuza, ata u arrestuan dhe u dënuan nga gjykatat. Autori nuk e mbyll rrëfimin për UÇK-në me

përfundimin e luftës në Kosovë dhe instalimin e administratës ndërkombëtare këtu, sepse, rrëfimi për këtë organizatë do të ishte i pakompletuar pa e trajtuar ndjekjen penale të shumë pjesëtarëve të saj për krime lufte.

Libri *“Ushtria Çlirimtare e Kosovës: rrëfim prej brenda për një kryengritje”* e Henry Perrittit është i veçantë (si për nga mënyra e ndërtimit, ashtu edhe për vlerat që ka), nga më të veçantat libra që janë shkruar lidhur me këtë temë. E them këtë, sepse asnjë libër që kam lexuar deri në kohën e botimit të tij, nuk del të jetë më i plotë dhe më gjithëpërfshirës. Edhe për atë se çfarë ka trajtuar, edhe si e ka trajtuar, por edhe për mënyrën e qasjes dhe strukturimit të tij. Natyrisht se në këtë libër janë bërë edhe lëshime e gabime që, krahasuar me vlerat e librit, nuk çojnë kushedi sa peshë, por janë të hetueshme dhe është mirë të evidentohen dhe veçohen me këtë rast.

Cilat janë disa prej tyre?

E para, edhe pse ai nuk mohon se UÇK-ja kishte 7 zona operative, ai gati gjithë rrëfimin e ndërton duke u bazuar pothuaj tërësisht në ato që i rrëfejnë komandantët e tri zonave: Zona Operative e Drenicës, Zona Operative e Dukagjinit dhe Zona Operative e Llapit. Ai bën lëshime (sigurisht të paqëllimshme) edhe kur është fjala për strukturimin e njësive të UÇK-së, sidomos në nivel brigade. Sipas tij, çdo brigadë kishte nga katër batalione. Ky fakt nuk qëndron. Sepse, derisa Brigada 141 “Mehë Uka” kishte katër batalione, Brigada 142 e të njëjtës zonë (ZOSH) kishte vetëm dy batalione. E dyta, fshatin Bajgorë e konsideron si pjesë të ZOLL (Komuna e Podujevës), mirëpo ai i takon Komunës së Mitrovicës dhe ZOSH-it. E treta, ka raste kur autori “shërbehet” edhe me fyerje. Rast konkret kemi kur Shqipërinë komuniste e quan “fundërrinë

ekonomike dhe politike”, kurse profesorët e Universitetit të Prishtinës i konsideron “për turp”. Ka edhe konstatime të tjera me të cilat nuk mund të pajtohem për arsye që nuk qëndrojnë. Përtej këtyre të metave, libri *“Ushtria Çlirimtare e Kosovës: rrëfim prej brenda për një kryengritje”* e Henry H. Perritt Jr. mendoj se është një nga librat më të plotë, në mos dhe më i ploti, më gjithëpërfshirës i shkruar për UÇK-në dhe luftën e saj deri në kohën e botimit të tij. Është më shumë se një libër, është një monografi me temë bosht luftën e UÇK-së. *“Ushtria Çlirimtare e Kosovës...”* e Henry H. Perritt Jr. konsiderohet si historia e parë e luftës që shfaqet në anglisht.

UÇK mes vlerësimeve, shantazheve dhe akuzave

Një monografi tjetër, me kryetëmë Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës, por me burime, literaturë, referenca të tjera, me strukturë e qasje tjetër është ajo e James Pettifer, me titull: *“Ushtria Çlirimtare e Kosovës: nga një luftë e fshehtë në një kryengritje të Ballkanit 1948-2001”*, Botim “Onuri”, 2013.

Shtrirja në kohë dhe hapësirë e UÇK-së, origjina dhe rrethanat e krijimit të saj, struktura, mënyra e funksionimit, strategjia, raportet e saj me subjektet politik e ushtarake (LPK, LDK, LKÇK, LBD, NATO) dhe me media; sfidat me të cilat ajo u ballafaqua gjatë ekzistencës së saj; imazhi i ushtarëve dhe komandantëve; përpjekjet e krerëve të saj për ta unifikuar faktorin shqiptar rreth qeverisë së luftës të udhëhequr nga ajo; raportet e saj me Adem Demaçin etj., janë vetëm disa nga çështjet e trajtuara me shumë kujdes në këtë monografi.

Temën për luftën e UÇK-së e trajton në disa aspekte: në aspektin ideologjik, politik, historik, diplomatik, ushtarak, kombëtar e ndërkombëtar dhe mediatik. Të gjitha këto aspekte gjejnë shtrirje në rrafshin përmbajtjesor dhe formal të librit, në kapitujt dhe nënkapitujt e tij. Aspekte të caktuara herë dalin si tema, herë si nëntema, por edhe si njësi më të vogla që përbëjnë kryetemën UÇK, e cila është trajtuar edhe në kontekst të kohës dhe rrethanave. Të gjitha këto janë pjesë e strukturës së librit. Strukturës së jashtme dhe të brendshme. Mirëpo, si njësi e veçantë e strukturës së librit janë edhe disa “Shtojca”, të cilat, në të shumtën e rasteve e pasurojnë librin dhe mund të merren si referenca interesante që sjellin të dhëna të panjohura për këtë organizatë.

Për ata që nuk e njohin sa duhet historinë e popullit shqiptar dhe për ata që nuk kanë njohuri të mjaftueshme se në çfarë rrethanash u formua UÇK, titulli i këtij libri në shikim të parë duket jo shumë real dhe i ekzagjeruar, si në aspektin e shtrirjes kohore ashtu edhe hapësinore. Këtë “dilemë” e heq autori. Ai, gjenezën e UÇK-së e sheh te tradita luftarake shqiptare. Këtë e pohon duke ju referuar edhe disa historianëve shqiptarë, të cilët pohojnë me të drejtë se *“kryengritjes” kundër sundimit të Beogradit asnjëherë nuk iu dha fund, se ajo ishte si një zjarr në pyll që s’mund të shuhej, se nga një zjarr që digjej përbrenda, mund të shpërthente në flakë pothuajse kurdo*. Sa i përket shtrirjes në hapësirë del se jehona e luftës së UÇK-së, shprehur figurativisht, kishte kaluar kufijtë e Kosovës, kufijtë kombëtar, duke u shndërrua në kryengritje të Ballkanit, siç shprehet autori, ngase lufta kishte prekur në një mënyrë a tjetër Kosovën e Shqipërinë, Serbinë dhe Malin e Zi.

Përveç me shtrirjen në kohë dhe hapësirë të temës që trajton, autori fokusohet edhe te mënyra e organizimit, strukturimit dhe funksionimit të kësaj organizate që në fillimet e saj. Sipas tij, UÇK-ja në praktikë kishte tri nivele autoriteti. *Niveli i parë*, dhe më i rëndësishmi, ishte autoriteti i komandantëve të UÇK-së në terren, të cilët shpeshherë kishin vetëm një marrëdhënie formale të paqartë me komandantët e zonave operative të saj. *Niveli i dytë*, ishte SHP i UÇK-së në Drenicë, kurse *niveli i tretë*, ishte skuadra negociuese². J. Pettifer e vlerëson mprehtësinë organizative të UÇK-së dhe strategjinë e saj. Kur flet për strategjinë e kësaj organizate politike dhe ushtarake, ka raste kur ai del pak ca kontradiktor. Një herë thotë: *Sulmi i UÇK-së në Rahovec është kritikuar shumë në Kosovën e pasluftës, por ai sulm gjithsesi kishte logjikë strategjike*, kurseherën e dytë shprehet se strategjia e UÇK-së, e marrjes dhe mbajtjes së qytezave të vogla (Rahovec, Malishevë etj.) ishte në favor të Beogradit në këtë rrafsh. Madje, ai e konsideron si gabim strategjik *mospërdorimin e eksplozivëve lokalë kundër Ushtrisë Jugosllave*. Këtë e konsideron si një nga dobësitë më serioze dhe irracionale të strategjisë të fillimit të fushatës së UÇK-së. E vlerëson faktin që SHP i UÇK-së prioritet kishte *diplomacinë e zgjuar me komunitetin ndërkombëtar dhe bashkëpunimin e mirë me media*. Për bashkëpunimin e mirë me media, meritën kryesore ia atribuon LPK-së, duke e vlerësuar jashtëzakonisht profesionale komunikimin mediatik të saj, madje edhe më profesionale se pala jugosllave³.

²James Pettifer, *Ushtria Çlirimtare e Kosovës: nga një luftë e fshehtë në një kryengritje të Ballkanit 1948-2001*, Botim "Onuri", 2013, f.230.

³Po aty, f. 110, 16.

Një aspekt tjetër i trajtuar në këtë vepër, është edhe sfida me të cilat është ballafaquar kjo organizatë gjatë veprimtarisë së saj. Shantazhi konsiderohet njëra nga sfidat kryesore me të cilat ishte ballafaquar ajo. Pettifer nuk ngurron t'i përmend kush ishin shantazhistët dhe pse shantazhonin. Për shumëkënd mund të duket e pakuptueshme, por ja që edhe Londra e shantazhonte UÇK-në. Madje, prioritet në Londër, sipas autorit, ishte që të shmangej një kryengritje popullore në Kosovë sipas modelit shqiptar. Ushtria Britanike kishte “frikë” se mos UÇK mund të binte në duart e atyre që konsideroheshin si grupime të së majtës ekstreme. Këtu ai e veçon Lëvizjen Kombëtare për Çlirimin e Kosovës (LKÇK), të cilën Londra e konsideronte element “komunist”. Ai thekson se emërimi i Agim Çekut si komandant i UÇK-së, ishte në thelb, një mjet për të dobësuar pushtetin e radikalëve politikë mbi orientimin e saj dhe për ta mbajtur peng atë për të ardhmen. Me këtë, britanikët, gjithnjë sipas autorit, po mendonin për të ardhmen, e Kosovës vetëm në aspektin e stabilizimit social të saj. Ata e mendonin një Kosovë brenda një Jugosllavie të reformuar demokratike ngase nuk shihnin asnjë perspektivë për pavarësinë e Kosovës, aq më tepër që Kosova të bëhej me ushtri. Urdhrat politikë, që vinin nga Londra dhe Uashingtoni, sipas James Pettifer, jepeshin me qëllim që UÇK të mbahej nën kontroll, në mënyrë që ajo të mos lejohej të bëhej tepër dominuese në lokalitetet ku vepronte, duke mbajtur parasysh situatën e pasluftës. Megjithatë, nuk ishte vetëm Londra që shantazhonte UÇK-në. Atë e shantazhonin edhe një pjesë tjetër e bashkësisë ndërkombëtare. E shantazhonin edhe një pjesë e faktorit politik shqiptar të Kosovës. Përmes shantazheve, një pjesë e faktorit ndërkombëtar dhe vendor i kishin kontribuar edhe prishjes së “Qeverisë Thaçi” të dalë pas

bombardimeve në Rambuje. Nuk lejohej assesi që rreth asaj qeverie të krijohej një front uniteti, një front i përbashkët shqiptar. Edhe pse gjenerali Majk Xhekson, kishte marrë përsipër prishjen e “Qeverisë Thaçi” të dalë nga Rambujeja, mbase për shkak se nuk kishte raporte të mira personale me të, ishte në fakt Rugova dhe LDK-ja, nën tutelën kryesisht italiane dhe të Vatikanit, që e kishte arritur zhbërjen e Qeverisë Thaçi, duke refuzuar të merrte pjesë në një front të bashkuar shqiptar në përballje me bashkësinë ndërkombëtare”⁴.

Një vëmendje të veçantë, një hapësirë të konsiderueshme në libër u kushtohet edhe raporteve të UÇK-së me Shqipërinë, me NATO-n, me subjektet politike, si: LPK, LKÇK, LDK, LBD; por edhe me popullsinë. Ai bën dallimin mes LDK-së dhe UÇK-së. Sipas tij, lidhshipi i LDK-së *i përkiste traditës së vjetër revizioniste komuniste të Jugosllavisë titiste, kurse ana politike e UÇK-së (LPRK-LPK-M.K.) ishte në thelb enveriste*. Duke folur për rolin historik të Lëvizjes Popullore të Kosovës, ai pohon se ndikim vendimtar mbi të ardhmen, e cila do të sigurojë një kuadër funksional për një brez të tërë militantësh, të cilët do ta drejtonin luftën (e UÇK-së) në Kosovë. Adem Jashari, H. Thaçi, Xh. Haliti, Ali Ahmeti, R. Haradinaj, Fazli Veliu i përkisnin ose punonin me LPK-në.

Kur merret me raportet mes UÇK-së dhe Adem Demaçit, autori ndalet në Konferencën e Rambujesë dhe presioni që po i bëhej Thaçit për ta nënshkruar marrëveshjen. I gjendur mes vendosmërisë së tij për të mos nënshkruar marrëveshjen pa një garanci ndërkombëtare për referendum dhe presionit nga të gjitha anët për të nënshkruar marrëveshjen, Thaçi do të mbetet i izoluar në delegacion. Mirëpo, siç shprehet më tutje Pettifer, vetëm mbështetja e palëkundur

⁴ Po aty, 178-180, 236, 251.

e Adem Demaçit, për atë që Albright dhe Hill e konsideronin si një kokëfortësi të tij, e kishte parandaluar një fiasko për shqiptarët. Pra, hezitimi i Thaçit për të nënshkruar dhe këmbëngulja e Demaçit për të mos nënshkruar, sipas autorit, kishin njëfarë baze. Sepse, rreziku i nënshkrimit pa asnjë kusht ishte më i madh se rreziku i hezitimit dhe këmbënguljes për të mos nënshkruar. Ai e argumenton këtë duke pas për bazë një të dhënë të panjohur më parë. Ishte sekretarja e Shtetit e SHBA-së, Ollbrait, që gjatë një bashkëbisedimi me Milan Milutinoviçin, president i Serbisë, ndër të tjera i kishte deklaruar atij *se zgjidhja politike që parashtronin amerikanët do të ishte e mirë për Serbinë, sepse UÇK-ja do të çarmatosej, se Kosova do mbetej brenda Jugosllavisë, se Ushtria Jugosllave do të lejohej të vazhdonte të patrullonte kufirin...*⁵. Bazuar në këtë fakt, në këtë të dhënë, del se hezitimi i Thaçit dhe kundërshtimi i Demaçit për të mos nënshkruar marrëveshjen e kishte shpëtuar Kosovën nga një robëri e re.

Mënyra se si dhe kur u formua UÇK-ja për shumëkënd ishte një mister. Dhe për këtë ka pikëpamje të ndryshme. Pettifer e veçon mendimin e Millosheviqit, i cili e kishte konsideruar krijimin e UÇK-së, si një *komplot i perëndimit kundër rendit në Jugosllavi* gjatë gjithë konfliktit (luftës-M.K) në Kosovë.

Gjatë leximit të kësaj monografie bie në sy edhe mënyra se si autori e paraqet imazhin e ushtarëve dhe komandantëve të UÇK-së. Përmes imazhit të pjesëtarëve të saj kjo organizatë synonte të *perceptohej si serioze, e rrezikshme, klandestine, e aftë për të ngjallur frikë dhe e arriti këtë gjë* - shton ai⁶

Pse veçohet ky libër?

⁵Po aty, f. 224, 237.

⁶Po aty, 134.

Për burimet, referencat dhe mënyrën e rrëfimit. Për informacionet dhe të panjohurat që sjell dhe i publikon për herë të parë. Se për UÇK-në flitet e shkruhet për rrethanat dhe kontekstin kohor kur është krijuar dhe kur ka vepruar ajo si organizatë. Krijimin e saj, veprimet e saj i vë dhe i trajton edhe në kontekst të politikës kombëtare dhe ndërkombëtare.

UÇK-në e konsideron si vazhduese të traditës kombëtare dhe atdhetare. Mirëpo, ndryshe nga grupet, lëvizjet, organizatat tjera të mëhershme politike e ushtarake, ilegale e legale, ajo arriti realizimin e ëndrrës që synonte shumica e popullit të Kosovës: lirinë dhe pavarësinë.

Libri veçohet edhe për faktin se, këtu, publikohen, mbase për herë të parë, disa të vërteta të panjohura deri më sot lidhur me sfidat, shantazhet dhe prapaskenat në dëm të UÇK-së të luajtura nga të huajt dhe vendorët. Përkundër të gjitha këtyre sfidave, UÇK-ja kishte arritur qëllimin e saj.

Natyrisht se te ky libër ka edhe gabime, sidomos te “Shtojca”. Aty bien në sy disa prej tyre. Kështu, Zona Operative e Llapit (ZOLL) këtu na del me numër 2, kurse Brigada “Zahir Pajaziti” del me numër 122. Mirëpo, dihet se ZOLL ishte zona operative me numër 5, kurse Brigada “Zahir Pajaziti” me numër 151. Pohimi i autorit se *ka pak ose aspak literaturë ekzistuese për UÇK-në në Mitrovicë, për arsyen e thjeshtë se, në këtë fazë, lufta pothuajse nuk ekzistonte fare atje*, bjen në kundërshtim me pohimin se më 15-17 tetor 1999, forca të mëdha të UJ-së lanë bazën e tyre në Kutlllovë të Mitrovicës dhe sulmuan fshatrat Mazhiq, Rashan dhe Medenicë (Melenicë - M.K) me mitraloza të rëndë. Po ashtu, këtu, edhe data jepet gabim ngase ky sulm ka ndodhur më 15-17 shtator 1998, e jo në

muajin tetor. Kur flet se si një grup i UÇK-së zuri 7 ushtarë dhe 1 oficer të UJ-së, në rrethana poshtëruese, pranë Mitrovicës, ai e përmend datën 10 janar 1999. Edhe këtu data është e gabuar, sepse kjo ka ndodhur saktësisht më 8 janar 1999.

Gabimet e kësaj natyre edhe mund të ndodhin, janë disi më të kuptueshme. Të pakuptueshme për mua janë akuzat se: në disa raste, komandantët lokalë të UÇK-së u bënë presion serbëve të largoheshin; se kjo ka ndodhur, por vetëm *“është çështje e diskutueshme nëse ka pasur nga ana e leadershipit të UÇK-së një strategji të koordinuar të “pastrimit” të Kosovës”*⁷.

Përkundër këtyre lëshimeve dhe akuzave goxha të rënda kundër UÇK-së, me të drejtë është thënë se *“ky libër magjepsës është një studim i detajuar i rolit të UÇK-së në këto ngjarje të jashtëzakonshme”, se “është një libër i mrekullueshëm...më i miri për nga trajtimi në thellësi i UÇK-së dhe se do të jetë me interes si për specialistët në Kosovë e Ballkan, si dhe për lexuesin e gjerë, që interesohet për një hyrje për temën e UÇK-së dhe për konfliktin e Kosovës të viteve ‘90-ta”*. Libri i J. Pettifer në fakt është cilësuar si një kryevepër që tregon historinë e fillesave të UÇK-së, duke filluar nga viti 1948 dhe, gjatë këtij procesi, zbulon detaje deri më tani të panjohura.

Libri, pra, është një referencë e mirë për të gjithë ata që do të merren në të ardhmen me historinë e UÇK-së, me luftën e saj, me sfidat nëpër të cilat ka kaluar dhe rolin e saj historik në historinë e Ballkanit.

⁷Po aty, f. 258.

Nëse do të na lejohej krahasimi i kësaj monografie me ndonjë lule, atëherë do të mund ta krahasonim me një trëndafil, por me një trëndafil me gjemba.

Në fund duhet thënë se botimi i këtyre dy librave nga dy autorë të huaj, në një gjuhë të madhe, botërore, siç është gjuha angleze, e afirmon UÇK-në.

Që të dy librat, në këtë lloj, janë të rrallë, madje i kanë munguar Kosovës dhe opinionit ndërkombëtar, sidomos atij që i intereson të dijë diçka për këtë organizatë. Të dy librat, në shumicën e rasteve, nxjerrin në shesh dhe e argumentojnë të vërtetën për UÇK-në, luftën e drejtë të UÇK-së, duke mohuar zërat se UÇK-ja u financua dhe u përkrah nga qarqe kriminale e mafioze. Lufta e UÇK-së vlerësohet një nga kryengritjet më të veçanta dhe më të suksesshme në historinë e kryengritjeve moderne. Krejt në fund, këto dy libra, mbetën një burim i rëndësishëm, një referencë që nuk do të mund t'i shmanget askush që në të ardhmen dëshiron të merret seriozisht me temën e UÇK-së dhe luftën e saj. Si të tilla e afirmojnë UÇK-në dhe të vërtetën për luftën e Kosovës 1998-1999.

Miftar KURTI

SUMMARY

Henry H. Perritt Jr. is the author of “Kosovo Liberation Army: The Inside Story of an Insurgency”, Koha, 2008, whereas James Pettifer is the author of “The Kosova Liberation Army: Underground War to Balkan Insurgency, 1948-2001”, Onufri, 2013. Both of these works focus on the Kosovo Liberation Army (KLA), its origins, the circumstances and period of time it was formed, and when it operated, but also its confrontation with the Serbian military, police, and paramilitary forces. These works showcase the relations that KLA had with the Albanian and international political factors as well as the political and military activity. The indispensable value of these works is due to the fact that they provide extensive and previously unknown information about the KLA. These works are a vital part of the KLA history written by two non-Albanian authors. They have been written in the English language, but have been translated and published in Albanian. The analysis of these two books has been based on the Albanian translated version. If one wants to learn more about the KLA-led 1998-1999 Kosovo War, the actors, the factors involved, and the context and circumstances of the war, one must read these two books.

Mrika Limani

Ndërhyrja e NATO-s në luftën e Kosovës

Për të kuptuar rolin dhe arsyet se përse NATO ndërhyri në luftën e Kosovës, duhet të kthehemi në histori dhe të shikojmë kontekstin socio-politik në të cilin u themelua NATO (*North-Atlantic Treaty Organization - Organizata e Traktatit të Atlantikut të Veriut*). Historia e NATO-s fillon që nga përfundimi i Luftës së Dytë Botërore dhe fillimi i Luftës së Ftohtë. Megjithëse ekziston një bindje e përgjithshme që NATO është formuar si përgjigje ndaj rrezikut që vinte nga Bashkimi Sovjetik, në rrafshin historik kjo nuk qëndron plotësisht. Aleanca ishte themeluar që t'i shërbente tri qëllimeve kryesore: të shmangte zgjerimin sovjetik, të parandalonte ringjalljen e nacionalizmit militaristik në Evropë përmes një pranie të fuqishme amerikane në kontinent, si dhe të inkurajonte integrimin politik ndërevropian.

Periudha e pas Luftës së Dytë Botërore, kishte qenë shumë e vështirë për Evropën. Së paku 36.5 milionë evropianë kishin humbur jetën gjatë luftës, prej të cilëve rreth 19 milionë ishin civilë. Jeta e përditshme përfshinte jetesë në kushte të vështira në qytete gjysmë të shkatërruara, si dhe ushqim të reduktuar përmes racioneve. Kësaj situate i ishte bashkëngjitur edhe kërcënimi real i zgjerimit të Bashkimit Sovjetik, i cili tentonte të vendoste territore të Evropës Qendrore brenda sferës së influencës së saj. Kjo situatë ishte më së shumti e tensionuar në hapësirën e Gjermanisë së sotme. Si reaksion i konsolidimit të Gjermanisë Perëndimore më 1949, sovjetikët bllokuan

territorin e Berlinit, i cili ishte nën kontrollin e aleatëve, në këtë mënyrë duke tentuar të vendosnin kontroll të plotë mbi kryeqytetin gjerman. Kjo luftë kontrolli mbi qytetin e Berlinit kishte vazhduar deri në vitin 1961, kur u ndërtua muri i Berlinit.¹

Kjo periudhë përkon edhe me kohën kur në politikën amerikane paraqitet një rrymë kundër izolacionit politik, që e shtyu përfundimisht SHBA-në të angazhohej më fuqishëm që të vendoste vetën si udhëheqës botëror. Në këtë aspekt, ndihmat e SHBA-së për Evropën, Plani i Marshallit, ishin jetike në rindërtimin e ekonomisë dhe mirëqenies në shtetet e dëmtuara gjatë luftës.² Përpos nevojës për mbështetje ekonomike, këto shtete kishin nevojë edhe për stabilitet në sferën e sigurisë. Me këtë ide në mendje, disa shtete të Evropës Perëndimore u bashkuan për të formuar bashkëpunime ushtarake ndërmjet veti për të siguruar mbrojtje të përgjithshme, që çoi në formimin e Bashkimit Perëndimor më 1948, e që më vonë do të shndërrohej në Bashkimin Perëndimor Evropian, më 1954. Në fund u arrit mirëkuptimi nga këto shtete që rreziku sovjetik mund të zvogëlohej vetëm në rast se krijohej një sistem transatlantik i sigurisë, i cili do të mbante agresionin sovjetik të kufizuar, por dhe njëkohësisht do të parandalonte ringjalljen e militarizmit evropian në shtetet evropiane.³

Në këtë frymë u themelua *North Atlantic Treaty (Traktati Atlantik i Veriut)*, më 4 prill 1949. Sipas traktatit, nëse një nga

¹Tony Judt, *Postwar: A History of Europe since 1945* (London: Vintage Books, 2010), 252-253.

²Tony Judt, *Postwar: A History of Europe since 1945* (London: Vintage Books, 2010), 150.

³Julian Lindley-French, *The North Atlantic Treaty Organization* (London; New York: Routledge, 2007), 21-23.

anëtarët e traktatit sulmohet, atëherë sulmi do të konsiderohet si sulm ndaj të gjithë nënshkruesve të tij, që në formë të drejtpërdrejtë e transformoi mënyrën e qasjes së sigurisë rreth mbajtjes së stabilitetit dhe baraspeshës së fuqive globale brenda kontinentit evropian.⁴

Një hap tjetër në evolucionin e NATO-s ishte lufta e Koresë e vitit 1950, meqë kjo ngjarje ia qartësoi aleatëve faktin se sa e brishtë është mirëmbajtja e paqes, posaçërisht në kushtet kur aktorët e tjerë ushtarakë kanë në posedim armë bërthamore. Në të njëjtën kohë u bë e qartë që një fat i ngjashëm me ndarjen e Koresë mund ta pret edhe Gjermaninë, dhe të zgjerojë në këtë formë sferën e influencës së sovjetikëve.⁵ Efekti i luftës ishte i atillë që në mënyrë të menjëhershme u themelua Shtabi Ushtarak i NATO-s (i mbiquajtur *Supreme Headquarters Allied Powers Europe, Shtabi Epror i Fuqive Aleate të Evropës*), që ka luajtur një rol të rëndësishëm në koordinimin e veprimeve dhe strategjive ushtarake të traktatit.⁶

Për të mirëmbajtur këtë stabilitet të sigurisë, që ishte akoma në fillet e saj, NATO vendosi të përfshijë në aleancën e saj edhe shtete me pozita të rëndësishme gjeostrategjike, si Greqia dhe Turqia (më 1952), si dhe Gjermaninë Perëndimore në vitin 1955. Reaksioni i Bashkimit Sovjetik ndaj përfshirjes së Gjermanisë Federale në NATO ishte posaçërisht agresiv, sepse kishte synime që të zgjeronte influencën e saj edhe në Gjermaninë Perëndimore. Si kundërpërgjigje, Bashkimi Sovjetik dhe shtetet e tjera të Evropës Lindore e themeluan

⁴Tony Judt, *Postwar: A History of Europe since 1945* (London: Vintage Books, 2010), 149.

⁵Tony Judt, *Postwar: A History of Europe since 1945* (London: Vintage Books, 2010), 151.

⁶Julian Lindley-French, *The North Atlantic Treaty Organization* (London; New York: Routledge, 2007), 88.

Paktin e Varshavës, më 1955. Krijimi i dy poleve me fuqi të tillë ushtarake e krijoi një tension të ri në kontinentin e Evropës.

Kjo periudhë përkon me kohën kur NATO e përvetësoi një doktrinë strategjike të quajtur Shpagimi masiv (*Massive retaliation*) - që nënkuptonte se nëse Bashkimi Sovjetik sulmonte, atëherë NATO do të përgjigjej me armë bërthamore. Qëllimi i kësaj doktrine ishte që të parandalonte secilën anë që të mos përdorte forcë të tepruar me armë bërthamore, sepse një sjellje e tillë do të krijonte një luftë botërore bërthamore.⁷

Kriza e Suezit në vitin 1956 e solli një krizë tjetër, kësaj radhe përbrenda vetë aleancës. Kur presidenti i Egjiptit e rinacionalizoi kanalin e Suezit, Izraeli e sulmoi këtë të parin. Në këtë rast, nën pretekstin e ndërhyrjes ndërmjet Izraelit dhe Egjiptit, Britania e Madhe dhe Franca kërkuan të kenë qasje në armët bërthamore që ndodheshin në territoret e tyre. Pas gjithë kësaj fiaskoje, dy shtetet evropiane u tërhoqën, dhe kjo ngjarje shënoi përfundimin e periudhës imperialiste të shteteve evropiane. Gjithsesi, kjo pati një ndikim në mënyrën sesi shtetet evropiane e shihnin rolin e tyre brenda aleancës, dhe se si e shihnin rolin e NATO-s në nivel global në përgjithësi.⁸

Tensioni ndërmjet NATO-s dhe Bashkimit Sovjetik u ngrit sërish gjatë dekadës së 60 të shekullit të kaluar, kur për pak u anashkalua një konflikt i drejtpërdrejtë në Kubë. Kjo përkon me periudhën e strategjisë të mbiquajtur Shkatërrim i siguruar reciprok (*Mutually assured destruction*), që nënkuptonte se meqë të dy akterët

⁷Julian Lindley-French, *The North Atlantic Treaty Organization* (London; New York: Routledge, 2007), 28.

⁸Julian Lindley-French, *The North Atlantic Treaty Organization* (London; New York: Routledge, 2007), 30-31.

kryesorë kishin grumbulluar një numër të madh të armëve bërthamore, atëherë cilido aktor që do të sulmonte së pari do të rrezikonte që të ngacmonte sulm më të fuqishëm nga kundërshtari - meqë supozohej se nuk do të arrihej shkatërrimi i plotë i armëve bërthamore me një sulm të vetëm. Kjo qasje i mbajti të ngrira rreziqet për sulm për një periudhë kohore. Në përgjithësi, në bazë të politikave më të relaksuara të ndjekura nga pala perëndimore, situata filloi të qetësohej. Kjo shkaktoi që NATO t'i përqendrojë fuqitë e saja në drejtime të tjera, gjegjësisht atyre paqeruajtës.

Mirëpo, përkundër këtyre zhvillimeve, pushtimi i Çekosllovakisë nga ana e Bashkimit Sovjetik, në gusht të vitit 1968 ndezi përsëri tensionet ndërmjet dy poleve, ku kjo e fundit ndiqte atë që në histori njihet si doktrina e Brezhnev - përmes së cilës Bashkimi Sovjetik synonte të merrte kontroll sa më të shpejtë, qoftë edhe afatshkurtër, mbi shtetet e Evropës Lindore, në proces e sipër duke ia pamundësuar shteteve perëndimore që të zgjerojnë sferën e tyre të influencës në këtë drejtim.

Qasja e NATO-s ndaj sulmeve të sovjetikëve gjatë periudhës së Kenedit ishte më e relaksuar, në kuptimin që të paktën në rast të ndonjë konflikti nuk synonin të përfshiheshin me sulmpërmes armëve bërthamore, por që të ktheheshin te taktikat më tipike të luftës konvencionale, dhe të nisin sulme të armëve bërthamore në mënyrë selektive dhe vetëm atëherë kur të gjitha metodat e tjera do të ishin shteruar. Kjo qasje njihet ndryshe edhe si Përgjigja e Ndryshueshme (*Flexible Response*).⁹ Më 1967 u parashtrua në NATO edhe strategjia e njohur si Raporti i Harmelit, që mbështeste dialogun ndërmjet

⁹Wesley K. Clark, *Waging modern war* (New York: Public Affairs, 2001), 4.

NATO-s dhe shteteve të Paktit të Varshavës si mënyrë për t'i qetësuar tensionet.

Raporti i Harmelite parashtroi nevojën për mbajtjen e Konferencës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë në vitin 1973, dy vjet pas së cilës konferencë u krijua Akti Final i Helsinkit. Sipas këtij Akti, të gjithë nënshkruesit e saj (përfshirë këtu edhe Bashkimin Sovjetik dhe shtetet e anëtare të Paktit të Varshavës), u obliguan që të respektojnë të drejtat themelore të qytetarëve të tyre, përfshirë këtu edhe lirinë e shprehjes, mendimit, ndërgjegjes dhe besimit.

Pushtimi i Afganistanit nga Bashkimi Sovjetik në vitin 1979 i ringjalli tensionet e Luftës së Ftohtë, që pati ndikim në rivendosjen e raketave bërthamore në pika kyçe të Evropës Perëndimore, përderisa vazhdonin bisedimet dhe dialogu me Bashkimin Sovjetik për marrëveshje mbi armët. Përkundër bisedimeve, pushtimi i Afganistanit trajtohet si fillimi i Luftës së dytë të Ftohtë.¹⁰ Por, kjo fazë e re i gjeti shtetet komuniste në përgjithësi shumë të rrënuara.¹¹ Përkundër kësaj, periudha e fundit e Luftës së Ftohtë u karakterizua me manifestime të ndryshme të fuqive ushtarake nga të dy akterët. Por, përfundimisht ndryshime të brendshme politike në Bashkimin Sovjetik dhe ardhja në fuqi e Gorbaqevit në vitin 1985, ndikoi në relaksimin e marrëdhënieve ndërmjet dy poleve të luftës, dhe shpërbërjen eventuale të Bashkimit Sovjetik në mënyrë formale në vitin 1991.

¹⁰Julian Lindley-French, *The North Atlantic Treaty Organization* (London; New York: Routledge, 2007), 46.

¹¹Tony Judt, *Postwar: A History of Europe since 1945* (London: Vintage Books, 2010), 551.

Në këtë pikë, roli i NATO-s transformohet rrënjësisht dhe e merr një karakter paqeruajtës në nivel global. Ndërhyrjen e NATO-s në luftën e Kosovës gjithashtu duhet shikuar nga ky kontekst, dhe në përgjithësi duhet shikuar në kontekst të zhvillimeve të politikave globale pas përfundimit të Luftës së Ftohtë.

Situata në Kosovë ishte e analizuar nga shumë nivele, duke përfshirë atë lokal, rajonal dhe ndërkombëtar, dhe posaçërisht duke pasur parasysh zhvillimet në Bosnjë, ishte e qartë që për opinionin ndërkombëtar elementi i “mësimeve nga e kaluara”ishin marrë parasysh në përfshirjen e NATO-s në Kosovë.

Në këtë kuptim pra, ndërhyrja e NATO-s ishte e motivuar nga parime të natyrës etike, që e parashtruan një imperativë për të ndërhyrë në një katastrofë humanitare.¹²

Përfshirjen më të drejtpërdrejtë të akterëve ndërkombëtarë e shohim që nga marsi i vitit 1998, kur Grupi i Kontaktit i përbërë nga ministrat e Jashtëm, të Francës, Gjermanisë, Italisë, Federatës Ruse, Mbretërisë së Bashkuar dhe SHBA-së, i komunikojnë Millosheviqit që ai duhet të angazhohet për të gjetur një zgjidhje politike përmes dialogut për situatën në Kosovë, duke filluar me tërheqjen e policisë speciale nga Kosova si dhe të ndalojë të gjitha veprimet e dhunshme mbi civilët në Kosovë.¹³ Më 31 mars të po atij viti, Këshilli i Sigurisë së Kombeve të Bashkuara e përvetësoi Rezolutën 1160, përmes së

¹²H. Papatotiriou, “The Kosovo War,” *Journal of Strategic Studies* (March 2002), 25: 1, 39-62, 52.

¹³Julian Lindley-French, *The North Atlantic Treaty Organization* (London; New York: Routledge, 2007), 81.

cilës i shpallën embargo të armëve Serbisë.¹⁴ Si pasojë, Bashkimi Evropian dhe SHBA-ja i ndaluan investimet në Serbi.¹⁵

Në atë periudhë, NATO kishte publikuar një deklaratë ku i shprehte brengat rreth rritjes së dhunës në Kosovë. Në tetor të po atij viti, NATO i dha urdhrat për aktivimin e raketave për sulm (ACTORDs), që paraqiste një hap larg sulmit në vetvete dhe ndërhyrjes në Kosovë.¹⁶

Pjesa e parë e vitit 1999 ishte posaçërisht e vështirë për shqiptarët, ndaj të cilëve tashmë kishte filluar haptazi dhuna pa dallim. Një numër i madh i shqiptarëve ishin dëbuar nga shtëpitë e tyre që në fillim të 1999.¹⁷

Meqë presionet paraprake nuk e kishin ndalur Millosheviqin të përfundonte planin e tij të dhunshëm në raport me Kosovën, u vu në veprim edhe diplomacia, e cila përmes konferencave ku ishin të përfshirë aktorë të të gjitha niveleve ka qenë shumë e rëndësishme për regjionin. Qëllimi ishte që të përfundonte shtypja ndaj shqiptarëve, si dhe të gjendej një zgjidhje politike për Kosovën. Në këtë situatë lufte të krijuar, më 6 shkurt të vitit 1999, fillojnë bisedimet për paqe në Rambuje, të cilat u ndërprenë më 23 shkurt dhe rifilluan më 15

¹⁴Julian Lindley-French, *The North Atlantic Treaty Organization* (London; New York: Routledge, 2007), 81.

¹⁵Laurence Binet and Médecins sans frontières (Association), *Violence against Kosovar Albanians, NATO's intervention 1998-1999* (Geneva: Médecins sans frontières, 2006), 20.

¹⁶Julian Lindley-French, *The North Atlantic Treaty Organization* (London; New York: Routledge, 2007), 82.

¹⁷Craig R. Whitney, *Serb Presson With Expulsions Despite NATO Raids*, *The NewYorkTimes*, 18 prill 1999, qasur në

<https://archive.nytimes.com/www.nytimes.com/library/world/europe/041899kosovo-rdp.html>

mars.¹⁸ Në këtë pikë NATO, e posaçërisht SHBA-ja, ishin të vetëdijshme që përfshirja e tyre me trupa të këmbësorisë në Kosovë ishte e nevojshme, megjithatë i duhej edhe leja nga Serbia për të ndërmarrë këtë hap.¹⁹ Meqë Serbia kishte refuzuar të nënshkruante marrëveshjen, atëherë u vu në efekt kushti i cili i ishte vënë Millosheviqit për nisjen e sulmeve ajrore.²⁰

Në mars të 1999, arsyetimit që fluksi i refugjatëve shqiptarë do të mund të shkaktonin krizë ekonomike Greqi dhe Turqi, vende anëtare të NATO-s, si dhe si përgjigje ndaj dhunës gjenocidale që kishte kryer dhe po vazhdonte të kryente aparati shtetëror i Serbisë ndaj civilëve në Kosovë, NATO filloi sulmet kundër Jugosllavisë. Sulmi ishte nisur me arsyetimin se të gjitha rrugët e tjera diplomatike ishin shtetur, duke mos i lënë rrugëdalje tjetër forcave ndërkombëtare.²¹

Që në prill të vitit 1999, në opinionin ndërkombëtar ishin përhapur lajmet për dhunën të cilën e kishin përjetuar refugjatët shqiptarë që ishin detyruar me forcë të largohen nga shtëpitë e tyre,²² të dhëna këto që vetëm i konfirmonin brengat e opinionit

¹⁸Jane Perlez, *Delayed by Serbian Maneuvering, Kosovo Talks Begin*, 7 shkurt 1999, qasur në <https://www.Nytimes.com/1999/02/07/world/delayed-by-serbian-maneuvering-kosovo-talks-begin.html>

¹⁹Wesley K. Clark, *Waging modern war* (New York: Public Affairs, 2001), 162.

²⁰Wesley K. Clark, *Waging modern war* (New York: Public Affairs, 2001), 173.

²¹Nathan Hausman, "Competing narratives: Comparing perspectives on NATO intervention in Kosovo" (2014), 2.

²²Carlotta Gall, *Refugees Crossing Kosovo Border Tellof Rapes and Killings*, The New York Times, 20 prill 1999, qasur në <https://archive.nytimes.com/www.nytimes.com/library/world/europe/042099kosovo-refugees.html>

ndërkombëtar që në Kosovë po ndodhte një gjenocid në kryerje e sipër.²³

Në qershor të 1999 veprimet e NATO-s në Jugosllavi u ndaluan me rastin e ofrimit të dorëzimit nga ana e Millosheviqit, me të cilin rast Këshilli i Sigurimit i Kombeve të Bashkuara e autorizon hyrjen në Kosovë të Forcës së Kosovës (KFOR) nën udhëheqjen e NATO-s.²⁴

Përfundimisht, ndërhyrja e NATO-s në Kosovë mund të konsiderohet një dimension suksesi për NATO-n dhe parimet e saja të veprimit, sepse përmes ndërhyrjes për parandalimin e gjenocidit, iu qartësua botës që ekzistojnë kauza morale për të cilat duhet luftuar dhe të cilat qëndrojnë përtej kufijve shtetërorë dhe kombëtarë, dhe se ato janë në efekt pikërisht në ato raste kur shteti i vret shtetasit e vet dhe mbrohet me argumentin se këto veprime çnjerëzore i përkasin natyrës së politikave të brendshme shtetërore. Këtë progres historik, Vaclav Havel e kishte quajtur fundi i shtetit komb në fjalimin e tij të dhënë para Parlamentit kanadez, më 29 prill 1999.²⁵ Për më tepër, ndërhyrja ushtarake e NATO-s duhet të vendoset përkrah ligjëritimit historik të zhvillimit të ideve për vetëvendosje dhe pavarësi të shqiptarëve brenda Jugosllavisë, dhe se injorimi i këtij dimensionit e thjeshtëzon problematikën duke e favorizuar diskursin sipërfaqësor se

²³Zbigniew Brzezinski, *Arm the KLA. And if that doesn't work, send in the groundtroops*, The Guardian, 31 mars 1999, qasur në <https://www.theguardian.com/world/1999/mar/31/balkans14>

²⁴Julian Lindley-French, *The North Atlantic Treaty Organization* (London; New York: Routledge, 2007), 124.

²⁵Vaclav Havel, *Kosovo and the End of the Nation-State*, June 10, 1999, qasur në: <https://www.nybooks.com/articles/1999/06/10/kosovo-and-the-end-of-the-nation-state/>

ndërhyrja e NATO-s paraqet sulm “imperialist” karshi një shtetit socialist.

Diskutimet mbi ndërhyrjen e NATO-s

Ndërhyrja ushtarake e një organizate ndërkombëtare në çështjet e brendshme shtetërore të ndonjë shteti tjetër nuk do të mund të kishte ndodhur në periudhën e Luftës së Ftohtë. Përparësia që e fitoi Perëndimi në raport me vendet e Evropës Lindore dhe atyre që më parë ishin pjesë e Bashkimit Sovjetik pas rënies së komunizmit qëndronte te promovimi i parimeve demokratike dhe mbrojtjes të së drejtave civile, fusha në të cilat shtetet ish-socialiste nuk kishin histori shumë pozitive. Reagimet ndaj ndërhyrjes së NATO-s erdhën në forma të ndryshme, dhe kundërshtimet nuk ishin të pakta. Shumë nga kundërshtimet vinin nga pikënisje të kundërshtimit mbi hegjemoninë gjeopolitike që do t’i ofronte NATO-s ndërhyrja në Kosovë, ndërkaq disa të tjera ishin të shtyra nga pikënisje parimore dhe teorike.

Në këtë drejtim i rëndësishëm ishte riprodhimi i ligjëritimit mbi “vëllazërinë sllave” që u rishfaq nga opinionioni rus. Në këtë kuptim, sulmi ndaj Serbisë po interpretohej si sulm amerikan ndaj sllavëve, që e zgjeroi diskursin në drejtim të luftës, përëndim kundrejt lindjes.²⁶Duke qenë që ky ligjërim e injoronte plotësisht dimensionin e kërkesave legjitime politike të shqiptarëve si dhe historinë e gjatë të pakënaqësive të tyre përbrenda Jugosllavisë, e këtu posaçërisht kur kemi parasysh persekutimin sistematik të shqiptarëve nga sistemi hegjemonist serb përbrenda Jugosllavisë së para vitit 1974 - ky

²⁶Nathan Hausman, “Competing narratives: Comparing perspectives on NATO intervention in Kosovo” (2014), 4.

interpretim mund të cilësohet si subjektiv nga aspekti argumentues. Përkundër kësaj, meqë ligjërimi ishte popullist nga natyra, ai pati një efekt në nxitjen dhe polarizimin e mëtutjeshëm të opinionit botëror në raport me krijimin e përshtypjes se ndërhyrja ishte një luftë e deleguar mbi Kosovën për shtrirjen e hegjemonisë perëndimore në shtetet që më herët ishin nën influencën sovjetike (më vonë ruse), kështu duke e prodhuar një tandem të viktimës dhe agresorit.

Kundërshtime për ndërhyrjen e NATO-s kishte edhe nga shtetet anëtare të vet organizatës. Në Francë, Partia Komuniste, e cila ishte anëtare e koalicionit qeverisës në atë kohë, e kundërshtonte ndërhyrjen me arsyetimin se Kombet e Bashkuara nuk kishin mandat për të kryer ndërhyrjen.²⁷ Në të njëjtën mënyrë e kundërshtoi edhe Partia për Socializmin Demokratik (PDS) në Gjermani, që ishte partia pasardhëse e Partisë Socialiste për Unitet në Gjermani, që ishte partia sunduese në Gjermaninë Lindore.²⁸

Reagime të ngjashme pati edhe nga anëtarë të Partisë Komuniste në Greqi, të cilët në akt demonstrimi kishin bllokuar një karvan ushtarak francez që kishte zbarkuar në portin e Selanikut. Opinioni grek në përgjithësi, dhe opozita parlamentare në veçanti, kishte mbajtur anësim serb në raport me situatën e krijuar, duke kundërshtuar në këtë formë ndërhyrjen e SHBA-së dhe aksionet ushtarake të NATO-s.²⁹

²⁷Karen Donfried, *Kosovo: International Reactions to NATO Air Strikes* (Congressional Research Service - The Library of Congress, April 1999), 2.

²⁸Karen Donfried, *Kosovo: International Reactions to NATO Air Strikes* (Congressional Research Service - The Library of Congress, April 1999), 3.

²⁹Karen Donfried, *Kosovo: International Reactions to NATO Air Strikes* (Congressional Research Service - The Library of Congress, April 1999), 4.

Në anën tjetër, ndër mbështetësit më të mëdhenj të kauzës shqiptare ishte Qeveria e Mbretërisë së Bashkuar. Tony Blair në cilësinë e kryeministrit, madje, kishte thënë që as autonomia nuk do të mjaftonte si opSION ideal për Kosovën, kështu duke aluduar në pavarësi. Opinioni britanik në përgjithësi mbante qëndrim mbështetës për ndërhyrjen e NATO-s në Kosovë.³⁰

Shumë më ndryshe ishte reagimi i Rusisë, me të cilin rast Duma ruse kishte ratifikuar rezoluta për dhënien e ndihmave Jugosllavisë. Madje, gjatë vitit 1999 kishte pasur edhe ide që të vendoseshin armë bërthamore në Bjellorusi si manovër taktike kundër lëvizjeve të NATO-s. Për më tepër, Duma kishte kaluar një rezolutë që ftonte Jugosllavinë t'i bashkohej Komonveltit të Shteteve të Pavarura. Megjithatë, Qeveria ruse kishte arritur që t'i zbuste këto zëra në Dumën ruse.³¹

Si pasojë e problemeve të veta të brendshme, respektivisht në raport me Tibetin, Taivanin dhe Xinjiangun, Kina (së bashku me Rusinë dhe Namibinë) kishte votuar pro rezolutës së Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara për ndaljen e sulmeve ajrore të NATO-s. Qëndrimi zyrtar i Kinës ishte se çështja e Kosovës i përket çështjeve të brendshme të Jugosllavisë.³²

Ndërhyrja e NATO-s në veçanti kishte nxitur reagime nga filozofë të së majtës. Slavoj Žižek, e kishte vendosur diskutimin te çështja e politizimit dhe depolitizimit të situatës. Sipas tij, ndërhyrja e NATO-s e kishte depolitizuar problematikën, duke i vendosur

³⁰Karen Donfried, *Kosovo: International Reactions to NATO Air Strikes* (Congressional Research Service - The Library of Congress, April 1999), 7.

³¹Karen Donfried, *Kosovo: International Reactions to NATO Air Strikes* (Congressional Research Service - The Library of Congress, April 1999), 13.

³²Karen Donfried, *Kosovo: International Reactions to NATO Air Strikes* (Congressional Research Service - The Library of Congress, April 1999), 14.

shqiptarët në kallëpet e viktimës. Me të njëjtën arsyetim, ai thotë që NATO i ofron mbrojtje shqiptarëve përderisa ata e mirëmbajnë rolin e viktimës. Mirëpo, Zhizheku i kritikon edhe të majtët duke thënë se duke e politizuar diskursin, ata e mbajnë një lloj jugo-nostalgjie titiste për shtetin e Jugosllav, i cili në fakt në atë pikë nuk ishte më utopia multietnike që të majtët pretendonin se ishte gjatë kohës së Titos. Sipas Zhizhekut, shpërbërja e Jugosllavisë ishte proces dialektik - ata që e kundërshtonin atë në fakt pos e kundërshtonin procesin nacionalist të serbizimit të Jugosllavisë, dhe jo vetë trashëgiminë jugosllave. Beogradi me këtë ritëm kishte vendosur hegjemoni duke e pozicionuar vetën si pasardhësen legjitime të Jugosllavisë, duke thënë se ishte agresioni serb ai që e kishte nisur luftën, e jo konflikti ndëretnik.³³

Në një intervistë të dhënë për Radio Televizionin e Serbisë në vitin 2006, aktivisti dhe filozofi, Noam Çomski, kishte kritikuar ndërhyrjen e NATO-s, duke e cilësuar atë si tendencë e SHBA-së për të shtrirë sundimin neoliberal në bastionin e fundit socialist të Evropës. Në vazhdim të intervistës, ai gjithashtu kishte akuzuar UÇK si dorase e numrit më të madh të vrasjeve deri në janar të vitit 1999³⁴, e dhënë kjo që është lehtësisht e kundërshtueshme përmes të dhënave historike. Të njëjtën vijë argumentimi e kishte ndjekur edhe Michael Parenti në *To kill a nation: The attack on Yugoslavia*.³⁵

Në qasjen kundërshtuese për neoliberalizmin, aktivistë dhe filozofë të së majtës kishin injoruar rrethanat e zhvillimit të

³³Slavoj Zizek, NATO, the Left Hand of God, 29 June 1999, qasur në: <https://www.lacan.com/zizek-nato.htm>

³⁴Noam Chomsky intervistuar nga Danilo Mandic, On the NATO bombing of Yugoslavia, RTS Online, April 25, 2006. Qasur në: <https://chomsky.info/20060425/>

³⁵Michael Parenti, *To kill a nation: The attack on Yugoslavia* (London; New York: Verso Books, 2002).

kundërshtimit shqiptar në raport me Jugosllavinë. Parenti dhe Çomski bëjnë shkelje posaçërisht flagrante në këtë aspekt duke e injoruar dialektikën e kundërshtimit të shqiptarëve - së pari si reaksion kundër shtypjes dhe hegjemonizmit jugosllav dhe serb që nga përfundimi i Luftës së Dytë Botërore dhe më vonë persekutimit sistematik gjatë viteve të '50-ta (duke i cilësuar shqiptarët si informbyroistë). Për më tepër, ata në mënyrë shumë të përshtatshme e kishin injoruar faktin që një pjesë e kundërshtimit antijugosllav buronte pikërisht nga një pikënisje diskursive e majtë gjatë viteve të '70-ta dhe '80-ta të shekullit të kaluar, e udhëhequr nga parime antikolonialiste. Çështja e ndikimit ideologjik marksist nga Shqipëria me lehtësi ishte shpërfillur si ndikim nacionalist, përderisa asnjë nga këta nuk e kishte marrë mundin të trajtojë traktet, programet, apo më së paku pikënisjet ideologjike të lëvizjeve antikolonialiste të majta shqiptare në Jugosllavi. Kjo gjë e qartëson më tepër faktin që qëndrimet gjasmë kundër neoliberalizmit të të majtëve në raport me ndërhyrjen e NATO-s nuk vinin nga ndonjë pikënisje e epërsisë morale në raport me dhunën ose për të dënuar përdorimin e dhunës kundër civilëve, por në fakt vinin sepse ata e kishin përvetësuar një ligjërim serb për konfliktin, i cili që nga zanafilla ishte hegjemonist dhe nacionalist. Ironia qëndron pikërisht te fakti që nga stimulimi ideologjik për të kritikuar nacionalizmin dhe neoliberalizmin perëndimor, ata kishin përvetësuar një ligjërim fashist që ishte fshehur prapa petkut të socializmit, socializëm që në fakt ishte i paqenë që pas vdekjes së Titos, e posaçërisht joekzistent gjatë viteve të '90-ta.

Përfundimisht, kurdoherë që diskutohet ndërhyrja e NATO-s në luftën e Kosovës, duhet pasur parasysh kontekstin historik së pari të evolucionit të strategjisë dhe rolit të NATO-s në mirëmbajtjen e paqes në nivel global, dhe së dyti kontekstin historik të zhvillimit të lëvizjeve kundërshtuese shqiptare ndaj Jugosllavisë. Në të kundërtën,

nëse injorohen këto dy dimensione të zhvillimit të ngjarjeve, atëherë nuk do të jetë e habitshme që ligjërimi të mbetet i mangët dhe subjektiv.

Mrika Limani

SUMMARY

The paper addresses the historical course the evolution of NATO. In this regard, the paper highlights the establishment of the alliance as a product of the circumstances created after the Second World War, and thus places the discussion on the geopolitical tracks of the alliance and the interests it represented. It also addresses the relationship that the other European countries had with the alliance, initially as members that received strong US support. The paper further places the discussion on the history of the Cold War, and NATO's role in maintaining a frozen war between the Soviet Union the US. The development of NATO strategies are pointed out, initially with the strategy known as Massive Retaliation, followed by Mutually Assured Destruction, and Flexible Response, as well as the Harmel report and the war in Afghanistan and finally the NATO intervention in Kosovo. It places these developments as shaped by global circumstances, and contextualizes them with the role that NATO took after dissolution of the Soviet Union in 1991. In this regard, the discussion falls on the importance of the intervention as a humanitarian intervention. Furthermore, the paper sheds light on the discussions that had taken place about NATO intervention in Kosova, mentioning here the countries that were most in favor of the intervention and those that were against it. The paper also sheds light on the analysis of left-wing circles in relation to NATO intervention, highlighting the double standard of criticism for neo-liberalism and the decontextualization of Kosova's anti-colonial movements in favor of appropriating a Serbian nationalist discourse.

Kosova - rruga drejt lirisë

(Materiale nga Konferenca shkencore ndërkombëtare : “*Kosova-rruga drejt lirisë*”, organizuar me rastin e vitit jubilar, 20-vjetorit të çlirimit të Kosovës, Prishtinë, më 11 qershor 2019)

Botues:

Instituti i Historisë “Ali Hadri”,

Formati:

14.8 x 21.8

Madhësi

27.5 tab.aut

Tirazhi:

500 ekzemplarë

U shtyp në shtypëshkronjën:

Nord – Prishtinë

Prishtinë, 2020

Katalogimi në botim - (CIP)

Biblioteka Kombëtare e Kosovës “Pjetër Bogdani”

94(496.51)(062)

323.1(496.51)(062)

“Kosova - rruga drejt lirisë” : (materiale nga konferenca shkencore ndërkombëtare : “Kosova-rruga drejt lirisë”, organizuar me rastin e vitit jubilar, 20-vjetorit të çlirimit të Kosovës, Prishtinë, më 11 qershor 2019) / kryeredaktor Sabit Syla. - Prishtinë : Instituti i Historisë “Ali Hadri”, 2020. - 440 f. ; 21 cm.

1.Syla, Sabit

ISBN 978-9951-409-91-9